


ORIGJINAT LINDORE  
TË QYTETËRIMIT PERËNDIMOR

John M. Hobson



© LOGOS·A  
S H K U P  
P R I S H T I N Ë  
T I R A N Ë  
2 0 1 8

**John M. Hobson**  
**ORIGINAT LINDORE TË QYTETËRIMIT PERËNDIMOR**

**TITULLI I ORIGINALIT:**  
**John M. Hobson**  
**THE EASTERN ORIGINS**  
**OF WESTERN CIVILISATION**  
**Cambridge University Press, 2013**

**Boton: LOGOS-A**  
**Biblioteka: LEXO**

**Për botuesin: Adnan Ismaili**  
**Kryeredaktor: Husamedin Abazi**  
**Redaktor biblioteke: Ali Pajaziti**

**Redaktor artistik & disenji: Edib Agagjyshi**  
**Redaktor teknik: Naser Fera**  
**Mbikëqyrës i shtypit: Kemal Ismaili**  
**Përgatitja kompjuterike: Focus Pro - Shkup**  
**Shtypi: Focus Print**  
**Rr. Pellagonia 3 - Shkup**

**ISBN 978-9989-58-719-1**

**[www.logos-a.com](http://www.logos-a.com)**

**Copyright©Logos-A, 2018**

**Tirazhi: 500**

**Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.**  
**Ky libër mund të kopjohet pjesërisht për përdorim personal dhe jofitimprurës.**  
**Kjo rekomandohet për qëllime promovuese të librit apo edhe për**  
**afirmim të kulturës së leximit në përgjithësi. Por, nuk lejohet riprodhimi,**  
**transmetimi apo kopjimi i këtij libri në tërësi pa lejen paraprake të Logos-A.**




# ORIGJINAT LINDORE TË QYTETËRIMIT PERËNDIMOR

**John M. Hobson**

E PËRKTHEU NGA ANGLISHTJA:

**Bujar M. Hoxha**



*Për ndikimin e tërthortë të stërgjyshit tim, John Atkinson  
Hobson, shkrimet "heretike" të të cilit e kanë përshkuar një pjesë  
të mirë të mënyrës si unë e shpjegoj botën.*

*Ju falënderoj!*

*Mugëtira juaj e vetmuar kurrë nuk ka për t'u shuar.  
Për ndikimin e drejtpërdrejtë të së dashurës sime Cecelia, dhe për  
familjen time, Evangeline, Michael dhe Gabriella, dashuria dhe  
veprimet empatike të të cilëve kanë depërtuar në shumë çka di,  
ndiej dhe kuptoj mbi botën.*

*Ju falënderoj të tërëve!*

*Vetëm agimi juaj i ndritshëm më ngroh për çdo ditë.*

## PËRMBAJTJA:

TABELA .....	7
ORIGINAT LINDORE TË QYTETËRIMIT PERËNDIMOR.....	9
PARATHËNIE DHE FALËNDERIME .....	10
1. KUNDËRSHTIMI I MITIT EUROCENTRIK TË PERËNDIMIT TË KULLUAR: ZBULIMI I PERËNDIMIT ORIENTAL .....	17

### PJESA I

LINDJA SI RAJON ME ZHVILLIM TË HERSHËM:

LINDJA E ZBULON DHE E UDHËHEQ BOTËN PËRMES

GLOBALIZIMIT ORIENTAL, 500-1800..... 51

2. PIONIERËT MUSLIMANË DHE AFRIKANË:

NDËRTIMI I URËS SË BOTËS DHE I EKONOMISË GLOBALE

NË EPOKËN AFRO-AZIATIKE TË ZBULIMEVE, 500-1500..... 53

3. PIONIERËT KINEZË: MREKULLIA E PARË INDUSTRIALE

DHE MITI I IZOLACIONIZMIT KINEZ, RR. 1000-1800 ..... 80

4. LINDJA MBETET DOMINUESE: MITET BINJAKE

TË DESPOTIZMIT ORIENTAL DHE TË IZOLACIONIZMIT NË INDI,

NËAZINË JUGLINDORE DHE NË JAPONI, 1400-1800 .....113

### PJESA II

PERËNDIMI QE I FUNDIT:

GLOBALIZIMI ORIENTAL DHE SHPIKJA

E BOTËS SË KRISHTERË, 500-1498 .....145

5. SHPIKJA E BOTËS SË KRISHTERË DHE ORIGINAT LINDORE

TË FEUDALIZMIT EUROPIAN, RR. 500-1000 .....147

6. MITI I PIONIERËVE ITALIANË, 1000-1492 .....168

7. MITI I EPOKËS SË VASKO DE GAMËS, 1498-RR.1800.....192

**PJESA III**

**PERËNDIMI SI RAJON ME ZHVILLIM TË VONË  
DHE AVANTAZHET E PRAPAMBETJES: GLOBALIZIMI ORIENTAL  
DHE RINDËRTIMI I EUROPËS PERËNDIMORE SI PERËNDIMI  
I PËRPARUAR, 1492-1850 .....223**

**8. MITI I 1492-SHIT DHE PAMUNDËSIA E AMERIKËS: KONTRIBUTI  
AFRO-AZIATIK NË ARRITJEN E Pjesës Tjetër të Botës nga  
PERËNDIMI, 1492-RR. 1700 .....225**

**9. ORIGJINAT KINEZE TË INDUSTRIALIZIMIT BRITANIK: BRITANIA  
SI VEND IMITUES ME ZHVILLIM TË VONË, 1700-1846.....264**

**10. NDËRTIMI I IDENTITETIT RACIST EUROPIAN DHE KONCEPTIMI  
I BOTËS, 1700-1850: MISIONI CIVILIZUES IMPERIAL  
SI NJË NDËRMARRJE MORALE .....302**

**11. ANA E ERRËT E INDUSTRIALIZIMIT BRITANIK DHE MITI I  
LAISSEZ-FAIRE: LUFTA, IMPERIALIZMI RACIST DHE ORIGJINAT  
AFRO-AZIATIKE TË INDUSTRIALIZIMIT.....332**

**PJESA IV**

**KONKLuzion: PERËNDIMI ORIENTAL KARSHI MITIT  
EUROCENTRIK TË PERËNDIMIT .....381**

**12. MITET BINJAKE TË SHITETIT LIBERALO-DEMOKRATIK RACIONAL  
PERËNDIMOR DHE TË HENDEKUT TË MADH MIDIS LINDJES  
DHE PERËNDIMIT, 1500-1900.....383**

**13. NGRITJA E PERËNDIMIT ORIENTAL:  
IDENTITETI/VEPRUESHMËRIA, STRUKTURA GLOBALE  
DHE RASTËSIA .....397**

**INDEKSI .....433**

## TABELA

1.1	Konstruksioni orientalist dhe patriarkal i “Perëndimit karshi Lindjes”	26
1.2	Pikëpamja orientaliste e Maks Veberit mbi “Lindjen” dhe “Perëndimin”: ndarja e madhe e “racionalitetit”	37
10.1	Retorika britanike e imperializmit: tabela e ligës qytetërimore dhe rikrijimi racist i botës	310
11.1	Shpenzimet e vërteta të qeverisë britanike (shpenzimet të shprehura si pjesë e të ardhurave kombëtare)	336
11.2	Barrat (reale) të krahasuara për mbrojtjen të fuqive të mëdha europiane gjatë fazave të tyre respektive të industrializimit	337
11.3	Tarifat mesatare në vendet europiane gjatë fazës së industrializimit	339
12.1	Njohja e të drejtave politike qytetare në shtetet kryesore perëndimore	393
13.1	Ndërtimi dhe pasojat e identitetit perëndimor	418
13.2	Dy vizione të momenteve kyçe në historinë botërore, rr. 500-1900	427



## ORIGINAT LINDORE TË QYTETËRIMIT PERËNDIMOR

John Hobson sfidon tendenciozitetin etnocentrik të përshkrimeve mbizotëruese mbi ngritjen e Perëndimit. Është pretenduar shpesh se, që nga kohët e lashta greke, europianët i kanë prirë zhvillimit të tyre, dhe se Lindja ka qenë një spektatore pasive sa ka të bëjë me historinë progresive të botës. Hobson argumenton se pati dy procese që e mundësuan ngritjen e “Perëndimit oriental”. Së pari, çdo pikë kthese e madhe zhvillimore në Europë mori trajtë në një pjesë të madhe nga përvetësimi i shpikjeve lindore (pra, ideve, teknologjive dhe institucioneve), që përmes globalizimit oriental u përhapën mes viteve 500 dhe 1800 nga Lindja më e përparuar tejndanë ekonomisë globale nën udhëheqjen lindore. Së dyti, ndërtimi i identitetit europian pas vitit 1453 çoi në imperializëm, nëpërmjet të cilit europianët përvetësuan shumë burime lindore (tokën, krahun e punës dhe tregjet). Libri i Hobson-it i shtyn kështu popujt lindorë, të lënë mënjanë deri më tani, në ballë të historisë së progresit në historinë e botës.

John M. Hobson është profesor i politikës dhe i marrëdhënieve ndërkombëtare në Universitetin e Shefildit. Ai është bashkëpërgatitës (me Steve Hobden) i *Historical Sociology of International Relations* (2002), autor i *The State and International Relations* (2000), *The Wealth of States: a Comparative Sociology of International Economic and Political Change* (1997), dhe bashkautor (me Linda Weiss) i *States and Economic Development: a Comparative Historical Analysis* (1995).

## PARATHËNIE DHE FALËNDERIME

Për të risiguruar lexuesin tim të mundshëm që mendon ankthshëm, “jo një libër tjetër tipik mbi ngritjen e Perëndimit,” më lejoni të them se ky nuk është një libër i tillë. Sepse ndryshe thuajse të gjithë librave mbi këtë çështje, ky nuk i rinumëron të tëra temat e njohura sipas kornizës standarde europiane, etnocentrike, të referimit. Në vend të historisë së zakonshme, unë jap një histori që vë në pah Lindjen. Kësisoj, ndonëse qëllimi im dallon në ca pikëpamje nga ai i *Millennium*-it të Felipe Fernández-Armesto-s, prapëseprapë unë e pëlqej atë, gjej kënaqësi në befasimin e lexuesit. Unë përqendrohem në shumë zbulime, popuj e vende lindore, që mundësuan ngritjen e Perëndimit, të tërë të shpërfillur në rrëfimet konvencionale. Nëse do të lejohesha, do të doja të përdorja frazeologjinë e ndeshur në prologun e *Millennium*-it për të përcjellë një përshtypje të asaj për çka është dhe nuk është libri im.

Lexuesi nuk ka për të gjetur në këtë libër asgjë mbi Konfliktin e Shugurimit, mbi Luftën e Tridhjetë Viteve apo mbi Traktatin e Vestfalisë. Ndërsa janë diskutuar komunat tregtare italiane, ato gjatë gjithë kohës bëhen të njohura që ta kenë burimin te zhvillimet më të gjera novatore të pararendura në ekonominë globale të udhëhequr nga Lindja. Rilindja europiane dhe revolucioni shkencor shqyrtohen më tepër nga këndvështrimi i Afrikës së Veriut dhe i Lindjes së Mesme islame, se nga i Toskanisë.<sup>1</sup> Da Vinci, Fiçino

<sup>1</sup> Vihet në dukje se unë e kam përdorur termin “Lindje e Mesme”, e jo “Azia Perëndimore”, vetëm sepse i pari është më i njohshëm për lexuesin e përgjithshëm. Vërehet gjithashtu se unë kam përdorur Wade-Giles-in përkundër sistemit Pinyin për përmendjen e emrave kinezë, e përsëri vetëm sepse i pari është qartas më i njohshëm për lexuesin e përgjithshëm nga ç’është i dyti.

dhe Koperniku bien në gjuhë përpara sojit të esh-Shatirit, el-Harezmit dhe et-Tusiut. Vasko de Gama humbet në hijet e skajuara të krijuara nga shkëlqimi i Azisë. Kjo është e vetmja përmendje e Elizabetës I, Oliver Kromuellit dhe mbretëreshës Viktoria. Luigji XIV dhe Frederiku i Madh shfaqen vetëm për të lypur që të shfajësohen. Për shumicën e periudhës së diskutuar në këtë libër, Madridi, Lisbona, Londra dhe Venecia janë pellgje provinciale të Bagdadit, Kajros, Kantonit dhe Kalikutit. Ekspozita e Madhe e Londrës del të jetë paturpësi, duke patur parasysh se industrializimi i Britanisë është veç faza e fundit e përcjelljes së shpikjeve shumë më të hershme të zëna fill në Kinë. Dhe proceset e industrializimit dhe proteksionizmit të militarizuar, të udhëhequr nga shteti, janë diskutuar dhe janë përdorur, por në kontekstin e Britanisë, e jo të Japonisë së Meixhit. E fundit, por kurrsesi jo më pak e rëndësishme, në vend të “industrializimit të vonë” të Gjermanisë, lexuesit do t’i jepet një diskutim i “zhvillimit të hershëm” të Japonisë së Tokugavës. Në përgjithësi, lexuesi ka për të mësuar shumë më tepër rreth Lindjes, veçanërisht rreth Lindjes së Mesme islame, Afrikës së Veriut, Indisë, Azisë Juglindore, Japonisë, e mbi të gjitha, rreth Kinës, ndonëse duke bërë kështu do të mësojë gjëra të reja për Perëndimin dhe origjinat e tij.


Kësisoj, lexuesi që pret t’i jepen të gjitha hollësitë specifike të zhvillimit perëndimor të para vetëm në një dritë europiane ka për t’u zhgënjyer medoemos. Megjithatë, qëllimi im është saktësisht që ta zhgënjë një lexues të tillë, si do që njëherësh e njoh atë me historinë e humbur të mënyrës se si Lindja mundësoi ngritjen e Perëndimit modern. Në lexuesi është tërësisht i bindur nga argumentet e veçanta të këtij libri më shqetëson më pak, në një kuptim, nga nëse ato janë perceptuar të jenë të freskëta, interesante dhe depërtuese. Dhe unë jam më i interesuar për çështjet dhe pyetjet e

mëdha që shtrojnë argumentet e këtij libri, se për përgjigjet e posaçme që ai jep. Kështu, mund ta risiguroj lexuesin tim të mundshëm në ankth se nuk ka sigurisht vend për një tjetër akoma libër tipik mbi ngritjen e botës perëndimore. Prandaj shpresoj që lexuesi sypatrembur, i cili vijon leximin, ka për ta shijuar këtë udhëtim kundërintuitiv të këtij libri në botën deri më tani të errët të së harruarës përgjithësisht.


Le të kthehem tani të falënderoj një numër njerëzish që në mënyra të ndryshme më kanë dhënë mundësi t'i skicoj këto ujëra më efektivisht se ç'mund të kisha bërë ndryshe. Unë falënderoj personat e mëposhtëm, të cilët dhanë këshilla ndihmuese: Robert Aldrich, Brett Bowden, Jeff Groom, Steve Hobden, David Mathieson, Leanne Piggott, Tim Rowse, Ahmad Shboul dhe Richard White. Falënderoj gjithashtu njerëzit në vijim që lexuan dhe komentuan pjesë thelbësore të dorëshkrimit: Amitav Acharya, Ha-Joon Chang, M. Ramesh, Lily Rahim, Leonard Seabrooke dhe Vanita Seth. Falënderime të dyfishta për Ha-Joon-in për ftesën për t'i bërë të njohura idetë e mia në Departamentin e Studimeve të Zhvillimit në Universitetin e Kembrixhit. Ben Tipton e lexoi me të butë tërë dorëshkrimin dhe dha në mënyrë karakteristike këshillë përkatëse. Falënderoj Michael Mann-in, prej të cilit kam mësuar shumë mbi historinë e botës, e mbetem thellësisht mirënjohës për mbështetjen e tij bujare që kur kisha fatin të diplomohesha në teorinë sociologjike, në LSE, në vitin 1986. Linda Weiss ishte njëlloj mbështetëse në dekadën e fundit. Falënderime të posaçme shkojnë dhe për Eric Jones-in, i cili gjithashtu më ka ndihmuar të mësoj aq shumë mbi historinë botërore përmes shkrimeve të tij (veçanërisht nëpërmjet *Growth Recurring*) dhe bisedave tona vetjake përgjatë viteve.

Falënderime John Haslam-it në CUP, durimi dhe këshilla e ndjeshme redaktoriale e të cilit është si gjithmonë shumë e vlerësuar. Falënderoj në të njëjtën kohë indeksuesin tim, Trevor Matthews, për përpjekjet e tij heroike, si dhe Hillary Scannell-in për korrektimin e saj. Falënderime të veçanta duhet të shkojnë po ashtu për tre recensues anonimë, të cilët bënë shumë komente pozitive, si dhe kritika konstruktive, dhe propozuan rishikimin më thelbësor që kam ndërmarrë deri tani në karrierën time. I falënderoj posaçërisht ngaqë më dhanë mundësinë për të shkruar një libër më të mirë; një libër për të cilin jam sigurisht shumë më i lumtur. Dhe, pa dyshim, kemi shtesën e njohur: që unë jam përgjegjës për çdo gabim.

Në fund, dua të shpreh dashurinë dhe mirënjohjen time më të thellë për të fejuarën time, Cecelia Thomas, e cila shërbeu si mbështetje, udhëzoi dhe sakrifikoi për mua në aq shumë drejtime në tre prej viteve më të trazuara të ngjarjeve jetëndryshuese që kam përjetuar deri më sot. Fuqia e saj njerëzore e sakrificës, ndjeshmëria dhe empatia, përfaqësojnë më të mirën e gjithçkaje të mirë në këtë planet të trazuar, e lëshojnë dritë dhe ngrohtësi mbi vendin tim në të. Këtu kemi shtesën më pak të njohur: që unë jam përgjegjës për çdo gabim vetjak.



*Hartë: projeksioni Hobo-Dyer i botës*





## 1. KUNDËRSHTIMI I MITIT EUROCENTRIK TË PERËNDIMIT TË KULLUAR: ZBULIMI I PERËNDIMIT ORIENTAL

Historia nuk mund të shkruhet sikur t'i përkiste vetëm një grupi [njerëzish]. Qytetërimi është ngritur gradualisht, herë nga kontributet e një [grupi], herë të një tjetri. Kur i gjithë qytetërimi u atribuohet [europianëve], deklarimi është po ai që çdo antropolog mund të dëgjojë çdo ditë nga fiset primitive – vetëm ato e tregojnë historinë e vetes së tyre. Ato po ashtu besojnë se gjithçka që është e rëndësishme në botë nis e mbaron me to... Ne buzëqeshim kur deklarime të tilla bëhen [nga fise primitive], por tallja mund të kthehet dhe kundër nesh... Provincializmi mund ta rishkruajë historinë dhe ta vërë theksin vetëm në arritjet e grupit të historianit, por mbetet provincializëm.

*Ruth Benedict*

Ne kemi mësuar, brenda klasës së shkollës dhe jashtë saj, se ekziston një entitet i quajtur Perëndimi, e se dikush mund ta mendojë këtë Perëndim si një shoqëri dhe qytetërim të pavarur dhe në kundërshti me shoqëritë dhe qytetërimet e tjera [pra, me Lindjen]. Shumë nga ne u rritën madje duke besuar se ky Perëndim ka [një] gjenealogji [autonome], sipas së cilës Greqia e lashtë solli Romën, Roma solli Europën kristiane, Europa kristiane solli Rilindjen, Rilindja solli iluminizmin, iluminizmi solli demokracinë politike dhe revolucionin industrial. Industria, e kryqëzuar me demokracinë, prodhoi Shtetet e Bashkuara, mishërim i të drejtave të jetës, lirisë, dhe kërkimit të lumturisë... [Kjo është] shpërudhëse, e para, sepse e kthen historinë në një rrëfim të suksesit moral, në një garë në kohë në të cilën çdo rendës [perëndimor] në të e kalon pishtarin e lirisë në grupin tjetër të stafetës. Historia kthehet

kështu në një rrëfenjë për çuarjen përpara të virtytit, për atë se si i virtytshmi [pra, Perëndimi] ia del ndaj të mbrapshtëve [Lindjes].

*Eric Wolf*

Pjesa më e madhe prej nesh mendojnë se Lindja dhe Perëndimi janë, dhe gjithmonë kanë qenë, entitete të ndryshme dhe më vete. Ne po ashtu besojmë përgjithësisht se është Perëndimi “autonom” apo “i kulluar” që e ka nisur vetëm krijimin e botës moderne; kjo është, më e pakta, çfarë shumë nga ne kanë mësuar në shkollë, nëse jo në universitet. Ne mendojmë tipikisht se Perëndimi i kulluar që shfaqur në majë të botës aty nga viti 1492 [ço në mendje Kristofor Kolombin], duke iu detyruar racionalitetit të vet shkencor veças gjenial, papushimshmërisë racionale dhe veçorive demokratike/progresive. Që atëherë, thotë pikëpamja tradicionale, europianët bënë për nga jashtë, duke pushtuar Lindjen dhe Perëndimin e Largët, teksa shtrinin njëkohësisht shinat e kapitalizmit, përgjatë së cilave bota e tërë mund të shpëtonte nga kthetrat e papasjes dhe mjerimit e të dilte në dritën e shndritshme të modernitetit. Sipas kësaj, ngjan tërësisht e natyrshme apo e vetëkuptueshme për shumicën prej nesh të shkrihen bashkë përshkrimi progresiv i historisë së botës me Ngritjen dhe Ngadhënjimin e Perëndimit. Kjo pikëpamje tradicionale mund të quhet “eurocentrike”. Sepse në zemër të saj është nocioni se Perëndimi meriton me vend të zërë skenën qendrore të historisë progresive të botës, të së shkuarës dhe së tashmes. Por a e meriton këtë?

Pretendimi bazë i këtij libri përcjell idenë se kjo pikëpamje eurocentrike e njohur, por ngashënjyese mashtrueshmërisht, është e rreme për arsye të ndryshme, mes më të rëndësishmeve prej të cilave veçohet ajo se Lindja dhe Perëndimi kanë qenë të ndërlidhur në mënyrë fundamentale

dhe të vazhdueshme përmes globalizimit që prej vitit 500 të erës së re. Ç'është më e rëndësishme, e nëpërmjet analogjisë, Martin Bernal argumenton se qytetërimi i lashtë grek e kishte prejardhjen, në të vërtetë, në mënyrë domethënëse, nga Egjipti i lashtë.<sup>2</sup> Po ashtu, libri i tanishëm argumenton se Lindja (e cila që më e përparuar se Perëndimi mes viteve 500 dhe 1800) siguroi një rol kritik në mundësimin e ngritjes së qytetëritimit modern perëndimor. Pikërisht për këtë arsye kërkoj që ta zëvendësoj nocionin e Perëndimit autonom apo të kulluar me atë të Perëndimit oriental. Lindja e mundësoi ngritjen e Perëndimit përmes dy proceseve kryesore: përhapjes dhe përvetësimit. Së pari, lindorët krijuan një rrjet të komunikacioneve globale dhe ekonomisë globale pas vitit 500, përgjatë së cilit "kapacitetet burimore" lindore (për shembull, teknologjitë, institucionet dhe idetë lindore) u përhapën anembanë Perëndimit, ku ato u asimiluan më pas përmes asaj që unë e quaj globalizim oriental. Dhe së dyti, imperializmi perëndimor i shtyu europianët pas vitit 1492 që t'i përvetësojnë të gjitha llojet e burimeve ekonomike lindore për të mundësuar ngritjen e Perëndimit. Shkurt, Perëndimi nuk e nisi në mënyrë autonome zhvillimin e vet, në mungesë të ndihmës lindore, sepse ngritja e tij do të kishte qenë e pakonceptueshme pa kontributet e Lindjes. Detyra e këtij libri, pra, është të gjurmojë kontributet e shumëfishta lindore që çuan në ngritjen e atij çka e quaj Perëndimi oriental.

Ky libër nxit debatin midis eurocentrizmit dhe antieurocentrizmit. Një rreth i vogël studiuesish kanë deklaruar në vitet e fundit se teoritë standarde të ngritjes së Perëndimit – teoria e sistemeve botërore/marksizmi, liberalizmi dhe veberianizmi – janë të gjitha eurocentrike.<sup>3</sup> Ata të tërë

<sup>2</sup> Martin Bernal, *Black Athena*, I (London: Vintage, 1991).

<sup>3</sup> Po aty; Samir Amin, *Eurocentrism* (London: Zed Books, 1989); Janet L. Abu-Lughod, *Before European Hegemony* (Oxford: Oxford University Press, 1989); James M.

mendojnë se Perëndimi i “kulluar ia doli” me të tijën si rezultat i virtyteve apo cilësive të tij të bashkëlindura dhe të epërme. Kjo pikëpamje pretendon se Europa u zhvillua në mënyrë autonome përmes një logjike të hekurt imanence. Kësisoj, teori të tilla pretendojnë se ngritja e botës moderne mund të tregohet si historia e ngritjes dhe e ngadhënjimit të Perëndimit. Ç’është e rëndësishme, përshkrimi eurocentrik ka patur një zgjatje jete apo një rigjallërim të ri, veçanërisht me botimin e vitit 1998 të *The Wealth and Poverty of Nations* [Pasuria dhe Varfëria e Kombeve] nga David Landes,<sup>4</sup> të një libri që në mënyrë të nënkuptuar i kthehet punimit *The Triumph of the West* [Triumfi i Perëndimit] të John Roberts-it.<sup>5</sup> Libri i Landes-it në veçanti nis një sulm të rrëmbyer dhe keqësues kundër ca prej analizave të fundit antieurocentrike (ndonëse e gjitha kjo është bërë me frymëzim dhe zgjuars, dhe është një material veçanërisht i këndshëm). Mbase shërbimi më domethënës i Landes-it është se ai ndihmoi shndërrimin e debatit të vjetër teorik të bërë mes teorisë së sistemeve botërore/marksizmit, liberalizmit dhe veberianizmit në një debat të ri të “eurocentrizmit kundër antieurocentrizmit”. Kjo më ngjan se është ajo ku gjendet veprimi i vërtetë intelektual. Sepse, argumentueshëm, debati i vjetër është diçka si jodebat, duke patur parasysh se të gjitha këto qasje duken veç si variacione të vogla apo të pakapshme

Blaut, *The Colonizer's Model of the World* (London: Guilford Press, 1993); Bryan S. Turner, *Orientalism, Postmodernism and Globalism* (London: Routledge, 1993); Jack Goody, *The East in the West* (Cambridge: Cambridge University Press, 1996); Andre Gunder Frank, *ReOrient* (Berkeley: University of California Press, 1998); Kenneth Pomeranz, *The Great Divergence* (Princeton: Princeton University Press, 2000); Clive Ponting, *World History* (London: Chatto & Windus, 2000). Shih gjithashtu punët më të hershme nga Marshall G. S. Hodgson, *The Venture of Islam*, 3 vëllime (Chicago: Chicago University Press, 1974); Eric R. Wolf, *Europe and the People Without History* (Berkeley: University of California Press, 1982).

<sup>4</sup> David S. Landes, *The Wealth and Poverty of Nations* (London: Little, Brown, 1998).

<sup>5</sup> John M. Roberts, *The Triumph of the West* (London, BBC Books, 1985).

mbi të njëjtën temë eurocentrike (shih pjesën tjetër më poshtë). Për rrjedhojë, libri i tanishëm hyn në këtë debat të ri dhe i kundërvihet çdonjërit prej deklarimeve të mëdha të bërë prej eurocentrizmit të vijës së përgjithshme, ndërsa njëherazi propozon një përshkrim alternativ.

Megjithatë mund të thuhet se korniza “eurocentrikja kundër antieurocentrikes” që ky libër e vë në përdorim është një tejthjeshtëzim, është vetë një “jodebat”. Supozimi i një lloj lufte manikeane midis dy ideologjive koherente është problematik përgjithësisht, sepse, mund të pretendohet, nuk ka paradigmë koherente të quajtur “eurocentrizëm”. Sigurisht, unë besoj se do të qe e gabuar të mendohej se shumica e studiuesve po luftojnë për të mbrojtur një vizion “triumfalist” qartas eurocentrik të Perëndimit. Dhe ndërsa ka disa që shkoqur e bashkëshoqërojnë veten me eurocentrizmin (të tillë si Landes dhe Roberts), pjesa më e madhe nuk bëjnë kështu. Prapëseprapë, unë besoj fort se eurocentrizmi i përshkon të tëra përshkrimet e përgjithshme mbi ngritjen e Perëndimit, edhe nëse kjo ngjet përgjithësisht pas shpinës së studiuesit të posaçëm (shih pjesën tjetër më poshtë).

Për pasojë, besoj se është legjitime që ta çoj më tej përshkrimin tim duke i vlerësuar në mënyrë kritike pretendimet e shumta të ngritura nga eurocentrizmi.

Argumenti kryesor i këtij libri kundërshton një prej teorive më bazë të eurocentrizmit: se Lindja ka qenë një spektatore pasive në historinë e zhvillimit historik të botës, si dhe një viktimë apo bartëse e fuqisë perëndimore, dhe se, për pasojë, mund të marginalizohet në mënyrë legjitime nga rrëfimi progresiv i historisë botërore. Sido që ky vëllim dallon në një sërë pikëpamjesh nga libri fenomenal i Felipe Fernández-Armesto-s, *Millennium* [Mijëvjeçar], unë ndaj me të megjithatë besimin e tij empatik se:

Për qëllimet e historisë së botës, skajet kërkojnë nganjëherë më vëmendje se metropoli. Pjesë e misionit të këtij libri është të rehabilitojë të lënë jashtë vëmendjes, duke përfshirë vende shpesh të shpërfillura si periferike, popuj të lënë mënjanë si inferiorë, dhe individë të degdisur në role të vogla dhe në poshtëshënime.<sup>6</sup>

Apo në një kontekst më të ngushtë, siç e shpjegoi W. E. B. Du Bois në parathënien për librin e tij të rëndësishëm, *Africa in World History* [Afrika në Historinë Botërore]:

ka patur një përpjekje të vazhdueshme për ta racionalizuar skllavërinë e zezakëve duke e lënë Afrikën jashtë historisë botërore, kështu që sot pretendohet thujse universalisht se historia mund të shkruhet vërtet pa përmendjen e popujve negroidë ... Prandaj po kërkoj në këtë libër t'u kujtoj lexuesve ... se sa rol kritik ka luajtur Afrika në historinë njerëzore, të shkuar dhe të tashme.<sup>7</sup>

Po ashtu, pretendimi im i madh në këtë libër është se mohimi eurocentrik i veprimit lindor dhe lënia jashtë e Lindjes në përshkrimin progresiv të historisë së botës janë krejtësisht të pavend. Sepse, ne jo vetëm marrim një pikëpamje tejte të shtrembëruar mbi ngritjen e Perëndimit, por njëherësh mësojmë pak mbi Lindjen, përveçse si një objekt pasiv, apo pellg provincial, i historisë së përgjithshme botërore perëndimore.

Ky margjinalizim i Lindjes përbën një heshtje tepër domethënëse, sepse fsheh tre çështje të mëdha. Së pari, Lindja i hyri e para aktivisht zhvillimit të saj të qenësishëm ekonomik aty pas vitit 500. Së dyti, Lindja krijoi dhe ushqeu aktivisht ekonominë globale pas 500-s. Së treti, dhe mbi të gjitha, Lindja ka kontribuar në mënyrë aktive dhe domethënë-

<sup>6</sup> Felipe Fernández-Armesto, *Millennium* (London: Black Swan, 1996), fq. 8.

<sup>7</sup> W. E. B. Du Bois, *Africa and the World* (New York: International Publishers, 1975 [1946]), fq. vii.

se për ngritjen e Perëndimit duke u prirë dhe duke i shpërndarë shumë “kapacitete burimore” të avancuara (për shembull, teknologji, institucione dhe ide) në Europë. Në përputhje me këtë, ne duhet të përtërijmë historinë e dinamizmit ekonomik në Lindje dhe rolin jetik të Lindjes në ngritjen e Perëndimit. Megjithatë, siç do ta shohim gjithashtu, kjo nuk do të thotë se Perëndimi, ka qenë një marrës pasiv i burimeve lindore. Sepse europianët luajtën një rol aktiv në trajtësimin e fatit të tyre (veçanërisht nëpërmjet ndërtimit të një identiteti kolektiv të ndryshueshëm, që në vijim i dha trajtë pjesërisht drejtimit të zhvillimit ekonomik dhe politik të Europës). Në mënyrë të përmbledhur, këto dy pretendime të ndërlydhura – veprimi lindor dhe asimilimi i “kapaciteteve burimore” lindore të përparuara nëpërmjet globalizimit oriental, në njërin anë, gërshetuar me veprimin/identitetin europian dhe përvetësimin e burimeve lindore, në anën tjetër, përbëjnë zbulimin e historisë së humbur së ngritjes së Perëndimit oriental.

Në këtë kontekst, vlen të vihet veçanërisht në dukje se perceptimi ynë i përgjithshëm mbi qenien jashtë loje të Lindjes dhe superioritetin e Europës përforcohet apo “konfirmohet” nga harta e botës e Mercator-it. Kjo hartë gjendet kudo, nga atlaset e botës te muret e shkollës, te agjencitë e rezervimit të linjave ajrore dhe sallat e mbledhjeve. Tejet domethënëse, masa tokësore e vërtetë e hemisferës jugore është saktësisht dyfishi i asaj të hemisferës veriore. Dhe prapëseprapë te Mercator-i masa tokësore e Veriut zë dy të tretat e hartës, ndërsa masa tokësore e Jugut përfaqëson vetëm një të tretën. Kështu, teksa Skandinavia është rreth një e treta e madhësisë së Indisë, i është dhënë e njëjta masë hapësire në hartë. Për më tepër, te Mercator-i, Grënlanda duket pothuajse dyfishi i madhësisë së Kinës, edhe pse kjo e fundit është gati katër herë sa madhësia e së parës. Për të

korrigjuar atë çka e pa si privilegjimin racist të Europës, Arno Peters nxori projeksionin Peters (apo projeksionin Peters-Gall), që kërkoi t'i paraqesë vendet e botës sipas perimetrit të vërtetë të sipërfaqes së tyre. Këtu Jugu duket përshtatshëm shumë më i madh, ndërsa Europa është konsiderueshëm e zbritur një nivel më poshtë. Sido që nuk ekziston asnjë hartë e përsosur e botës, paraqitja e tij është sigurisht e çliruar nga shtrembërimi i nënkuptuar eurocentrik i ndeshur te Mercator-i. Jo habitshëm, kur projeksioni i Peters-it u shfaq fillimisht, pati një stuhi politike, sepse, siç vuri në dukje Marshall Hodgson, "Perëndimorët në mënyrë të kuptueshme u kapën pas një projeksioni [Mercator-it] që aq dukshëm i lajkaton ata".<sup>8</sup>

Ky libër përpiket në thelb ta korrigjojë perceptimin tonë mbi historinë e botës në të njëjtën mënyrë që projeksioni i Peters-it kërkon ta korrigjojë perceptimin tonë mbi gjeografinë botërore, duke zbuluar rëndësinë relative të Lindjes *karshi* Perëndimit. Më specifikisht, unë kam paraqitur një variant të këtij projeksioni ("Hobo-Dyer"-in) në fillim të këtij kapitulli, por e kam ripërvijuar atë për të vendosur Kinën në qendër, duke patur parasysh rolin e saj boshtor në ngritjen e Perëndimit. Me jo më pak rëndësi, SHBA-ja dhe Europa tani zënë si duhet respektivisht skajet periferike të zvoçëluara të Verilindjes së Largët dhe të Veriperëndimit të Largët. Dhe ndërsa Afrika zë gjithashtu Perëndimin e Largët, madhësia e saj e përmirësuar korrigjon marginalizimin e përqësuar në modelin eurocentrik.

Ky kapitull vijon në dy pjesë. E para fillon me gjurmimin shumë shkurtësisht të ndërtimit të ligjërimit eurocentrik ndërsa ai u shfaq gjatë shekullit të tetëmbëdhjetë dhe të nëntëmbëdhjetë. Më pas vazhdohet me tregimin se si shpje-

<sup>8</sup> Marshall G. S. Hodgson, *Rethinking World History* (Cambridge: Cambridge University Press, 1993), fq. 33.

gimet e mëdha të ngritjes së Perëndimit, të gjendura posaçërisht në punën e Karl Marx-it (Karl Marksit) dhe Max Weber-it (Maks Veberit), u mbështetën brenda këtij ligjërimi. Pjesa e dytë e shtjellon shkurt argumentin tim dydegësh si një rrugëdalje për eurocentrizmin mbizotërues të përshkrimeve të përgjithshme.

### **Ndërtimi i bazave eurocentrike/orientaliste të teorive të përgjithshme mbi ngritjen e Perëndimit**

#### *Formimi i identitetit europian dhe krijimi i euocentrizmit/orientalizmit*

Edward Said-i krijoi famëmadrhësisht në vitin 1978 shprehjen “orientalizëm”, ndonëse, ç’është e drejta, një numër studiuesish të tjerë, duke përfshirë Victor Kiernan-in, Marshall Hodgson-in dhe Bryan Turner-in, po mendonin tashmë thujtjese në mënyrë të ngjashme.<sup>9</sup> Orientalizmi apo eurocentrizmi (unë i përdor ato në mënyrë të ndërkyëmbyeshme gjatë gjithë këtij libri) është një botëkyptim që thekson superioritetin e brendaqenësishëm të Perëndimit mbi Lindjen. Posaçërisht orientalizmi ndërton një imazh të përherëshëm të Perëndimit superior (“Vetes”), të përkufizuar negativisht kundrejt “Tjetrit” jo më pak imajinar – Lindjes së prapambetur dhe inferiore. Siç e shpjegon me hollësi kapitulli 10, qe përgjithësisht gjatë shekujve të tetëmbëdhjetë dhe të nëntëmbëdhjetë që ky konstrukt i polarizuar dhe esencialist u bë plotësisht i dukshëm brenda imajinatës europiane. Cilat ishin, atëherë, kategoritë specifike me të cilat Perëndimi nisi ta imajjinojë Vetën e tij si superior ndaj Tjetrit lindor?

<sup>9</sup> Edward W. Said, *Orientalism* (London: Penguin, 1991 [1978]); Victor G. Kiernan, *The Lords of Mankind* (New York: Columbia University Press, 1986 [1969]); Hodgson, *Venture*, I; Bryan S. Turner, *Marx and the End of Orientalism* (London: Allen & Unwin, 1978).

Imagjinata europiane e ndau botën mes viteve 1700 dhe 1850, apo, më saktë, e shtyu, në dy kampe radikalisht të kundërta: Perëndimi dhe Lindja (apo “Perëndimi dhe Pjesa Tjetër”). Perëndimi u imagjinua si superior ndaj Lindjes në këtë konceptim të ri. Vlerat e imagjinuara të Lindjes inferiore u formuluan si antiteza e vlerave racionale (perëndimore). Specifikisht, Perëndimi u imagjinua si i bekuar brendaqenësisht me virtyte unike: ai ishte racional, punëtor, produktiv, sakrifikues dhe kursimtar, liberal-demokrat, i ndershëm, atëror dhe i pjekur, i përparuar, gjenial, proaktiv, i pavarur, progresiv dhe dinamik. Lindja u paraqit atëherë si Tjetri i kundërt i Perëndimit: si irracionale dhe arbitrare, dembele, joproduktive, dorëlëshuar, ekzotike, si dhe ngashënnyese dhe e shturur, despotike, e korruptuar, fëmijërore dhe e papjekur, e prapambetur, joorigjinale, pasive, e varur, e amullt dhe e pandryshueshme. Një tjetër mënyrë e shprehjes së kësaj është të thuash se Perëndimi u përkufizua me një varg pranish progresive, dhe Lindja me një varg mungesash.

Tabela 1.1 *Konstruksioni orientalist dhe patriarkal i “Perëndimit karshi Lindjes”*

Perëndimi dinamik	Lindja e pandryshueshme
Krijues, gjenial, proaktiv	Imituese, e paditur, pasive
Racional	Irracionale
Shkencor	Bestytnore, ritualiste
I disiplinuar, i rregullt, i vetëpërbajtur,	Dembele, kaotike/e parregullt, spontane,
i arsyeshëm, i ndjeshëm	e paarsyeshme, emocionale
I orientuar nga mendja	E orientuar nga trupi, ekzotike dhe ngashënnyese
Atëror, i pavarur, funksional	Fëmijërore, e varur, disfunktionale
I lirë, demokratik, tolerant, i ndershëm	E skllavëruar, despotike, intolerante, e korruptuar

I qytetëruar	E egër/barbare
Progresiv moralisht dhe ekonomisht	Regresive moralisht dhe e amullt ekonomisht

Është veçanërisht me rëndësi që ky proces riimagjinues përcaktoi se Perëndimi kishte qenë gjithmonë superior (ngaqë ky konstrukt u çua pas në kohë, deri në Greqinë e Lashtë). Sepse Perëndimi ka gëzuar nga sa thuhet institucione racionale dhe vlera dinamikisht progresive, liberale dhe demokratike që në krye të herës, që në vijim nxorën në dritë individin racional, jeta e lulëzuar e të cilit mundësoi progres ekonomik dhe kthesën e pashmangshme rrënjësore drejt dritës verbuese dhe ngrohtësisë së modernitetit kapitalist. Në të kundërt, Lindja u damkos si inferiore në mënyrë të pandryshueshme. Ajo ka duruar nga sa thuhet institucione irracionale dhe vlera despotike, që do të thotë se, mu në zemër të errësirës, një kolektivizëm mizor i zuri frymën në lindje individit racional, duke e bërë kështu skllavërinë dhe amullinë ekonomike fatin e saj të përjetshëm. Ky argument formoi bazën e teorisë së despotizmit oriental dhe teorinë e Piter Panit të Lindjes, që përçuan një imazh eternal të një “Perëndimi dinamik” karshi një “Lindjeje të pandryshueshme” (shih tabelën 1.1).

Vështirë të mos vihet re se këto të kundërta dyjare janë saktësisht të njëjtat kategori që përbëjnë identitetin e ndër-tuar patriarkalisht të mashkullorësisë dhe të femërisë. Që do të thotë, Perëndimi modern i ngjason mashkullit të konstruktuar, dhe Lindja femrës së imagjinuar. Kjo nuk është rastësi, sepse, gjatë periudhës së pas vitit 1700, identiteti perëndimor u ndërtua si patriarkal dhe i fuqishëm, ndërsa Lindja u imagjinua njëherësh si femërore, si e dobët dhe e pandihmë. Kjo çoi në paraqitjen orientaliste të një Azie “të shtrirë plogëtisht në pritje për Bonapartin”, ngase vetëm ai

mund ta çlironte atë nga ekzistenca e saj e skllavëruar (një akt çlirimi, që më pas u quajt “barra e njeriut të bardhë”). Dhe kjo teori ishte jetikisht e rëndësishme, sepse, duke e damkosur Lindjen si ekzotike, ndjellëse, ngashënjyese, dhe mbi të gjitha, pasive (pra, si pa iniciativë për t’u zhvilluar vetë), prodhoi me këtë një arsye fundamentale imanente dhe mendjehollë legjitimuese për depërtimin imperial të Perëndimit dhe kontrollin e Lindjes.

Por kjo nuk ishte vetëm një ide legjitimuese për imperializëm dhe për nënshtrimin e Lindjes. Sepse, duke e vizatuar apo duke e imagjinuar Lindjen si të kundërtën pasive të Perëndimit, ky ishte veç një hap i vogël për të prodhuar argumentin se *vetëm* Perëndimi ishte i aftë për zhvillim progresiv në mënyrë të pavarur pararendës. Sigurisht, rrjedhoja e revolucionit intelektual europian ishte ndërtimi i subjektit “proaktiv” europian, dhe i objektit “pasiv” lindor, të historisë botërore. Për më tepër, historia europiane ishte skalitur me një linearitet kohor progresiv, ndërsa Lindja u imagjinua të qeverisej nga cikle regresive amullie. Në veçanti, brenda ligjëritimit eurocentrik, kjo ndarje nënkuptoi një lloj “regjimi aparteidi intelektual”, sepse Perëndimi superior u izolua në mënyrë retrospektive dhe të përhershme nga Lindja inferiore. Apo, në frazën e goditur të Rudyard Kipling-ut, “Oh, Lindja është Lindje, dhe Perëndimi është Perëndim, dhe kurrë dyshja nuk do të takohet.” Kjo ishte me rëndësi të jashtëzakonshme saktësisht sepse e imunizonte Perëndimin nga njohja e ndikimit pozitiv të dhënë nga Lindja përgjatë shumë shekujve, duke nënkuptuar me këtë se Perëndimi i kishte paraprirë zhvillimit të tij në mungesë të plotë të ndihmës lindore që prej kohës së Greqisë së lashtë. Dhe që andej ishte veç një hap i vogël për të deklaruar se historia e botës mund të tregojë vetëm si përshkrimi i Perëndimit pararendës dhe ngadhënjyës që në krye të he-

rës. Në këtë mënyrë lindi miti i Perëndimit të kulluar: se europianët, përmes cilësive të tyre social-demokrate, racionalitetit dhe gjenialitetit superior, i paraprinë zhvillimit të tyre në mungesë të plotë të ndihmës lindore, kështu që kthesa e tyre ngadhënjese drejt kapitalizmit modern ishte e pashmangshme.

Nuk është rastësi që shkencat shoqërore u shfaqën më plotësisht në shekullin e nëntëmbëdhjetë, në kohën kur ky proces i riimagjinimit të identitetit perëndimor arriti kulmin e vet. Sepse prej atëherë europianët e kishin ndarë intelektualisht botën e tërë në dy pjesë antitetike. Por në vend të kritikës për këtë ndarje orientaliste dhe esencialiste Perëndim/Lindje, shkencëtarët shoqërorë ortodoksë perëndimorë, nga shekulli i nëntëmbëdhjetë e gjer sot, jo vetëm e pranuan këtë ndarje të polarizuar si vetëkuptueshëm të vërtetë, por e skalitën atë në teoritë e tyre të ngritjes së Perëndimit dhe të origjinave të modernitetit kapitalist. Si ndodhi kjo?

Më përgjithësisht, siç vë në dukje citati nga Eric Wolf (i shkruar në fillim të këtij kapitulli),<sup>10</sup> brenda teorive mbizotëruese ne mund të pikasim një telelogji jo të dukshme – ndonëse hera-herës të qartë – triumfaliste në të cilën e tërë historia njerëzore po çohet drejt pikës fundore perëndimore të modernitetit kapitalist. Kështu, përshkrimet konvencionale të historisë botërore thonë se e gjithë kjo nisi me Greqinë e lashtë, për të vijuar me revolucionin agrikorik evropian në mesjetën e hershme, e më pas me lulëzimin e tregtisë të udhëhequr nga italianët në mbarim të mijëvjeçarit. Historia vazhdon në mesjetën e mesme, kur Europa i rizbuloi idetë e pastra greke të Rilindja, që, kur u bashkëshoqërua me revolucionin shkencor, me iluminizmin dhe lindjen e demokracisë, e çoi Europën në industrializim dhe në modernitetin kapitalist.

<sup>10</sup> Wolf, *Europe*, fq. 5.

Merr çdo libër konvencional mbi lindjen e botës moderne. Perëndimi është paraqitur zakonisht si *qytetërimi mbizotërues* dhe është shenjtëruar me një cilësi *prometeane* (për të parafrazuar titujt e dy librave të spikatur).<sup>11</sup> Ndërsa shoqëritë lindore janë diskutuar nganjëherë, ato qartazi gjenden jashtë historisë së vijës së përgjithshme. Dhe shpesh ndodh që nëse diskutohet Lindja, diskutimi bëhet në seksione të ndara. Sipas kësaj, mund të përqendrohesh vetëm në seksionet perëndimore dhe të marrësh historinë kryesore. Në këtë mënyrë, shoqëritë lindore shfaqen në thelb si një shmangie apo si një poshtëshënim pa lidhje. Por kjo shmangie është e rëndësishme, jo sepse thotë pak mbi Lindjen, por sepse përshkruan vetëm cilësitë e brendaqenësishme, regressive, që bllokuan përparimin e saj. Edhe një herë, kjo siguron një konfirmim shumë të fuqishëm të superioritetit perëndimor dhe pse “triumfi i Perëndimit” ishte veç një *fait accompli* (fakt i kryer).

Dy pika kryesore janë për t’u shënuar këtu. E para, kjo histori është një e tillë që e imagjimon superioritetin perëndimor prej në krye të herës. Dhe së dyti, historia e ngritjes dhe e triumfit të Perëndimit është ajo që mund të tregohet pa ndonjë diskutim të Lindjes apo të “çka nuk është Perëndim”. Europa është parë si autonome ose vetëformuese, në një rën anë, dhe racionale/demokratike, në anën tjetër, që e bën vetë hapin e madh. Kjo është ajo çfarë unë i referohem si logjika e hekurt eurocentrike e imanencës. Të dyja këto pikëpamje mbështesin nocionin triumfalist eurocentrik të “mrekullisë europiane”, të konceptuar si një “lindje e virgjër”. Për rrjedhojë, historia e origjinave të kapitalizmit (dhe globalizimit) është shkrirë me ngritjen e Perëndimit; përsh-

<sup>11</sup> Për shembull, Joseph R. Strayer dhe Hans W. Gatzke, *The Mainstream of Civilization* (New York: Harcourt Brace Jovanovich, 1979); David S. Landes, *The Unbond Prometheus* (Cambridge: Cambridge University Press, 1969).

krimi i lindjes së qytetërimit dhe kapitalizmit modern është historia perëndimore. Është pikërisht ky nocion që Ruth Benedict kishte në mendje kur e përshkroi konceptin “tonë” mbi historinë botërore si “provincial”.<sup>12</sup> Apo siç thotë Du Bois:

Prej kohësh është besimi i njerëzve modernë se historia e Europës mbulon historinë thelbësore të qytetërimit, me përjashtime të parëndësishme; se progresi i të bardhëve (europianëve) ka qenë përgjatë udhës normale, natyrore, për në kulturën më të lartë të mundshme njerëzore.<sup>13</sup>

Megjithatë, mbetet për t’u parë se si kategoritë e orientalizmit u endogjenizuan brenda përshkrimeve mbizotëruese mbi ngritjen e Perëndimit. Ngaqë autorë të tjerë antieurocentrikë kanë dekonstruktuar një varg studiuesish të spikatur modernë,<sup>14</sup> unë do të përqendrohem këtu në bërjen të njohur të bazave orientaliste të teorive klasike të Marksit dhe Veberit. Ky përqendrim është legjitim, sepse teoritë më të mëvonshme kanë rrjedhur nga Marksi, e veçanërisht nga Veberi, në një mënyrë apo në një tjetër.

### *Bazat orientaliste të marksizmit*

Mund të mendohet se marksizmi *nuk* do t’i përshtatej shtampës orientaliste, duke patur parasysh se Karl Marksi ishte një prej kritikëve më të ashpër të kapitalizmit perëndimor. Por fakti është se Marksi e privilegjoj Perëndimin si subjekti aktiv i historisë progresive të botës dhe e denigroi Lindjen si veç objekti i saj pasiv. Dhe, në vazhdim, teoria e Marksit i demonstroi të gjitha veçoritë dalluese të historisë eurocentrike të botës. Si kështu?

<sup>12</sup> Ruth Benedict, *Race: Science and Politics* (New York: Modern Age Books, 1940), fq. 25-26.

<sup>13</sup> Du Bois, *Africa*, fq. 148.

<sup>14</sup> Shih veçanërisht James M. Blaut, *Eight Eurocentric Historians* (London: Guilford Press, 2000).

Teoria e Karl Marksit thoshte se Perëndimi ishte unik dhe kishte një histori zhvillimore që pati munguar në Lindje. Sigurisht, ai shprehej qartë se Lindja *nuk* kishte patur histori (progresive). Kjo u përsërit në artikuj gazetash dhe në pamflete të shumta. Për shembull, Kina ishte një “gjysmëcivilizim i kalbur ... që vegjeton përkundër kohës”.<sup>15</sup> Si rrjedhim, e vetmja shpresë e Kinës për emancipim progresiv apo për shpëtim gjendet te Luftërat e Opiumit dhe te inkursionit i kapitalistëve britanikë që do ta “hapnin” Kinën “e prapambetur” ndaj impulsit energjizues të tregtisë botërore kapitaliste.<sup>16</sup> India po ashtu qe pikturuar me të njëjtin penel.<sup>17</sup> Kjo formulë u çua përpara në mënyrë më të mirënjohur te *The Communist Manifesto* [Manifesti Komunist], ku ne na thuhet se borgjezia perëndimore,

i tërheq të gjitha kombet, edhe më barbarët, në qytetërim ... Ajo i detyron të gjitha kombet, po nuk deshën të shuhen, të pranojnë mënyrën borgjeze [perëndimore] të prodhimit, i shtrëngon të fusin në mesin e tyre atë çka ajo e quan qytetërim, domethënë, të bëhen vetë [perëndimore]. Me një fjalë, ajo [borgjezia perëndimore] krijon një botë sipas imazhit të saj.<sup>18</sup>

Mospranimi i Lindjes nga Marks i nuk u kufizua me artikujt e tij të shumtë të gazetave (jo më pak se shtatëdhjetë e katër mes viteve 1848 dhe 1862) dhe pamfletet e ndryshme, por u skalit fundamentalisht në skemën teorike të qasjes së tij historike materialiste. Kritike këtu ishte koncepti i tij mbi “mënyrën aziatike të prodhimit”, ku mungonin në

<sup>15</sup> Karl Marx, te Shlomo Avineri, *Karl Marx on Colonialism and Modernization* (New York: Anchor, 1969), fq. 184, 343; shih gjithashtu, Brendan O’Leary, *The Asiatic Mode of Production* (Oxford: Blackwell, 1989), fq. 69.

<sup>16</sup> Karl Marx, “Chinese Affairs” (1862), te Avineri, *Marx*, fq. 442-444.

<sup>17</sup> Për shembull, Karl Marx, “The Future Results of British Rule” (1853), te Avineri, *Marx*, fq. 132-133; Karl Marx, *Surveys from Exile* (London: Pelican, 1973), fq. 320.

<sup>18</sup> Karl Marx dhe Friedrich Engels, *The Communist Manifesto* (Harmondsworth: Penguin, 1985), fq. 84.

mënyrë të dukshme “prona private” dhe, që këtej, “lufta e klasave”, motori zhvillimor i progresit historik. Siç e shpjegoj ai te *Capital*-i [Kapitali], në Azi, “prodhuesit e drejtpërdrejtë ... [janë] nën vartësinë e drejtpërdrejtë të një shteti i cili u qëndron mbi kokë si pronar toke ... [Sipas kësaj,] nuk ekziston asnjë pronësi private e tokës.”<sup>19</sup> Dhe ishte përthithja, e, që këtej, dështimi për të prodhuar një tepricë për riinvestime në ekonomi që “siguroi çelësin për të fshehtën e *pandryshueshmërisë* së shoqërive aziatike”.<sup>20</sup> Shkurt, prona private dhe lufta e klasave dështuan pjesërisht për t’u shfaqur ngaqë forcat e prodhimit zotëroheshin nga shteti despotik. Në këtë mënyrë, amullia u gdhend në këtë sistem të tokës të zotëruar publikisht sepse rentat u nxorën nga prodhuesit, në formën e “taksave të zhvatura prej tyre, shpesh me anë të torturës, nga një shtet i pamëshirshëm despotik”.<sup>21</sup>

Ky skenar binte ndesh fundamentalisht me situatën europiane. Në Europë, shteti nuk qëndronte mbi shoqërinë, por ishte i mbërthyer në thelb brenda klasës ekonomike mbizotëruese dhe bashkëpunonte me të. Në vijim, duke qenë i paaftë për të nxjerrë një tepricë përmes tatimit të lartë, shteti lejonte një hapësirë për t’u shfaqur, nëpërmjet së cilës kapitalistët mund të akumulonin një tepricë [pra, fitime] për t’u riinvestuar në ekonominë kapitaliste. Për pasojë, progresi ekonomik u perceptua si privilegji unik i Perëndimit. Kështu, çfarë ne kemi në kuptimin teorik të Marksit mbi Lindjen dhe Perëndimin është teoria e despotizmit oriental (që më pas e gjeti zërin e saj më të famshëm te libri neomarksist i Karl Wittfogel-it).<sup>22</sup> Eshtë e vërtetë se nocioni i Marksit mbi mënyrën aziatike të prodhimit u soll

<sup>19</sup> Karl Marx, *Capital*, III (London: Lawrence and Wishart, 1959), fq. 791, 333-334; Marx, *Capital*, I (London: Lawrence and Wishart, 1954), fq. 140, 316, 337-339.

<sup>20</sup> Marx, *Capital*, I, fq. 338; theksimi me kursiv është i imi.

<sup>21</sup> Karl Marx, *Capital*, III, fq. 726.

<sup>22</sup> Karl Wittfogel, *Oriental Despotism* (New Haven: Yale University Press, 1963).

mes fuqive mbytëse të shtetit despotik, në njëren anë, dhe rolit asfiksues të prodhimit të përbashkët rural, në anën tjetër. Por se cili faktor ishte vendimtar nuk e zbeh besimin e tij të qëndrueshëm se Lindja nuk kishte perspektivë për vetëzhvillim progresiv dhe, prandaj, mund të shpëtohej vetëm nga imperialistët kapitalistë britanikë.

Me jo më pak rëndësi, e tërë teoria e Marksit mbi historinë riprodhon besnikërisht parashtrimin teleologjik orientalist apo eurocentrik. Te *The German Ideology* [Ideologjia Gjermane], Marksi i gjen origjinat e modernitetit kapitalist te Greqia e lashtë, burimi i qytetërimit (dhe te *Grundrisse* ai hedh poshtë qartazi rëndësinë e Egjiptit të lashtë).<sup>23</sup> Ai atëherë rrëfen historinë e njohur eurocentrike të progresit linear/imanent, drejt feudalizmit europian dhe drejt kapitalizmit europian, pastaj drejt socializmit, përpara se të kulmohet me pikën fundore të komunizmit.<sup>24</sup> Në këtë mënyrë, njeriu perëndimor kishte lindur fillimisht i lirë në “komunalizmin primitiv, dhe, duke kaluar përmes katër epokave progresive historike, do të emanciponte në fund veten, si dhe aziatikun, nëpërmjet luftës revolucionare të klasave. Për Marksin, proletariati perëndimor është “Populli i Zgjedhur” i njerëzimit jo më pak nga ç’është borgjezia perëndimore “Populli i Zgjedhur” i kapitalizmit global. Qasja e anasjellë hegeliane e Marksit i dha udhë një historie progresive/lineare, në të cilën speciet [perëndimore] iu afruan më pranë lirisë përmes luftës së klasave me çdo epokë kalimtare historike.

Asnjë “linearitet” i tillë progresiv nuk ishte i mundur në Orient, ku “ciklet” represive të rritjes të regjimeve despotike politike dhe të sistemeve regresive të prodhimit rural nuk bënë më shumë se mbetja në vend. Nënvizimi i kë-

<sup>23</sup> Karl Marx, *Grundrisse* (New York: Vintage, 1973), fq. 110.

<sup>24</sup> Karl Marx, *The German Ideology* (London: Lawrence and Wishart, 1965).

saj qasjeje të tërë është një mohim i qartë i veprimit lindor. Për të parafrazuar diskutimin e Marksit mbi dallimin midis një “klase në vetvete” proletare (që përfaqëson inercinë dhe pasivitetin) dhe një “klase për vetveten” (që përfaqëson një prirje proaktive për emancipim), është sikur Marks i ta shih-te Lindjen si një “qenie në vetvete”, që ishte brendaqenë-sisht e paaftë për t’u bërë një “qenie për vetveten”. Në të kundërt, Perëndimi ishte që në fillim një “qenie për vetveten”. Për më tepër, nuk ngjan rastësi që ndikimi hegelian në punën e Marksit të ketë prodhuar këtë çift dyjar “Perëndim progresiv/Lindje regressive”, saktësisht sepse, për Hegelin, Fryma superiore e Perëndimit është liri progresive, ndërsa Fryma inferiore e Lindjes është despotizëm regresiv, i pandryshueshëm.<sup>25</sup> Me pak fjalë, për Marks, Perëndimi ka qenë mbartësi ngadhënyjes i progresit historik, Lindja veç përfituesi i tij pasiv.

Përgjithësisht ngjan e drejtë ta quash qasjen e Karl Marksit si “orientalizëm i skuqur”.<sup>26</sup> Megjithatë, e tëra kjo nuk do të thotë se marksizmi është në agoni, sepse ai pa dyshim mbetet i përdorshëm dhe perceptues. Por do të thotë se, si një kornizë e përgjithshme, mbetet i mbërthyer fort brenda një ligjërimi orientalist.

### ***Bazat orientaliste të veberianizmit***

Askund nuk është më e qartë qasja orientaliste se në punët e sociologut gjerman Maks Veber. E tërë qasja e Veberit u mbështet në pyetjet orientaliste më të mprehta: ç’ngjau me Perëndimin që e bëri të pashmangshme udhën e tij drejt kapitalizmit modern? Dhe pse ishte Lindja e para-

<sup>25</sup> Georg W. F. Hegel, *The Philosophy of History* (New York: Dover Publications, 1956).

<sup>26</sup> Teshale Tibebu, “On the Question of Feudalism, Absolutism, and the Bourgeois Revolution”, *Review* 13 (1) (1990), 83-85.

caktuar për prapambetje ekonomike? Nuanca orientaliste të Veberi gjendet me pyetjet e fillimit dhe me metodologjinë e mëpastajme që ai përdori për t'iu përgjigjur atyre. Pikëpamja e Veberit ishte se esenca e kapitalizmit modern gjendej të shkalla e tij unike dhe e dukshme e “racionalitetit” dhe “parashikueshmërisë”, vlera që mund të gjendeshin vetëm në Perëndim. Nga këtej, siç vë në dukje Randall Collins,

logjika e argumentit të Veberit është së pari për t'i përshkruar këto karakteristika; më pas për të treguar *pengesat për to që ishin të pranishme në thuajse të gjitha shoqëritë e historisë botërore deri në shekujt e fundit në Perëndim*; dhe, në fund, me metodën e analizës krahasuese, për të treguar kushtet shoqërore përgjegjëse për shfaqjen e tyre [unike në Perëndim].<sup>27</sup>

Kjo është logjikë e pastër orientaliste, duke patur parasysh se Veberi përzgjedhi apo i dha atribut një vargu veçorish progresive që ishin unike nga sa thuhej për Perëndimin. Dhe ai njëherësh këmbënguli në mungesën e tyre në Lindje, ku një seri bllokimesh imagjinare siguruan dështimin e saj për të përparuar. Domethënë, ai nuk i përzgjedhi objektivisht aspektet kyçe që e bënë të mundur ngritjen e Perëndimit. Ai, në fakt, ua atribuoi atyre jo më pak nga çka ia atribuoi një serie bllokimesh imagjinare që supozueshëm e bënë të pashmangshëm dështimin e Lindjes (një pretendim të cilin unë e tregoj gjatë gjithë këtij libri). Karakteri orientalist i shabllonit të tij analitik i zbulohet më qartë në përshkrimin e Lindjes dhe Perëndimit (shih tabelën 1.2).

Krahasimi kritik këtu është midis tabelave 1.1 dhe 1.2. Ky krahasim vërteton se Veberi i ndërkëmbeu në mënyrë të përsosur kategoritë eurocentrike në konceptet e tij qendrore

<sup>27</sup> Randall Collins, *Weberian Sociological Theory* (Cambridge: Cambridge University Press, 1986), fq. 23, theksimi im me kursiv.

sociale shkencore. Kështu, Perëndimi u bekua me një varg unik institucionesh racionale që ishin liberale dhe lejuese të rritjes. Faktorët lejues të rritjes bien në sy për praninë e tyre në Perëndim dhe për mungesën e tyre në Lindje.<sup>28</sup> Këtu, ndarja e Lindjes dhe Perëndimit sipas pranisë respektivisht të institucioneve irracionale dhe racionale i bën së tepërmi jehonë teorisë së Piter Panit mbi Lindjen. Në veçanti, dy kategoritë përfundimtare të gjendura në fund të tabelës meritojnë theksim. E para, dallimet në dy qytetërimet janë përmbledhur në pretendimin e Veberit se moderniteti kapitalist perëndimor karakterizohet nga një ndarje fundamentale e sferave publike dhe private. Në shoqëritë tradicionale (si në Lindje) nuk kishte ndarje të tillë. Në mënyrë tejet domethënëse, vetëm kur ka një ndarje të tillë mund të mbizotërojë racionaliteti formal, *lajtmotivi* i modernitetit. Kjo supozohet se i përshkon të gjitha sferat, politike, ushtarake, ekonomike, sociale dhe kulturore.

Tabela 1.2 *Pikëpamja orientaliste e Maks Veberit mbi "Lindjen" dhe "Perëndimin": ndarja e madhe e "racionalitetit"*

Oksident (modernitet)	Orient (traditë)
E drejtë racionale (publike)	E drejtë e posaçme (private)
Regjistrim i dyfishtë	Mungesë e llogarisë racionale
Qytete të lira dhe të pavarura	Kampe politike/administrative
Borgjezi e pavarur urbane	Tregtarë të kontrolluar nga shteti
Shtet racional-ligjor (dhe demokratik)	Shtet patrimonial (despotik oriental)
Shkencë racionale	Misticizëm
Etikë protestante dhe shfaqja e individit racional	Religjione represive dhe mbizotërim i kolektivitetit

<sup>28</sup> Shih, në veçanti, nga Weber-i, *The Religion of China* (New York: The Free Press, 1951); *The Religion of India* (New York: Don Martindale, 1958); *General Economic History* (London: Transaction Books, 1981); *The Protestant Ethic and the Spirit of Capitalism* (New York: Charles Scribner's Sons, 1958).

**Përbërja bazë institucionale e Perëndimit**

Qytetërim i copëzuar, me një balancë të pushtetit shoqëror midis të gjitha grupeve dhe institucioneve (pra, sistem shumëshitetëror apo qytetërim me shumë aktorë pushteti)  
Ndarje e sferave publike dhe private (institucione racionale)

**Përbërja bazë institucionale e Lindjes**

Qytetërim të unifikuar, pa asnjë balancë shoqërore pushteti midis grupeve dhe institucioneve (pra, sisteme njëshitetërore apo perandori dominimi)  
Shkrimje e sferave publike dhe private (institucione irracionale)

Veçoria e dytë e përgjithshme dalluese midis Orientit dhe Oksidentit ishte ekzistenca e një “balance shoqërore pushteti” te i dyti dhe mungesa e saj në të parin. Duke marrë shembull nga Veberi, analizat neoveberiane bëjnë dallimin e “qytetërimeve me shumë aktorë pushteti”, apo të sistemit shumëshitetëror evropian, nga sistemet njëshitetërore lindore, ose “perandoritë e dominimit”.<sup>29</sup> Dhe ato, ashtu si teoricienët marksianë të sistemeve botërore, si edhe një numër jomarksistësh,<sup>30</sup> theksojnë rolin jetik që luajti lufta midis shteteve në ngritjen e Europës (që, “për definicion”, nuk ekzistoi në perandoritë njëshitetërore në Lindje). Është pikërisht këtu ku teoria e despotizmit oriental bëhet boshtore. Vetëm Oksidenti pati një balancë të paqëndrueshme të institucioneve dhe forcave shoqërore, ku asnjë nuk mund të mbizotëronte.<sup>31</sup> Qeverisësit shekullarë evropianë nuk mund të sundonin mbi një model despotik. Ata u dhanë “fuqi dhe liri” individëve në shoqërinë civile, fillimisht fisnikëve, e më pas borgjezisë. Nga viti 1500, sundimtarët mezi prisnin

<sup>29</sup> Për shembull, Anthony Giddens, *The Nation-State and Violence* (Cambridge: Polity, 1985).

<sup>30</sup> Për shembull, Immanuel Wallerstein, *The Modern World System*, I (London: Academic Press, 1974); Giovanni Arrighi, “The World according to Andre Gunder Frank”, *Review* 22 (3) (1999), 348-353; Jared Diamond, *Guns, Germs and Steel* (London: Vintage, 1998).

<sup>31</sup> Max Weber, *Economy and Society*, II (Berkeley: University of California Press, 1978), fq. 1192-1193.

ta inkurajonin kapitalizmin me qëllim që t'i shtonin të ardhurat nga taksat përballë rivalitetit të vazhdueshëm ushtarak, gjithnjë e më tepër të kushtueshëm, midis shteteve. Në të kundërt, në Lindje, mbizotërimi i "sistemeve njëstetërore" çoi në perandoritë e dominimit, në një pjesë të madhe ngaqë mungesa e rivalitetit ushtarak e çliroi shtetin nga presioni i detyrimit për të ushqyer zhvillimin e shoqërisë. Kështu, në kontrast me feudin (pronësinë e trashëgueshme të tokës) që sundimtarët perëndimorë i kishin dhënë fisnikërisë diçka përpara vitit 1500, fisnikëve lindorë u ishte zënë fryma nga shteti despotik apo patrimonial, i cili imponoi të drejtat e prebendës (të drejta që e pengonin konsolidimin e pushtetit të kësaj klase). Për më shumë, borgjezia lindore ishte plotësisht e shtypur nga shteti despotik apo patrimonial dhe qe kufizuar në "kampe administrative", në dallim nga "qytetet e lira", që nga sa thuhej gjendeshin vetëm në Perëndim. Veç kësaj, sundimtarët europianë ishin gjithashtu të ekuilibruar kundrejt pushtetit të Perandorisë së Shenjtë Romake, si edhe papatit, që binte ndesh me çezaropapizmin (ku institucionet fetare dhe politike ishin shkriur). Në fund, ndërsa njeriu perëndimor u mburrte me një "parehati racionale" dhe me një "etikë" transformuese "të zotërimit të botës", pjesërisht për shkak të impulsit energjizues të Protestantizmit, njeriu lindor ishte i bllokuar nga fetë regresive, dhe, nga kjo, qe karakterizuar nga një fatalizëm afatgjatë dhe një konformitet pasiv me botën. Për pasojë, ngritja e kapitalizmit ishte po aq një pashmangshmëri në Perëndim sa ç'ishte një pamundësi në Lindje.

Përmbledhurazi, ndonëse argumenti veberian ka një përmbajtje ndryshe nga i Marksit, të dy punuan brenda një kornize orientaliste. Dhe lidhja e qartë këtu gjendet në pozicionin qendror që të dy i japin mungesës së despotizmit oriental në Perëndim, në njërën anë, dhe logjikës së atribuar

europiane të imanencës, në anën tjetër. Për rrjedhojë, siç u vu në dukje më herët, kur shihen përmes një prizmi antieu-rocentrik, këto këndvështrime të ashtuquajtura radikalisht të kundërta shfaqen veç si variacione të holla mbi saktësisht të njëjtën temë orientaliste.

Mbase rrjedhoja më domethënëse e ndërtimit nga Maks Veberi të shabllonit teorik eurocentrik është se ai i ka përshkuar pothuajse të gjithë përshkrimet eurocentrike mbi ngritjen e Perëndimit, edhe nëse, siç vë në pah po ashtu James Blaut, shumë prej autorëve relevantë nuk do ta pranonin veten as si veberianë, as si orientalistë.<sup>32</sup> Kjo vështirë të jetë befasuese, duke patur parasysh se të gjithë studiuesit e vijës së përgjithshme e fillojnë analizën e tyre duke bërë pyetjen standarde veberiane: pse *vetëm* Perëndimi çau drejt kapitalizmit modern, ndërsa, në të kundërt, Lindja ishte e dënuar të mbetej në varfëri? Kur u shpreh në këtë mënyrë, një histori orientaliste u bë e pashmangshme, sepse pyetja e çoi pyetësin (shpesh në mënyrë të paqëllimtë) t'i atribuojë një pashmangshmëri si ngritjes së Perëndimit dhe amullisë së Lindjes. Si kështu? Përdorimi i konceptit orientalist të “ndarjes” dyjare “Perëndim-Lindje” i furnizoi studiuesit perëndimorë me përgjigjen e pashmangshme: se vetëm Perëndimi kishte gjenialitetin dhe cilësitë progresive për të bërë hapin e madh – vlera që qe çmuar të mungonin tërësisht në Lindje që prej fillimit. E shtruar në këtë mënyrë, pyetja lypi përgjigjen: si Perëndimi liberal, gjenial dhe progresiv, bëri përpara drejt modernitetit kapitalist në dallim nga Lindja regresive, despotike, fati eternal i së cilës gjendej te amullia dhe skllavëria? Kështu, kategoritë thelbësore shkakore ishin caktuar tashmë përpara hulumtimit historik.

Por mund të jepet përgjigje se është e arsyeshme të fillohet me vënien në dukje të gjendjes aktuale, të një Perën-

<sup>32</sup> Blaut, *Colonizer's Model*, kapitulli 2.

dimi të përparuar dhe të një Lindjeje të prapambetur, e më pas me shqyrtimin e së shkuarës, për të “zbuluar” faktorët që e bënë këtë kështu. Problemi është se me ekstrapolim retropektivisht të nocionit të një Lindjeje të prapambetur është bërë një rrëshqitje e vogël, por e gabuar: në “zbulimin” e bllokimeve të ndryshme që e mbajtën pas Lindjen, eurocentrizmi përfundon me atribuimin Lindjes një “ligj të hekurt” të përhershëm “johzvillimi”. Dhe mbi të gjitha, ngaqë eurocentrizmi e vlerëson Lindjen vetëm përmes prizmit të hapit të madh përfundimtar të Perëndimit drejt kapitalizmit modern, çdo zhvillim teknologjik apo ekonomik i bërë në Lindje është hedhur poshtë menjëherë si jologjik. Në të kundërt, me marrjen e superioritetit perëndimor të ditëve të sotme si një fakt, dhe, më pas, me ekstrapolim të këtij konceptimi pas përmes kohës historike, pyetësi përfundon domosdoshmërisht duke i atribuar Perëndimit një “ligj të hekurt” të përhershëm “të zhvillimit imanent”. Kjo është bërë problematike nga argumenti qendror i këtij libri: se nuk kishte asgjë të pashmangshme rreth ngritjes së Perëndimit, saktësisht sepse Perëndimi nuk ishte askund si gjenial apo moralisht progresiv, siç pretendon eurocentrizmi. Sepse, pa dorën ndihmëse të Lindjes më të përparuar në periudhën nga viti 500 në vitin 1800, Perëndimi ka shumë të ngjarë të mos kishte kapërcyer kurrë në modernitet.

Në këtë mënyrë, një pjesë e mirë e mendimit tonë perëndimor nuk është shkencor dhe objektiv, por është i orientuar përmes një këndvështrimi me një sy, që reflekton vlerat e paragjykuara të Perëndimit, dhe që medoemos e pengon hulumtuesin nga shikimi i tablosë së plotë. Kjo është ekuivalente me atë çka Blaut e quan “historia e tunelit eurocentrik”.<sup>33</sup> Çfarë ngjet, atëherë, kur ne e shohim botën nëpërmjet një këndvështrimi më përfshirës me dy sy?

<sup>33</sup> Po aty, fq. 5.

## Iluzioni i eurocentrizmit: zbulimi i Perëndimit oriental

Eshtë e rëndësishme të vihet në dukje se tendencioziteti eurocentrik dhe i nënkuptuar “triumfalist” i teorive tona mbizotëruese nuk i bën domosdoshmërisht ato të pasakta. Në të vërtetë, siç ka argumentuar së fundi studiuesi i vetëshpallur eurocentrik David Landes, ka në fakt arsye shumë të mirë për eurocentrizmin, sepse është Perëndimi, dhe jo Lindja, që ka triumfuar, ngaqë, pretendon ai, vetëm europianët ia dolën t’i paraprijnë përparimit drejt modernitetit kapitalist. Për pasojë, Landes-i e hedh poshtë përshkrimin antieurocentrik si “mirëmendim i saktë politikisht”, apo “eurofobik” a thjesht “histori e keqe”.<sup>34</sup> Por argumenti im qendror kërkon të thotë se historia eurocentrike është problematike jo sepse është e pasaktë politikisht, por sepse nuk përputhet me atë që ngjau vërtet. David Landes-i kundërshton me forcë në librin e tij të vetëshpallur eurocentrik. Siç parashtron:

Një shkollë e tretë [në të cilën libri i tanishëm do të përfshihej] do të argumentonte se dikotomia Perëndim-Pjesa Tjetër [Perëndim-Lindje] është thjesht e rreme. Në rrjedhën e madhe të historisë botërore, Europa është një e vonuar dhe shfrytëzuese e arritjeve të mëhershme të të tjerëve. Kjo është haptas e pasaktë. Siç tregon dokumentimi historik, Europa [Perëndimi] ka qenë gjatë një mijë viteve të fundit forca kryesore lëvizëse e zhvillimit dhe modernitetit. Kjo prapëseprapë e lë çështjen morale. Ca do të thonin se eurocentrizmi është i keq për ne, sigurisht, i keq për botën, prandaj duhet shmangur. Ata një-rëz do ta shmangin atë. Sa për mua, unë parapëlqej të vërtetën ndaj mirëmendimit. Unë ndihem më i sigurt për truallin tim.<sup>35</sup>

<sup>34</sup> Landes, *Wealth*, kapitulli 29.

<sup>35</sup> Po aty, fq. xxi.

Por dokumentimi historik empirik që unë pashë bën të ditur se Lindja ka qenë për pjesën më të madhe të një mijë viteve të fundit forca kryesore lëvizëse e zhvillimit botëror. Studiuesit konvencionalë ua atribuojnë, pa përjashtim, shteteve perëndimore pararojën e fuqisë globale në një mijë vitet e fundit. Por problemi i atypëratyshëm është se fuqitë perëndimore vetëm shfaqen të kenë qenë dominuese ngaqë një pikëpamje eurocentrike vendosi nga fillimi se asnjë fuqi lindore nuk mund të përzgjidhej në të. Ashtu siç tregon ky libër, të gjitha të ashtuquajturat “fuqi udhëheqëse perëndimore” ishin inferiore, ekonomikisht dhe politikisht, kundrejt fuqive udhëheqëse aziatike (shih kapitujt 2-4 dhe 7). Qe vetëm pranë fundit të periudhës (rreth vitit 1840) që një fuqi perëndimore e eklipsoi më në fund Kinën.

Megjithatë, Landes-i do të pretendonte sërish se, edhe nëse e gjitha kjo ishte e vërtetë, qëndron fakti se vetëm evropianët arritën të çanin vetë drejt modernitetit kapitalist. Apo, siç shprehet Lynn White: “Një gjë është aq e sigurt, sa duket budallallëk ta tjerresh: si teknologjia moderne dhe shkencat moderne janë dallueshëm *oksidentale*”.<sup>36</sup> Por, siç e thashë më herët, Perëndimi vetëm kapërceu në modernitet, sepse ai u ndihmua nga përhapja dhe përvetësimi i burimeve dhe kapaciteteve burimore më të përparuara lindore. Ngaqë suksesi i përshkrimit tim duhet të gjendet te dëshmia empirike që rendit, e jo sepse është thjesht “mirëmendim”, cilat janë atëherë ca prej fakteve empirike që e mbështesin përshkrimin tim alternativ antieurocentrik? Le të marrim përhapjen dhe asimilimin e kapaciteteve burimore lindore përmes globalizimit oriental, së pari, përpara kthimit të përvetësimi i burimeve lindore nëpërmjet imperializmit evropian.

<sup>36</sup> Lynn White, cituar te Blaut, *Eight Eurocentric Historians*, fq. 39 (theksimi me kursiv është në origjinal).

Një shembull njohës gjendet te çka e quaj “miti i Vasko de Gamës” (shih kapitullin 7). Ne në Perëndim krenohemi përgjithësisht me faktin se ishte zbuluesi portugez Vasko de Gama i pari që e kishte kaluar Kepin e Shpresës së Mirë dhe kishte lundruar drejt Indeve Lindore, ku pati kontaktin e parë me një racë indiane primitive dhe gjer atëherë të izoluar. Por dikur, dy gjer në pesë dekada më herët, lundërtari islam Ahmed ibn Mexhidi e kishte kaluar tashmë Kepin dhe, duke lundruar deri në bregun afrikanoperëndimor, pati hyrë në Mesdhe nëpërmjet Ngushticës së Gjibraltarit. Për më tepër, persianët sasanidë kishin kapërcyer Indinë dhe Kinën nga shekujt e hershëm të mijëvjeçarit të parëtë erës sonë, siç bënë etiopianët e zinj dhe, më vonë, muslimanët (aty pas vitit 650). Dhe javanezët, indianët dhe kinezët i kishin rënë përçark Kepit shumë dekada përpara De Gamës, në mos shekuj. Jo më pak është harruar se De Gama vetëm ia doli të lundrojë deri në Indi, sepse ai qe drejtuar nga një udhërrëfyes i paemër musliman i Guxharatit. Siç është jo më pak e bezdisshme çështja se thuajse të tëra teknikat dhe teknologjitë detare e lundrimore që e bënë të mundur udhëtimin e De Gamës ishin shpikur (dhe sigurisht, ishin përpunuar më tej) ose në Kinë, ose në Lindjen e Mesme islame. Këto më pas ishin përvetësuar nga europianët, për t’u përhapur anembanë ekonomisë globale nëpërmjet Urës Islame të Botës (shih kapitujt 3, 6-8). Dhe kur ne shtojmë çështjen se topi dhe baruti i zi u zbuluan në Kinë dhe u përhapën anekënd, pothuajse nuk ka mbetur asgjë për të treguar se portugezët nuk kishin asgjë për të pretenduar njëmend për veten e tyre. Përfundimisht, siç ky libër argumenton me hollësi, indianët nuk ishin barbarë primitivë. Në fakt, ata ishin konsiderueshëm më të përparuar se “zbuluesit” e tyre portugezë – në vetvete një emërtim i pasaktë, sepse India kishte qenë prej kohësh në kontakt të

drejtpërdrejtë tregtar me një pjesë të mirë të Azisë, të Afrikës Lindore, e në mënyrë të tërthortë me Europën, shumë shekuj përpara se De Gama të pretendonte në mënyrë të pasinqartë ta kishte zbuluar atë (shih kapitujt 2-4).

Më në përgjithësi, është e rëndësishme të vihet në pah se kapacitetet burimore lindore patën një ndikim domethënës në çdo pikë kthese të madhe europiane. Shumica e teknologjive kryesore që mundësuan revolucionin agrikuturor mesjetar europian pas vitit 600 të erës sonë ngjan të kenë ardhur andej nga Lindja (kapitujt 5 dhe 6). Pas vitit 1000, teknologjitë, idetë dhe institucionet e mëdha që nxitën revolucionet e ndryshme tregtare, prodhuese, financiare, ushtarake dhe lundrimore, si edhe Rilindjen dhe revolucionin shkencor, ishin zhvilluar fillimisht në Lindje, por më vonë u asimiluan nga europianët (kapitujt 6-8). Pas 1700-s, idetë teknologjike dhe teknologjitë e mëdha që nxitën revolucionet agrikuturore dhe industriale britanike u përhapën të tëra tejdanë nga Kina (kapitulli i nëntë). Për më tepër, idetë kineze ndihmuan gjithashtu nxitjen e iluminizmit europian. Dhe është saktësisht ngaqë Lindja dhe Perëndimi janë të lidhur së bashku në një rrjetë të vetme globale që prej vitit 500 që ne nevojitet ta përjashtojmë pretendimin eurocentrik se këto dy entitete mund të paraqiten si tërësisht më vete dhe antitetike.

Jo më pak e rëndësishme është të vihet në dukje se, për çdonjë prej pikave të mia, janë përdorur një seri kundërmasash që mundësojnë (zakonisht pa qëllim) kujtimin e vizionit eurocentrik. Kështu, kur autorë eurocentrikë pohojnë se një ide apo teknologji e caktuar e kishte origjinën në Lindje, ata shpesh mbështeten në atë çka mund të quhet një "dogmë" specifike "orientaliste". Dogma të tilla e hedhin poshtë rëndësinë e një arritjeje të veçantë lindore, duke na kthyer me këtë te statukuoja orientaliste. Ky proces është

ndërmarrë rrallë në një mënyrë të vetëdijshme, duke patur parasysh se shumica e studiuesve nuk po luftojnë për të mbrojtur një vizion qartazi eurocentrik mbi botën. Ata i përdorin dogmat orientaliste më shpesh për të ruajtur këndvështrimin e tyre teorik (për shembull, marksist, liberal, veberian, etj.), e jo eurocentrizmin si të tillë. Por e qëllimshme apo jo, rrjedhoja është përsëri ruajtja e vizionit eurocentrik qoftë edhe sepse këto qasje janë brendaqenësisht orientaliste.

Dy shembuj mbi mënyrën e përdorimit të dogmave të tilla do të mjaftonin për të ilustruar temën time. Për deklarin tim të bërë në kapitullin e tretë se Kina bëri një mrekulli industriale gjatë Sungut (shekulli i njëmbëdhjetë), historianët eurocentrikë shpesh përgjigjen duke iu referuar një prej “dogmave kineze” (apo çfarë Blaut i quan “formula kineze”).<sup>37</sup> Kjo dogmë e hedh poshtë domethënien e saj, duke këmbëngulur se ishte veç një “revolucion i dështuar”, me ekonominë kineze të kthyer më pas në gjendjen e vet normale të amullisë relative. Në këtë mënyrë, teoricienë të tillë janë në gjendje ta mbrojnë pretendimin e tyre se revolucioni industrial britanik ishte vërtet i pari (“dogma britanike”). E dyta, për t’i përgjigjur pretendimit se Lindja e Mesme i përcolli në Europë tekstet dhe mendimet shkencore origjinale që mundësuuan Rilindjen perëndimore dhe revolucionin shkencor, është thirrur në ndihmë menjëherë “dogma islame”. Kjo e hedh poshtë kontributin lindor me argumentin se këto tekste ishin në fakt punë të pastra greke, e se muslimanët nuk kishin shtuar asgjë nga vlera intelektuale; gjithçka ata bënë ishte kthimi te evropianët i veprave origjinale greke. Kjo atëherë ka diçka të përbashkët me “dogmën greke”, e cila specifikon se grekët e lashtë ishin burimi origjinal i qytetërimit modern (pra, perëndimor). Vetëm nga këto dy

<sup>37</sup> Blaut, *Colonizer's Model*, fq. 115-119.

shembuj duhet të jetë e qartë se ka shumë dogma orientaliste që mbivendosen për të dhënë një “tekst orientalist” logjikisht koherent. Kështu, për ta bërë argumentin tim aq të pranueshëm sa është e mundur, është detyra ime, apo e çdokujt tjetër që kërkon ta kundërshtojë eurocentrizmin, t’i kundërvihet dhe ta çmontojë çdonjë prej këtyre dogmave apo formulave orientaliste të ndërlidhura. Është kjo detyrë që i jep trajtë narrativës kryesore të këtij libri. Kaq për procesin e përhapjes.

Rruga e dytë kryesore në të cilën Lindja mundësoi ngritjen e Perëndimit ishte përmes përvetësimit imperial evropian të burimeve lindore (tokës, krahut të punës dhe tregjeve). Këtu unë theksoj rolin e identitetit apo veprimit evropian. Të tërë studiuesit kryesorë antieurocentrikë kërkojnë ta zhvlerësojnë plotësisht veprueshmërinë e Perëndimit. Ta përfshish atë, arsyetojnë ata, do të thotë t’i kthehesh kurthit eurocentrik të theksimit të unikalitetit evropian. Por, me fshirjen e nocionit të veprimit evropian, ne vihem i përballë një sërë rreziqesh. Së pari, i hyjmë rrezikut të paraqitjes së arritjes europiane si vërtet mrekullore.<sup>38</sup> Së dyti, duke patur parasysh se argumenti im kryesor e përfshin kontributin pozitiv të Lindjes për përparimin perëndimor, unë rrezikoj të bie në kurthin e oksidentalizmit, në të cilin Lindja është e privilegjuar dhe Perëndimi është i denigruar. Në fund, kjo nuk do të qe më e përshtatshme se një qasje orientaliste. Dhe së treti, me mohimin e veprimit evropian, ne i hyjmë rrezikut të rënies në një lloj kurthi strukturorofunksionalist, në të cilin veprimi njerëzor zëvendësohet me nocionin e individit si një “bartës pasiv” i strukturave materiale. Kjo në thelb i koncepton krijesat njerëzore si pritës të dhuratës apo të barrës së ndryshimit, e jo si drejtues krijues të ndryshimit.

<sup>38</sup> Immanuel Wallerstein, “Frank Proves the European Miracle”, *Review* 22 (3) (1999), 356-357.

Koncepti im i veprimit europian ndahet nga qasjet e pastra materialiste të literaturës ekzistuese antieurocentrike (si dhe eurocentrike), sepse ai është mbështetur në nocionin e identitetit, i cili, në vijim, është një fenomen i konstruktuar nga pikëpamja shoqërore. Dhe këtu gjendet një lidhje me degën e parë të argumentit tim, duke patur parasysh se identiteti europian ka qenë gjithmonë i farkëtuar në një kontekst global. Në këtë mënyrë, unë u kushtoj vëmendje fazave të ndryshme në të cilat u ndërtua dhe u rindërtua identiteti europian në një kontekst global gjithmonë në ndryshim, duke e lidhur këtë ndërkohë në çdo kohë me progresin ekonomik të Perëndimit. Megjithatë, siç e shpjegoj në kapitullin e fundit, kjo nuk do të thotë kurrsesi se faktorët materialë janë të parëndësishëm; sigurisht, ato formojnë një pjesë të madhe të argumentit tim të përgjithshëm. Këtu unë thjesht vë në dukje se identiteti është një aspekt i rëndësishëm i veprueshmërisë. Nocioni im i veprimit fillon nga premisa se mënyra si ne e mendojmë apo e imagjinojmë vetveten dhe vendin tonë në botë i jep trajtë në një shkallë shumë të rëndësishme mënyrës si veprojmë në të. Si e ndërtoan atëherë europianët një identitet imperial, dhe si kjo në vazhdim mundësoi fazën e fundit të ngritjes së Perëndimit?

Europianët do ta përcaktonin veten negativisht kundrejt Islamit gjatë periudhës së hershme mesjetare (kapitulli i pestë). Kjo ishte jetike për ndërtimin e botës së krishterë, që në vijim mundësoi konsolidimin e sistemit ekonomik dhe politik feudal teksa ai u shfaq rreth fundit të mijëvjeçarit të parë të erës sonë. Ishte gjithashtu ky identitet që çoi në kryqëzatat. Më pas, identiteti kristian europian nxiti të ashtuquajturat “udhëtime zbulimi”, apo çka unë e quaj “raundi i dytë” i kryqëzatave mesjetare, udhëhequr nga Vasko de Gama dhe Kristofor Kolombi (kapitujt shtatë dhe tetë). Duke arritur në Amerikë, idetë e ndryshme kristiane i bënë eu-

ropianët të besojnë në inferioritetin e vendasve amerikanë, si dhe të afrikanëve zezakë. Kjo në vijim legjitimoi në sytë e tyre tejshfrytëzimin dhe shtypjen e amerikanëve vendas dhe të afrikanëve, si dhe përvetësimin e arit dhe argjendit amerikan, gjë e cila e ndihmoi zhvillimin ekonomik europian në mënyra të shumëfishta (kapitulli i tetë). Pastaj, gjatë shekullit të tetëmbëdhjetë, rindërtimi i identitetit europian çoi në krijimin e çka unë i referohem si “racizëm i nënkuptuar”, që shpuri te ideja e nevojës morale të “misionit civilizues” imperial (kapitulli i dhjetë). Imagjinimi i Lindjes si e prapambetur, pasive dhe fëmijërore, në kontrast me Perëndimin si të përparuar, proaktiv dhe atëror, ishte jetik në nxitjen e europianëve për të kaluar në imperializëm. Sepse elitat europiane besonin sinqerisht se po e civilizonin Lindjen nëpërmjet imperializmit (edhe nëse shumë prej veprimeve të tyre ishin në mospajtim me këtë koncept fisnik). Dhe, në vijim, përvetësimi i shumë burimeve joeuropiane me anë të imperializmit nënshkroi revolucionin industrial boshtor britanik (kapitulli i njëmbëdhjetë).

Në tërësi, kjo më jep mundësi mua ta riparaqes veprimin europian si pjesë të përshkrimit tim antieurocentrik të ngritjes së Perëndimit. Studiues të tillë si Blaut-i mund ta denoncojnë përgjithësisht këtë aspekt të argumentit tim, ngaqë ai ngjan të kthehet në një argument eurocentrik që thekson përjashtueshmërinë europiane. Por do të qe kështu *vetëm* nëse kjo formonte elementin qendror të shpjegimit tim. Kësisoj, është jetike të vlerësohet korniza ime e përgjithshme shpjeguese: se identiteti europian përbën një variabël shpjeguese të nevojshëm, ndonëse jo të mjaftueshëm. Sepse pa përhapjen e burimeve materiale dhe ideore lindore përmes globalizimit oriental, kurrfarë lakmie dhe përvetësimi i treguar nga europianët nuk mund t'i kishte kapërcyer ata “përtej vijës”. Kjo do të thotë domosdoshmërisht se shkaqet materialiste duhet të merren në konsideratë për-

krah rolit të identitetit nëse duam të japim një shpjegim të kënaqshëm për ngritjen e Perëndimit.

Përmbledhtazi, kur ne zbulojmë tablonë e madhe që mbulon eurocentrizmi, atëherë panorama e tij e kulluar e qytetërimit perëndimor – si autonom, gjenial dhe progresiv moralisht – duket më shumë si portreti i Dorian Gray-it, i Oscar Wilde-it, imazhi real i të cilit i është fshehur shikuesit. Prandaj detyra ime është ta zbuloj këtë tablo të fshehur dhe njëkohësisht të ringjall historinë lindore. Në këtë mënyrë kërkoj të minoj nocionin eurocentrik të Perëndimit ngadhënjyes që gjendet, në mënyrë të fshehur apo të dukshme, në zemër të përshkrimeve mbizotëruese të ngritjes së Perëndimit. Gjatë punës ne zbulojmë domosdoshmërisht origjinat e Perëndimit oriental. Kështu, për të përdorur gjuhën e shkencës pozitiviste sociale perëndimore të adoptuar nga Landes-i dhe të tjerë, është për këto arsye empirike (të diskutuara më sipër) që ne duhet ta shmangim eurocentrizmin. Sepse vetëm atëherë mund të japim një përshkrim të kënaqshëm të ngritjes së Perëndimit.

Një pikë përfundimtare meriton të vihet në pah. Unë qartësisht i kam vënë vetes një detyrë shumë ambicioze, e cila kërkon një histori të rishikuar të thujtë tërë botës në një mijë e pesëqind vitet e fundit! Qartas nuk është e mundur të jepen të tëra hollësitë në një libër. Ndonëse e dëshirueshme, detyra ime duhet të jetë më e matur. Objektivi im kryesor është të skicoj vijat e përgjithshme të një tabloje alternative dhe me këtë të jap prova të mjaftueshme për t'i minuar tezat e mëdha të qasjes eurocentrike. Thënë ndryshe, unë ndjej se “suksesi intelektual” i librit duhet çmuar jo nga fakti nëse lexuesi është plotësisht i bindur nga veçantitë e përshkrimit tim, por, më saktë, nëse ai apo ajo është bindur nga pretendimi im se vizioni dhe shpjegimi eurocentrik i ngritjes dhe triumfit të Perëndimit është një mit që ka nevojë të kundërshtohet.

# **PJESA I**

**Lindja si rajon me zhvillim të hershëm:  
Lindja e zbulon dhe e udhëheq botën përmes  
globalizimit oriental, 500-1800**



## 2. PIONIERËT MUSLIMANË DHE AFRIKANË: NDËRTIMI I URËS SË BOTËS DHE I EKONOMISË GLOBALE NË EPOKËN AFRO-AZIATIKE TË ZBULIMEVE, 500-1500

Nëse një filozof do të donte të mësonte çfarë ka ndodhur në botë, pikësëpari duhet t'i kthejë sytë nga Lindja, djepi i çdo arti, të cilit Perëndimi i detyrohet për gjithçka.

*Voltaire*

Dijetarët perëndimorë, të paktën që nga shekulli i nëntëmbëdhjetë, janë përpjekur të gjejnë mënyra për ta parë zonën afro-aziatike të civilizimit si të përbërë nga botëra të dallueshme historike ... dhe një nga rezultatet e pëlqyeshme [të kësaj] është lënia e Europës ... me një histori që nuk është nevojë të integrohet me atë të pjesës tjetër të njerëzimit, përveç se në terma të vendosur nga vetë historia europiane ... [Por pas] 500-ës të erës sonë, një përmirësim akumulativ po ndodhte në teknikë, sidomos në [institucionet] ushtarake e madje financiare; hapësira e tregtisë u zgjerua, siç ndodhi në Afrikën Nën-Sahariane e cila tashmë hyri në hapësirën qytetërimore afro-aziatike ... [Sepse] ndërveprimet midis rajoneve – qoftë si rezultat i Islamit, i mongolëve, apo i huazimeve shkencore apo artistike [etj.] – ishin aq të shpeshta duke përfshirë ... Kinën dhe ... Europën Perëndimore [sa kjo detyrimisht nënkupton] që këto zhvillime [në teknikë] s'mund të shkëputen plotësisht nga njëra-tjetra.

*Marshall Hodgson*

Peizazhi standard i botës para 1500-s që paraqet eurocentrizmi përmban dy tipare thelbësore: së pari, një botë të ngecur në baltën e së ashtuquajturës 'traditë' e amullt dhe, së dyti, një botë të fragmentuar dhe të ndarë mes civilizimeve të izoluara e të prapambetura rajonale, të qeverisura nga

shtete despotike 'irracionale' (kryesisht në Lindje). Sipas këtij peizazhi bëhet e pakonceptueshme të përfytyrohet një botë e ndërvarur globalisht në çfarëdo pike para 1500-ës. Kurse eurocentrizmi supozon se vetëm më 1500, me shfaqjen e Europës si qytetërim i përparuar, nisi epoka europiane e zbulimeve gjeografike, çka solli me vete shembjen e mureve që i kishin mbajtur të shkëputura qytetërimet madhore, duke e shtruar udhën kësisoj për epokën e ardhshme perëndimore të globalizimit që do të shfaqej në shekullin e nëntëmbëdhjetë e do të arrinte pjekurinë pas 1945-ës.

Ky peizazh i mirënjohur eurocentrik është mit para së gjithash sepse një ekonomi globale që do ta shembte izolacionizmin qytetërimor filloi që në shekullin e gjashtë gjatë epokës afro-aziatike të zbulimeve gjeografike. Siç do ta shohim, të ashtuquajturit pionierë europianë hynë në këtë qark paraekzistues global në kushte të diktuar nga arabët mesolindorë, persianët dhe afrikanët (shih kap. 4, 6 dhe 7). Për më tepër, siç e tregojnë ky kapitull dhe dy të tjerët në vijim, periudha para 1500-ës ka dëshmuar zhvillim të konsiderueshëm ekonomik në Lindje, çka njëkohësisht e përgënjeshtroi teorinë eurocentrike për despotizmin oriental. Tregoj gjithashtu se 'skaji prirës i fuqisë ekonomike globale' në periudhën para 1800-ës u përkiste shoqërive të ndryshme lindore. Ka dy lloje të përgjithshme fuqie globale ekonomike që mund të quhen, sipas Michael Mann-it, 'ekstensive' dhe 'intensive'.<sup>39</sup> Në sferën ekonomike, fuqia ekstensive nënkupton aftësinë e një shteti apo rajoni për t'i shtrirë tentakulat e tij ekonomike jashtë në drejtim të botës. Kurse fuqia intensive nënkupton një shkallë të lartë fuqie 'prodhuese' brenda 'kufijve'. Duhet t'i dallojmë këto pikërisht ngaqë rajone të ndryshme janë shquar në njëërën apo në të dyja

<sup>39</sup> Michael Mann, *The Sources of Social Power*, I (Cambridge: Cambridge University Press, 1986), fq. 6-10.

këto forma fuqie globale në periudha të ndryshme. Kështu, për shembull, afërsisht mes viteve 650 dhe 1000, Lindja e Mesme dhe Afrika Veriore islamike gëzonin nivelet më të larta të fuqisë ekstensive dhe intensive, por rreth vitit 1100, skaji prirës për sa i përket fuqisë intensive u zhvendos në Kinë (ku do të mbetej deri në shekullin e nëntëmbëdhjetë – shih kap. 3). Megjithatë, Lindja e Mesme dhe Afrika Veriore e ruajtën skajin prirës të fuqisë ekstensive deri rreth shekullit të pesëmbëdhjetë kur Kina doli në krye, ndonëse vazhduan të gëzonin nivele domethënëse fuqie intensive e ekstensive deri në shekullin e tetëmbëdhjetë. Ky peizazh u ripërfytyrua me vetëdije nga intelektualët eurocentrikë në shekullin e nëntëmbëdhjetë, ashtu që fillimisht Venecia e pastaj me radhë Portugalia, Spanja, Holanda e Britania u paraqitën si fuqi udhëheqëse globale në periudhën pas 1000-ës.

Për ta përmbledhur, qëllimi i këtij kapitulli është të zbulojë peizazhin origjinal (atë që ekzistonte para se të fshihej nga eurocentrizmi). Por megjithëse u kam kushtuar mbi tre kapituj arritjeve ekonomike të Lindjes, ato doemos mund të ofrojnë vetëm se një skicë. Sepse siç na rikujton Perry Anderson,

zhvillimi aziatik kurrsesi s'mund të reduktohet në një kategori uniforme të mbetur pas përcaktimit të kriterëve të evoluimit europian ... Është thjesht në natën e injorancës sonë që të gjitha format e huaja marrin të njëjtën ngjyrë.<sup>40</sup>

Prandaj, me sa është e mundur jam përpjekur ta shpërbëj Lindjen në pjesët e saj përbërëse kryesore, asnjëra prej të cilave s'mund të pikturohet me të njëjtën furçë. Në këtë mënyrë shpresoj që lexuesit do të ma falin faktin që fokusi im kryesor në këtë kapitull dhe në dy të tjerët që vijojnë,

<sup>40</sup> Perry Anderson, *Lineages of the Absolutist State* (London: Verso, 1979), fq. 548-549.

janë Lindja e Mesme dhe Afrika Veriore islamike, Kina, Japonia, India dhe Azia Juglindore.

Ky kapitull ndahet në dy pjesë. E para vë në pah rolin paraprirës që muslimanët e Lindjes së Mesme dhe të Afrikës Veriore luajtën në krijimin e një ekonomie globale pas 500-ës, si dhe gjurmon skajin udhëheqës të fuqisë globale. Pjesa e dytë gjurmon zgjerimin e fuqisë ekstensive muslimane dhe zhvendosjen e saj në Egjipt, duke nxjerrë në pah njëkohësisht konturet e ekonomisë globale në periudhën 1000-1500.

### **Origjinat lindore të ekonomisë globale: epoka afro-aziatike e zbulimeve (pas 500-ës)**

#### *Krijimi i globalizimit lindor pas 500-ës*

Pretendimi se globalizimi filloi të paktën që në shekullin e gjashtë, detyrimisht i kundërvihet këmbënguljes eurocentrike se globalizimi u shfaq vetëm pas 1500-ës me fillimin e së ashtuquajturës epokë europiane e zbulimeve gjeografike. Specifikisht, ka gjashtë kundërshtime eurocentrike ndaj pretendimit se globalizimi ka nisur shumë më përpara 1500-ës.<sup>41</sup> Së pari, supozohet se civilizimet madhore rajonale kanë qenë të izoluara nga njëri-tjetri. Së dyti, ky pretendim vjen nga supozimi se kostot politike ishin shumë të larta për të lejuar tregti globale, duke patur parasysh se sunduesit despotikë lindorë përpiqeshin t'ia zinin frymën tregtisë dhe të ardhurave tatimore. Së treti, nuk mund të ketë ekzistuar tregti domethënëse globale para 1500-ës sepse ka patur një mungesë institucionesh kapitaliste (si kreditimi, këmbyesit e monedhave, bankat, ligjet kontraktuale, etj.). Së katërti, një tregti domethënëse në nivel global ishte thjesht e pa-

<sup>41</sup> Për shembull, David Held, Anthony McGrew, David Goldblatt dhe Jonathan Perraton, *Global Transformations* (Cambridge: Polity, 1999).

mundur ngaqë teknologjitë e transportit ishin tejet të pazhvi-lluara. Dhe për aq sa ka patur ndonjëfarë tregtie globale, kjo ka qenë e parëndësishme sepse ka qenë në kuadër të mallrave të luksit të cilat, me përkufizim, konsumoheshin vetëm nga një pakicë e vogël e popullatës globale (rreth 10%). Së pesti, për aq sa kishte rrjedha globale, ato ishin shumë të ngadalta për të patur ndonjë rezultat. Së gjashti, edhe nëse kishte procese globale, ato nuk ishin të mëdha sa për të pasur një ndikim madhor riorganizues mbi shumë shoqëri të botës.

E filloj këtu duke paraqitur gjashtë kundërparashtrimet e mia, para se t'i shtjelloj përgjatë këtij kapitulli (si dhe në kap. 3-9). Së pari, pas 500-ës, persianët, arabët, afrikanët, javanezët, hebrenjtë, indianët dhe kinezët krijuan dhe deri rreth vitit 1800 mbajtën gjallë një ekonomi globale ku civilizimet madhore të botës ishin në çdo kohë të ndërlidhura (prandaj dhe termi globalizim lindor). Së dyti, rajonet e ndryshme qeveriseshin nga sundues të cilët siguronin një mjedis paqësor dhe i mbanin taksat e kalimit të ulëta për ta lehtësuar tregtinë globale. Së treti, një sërë institucionesh racionale kapitaliste u krijuan dhe u vunë në punë pas 500-ës për të mbështetur tregtinë globale (këto diskutohet me hollësi në kap. 6). Siç e vë në dukje Janet Abu-Lughod:

Distancat, të matura sipas kohës, në rastin më të mirë llogariteshin me javë e muaj, por duheshin vite për të përshkuar të gjithë qarkun [global]. Megjithatë mallrat barteshin, çmimet vendoseshin, bihej dakord për vlerat e këmbimit valutor, lidheshin kontrata, jepeshin kredi – mbi fonde ose mallra që ndodheshin gjetkë – formoheshin partneritete dhe, sigurisht, veprimet regjistroheshin e marrëveshjet respektoheshin.<sup>42</sup>

<sup>42</sup> Janet L. Abu-Lughod, *Before European Hegemony* (Oxford: Oxford University Press, 1989). fq. 8.

Së katërti, ndonëse është e qartë se teknologjitë e transportit nuk ishin në kurrfarë niveli të krahasueshme me sot, ishin gjithsesi të mjaftueshme për zhvillimin e tregtisë globale. Kurse supozimin eurocentrik se tregtia globale prekte vetëm rreth 10% të popullsisë globale – dhe prandaj ishte pa ndikim – e kundërshton pikësëpari Charles Tilly, i cili i përkufizon si të rëndësishme lidhjet globale për aq sa, 'Veprimet e pushtetmbajtësve në një rajon të rrjetit ... dukshëm ... ndikonin në mirëqenien e të paktën një pakice të konsiderueshme (thuj një të dhjetën) të popullsisë në një rajon tjetër të rrjetit'.<sup>43</sup> Të tjerë kanë hedhur mendimin se tregtia e mallrave të luksit ka krijuar shumë efekte të rëndësishme në riprodhimin e shteteve e të shoqërive në mbarë botën.<sup>44</sup> Sido që të jetë, shumica e tregtisë globale bëhej në mallra të konsumit masiv, të cilat preknin konsiderueshëm më shumë se 10% të popullsisë së botës (pikë kjo të cilën e përsëris në kapituj të ndryshëm).

Së pesti, ndërsa pa dyshim është e vërtetë se ritmi i qar-kullimit global shpesh ishte shumë i ngadaltë, rrjedhat globale megjithatë kishin një efekt madhor riorganizues mbi shoqëritë në botë. Kjo shpie drejtpërdrejt në pretendimin tim të gjashtë: se rëndësia kritike e ekonomisë globale nuk qëndronte në llojin apo sasinë e tregtisë që mbështeste, por në krijimin e një rruge përcjellëse nëpër të cilën do të arri-nin në Perëndim 'kapacitetet burimore' (idetë, institucionet e teknologjitë) më të përparuara të Lindjes. Këto rrjedha globale në përfundim shkaktuan një rikonfigurim radikal të shoqërive në një pjesë të madhe të botës. Motivin kryesor të këtij libri e përbën përpjekja për ta vërtetuar këtë pikë duke

<sup>43</sup> Charles Tilly, *Big Structures, Large Processes, Huge Comparisons* (New York: Russell Sage Foundation, 1984), fq. 62.

<sup>44</sup> Jane Schneider, "Was there a Pre-Capitalist World-System?", *Peasant Studies* 6 (1977), 20-29.

treguar se si përhapja e 'kapaciteteve burimore' të praktikës më të mirë (domethënë lindore) përmes globalizimit lindor, ishte aq e rëndësishme sa shërbeu si bazë për ngritjen e Perëndimit (shih kap. 5-9).

Së fundmi, pretendimi im mund të kundërshtohet mbi bazën se jo të gjitha pjesët e globit ishin tërësisht të ndërli-dhura. Por ideja se e gjithë bota duhet jetë e lidhur ngushtë para se ta deklarojmë globale, është problematike edhe për epokën moderne. Sërish, siç e vë në dukje Janet Abu-Lughod:

Asnjë sistem botëror nuk është *global*, në kuptimin që të gjitha pjesët të jenë të nyjtuara në mënyrë të barabartë, qoftë roli i tyre qendror apo periferik. Edhe sot e kësaj dite bota, e integruar më globalisht se kurrë më parë, ndahet në nënsfera apo nënsisteme të rëndësishme, siç është sistemi atlantikoverior ... skaji i Paqësorit ... Kina, ende një sistem më vete, dhe [kështu me radhë].<sup>45</sup>

Pa dyshim globalizimi ka qenë një fenomen dinamik dhe pa dyshim që 'shtrirja' e tij ka ndryshuar në kohë. Globalizimi modern i periudhës 1800-2000, në disa aspekte të rëndësishme është shumë i ndryshëm nga pararendësi i tij lindor. Megjithatë, mund të thuhet se globalizimi ka ekzistuar para (dhe sigurisht pas) 1500-ës në formë rrjedhash të rëndësishme mallrash, burimesh, monedhash, kapitali, institucionesh, idesh, teknologjish e njerëzish mes rajoneve në atë shkallë sa ndikuan mbi shoqëritë duke shkaktuar transformimin e tyre në një pjesë të madhe të globit. Megjithatë, Robert Holton thotë se:

Një histori globale nuk është e thënë të marrë patjetër formën e një procesi të vetëm përbashkues (ose metanarrativ) siç është ngadhnjimi i arsyes apo qytetërimi pe-

<sup>45</sup> Abu-Lughod, *Hegemony*, fq. 32.

rëndimor. Po ashtu nuk është e thënë të nënkuptojë një proces të pandalshëm homogjenizimi drejt një modeli të vetëm ... *Minimumi* që nevojitet për të mund të folur për një fije të vetme lidhëse globale është që *ndërlidhje të prekshme të ekzistojnë midis rajoneve, duke krijuar ndërshkëmbim dhe ndëroarësi*.<sup>46</sup>

Përkufizimi im është dukshëm më pak 'minimalist' se ai i Holton-it.

Si datë të përafërt për fillimin e globalizimit lindor marr vitin 500 të erës sonë. Siç shpjegon William McNeill, ndonëse ka patur një tërësi të pazhvilluar mirë lidhjesh globale që shkojnë pas deri në mijëvjeçarin e parë para erës sonë (ose më herët), rreth vitit 500 thuhet të gjitha boshllëqet në hapësirë që i izolonin rajonet nga njëri-tjetri qenë mbushur tashmë.<sup>47</sup> Ringjallja e transportit me deve mes viteve 300-500 rezultoi veçanërisht e rëndësishme. Devetë ishin 'mjete' shumë më superiore se kuajt apo qetë. Ato mund të përshkonin dyfishin e distancës ditore, ishin shumë më të lira, mund të organizoheshin më lehtë dhe nuk kërkonin rrugë. Kjo nënkuptonte se rrugët e gjata tokësore përmes Azisë Qendrore tashmë mund të përshkoheshin relativisht me lehtësi. Aq i rëndësishëm ishte ky zhvillim, sa McNeill e ka përshkruar si:

analog... me hapjen shumë më të mirënjohur të oqeanëve nga detarët evropianë pas 1500-ës. Arabia bashkë me oazet dhe shkretëtirat e Azisë Qendrore, stepat në veri dhe Afrika Nën-Sahariane qenë rajonet më të ndikuara ... [dhe] të gjitha u vunë në kontakt shumë më të ngushtë me qendrat e hershme të jetës së qytetëruar – kryesisht me Lindjen e Mesme dhe Kinën – se ç'kishte qenë e

<sup>46</sup> Robert J. Holton, *Globalization and the Nation-State* (London: Macmillan, 1998), fq. 28, theksimi me kursiv është i imi.

<sup>47</sup> William H. McNeill, *The Rise of the West* (Chicago: Chicago University Press, 1963), fq. 460.

mundur më parë. Si rezultat, afërsisht mes viteve 500 dhe 1000 [u shfaq] një sistem i intensifikuar botëror.<sup>48</sup>

Por zhvillimi kyç këtu qe shfaqja e një sërë perandorish botërore të ndërlihdura, çka bëri të mundur një mjedis mjaft të paqtë ku tregtia tokësore – si dhe detare – mund të lulëzonte.<sup>49</sup> Ngritja e Kinës së dinastisë Tang (618-907), e perandorisë umejade/abaside islamike në Lindjen e Mesme (661-1258) si dhe e fatimidëve në Afrikën Veriore (909-1171) pati rol kritik në zhvillimin e një rrjeti tregtar global me shtrirje të konsiderueshme. Siç e vë në dukje Philip Curtin: ‘Fuqia e njëkohshme e abasidëve dhe e kinezëve tangë ua bëri relativisht të lehtë tregtarëve të distancave të largëta të gjithë udhëtimin përmes Azisë dhe Afrikës Veriore’.<sup>50</sup> Dhe ndonëse Jack Goody, Andre Wink dhe Nigel Harris pikasin lidhje globale që shkojnë deri në vitet 3500 p.e.s. ose edhe më herët, ata bien dakord se zgjerimi i madh i tregtisë globale ndodhi në periudhën pas 600-ës.<sup>51</sup> Shkurt, siç ka argumentuar McNeill së fundmi, lulëzimi dhe komercializimi i botëve arabe e kineze (si dhe aziatikojugore) veptoi si një gjyryk gjigand që u fryu flakëve të një ekonomie globale në lindje e sipër.<sup>52</sup> Këtu vlen të vihet në dukje se teza e famshme e Pirenne-it, që pushtimet islame e thyen unitetin mes Europës Perëndimore e asaj Lindore (Bizantit) dhe se treg-

<sup>48</sup> William H. McNeill, “*The Rise of the West after Twenty-Five Years*”, te Stephen K. Sanderson (red.), *Civilizations and World Systems* (London: Altamira Press, 1995), fq. 314.

<sup>49</sup> Jerry H. Bentley, *Old World Encounters* (New York: Oxford University Press, 1993), veçanërisht kapitujt 1 dhe 3.

<sup>50</sup> Philip D. Curtin, *Cross-Cultural Trade in World History* (Cambridge: Cambridge University Press, 1984), fq. 105.

<sup>51</sup> Jack Goody, *The East in the West* (Cambridge: Cambridge University Press, 1996), fq. 86; Nigel Harris, *The Return of Cosmopolitan Capital* (London: I. B. Tauris, 2003), fq. 15-24; Andre Wink, *Al-Hind: the Making of the Indo-Islamic World*, I (Leiden: E. J. Brill, 1990), kapitulli 2.

<sup>52</sup> McNeill: “*Rise of the West after Twenty-Five Years*”, fq. 316.

tia rifilloi vetëm në kapërcyell të mijëvjeçarit, duhet kthyer përmbys:

Kishte një lidhje të ngushtë mes botëve franke e arabe dhe ... Rilindja Karolinjane, sukseset e qytet-shteteve italiane dhe rritja e Lidhjes Hanseatike u stimuluan, e nuk u penguan, nga kontaktet me Lindjen muslimane ... Duket tejet e qartë se tregtia u ringjall në shumë vende në shekujt e tetë e të nëntë [në Europë] ... Në kundërshtim me Pirenne-in, historianët sot flasin për 'islamizimin' ekonomik 'të Europës në mesjetën e hershme'.<sup>53</sup>

Kësisoj, me lindjen e perandorisë karolinjane më 751 në Europën Perëndimore dhe shfaqjen e qytet-shteteve të ndryshme tregtare italiane në shekujt e tetë e të nëntë, sistemi tregtar global u zgjerua deri në Europë, duke i lidhur kështu të dy skajet e masës tokësore të Eurazisë në një rrjet të vazhdueshëm perandorish botërore të ndërlydhura. Rrjedh se globalizimi nuk është unik, apo me ndikim, vetëm për shekullin e njëzetë. Jo vetëm që ky fenomen ka filluar gjatë 'epokës së errët' të Europës, por domethënia e tij përfundimtare qëndron në faktin se globalizimi lindor ka qenë mamia, në mos nëna, e Perëndimit mesjetar dhe modern.

Lindja e globalizimit lindor i detyrohet shumë Lindjes së Mesme dhe Afrikës Veriore muslimane. Muslimanët (dhe zezakët) e Afrikës Veriore si dhe muslimanët e Lindjes së Mesme ishin pionierët e vërtetë kapitalistë globalë, të cilët shërbyen për ta thurur bashkë një ekonomi globale të një shkalle e rëndësie domethënëse. Sepse kjo e fundit shtrihej përgjatë masës tokësore afro-euraziatike dhe linjave detare nga Europa Perëndimore deri në Kinë e Kore në lindje dhe në Afrikë e Polinezi (e ndoshta në Australinë aborigjene) në jug. Si u arrit kjo?

<sup>53</sup> Wink, *Al-Hind*, fq. 35-36.

**Pionieri global musliman:  
rritja e fuqisë ekstensive dhe intensive muslimane**

Muslimanët arabë të Lindjes së Mesme ndërtuan mbi arritjet e mëparshme të persëve sasanidë, të cilët i kanë rrënjët ndoshta në shekullin e tretë, dhe me siguri në të katërtin.<sup>54</sup> Pas vitit 610, Lindja e Mesme nisi të ngrihej si fuqi globale me 'revelatën' e Muhammedit. Para kësaj Lindja e Mesme ishte tejet e fragmentuar dhe objekt përpjekjesh të ndryshme kolonizuese nga Persia, Siria e Egjipti bizantin. Një nga kontributet më të mëdha të Muhammedit ishte farkëtimi i një uniteti përmes forcës së Islamit. Kurse një nga aspektet më domethënëse të Islamit ishte prirja e tij për tregti dhe veprimtari kapitaliste racionale.

Meriton të theksohet këtu se kjo menjëherë bie ndesh me supozimin eurocentrik se Islami ishte një fe regresive e cila e bllokonte mundësinë për veprimtari kapitaliste, aq më pak kapitaliste racionale. Por duket se harrohet, me ose pa dashje, se vetë Muhammedi kishte qenë një tregtar *commenda* (ose *kirâd*). Në të njëzetat ai u martua me një grua të pasur kurejshite (fis i cili ishte pasuruar me anë të tregtisë së karvaneve si dhe të veprimtarisë bankare). Është interesante se:

mekasit – fisi Kurejsh – e bënë kapitalin e tyre të lulëzonte përmes tregtisë dhe huave me kamatë në një mënyrë që Weber-i do ta quante racionale ... Tregtarët e perandorisë muslimane i plotësonin përsosmërisht kriteret [racionale] e Weber-it për veprimtari kapitaliste. Ata shfrytëzonin çdo mundësi fitimi dhe i llogarisnin shpenzimet, arkëtimet dhe fitimet në kuadër monetar.<sup>55</sup>

<sup>54</sup> George F. Hourani, *Arab Seafaring in the Indian Ocean in Ancient and Early Medieval Times* (Beirut: Khayats, 1963), fq. 36-38; Wink, *Al-Hind*, fq. 48-55.

<sup>55</sup> Kjo referencë dhe dy referencat e tjera janë nga Maxime Rodinson, *Islam and Capitalism* (London: Allen Lane, 1974), fq. 14, 16-17, 29 respektivisht.

Në dritën e gjithë kësaj, është interesante të vihen në dukje disa nga lidhjet mes Islamit dhe kapitalizmit që mund të gjenden në Kur'an. Sipas hulumtimit të hollësishtëm të Maxime Rodinson-it, Kur'ani 'jo vetëm thotë se njeriu s'duhet ta harrojë atë që i takon nga kjo botë, por thotë se është me vend që të kombinohet praktika fetare me jetën materiale, me tregtinë që vazhdon edhe gjatë pelegrinazheve. Madje shkon deri atje sa ta mbrojë fitimin tregtar nën cilësimin "bujari e Zotit"'. Islami parashikon që një tregtar mund ta kryejë më mirë pelegrinazhin sesa një punëtor krahu. Kur'ani thotë se:

Nëse fiton me atë që është e lejuar, puna jote është xhihad ... Nëse atë që fiton e shpenzon për familjen dhe të afërmit, ajo është *sadaka* [bamirësi me kuptim fetar] dhe një dirhem [dhrakmi, monedhë argjendi] e fituar legjitimisht nga tregtia vlen më shumë se dhjetë dirhemë të fituar ndryshe.

Kurse thënia e Muhammedit se 'varfëria është gati femohim',

nënkupton se shërbëtori i vërtetë i Zotit duhet të jetë deri diku i pasur, ose të paktën i pavarur ekonomikisht. Pikat e këmbyesve të monedhave në xhaminë e madhe të qytet-kampit të Kufës ndoshta vlejné si ilustrim i faktit se nuk ka detyrimisht konflikt mes biznesit dhe fesë në Islam.<sup>56</sup>

Po ashtu është domethënëse që Kur'ani thekson rëndësinë e investimit. Dhe ndërkohë që ne zakonisht e konsiderojmë sheriatin (e drejta islame) si burim të despotizmit dhe të prapambetjes ekonomike, në fakt ai është krijuar si një mënyrë për të parandaluar abuzimin me pushtetin e sun-

<sup>56</sup> S. D. Goitein, *Studies in Islamic History and Institutions* (Leiden: E. J. Brill, 1968), fq. 228-229.

dimtarëve apo kalifëve dhe për më tepër përmban dispozita të qarta lidhur me të drejtën kontraktuale. Nuk është për t'u habitur që tregtarët muslimanë kanë patur një arsye racionale për të qenë mbështetës të fuqishëm të sheriatit. Më tej akoma, në Islam kishte tregues të qartë të një lirie personale më të madhe sesa në Europën mesjetare. Ofiqet përcaktoheshin në bazë të 'përgjegjësiave kontraktuale egalitare'. Këto gjëra nënkuptojnë koncepte racionale të cilat, sipas Hodgson-it, janë më afër konceptit modern të *Gesellschaft*-it sesa atij tradicional të *Geimenschaft*-it.<sup>57</sup>

Mbi të gjitha, avantazhi i krahasueshëm i Islamit qëndronte në fuqinë e tij të madhe 'ekstensive'. Islami ishte në gjendje të pushtonte hapësira horizontale, çka duket më së shumti në aftësinë e tij për t'u përhapur në pjesë në mëdha të globit, si dhe në aftësinë për të përhapur kapitalizmin. Qendra e Islamit, Mekka, ishte një nga qendrat e rrjetit global të tregtisë. Pushteti i Islamit u përhap me shpejtësi pas shekullit të shtatë dhe Mesdheu praktikisht u bë një liqen i muslimanëve, kurse 'Europa Perëndimore' një skaj i ekonomisë globale afro-aziatike. Islami do të kishte një ndikim veçanërisht të fuqishëm në zhvillimin e Europës (kap. 5-8) nëpërmjet Spanjës muslimane, ndonëse kurrsesi jo ekskluzivisht. Mbi të gjitha bota islame formonte jo më pak se vetë Urën e Botës, përmes së cilës shumë 'kapacitete burimore' lindore si dhe tregti kaluan drejt Perëndimit mes viteve 650 dhe 1800. Rritja e qyteteve dhe shtëpitë e ndërtuara nga muslimanët janë veçanërisht ilustruese për sa i përket fuqisë ekstensive të Islamit. Islami e ndalonte ndërtimin e shtëpive të larta shumëkatëshe pasi të lartësuarit drejt qiellit konsiderohej si arrogancë. Në përgjithësi në Islam ishte e papëlqyeshme moralisht të pushtohej hapësira vertikale.

<sup>57</sup> Marshall G. S. Hodgson, *Rethinking World History* (Cambridge: Cambridge University Press, 1993), fq. 111-116, 141.

Treguesi më i mirë i devotshmërisë ishte përrulja e vetes në sytë e Zotit – vënia e ballit në tokë përballë madhësisë së Zotit. Po ashtu, siç na tregohet në ‘Një mijë e një netët’, se respekti për sovranin tregohet duke ‘puthur tokën përpara’. Shkurt, koncepti i xhihadit predikonte se muslimanët nuk duhej të pushtonin hapësirën vertikale, por atë horizontale, ose ekstensive, qoftë nëpërmjet fesë apo tregtisë. Si rrjedhojë qytete lulëzuan në mbarë Lindjen e Mesme dhe shpejt formuan nyjet e rrjetit ekonomik global.

Peizazhi i një rrjeti të dendur tregtar urban, bie ndesh me vizionin eurocentrik tradicional për Islamin si një shkretëtirë e populluar nga nomadë. Siç shprehet Marshall Hodgson, Islami ‘nuk ishte “monoteizëm shkretëtirë”, lindur nga mahnia e beduinëve kundrejt hapësirës së pamatë të qiellit e të tokës ... Islami lindi nga një traditë e gjatë fetare urbane dhe ishte po aq “qytetar” sa çdo variant tjetër i asaj tradite’.<sup>58</sup> Maxime Rodinson e përforcon pretendimin e përgjithshëm të bërë këtu:

dendësia e marrëdhënieve tregtare brenda botës muslimane krijonte një lloj tregu botëror ... me përmasa të papara ndonjëherë. Zhvillimi i këmbimit valutor bëri të mundur specializimin rajonal në industri dhe agrikulturë ... Bota muslimane jo vetëm që kishte një sektor industrial, por ky sektor duket të ketë qenë më i gjeri e më i zhvilluari në historinë e deriatëhershme para [periudhës moderne].<sup>59</sup>

Islami u përhap jo vetëm drejt perëndimit në Europë, por edhe drejt lindjes në Indi, në Azinë Juglindore e Kinë, si dhe drejt jugut në Afrikë, përmes ndikimit fetar ose tregtar (dhe shpesh përmes të dyjave). Kapaciteti i tij ekonomik

<sup>58</sup> Po aty, fq. 133.

<sup>59</sup> Rodinson, *Islam*, fq. 56.

ishte i jashtëzakonshëm për epokën, aq sa një studiues me të drejtë ka vënë në dukje se, 'duhet pranuar fakti i qartë se ata [arabët] ishin ndër pionierët e tregtisë në ato vende të largëta dhe ndoshta, siç sugjeron Tibbets, vepronin si ndërmjetës në tregtinë midis Kinës dhe Azisë Juglindore'.<sup>60</sup> Me siguri, në shekullin e nëntë – siç e konfirmojnë dokumente të shumta të kohës – një linjë e gjatë e vazhdueshme tregtie ndërkontinentale e hapur nga tregtarët muslimanë, zgjatej nga Kina deri në Mesdhe.<sup>61</sup>

Umejadët (661-750) dhe abasidët (750-1258) mesolindorë, si dhe fatimidët afrikanoveriorë, ishin veçanërisht të rëndësishëm si përbashkues të arterieve të ndryshme të tregtisë në distanca të largëta që shtrihej në lashtësi mes Oqeanit Indian dhe Mesdheut. Këto arterie përfshinin Detin e Kuq dhe Gjirin Persik. Kryeqyteti abasid, Bagdadi, ishte i lidhur me rrugën e Gjirit Persik e cila shpërndahej në Oqeanin Indian e përtej, në Detin e Kinës Jugore si dhe të Kinës Lindore. Bashkëkohësi el-Jakubiu (rr. 875) e përshkruante Bagdadin si 'portin e botës', kurse el-Mansuri deklaronte se 'nuk ka pengesë mes nesh dhe Kinës; gjithçka në det mund të mbërrijë tek ne përmes tij'.<sup>62</sup> Të tjera porte muslimane ishin gjithashtu të rëndësishme, veçanërisht Sirafi në Gjirin Persik (në bregun iranian, në jug të Shirazit), i cili shërbente si destinacioni madhor për mallrat që vinin nga Kina dhe Azia Juglindore. Rruga e Detit të Kuq (e sunduar nga Egjipti) po ashtu kishte rëndësi të veçantë (shih pjesën në vijim). Krahas rrugëve detare, më e famshmjja ndoshta ishte

<sup>60</sup> Rita R. Di Meglio, "Arab Trade with Indonesia and the Malay Peninsula from 8th to the 16th Century", te D. S. Richards (red.), *Islam and the Trade of Asia* (Oxford: Bruno Cassirer, 1970), fq. 126.

<sup>61</sup> Hourani, *Arab Seafaring*, fq. 62; Abu-Lughod, *Hegemony*, fq. 199; W. E. B. Du Bois, *Africa and the World* (New York: International Publishers, 1975 [1946]), fq. 174, 192; Neville Chittick, "East African Trade with the Orient", te Richards, *Islam*, fq. 98.

<sup>62</sup> Al-Mansur dhe al-Ya'qubi, cituar te Hourani, *Arab Seafaring*, fq. 64.

rruga tokësore me Kinën, përgjatë së cilës karvanet kalonin përmes qyteteve të Iranit si Tebrizi, Hamadani e Nishapuri për në Buhara e Semerkand në Transoksianë, dhe më tutje, për në Kinë ose Indi. Marko Polo ('Ibni Battuta i Europës?') ndihej veçanërisht i impresionuar – siç do të ndihej edhe vetë Ibni Battuta:

Banorët e Tebrizit rrojnë me anë të tregtisë dhe industrisë ... Qyteti ka një pozitë aq të favorshme, sa shërben si një treg për mallrat nga India a Bagdadi, nga Mosuli e Hormuzi, si dhe nga shumë vende të tjera. Shumë tregtarë latinë vijnë këtu për të blerë mallrat e sjella nga vise të huaja. Po ashtu shërben si treg për gurët e çmuar, të cilët këtu gjenden me bollëk. Është një qytet ku tregtarët udhëtarë arrijnë fitime të mira.<sup>63</sup>

Muslimanët ishin veçanërisht të varur nga tregtia me shumë pjesë të Afrikës (dhe jo vetëm të Afrikës Veriore). Kjo për një sërë arsyesh: së pari, ngaqë Egjipti sundonte mbi një nga rrugët tregtare jetike që lidhnin Lindjen e Largët me Perëndimin (shih pjesën në vijim) dhe, së dyti, ngaqë tregjet afrikane përbënin ndoshta degën më fitimprurëse të tregtisë së Islamit me jashtë. Ndërsa eurocentrizmi e shpërfill lidhjen e Afrikës me sistemin tregtar ndërkombëtar që ekzistonte para 1500-ës, tregtia që zhvillonte Afrika nuk ishte aspak e parëndësishme dhe kjo shumë kohë para shkeljes së europianëve atje. Jo më pak domethënës është fakti se mbretëria aksumite abisinase kishte tregtarë zezakë të cilët bënë tregtinë të konsiderueshme me Indinë edhe përpara Islamit.<sup>64</sup> Përshkrimi përndryshe mjeshtëror i ekonomisë globale që bën Abu-Lughod bie në sy vetëm për

<sup>63</sup> Marco Polo, cituar te Jonathan Bloom dhe Sheila Blair, *Islam: Empire of Faith* (London: BBC Worldwide, 2001), fq 164; krahaso, Ibn Battuta, *Travels in Asia and Africa, 1325-1354* (London: Routledge and Kegan Paul, 1983), fq. 101.

<sup>64</sup> Wink, *Al-Hind*, fq. 28, 47.

lënien jashtë peizazhit të Afrikës Juglindore.<sup>65</sup> Por tregtia detare nga bregu juglindor kishte qenë e rëndësishme që para ardhjes së muslimanëve; shtrirjen e saj e nxjerr në pah fakti se tregti e rregullt zhvillohej deri në Polinezi. Për më tepër, indonezianët patën migruar në Afrikën Lindore që në shekujt 2-4 të erës sonë. Anijet e muslimanëve zbritën përgjatë bregut afrikanolindor deri në Sufala të Mozambikut dhe Kanbalu (Madagaskar). Në shumë vende, përfshirë Etiopinë dhe Zimbabven, nxirrej ar, kurse në Kilva (në jug të Tanzanisë së sotme) ndodhej pika kryesore e grumbullimit dhe e shpërndarjes.<sup>66</sup> Udhëtari i famshëm botëror musliman Ibni Battuta e përshkruan Kilvan si ‘një nga qytetet më të bukura e më të mirëndërtuara’ që ai kishte parë gjatë udhëtimeve të tij të shumta në një pjesë të madhe të botës.<sup>67</sup> Afrikanët importonin rruaza, guaska *cowry*, bakër dhe sende bakri, drithë, fruta dhe rrush të thatë, grurë dhe më vonë tekstile (të gjitha mallra të konsumit masiv dhe jo mallra luksi). Marrëdhëniet më të dendura tregtare portet e Afrikës Lindore i kishin me Indinë, Adenin, Suharin dhe Sirafin. Kjo tregti distancash të largëta gjithashtu ndihmoi në stimulimin e tregtisë edhe në hinterlandin afrikan.<sup>68</sup>

Për më tepër, do të ishte e gabuar të mendohej se Afrika Perëndimore ishte e izoluar nga pikëpamja tregtare nga bregu lindor dhe ‘u soll në jetë’ nga europianët pas 1492-shit.<sup>69</sup> Në fakt, pas ardhjes shumë më të hershme të muslimanëve, qendra grumbullimi perëndimore si Sixhilmassa

<sup>65</sup> Abu-Lughod, *Hegemony*, fq. 36.

<sup>66</sup> Philip D. Curtin, “Africa and the Wider Monetary World, 1250-1850”, te J. F. Richards (red.), *Precious Metals in the Later Medieval and Early Modern Worlds* (Durham: Carolina Academic Press, 1983), fq. 231-238.

<sup>67</sup> Ibn Battuta, cituar te Du Bois, *Africa*, fq. 191.

<sup>68</sup> John Middleton, *The World of the Swahili* (New Haven: Yale University Press, 1992).

<sup>69</sup> Du Bois, *Afrika*, kapitulli 10; Eric R. Wolf, *Europe and the People Without History* (Berkeley: University of California Press, 1982), fq. 37-44.

(në Marok) dhe Avdaghasti u zgjeruan, dhe brigjet lindore e perëndimore u ndërlihdën, si në veri dhe në rajonet nën-sahariane.<sup>70</sup> Megjithatë, lidhjet tregtare brenda Afrikës kishin filluar kohë para ardhjes së muslimanëve (siç vihet në dukje më lart), siç kishin filluar edhe gjithfarë formash prodhimi, si nxjerrja e arit, prodhimi i bakrit dhe hekurshkrirja.<sup>71</sup> Arkeologu Sayce e përshkruan qendrën hekurprodhuese Meroen (kryeqyteti i mbretërisë së Kushit në fund të mijëvjeçarit të parë p.e.s.) si 'Birmingham-in e Afrikës Qendrore'. Kurse Sufula (para ardhjes së muslimanëve) kishte minierat më të mira e më të mëdha të hekurit dhe një pjesë e hekurit të prodhuar atje eksportohej edhe në Indi.<sup>72</sup>

Gjithashtu vlen të vihet në dukje se tregtia globale në masë domethënëse u bë e mundur edhe nga tregtarët hebrej, si dhe nga mbretëria e Srivixhajës në Sumatra. Kjo e fundit shërbente si një bosht tregtar global në të ashtuquajturën 'Lindje e Largët', njësoj si Lindja e Mesme/Afrika Veriore në Perëndim. Siç e vë në dukje Jerry Bentley:

tregtia që e lidhte Kinën Jugore me Sejlonin dhe Indinë u rrit në ato përmasa sa mbretërit e Srivixhajës në Palembang, në juglindje të Sumatrës, organizuan një perandori ishullore e cila për një pjesë të madhe të kohës mes shekujve të shtatëmbëdhjetë e tetëmbëdhjetë kontrolloi tregtinë që zhvillohej përmes ujrave të Azisë Juglindore.<sup>73</sup>

Shumica e autoriteteve bien dakord se ngritja e Srivixhajës u ndihmua mjaft nga ringjallja e tregtisë kineze gjatë dinastisë Tang.<sup>74</sup> Srivixhajja ndodhej në një pikëtakim të

<sup>70</sup> K. P. Moseley, "Caravel and Caravan: West Africa and the World-Economies, ca. 900-1900 AD", *Review* 15 (3) (1992), 527; E. W. Bovill, *Caravans of the Old Sahara* (London: Oxford University Press, 1933), veçanërisht kapitujt 5-6.

<sup>71</sup> Du Bois, *Africa*, kapitulli 7; Roland Oliver, *The African Experience* (London: Phoenix, 1999), kapitujt, 6, 11.

<sup>72</sup> Wink, *Al-Hind*, fq. 61.

<sup>73</sup> Jerry, H. Bentley, "Cross-Cultural Interaction and Periodization in World History", *American Historical Review* 101 (3) (1996), 764.

<sup>74</sup> O. W. Wolters, *Early Indonesian Commerce* (Ithaca: Cornell University Press, 1967).

rëndësishëm mes tregtisë që vinte nga Lindja e Mesme, India dhe Kina.<sup>75</sup> Udhëtari i famshëm kinez I-Çing numëronte tridhjetë e pesë anije të ardhura vetëm nga Persia gjatë qëndrimit të tij gjashtëmujor atje më 671. Hebrenjtë (ose 'tregtarët rhadanitë') ishin të rëndësishëm gjithashtu.<sup>76</sup> Roli i tyre përshkruhet hollësisht nga bashkëkohësi Ibni Kurra-dhib, si dhe në letrat bashkëkohëse të Genizës (në Kajro).<sup>77</sup> Termi 'rhadanit' duket se vjen nga termi persisht *rha dan* ('ata që dinë rrugën'). Në veçanti këta tregtarë luanin një rol shumë të rëndësishëm në tregtinë dhe financat e botës muslimane – në Bagdad deri rreth shekullit të dhjetë dhe më vonë në Kajron fatimide pas 969-ës.

Së fundmi, mes viteve 650-1000, skaji udhëheqës i fuqisë intensive globale ishte në Lindjen e Mesme dhe Afrikën Veriore muslimane. Eric Jones pretendon se kalifati abasid është i pari rajon në botë që ka arritur rritje ekonomike të të ardhurave për frymë (që mendohet si lajtmotivi i kapitalizmit modern).<sup>78</sup> Fernand Braudel e përshkruante si më poshtë aktivitetin ekonomik të botës islame pas 800-ës:

Fjala 'kapitalist' nuk është shumë anakronike. Nga njëri skaj i lidhjeve të botës islame në tjetrin, spekulatorët rrezikonin vazhdimisht në tregti. Një autor arab, Hariri, e bën një tregtar të deklarojë: 'Dua të dërgoj shafran persian në Kinë, ku kam dëgjuar se blihet me çmim të lartë, pastaj të çoj porcelan kinez me anije në Greqi, brokadë greke në Indi, hekur indian në Haleb, qelq Halebi në Jemen dhe stofra Jemeni me shirita në Persi'. Në Basra, marrëveshjet mes tregtarëve bëheshin nëpërmjet asaj që sot do ta quanim një sistem likuidimi.<sup>79</sup>

<sup>75</sup> Wink, *Al-Hind*, fq. 351-355.

<sup>76</sup> Po aty, fq. 86-104.

<sup>77</sup> Shih S. D. Goitein, *Jews and Arabs* (New York: Schocken Books, 1964).

<sup>78</sup> Eric L. Jones, *Growth Recurring* (Oxford: Clarendon Press, 1988), kapitulli 3.

<sup>79</sup> Fernand Braudel, *A History of Civilizations* (London: Penguin, 1995), fq. 71.

Me rëndësi kritike këtu që një radhë risish intensive (prodhuese) dhe përsosjesh teknologjike e konceptuale të bëra nga muslimanët. Siç e shpjegon kapitulli 6, shpikja e mundshme, përmes një zhvillimi të caktuar, e velës trekëndore bëri të mundur lundrimin në distanca të gjata, sidomos në Oqeanin Indian. Po kështu edhe zhvillimi i astrolabit bashkë me përparime të shumta në astronominë dhe matematikën muslimane (shih edhe kap. 7, 8). Prodhimi i letrës filloi pas vitit 751. Prodhimi i tekstileve ishte veçanërisht i rëndësishëm: Siria dhe Iraku ishin të famshëm për prodhimet e tyre të mëndafshit, kurse Egjipti udhëhiqte për sa u përket stofrave të linit dhe të leshit. Muslimanët gjithashtu përdornin ngjyra mbresëlënëse stofrash. Ndikimin musliman e nxjerrin në pah termat e shumtë arabisht (dhe persisht) të huazuara në gjuhët europiane. Kimikatet e njohura si ngjyrëfiksuese nevojiteshin për t'i bërë ngjyrat të qëndrueshme në stof, sidomos alkalitet (nga arabishtja *el-kali*, 'hi'). Shafrani vjen nga arabishtja *zafaran*. Fjala damask vjen nga Damasku, byrynxyku [*muslin*] nga qyteti i Mosulit dhe tyli [*organdy*] nga qyteti i Urgençit në Azinë Qendrore. Leshi i angorës [*mohair*] vjen nga arabishtja *mukhajjir* (më e mira), kurse taftaja nga *taftan* (folja persisht 'tjerr').<sup>80</sup> Për t'u shënuar gjithashtu është se muslimanët ia kalonin Europës për sa i përket prodhimit të hekurit, kurse në prodhimin e çelikut mbizotëruan deri në shekullin e tetëmbëdhjetë. Veç kësaj, prodhimi i muslimanëve përfshinte rafinimin e sheqerit, ndërtimin, mobiljet, qelqin, lëkurëpunimin, poçerinë dhe gurprerjen.<sup>81</sup> Prodhimi egjiptian i kallamit të sheqerit ishte një industri udhëheqëse globale dhe *sukkar*-i i

<sup>80</sup> Bloom dhe Blair, *Islam*, fq. 110-111.

<sup>81</sup> S. D. Goitein, "The Main Industries of the Mediterranean Area as Reflected in the Records of the Cairo Geniza", *Journal of the Economic and Social History of the Orient* 4 (2) (1961), 168-197.

rafinuar (nga vjen edhe 'sheqer') eksportohej gjerësisht në një pjesë të madhe të botës. Muslimanët gjithashtu përfitonin energji nga mullinjë me erë dhe me ujë dhe kjo energji përdorej për prodhim industrial. Vlen të thuhet po ashtu se Lindja e Mesme/Afrika Veriore për shumë kohë ishin përpara Europës si në dije shkencore ashtu edhe në teknologji ushtarake (kap. 8). Jo më pak i rëndësishëm ishte krijimi i një sërë institucionesh kapitaliste (që kishin të bënin me partneritetet, të drejtën kontraktuale, sistemin bankar, kreditimin e shumë të tjera), ku mbështeteshin jo vetëm prodhimi, investimi e tregtia e muslimanëve, por edhe tregtia globale (kap. 6). Në tërësi, siç e përmbledh saktë Eric Jones, 'historia e përparimit teknik dhe ekonomik në kalifatin abasid ... tregon se e kaluara [islamike] nuk ka qenë kurrsesi e pandryshueshme'.<sup>82</sup>

### **Fuqia ekstensive globale dhe konturet e ekonomisë globale, rr. 1000-1517**

Konturet e ekonomisë globale në periudhën pas vitit 1000 janë përshkruar në mënyrën më të qartë nga Janet Abu-Lughod në librin e saj autoritar *Before European Hegemony*. Ajo nxjerr në pah tri rrugë kryesore tregtare që lidheshin me tetë nënsisteme rajonale, të cilat do t'i trajtoj tani.

#### ***Rruga veriore dhe perandoria mongole: 'fiset paqësore nga ferri'?***

Një shtysë të madhe globalizimit lindor ia dha lindja e Perandorisë Mongole në shekullin e trembëdhjetë. Kjo perandori i bashkoi Lindjen dhe Perëndimin në një hapësirë tregtare të pandërprerë. Është me siguri e vërtetë që në she-

<sup>82</sup> Jones, *Growth Recurring*, fq. 67.

kullin e dymbëdhjetë turqit selçukë u shtynë drejt perëndimit dhe morën në kontroll një hapësirë të madhe që përfshinte të gjithë Irakun dhe Gjysmëhënën Pjellore. Por qenë Xhingis Hani dhe mongolët ata që arritën të pushtonin një pjesë të madhe të masës tokësore euraziatike. Ironikisht – parë nga prizmi tradicional eurocentrik – Xhingis Hani nuk zgjodhi ta pushtonte Europën e prapambetur, duke u mjaftuar me pjesët e saj lindore (kryesisht Rusinë e Kievit), por i përqendroi përpjekjet në çmimin më të vyer, Kinën. Në gjysmën e dytë të shekullit të trembëdhjetë, pjesa më e madhe e masës tokësore të Eurazisë ndodhej nën zotërimin e mongolëve. Çështja kritike është se kjo perandori relativisht e unifikuar territoriale – *Pax Mongolica* – rezultoi një rajon i paqtuar ku kapitalizmi mund të lulëzonte. Ajo bëri të mundur tregtinë në distanca shumë të gjata, ose globale, me 5000 milje nga Kina deri në Europë, si dhe përhapjen në Perëndim (dhe gjetkë) të ideve dhe teknologjive superiore të Lindjes.<sup>83</sup> Kufizimet institucionale dhe kostot politike u ulën, jo më së paku ngaqë mongolët u treguan dashamirës ndaj tregtarëve të shumtë që udhëtonin përmes perandorisë. Bashkëkohësi i famshëm i Marko Polos, Balducci Pegolotti, e përshkruante Rrugën e Mëndafshit si ‘plotësisht të sigurt, natën dhe ditën’.

Një tjetër ironi këtu është se eurocentrizmi i sheh mongolët ose ‘tartarët’ (siç i quanin europianët) si fundamentalisht destruktivë e armiqësorë ndaj aktivitetit progresiv ekonomik. Siç shpjegon Abu-Lughod:

Fillimisht mongolët u lanë në po atë rajon mitologjik që u rezervohet krijesave të tjera të çuditshme që popullonin botën e panjohur të Azisë. Bazuar në një keqinterpretim të termit tatar (emri i vetëm njërit prej grupeve fisno-

<sup>83</sup> Felipe Fernandez-Armesto, *Civilizations* (London: Pan Books, 2001), fq. 120-131.

re që më vonë iu bashkuan konfederatës mongole), mongolët u identifikuan si tartarë, domethënë që vinin nga rajoni biblik i Tartarusit, ose Ferri. Është e vështirë të kuptohet se si, në të njëjtën kohë, ata mund të vështroeshin me mall si aleatë të mundshëm të botës së krishterë në luftën e shenjtë kundër muslimanëve. Ndoshta edhe krijesat e viseve të Gogut dhe Magogut [lajmëtarë të apokalipsit] (një tjetër orvatje e dobët për të përcaktuar origjinën e tyre) mund të mobilizoheshin në luftën e tyre [kundër muslimanëve].<sup>84</sup>

Kronikani bashkëkohës Matthew Paris më 1240 e përshkruante 'pushtimin tartar' si: 'një komb i urryer i Satanait; hordhitë e panumërta të tartarëve, dalë prej atdheut të tyre malor, duke shpuar shkëmbinjtë e patundshëm [të Kaukazit] tek derdhen si djaj'.<sup>85</sup> Ai madje i përshkruante 'tartarët' si njerëz me koka me përmasa groteske, që ushqehen me mish njeriu. Europianëve mesjetarë të gjitha këto u tingëllonin të natyrshme, sepse thjesht i plotësonin përfytyrimet e tyre groteskte për popujt lindorë, si blemanët (me fytyra në kraharor), skiopodët (të cilët kishin një këmbë dhe shputën gjigande e përdornin për t'i bërë vetes hije), antropofagët (me koka poshtë supeve) dhe kinoqefalët (njerëz me kokë qeni).<sup>86</sup>

Perceptimet e europianëve për mongolët – për të mos përmendur popujt e tjerë lindorë – mbështeteshin në disa mite. Së pari, fisin e tatarëve e kishte zhdukur nga faqja e dheut Xhingisi. Së dyti, mongolët ishin shumë të ndryshëm nga 'barbarët qimekuq' të Perëndimit të prapambetur. Dhe së treti, krahas sjelljes së mallrave lindore, Perandoria Mon-

<sup>84</sup> Abu-Lughod, *Hegemony*, fq. 159.

<sup>85</sup> Matthew Paris, cituar te Michael Edwardes, *East-West Passage* (New York: Taplinger, 1971), fq. 70.

<sup>86</sup> J. B. Friedmann, *The Monstrous Races in Medieval Art and Thought* (Cambridge, Mass.: Harvard University Press, 1981).

gole tërthorazi i ofroi shërbime tejet të dobishme Europës për aq sa përbënte një konvektor përgjatë të cilit disa nga 'kapacitetet burimore' të përparuara lindore arritën në Perëndim (siç do ta shohim në kapitujt e mëtejshëm). Por ky qark tregtar me ndikim, në mesin e shekullit të katërmbëdhjetë ishte në rënie. Timurlengu, duke u nisur për luftë nga Semerkandi, ndihmoi për t'i dhënë fund *Pax Mongolica-s*, siç ndihmuan edhe kërditë e Vdekjes së Zezë. Por kjo nuk shënoi fundin e ekonomisë globale të udhëhequr nga Lindja. Përkundrazi, tregtia gjithnjë e më shumë po kanalizohet në rrugën e mesme e sidomos në atë jugore.

### *Rruga e mesme:*

#### *ruajtja e fuqisë ekstensive islamike mesolindore*

Sipas Abu-Lughod-it, rruga e mesme fillonte në bregun mesdhetar të Sirisë/Palestinës, kalonte përmes shkretëtirës së kuqe e fushës së Mezopotamisë dhe arrinte në Bagdad para se të ndahej përfundimisht në një rrugë tokësore dhe një rrugë detare. Rruga tokësore vazhdonte përmes Persisë në Transoksianë dhe pastaj ose drejt juglindjes për në Indinë Veriore, ose drejt lindjes, për në Semerkand, e që andej kalonte shkretëtirën dhe përfundonte në Kinë. Kurse rruga detare ndiqte Lumin Tigër deri në Gjirin Persik nga Bagdadi përmes Basrës dhe që andej kalonte mbretëritë tregtare të Omanit, Sirafit, Hormuzit ose Kajsit (rojtarë të lidhjes midis Gjirit dhe Oqeanit Indian më tutje). Kjo rrugë u bë veçanërisht e rëndësishme pas shekullit të gjashtë, por fitoi ndikim tejet të madh kur Bagdadi u bë qendra kryesore tregtare muslimane pas 750-ës. Kur Bagdadi u plaçkit nga mongolët në vitin 1258, kjo rrugë pësoi një rënie të përkohshme, por e rifitoi gjallërinë kur Irakun më vonë e sundoi Persia. Rruga e mesme gjithashtu ishte e rëndësishme pasi bënte të mundur një marrëdhënie tregtare 'thellësisht simbiotike' midis

mbretërive kryqtare dhe tregtarëve muslimanë të cilët sillnin mallra që nga Orienti.

Porti kryesor i kryqtarëve në Lindjen e Mesme, Akka, deri në vitin 1291 kontrollohej nga venedikasit, të cilët i nxorrën jashtë loje atje rivalët e tyre pizanë dhe gjenovezë. Por edhe pse venedikasit e mbizotëronin sistemit tregtar të Europës, ata gjithmonë hynin në sistemin global sipas kushteve të diktuar nga muslimanët e Lindjes së Mesme e sidomos të Afrikës Veriore. Kur Konstandinopojën e morën sërish bizantinët më 1261, gjenovezët u favorizuan kundrejt venedikasve, duke i detyruar ata të përqendroheshin në rrugët e mesme dhe jugore. Por me rënien e Akkës më 1291, venedikasit u detyruan të mbështeteshin në rrugën jugore e cila mbizotërohej nga egjiptianët.

### *Rruga jugore:*

#### *Varësia e Europës nga hegjemonia tregtare e Egjiptit, 1291-1517*

Kjo rrugë e lidhte kompleksin Aleksandri-Kajro-Det i Kuq me Detin Arabik dhe Oqeanin Indian e përtej. Pas shekullit të trembëdhjetë, Egjipti përbënte portën kryesore drejt Lindjes. Siç pretendon Abu-Lughod, 'Kushdo që kontrollonte rrugën detare drejt Azisë mund të përcaktonte kushtet e tregtisë për Europën tashmë në tërheqje. Nga shekulli i trembëdhjetë e deri në shekullin e gjashtëmbëdhjetë, kjo fuqi ishte Egjipti.'<sup>87</sup> Mes viteve 1291 dhe 1517, rreth 80% e të gjithë tregtisë që shkonte në Lindje përmes detit, kontrollohej nga egjiptianët. Me rënien e Bagdadit, el-Kahire – më vonë e europianizuar në Kajro – u bë kryeqyteti i botës islame dhe epiqendra e tregtisë globale (ndonëse ky proces kishte filluar gjatë periudhës fatimide në shekullin e dhjetë).

Studiuesit eurocentrikë theksojnë se tregtia ndërkom-bëtare europiane me Lindjen u tha pas vitit 1291 (me rënien

<sup>87</sup> Abu-Lughod, *Hegemony*, fq. 149.

e Akkës) ndërsa Egjipti mbizotëroi tregtinë e Detit të Kuq me Lindjen në dëm të europianëve të krishterë dhe që pikërisht kjo që i nxiti vëllezërit portugezë Vivaldi të kërkonin rrugën më jugore për në Indet përmes Kepit më 1291. Por ky pretendim është problematik. Është e vërtetë se rënia e Akkës më 1291 e nxiti Papa Nikolën IV të shpallte një sërë ndalimesh mbi tregtinë me 'të pabesët'. Por fakti është se venedikasit arritën ta anashkalonin ndalesën dhe të siguronin marrëveshje të reja me sulltanin më 1355 dhe 1361. Deri më 1517 Venecia mbijetoi falë faktit që Egjipti luante një rol kaq të rëndësishëm në ekonominë botërore. Për më tepër, Venecia dhe Gjenova nuk ishin 'pionierë' të tregtisë globale, por aktorë që përshtateshin, duke u futur në boshllëqet e ekonomisë globale të udhëhequr nga afro-aziatikët dhe duke tregtuar në kushte të vendosura nga muslimanët e Lindjes së Mesme dhe sidomos egjiptianët. Kur arrinin në Aleksandri, ata i prisnin ofiqarët e doganave, të cilët qëndronin në anije dhe mbikëqyrnin shkarkimin e mallrave. Të krishterëve u kërkohej një leje ose vizë e veçantë dhe paguanin taksë shumë më të lartë se tregtarët muslimanë. Europianët pastaj tërhiqeshin në lagjet e tyre ku qeveriseshin sipas ligjeve të tyre. Por atyre nuk u lejohej të dilnin nga këto lagje në Aleksandri, kështu që u bënë krejtësisht të varur nga tregtarët dhe ofiqarët egjiptianë. Megjithatë, venedikasit dhe europianët e tjerë e pranonin këtë regjim pasi që këtu arrinin akses në mallrat e shumtë që prodhoheshin në Lindje. Pasurimi i Venecias u bë i mundur vetëm falë aksesit të saj në tregtinë e Lindjes përmes Afrikës Veriore.

Së fundmi, është e rëndësishme të vihet në dukje se Venecia dhe Gjenova vazhduan ta gëzonin aksesin e tyre të privilegjuar në ekonominë globale të udhëhequr nga afro-aziatikët përmes një doze të fortë fati (më shumë se falë fuqisë së tyre ekonomike). Sfidat gjeopolitike me të cilat u

përball Egjipti përballë mongolëve e kryqtarëve, kishin çuar në një riorganizim ushtarak të shoqërisë egjiptiane. Ngaqë organizimi ushtarak mamluk i Egjiptit bazohej në përdorimin e skllëvërve, të cilët s'mund të rekrutoheshin nga radhët e muslimanëve, Venecia dhe Gjenova u lejuan t'i ruanin marrëdhëniet e tyre tregtare me kusht që të sillnin skllëvër jomuslimanë në Egjipt. Pas vitit 1261, Gjenova luajti një rol kritik në furnizimin me skllëvër kaukazianë jomuslimanë, të cilët dërgoheshin me anije nga Krimea. Por në shekullin e katërbëdhjetë, një sërë zhvendosjesh gjeopolitike i çliruan egjiptianët nga nevoja për skllëvër jomuslimanë. Kjo e vulosi fatin e tregtisë gjenoveze të skllëvërve, meqë egjiptianët nuk ua kishin më nevojën shërbimeve të tyre Megjithatë, lidhja e favorizuar e Venecias me Egjiptin vazhdoi, por vetëm falë vullnetit të mirë të egjiptianëve.

Kjo e përmbyll përshkrimin e kontureve të ekonomisë globale të udhëhequr nga Lindja në njërën anë, si dhe të hegjemonisë tregtare të Azisë Perëndimore e Afrikës Veriore mbi Europën në anën tjetër. Por është gjithashtu e rëndësishme të vihet në dukje se hegjemonia tregtare muslimane mbi Europën vazhdoi edhe pas 1517-ës. Kjo sepse stafeta e fuqisë ekstensive të Islamit kaloi nga Egjipti tek Perandoria Osmane, e cila ruajti kontrollin mbi portugezët në Oqeanin Indian (shih kap. 7). Veç kësaj, qendra të tjera të fuqisë ekonomike muslimane – Indian mogule dhe Azia Juglindore – mbetën mjaft të fuqishme për t'u rezistuar e për të dominuar kundrejt tregtarëve europianë deri rreth 1800-ës (kap. 4 dhe 7). Megjithatë, pavarësisht se sa mbresëlënëse ishte fuqia ekstensive muslimane dhe faktit se Lindja e Mesme vazhdoi të shërbente si Ura e Botës gjatë një pjese të madhe të mijëvjeçarit të dytë, skaji udhëheqës i fuqisë intensive globale i kaloi jo Italisë pas vitit 1000, apo Portugalisë pas 1500-ës, por Kinës më 1100, ku do të mbetej deri në shekullin e nëntëmbëdhjetë.

### 3. PIONIERËT KINEZË: MREKULLIA E PARË INDUSTRIALE DHE MITI I IZOLACIONIZMIT KINEZ, RR. 1000-1800

Kur Marko Polo udhëtoi në Lindje dhe tregoi për ato që kishte parë, duke e përzier të vërtetën me gënjeshtër por duke treguar diçka nga e vërteta në çdo rast, perëndimorët nuk deshën ta besonin. Në mesjetën e vonë rrëfimet e tij për udhëtimet që kishte bërë shiheshin si një libër përrallash ... thua se perëndimorët nuk ishin në gjendje të besonin në realitetin e mrekullive të Orientit.

*Jacques Le Goff*

Historianët europianë [nuk e kanë] kuptuar ende se ngritja e civilizimit mejsetar europian pas vitit 1000 përkoi me një zhvendosje të qendrës [prodhimtare] të sistemit botëror nga Lindja e Mesme në Kinë. Kjo nuk është për t'u habitur po të kihet parasysh preokupimi i historianëve tanë të mesjetës me historinë e Francës e të Anglisë, duke ia veshur në mënyrë të nënkuptuar të gjithë të kaluarës njerëzore rrethanat e fundit të shekullit të nëntëmbëdhjetë kur perandoritë franceze dhe angleze mbulonin pjesën më të madhe të botës. Prandaj të kuptuarit e pozitës udhëheqëse kineze kërkon një kapërcim të vërtetë të përfytyrimit.

*William H. McNeill*

Në vitin 1100, skaji udhëheqës i fuqisë intensive globale ishte zhvendosur në Kinë dhe do të mbetej atje deri në shekullin e nëntëmbëdhjetë. Kina gjithashtu zhvilloi fuqi të konsiderueshme ekstensive dhe arriti të dominonte në këtë aspekt pas shekullit të pesëmbëdhjetë (ndonëse Lindja e Mesme muslimane vazhdoi të përbënte një nyjë jetike të ekonomisë globale). E gjitha kjo bie ndesh me përshkrimin

eurocentrik. Kritika ime ndaj karakterizimit standard eurocentrik të Kinës konsiston në dy pjesë. Pjesa e parë tregon se Kina arriti atë që unë e quaj 'mrekulli të parë industriale', ku shumë karakteristika të cilat i bashkëshoqërojmë me revolucionin industrial në Britaninë e shekullit të tetëmbëdhjetë dolën në pah që më 1100. Pjesa e dytë merret me mohimin e zakonshëm eurocentrik të arritjeve të dinastisë Sung, gjegjësisht që sundimet e mëvonshme despotike lindore të Kinës i këputën filizat e zhvillimit industrial të sungëve duke bërë që ekonomia të merrte një tatëpjetë të thepisur. Kjo e shpjegon edhe gjoja tërheqjen e Kinës nga bota pas vitit 1434 kur shteti e ndaloi tregtinë e jashtme dhe u struk në sistemin e tij perandorak të haraçit. Këtu unë ofroj një peizazh tjetër që nxjerr në pah, në mos një ekonomi globale sinocentrike, me siguri një të tillë ku Kina ka lozur një rol madhor në periudhën pas 1434-ës. Po ashtu, në kapitujt 4 dhe 7 ofroj edhe të dhëna të mëtejshme të hollësishme në mbështetje të pozitës udhëheqëse të Kinës.

### **Mrekullia e parë industriale:**

#### **Kina sunge e shekullit të njëmbëdhjetë**

Siç e shpjegon kapitulli 9, historianët e ekonomisë konvencionalisht e marrin për të mirëqenë se origjinat ose receta e industrializimit mund të gjendet në Britaninë e shekullit të nëntëmbëdhjetë. Por ajo që nuk na thuhet është se kryemjeshtri i industrisë ishte Kina dhe jo Britania. 'Mrekullia industriale' e Kinës ndodhi përgjatë një periudhe prej 1500 vjetësh duke arritur kulmin me revolucionin sung – rreth gjashtëqind vjet para se Britania të hynte në fazën e saj të industrializimit. Mrekullia industriale kineze vlen të vështrohet deri diku hollësisht sepse ishte ngjarja më e rëndësishme në historinë e fuqisë intensive globale mes viteve

1100-1800. Sepse bartja e shumë kapërcimeve teknologjike e konceptuale të Kinës sunge qe mjaft përcaktuese në ngritjen e Perëndimit (kap. 6-9).

*(R)evolucioni i hekurit dhe çelikut, 600 p.e.s.-1100 e.s.*

Mrekullia kineze e hekurit dhe çelikut shkon pas deri në vitet 600 p.e.s., me objektin e parë prej hekuri të derdhur që daton nga viti 513 p.e.s. dhe me çelikun të prodhuar në shekullin e dytë p.e.s.<sup>88</sup> Gjithsesi, rritja e fuqishme e industrisë në fjalë në periudhën 800-1100 duket e pakundërshtueshme, edhe pse hollësitë për sa u përket sasive nuk janë krejt të qarta. Në një artikull të mirënjohur, Robert Hartwell vlerëson se prodhimi kinez i hekurit për frymë u rrit gjashtëfish mes viteve 806-1078, kurse në shifra bruto, Kina prodhoi rreth 13.500 më 806, rreth 90.400 tonë më 1064 dhe 125.000 tonë më 1078.<sup>89</sup> Dy krahasime janë ndriçuese: së pari, që e gjithë Europa do të prodhonte sasi më të mëdha vetëm më 1700, kurse deri më 1788 Britania prodhonte vetëm 76.000 tonë. Së dyti, raporti i çmimit (matur si raport i vlerës së hekurit kundrejt orizit) ishte 177:100 në Siçuanin e Kinës sunge më 1080 dhe 135:100 në Shensi, çka tregon se çmimi i hekurit ishte i ulët. Duhet vënë në dukje gjithashtu se këto provinca nuk përbënin përjashtim, pasi çmimet ishin edhe më të ulëta në Kinën Verilindore. Por statistika befasuese këtu është se më 1700 Britania kishte një raport prej 160:100, që ishte rreth 30% më shumë se çmimi në tregjet e Kinës Verilindore në shekullin e njëmbëdhjetë. Së fundmi, më 977, ky raport në Kinë kishte qenë 632:100, çka

<sup>88</sup> Tsun Ko, "The Development of Metal Technology in Ancient China", te Cheng-Yih Chen (red.), *Science and Technology in Chinese Civilisation* (Singapore: World Scientific, 1987), fq. 229-238.

<sup>89</sup> Robert Hartwell, "Markets, Technology, and the Structure of Enterprise in the Development of the Eleventh Century Chinese Iron and Steel Industries", *Journal of Economic History* 26 (1966), 29-58.

tregon një rënie prej katërfish në çmim brenda njëqind vjetësh. Britanisë do t'i duheshin mbi dyqind vjet, nga 1600-a deri më 1822 për të arritur një rënie të krahasueshme çmimi. Megjithatë Joseph Needham thotë se shifrat e Hartwell-it për prodhimin janë disi maksimale për periudhën (çështje së cilës do t'i kthehem më poshtë). Por edhe në qoftë kështu, do të duhej të ishin shumë të pasakta për ta zhvlerësuar përfundimin se Kina sunge arriti një rritje të jashtëzakonshme, në mos 'revolucionare', për sa i përket prodhimit të hekurit, të tillë që Britania do ta arrinte vetëm pas shtatë shekujsh.

Studiuesit eurocentrikë shpesh e shpërfillin këtë arritje me arsyetimin se përdorimi i hekurit nga kinezët kufizohej vetëm me armët dhe artin dekorativ dhe nuk përfshinte mjetet dhe prodhimin. Por fakti është se hekuri *përdorej* për të bërë sende dhe mjete të përditshmërisë, siç do të ishte e pritshme në një revolucion industrial. Këto përfshinin thika, nagaçe, dalta, turjela shpuese, çekiçë e tokmakë, plorë, lopata, boshte karrocash dore, rrota, patkoj, tenxhere e tava, ibrikë, zile, zinxhirë për ura të varura, porta të blinduara dhe kulla vrojtimi, ura, kallëpe dhe gërma shtypshkrimi. Këto janë vetëm pak nga çfarë ofrohej në atë kohë. Kësaj liste Hartwell i shton sharrat, menteshat, drynat, sobat, llambat, gozhdët, gjilpërat, kunjat, kazanët, pjatat e perkusionit dhe mbërthesat e daulleve. Më përgjithësisht, Donald Wagner arrin në përfundimin se, 'prodhimi në masë i mjeteve prej hekuri të derdhur ishte tejet i rëndësishëm ... dhe mjeshtrat "protoindustrialë" të hekurit arrinin fitime të mëdha', proces të cilin ai e daton deri në shekullin e tretë p.e.s..<sup>90</sup>

Jo më pak mbresëlënëse ishin teknikat e prodhimit që u shpikën. Kinezët prodhonin një larmi llojesh hekuri, si për

<sup>90</sup> Donald Wagner, *Iron and Steel in Ancient China* (Leiden: E. J. Brill, 1993), fq. 407 dhe 69-71.

shembull hekur të derdhur për lopata e plorë (si dhe topa) dhe hekur të rrahur për mjete prerëse (shpata e thika). Kjo është veçanërisht domethënëse pasi europianët kanë përdorur hekur të rrahur gjatë pjesës më të madhe të mesjetës. 'Në fakt duket se bota kineze ... ka arritur drejt e në hekurin e derdhur, pa kaluar, si vendet europiane, nëpër fazën e gjatë të ndërmjetme të farkëtimit të hekurit'.<sup>91</sup> Hekuri i derdhur ishte shumë më superior për sa i përket forcës. Dhe është pikërisht falë faktit që kinezët arritën tek hekuri i derdhur shumë më i lirë që efektet e revolucionit industrial u ndjenë aq gjerësisht në mbarë vendin.

E gjitha kjo u bë e mundur falë arritjeve në shkrirjen e hekurin, ku mbështetej prodhimi i hekurit të derdhur. Në këtë pikë përdorimi i furnaltave dhe i gjyrykëve me piston qe veçanërisht i rëndësishëm (ndonëse, sërish, këto njihe-shin që prej rreth 1400 vjetësh). Gjyrykët krijojnë rrjedhën e vazhdueshme të ajrit që nevojitej për të ruajtur temperaturat e larta (975°C). Këto përdoshin në shekullit e katërt p.e.s. dhe viheshin në punë me forcën e ujit që në vitin 31 e.s. Veç kësaj, kinezët prodhonin çelik (i cili përftohet nga hekuri i derdhur) që në shekullin e dytë p.e.s., ndërkohë që Europa do të arrinte tek çeliku vetëm në epokën moderne. Veçanërisht e rëndësishme këtu ishte se çeliku kinez prodhohej në shekullin e pestë e.s. përmes një procesi 'bashkë-fuzioni' ku hekuri i rrahur dhe ai i derdhur përziheshin bashkë.

Një tjetër risi madhore ishte zëvendësimi i qymyrrurit me koks (duke qenë se druri ishte në sasi të kufizuar). Kjo është tejet domethënëse, pasi eurocentrizmi këmbëngul se kjo u arrit për herë të parë nga britanikët shumë shekuj më vonë. Por Britania ishte si Kina në kuptimin që të dyja nisën

<sup>91</sup> Jacques Gernet, *A History of Chinese Civilisation* (Cambridge: Cambridge University Press, 1999), fq. 69.

të përdornin koxsin për të zgjidhur problemin e shpyllëzimit. Arritje të spikatur në prodhimin e tekstileve janë një tjetër aspekt i mrekullisë sunge, që zakonisht i njihet Britanisë së shekullit të tetëmbëdhjetë. Industria kineze e mëndafshit filloi që në shekullin e katërmëdhjetë p.e.s. Dhe ndoshta risia më e madhe industrialo-teknologjike u arrit në fushën e tekstileve me adoptimin e përhapur të makinës tjerrese me ujë për kërpin dhe mëndafshin (shih kap. 6 dhe 9). Ndonëse të gjitha këto arritje në industrinë e hekur-çelikut dhe të tekstileve ishin mbresëlënëse, nuk ishin veçse maja e një ajsbergu të madh industrial. Sepse një prodhim i tillë presupozon një rrjet të madh mbështetës infrastrukturor.

### *Revolucionet në transport dhe energji*

Ndërsa mullinjtë europianë me ujë për herë të parë u përdorën për të bluar drithë, kurse në prodhimin e hekurit për herë të parë u përdorën në jug të Gjermanisë rreth vitit 1025, në Kinë ndodhi e kundërta. Mullinjtë kinezë u zhvilluan me qëllimin për të vënë në punë gjyrykët e furnalrave që më 31 e.s. Më domethënëse akoma, përdorimi i bjellit të pistonit dhe i rripit të transmisionit në gjyrykët me ujë, shfaqte një ngjashmëri befasuese me motorin me avull (shih kap. 9 për detaje). Veç kësaj, risi madhore ishin edhe kanalet e lundrimit dhe shkallët ujore (këto të fundit të shpikura më 984).<sup>92</sup> Transportimi i qymyrit, hekurit dhe çelikut përgjatë kanaleve, bëri të mundur shpërndarjen e tyre në jug të vendit, çka ishte jetike për mrekullinë industriale kineze, jo më së paku ngaqë nënkuptonte se kërkesa tepër e madhe e brendshme për këto materiale mund të plotësohej. Vlen të vihet në dukje gjithashtu se kinezët arritën të përdornin naftën dhe gazin natyror si karburant dhe për gatim e ndri-

<sup>92</sup> Joseph Needham, Wang Ling dhe Lu Gwei-Djen, *Science and Civilisation in China*, IV (3) (Cambridge: Cambridge University Press, 1971), fq. 300-306, 344-365.

çim, me gjasë që në shekullin e katërt p.e.s.<sup>93</sup> Përdorimin e gjerë të kësaj risie e tregon fakti se llamba të përhershme asbesti për shtëpitë nisën të prodhoheshin diku rreth shekullit të dhjetë.<sup>94</sup>

*Taksimi, letra, shtypshkrimi dhe ngritja e një ekonomie të komercializuar*

Një risi veçanërisht e rëndësishme që krijimi i një sistemi tatimor të bazuar në vlerë monetare. Ndërsa kartmonedha (*fei-çi'en*) u shpik rreth shekullit të nëntë për qëllime kreditimi, në fillimet e shekullit të dhjetë, ajo evoluoi në para 'të vërtetë' prej letre si mjet këmbimi. Në vitin 1161 shteti emetonte dhjetë milionë kartmonedha në vit. Këto zhvillime pionierike do të kopjoheshin më vonë nga europianët, me anglezët që do të arrinin vetëm në vitin 1797.<sup>95</sup> Taksat gjithnjë e më shumë nisën të vilesnin në vlerë monetare dhe jo në mallra. Kësisoj, nga një shifër prej 4% më 749, taksat e vjela në vlerë monetare arritën deri në 52% në mesin e shekullit të njëmbëdhjetë. Kjo ishte veçanërisht e rëndësishme pasi i detyronte fshatarët të përfshiheshin në treg. Shkëmbimi tregtar arriti deri në nivelet më të ulëta të shoqërisë, kështu që edhe më të varfërit ishin të detyruar të prodhonin për tregun. Siç e shpreh McNeill, 'Shkëmbimet e rritura tregtare – në nivel lokal, rajonal e ndërrajonal – bënë të mundur rritje spektakolare në prodhimtarinë e pëgjithshme, ngaqë u vunë në punë të gjitha avantazhet e specializimit që Adam Smith-i më vonë do t'i shtjellonte aq bindshëm.<sup>96</sup> Dhe ai vazhdon, duke cituar një autor të shekullit të katërmëdhjetë, i cili na tregon se:

<sup>93</sup> Peter J. Golas, *Science and Civilisation in China*, V (13) (Cambridge: Cambridge University Press, 1999), fq. 190-197.

<sup>94</sup> Robert Temple, *The Genius of China* (London: Prion Books, 1999), fq. 119-120.

<sup>95</sup> Po aty, fq. 119.

<sup>96</sup> William H. McNeill, *The Pursuit of Power* (Oxford: Blackwell, 1982), fq. 29.

kohët e fundit, kudo që ka një vendbanim prej dhjetë shtëpish, gjithnjë ka një treg ... Në stinën përkatëse, njerëzit këmbëjnë atë që kanë me atë që nuk e kanë, duke i rritur ose ulur çmimet sipas vlerësimit që i bëjnë dëshirës apo indiferencës së të tjerëve për të blerë, në mënyrë që të arrijnë edhe masën më të vogël të fitimit. Sigurisht, në këtë mënyrë funksionon bota zakonisht.<sup>97</sup>

Ndryshe nga përshkrimi eurocentrik i shtetit kinez si despotizëm oriental, Eric Jones na tregon se shteti:

hiqte dorë nga funksioni i tij për ndarjen dhe rindarjen e tokave kundrejt shërbimeve në fuqi punëtore dhe taksave në lloj, duke i vjelë taksat në vlerë monetare. Kjo politikë mosndërrhyrëse e lehtësoi rritjen e tregut privat të tokës ... Shteti as nuk ishte në gjendje t'i ndalonte ndryshimet ekonomike që i konsideronte të padëshiruara shoqërisht dhe, vlen të shënohet, as nuk ia kanalizonte perandorit e ofiqarëve të lartë ajkën e të ardhurave që sillte ndryshimi. As shteti dhe as 'kanakarët politikë' nuk mundeshin t'i taksonin të gjitha fitimet ... Një gjë e tillë do ta kishte shuar nxitjen për rritjen e ofertës që shohim në realitet.<sup>98</sup>

R. Bin Wong ngjashëm vë në dukje se qeveritë kineze, 'mendonin se taksimi i lehtë i lejonte njerëzit të lulëzonin dhe duke qenë se një gjindje e pasuruar konsiderohej shumë e rëndësishme për mbajtjen gjallë të një shteti të fuqishëm, taksat ishin të ulëta'.<sup>99</sup> Barra fiskale e vënë nga qeveritë qendrore ishte tejet e ulët, ndoshta rreth 6% e të adhurave kombëtare.<sup>100</sup> Ndërsa eurocentrizmi e përshkruan ekonominë kineze si një sistem agrar bazuar në nivelin e jete-

<sup>97</sup> Po aty, fq. 30.

<sup>98</sup> Eric L. Jones, *Growth Recurring* (Oxford: Clarendon Press, 1988), fq. 77, 81.

<sup>99</sup> R. Bin Wong, *China Transformed* (Ithaca: Cornell University Press, 1997), fq. 90.

<sup>100</sup> Albert Feuerwerker, "The State and the Economy in Late Imperial China", *Theory and Society* 13 (1984), 300.

sës, fakti është se tregtia në periudhën sunge ishte jo vetëm tejet e zhvilluar, por se shumicën e të ardhurave fiskale shteti i siguronte nga sektori tregtar. Domethënëse gjithashtu është se tregtarët taksoheshin në nivele shumë më të ulëta se prodhuesit ruralë.<sup>101</sup> Ndriçuese në këtë pikë janë edhe rrëfimet e panumërta të misionarëve jezuitë në Kinë; shumë prej tyre konfirmojnë se tregtarët liheshin të qetë nga shteti për të kryer biznesin e tyre.<sup>102</sup>

Dëshmi befasuese për thellësinë e komercializmit nën dinastinë Sung është rritja e qyteteve dhe metropoleve. Joshinobu Shiba vë në dukje se vlerësimi i përmasave të popullsisë urbane është i vështirë për shkak të pabarazisë së të dhënave gjatë periudhës sunge. Vlerësimet për qarkun e Jin-it flasin për një popullsi urbane prej rreth 13%, për qarkun She 7% dhe për Tan-t'u-në deri në 37%. Sidoqoftë, urbanizimi jo vetëm ishte më i theksuar në Kinë se ç'ishte në Europë, por Kina mund të krenohet për disa nga qytetet më të mëdha në botë. Për shembull, popullsia e Hang-çou-së ishte diku mes 1.5 dhe 5 milionë (në varësi të vlerësimeve të ndryshme).<sup>103</sup>

Zhvillimi i një ekonomie monetare lidhet në mënyrë domethënëse me një tjetër risi jetike: shtypshkrimin dhe letërprodhimin (origjina e të cilit trajtohet në kap. 6 dhe 8). Vlen të shënohet se përdorimi i gjerë i kartmonedhës së printuar ishte një nga aspektet e shumta të Kinës që i pati bërë përshtypje Marko Polos. Jo më pak i spikatur është fakti se letra përdorej në shumë mënyra krijuese, si koracë (një produkt i fortë që nuk ndryshkej), letër muri, në artikuj vesh-

<sup>101</sup> Yoshinobu Shiba, "Urbanization and the Development of Markets in the Lower Yangtze Valley", te John W. Haeger (red.), *Crisis and Prosperity in Sung China* (Tucson: University of Arizona Press, 1975), fq. 43.

<sup>102</sup> Donald F. Lach dhe Edwin J. Van Kley, *Asia in the Making of Europe*, III (Chicago: Chicago University Press, 1993), fq. 1606-1607.

<sup>103</sup> Shiba, "Urbanization", fq. 20-23.

mbathjeje, si letër higjenike, balona, shami e shumë të tjera. Industrinë kineze të letrës e nxiste gjithashtu edhe një kërkesë e madhe për libra. Akademia Kombëtare në kryeqytetin Khaifeng dhe më vonë në Hang-çou botonin libra në shkallë të gjerë. Por botimi dhe shitja e librave nuk ishte veprimtari vetëm e shtetit, por edhe e sektorit privat.

### *Revolucioni agrikoror ose 'i gjelbër'*

Në shekullin e gjashtë Kina i kishte zhvilluar thajse të gjitha aspektet të cilat ia njohim revolucionit agrikoror britanik të shekujve të tetëmbëdhjetë e nëntëmbëdhjetë (shih kap. 9 për një trajtim më të plotë).<sup>104</sup> Siç e shpreh Robert Temple:

Nuk është teprim të thuhet se Kina ishte në pozitën e Amerikës ose të Europës Perëndimore sot, kurse Europa ishte në pozitën, le të themi, e Marokut [sot]. Agrikultura primitive dhe e pafuqishme e Europës para shekullit të tetëmbëdhjetë dhe ... agrikultura e përparuar e Kinës pas shekullit të katërt p.e.s., thjesht nuk kanë të krahasuar.<sup>105</sup>

Superioriteti i agrikorurës kineze në periudhën sunge ishte i tillë sa një historian eurocentrik është detyruar të pranojë se 'gjendjen e Kinës në shekullin e dymbëdhjetë Europa në tërësi nuk do ta arrinte dot deri në shekullin e njëzetë'.<sup>106</sup> Bujqit kinezë merrnin prodhim shumë më të lartë se të ngjashmit e tyre europianë.<sup>107</sup> Për më tepër, agrikultura kineze do të mbetej mbresëlënëse edhe përgjatë shtatë shekujve në vijim (shih pjesën vijuese). Jo më pak domethënëse ishte iniciativa e shtetit sung e njohur si 'politika e filizave

<sup>104</sup> Francesca Bray, *Science and Civilisation in China*, VI (2) (Cambridge: Cambridge University Press, 1984), fq. 565.

<sup>105</sup> Temple, *Genius*, fq. 20.

<sup>106</sup> Angus Maddison, *Chinese Economic Performance in the Long Run* (Paris: OECD, 1998), fq. 31.

<sup>107</sup> Bray, *Science*, VI (2), fq. 286-288.

të rinj' (*ching miao fa*). Shteti ofronte stimuj për bujqit për investime në agrikulturë si dhe hua me kamata mjaft të favorshme. 'Ndoshta arritja më e madhe ishte se si popullsia rurale, e vetëdijshme për dobitë e teknologjisë së re, ishte e gatshme rë eksperimentonte e të përmirësonte me iniciativën e vet.'<sup>108</sup>

### *Revolucioni lundrimor*

Është i famshëm pretendimi i Francis Bacon-it në librin *Novum Organum* (1620) se tre shpikjet më të rëndësishme në botë kanë qenë shtypshkrimi, baruti dhe busulla. Të gjitha këto shpikje u bënë në Kinë (shih më poshtë si dhe kap. 6 dhe 8). Për t'u shënuar gjithashtu është fakti se, rreth vitit 1000, kinezët zbuluan se veriu magnetik dhe veriu polar nuk janë e njëjta gjë. Më vonë, në shekullin e pesëmbëdhjetë, kjo dije mundësoi ndërtimin e hartave më të sakta të njohura gjer atëherë.

Ndoshta aspekti më mbresëlënës i revolucionit lundrimor kinez ishte përparimi në ndërtimin e anijeve. Këto ishin të jashtëzakonshme si për përmasat, ashtu dhe për numrin e tyre. Teksa deri në vitin 1588 anijet më të mëdha britanike mund të mbanin vetëm 400 tonë, xhunket shumë më të hershme kineze mund të mbanin mbi 3000 tonë (shih edhe kap. 7). Për më tepër, xhunket e mëdha kishin edhe shumë karakteristika të tjera të përparuara, si kiç katror, fletë fundore timoni, vela bashi e pupe dhe kompartamente të papërshkueshme nga uji, të gjitha të përshtatura shumë më vonë nga europianët (shih kap. 6 dhe 9). Veçanërisht numri i anijeve, të mëdha e të vogla, dëshmon jo vetëm revolucionin lundrimor të Kinës, por edhe natyrën e komercializuar të ekonomisë së saj. Në shekullin tetë, rreth 2000

<sup>108</sup> Po aty, fq. 600.

anije lundronin në Lumin Jangxe, të cilat bartnin një ngarkesë totale të barabartë me rreth një të tretën e ngarkesës që do të bartte flota tregtare britanike njëmijë vjet më vonë. I famshëm është vlerësimi i Marko Polos se duhej të ishin 15.000 anije vetëm në Jangxen e poshtme. Në shekullin e shtatëmbëdhjetë, jezuiti Alvarez Semedo do të numëronte jo më pak se 300 anije që lundronin kundër rrymës në Jangxe vetëm brenda një ore!<sup>109</sup> Së fundmi, Gang Deng tregon se gjatë dinastisë Sung të veriut kishte rreth 12.000 anije që transportonin drithë, të cilat arritën deri në 20.000 gjatë dinastisë Ç'ing, si dhe rreth 130.000 anije private transporti rreth fundit të shekullit të tetëmbëdhjetë.<sup>110</sup> Duket me vend përfundimi i Temple-it se:

Ndoshta mund të thuhet pa frikë se kinezët ishin lundërtarët më të mëdhenj në histori. Për gati dymijë vjet ata kanë patur anije dhe teknika lundrimi aq përpara pjesës tjetër të botës, sa krahasimet do të ishin turpëruese. Kur Perëndimi më në fund e arriti Kinën, kjo vetëm falë adoptimit të shpikjeve të tyre në një mënyrë apo një tjetër. Gjatë pjesës më të madhe të historisë, europianët kanë përdorur anije tejet inferiore ndaj atyre kineze në çdo aspekt që mund të përfytyrohet [deri rreth 1800-ës].<sup>111</sup>

### ***Revolucioni i parë ushtarak: Kina, rr. 850-1290***

Siç do ta shohim në kapitullin 8, eurocentrizmi e ngre lart gjenialitetin ushtarak të europianëve të cilët gjoja udhëhoqën 'revolucionin' e parë të madh 'ushtarak' (1550-1660). Përparimet e mëdha teknologjike u shënuan për sa i përket barutit, mushqetave dhe topave. Por të gjitha këto u shpikën për herë të parë në Kinë gjatë 'revolucionit të parë

<sup>109</sup> Cituar te Lach dhe Kley, *Asia*, fq. 1614.

<sup>110</sup> Gang Deng, *Chinese Maritime Activities and Socioeconomic Development, c. 2100 BC-1900 AD* (London: Greenwood Press, 1997), fq. 68-69.

<sup>111</sup> Temple, *Genius*, fq. 186.

ushtarak' mes viteve 850-1290. Një nga kundërshtimet më të zakonshme eurocentrike ndaj këtij pretendimi është se kinezët e përdornin barutin vetëm në fishekzjarre dhe se kjo lëndë nuk kishte kurrfarë zbatimi ushtarak ('dogma kineze' orientaliste). Interesante është se në filmin epik *The Adventures of Marco Polo* na thuhet se shpikja e parë kineze që iu prezantua Marko Polos ishin spagetit, kurse e dyta baruti shpërthyes. Për të dytën Polo paraqitet të ketë pyetur, 'a vetëm në lodra përdoret kjo?', kurse kinezët i përgjigjen, 'Po, si dhe në fishekzjarre'. Polo atëherë shpreh mendimin se: 'Kjo do mund të ishte një armë e vlefshme në luftë', së cilës kinezët i përgjigjen, 'Jo, do të ishte shumë e tmerrshme, shumë vdekjeprurëse'. Ky dialog e pasqyron bukur një nga mitet më të rëndomta eurocentrike: që megjithëse kinezët e kishin shpikur barutin, do të ishin europianët më krijuar që do ta përdornin atë për qëllime luftarake.

Kinezët e shpikën barutin rreth vitit 850.<sup>112</sup> Në fillim të shekullit të dhjetë baruti përdorej në flakëdhësit kinezë dhe në vitin 969 përdorej për të gjuajtur shigjeta. Në vitin 1231 përdorej në bomba, granada e raketa (të cilat morën formën e një murtaje në një tub hekuri). Kurse në shekullin e katërbëdhjetë përdorej në mina tokësore e ujore.<sup>113</sup> Kinezët madje shpikën raketahedhës që mund të hidhnin 320 raketa njëherësh, çka Needham e përshkruan si një 'ekuivalent mesjetar të bazukës të përdorur aq gjerësisht në Luftën e Dytë Botërore'.<sup>114</sup> Në shekullin e katërbëdhjetë kinezët zhvilluan edhe një raketë me krahë dhe fletë e cila sërish, sipas Needham-it, 'ishte mjaft e ngjashme ... me raketat e

<sup>112</sup> Gernet, *History*, fq. 311; Joseph Needham, Ho Ping Yü, Lu Gwei-Djen dhe Wang Ling, *Science and Civilisation in China*, V (7) (Cambridge: Cambridge University Press, 1986), fq. 111-117.

<sup>113</sup> Needham, dhe të tjerë, *Science*, V (7), fq. 161-210.

<sup>114</sup> Po aty, fq. 486-495.

famshme V-1 të Luftës së Dytë Botërore'.<sup>115</sup> Origjinat e mushqetës mund të gjurmohen tek 'heshta e zjarrtë' e mesit të shekullit të dhjetë. Mushqeta e parë që qëllonte plumba prej hekuri u shpik rreth vitit 1259, kurse një tytë metalike është përdorur jo më vonë se viti 1275.<sup>116</sup> Rreth vitit 1288 qe shpikur një top primitiv i njohur si 'zjarrvjellësi' (duke i paraprirë topit europian me rreth 38 vjet).<sup>117</sup> Gjithashtu ka të dhëna të forta se shpikja kineze në fjalë arriti në Europë (shih kap. 8).

E fundit, por jo më e pakta, një nga aspektet më mbresëlënëse të revolucionit ushtarak kinez ishte flota. Me kohë, numri i anijeve në flotën sunge do të arrinte deri në 20.500.<sup>118</sup> Kjo flotë kineze do ta kishte shpartalluar çdo fuqi europiane më vete dhe me çdo gjasë të gjithë fuqinë detare europiane bashkë. I rëndësishëm është fakti se sistemet e armatimit të anijeve përmirësoheshin vazhdimisht. Në vitin 1129 katapultat hidhnin bomba me barut dhe përbënin armatimin standard, kurse në vitin 1203 disa anije qenë koracuar me pllaka hekuri. Anijendërtimi ushtarak kinez prej kohësh kishte patur një trashëgimi mbresëlënëse. Për shembull, rreth fundit të shekullit të gjashtë, luftanija 'me pesë flamuj' kishte pesë kuverta që arrinin në 100 këmbë lartësi dhe mbanin rreth 800 burra. Ishte e pajisur me 'armë goditëse' ose 'hekura shpues', shtiza hekuri 50 këmbë të gjata me maja të rënda hekuri në skaj, të fiksuara në kuvertat e sipërme. Këto funksiononin si çekiçë gjigandë që godisnin për poshtë për të shkatërruar anijet armike. Kurse që në

<sup>115</sup> Temple, *Genius*, fq. 240; Needham, dhe të tjerë, *Science*, V (7), fq. 495-505.

<sup>116</sup> L. Carrington Goodrich dhe Feng Chia-Sheng, "The Early Development of Firearms in China", te Nathan Sivin, *Science and Technology in East Asia* (New York: Science History Publications, 1977), fq. 128-139; Wang Ling, "On the Invention and Use of Gunpowder and Firearms in China", te Sivin, *Science*, fq. 140-158.

<sup>117</sup> Needham, dhe të tjerë, *Science*, V (7), fq. 264.

<sup>118</sup> Deng, *Chinese Maritime Activities*, fq. 70.

shekullin e tretë kishte ‘fortesa katrore pluskuese’ të lëvizshme, të cilat mbulonin jo më pak se 360.000 këmbë katrorë, kishin kulla të larta dhe mbanin mbi 2000 njerëz.<sup>119</sup> Fjalët e Temple-it sërish shprehin një përfundim me vend: ‘Kinezët ... prodhonin armë në një shkallë që Perëndimi se kish ëndërruar ndonjëherë deri në kohërat moderne.’<sup>120</sup>

### *Një përfundim fillestar mbi Kinën*

Më në fund jemi në një pozitë ku mund ta rivlerësojmë një nga doktrinën qendrore të eurocentrizmit: që vetëm europianët perëndimorë zhvilluan një ‘këndvështrim mekanik’. Tipike janë fjalët e Frederic Lane-it:

Nevoja nuk shpjegon asgjë ... Ndërkohë që artistët e Lindjes së Lartë kënaqeshin duke pikturuar lule, peshq e kuaj, Leonardo da Vinci dhe Francesco di Giorgio Martini ishin të obsesuar me makineritë. Filozofët [europianë] nisën ta shihnin universin si një mekanizëm ore gjigande, trupin njerëzor si makineri dhe Zotin si një ‘orëbërës’ të pashoq.<sup>121</sup>

Por kjo pikëpamje nuk mund të qëndrojë në dritën e shpikjeve të jashtëzakonshme mekanike kineze. Ç’është e vërteta, siç e tregoj në këtë libër, në një pjesë të madhe të periudhës së shqyrtuar, europianët shpikën shumë pak vetë. Të vetmet shpikje autentike të bëra prej tyre para shekullit të tetëmbëdhjetë ishin helika e Arkimedit, kollodoku dhe proceset e distilimit të alkoolit.<sup>122</sup> Dhe ndërsa europianët treguan një aftësi të madhe për sa i përket përvetësimit

<sup>119</sup> Needham, dhe të tjerë, *Science*, IV (3), fq. 689-695.

<sup>120</sup> Temple, *Genius*, fq. 248.

<sup>121</sup> Frederic C. Lane, “The Economic Meaning of the Invention of the Compass”, *American Historical Review* 68 (1963), 151-152.

<sup>122</sup> Irfan Habib, “The Technology and Economy of Mughal India”, *Indian Economic and Social History Review* 17 (1) (1980), 26-28; Joseph Needham, *Science and Civilization in China*, I (Cambridge: Cambridge University Press, 1954), fq. 243.

të shumë shpikjeve teknologjike kineze gjatë shtatë shekujve në vijim, prirja për përvetësim nuk është e njëjta gjë me këndvështrimin 'novator' mekanik. Nëse e ka treguar ndokush një këndvështrim të tillë, këta janë kinezët e jo evropianët.

Përgjigja më e zakonshme eurocentrike është hedhja poshtë e arritjeve ekonomike të dinastisë Sung si një 'revolucion i mbetur në mes', kur zhvillimi ekonomik shpejta në ajsbergun e shtetit despotik oriental dhe u fundos pa lënë gjurmë.<sup>123</sup> Përpos faktit se ky zhvlerësim nuk mund t'i shpjegojë arritjet mbresëlënëse të periudhës sunge, ekonomia kineze nuk bëri prapa dhe nuk u fundos pa lënë gjurmë pas vitit 1279. Gjallëria e saj e madhe i dha mundësinë Kinës të qëndronte në qendër ose shumë pranë qendrës së ekonomisë globale deri në shekullin e nëntëmbëdhjetë.

### Miti i izolacionizmit dhe amullisë ekonomike të Kinës:

#### Kina si e parë ndër të barabartët, 1434-1800

Përgjatë shumicës së mijëvjeçarit të dytë, tregtia kineze ishte aq domethënëse sa autorë të ndryshëm antieurocentrikë e kanë përshkruar ekonominë globale para 1800-ës si 'sinocentrike'.<sup>124</sup> Në fakt, kur Kina ishte vërtet fuqia kryesore në botë, më së miri mund të karakterizohej si *primus inter pares*. Shpërndarja e fuqisë ekonomike në botë nën globali-

<sup>123</sup> Shih, veçanërisht, Perry Anderson, *Lineages of the Absolutist State* (London: Verso, 1979), fq. 541-546; Alan K. Smith, *Creating a World Economy* (Boulder: Westview Press, 1991), fq. 27-29; David S. Landes, *The Wealth and Poverty of Nations* (London: Little, Brown, 1998), fq. 55-59.

<sup>124</sup> Takeshi Hamashita, "The Tribute Trade System and Modern Asia", te A. J. H. Latham dhe Heita Kawakatsu (red.), *Japanese Industrialization and the Asian Economy* (London: Routledge, 1994); Dennis O. Flynn dhe Arturo Giraldez, "China and the Manila Galleons", te Latham dhe Kawakatsu, *Japanese Industrialization*, fq. 71-90; Andre Gunder Frank, *ReOrient* (Berkeley: University of California Press, 1998), fq. 111-117.

zimin lindor ishte 'policentrike', ku Kina, India, Lindja e Mesme dhe Afrika Veriore, Azia Juglindore e Japonia ishin të gjithë lojtarë të rëndësishëm.

Megjithatë, shumica e studiuesve e hedhin poshtë suksesin e Kinës pas shekullit të pesëmbëdhjetë sipas dy argumentesh kryesore brenda 'dogmës kineze'. Së pari, siç e vumë në dukje më lart, edhe nëse pranohet se ka patur rritje domethënëse gjatë periudhës sunge, kjo shpërfillet si një 'revolucion i mbetur përgjysmë', me rritjen që do të merrte fund pak kohë më vonë. Së dyti, shpallja e një ndalese perandorake ndaj tregtisë së jashtme në vitin 1434 gjatë periudhës minge do të siguronte që çdo dritare mundësie për Kinën që ta ribëntë botën të mbyllej me forcë. Dhe kjo sepse ekonomia kineze ishte në rënie, çka i detyroi autoritetet të tërhiqeshin nga tregtia e jashtme. Tregtia ndërkombëtare kineze, pretendojnë ata, u zëvendësua me sistemin regresiv kinez të haraçit, i cili ishte krejtësisht i shkëputur nga ekonomia globale. Mbi këto dy argumente eurocentrizmi e hedh poshtë mundësinë që Kina të ketë qenë në qendër të tregtisë botërore pas vitit 1280 e sidomos pas 1434-ës. Përkundrazi, siç na thuhet, Kina u zhyt në izolacionizëm.

Kjo e ashtuquajtur tërheqje shpie në dy nga pretendimet më të rëndësishme në lidhje me historinë botërore eurocentrike. Së pari, ajo pati pasoja shumë të mëdha për aq sa, siç pretendohet, krijoi një vakum pushteti në Lindje, i cili u mbush ethshëm nga europianët superiorë pas 1500-ës. Me fjalët e David Landes-it:

Braktisja e programit të udhëtimeve të mëdha [nën Çeng Ho-në] ishte pjesë e një politike më të gjerë mbylljeje dhe tërheqjeje nga rreziqet e tundimet e detit. Kjo vetëmbyllje e qëllimshme, një kthesë madhore në historinë kineze, nuk mund të kish ndodhur në një kohë më të keqe, sepse ajo jo vetëm e çarmatosi Kinën përballë fuqisë në

rritje europiane, por i vendosi ata, të vetëkënaqur e këfëfortë, përkundër mësimëve dhe risive që udhëtarët europianë do të sillnin së shpejti.<sup>125</sup>

Së dyti, ndalesa nënkuptonte që Kina u shkëput nga kryerryma e tregtisë ndërkombëtare (e cila supozohet se filloi pas 1500-ës), kështu që ekonomia e saj u tha paskëtaj. Për ta cituar sërish Landes-in: 'Izolacionizmi u bë Kina. E rrumbullakosur, e plotë, e paqtë, e harmonishme sa s'thuhet, Perandoria Qiellore dremiti për disa qindra vjet akoma, mospërfillëse dhe e patrazuar. Por bota po e parakalonte.'<sup>126</sup> Kësisoj, tërheqja gjoja shpjegon kërcimin e madh mbrapsht të Kinës që njëkohësisht bëri të mundur kërcimin e madh përpara të Europës pas 1500-ës. Atëherë është e qartë se shumëçka varet nga kjo çështje. Ndryshe nga përshkrimi standard eurocentrik, unë ofroj katër kundërparashtrime të cilat diskutohet në vijim.

### *Miti i tërheqjes kineze:*

#### *vazhdimi i tregtisë ndërkombëtare të Kinës pas 1434-ës*

Peizazhi konvencional i një tërheqjeje është i gabuar pikësëpari sepse historianët perëndimorë e marrin shumë literalisht si ndalesën zyrtare, ashtu dhe sistemin kinez të haraçit. Leximi literal i ndalesës zyrtare deri diku buron nga problemi i keqinterpretimit. Dokumentet zyrtare i shtrembëron përpjekja e shtetit kinez për t'u dukur se po ruan njëfarë ideali konfucian (domethënë, izolacionist). Veç kësaj, tërheqjen gabimisht mendohet se e konfirmon prania e një sistemi regresiv perandorak haraçi, që mendohet se bazohej në detyrim me dhunë dhe forma shtetëroro-administrative haraçi më shumë sesa në tregti. Por leximet kon-

<sup>125</sup> Landes, *Wealth*, fq. 96.

<sup>126</sup> Po aty, fq. 98.

vencionale e keqkuptojnë si sistemin e haraçit ashtu dhe natyrën e ndalesës.

Përgjigja e parë këtu është se sistemi i haraçit ishte gjithashtu një sistem tregtie. Siç e vë në dukje Rodzinski, sistemi i haraçit

shpesh ishte, në praktikë, veçse një formë në dukje për një tregti tejte të konsiderueshme të jashtme. Në shumë raste tregtarët e huaj, sidomos ata nga Azia Qendrore, vetëprezantoheshin si prurës haraçesh imagjinare nga shtete imagjinare, vetëm e vetëm për të bërë tregti.<sup>127</sup>

Për më tepër, marrëdhëniet tregtare në Lindje dhe në Azinë Juglindore u zgjeruan bashkë me zgjerimin e marrëdhënieve kineze të haraçit.<sup>128</sup> Kjo herëpashere pohohet edhe në dokumentet zyrtare kineze. Një sërë argumentesh mund të shtohen.<sup>129</sup> Sistemi i haraçit ishte më shumë vullnetar sesa i imponuar. Kjo sepse aksesi në tregjet kineze duke paguar shuma formale haraçi ishte një mënyrë nëpërmjet së cilës të ashtuquajturit vasalë mund të pasuroheshin. Si mund ta shpjegojmë ndryshe faktin se portugezët, spanjollët e holandezët vazhdimisht kërkonin të përfshiheshin në sistem si vasalë? Madje shtetet vasale shpesh garonin me njëri-tjetrin për të paguar haraç, sërish për të patur akses në ekonominë fitimprurëse kineze. Një radhë e tërë sundimtarësh, si sulltani i Melakës, sundimtarët e Bruneit, mbretërit Chola të Koromandelit dhe princërit e Malabarit ishin të ethshëm për të dërguar haraç në mënyrë që të fitonin mbrojtjen kineze kundër disa prej armiqve të tyre fqinj. Siç e vë në dukje Anthony Reid, disa 'shtete' si Java, Siami e Melaka ishin aq këmbëngulëse në misionet e tyre haraçpaguese sa arritën t'i

<sup>127</sup> Witold Rodzinski, *A History of China* (Oxford: Pergamon Press, 1979), fq. 197.

<sup>128</sup> Hamashita, "Tribute", fq. 92.

<sup>129</sup> Shih, veçanërisht, Gang Deng, "The Foreign Staple Trade of China in the Pre-Modern Era", *International History Review* 19 (2) (1997), fq. 256.

irritonin autoritetet kineze.<sup>130</sup> Aspektin vullnetar të sistemit e dëshmon fakti se kur vasalët privoheshin nga statusi i tyre si haraçpagues, kjo shpesh shkaktonte reagime të ashpra nga të ashtuquajturit vasalë. Për shembull, në fund të shekullit të gjashtëmbëdhjetë, Japonia pushtoi Korenë (një shtet vasal i Kinës minge) për ta detyruar Kinën ta vazhdonte marrëdhënien e haraçit, madje duke kërcënuar se do ta pushtonte vetë Kinën nëse kjo e fundit refuzonte! Një tjetër strategji e përdorur shpesh nga tregtarët aziatikë ishte paraqitja e kredencialeve të rreme, duke u shtirur si të dërguar që paguanin haraç 'si një gjethe fiku për tregtinë e zakonshme'.<sup>131</sup> Sërish, kjo gjë dihej mirë dhe herë herë pranohej në dokumentet minge.

Tre janë arsyet kryesore pse ndalesa ishte një mit. Së pari, siç u vu në dukje tashmë, sistemi i haraçit ishte pjesërisht një sistem tregtar i maskuar. Së dyti, shumë tregtarë privatë kinezë zhvillonin tregti duke e anashkaluar ndalesën zyrtare në disa mënyra. Ironikisht, paraqitja eurocentrike e sistemit portugez të *cartaz*-it si tregues i dominimit europian, e lë në harresë faktin se për kinezët veçanërisht, zotërimi i një *cartaz*-i nënkuptonte se mund të shtreshin si portugezë për ta anashkaluar ndalesën minge. Veç kësaj, një pjesë e madhe e tregtisë kineze ishte e përzier me japonezët (por në të vërtetë ishte pirateri kineze) dhe ishte tejet e lulëzuar. Por ndoshta metoda më e zakonshme për ta anashkaluar ndalesën qëndronte në praktikën tregtare kantoneze. Siç shpjegon Philip Curtin:

Të gjitha ngarkesat që e tejkalonin haraçin zyrtar shkar-  
koheshin bashkë me të, etiketoheshin si 'balast në anije  
haraçpaguese' dhe mbaheshin derisa të vinte leja nga

<sup>130</sup> Anthony Reid, *Southeast Asia in the Age of Commerce 1450-1680*, I (New Haven: Yale University Press, 1993), fq. 15.

<sup>131</sup> Frank, *ReOrient*, fq. 114.

Pekini për shitjen e tyre ... Nëse anijes së huaj i duhej të largohej, duhej të ngarkonte balast për të garantuar një kalim të sigurt, kështu që merrte mallra kineze si balast në udhëtimin e kthimit. Në këtë mënyrë 'balasti' [domethënë mallrat e tregtisë] që anijet bartnin në të dyja drejtimet ishte më i rëndësishëm se haraçi që shërbente si justifikim.<sup>132</sup>

Sundimtari i mbretërisë ishullore të Rjukjut ishte veçanërisht krijues, duke i inkurajuar tregtarët privatë kinezë nga Fuxhiani të nguliteshin aty, prej ku mund të angazhoheshin në tregti fitimprurëse me Kinën. Gjithë ç' duhej të bënte kundrejt kësaj ishte të dërgonte misione të herëpashershme haraçpaguese në Kinë. Kjo ishte pjesë e një strategjie më të përgjithshme që ndiqnin tregtarët privatë kinezë të cilët barteshin në pjesë të tjera të rajonit për të eksportuar prodhime në Kinë. Në gjysmën e parë të shekullit të gjashtëmbëdhjetë, tregtarët kinezë u shpërndanë në çdo pjesë të Detit komercialo-strategjik të Kinës Jugore, në Indokinë, Malajzi, Siam dhe në të gjithë harkun e ishujve nga Sumatra në Timor e në Filipine. Ata do ta dominonin këtë rrjet tregtar deri në shekullin e nëntëmbëdhjetë. Veç kësaj ata udhëtonin drejt lindjes e perëndimit dhe ishin të lidhur me Fுகienin në Kinë.<sup>133</sup> Dhe e fundit, por jo më e pakta, ekzistonte edhe një tregti e lulëzuar kontrabandë. Ngaqë ofiqarët e shtetit shpesh bashkëpunonin me kontrabandistët, ndalesa afërmendsh bëhej e pazbatueshme. Në fakt aq e madhe ishte tregtia kontrabandë, sa në vitet 1560 shteti ming më në fund u dorëzua dhe e ligjëroi portin kryesor të kontrabandistëve (Port Moon-in).

<sup>132</sup> Philip D. Curtin, *Cross-Cultural Trade in World History* (Cambridge: Cambridge University Press, 1984), fq. 169.

<sup>133</sup> Peter W. Klein, "The China Sea and the World Economy between the Sixteenth and Nineteenth Centuries: the Changing Structures of Trade", te Carl-Ludwig Holtfrerich (red.), *Interactions in the World Economy* (New York: New York University Press, 1989), fq. 71, 73-86.

Arsyeja e tretë pse ndalesa ishte një mit, është se jo e gjithë tregtia private u ndalua. Një pjesë e madhe e saj u sanksionua në tri porte kyçe: në Makao, në Çang-çu në provincën e Fukianit dhe Su-çu në provincën perëndimore të Shensit. Më vonë, gjatë periudhës së dinastisë Çi'ng, tregtia zhvillohej përmes Amojit, Ningbos dhe Shangait. Siç shpjegojnë Lach dhe Kley:

Vëzhguesit më të hershëm perëndimorë, si Mendoza, patën kujtuar se tregtarët fukienezë tregtonin ilegalisht me jashtë me bashkëpunimin e heshtur të ofiqarëve lokalë. Por autorët e shekullit të shtatëmbëdhjetë – Matlieff ishte një ndër të parët syresh – shpejt e kuptuan se tregtarët nga Çang-çu kishin leje zyrtare për të tregtuar përtej kufijve të perandorisë.<sup>134</sup>

Autorë të ndryshëm kanë vënë në dukje rëndësinë e lidhjes tregtare mes Kinës dhe Azisë Juglindore.<sup>135</sup> Veçanërisht Manila ishte një pikë tejet e rëndësishme grumbullimi për të gjithë sistemin tregtar botëror sepse prej atje Kina përfntonte një pjesë të madhe të argjendit (përmes galeonit spanjoll të Manilës). Vetëm mes viteve 1570 dhe 1642, mesatarisht njëzet e pesë anije kineze dërgoheshin çdo vit në Manila.<sup>136</sup> Kjo lidhje mbeti e rëndësishme jo vetëm gjatë një pjese të gjatë të periudhës së 'ndalimit', por u intensifikua rreth fundit të shekullit të tetëmbëdhjetë.<sup>137</sup> Por fakti vendimtar është se shumica e argjendit botëror përthitjej nga Kina, çka konfirmon se ekonomia kineze ishte jo vetëm e integruar plotësisht në ekonominë globale, por ishte e shën-

<sup>134</sup> Lach dhe Kley, *Asia*, fq. 1618.

<sup>135</sup> Për shembull, Jakob C. Van Leur, *Indonesian Trade and Society* (The Hague: W. van Hoeve, 1955).

<sup>136</sup> Deng, *Chinese Maritime Activities*, fq. 108.

<sup>137</sup> P. J. Marshal, "Private British Trade in the Indian Ocean Before 1800", te Ashin Das Gupta dhe M. N. Pearson (red.), *India and the Indian Ocean 1500-1800* (Calcutta: Oxford University Press, 1987), fq. 297.

doshë aq sa për të bërë të mundur një suficit të madh tregtar. Prandaj kjo pikë vlen të trajtohet më tej.

Katër janë arsyt kryesore pse argjendi i botës prirej në drejtim në Kinës. Së pari, në mesin e shekullit të pesëmbëdhjetë, ekonomia kaloi në monedhat e argjendit. Së dyti, fuqia e ekonomisë kineze krijonte një kërkesë të fuqishme për argjend. Së treti, eksportet kineze i tejkalonin shumë importet. Dhe, së katërti, çmimi i argjendit në raport me arin në Kinë ishte më i larti në botë (raporti ar/argjend në Kinë ishte 1:6, krahasuar me 1:14 në Europë).<sup>138</sup> Këtë gjë e ka pranuar edhe Adam Smith: 'Në Kinë, që është një vend shumë më i pasur se çdo pjesë e Europës, vlera e metaleve të çmuara është shumë më e lartë se në çdo pjesë të Europës'.<sup>139</sup> Ekonomia kineze ishte epiqendër për aq sa përbënte një vorbull ku përfundonte shumica e argjendit të botës. Në vitet 1640, në thesarin kinez depozitoheshin rreth 750.000 kilogramë argjend në vit. Niveli i pasurisë në Kinë mund të përfytyrohet nga fakti se 'edhe një tregtar "i varfër" rrobash në Shangai kishte një kapital prej rreth pesë tonë argjend, kurse familjet më të pasura kishin [si kapital] qindra tonë argjend'.<sup>140</sup>

Megjithatë, termi 'vorbull' krijon përfytyrimin e gabuar se argjendi i botës përfundonte në Kinë për të mos u rishfaqur më që andej. Fakti që çmimi i argjendit kinez në raport me arin ishte shumë i lartë ndërsa gjetkë ishte shumë më i ulët, i dha shkas rritjes së një sistemi global këmbimi.<sup>141</sup> Siç shpjegojnë Flynn dhe Giraldez:

<sup>138</sup> Han-sheng Chuan, "The Inflow of American silver into China from the late Ming to the mid-Ch'ing Period", *Journal of the Institute of Chinese Studies of the China University of Hong Kong* 2 (1969), 61-75.

<sup>139</sup> Adam Smith, *The Wealth of Nations* (New York: The Modern Library, 1965), fq. 238.

<sup>140</sup> Clive Ponting, *World History* (London: Chatto dhe Windus, 2000), fq. 520.

<sup>141</sup> Richard Von Glahn, *Fountain of Fortune* (Berkeley: University of California Press, 1996); Frank, *ReOrient*, kapitulli i tretë.

raportet e ndryshme midis dy metaleve nënkuptojnë që, teorikisht, me një ons ar mund të bliheshin njëmbëdhjetë onsë argjend në Amsterdam dhe ky argjend të çohet në Kinë e të këmbehej me rreth dy onsë ar. Dy onsët e arit mund të silleshin sërish në Europë për t'u këmbyer me njëzet e katër onsë argjend që mund të çoheshin sërish në Kinë e t'u dyfishohej vlera edhe njëherë, e kështu me radhë.<sup>142</sup>

Ky sistem global këmbimi valutor shkaktonte zhvendosjen e vazhdueshme të argjendit në Kinë, ku këmbehej me ar. Ari pastaj eksportohej jashtë, kryesisht në Europë ku këmbehej me argjend që më pas çohet sërish në Kinë për t'u këmbyer me ar të ri. Këtë unë e quaj 'qarkullim global të argjendit': 'global' sepse kishte formën e një rrethi të vazhdueshëm që shkonte nga Amerikat, përmes Eurazisë e në Kinë dhe kthehej sërish drejt perëndimit në Europë. Prandaj termi 'vorbull' është problematik. Dhe është e qartë se kinezët nuk ishin grumbullues (siç e shpjegoj në kap. 4). Interesant është fakti se edhe pas 1640-ave kur fitimet nga këmbimi valutor u shua, argjendi akoma rridhte drejt Kinës për shkak të një kërkese të fortë që vazhdonte për prodhimet e argjendit. Kjo njëkohësisht e hedh poshtë 'dogmën kineze' eurocentrike, gjegjësisht që pas periudhës sunge ekonomia kineze 'thjesht ndaloi'. Për më tepër, siç arsyetojnë Flynn dhe Giraldez, fakti është se konvertimi i ekonomisë kineze në argjend në mesin e shekullit të pesëmbëdhjetë, pati rrjedhoja shumë të rëndësishme për fatin e Europës. Sepse, siç e vë në dukje me të drejtë Pomeranz, 'nëse Kina ... nuk do të kishte patur një ekonomi kaq dinamike [të bazuar në monedhat e argjendit, çka i jepte mundësinë] ... t'i përthithte sasitë e jashtëzakonshme të argjendit që u nxorr në Botën e

<sup>142</sup> Flynn dhe Giraldez, "China", fq. 75.

Re përgjatë tre shekujsh, minierat në fjalë brenda disa dekadash nuk do të kishin sjellë më fitime'.<sup>143</sup>

Për ta përmbledhur, është e qartë se në një mënyrë apo një tjetër, tregtarët kinezë e vazhduan tregtinë e tyre tejet fitimprurëse me ose pa sanksionim zyrtar. Shumë studiues eurocentrikë tepër lehtë kanë rënë pre e retorikës zyrtare kineze. Siç përfundon me të drjetë Jacques Gernet: 'Mes dispozitave zyrtare dhe situatës reale për sa i përket tregtisë, kishte një hendek të madh; kufizimet [zyrtare] ndaj tregtisë mund të na bëjnë të mendojmë se Kina ishte e izoluar pikërisht atëherë kur tregtia detare ishte më e dendur se kurrë'.<sup>144</sup> Por nëse autoritetet kineze me siguri e mbyllnin njërin sy ndaj këtij sistemi ilegal privat tregtar, kjo menjëherë bën të lindë pyetja: pse këmbëngulnin të pretendonin zyrtarisht se ndalesa zbatohet? Për t'i dhënë përgjigje kësaj pyetjeje, na duhet të ballafaqohemi me një tjetër keqperceptim të zakonshëm eurocentrik.

***Miti i 'ndalesës' kineze ndaj tregtisë ndërkombëtare:  
politikat e identitetit kinez***

Duke iu kthyer kundërparashtrimin tim të dytë madhor, historia eurocentrike thekson se ndalesa zyrtare ndaj tregtisë së jashtme qe një rezultat i pashmangshëm i rënies ekonomike të Kinës. Ngjashëm, nëse Kina kishte ndonjë pretendim imperial në atë kohë, rënia e saj ekonomike e bëri të tërhiqej e të vetëizolohej. Por duke patur parasysh të dhënat që dëshmojnë për vazhdimin e tregtisë kineze, siç renditen më sipër, është e qartë se ndalesa ishte thjesht një mit. Këtu unë pretendoj se miti i ndalesës vazhdohej për të riprodhuar legjitimitetin e shtetit kinez (çka lidhet me identitetin ki-

<sup>143</sup> Kenneth Pomeranz, *The Great Divergence* (Princeton: Princeton University Press, 2000), fq. 273.

<sup>144</sup> Gernet, *History*, fq. 420.

nez). Sepse fakti është se sistemi i haraçit ishte shumë më tepër se thjesht një sistem i maskuar tregtar. Miti i ndalesës u vazhdua si zgjedhje politike, e jo për shkak të shtrëngesës ekonomike.

Nën perandorin ming Hung-hsi, Kina iu kthye vlerave të saj tradicionale konfuciane, të cilat theksonin vetëizolim nga pjesa tjetër e botës. Dinastia e hershme minge e pati drejtuar vështrimin jashtë (çka e dëshmonë ekspeditat e Çeng Ho-së), edhe pse nuk kishte interes të inicioje një politikë imperiale. Por kur pushtetin e mori perandori Hung-hsi (më 1424), ai mori përsipër të rivendoste praktikat konfuciane në zemër të shtetit kinez. Më 1434 dinastia minge zyrtarisht e shpalli të vdekur tregtinë ndërkombëtare të Kinës. Por nëse një tregti e konsiderueshme vazhdoi, pse nevojitet shtirja si një mbretëri e izoluar ku marrëdhëniet me botën e jashtme mbështeteshin vetëm në një sistem imagjinar vasaliteti haraçpagues? Sistemi i haraçit kishte qenë një mënyrë jetike për shtetin kinez për të ruajtur legjitimitetin e brendshëm. Ç'është më e rëndësishme, ky sistem përfshinte edhe kryerjen e temenave nga ambasadorët dhe të dërguarit e shteteve vasale, çka përbënte një simbol kyç të mandatit qiellor të perandorit. Kësisoj ishte thelbësore që të vazhdohej sistemi i haraçit, qoftë edhe vetëm për të ruajtur legjitimitetin e brendshëm të shtetit.<sup>145</sup> Kështu që domethënia politike e sistemit të haraçit qëndronte në faktin se perandori ishte i detyruar t'i demonstronte popullatës së tij se gëzonte besnikërinë e botës 'barbare' (prandaj dhe ishte sistem haraçpagues), ndonëse në praktikë gjithashtu nënkuptonte edhe tregti fitimprurëse për tregtarët kinezë dhe vasalët.

<sup>145</sup> Yongjin Zhang, "System, Empire and State in Chinese International Relations", te Michael Cox, Ken Booth dhe Tim Dunne (red.), *Empires, Systems and States* (Cambridge: Cambridge University Press, 2001), fq. 43-63.

Kjo lojë perandorake për prodhim legjitimiteti dhe mashtrim tregtar është përshkruar saktë nga Joseph Fletcher, përshkrim që vlen të citohet:

Autoritetet kineze ishin të lumtura të mashtroheshin. Prestigji i perandorit [domethënë, legjitimiteti] nuk rritej nëse ministrat e tij e nxirrnin në shesh natyrën e vërtetë të ‘vasalëve’ dhe oborri e kishte më të sigurt t’i çukiste mallrat nëse tregtarët ... i sillnin ato me vete në kryeqytet. Si rrjedhojë, misione të rreme me kredenciale të rreme hynin e dilnin rregullisht në oborrin kinez. Si tregtarët ashtu dhe ministrat ishin palë në atë që mund të quhej një sekret i hapur ... Sipas [misionarit jezuit bashkëkohës] Ricci-t, ‘vetë kinezët (të cilët kurrsesi nuk janë të pavetëdijshëm për mashtrimin) e mashtrojnë mbretin e tyre, duke iu lëpirë me devotshmëri, thua se vërtet e gjithë bota i paguante taksa mbretërisë kineze, ndërkohë që përkundrazi, Kina është ajo që më realisht u paguan haraç këtyre mbretërive’. Dhe nëse Ricci gabohej diku, kjo vetëm në besimin se vetë perandori nuk ishte pjesë e lojës gjithashtu.<sup>146</sup>

Vërtet ishte një lojë mashtrimi që të ashtuquajturat shtete vasale ishin veçse të lumtura ta luanin sepse, siç e vë saktë në dukje Bin Wong, ‘shtetet e huaja zakonisht i lejonin kinezët ta ushqenin këtë ide [të superioritetit kinez] pa e pranuar vetë medoemos’.<sup>147</sup> Sepse ishte në përputhje me interesat e tyre tregtare që të bëheshin pjesë e lojës.

Është e qartë, pra, se nuk ishte rënia ekonomike, por nevoja për të ruajtur legjitimitetin – çka lidhet me identitetin kinez – ajo që i shtynte autoritetet të pretendonin se ndalesa zbatohej. Megjithatë, paradoksalisht, kinezët qenë

<sup>146</sup> Joseph Fletcher, “China and Central Asia, 1368-1884”, te John K. Fairbank (red.), *The Chinese World Order* (Cambridge, Mass.: Harvard University Press, 1968), fq. 208-209.

<sup>147</sup> Bin Wong, *China Transformed*, fq. 89.

tërhequr vërtet në një kuptim. Ata nuk u tërhoqën nga ekonomia globale, por 'abstenuan' nga politikat imperiale të cilat shpejt do t'i mbërthenin shtetet iberike. Siç e vë në dukje Louise Levathes,

Gjatë [fillimit të shekullit të pesëmbëdhjetë] ... Kina e zgjeroi sferën e saj ... të ndikimit në mbarë Oqeanin Indian. Gjysma e botës ishte nën dominimin e Kinës dhe me një flotë të tillë edhe gjysma tjetër ishte lehtësisht e arritshme, nëse Kina do ta kish dëshiruar një gjë të tillë. Kina do mund të ishte bërë fuqia e madhe koloniale njëqind vjet para epokës së madhe të eksplorimit dhe ekspansionit evropian. Por Kina nuk e bëri këtë.<sup>148</sup>

Fakti është se kinezët do mund të kishin ndërmarrë një mision imperial në një pjesë të madhe të botës, po të kishin dashur. Por pse nuk e bënë? Duhet të jetë e qartë tashmë se kjo nuk qe rezultat i një kapaciteti të pamjaftueshëm material, por ndodhi kështu sepse ata *zgjodhën* të mos merrnin drejtimin imperialist, në masë të madhe për shkak të identitetit të tyre të veçantë. Siç e ka vënë në dukje ngjashëm Felipe Fernandez-Armesto:

'Fati i qartë' i Kinës nuk u realizua kurrë, dhe dominimi botëror, që për një kohë u duk se mjaftonte të zgjasnin dorën për ta kapur, u braktis ... Tërheqja [e Kinës] mbetet një nga shembujt më të spikatur të vetëpërmbytjes kolektive në histori.<sup>149</sup>

Si përfundim, i vetmi problem për sa i përket kësaj ndalesë është se studiuesit eurocentrikë janë joshur shumë lehtë të besojnë se zbatohej dhe në të njëjtën kohë e kanë keqkuptuar funksionin e saj shoqëror. Ky keqkuptim nga ana e tij i

<sup>148</sup> Louise E. Levathes, *When China Ruled the Seas* (London: Simon and Schuster, 1994), fq. 20.

<sup>149</sup> Felipe Fernandez-Armesto, *Millennium* (London: Black Swan, 1996), fq. 129, 134.

ka dhënë shkas njëres prej ideve më të mëdha të gabuara të historisë botërore eurocentrike: se që tërheqja e kinezëve nga ekonomia globale ajo që krijoi vakumin që do të mbushesh nga europianët superiorë pas 1500-ës. Në fakt, nuk kishte kurrfarë vakumi (shih edhe kap. 7).

*Miti i rënies së ekonomisë kineze:*

*Kina e shkëlqyer, 1100-1800/1840*

Pas 1100-ës, fuqia intensive e Kinës ishte e para në botë. Në qoftë kështu, si ta marrim shpërfilljen eurocentrike se revolucionin industrial i dinastisë Sung ishte në fakt një 'revolucion i mbetur përgjysmë'? Studiuesit eurocentrik janë të mendimit se ekonomia pas dinastisë Sung u tha si pasojë e rivendosjes së despotizmit oriental që u detyrua ta ndalonte tregtinë për shkak të dobësisë ekonomike dhe rënies së prodhimit. Ironikisht, kjo pikëpamje shpesh ndikohet nga të dhënat e Robert Hartwell-it për hekurin dhe çelikun, të cilat japin idenë se prodhimi u tkurr me shpejtësi pas vitit 1279. Ose siç e ka shprehur tipikisht Fernand Braudel këtë pretendim standard eurocentrik:

Ajo që është kaq e jashtëzakonshme është se pas këtij fillimi të pabesueshëm, metalurgjia kineze nuk u zhvillua më tej pas shekullit të trembëdhjetë. Fonderitë dhe farkëtaritë kineze nuk bënë më zbulime të reja, por vetëm përsëritën proceset e vjetra. Shkrija me koks – nëse njihet, gjithsesi – nuk u zhvillua. Kjo është e vështirë të konstatohet, e jo më të shpjegohet.<sup>150</sup>

Problemi i parë me mohimin eurocentrik është se tregtia ndërkombëtare kineze mbeti e gjallë (siç u shpjegua), e

<sup>150</sup> Fernand Braudel, *Civilization and Capitalism, 15th-18th Century*, I (London: Collins, 1981), fq. 377.

po ashtu edhe tregtia e brendshme.<sup>151</sup> Problemi i dytë me pretendimin eurocentrik qëndron në atë që vlerësimet e Hartwell-it janë problematike më pak ngaqë i ekzagjerojnë disi arritjet e periudhës sunge, por kryesisht ngaqë i nënvlerësojnë nivelet e *mëvonshme* të prodhimit të hekurit dhe çelikut. Kenneth Pomeranz sugjeron se ndryshe nga ç'mendohej më parë, prodhimi i hekurit u rigjallërua pas 1420-ës.<sup>152</sup> Fang Xing vlerëson se në fillimet e shekullit të njëzetë prodhoheshin rreth 170.000 tonë 'hekur vendi' (krahasuar me 125.000 tonë më 1078).<sup>153</sup> Për më tepër, Peter Golas arrin në përfundimin se prodhimi i hekurit me gjasë arriti kulmin në shekullin e tetëmbëdhjetë.<sup>154</sup> Ai gjithashtu vë në dukje se në shekullin e nëntëmbëdhjetë Kina kishte nivele shumë të larta të prodhimit të qymyrit, një pjesë e të cilit ruhej në depozita po aq të mëdha sa ato që ishin kudo në Europë, dhe se qymyri përdorej në çdo fushë të ekonomisë. Për më tepër, ka të dhëna të forta se prodhimi i hekurit në Guangdong bëhej sipas një modeli kapitalist formal.<sup>155</sup> Kështu që mrekullia industriale sunge nuk ishte një rast i izoluar në historinë kineze. Ekonomia mbeti jo vetëm e gjallë, por e tillë që do të kishte rrjedhoja madhore për perspektivën zhvillimore të shumë rajoneve të botës, mbi të gjitha të Europës (shih kap. 6-9). Atëherë çfarë të dhënash të mëtejshme e shpalosin nivelin domethënës të fuqisë intensive të Kinës pas 1280-ës?

<sup>151</sup> Wang Shixin, "Commodity Circulation and Merchant Capital", te Xu Dixin dhe Wu Chengming (red.), *Chinese Capitalism, 1522-1840* (London: Macmillan, 2000), fq. 46-64.

<sup>152</sup> Pomeranz, *Great Divergence*, fq. 62-63.

<sup>153</sup> Fang Xing, "The Role of Embryonic Capitalism in China", te Dixin dhe Chengming, *Chinese Capitalism*, fq. 418.

<sup>154</sup> Golas, *Science*, V (13), fq. 169-170.

<sup>155</sup> Wang Shixin, "The Iron Industry of Foshan, Guangdong", te Dixin dhe Chengming (red.), *Chinese Capitalism*, fq. 93-110.

Një tregues i fuqisë së madhe intensive të Kinës ka të bëjë me bazën e saj prodhuese agrikulurore. Në shekullin e gjashtëmbëdhjetë, ekonomia e kishte marrë veten nga Vdekja e Zezë. Prodhimet agrikulurore jo vetëm u rritën me 60% mes fundit të shekullit të katërmëdhjetë dhe 1600-ës, por i tejkalonin shifrat e arritura kudo në Europë. Për më tepër, një pjesë e madhe e prodhimit të tepërt eksportohet. Kjo nuk ishte një ekonomi e prapambetur e bazuar në nivelin jetik, por ishte tejet e komercializuar dhe mbështetej në tregtinë ndërkombëtare.<sup>156</sup> Një sërë autorësh kanë ofruar një pamje mbresëlënëse të zhvillimit agrikulor të Kinës në shekullin e tetëmbëdhjetë.<sup>157</sup> Gernet madje e quan atë një 'periudhë lulëzimi', dhe arrin në përfundimin se agrikultura kineze ishte ende shumë përpara Europës.<sup>158</sup> Vlen të shënohet gjithashtu se në periudhën 1700-1850, shpejtësia e rritjes së popullsisë u rrit me ritme fenomenale që do të mund të krahasoheshin vetëm me Britaninë pas periudhës së saj të industrializimit. Kjo nënkuptonte një rritje shumë të madhe të prodhimit agrikulor dhe të prodhimit të drithit për frymë, çka me siguri presupozon një potencial të jashtëzakonshëm teknik.<sup>159</sup> Jones pajtohet me këtë, duke hedhur mendimin se kishte një zëvendësim të fuqisë punëtore me kapital që do të vazhdonte edhe në periudhën postsunge.<sup>160</sup>

Fuqia e madhe intensive e Kinës pasqyrohet edhe në prodhimet dhe tregtinë e saj mbresëlënëse. Së pari, argjendi rridhte në vend nga e gjithë bota (çka, siç është vënë në

<sup>156</sup> Robert Marks, *Tigers, Rice, Silk and Silt* (New York: Cambridge University Press, 1997).

<sup>157</sup> Për shembull, Susan Naquin dhe Evelyn Rawski, *Chinese Society in the Eighteenth Century* (London: Yale University Press, 1987).

<sup>158</sup> Gernet, *History*, fq. 483-489.

<sup>159</sup> Gang Deng, *Development versus Stagnation* (London: Greenwood Press, 1993), fq. 156, 171-72.

<sup>160</sup> Jones, *Growth Recurring*, kapitujt 3-4.

dukje tashmë, përbën dëshmi të mjaftueshme për superioritetin e kapacitetit prodhues të Kinës). Së dyti, kishte një tërësi të madhe infrastrukturash private kapitaliste.<sup>161</sup> Në veçanti, sistemi bankar privat e dominonte atë publik. Shansi ishte qendra kryesore e sistemit bankar privat dhe tetë bankat më të mëdha kishin mbi tridhjetë degë në të gjithë Kinën në fillimet e shekullit të nëntëmbëdhjetë. Investimet në tregti e industri ua kalonin atyre në agrikulturë, ndërkohë që fuqia e tregtarëve po rritej konsiderueshëm. Së treti, prodhimi i pambukut ishte shumë i madh dhe kërkonte sasi të mëdha pambuku të papërpunuar. Rreth fundit të shekullit të tetëmbëdhjetë Kina importonte më shumë pambuk nga India sesa Britania nga Amerika. Kësaj i shtohet argumentet e dhëna në kapitullin 4; që të ardhurat për frymë të Kinës ishin gati të barabarta me ato të Britanisë rreth vitit 1750; që prodhimi i saj kombëtar bruto ishte po aq i lartë sa i Britanisë më 1850; dhe që pjesa e saj në prodhimin industrial botëror ishte më e madhe se e Britanisë deri më 1860. Preokupimi deri edhe i shumë studiuesve eurocentrikë për ta lidhur rritjen ekonomike të Kinës me ndikimin perëndimor pas 1839-ës nuk e merr parasysh zhvillimin ekonomik që qe arritur shumë para ardhjes së britanikëve.

Së fundmi, siç shpjegohet në kapitullin 9, fryma e asaj që unë përpiqem të arsyetoj këtu pranohej nga europianët deri në shekullin e tetëmbëdhjetë. Vetëm pas vitit 1780 europianët do ta ndryshonin këtë pikëpamje në atë çka përbën ndoshta një nga shembujt më fantastikë të konceptndërtimit social të ndërmarrë nga europianët në mijëvjeçarin e kaluar. Para një minuti kinezët përshkruheshin si 'një shembull dhe model i qytetërimit të përparuar', kurse minutën tjetër u bënë 'një popull i degraduar e në amulli të përjetshme'. Për fat

<sup>161</sup> Mark Elvin, *The Pattern of the Chinese Past* (Stanford: Stanford University Press, 1973), veçanërisht kapitujt 11-12.

të keq, studiuesit eurocentrikë të historisë botërore (perëndimore dhe kineze) gabimisht kanë zgjedhur të ushqejnë ‘argumentin e ndalimit’,<sup>162</sup> ndërkohë që duhej të ishin përqendruar në nocionin e Kinës si një qytetërim dinamik e i përparuar në pjesën më të madhe të mijëvjeçarit të dytë.

Kundërparashtrimi im i fundit pohon se, para 1839-ës, Kina ishte në gjendje të kontrollonte europianët të cilëve u qe lejuar zyrtarisht akses në tregjet e saj, si dhe të mposhte ushtarakisht çdo sfidues europian të cilit nuk i qe dhënë akses. Meqë me këtë çështje merrem disi hollësisht në kapitullin 7, hëpërhë po e lë mënjanë. Si përfundim, duket me vend të thuhet se Kina as u tërhoq nga ekonomia globale pas 1434-ës, dhe as ekonomia e saj u tha. Kësisoj, pretendimi i Landes-it (cituar më lart) se ‘izolacionizmi u bë Kina’ ndërkohë që bota e jashtme po e parakalonte, rezulton të jetë një tjetër mit eurocentrik. Ky përfundim vlen jo më pak për Indinë, Azinë Juglindore e Japoninë, siç do ta shohim.

<sup>162</sup> Shih diskutimin e përmbledhur te Paul A. Cohen, *Discovering History in China* (New York: Columbia University Press, 1984).

#### 4. LINDJA MBETET DOMINUESE: MITET BINJAKE TË DESPOZITIZMIT ORIENTAL DHE TË IZOLACIONIZMIT NË INDI, NËAZINË JUGLINDORE DHE NË JAPONI, 1400-1800

Tradita e vazhdueshme e kundërshton idenë se civilizimi nuk mund të gjendet në ekuator. Zoti e di më së miri!

*Ibni Haldun*

Një nga parashtrimet qendrore eurocentrike pohon se, rreth vitit 1500, Perëndimi qe shfaqur si rajoni dominues në botë. Po ashtu zakonisht mendohet se fuqitë udhëheqëse botërore mes viteve 1400-1800 ishin të gjitha, pa përjashtim, europiane. Por siç e tregon ky kapitull, asnjë nga lojtarët kryesorë të ekonomisë botërore në çfarëdo momenti para 1800-ës, nuk ka qenë europianë. Për më tepër, Europa arriti të barazohej vetëm në shekullin e nëntëmbëdhjetë, pasi kishte ndjekur nga pas për rreth pesëmbëdhjetë shekuj. Një nga arsyet kryesore pse studiuesit eurocentrikë kanë menduar se Lindja ka qenë historikisht e prapambetur, është ideja e tyre se ekonomitë lindore kanë qenë të asfiksuar nga mbizotërimi i despotizmit oriental si dhe nga izolimi i tyre prej tregtisë ndërkombëtare. Hedhja poshtë e këtyre ideve ndihmon për të përforcuar pretendimin e bërë në pjesën e parë më poshtë: se Lindja ka qenë përpara Perëndimit deri në shekullin e nëntëmbëdhjetë. Kurse pjesa e dytë nxjerr në pah mitin eurocentrik që i shpërfill Indinë dhe Azinë Juglindore si rajone izolacioniste, të mbajtura peng – në rastin e Indisë – nga një shtet despotik oriental. Pjesa e tretë bën të njëjtën gjë për Japoninë. Në veçanti arsyetoj se Japonia pati arritur zhvillim domethënës ekonomik *para* industrializimit britanik, duke hedhur idenë se Japonia ishte një vend ‘me zhvillim të hershëm’ e jo ‘me zhvillim të vonë’.

## Lindja mbi Perëndimin, 1200-1800

Çfarë prove (sasiore apo cilësore) ekziston në mbështetje të pretendimit se Lindja ishte më e përparuar ekonomikisht se Europa deri në shekullin e nëntëmbëdhjetë? Ndonëse shumë nga treguesit standardë statistikorë janë domos kaba, ato mbeten e vetmja gjë ku mund të mbështetemi dhe sidoqoftë janë përdorur nga autorët eurocentrikë në mbështetje të pretendimeve të tyre. Le të fillojmë me të dhënat mbi të ardhurat kombëtare. Sipas Paul Bairoch-ut, të ardhurat e asaj që do të bëhej bota e tretë (lindore) ishin 220% të të ardhurave të Perëndimit më 1750, 124% më të larta (më 1830) dhe 35% më të larta (më 1860). Të vihet re se të ardhurat e Perëndimit përfshijnë Europën, Amerikat, Rusinë e Japoninë, kurse të ardhurat e Lindjes i referohen Afro-Azisë (përkufizim i bërë kundrejt Perëndimit). Të ardhurat e Perëndimit i kaluan ato të Lindjes vetëm më 1870.<sup>163</sup> Sipas Angus Maddison-it, prodhimi i brendshëm bruto i Kinës në vitin 1820 përbënte 29% të të gjithë botës dhe ishte i barabartë me kontributin e mbarë Europës.<sup>164</sup> Nuk është për t'u habitur që studiuesit eurocentrikë janë prirur të fokusohen në të dhënat për të ardhurat për frymë, meqë Lindja ka popullsi shumë më të madhe se Perëndimi. Angus Maddison dhe David Landes propozojnë një raport 2:1 në favor të Perëndimit për vitin 1750.<sup>165</sup> Por në bazë të dollarit amerikan të 1960-ës, Bairoch vlerëson se më 1750 të ardhurat për fry-

<sup>163</sup> Paul A. Bairoch, "The Main Trends in National Economic Disparities since the Industrial Revolution", te P. A. Bairoch dhe M. Levy-Leboyer (red.), *Disparities in Economic Development since the Industrial Revolution* (London: Macmillan, 1981), fq. 7.

<sup>164</sup> Angus Maddison, *Monitoring the World Economy* (Paris: OECD, 1995), fq. 30, 182-190.

<sup>165</sup> Angus Maddison, "A Comparison of Levels of GDP per capita in Developed and Developing Countries, 1700-1980", *Journal of Economic History* 43 (1) (1983), 29-30; Maddison, *Monitoring*, fq. 23-24; David S. Landes, *The Unbound Prometheus* (Cambridge: Cambridge University Press, 1969), fq. 14.

më të Lindjes ishin pak a shumë të barabarta me ato të Europës Perëndimore dhe se Kina ishte në një nivel me ekonomitë kryesore europiane.<sup>166</sup>

Si mund t'i pajtojmë këto vlerësime me përfundimet tejet të ndryshme? Siç e vë në dukje me të drejtë Maddison:

Nëse Bairoch ka të drejtë, atëherë shumë më tepër nga prapambetja e botës së tretë [sot] lipset shpjeguar me shfrytëzimin kolonial dhe shumë më pak nga avantazhi i Europës mund t'i atribuohet paraprirjes në shkencë, shekujve të grumbullimit të ngadaltë dhe superioritetit organizativ e financiar.<sup>167</sup>

Është domethënëse se Maddison e pranon se po të përdornim metodat që ofrojnë një nga tërësitë më të sofistikuarara të të dhënave deri më sot, prapazbatimi në 1750-ën do t'i konfirmonte të dhënat e Bairoch-ut.<sup>168</sup> Për më tepër, në librin e tij të vitit 1993, Bairoch merr parasysh një tërësi më të re të dhënash të ofruara nga Maddison e cila, konvertuar në dollarin amerikan të 1960-ës, shpie në një vlerësim prej 121 dollarësh për Indinë dhe Indonezinë për vitin 1830. Kjo është domethënëse sepse, siç përfundon Bairoch,

Duke marrë parasysh faktin se niveli i Indisë rreth vitit 1750 me gjasë ishte të paktën një të tretën më i lartë se rreth vitit 1830 dhe se në atë kohë (1750) Kina ishte më e pasur se India kurse Amerika Latine me gjasë ishte 'më e pasur' se Azia, ndërsa Afrika me gjasë ishte 'më e varfër', një nivel fillestar prej 170-190 dollarësh për atë që do të përbënte Botën e Tretë, ngjan të jetë një vlerësim mjaft konservator; me fjalë të tjera, një shifër shumë e afërt, ose të paktën e ngjashme, me vlerësimin tim të bërë më 1981.<sup>169</sup>

<sup>166</sup> Bairoch, "Main Trends", fq. 7, 12, 14.

<sup>167</sup> Maddison, "Comparison", 29.

<sup>168</sup> Po aty, 32.

<sup>169</sup> Paul A. Bairoch, *Economics and World History* (Chicago: Chicago University Press, 1995), 105-106.

Si përfundim, ka një bazë të mirë për të thënë se deri në vitin 1750, për sa u përket të ardhurave për frymë, Perëndimi ishte pak a shumë në një nivel me Lindjen. Por ka konsensus se pas 1800-ës të ardhurat për frymë të Europës Perëndimore kaluan përpara.

Si ishte situata krahasuese për sa i përket prodhimit industrial botëror? Këtu jam i detyruar të mbështetem në tërësinë e të dhënave të Bairoch-ut të 1982-shit (e cila me sa di është e vetmja).<sup>170</sup> Sipas Bairoch-ut, më 1750 Perëndimi jepte rreth 23% të këtij prodhimi, kurse Lindja (përfshirë Japoninë) rreth 77%. Deri më 1830 Lindja prodhonte dy herë më shumë se Perëndimi dhe ky i fundit arriti ta kalonte të parën vetëm rreth vitit 1850. Por një çështje më e rëndësishme ka të bëjë me pozitat relative të vendeve kryesuese. Në vitin 1750 kryesimi i Kinës ishte i qartë, me rreth 33% të prodhimit industrial botëror (që e kalon pozitën e SHBA-së sot). Befasuese është se pjesa relative e Kinës ishte thuhetse 50% më e lartë se ajo e Perëndimit në atë kohë, çka barazohet me pjesë e SHBA-së në kulmin e saj më 1953 kundrejt Europës bashkë me Japoninë e Kanadanë. Vetëm më 1830 Perëndimi arriti t'ia kalonte Kinës. Por si është raporti mes Kinës dhe Britanisë? Më 1750, pjesa e Kinës në prodhimin industrial botëror ishte mbi 1600% të asaj të Britanisë. Më 1800 ky raport ishte 670% në favor të Kinës dhe më 1830, 215%. Vetëm rreth vitit 1860 pjesa e Britanisë më në fund arriti të barazohet me atë të Kinës. Jo më pak i rëndësishëm është fakti se pjesa e Indisë ishte më e lartë se ajo e të gjithë Europës më 1750 dhe 85% më e lartë se Britanisë deri më 1830.

Si mund ta përmbyllim këtë pikë? Nëse ecim me të dhënat për prodhimin kombëtar bruto, Perëndimi ia kaloi Lindjes vetëm më 1870. Nëse marrim për bazë të ardhurat

<sup>170</sup> Paul A. Bairoch, "International Industrialization Levels from 1750 to 1980", *Journal of European Economic History* 11 (2) (1982), 269-333.

për frymë, duket e mundshme të themi se Perëndimi mori kryesimin vetëm pas vitit 1800. Megjithatë, të ardhurat për frymë jo doemos tregojnë fuqi ekonomike globale. Zvicra dhe Singapori sot gëzojnë të ardhura shumë të larta për frymë, por kjo askënd nuk e bën të arrijë në përfundimin se ato janë fuqi të mëdha ekonomike globale. Kryesimi i fuqishëm i Kinës për sa i përket prodhimit industrial botëror deri në mesin e shekullit të nëntëmbëdhjetë është veçanërisht domethënës. Prandaj duket e mundshme të thuhet se Lindja ka qenë përpara Perëndimit të paktën deri më 1800.

Gjithashtu, ka edhe një sërë kriteresh të ndryshme cilësore që vlejnë, përfshirë të dhënat për jetëgjatësinë e pritshme dhe kaloritë e marra. Kenneth Pomeranz së fundmi i përmbledhur të dhënat përkatëse nga një spektër i gjerë burimesh, duke arritur në përfundimin se Azia ishte të paktën po aq mirë, në mos më mirë, se Europa deri më 1800 (ndonëse ai përqendrohet kryesisht tek Japonia dhe Kina).<sup>171</sup> Interesante është se studimet e fundit tregojnë se *përkundër* pretendimit standard eurocentrik, standardi osman i jetesës dhe niveli i rrogave reale nuk mbetën kurrë prapa atyre të europianëve në asnjë moment përpara shekullit të nëntëmbëdhjetë.<sup>172</sup> Për më tepër, shëndeti publik dhe furnizimi me ujë të pastër ishte në nivel më të përparuar në Kinë se në Europë. Lee dhe Feng parashtrajnë se standardi kinez i jetesës ishte me siguri i krahasueshëm me atë të Perëndimit deri rreth 1800-ës.<sup>173</sup> Kurse Susan Hanley na tregon se edhe më 1850 standardi japonez i jetesës ishte më i lartë se

<sup>171</sup> Kenneth Pomeranz, *The Great Divergence* (Princeton: Princeton University Press, 2000), fq. 36-41.

<sup>172</sup> Süleyman Özmucur dhe Şevket Pamuk, "Real Wages and Standards of Living in the Ottoman Empire, 1489-1914", *Journal of Economic History* 62 (2) (2002), 293-321.

<sup>173</sup> James Z. Lee dhe Wang Feng, *One Quarter of Humanity* (London: Harvard University Pressi 1999), kapitulli 3.

ai i Britanisë. Ajo gjithashtu arsyeton se japonezi mesatar hante shumë më shëndetshëm se britaniku mesatar.<sup>174</sup>

Sido që të jetë, Lindja ishte qartazi përpara për sa i përket pozitës tregtare në ekonominë botërore. Siç bien dakord shumica e autoriteteve, përgjatë kësaj periudhe Europa ka vuajtur deficite kronike tregtare me fuqitë kryesore të Lindjes, precedent i nisur që në kohën e Perandorisë Romake. Ngaqë kërkesa europiane për mallrat e Lindjes ishte e lartë, por kërkesa e Azisë për prodhimet europiane ishte shumë e ulët, Europa e mbulonte diferencën me anë të eksportimit të metaleve të çmuara (tregues i qartë i prapambetjes së Europës). Dëshmi të mëtejshme përbën fakti se europianët nuk i prodhonin vetë as metalet në fjalë, por i plaçkisnin nga Afrika dhe Amerikat. Ose siç shprehet André Gunder Frank:

Në strukturën e ekonomisë botërore, katër rajone kryesore ruanin deficite të ngulitura në tregtinë e artikujve primarë: Amerikat, Japonia, Afrika dhe Europa. Dy të parat e balanconin deficitin duke prodhuar monedha argjendi për eksport. Afrika eksportonte modhena ari dhe skllëvër. Në terma ekonomikë, këto tri rajone prodhonin 'artikuj primarë' për të cilat kishte kërkesë gjetkë në ekonominë botërore, Kurse rajoni i katërt deficitar, Europa, nuk ishte në gjendje të prodhonte thujasë asgjë të vetën për eksport, me të cilën të mund ta balanconte deficitin tregtar.<sup>175</sup>

Megjithatë, ka dy përgjigje kryesore eurocentrike ndaj kësaj, të cilat do t'i hedh poshtë. Së pari, studiuesit eurocentrikë shpesh pretendojnë se aziatikët nuk i blinin mallrat europiane thjesht ngaqë shijet e konsumatorit aziatik nuk

<sup>174</sup> Susan B. Hanley, "A High Standard of Living in Nineteenth Century Japan: Fact or Fantasy?", *Journal of Economic History* 43 (1) (1983), 183-192.

<sup>175</sup> Andre Gunder Frank, *ReOrient* (Berkeley: University of California Press, 1998), fq. 127.

ishin të sofistikuara sa duhej. Por mallrat europiane ishin inferiore si në cilësi, ashtu edhe në çmim (çka është edhe arsyeja pse aziatikët pranonin vetëm arin dhe argjendin).<sup>176</sup> Për më tepër, duket se i ka shpëtuar vështrimi fakti se Europa nuk ishte i vetmi rajon me deficit të vazhdueshëm kundrejt disa prej fuqive kryesore të Lindjes (çka sugjeron se problemi nuk mund të ketë qenë vetëm në zgjedhjet 'e pasofistikuara' konsumatore të Lindjes).

Përgjigja e dytë dhe po aq e zakonshme është se preferenca aziatike për metalet e çmuara shpjegohet me prirjen e fortë të aziatikëve për të grumbulluar pasuri.<sup>177</sup> Por teza e grumbullimit ka tri dobësi kryesore. Së pari, mbështetet në supozimin e gabuar se ekonomitë aziatike nuk ishin të monetarizuara. Me siguri ekonomitë kineze, japoneze dhe indiane qenë monetarizuar në shekujt gjashtëmbëdhjetë/shtatëmbëdhjetë. Për t'u shënuar gjithashtu është fakti se shumica e shteteve aziatike këmbëngulnin t'i mblidhnin taksat në para e jo në lloj, çka i bënte shumë fshatarë të përfshihe-shin në ekonominë komerciale. Së dyti, dhe më e rëndësishmja, nëse aziatikët vetëm i grumbullonin metalet e çmuara, si do ta shpjegojmë faktin se ata do të merreshin me këmbim valutor global për të siguruar fitime të mëtejshme akoma? Fakti është se ndërsa argjendi përthitëj sidomos në Indi dhe Kinë, atje këmbehej me ar, i cili dërgohej në Europë për t'u këmbyer sërish me argjend (siç e shpjeguan në kapitullin pararendës). Kështu që metalet e çmuara nuk grumbulloheshin, por përdroreshin në një mënyrë racionale e me qëllim fitimi. Së treti, importimi i metaleve të

<sup>176</sup> Om Prakash, "The Dutch East India Company in the Trade of the Indian Ocean", te Ashin Das Gupta dhe M. N. Pearson (red.), *India and the Indian Ocean 1500-1800* (Calcutta: Oxford University Press, 1987), fq. 186-187.

<sup>177</sup> Për shembull, Charles P. Kindleberger, "Spenders and Hoarders", te C. P. Kindleberger (red.), *Historical Economics* (Berkeley: University of California Press, 1990), fq. 35-85.

çmuara përbënte një nxitje të madhe për komercializimin e shumë ekonomive aziatike. Thënë ndryshe, metalet në fjalë nuk nxirreshin nga qarkullimi duke u grumbulluar, për përdorshin për ta nxitur qarkullimin, si dhe prodhimin.<sup>178</sup> Për këto arsye është e qartë se eksportimi evropian i metaleve të çmuara për të balancuar deficitin tregtar vinte si pasojë e dobësisë së saj prodhuese dhe e fuqisë relative ekonomike të Azisë.

Për ta përmbledhur, ka mjaft të dhëna që tregojnë se në të gjithë treguesit kyç të ekonomisë, Lindja ia kalonte Perëndimit deri të paktën në fillim të shekullit të nëntëmbëdhjetë. Tani do t'i kthehem Lindjes për ta zbërthyer dhe për të shqyrtuar kapacitetet intensive e ekstensive të disa prej fuqive të saj kryesore. Pasi e kam trajtuar Kinën në kapitullin pararendës, këtu do të marr në shqyrtim Indinë, Azinë Juglindore dhe Japoninë. Të vihet re se Perandorinë Osmane dhe Perandorinë Perse i trajtoj shkurtimisht në kapitullin 7.

### Mitet binjake të izolacionizmit indian dhe të despotizmit oriental

Eurocentrizmi e përshkruan Indinë si një rast klasik të despotizmit oriental, një Leviathan brutal e i pangopur i cili duke ia shtrydhur e tharë burimet ekonomisë, krijoi një ekonomi të prapambetur e të amullt, të izoluar nga kryerryma e tregtisë ndërkombëtare.<sup>179</sup> Në këtë pjesë jepen tetë kundërparashtrime që nxjerrin në pah se para imperializmit britanik ekonomia e Indisë spikaste vetëm për gjallërinë e saj.

<sup>178</sup> Najaf Haider, "Precious Metal Flows and Currency Circulation in the Mughal Empire", *Journal of the Economic and Social History of the Orient* 39 (3) (1996), 298-367; Frank, *ReOrient*, fq. 151-164.

<sup>179</sup> Për shembull, W. H. Moreland, *From Akbar to Aurangzeb* (London: Macmillan, 1923); Tapan Raychaudhuri, "The Mughal Empire", te Tapan Raychaudhuri, dhe Irfan Habib (red.), *The Cambridge Economic History of India*, I (Cambridge, Cambridge University Press, 1982), fq. 172-173.

**Shteti indian si lejues i rritjes:  
tetë parashtrime antieurocentrike**

Së pari, ideja se shteti mogul e dërrmoi çdo aktivitet kapitalist, është problematik, sepse shteti në rastin më të keq ishte indiferent ndaj kapitalizmit, shpesh ishte tolerant dhe ndonjëherë bënte shumë për ta mbështetur. Një shembull i spikatur i ndihmës pozitive të shtetit është rasti i tregtarëve guxharatianë. Ndërsa anijet mbretërore ishin të rëndësishme deri në fillimet e shekullit të shtatëmbëdhjetë, një ndryshim fundamental ndodhi më vonë. Tregtarët e Guxharatit arritën t'i bindnin sundimtarët ta tërhiqnin flotën mbretërore dhe t'u njihnin autonomi për ta zhvilluar tregtinë e tyre me anijet e tyre, veçanërisht nga Surat (proces që përfundoi në mesin e shekullit të shtatëmbëdhjetë). Duket se shoqërimi mbrojtës që shteti u ofronte tregtarëve guxharatianë ishte një faktor i rëndësishëm në rritjen shumë të madhe të trafikut detar me bazë Surat, me një faktor prej 600-1000%. Vlen të shënohet gjithashtu edhe filozofia e sundimtarit të Marathës, Shivaxhit:

Tregtarët janë stolia e mbretërisë dhe lavdia e mbretit. Ata janë burimi i lulëzimit të mbretërisë. Gjithfarë mallrash që nuk gjenden në mbretëri vijnë përmes tyre dhe mbretëria pasurohet. Përmes tyre bëhet i mundshëm çdo lloj borxhi që mund të nevojitet në kohë të vështirë. Prandaj respekti që u takon tregtarëve duhet ruajtur. Në tregjet e kapitalit duhen ruajtur tregtarët e mëdhenj.<sup>180</sup>

Një qëndrim i tillë do t'i joshte guxharatianët të migronin në Maharashtra në shekullin e shtatëmbëdhjetë. Më përgjithësisht, prestigj të madh gëzonin tregtarët e distancave të largëta, *banxhara*-të. Grover vë në dukje se

<sup>180</sup> H. Fukazawa, "Maharashtra and the Deccan: A Note", te Raychaudhuri dhe Habib, *Cambridge Economic History*, fq. 202.

Në emët të shtetit, zamindarët e krahinave duhej t'u siguronin kalim të lirë [*banxhara-ve*] të tyre në territoret ku qeverisnin. Duke qenë se banxharatë mbanin gjallë linjën e furnizimeve nga një vend në tjetrin ... ishin shumë të respektuar në shoqëri. Sa herë që një karvan arrinte në një fshat ... pritej me ngrohtësi të madhe. Kryezamindarët ... shpesh u dhuronin rroba nderi banxharave prijës kur këta arrinin shëndoshë e mirë në territoret e tyre.<sup>181</sup>

Për më tepër, duke i mbështetur pretendimet e tij në kërkime primare, Muzafar Alam tregon se si sundimtarët mugalë shpesh përpiqeshin t'i mbronin tregtarët indianë. Për shembull, letra shkëmbeheshin midis sundimtarëve mugalë, Shahut të Persisë dhe hanëve uzbekë, për të ushqyer paqen për hir të ruajtjes së tregtisë fitimprurëse që i lidhte këto rajone.<sup>182</sup> Siç e vë në dukje Van Santen, sundimtarët mugalë zhvillorin një lloj politike stimuluese për eksportet me qëllimin për të tërhequr metale të çmuara në Indi.<sup>183</sup> Prandaj s'është për t'u habitur që tregtarët indianë shpesh i shihnin sundimtarët si aleatët e tyre.

Një tjetër problem është se teza e despotizmit oriental e ekzagjeron jashtë mase centralizmin dhe pushtetin e shtetit mugal. Shteti qendror në fakt u kalonte pushtet dhe kontroll lokaliteteve dhe ishte i lumtur të lejonte (dhe toleronte) autoritetet e shumta provinciale që mbikqyrnin tregtinë. Duke patur parasysh se autoritetet portuale dhe lokale bënë shumë për ta mundësuar zhvillimin e kapitalizmit dhe të

<sup>181</sup> B. R. Grover, "An Integrated Pattern of Commercial Life in Rural Society of North India during the Seventeenth and Eighteenth Centuries", te S. Subrahmanyam (red.), *Money and the Market in India 1100-1700* (Delhi: Oxford University Press, 1994), fq. 238-239.

<sup>182</sup> Muzafar Alam, "Trade, State Policy and Regional Change: Aspects of Mughal-Uzbek Commercial Relations, c. 1550-1750", *Journal of the Economic and Social History of the Orient* 37 (3) (1994), 215-218, 225-226.

<sup>183</sup> H. W. Van Santen, "Trade between Mughal India and the Middle East, and Mughal Monetary Policy, c. 1600-1660", te Karl R. Haellquist (red.), *Asian Trade Routes* (London: Curzon Press, 1991), fq. 94-95.

komercializmit, kjo në vetvete ka mjaft peshë në rrëzimin e argumentit eurocentrik. Kjo dobësi administrative gjithashtu e rrëzon idenë eurocentrike se tregtia dhe çmimet administroheshin nga autoriteti qendror. Teksa kishte disa vende ku qeveria mugale përpiqej të ushtronte ndikimin e vet mbi tregtinë,

anijet private ishin të lira të shkonin ku të donin; kurrfarë linje detare nuk ishte në monopol të ndonjë personi apo grupi. Orvatje të herëpashershme për të vendosur monopol mbi artikuj të caktuar primarë ndodhnin, por shiheshin vëngër dhe nuk zgjasnin shumë.<sup>184</sup>

Sido që të jetë, sistemi thjesht ishte shumë i madh, kurse shteti mugal shumë i dobët për të mund të krijuar një ekonomi të kontrolluar dhe sistem tregtar monopolist për interesat e veta.

Një problem i tretë është se nëse teza e despotizmit oriental do të ishte e saktë, nuk do të ishte e pritshme të shihnim burime domethënëse kreditimi në ekonominë indiane. Por institucionet financiare ishin edhe të mirëzhvilluara, edhe me spektër të gjerë. Tregtarët nga Ahmedabadi, për shembull, kryenin çdo lloj pagese dhe huadhënieje e huamarrjeje në letër. Spikat fakti se interesat në tregjet financiare ishin të barabarta ose më të ulëta se ato në Britani (0.5-1% në muaj) në shekujt e gjashtëmbëdhjetë e shtatëmbëdhjetë.<sup>185</sup> Për më tepër, *shrof*-ët (bankierët) lokalë jepnin hua me interesa shumë të ulëta vjetore, 1-5% në zonat rurale dhe 1-6% në qytete. Po ashtu, edhe çmimet që kërkonin *sarraf*-ët për sigurimin e tregtisë ishin mjaft të ulëta, çka tre-

<sup>184</sup> Ashin Das Gupta, *The World of the Indian Ocean Merchant, 1500-1800* (New Delhi: Oxford University Press, 2001), fq. 124.

<sup>185</sup> Irfan Habib, "Banking in Mughal India", te Tapan Raychaudhuri (red.), *Contributions to Indian Economic History, I* (Calcutta: Firma K. L. Mukhopadhyay, 1960), veçanërisht fq. 10-12.

gon qartë se rrugët duhet të kenë qenë relativisht të sigurta. Së fundmi, sarrafët merreshin edhe me depozitim bankar dhe i ofronin depozitat (kryesisht tregtarëve) me kamata më të larta, një tipar i qartë ky i financave moderne bankare. Nëse këta kapitalistë do të jetonin nën frikën e një shteti 'grabitqar', me siguri nuk do të merreshin me të tilla veprimtari financiare.

Së katërti, nëse shteti do të kish qenë një despotizëm oriental, si mund ta shpjegojmë faktin se shumë tregtarë ishin jashtëzakonisht të pasur. Një tregtar i shekullit të shtatëmbëdhjetë, Abdulghafuri, zhvillonte një vëllim tregtie të barazvlefshëm me atë të Kompanisë Angleze të Indisë Lindore në total! Për të thuhet se zotëronte rreth njëzet anije prej 300-800 tonësh secila. Një tjetër tregtar, Virxhi Vora, kishte një pronë gjigande me vlerë rreth 8 milionë rupi dhe ishte aq i shquar në sektorë të ndryshëm të tregtisë, sa mund të ushtronte kontroll mbi Kompaninë Holandeze të Indisë Lindore.<sup>186</sup> Veç kësaj, shumë tregtarë nga Suratit ishin tejet të pasur dhe disa prej tyre kishin 5 ose 6 milionë rupi në mesin e shekullit të shtatëmbëdhjetë. Domethënës gjithashtu është fakti se pasuri të tilla nuk kishin vetëm tregtarët e Suratit. Siç përfundon Ashin Das Gupta:

*Bania*-i hindu që dridhej nga frika e mugalëve, i privuar nga mundësia për të grumbulluar dhe ruajtur pasuri për shkak të shtetit [grabitqar], është një figurë e dalë në masë të madhe nga përfytyrimi i keqinformuar i disa prej udhëtarëve [eurocentrikë] perëndimorë në Indi. Pasuri të mëdha grumbulloheshin lirisht nëpërmjet tregtisë detare.<sup>187</sup>

Së pesti, nëse shteti ishte 'vetëm rrëmbyes' si mund ta shpjegojmë faktin se tarifat mbi tregtinë e jashtme dhe

<sup>186</sup> Van Santen, "Trade", fq. 92.

<sup>187</sup> Das Gupta, *World*, fq. 73.

tarifat për transitin e brendshëm ishin shumë të ulëta? Nëse taksat mbi tokën dhe tregtinë kanë qenë kaq dërrmuese, si mund ta shpjegojmë praninë e shumë grupeve tregtare tejet të pasura (të cilat nuk i detyroheshin ndonjë mirënjohje të veçantë shtetit)?

Së gjashti, eurocentrizmi pohon se një nga treguesit kryesorë të despotizmit oriental në Indi qëndron në pretendimin se para krijimit të perandorisë britanike, tregtia indiane ishte e papërfillshme.<sup>188</sup> Për më tepër, studiues eurocentrikë si Moreland e kanë pasqyruar tregtinë indiane si thjesht një shtojcë apo poshtëshënim të kryerrymës europiane. Me këtë lidhen dy pretendime të veçanta: së pari, se tregtia e vogël ekzistuese ishte vetëm në mallra luksi dhe, si e tillë, nuk ishte e gjerë;<sup>189</sup> dhe së dyti, se tregtia indiane kryhej nga 'ambulantë' të cilët ishin vetëm lojtarucë në arenën ndërkombëtare. Le t'i marrim me radhë.

Një nga arsyet pse eurocentrizmi këmbëngul se tregtia indiane ishte e papërfillshme, vjen nga imazhet ekzotike të tekstileve luksoze indiane që u shiteshin mbretërve dhe të pasurve. Por këto imazhe duket se janë produkt i një mendësie orientaliste pikësëpari. Tekstilet luksoze në fakt vërtet prodhoheshin në vende si Bengali, Guxharati e Koromandeli, por pjesa dërrmuese e tekstileve që prodhoheshin në Indi ishin për tregjet popullore. Ajo që studiuesve eurocentrikë u ka shpëtuar nga vëmendja është se një pjesë e mirë e tekstileve indiane ishin të një lloji kaba, të përshtatshme vetëm për konsumatorët e varfër. Interesante gjithashtu është se këto tregje popullore shtriheshin në një hapësirë të madhe, nga Indonezia në juglindje e deri në Hormuz e Aden në perëndim. Kështu që këto tregje vështirë të përbënin

<sup>188</sup> Moreland, *From Akbar*.

<sup>189</sup> Për shembull, Jakob Van Leur, *Indonesian Trade and Society* (The Hague: W. van Hoeve, 1955).

përrjashtim. Në të vërtetë, grupet e varfra konsumatore në një pjesë të madhe të Lindjes së Mesme krijonin shumicën e kërkesës për pëlhurat e vrazhdëta indiane.<sup>190</sup> Mallrat e konsumit masiv konsistonin edhe në artikuj të konsumit të përditshëm, si oriz, legume, grurë e vaj, të gjitha të tregtuara në mbarë Oqeanin Indian dhe madje në sasi të konsiderueshme.

Imazhi konvencional eurocentrik i tregtisë indiane të zhvilluar nga 'ambulantët' është gjithashtu i pavërtetë. Këtë e tregon fakti se kishte shumë tregtarë shumë të mëdhenj të cilët kryenin tregtinë e tyre si brenda edhe jashtë ekonomisë indiane. Të rëndësishëm në këtë kuadër ishin *banxhara*-të (tregtarët e distancave të gjata) dhe *banian*-ët (tregtarët e qyteteve). *Banxhara*-të me siguri nuk ishin ambulantë. Po kështu edhe *banian*-ët, dhe kjo jo më së paku ngaqë shpesh pajtonin ambulantë. Tregtarët muslimanë të Guxharatit ishin *banxhara*-të më të mëdhenj, dhe roli i tyre në rrjetin gjigand të Oqeanit Indian ishte tejet i madh.<sup>191</sup> Dhe, siç u përmend më lart, shumë prej tyre do të bëheshin jashtëzakonisht të pasur. *Banian*-ët ndaheshin në dy grupe – *dallal*-ët (komisionerët) dhe *shrof*-ët ose *sarra*-ët (bankierët dhe valutëkëmbyesit). *Banian*-ët ishin të ushqyer që në fëmijëri me mendësi kapitaliste. Siç e vë në dukje Habib-i:

Marrja e përkushtuar e aftësisë për të fituar, ishte një aspekt themelor i botëkuptimit tradicional të banianëve ... Në këtë botëkuptim kombinoreshin bashkë dy virtyte kalviniste, fryma e lulëzimit ekonomik dhe ajo fetare. Banianët i ruheshin me kujdes ekspozimit të pasurisë dhe nuk shpenzonin me tepri në asgjë, përveç se në stoli të çmuara për gratë e tyre (që ishte një formë kursimi).<sup>192</sup>

<sup>190</sup> Das Gupta, *World*, fq. 66, 92.

<sup>191</sup> Po aty, kapitulli 3.

<sup>192</sup> Irfan Habib, "Merchant Communities in Pre-Colonial India", te James D. Tracy (red.), *The Rise of Merchant Empires* (Cambridge: Cambridge University Press, 1990), fq. 384.

Në veçanti, *balian*-ët mund të siguronin nivele të jash-tëzakonshme kapitali. Ata ishin lojtarë kyç në financimin jo vetëm të tregtisë tejdetase indiane, por edhe të kompanive të ndryshme europiane, sidomos të Kompanisë Angleze të Indisë Lindore. Jo më pak domethënës është fakti se ata mund të financonin tregti në distanca të gjata në nivele shumë më të larta se ç'mundeshin britanikët. 'Anijet europiane ishin më të vogla dhe me kapital më të ulët. Në fillim të shekullit të shtatëmbëdhjetë anglezët kontrollonin një kapital prej mesatarisht 200.000 rupish, ndërkohë që anijet guxharatiane që bënin tregti me Detin e Kuq vlenin sa pesëfishi i kësaj shume.'<sup>193</sup> Kështu që, edhe pse kishte shumë tregtarë të vegjël indianë, fakti është se ata (ashtu si dhe britanikët) nuk do të kishin mundur të përfshiheshin në tregti pa ndihmën e shumë tregtarëve të mëdhenj indianë.

Megjithatë, për ta ruajtur imazhin eurocentrik, mund të pretendohet se këta kapitalistë në shkallë të gjerë ishin thjesht kompradorë dhe të varur nga tregtarët superiorë europianë. Por, në të vërtetë, *balian*-ët ishin më shumë si 'partnerë të mëdhenj'.<sup>194</sup> *Balian*-ët nuk ishin njerëz me origjinë modeste të cilëve u kishin dhënë pasuri e pushtet britanikët. Ata ishin të pasur shumë para se të arrinin britanikët. Mbi të gjitha, kapitali i tyre financonte një pjesë të madhe të tregtisë britanike. Britanikët ishin partnerët e tyre të vegjël deri më 1800.

Gjithashtu është e rëndësishme të vihet në dukje se përkrimi i Indisë si një vend i izoluar nga tregtia ndërkombëtare është qartazi shumë i gabuar. Ndërkohë që osmanët dhe kinezët ishin lojtarët më të rëndësishëm tregtarë në ekonominë globale në periudhën pas 1500-ës, tregtarët indi-

<sup>193</sup> Jack Goody, *The East in the West* (Cambridge: Cambridge University Press, 1996), fq. 128.

<sup>194</sup> Das Gupta, *World*, fq. 122-133.

anë gjithnjë e më tepër luanin një rol plotësues, sidomos brenda sistemit të rëndësishëm tregtar të Oqeanit Indian. India ishte e orientuar më shumë nga eksportet sesa importet dhe gëzonte një suficit të madh tregtar me Europën.<sup>195</sup> Nuk është befasuese që sasi të mëdha argjendi rridhnin nga Europa në Indi. Vetëm kjo mjafton si argument kundrejt idesë (së gabuar) eurocentrike se tregtia europiane përbënte 'kryerrymën'. Veç kësaj, do të ishte e gabuar të mendohej se ekonomia indiane ngrihej mbi bazën e një agrikulture të pazhvilluar të nivelit jetik. Studime të vona kanë treguar se fshati 'tipik' indian ishte mjaft i lidhur jo vetëm me qendrat e gjalla komerciale brenda Indisë, por edhe me ekonominë globale.<sup>196</sup> Domethënëse ishin edhe përmasat e tregtisë së brendshme indiane që kryhej nga *banxhara*-të, e cila qëndronte në rreth 821 milionë tonë në vit.

Përmasat e saj të konsiderueshme mund të merren me mend nga fakti se deri më 1882, hekurudhat transportonin 2.500 milionë tonë për milje.<sup>197</sup>

Së fundmi, ndoshta problemi më i qartë me despotizmin oriental është se ekonomia indiane shfaqte nivele mbresëlënëse për sa i përket fuqisë intensive. Është fakt i mirënjohur se dy industritë kryesore në revolucionin industrial britanik ishin pambuku dhe hekuri/çeliku. Ajo që bën përshtypje këtu është se në të dyja këto industri, India udhëhiqte deri në shekullin e tetëmbëdhjetë, në mos edhe të nëntëmbëdhjetë. India ishte e famshme për prodhimin e çelikut Wootz që eksportohej në Persi ku përbënte bazën për çelikun e famshëm të Damaskut. Furnnaltat ishin mjaft të pranishme në periudhën mugale, me rreth 10.000 të tilla rreth fundit të shekullit të tetëmbëdhjetë. Për më tepër, çeli-

<sup>195</sup> Frank, *ReOrient*, fq. 84-92.

<sup>196</sup> Grover, "Integrated Pattern", fq. 219-255.

<sup>197</sup> Habib, "Merchant Communities", fq. 376-377.

ku indian mbeti superior ndaj çelikut të prodhuar në Sheffield, por edhe më i lirë. Edhe me fillimin e industrializimit britanik, hendeku midis çelikut european dhe atij indian, ndonëse u ngushtua, prapëseprapë mbeti i konsiderueshëm (shih kap. 9).

India gjithashtu ishte prodhuesja kryesore në botë e tekstileve të pambukut, por edhe në prodhimin e tekstileve të mëndafshit ishte po aq mbresëlënëse. Vetëm zona e Kasimbazarit prodhonte 2.2 milionë paundë mëndafsh në vit. Siç përfundon Braudel:

Në fakt, e gjithë India përpunonte mëndafsh dhe pambuk dhe dërgonte në mbarë botën sasi të pabesueshme stofrash, nga më të rëndomtë deri tek më luksozet, po të kemi parasysh se edhe Amerikat merrnin një pjesë të madhe të tekstileve indiane përmes europianëve ... Nuk mund të ketë dyshim se deri në revolucionin industrial britanik, industria indiane e pambukut ishte më e madhja në botë, si për nga sasia dhe cilësia e prodhuar, ashtu dhe për nivelet e eksportit.<sup>198</sup>

Veç kësaj, ndikimi i Indisë reflektohet edhe në gjuhë: *chintz*, *calicoe*, *dungaree*, *khaki*, *pyjama*, *sash* dhe *shawl* [damask, basma, xhins, kaki, pizhama, brez dhe shall], janë të gjitha fjalë me prejardhje indiane.<sup>199</sup>

Si përfundim, fakti se deri në fund të shekullit të tetëmbëdhjetë India gëzonte fuqi më të madhe intensive e ekstensive se fuqitë kryesore europiane, e nxjerr në dritë si mitin e despotizmit oriental të Indisë, ashtu edhe të izolacionizmit, si dhe faktin se agimi i epokës europiane nuk kishte ardhur ende.

<sup>198</sup> Braudel, *Civilization and Capitalism, 15th-18th Century*, III (Berkeley: University of California Press, 1992), fq. 509.

<sup>199</sup> Arnold Pacey, *The Maze of Ingenuity* (London: Allen Lane, 1974), fq. 187-188.

### *Një shtojcë e Azisë Juglindore?*

Eurocentrizmi e redukton Azinë Juglindore në Ngushticën e Melakës, kurse këtë të fundit në një shtojcë, ose poshtëshënim të vogël në narrativën e madhe perëndimore. Kjo pjesërisht ngaqë Ngushticat përfytyrohen si thjesht një pikë tranziti ose stacion në të ashtuquajturën ‘kryerrymë tregtare’ midis Europës e Kinës, dhe pjesërisht ngaqë mendohet se Melaka dominohej nga portugezët pas vitit 1511 dhe nga holandezët pas 1641-shit. Por kjo e fsheh faktin se rajoni ishte i përfshirë në një tregti që i kishte fillimet në vitet e para të epokës së re.<sup>200</sup> Ky arsyetim gjithashtu e fsheh rolin jetik që mbretëria e Srivixhajës në Sumatra luante brenda ekonomisë botërore mes shekujve të shtatë e të trembëdhjetë (siç u vu në dukje në kap. 2). T’ia njohësh rëndësinë Melakës vetëm në periudhën pas 1511-ës, është problematike, jo më së paku ngaqë ishin udhëtimet e admiralit kinez (musliman) Çeng Ho rreth një shekull më parë ato që i dhanë një shtysë të madhe Melakës dhe tregtisë së Azisë Juglindore.<sup>201</sup> Sepse vetëm atëherë Melaka e zëvendësoi Javën si qendër kryesore të tregtisë indoneziane, duke i shtrirë lidhjet e saj tregtare deri në Guxharat, Dhabol, Bengal e Koromandel në Indi; në Kinë dhe Ishujt Rjukju; në perandoritë osmane e perse, si dhe në Mesdhe. Por mbi të gjitha, ritregimi i historisë së Melakës si një avanpost evropian është problematik sepse, siç do ta shohim hollësisht në kapitullin 7, portugezët dhe holandezët thjesht nuk mundën ta monopolizonin tregtinë e Azisë Juglindore.

Zhvlerësimi eurocentrik i tregtisë së Azisë Juglindore, ashtu si zhvlerësimi i tregtisë së Indisë, mbështetet në dy

<sup>200</sup> Arun Das Gupta, “The Maritime Trade of Indonesia: 1500-1800”, te Om Prakash (red.), *European Commercial Expansion in Early Modern Asia* (Aldershot: Variorum, 1997), fq. 240-250.

<sup>201</sup> Anthony Reid, *Southeast Asia in the Age of Commerce 1450-1680*, I (New Haven: Yale University Press, 1993), fq. 12, 15.

argumente të tjera. Së pari, tregtia gjoja zhvillohej vetëm nga ‘ambulante’ të vegjël dhe; së dyti, tregtia bëhej vetëm në mallra ‘luksi’ dhe prandaj ishte e papërfillshme. Prendimi i parë eurocentrik rrëzohet nga prania e *nakhoda*-ve, pronarë të mëdhenj e të pasur xhunkesh. Në shumicën e rasteve ata ishin javanezë dhe ishin përcuesit kryesorë të tregtisë së jashtme. Dëshmia për këtë qëndron në faktin se anijet mesatare aziatikojuglindore të ngarkesës mbanin deri në 500 tonë, kurse më të mëdhatë – që kishin pronarë *nakhoda*-t – peshonin deri në 1000 tonë me ngarkesë të plotë (të gjitha ia kalonin kapacitetit bartës të anijeve europiane). Veç kësaj, duke folur për tregtinë indoneziane, Meilink-Roelofs përon:

Është ... e qartë se tregtia në një shkallë të tillë ... s’mund të quhet tregti ambulante. Përkundrazi, ajo merrte forma tejet të larmishme ku sasi tepër të mëdha artikujsh kryesorë si ushqime e tekstile alernoheshin me sasi më të vogla artikujsh të çmuar ose edhe më të lirë.<sup>202</sup>

Kjo shpie në kundërshtimin ndaj argumentit të dytë. Argumenti i njohur eurocentrik se tregtia aziatiko-juglindore dominohej nga artikujt e luksit duket se mbështetet në theksimin e ekzagjeruar të tregtisë së erëzave, me gjasë ngaqë kjo e fundit dominohej nga europianët. Por, në fakt, erëzat ishin një artikull pa ndonjë peshë të madhe në tregtinë që zhvillohej në rajon.<sup>203</sup> Ishin ushqimet kryesore (si orizi, kripa, peshku turshi e i tharë dhe vera e palmës), si dhe tekstilet e punimet e lira metalike) ato që ‘zinin hapësi-

<sup>202</sup> M. A. P. Meilink-Roelofs, “Trade and Islam in the Malay-Indonesian Archipelago Prior to the Arrival of the Europeans”, te D. S. Richards (red.), *Islam and the Trade of Asia* (Oxford: Bruno Cassirer, 1970), fq. 153.

<sup>203</sup> K. N. Chaudhuri, *Trade and Civilisation in the Indian Ocean* (Cambridge: Cambridge University Press, 1978), fq. 186-187.

rën më të madhe në anijet që përshkonin ujrat e qeta të cektësirave të Sundës.<sup>204</sup>

### **Miti i despotizmit oriental dhe i izolacionizmit japonez: Japonia si 'vend me zhvillim të hershëm', 1600-1868**

Mund të mendohet se Japonia – e cila do të përjetonte industrializim të madh pas vitit 1868 (për të mos përmendur 'mrekullinë ekonomike' pas Luftës së Dytë Botërore) – me siguri përbën përjashtimin që edhe autorët eurocentrikë janë të detyruar ta pranojnë. Por për shumë studiues të tillë, Japonia përbën përjashtimin që vërteton rregullin eurocentrik.<sup>205</sup> 'Dogma japoneze' përmban dy argumente kyçe. I pari pohon se Japonia e Meixhi-t u industrializua vetëm në periudhën pas 1868-ës për shkak se u detyrua nga amerikanii Commodore Perry më 1853 që të dilte nga politika e saj e izolimit ndërkombëtar. Ndikimi perëndimor mendohet të ketë qenë kritik, pasi e lënë në vetminë e saj, ekonomia e prapambetur japoneze do të lëngonte siç kishte bërë nën despotizmin e shtetit Tokugava (1603-1868). Së dyti, Japonia e vërteton rregullin eurocentrik duke qenë se industrializimi i saj i suksesshëm pas 1868-ës gjoja u arrit falë aftësisë së saj për të përvetësuar ose imituar mënyrat perëndimore (në përputhje me strategjinë e 'zhvillimit të vonë'). Datimi i industrializimit japonez në periudhën pas 1868-ës është i rëndësishëm për argumentin eurocentrik sepse një periudhë e tillë, me përkufizim do ta bënte Japoninë një 'vend me zhvillim të vonë' (meqë të gjitha vendet europiane, përfshirë edhe Rusinë, e filluan programin e tyre industrial-

<sup>204</sup> Anthony Reid, *Southeast Asia in the Age of Commerce 1450-1680*, II (New Haven: Yale University Press, 1993), fq. 2.

<sup>205</sup> Për shembull, John M. Roberts, *The Triumph of the West* (London: BBC Books, 1985), kapitulli 1.

zues para 1868-ës). Për më tepër, studiuesit eurocentrikë shpesh e shpjegojnë ritmin e shpejtë të zhvillimit industrial të Japonisë pas 1868-ës ose me shpejtësinë me të cilën u përthithën idetë perëndimore, ose me shkallën e ngjashmërisë së shoqërisë japoneze me atë të Britanisë (teza e 'Britanisë së Lindjes').<sup>206</sup>

Në këtë mënyrë, rasti i Japonisë përbën dëshmi të mëtejshme të superioritetit të mënyrave perëndimore duke konfirmuar supozimin standard eurocentrik të bërë të famshëm nga Walt Rostow: se të gjitha vendet e prapambetura mund t'i shijojnë frytet e modernitetit për sa kohë ndjekin recetën perëndimore për modernizim.<sup>207</sup> Kjo pjesë ofron një vështrim kritik ndaj perspektivës eurocentrike dhe paraqet një peizazh të ndryshëm të Japonisë si një 'vend me zhvillim të hershëm'. Ky argument e lëkund supozimin eurocentrik se 'vendet me zhvillim të hershëm' ndodheshin vetëm në Europë dhe se Lindja ishte e paaftë të udhëhiqte zhvillimin e saj.

### *Si nisi gjithçka në Japoni:*

#### *dinamizmi ekonomik në epokën Tokugava (1603-1868)*

Pak të dhëna empirike ka patur në të kaluarën për zhvillimin e Japonisë në periudhën para Meixhi-t. Shpesh thjesht supozohej se ekonomia e Japonisë Tokugava ishte e prapambetur dhe e amullt për shkak të despotizmit oriental. Madje edhe specialistët e Japonisë ekzistonte konsensusi se Japonia Tokugava ishte një ekonomi e prapambetur, feudale ose agrare. Megjithatë ka një të dhënë imediate rrethanore që e vë në pikëpyetje këtë pikëpamje: Ritmi i rritjes

<sup>206</sup> R. N. Bellah, *Tokugawa Religion* (Boston: Beacon Press, 1970); David S. Landes, *The Wealth and Poverty of Nations* (London: Little, Brown, 1998), kapitulli 23.

<sup>207</sup> Walt W. Rostow, *The Stages of Economic Growth* (New York: Cambridge University Press, 1960).

ekonomike të Japonisë në periudhën Meixhi pas 1868-ës ia kalonte ritmit thuajse të të gjitha ekonomive europiane. Një ritëm i tillë rritjeje ekonomike nuk mund të ketë ardhur nga hiçi. Ngjan e pakonceptueshme të mendohet se ekonomia japoneze ishte e amullt në një çast (menjëherë para 1853-shit) dhe në çastin tjetër të bëhej një nga ekonomitë më dinamike në botë. Vitet e fundit kanë dalë studimet (shpesh të kryera me mund të madh) që paraqesin një peizazh të rishikuar të një dinamizmi ekonomik gjatë periudhës Tokugava. Kjo i ka bërë disa të mendojnë, siç shprehet Eric Jones, se: 'lehtësia relative e arritjeve të Meixhi-t tashmë në masë të madhe i detyrohet pikënisjes që mori nga historia [Tokugava]'.<sup>208</sup>

Një nga argumentet kryesore të bëra nga Eric Jones në librin e tij, *Growth Recurring*, është se Japonia e Tokugava-s kishte rritje të të ardhurave për frymë (që mendohet si lajtmotivi i kapitalizmit modern). Të tjerë kanë hedhur mendimin se rritja për frymë është arritur në gjysmën e dytë të sundimit të Tokugava-s.<sup>209</sup> Siç u përmend më lart, ka të dhëna se Japonia gëzonte një standard relativisht të lartë jetese, me rroga e të ardhura reale, para 1868-ës.<sup>210</sup> Ngjashëm, pikëpamja tradicionale ishte se prodhimi agrikulturor u rrit veçse ngadalë nën Tokugava-n. Por tashmë është bërë e qartë se të dhënat tradicionale për prodhimin e drithit kanë qenë rezultat i një paragjykimi konservativ. Studime të fundit tregojnë për një rritje domethënëse në prodhimin agrikulturor gjatë pjesës më të madhe të periudhës së Tokuga-

<sup>208</sup> Eric L. Jones, *Growth Recurring* (Oxford: Clarendon Press, 1988), fq. 153; Christopher Howe, *The Origins of Japanese Trade Supremacy* (Bathurst, New South Wales: Crawford House Publishing, 1996), fq. 49.

<sup>209</sup> J. I. Nakamura dhe M. Miyamoto, "Social Structure and Population Change: a Comparative Study of Tokugawa Japan and Ch'ing China", *Economic Development and Cultural Change* 30 (2) (1982), 263-265.

<sup>210</sup> Susan Hanley dhe Kozo Yamamura, *Economic and Demographic Change in Pre-Industrial Japan, 1600-1868* (Princeton: Princeton University Press, 1977), kapitujt 5-7.

va-s, në mos në të gjithën.<sup>211</sup> Rritjet në prodhueshmërinë e tokës u atribuohen një sërë risive, si plehëruesit komercialë, një numri në rritje të varieteteve bimore (sidomos të orizit), përdorimi i gjerë i kanaleve ujitëse dhe shndërrimi i fushave të thata në orizore, përdorimi në rritje i specializimit (domethënë, çlirim nga nevoja për të kultivuar bimë joekonomike), përzgjedhja e farave, korret e shumëfishta e shumë të tjera.<sup>212</sup>

Një argument konvencional pohon se vetëm gjatë periudhës Meixhi u rrëzuan bastionet e vjetra të feudalizmit – *daimjo*-t (aristokracia) dhe *samurai*-t (vasalët ushtarakë). Por kjo ishte vetëm fundi i një sërë politikash të nisura nën Tokugava-n, politika të cilat e bënë këtë përfundim një fakt të kryer. Gërryerja e bazës së pushtetit të *daimjo*-ve dhe *samurai*-ve nisi që gjatë gjysmës së parë të shekullit të shtatëmbëdhjetë. *Daimjo*-t u detyruan të banonin në kryeqytet (Edo) dhe qëllimi i sundimitarit ishte që t’ua gërryente pushtetin duke i ngarkuar me borxhe të mëdha personale. Këtu vlen të vihet në dukje se kjo strategji ngjan me atë të sundimtarëve europianë kur këta ndërmorën politikat e tyre për centralizimin e shtetit.<sup>213</sup> Këto politika arritën t’ua zvogëlonin autonominë lokale *daimjo*-ve dhe, si rrjedhojë, ta rrëzonin feudalizmin.<sup>214</sup> Aq shumë ishin zhytur në borxhe *daimjo*-t në fund të periudhës Tokugava, sa shumica ishin veçse të kënaqur që shteti Meixhi t’ua merrte pronat (kundrejt faljes së borxheve). Shkurt, reformat Meixhi ishin thjesht skaji fundor i një procesi të gjatë shtetformimi ‘racional’ të ndërmarrë në periudhën Tokugava.

<sup>211</sup> Hanley dhe Yamamura, *Economic and Demographic Change*, fq. 69-78.

<sup>212</sup> Thomas C. Smith, *The Agrarian Origins of Modern Japan* (Stanford: Stanford University Press, 1959), kapitulli 7.

<sup>213</sup> Norbert Elias, *The Court Society* (Oxford: Blackwell, 1983).

<sup>214</sup> Shinzaburo Oishi, “The Bakuhan System”, te Chie Nakane dhe Shinzaburo Oishi (red.), *Tokugawa Japan* (Tokyo: Tokyo University Press, 1990), fq. 11-36.

Shteti Tokugava gjithashtu u përpoq ta minonte push-tetin e *samurai*-ve duke i detyruar të banonin në qytet-kësh-tjella. Zhvillimi i shpejtë i këtyre qyteteve pati një efekt të madh shumëzues komercial, duke sjellë përparime në agri-kulturë, të nevojshme për të ushqyer popullsinë në rritje. Në fillim të shekullit të nëntëmbëdhjetë, kultivimi në nivel jetik thuhet kishte marrë fund plotësisht dhe tregjet kishin depërtuar deri në fshtatrat më të vegjël. Kjo i detyrohej jo pak shkëputjes së *samurai*-ve nga fshatarësia, duke çuar në konsolidimin e plotë të familjes fshatare si njësi. Në këtë proces, çlirimi i fshatarëve u dha atyre një shtysë të menjë-hershme për të prodhuar më shumë, sidomos duke qenë se shteti po i nxiste në këtë drejtim. Ata filluan të lexonin traj-tesat agrikulturore që po botoheshin (si për shembull *Nogio Zensho* e 1697-ës), për të shtuar dijen, si dhe të prodhonin për tregun. Kjo u bë e mundur nëpërmjet zgjerimit të sipër-faqes për kultivimin e të mbjellave të ujitura, si dhe nëpër-mjet prodhimit në rritje. E gjitha kjo ushqente komer-cializimin e shpejtë të ekonomisë. Dëshmi për këtë përbën fakti se në vitin 1880, 22% e popullsisë japoneze jetonte në qytete, shifër kjo që e tejkalon lehtësisht atë të Europës.<sup>215</sup> Së fundmi, nxitja e një monedhe kombëtare nga qeveria ndih-moi duke i detyruar *daimjo*-t t'i shisnin mallrat e tyre për të mbledhur nga monedha e re (para kësaj *daimjo*-t shtypnin monedhat e tyre). Kjo i dha një shtysë të mëtejshme komer-cializimit dhe krijimit të një tregu të unifikuar kombëtar.

Si përfundim, prirjet centralizuese të shtetit dhe nivelet komerciale e produktive në rritje që i shoqëruan ato, nën-kuptojnë se imazhi konvencional i Japonisë si një shoqëri e prapambetur feudale para 1868-ës është tejet i gabuar. Rezultati përfundimtar që 'një strukturë tejet e elaboruar

<sup>215</sup> Pomeranz, *Great Divergence*, fq. 35.

[burokratike] pushteti ... [që] rezultoi si e lidhur në vetvete, ashtu dhe mjaft elastike për të lejuar një kalim të shpejtë në strategjitë e reja të shtetndërtimit pas kontaktit të dytë me Perëndimin [më 1853].<sup>216</sup> Për më tepër, ky aparat i centralizuar burokratik, gjithnjë e më racional, e hedh poshtë përshkrimin eurocentrik të Japonisë Tokugava si një despotizëm oriental. Në veçanti Eric Jones i paraqet hollësisht të gjitha politikat 'racionale' ekonomike të nxitura nga shteti, të cilat i konsideron jo më pak rationale se ato të zbatuara në Perëndim gjatë asaj periudhe.<sup>217</sup> Prandaj le t'u hedhim një vështrim institucioneve racionalo-kapitaliste që u shfaqën gjatë periudhës së Tokugava-s.

Në mbështetje të tregtisë që po rritej shpejt në Japoni, institucionet e kreditimit për herë të parë u shfaqën gjatë viteve 1630 në Osaka. Në vitet 1640, huadhënësit pranonin depozitime dhe jepnin hua mbi to. Në vitin 1670, atyre që quheshin Grupi i të Dhjetëve (dhjetë financuesit kryesorë në Osaka) u njohën zyrtarisht për të vepruar për qeverinë si dhe për të marrë përgjegjësi për operimin e tregut monetar. Për më tepër, ky grup bankash kishin disa karakteristika të një banke qendrore, duke mbajtur rezerva përfundimtare të sistemit bankar, duke shërbyer si 'huadhënës të zgjidhjes së fundit', si dhe duke ushtruar njëfarë kontrolli mbi tregun e arit dhe të argjendit. Askush nuk mund të hapte një biznes bankar pa marrë miratimin e tyre dhe pa rënë dakord për të respektuar dispozitat e tyre.<sup>218</sup> Ishte një sistem i sofistikuar financiar që ngërthente metoda moderne, si depozitat, parapagimet, skontot dëftesore, çequet, mbitërheqjet, transkasionet ndërvalutore, sigurimet dhe skemat e sigurimeve jetëso-

<sup>216</sup> Johann P. Arnason, *Social Theory and Japanese Experience* (London: Kegan Paul International, 1997), fq. 257.

<sup>217</sup> Jones, *Growth Recurring*, fq. 152-167.

<sup>218</sup> E. S. Crawcour, "The Development of a Credit System in Seventeenth Century Japan", *Journal of Economic History* 20 (3) (1961), 347, 353-354.

re. Nëpërmjet këtij sistemi financoheshin industria dhe agrikultura. Supozimi tradicional se institucionet bankare nuk ekzistonin në zonat rurale dhe se të vetmit huadhënës të pranishëm atje ishin fajdexhinj e jo bankierë, është mjaft i gabuar. Studime të fundit tregojnë se një rrjet i tërë sipërmarrësish financiarë ose bankierësh ruralë qe shfaqur të paktën që në vitet 1830.<sup>219</sup>

Dëshmi të sipikatur për shkallën e përparuar të institucioneve financiare në periudhën e Tokugava-s përbën prania e një tregu për transaksione në avancë.<sup>220</sup> Për t'u shënuar gjithashtu është e para bursë e tillë u krijua nga Doxhima (në Osaka) më 1730. Për krahasim, bursat e avancës në Frankfurt dhe Londër u shfaqën vetëm më 1867 dhe 1877 respektivisht. Për t'u shënuar gjithashtu është se sistemi i ligjit komercial i krijuar gjatë periudhës së Tokugava-s, ishte veçanërisht i sofistikuar për mbulimin e gjerë dhe paanësinë (tregues të një institucioni 'racional'). Transaksionet komerciale kuptoheshin dhe nocionet e kontratës, të faliementit dhe të dallimit midis huave dhe kapitalit bazë ishin veçanërisht mbresëlënëse. Si përfundim, siç shprehen Hanley dhe Yamamura:

përshkrimet e këtyre institucioneve [financiare] ... e shpien lexuesin në përfundimin se çdo ekonomi me të tilla institucione duhet të ketë qenë tejet e komercializuar dhe e zhvilluar. Ajo që është e rëndësishme këtu janë kontributet e këtyre institucioneve në rritjen e tregtisë duke ulur kostot e transaksioneve.<sup>221</sup>

<sup>219</sup> Ronald P. Toby, "Both a Borrower and a Lender Be: from Village Moneylender to Rural Banker in the Tempo Era", te Michael Smitka (red.), *The Japanese Economy in the Tokugawa Era 1600-1868* (New York: Garland, 1998), fq. 325-354.

<sup>220</sup> Ulrike Schaeede, "Forwards and Futures in Tokugawa-Period Japan: a New Perspective on the Dojima Rice Market", *Journal of Banking and Finance* 13 (1989), fq. 487-513.

<sup>221</sup> Hanley dhe Yamamura, *Economic and Demographic Change*, fq. 80.

Një tjetër fushë me rëndësi ekonomike ishte industria. Ndërkohë që prodhimin më të përparuar do t'i duhej të priste periudhën e Meixhi-t, gjatë Tokugava-s kishte shumë shenja 'protoindustrializimi'. Këto industri përfshinin peshkimin, tekstilet, prodhimin e letrës, prodhimin e sakesë dhe të salcës së sojës, punimin e hekurit dhe të metaleve të tjera si dhe përpunimin e produkteve agrikuturore e të detit.<sup>222</sup> Sërish, rëndësia e këtyre zhvillimeve ishte se me ardhjen e shtetit të Meixhi-t, terreni në masë të madhe qe bërë gati, duke e lehtësuar kësioj kalimin në industrializim të plotë.

*Miti i izolacionizmit japonez:  
vazhdimi i tregtisë me jashtë pas 1639-ës*

Ashtu si në analizën që i bëjnë Kinës pas 1434-ës, studiuesit eurocentrikë vënë theks të madh mbi idenë se gjatë shekullit të shtatëmbëdhjetë Japonia u tërhoq dhe u vetëizolua nga tregtia ndërkombëtare me zbatimin nga shteti të politikës së njohur si *sakoku* ('vend i mbyllur') më 1639. Kjo përdoret për të konfirmuar praninë e despotizmit oriental nga njëra anë dhe prapambetjen ekonomike nga ana tjetër, duke patur parasysh se nën regjimin e Tokugava-s ekonomia gjoja gati u tha plotësisht. Në vitin 1639 vetëm holandezët dhe kinezët lejoheshin zyrtarisht të qëndronin në Nagasaki, prej ku importonin prodhime të huaja. Këto importe dhe eksporte mendohet se ishin të papërfillshme. Përgjigja e parë – se ekonomia japoneze nuk u tha aspak gjatë regjimit të Tokugava-s – u dha, me disa detaje kritike, në nënpjesën pararendëse.

Problemi i dytë me këtë ide eurocentrike është se ajo e keqkupton politikën e *sakoku*-t dhe shprehjen 'vend i mby-

<sup>222</sup> David L. Howell, "Proto-Industrial Origins of Japanese Capitalism", *Journal of Asian Studies* 51 (2) (1992), 269-286.

llur' e merr shumë literalisht. Kina pas 1434-ës dhe Japonia pas 1639-ës as nuk u vetëizoluan prej tregtisë ndërkombëtare dhe as ishte ky qëllimi i shtetit japonez. Shteti thjesht u përpoq të rregullonte ose kontrollonte tregtinë e jashtme. Ç'është më e rëndësishmja, regjimi i Tokugava-s në fakt ishte fundamentalisht i përkushtuar për ta mbajtur gjallë tregtinë. Megjithatë, për mendësinë eurocentrike, kjo qasje rregulluese ose monopoliste vjen erë 'merkantilizmi regresiv' (ndonëse studiuesit eurocentrikë merkantilizmin evropian e shohin si një mënyrë racionale për krijimin e një ekonomie kombëtare). Por aspekti kryesor i këtij sistemi nuk ishte përjashtimi i tregtisë në vetvete, por zhdukja e ndikimit të ideve të krishtera katolike (që është edhe arsyeja pse u favorizuan holandezët protestantë kundrejt portugezëve e spanjollëve katolikë).<sup>223</sup> Sidoqoftë, studiuesit eurocentrikë këmbëngulin se tregtia me jashtë ra me shpejtësi dhe u bë e papërfillshme.

Fakti është se përgjatë pjesës më të madhe të shekullit të shtatëmbëdhjetë – përfshirë edhe periudhën pas 1639-ës – sasi të argjendit të eksportuar në Azi nga japonezët e tejkalonin shumë atë që eksportohej nga britanikët, holandezët e portugezët marrë së bashku (siç u shpjegua në kap. 7). Interesante është se, duke ndjekur Satoshi Ikeda-n, Frank vë në dukje se pozitat japoneze dhe europiane kundrejt Azisë dhe sidomos Kinës, ishin analoge. Si Japonia ashtu dhe Europa importonin prodhime industriale nga Azia dhe eksportonin argjend. I vetmi dallim është se japonezët e prodhonin vetë argjendin e tyre, kurse europianët e plaçkisnin nga kolonitë amerikane.<sup>224</sup> Megjithatë, studiuesit eurocentrikë vënë në dukje 'faktin' se më 1668, shteti japonez ndaloi

<sup>223</sup> Oishi, "Bakuhan System", fq. 26-28.

<sup>224</sup> Frank, *ReOrient*, fq. 106.

çdo eksport të argjendit. Por sipas studimeve të fundit, Japonia vazhdoi të eksportonte argjend dhe të tjera metale të çmuara në Kore dhe Kinë përmes ishullit të Cushimës, në sasira që i tejkalonin ato që transportonin më parë nga Nagasaki holandezët e kinezët. Jo më pak domethënës është fakti se kur eksporti i argjendit shteroi në mesin e shekullit të tetëmbëdhjetë, vendin e tij e zuri bakri, që eksportohej në sasi të mëdha e të vazhdueshme.<sup>225</sup> Siç e vë në dukje Satoshi Ikeda në përmbledhjen e gjetjeve të tij në këtë studim të fundit: 'Ky cikël i artikujve japonezë të eksportit qe rezultat i përpjekjes së Bakufu-it (të Tokugava-s) për të ruajtur vlerën totale të tregtisë.'<sup>226</sup>

Ka të dhëna të mëtëjshme se tregtia japoneze vazhdoi edhe pas shpalljes së *sakoku*-t më 1639.<sup>227</sup> Zakonisht mendohet se Japonia ndërmoi një politikë klasike merkantiliste të zëvendësimit të importit me qëllimin për të krijuar industri të ndryshme të brendshme si sheqeri i mëndafshi. Por në fakt, vëllimet e mëdha të importit të mëndafshit nga Kina vazhduan deri në gjysmën e dytë të shekullit të tetëmbëdhjetë. Sasi të konsiderueshme mëndafshi të importuar vinin edhe përmes Koresë (të cilat shpesh e tejkalonin vëllimin që vinte në Nagasaki). Dhe ndërkohë që importi i mëndafshit të papërpunuar u kufizua në shekullin e tetëmbëdhjetë, rroba kineze e aziatiko-juglindore prej mëndafshi vazhduan të importoheshin deri në fund të periudhës së Tokugava-s. Po ashtu, ndërsa prodhimi i brendshëm japonez i sheqerit u fuqizua në gjysmën e parë të shekullit të

<sup>225</sup> Dennis O. Flynn, "Comparing the Tokugawa Shogunate with Hapsburg Spain: Two Silver-based Empires in a Global Setting", te James D. Tracy (red.), *The Political Economy of Merchant Empires* (Cambridge: Cambridge University Press, 1991), fq. 354.

<sup>226</sup> Satoshi Ikeda, "The History of the Capitalist World-System vs. the History of East-Southeast Asia", *Review* 19 (1) (1996), 55, theksimi im me kursiv.

<sup>227</sup> Ikeda, "History", fq. 55-57.

nëntëmbëdhjetë, para kësaj importoheshin sasira të mëdha, por edhe më pas importi i sheqerit nga Kina vazhdoi për të ruajtur marrëdhëniet tregtare me Kinën.

Supozimi i njohur eurocentrik se vetëm holandezët e kinezët lejoheshin të tregtonin me Japoninë, bëhet problematik nga fakti se tregti e konsiderueshme vazhdoi të kryhej me Siamin, Korenë dhe sidomos me Ishujt Rjukju (me autorizimin, në fakt, të shtetit japonez). Kjo lidhej me faktin se Japonia, pasi u nxorr nga sistemi kinez i haraçit më 1557, krijoi sistemin e vet rival të haraçit. Koreja ishte i vetmi shtet që trajtohej si i barabartë. Ishujt Rjukju konsideroheshin si inferiorë dhe holandezët akoma më shumë (shih kap. 7). Tregtarët japonezë zhvillonin tregti të konsiderueshme jozyrtare private, si edhe kontrabandë – çka u bën jehonë zhvillimeve në Kinë pas 1434-ës. Për më tepër, ashtu si sivëllezërit e tyre kinezë pas 1434-ës, shumë tregtarë japonezë pas 1639-ës u zhvendëson në pjesë të tjera të Azisë Juglindore për të vazhduar veprimtarinë e tyre tregtare (proces që ka si vijimësi të natyrshme bartjen e kompanive multinacionale japoneze sot). Në veçanti, tregtarët privatë japonezë e kinezë zhvillonin një tregti të gjallë reciproke në portet e Detit të Kinës Jugore. Kështu që mund ta shohim tashmë se politika japoneze e *sakoku*-t nuk kishte për qëllim kufizimin e tregtisë me botën e jashtme në vetvete, por kufizimin e tregtisë me fuqitë katolike të Europës. Dhe në të dyja këto qëllime, politika në fjalë duket të ketë qenë mjaft e suksesshme. Prandaj në tërësi, pretendimi eurocentrik se amerikani Commodore Perry e hapi ndaj tregtisë botërore Japoninë e mbyllur pas 1853-shit, është problematik, sepse Japonia kishte qenë e hapur ndaj tregtisë globale shumë kohë më parë.

Si përfundim, duket e qartë se Japonia e Tokugava-s nuk ishte një despotizëm oriental që e shtypte rritjen. Pika kritike për t'u vënë në dukje është se ritmet tepër të shpejta

të rritjes ekonomike pas 1868-ës nuk ishin rezultat çudibërës i stimujve dhe ideve perëndimore që arritën papritur në Japoni më 1853. Terreni që përgatitur në masë të konsiderueshme gjatë periudhës së Tokugava-s për sa i përket shtetformimit, ndërtimit të institucioneve kapitaliste dhe krijimit të ekonomisë kapitaliste. Proven përfundimtare këtu ironikisht e jep Angus Maddison, i cili përllorarit se të ardhurat kombëtare të Japonisë më 1820 ishin mjaft të mëdha për t'i dhënë asaj një pozitë të respektueshme në tabelën europiane të ligës së prodhimit të brendshëm bruto.<sup>228</sup>

Së fundmi, nuk kam marrë në konsideratë këtu parashtrimin eurocentrik se Japonia e Meixhi-t pati sukses vetëm ngaqë mori si shembull Perëndimin. Por është ndriçuese të vihet në dukje se, sërish, studime të fundit tregojnë se industrializimi në periudhën e Meixhi-t u nxit në masë të madhe nga dëshira e Japonisë për të rivalizuar dominimin e tregtarëve kinezë në rajon, e jo dhe aq tregtarët perëndimorë.<sup>229</sup> Në qoftë kështu, kjo sugjeron jo vetëm një motiv alternativ si nxitës i industrializimit të Japonisë së Meixhi-t, por më e rëndësishme akoma, mund të jetë një tregues i mundësisë që Japonia ta ketë ndërmarrë një program industrializimi të plotë në mungesë të inkursionit perëndimor. Për më tepër, zhvillimi social i arritur gjatë periudhës së Tokugava-s bart shumëçka që të bën të mendosh se ekonomia e kishte kapacitetin për një zhvillim të vetvetishëm drejt kapitalizmit të plotë.<sup>230</sup> Sido që të jetë, mund të jemi të sigurt se zhvillimi i Japonisë para 1853/1868-ës ka qenë jo vetëm domethënës, por se me përjashtimin e papërfillshëm të *rangaku-t* ose *bangaku-t* ('mësime barbare' nga holandezët), është arritur në mënyrë të pavarur nga ndikimi perëndimor.

<sup>228</sup> Maddison, *Monitoring*, fq. 182-190.

<sup>229</sup> Ikeda, "History", 61.

<sup>230</sup> Norman Jacobs, *The Origins of Capitalism and Eastern Asia* (Hong Kong: Hong Kong University Press, 1958), kapitulli 10.



## **PJESA II**

**Perëndimi qe i fundit:  
globalizimi oriental dhe shpikja  
e botës së krishterë, 500-1498**



## 5. SHPIKJA E BOTËS SË KRISHTERË DHE ORIGINAT LINDORE TË FEUDALIZMIT EUROPIAN, RR. 500-1000

Për arabët ... [Europa Perëndimore] kishte aq pak interes si rajon sa ndërsa dija e tyre gjeografike përmirësohej vazhdimisht mes viteve 700 dhe 1000, 'dija e tyre për Europën nuk u rrit aspak'. Nëse gjeografët arabë nuk u morën fare me Europën, kjo jo për shkak të ndonjë qëndrimi armiqësor, por sepse Europa në atë kohë 'ofronte shumë pak' gjë me interes.

*Carlo Cipolla*

Pika e dobët kryesore metodologjike e librit tim [*The Rise of the West*] është se ... nuk i kushton vëmendjen e duhur lindjes së ... sistemit botëror ... Duke qenë tejet i preokupuar me nocionin e qytetërimit, kam bërë gafë duke mos i dhënë shfaqjes fillestare të një procesi transqytetërimor theksin e vazhdueshëm që meriton.

*William H. McNeill*

Pretendimi që hedh ky kapitull e konfirmon praninë e globalizimit lindor para vitit 1500 (siç u shpalo në pjesën I të këtij libri). Jo vetëm që ngritja e Europës feudale ishte e papërfytyrueshme pa përhapjen e 'kapaciteteve' të ndryshme 'burimore' të përparuara të Lindjes, por në këtë periudhë pati një valë të dendur rrjedhash globale. Sidoqoftë, Europa nuk qe, dhe kurrë nuk ka qenë, thjesht një 'përfituese pasive' e përcjelljeve globale të teknologjive, ideve e burimeve. Në njëfarë mase 'Europa' ka bërë historinë e saj (përmes procesit të identitetformimit). Ky kapitull ka tri pjesë. Në të parën shqyrtohet se si përhapja e ideve dhe teknologjive lindore bëri të mundur revolucionin agrikulturor të mesjetës. Në të dytën shqyrtohen forcat globale të cilat i

dhanë formë sistemit politik e klasor të feudalizmit (ku ishte fundamentalisht e mbërthyer ekonomia). Kurse në pjesën e tretë shqyrtohet konteksti global brenda të cilit u farkëtua identiteti evropian. Kjo është e rëndësishme, jo më së paku ngaqë Katolicizmi bëri të mundur konsolidimin dhe riprodhimin e sistemit ekonomik dhe politik feudal.

### **Forcat globale dhe lindore në ngritjen e ekonomisë feudale të Europës**

Dua të kaloj shpejt mbi teknologjitë ekonomike të revolucionit agrikulturor të mesjetës, kryesisht për dy arsye. Së pari, kontekstet klasore, politike e morale ishin më të rëndësishme për ngritjen e Europës. Së dyti, rrëfimi progresiv i ngritjes së Perëndimit thekson shumë më tepër ngritjen e tregtisë dhe të protokapitalizmit pas vitit 1000 (çka do ta trajtoj shumë më hollësisht në kap. 6).

#### *Përbërësit bazë teknologjike të revolucionit agrikulturor mesjetar*

Shumica e historianëve të ekonomisë bien dakord se qenë një sërë teknologjish të reja agrikulturore që u bënë bashkë për të mundësuar ngritjen e feudalizmit evropian, të cilat përfshijnë mullinjtë me ujë dhe me erë, plugun e rëndë me veshëz, pajimet e reja për kafshët dhe patkoin prej hekuri.<sup>231</sup> Plugu i rëndë qe veçanërisht i rëndësishëm. Para shekullit të shtatë, i vetmi plug që përdornin evropianët ishte 'plugu gërvishtës' mesdhetar, i cili vlente në kushtet e thata të Europës Jugore, duke qenë se funksioni i tij ishte shkruftimi i dheut të thatë për të penguar avullimin, por ishte krejtësisht i padobishëm në Europën Veriperëndimo-

<sup>231</sup> Carlo Cipolla, *Before the Industrial Revolution* (London: Routledge, 1993), fq. 138.

re, ku dherat e njomë nënkuptonin se problemi i kullimit mbetej i pazgjidhur. Prandaj ky rajon kish mbetur i pazhvilluar agrikuturalisht. Përdorimi i plugut të rëndë me veshëz e ndryshoi të gjithë këtë, duke qenë se hapte brazda kullimi.

Por ky plug solli me vete një sërë problemesh të tjera që duheshin zgjidhur para se plugu vetë të mund të përdorej siç duhej. Së pari, gjeneronte nivele shumë të larta fërki mi për shkak të joefikasitetit të veshëzës dhe rrotave të drunjta, qeve të shumta që kërkonte për ta tërhequr (zakonisht katër copë njëherësh). Por qetë ishin të ngadalta, jo veçanërisht efikase dhe shumë të shtrenjta. Me kohë bujqit filluan të përdornin kuajt, të cilët ishin më të fuqishëm dhe rrjedhimisht kërkonin numër më të vogël skuadrash për tërheqjen e plugut. Por për përdorimin e kuajve fillimisht ekzistonin dy pengesa: mbrehja dhe mbrojtja e thundrave të kuajve nga kalbja (në dhera të lagësht). Zgjedha tradicionale (ose zgjedha e 'qafës dhe nënbarkëzës') e cila mbërthehej në brez dhe në qafë ishte tejet joefikase pasi ia merrte frymën kafshës nëse barra ishte shumë e rëndë. Zgjidhja erdhi në formën e 'zgjedhës me kular kali' e cila mbërthehej pas trupit të kalit duke e shmangur qafën. Shumica e historianëve bien dakord se kjo gjë bëri të mundur një katërfishim ose pesëfishim të fuqisë tërheqëse. Megjithatë kuajt nuk mund të përdroreshin në dhë të lagësht pa mbrojtje tek këmbët, duke qenë se lagështia shkaktonte kalbje të thundrës. Ky problem do të zgjidhej vetëm me hyrjen në përdorim të patkojve të hekurt me gozhda. Kësisoj, rreth shekujve të dhjetë e të njëmbëdhjetë, kulari i kuajve dhe patkoi i hekurt me gozhda mundësuan përhapjen e plugut të rëndë në mbarë Europën. Së fundmi, copëza e fundit që e plotëson figurën që roli i mullinjve me ujë dhe atyre me erë (origjinën e të cilëve e diskutoj në kap. 6).

### *Origjinat lindore të ekonomisë feudale europiane*

Ndryshe nga parashtrimi i përgjithshëm eurocentrik se Europa i parapriu krejtësisht zhvillimit të vet, ajo që pretendohet këtu është se disa nga kapërcimet madhore teknologjike ndodhën jashtë Europës dhe më pas mbërritën atje përmes globalizimit lindor. Ajo që bëri Europa që asimilimi i këtyre shpikjeve. Si ndodhi kjo? Siç është vënë në dukje tashmë, kapërcimi më i rëndësishëm që ai i plugut të rëndë. E dimë se plugjet gërvishtës qenë përdorur në Azi dhe në pjesë të Afrikës shumë kohë para kapërcyellit të mijëvjeçarit të parë para erës sonë. Por këto pak ngjanin me plugun e rëndë lërues. Për fat të keq askush nuk e di me siguri ku e ka origjinën ky i fundit, siç bëhet menjëherë e qartë sapo të shqyrtohen librat e shumtë mbi revolucionin agrikuturor mesjetar. Thëniet se 'plugu me gjasë [ose ndoshta] për herë të parë u shfaq në' janë me bollëk. Por më së shumti historianët thjesht shpjegojnë se plugu luajti një 'rol të rëndësishëm' dhe e kalon vendin e origjinës. Për aq sa historianët europianë kanë treguar interes për këtë çështje, shpesh mendohet se sllavët qenë të parët që e zhvilluan plugun rreth vitit 568. Por Lynn White na jep një të dhënë lidhur me këtë: që plugun nuk e shpikën sllavët, por arriti tek ata nga një 'burim i panjohur'.<sup>232</sup> Ajo që dimë është se sllavët filluan ta përdornin plugun e rëndë menjëherë pas pushtimit avar të 567-ës (avarët ishin 'refugjatë' që dolën nga stepa pas krijimit të konfederatës turke në Mongoli dhe në rajonin e Altajit mes viteve 552-565). Duket e pagjasë që kjo të jetë thjesht rastësi. Për fat të keq, shqyrtimi i një literature të gjerë mbi këtë çështje nuk ofron asnjë përfundim lidhur me origjinën lindore apo perëndimore të plugut.

<sup>232</sup> Lynn White, *Medieval Technology and Social Change* (Oxford: Clarendon Press, 1962), fq. 52.

Po patkoi i hekurt dhe kulari? Është e paqartë se kur është shpikur patkoi, por të dhënat rrethore të bëjnë të mendosh se duhet të jetë përdorur nga hunët të paktën që nga shekulli i pestë.<sup>233</sup> Nga romakët nuk është përdorur. Duket se ka hyrë në Europën Lindore nga Lindja (me gjasë nga Siberia) në shekullin e nëntë, ka mbërritur në Bizant në fund të shekullit dhe që atje është përhapur në gjysmën e prapambetur të Europës.<sup>234</sup> Kularin është e qartë se është përdorur për herë të parë nga kinezët në shekullin e tretë p.e.s., përftuar ndoshta nga kapistalli më i hershëm gjoksor (ose 'kapistalli me rrip') i shpikur në Kinën e dinastisë Han rreth vitit 100 p.e.s. Por edhe kapistalli me rrip ishte shumë më efikas se kapistalli perëndimor 'i qafës dhe nënbarkëzës', për çka një autor është shprehur se: 'Një koçi e dinastisë Han ishte si autobus krahasuar me koçinë greke apo romake'.<sup>235</sup> Kësisoj,

ndërsa koçitë egjiptiane, greke apo romake gjithmonë hasen në përmasa minimale, për dy persona maksimumi ... dhe shpesh të tërhequra nga katër kuaj, koçitë kineze shpesh hasen në përmasa të përshtatshme për deri në gjashtë persona ... po ashtu shpesh kanë edhe mbulesa të rënda të harkuara për së larti ... dhe zakonisht tërhiqen nga një kalë i vetëm.<sup>236</sup>

Është e qartë se kapistalli me kular është përcjellë drejt-përdrejt nga Kina.<sup>237</sup>

<sup>233</sup> Haudricourt, cituar te Joseph Needham dhe Wang Ling, *Science and Civilisation in China*, IV (2) (Cambridge: Cambridge University Press, 1965), fq. 137.

<sup>234</sup> James Burke, *Connections* (London: Macmillan, 1978), fq. 63; Hugh Thomas, *An Unfinished History of the World* (London: Papermac, 1995), fq. 90; Clive Ponting, *World History* (London: Chatto and Windus, 2000), fq. 371.

<sup>235</sup> Joseph Needham, te Mansel Davies, *A Selection from the Writings of Joseph Needham* (Lewes, Sussex: The Book Guild, 1990), fq. 148.

<sup>236</sup> Needham dhe Ling, *Science*, IV (2), fq. 313.

<sup>237</sup> Po aty, fq. 319-328.

Kur kësaj i shtojmë faktin se mulliri me erë dhe ai me ujë kishin origjinë lindore (shih kap. 6), tingëllon e arsyeshme të arrijmë në përfundimin se revolucioni agrikulturor mesjetar i Europës nuk ishte një 'lindje virgjërore perëndimore' por në të ka kontribuar mjaft përcjellja globale e teknologjive të ndryshme lindore. Por nëse mjaftohemi me kaq, do të përfundonim me një histori të feudalizmit evropian që e ekzagjeron rëndësinë e teknologjisë ekonomike. Ama, në fakt, ka patur një sërë faktorësh të tjerë më të rëndësishëm, të cilëve do t'u kthehem tani.

### **Dimensionet ushtarake dhe klasore të feudalizmit: konteksti lindor**

Një ekonomi kurrë nuk është thjesht një grumbull teknologjish ekonomike. Ekonomia feudale europiane ishte thellësisht e mbërthyer brenda sistemeve klasore dhe politiko-ushtarake, të cilat nga ana e tyre ishin fundamentalisht të mbërthyera brenda strukturës morale e normative. Në shekullin e tetë qe shfaqur një mënyrë e re luftimi (kalorësia goditëse), e cila luajti një rol të rëndësishëm në krijimin e strukturës institucionale të shtetit dhe ekonomisë feudale. Kjo varej nga shpikja e yzengjive më herët.<sup>238</sup> Para yzengjive, kuajt ishin joefikasë në betejë pasi kalorësi nuk kishte asgjë ku mund të mbahej fort i lidhur pas kalit. Kësisoj, një goditje me heshtë mund të jepej vetëm me forcën e vetë kalorësit. Kurse yzengjitë bënë të mundur që kalorësi të godiste me tërë forcën e kalit. Në këtë mënyrë, forca e brishtë e muskulit njerëzor u zëvendësua me forcën superiore të kafshës, duke i dhënë mundësinë kalorësisë goditëse të çante si një autobus përmes këmbësorëve.

<sup>238</sup> White, *Medieval Technology*, kapitulli 1; Marc Bloch, *Feudal Society*, I (Chicago: Chicago University Press, 1961), fq. 153.

Studiuesit eurocentristë shpikjen e yzengjisë zakonisht ia atribuojnë Charles Martel-it në vitin 733, por duket qartë se ideja bazë e yzengjisë, ku kalorësi vinte vetëm gishtin e madh të këmbës, është shfaqur për herë të parë në Indi (në shekullin e dytë para erës sonë). Rreth vitit 100 e.s. në Indi në Veriore (ku klima ishte më e ftohtë dhe prandaj nuk e lejonte kalorësin të kalëronte këmbëzbathur) këmba me çizme mbërthehej me tokëza, ndonëse kjo mund të ishte tejet e rrezikshme pasi një kalorës i rënë nga kali do të tërhiqej zvarrë. Zhvillimi kritik këtu që shpikja e yzengjive kineze prej bronzi dhe hekuri të derdhur në shekullin e tretë të erës sonë. Në vitin 477 këto yzengji përdorshin gjerësisht në tërë Kinën.<sup>239</sup> Që atje u përhapën përmes Rrugës së Mëndafshit tek popujt e Azisë së Mesme dhe duket të kenë arrihur në Persi në shekullin e shtatë. Në veçanti yzengjitë u përcollën nga fisi i avarëve kur këta u shtynë në Perëndim për t'u vendosur mes Danubit dhe Tisës. Në vitin 694 arabët prodhonin yzengji prej hekuri para se kjo shpikje të përhapet drejt Perëndimit përmes vikingëve e lombardëve.<sup>240</sup> Prandaj, supozimi i rëndomtë se shumë të rëndësishmen yzengji e ka shpikur Charles Martel-i rreth vitit 733, nuk mund të qëndrojë.

Megjithatë, një përgjigje mund të jetë se edhe pse nuk është ai që e ka shpikur yzengjinë, Martel-i me siguri është pionieri i kalorësisë 'së re' goditëse. Që Martel-i është shpikësi kryesor i kësaj në kontekstin 'europian' ngjan një pohim i kënaqshëm. Por fakti është se pionierët e kalorësisë goditëse janë persët (si dhe bizantinët). Muslimanët arabë shpejt u ndeshën me këtë lloj kalorësie në betejat e tyre me

<sup>239</sup> Joseph Needham, Ho Ping-Yü, Lu Gwei-Djen dhe Wang Ling, *Science and Civilisation in China*, V (7) (Cambridge: Cambridge University Press, 1986), fq. 17.

<sup>240</sup> E. M. Jope, "Vehicles and Harness", te Charles Singer, E. J. Holmyard, A. R. Hall dhe T. I. Williams (red.), *A History of Technology*, II (Oxford: Clarendon Press, 1956), fq. 556-557; White, *Medieval Technology*, fq. 14-20.

persët dhe gjatë periudhës pas vitit 640 (gati një shekull para 'shpikjes' së Martel-it), kalorësia goditëse u bë një element thelbësor i ushtrive muslimane. Vlen të vihet në dukje se kalorësia luftarake për herë të parë u përdor nga asirianët diku rreth fillimit të mijëvjeçarit të parë p.e.s. (ndonëse kalorësit gjuanin shigjeta dhe nuk kishin yzengji). Është gjithashtu interesante, në mos domethënëse, të vihet re se shumë nga armët të cilat i bashkëshoqërojmë me Europën mesjetare, si harku i gjatë, topuzi dhe heshta kalorësiake, janë shfaqur së pari të gjitha në Lindjen e Mesme.<sup>241</sup> Veç kësaj, ushtritë muslimane vunë në përdorim teknologji superiore ushtarake për shumë shekuj me radhë, shumë prej të cilave u kopjuan apo asimiluan nga europianët (shih kap. 8). Është e qartë pra se Martel-i nuk ka shpikur as yzengjinë, as kalorësinë goditëse.

Si ndodhi që kalorësia goditëse mundësoi ngritjen e sistemit politik feudal? Problemi kryesor me mënyrën e re kalorësiake të të luftuarit ishte kostoja e saj. Kjo bëri të detyrueshëm krijimin e një ekonomie ku prodhimet e tepërta agrikulturore mund thitheshin ose të konfiskoheshin nga fshatarët. Kësisoj monarkët ua dhanë tokat e tyre të populluara me fshatarë kalorësve (ose vasalëve) me lirinë për t'i shfrytëzuar fshatarët. Në këtë mënyrë lindi një klasë e fuqishme e cila e konsolidoi pushtetin e saj si mbi fshatarësinë, ashtu dhe, ironikisht, mbi sundimtarët. Kështu lindi sistemi socio-politik feudal. Por a qe e gjitha kjo një përgjigje ndaj problemeve ushtarake që u shfaqën brenda Europës, apo pati një dimension global të rëndësishëm?

Valët e dendura të migrimeve aziatike paraqitën shumë sfida ushtarake për Europën. Për më tepër, ndërsa kishte migrime të shumëfishta drejt Europës, ato në vetvete ishin

<sup>241</sup> Ahmad Y. al-Hassan dhe Donald R. Hill, *Islamic Technology* (Cambridge: Cambridge University Press, 1986), fq. 95-120.

rezultat i një zhvendosjeje të shkaktuar nga behja e popujve të ndryshëm lindorë. Së pari në vitin 370 hunët përparuan nga Azia si rezultat i trazirave ushtarake që shkolinin deri në Kinë. Depërtimi i tyre në Europë qe dramatik, duke shkaktuar një zhvendosje masive të popujve gjermanë në Europë e përtej. Ostrogotët u dyndën në Itali, vizigotët në Spanjë (deri më 711), frankët në Gali, anglët dhe saksonët në Angli. Avarët u dyndën në Europë në vitin 567 në përpjekje për të plaçkitur sa territor të mundnin. Ia vunë syrin veçanërisht hungarisë dhe pasi e shfarosën fisin e gepidëve, i detyruan lombardët t'ia mbathnin drejt jugut. Sulmet e tyre vazhduan deri në shekullin pasues. Siç na tregon McNeill:

Këto sulme provokuan dy ndryshime të qëndrueshme etnike: pushtimin e Italisë nga lombardët (568), të cilët i nxorrën bizantinët nga brendia e gadishullit; dhe tërheqjen e fshatarësive greqisht e latinishtfolëse të Ballkanit në zona malore ose bregdetare ku mund të gjenin strehim. Vendin e tyre e zunë sllavët të cilët ushqeheshin nëpërmjet një lloji agrikulture primitive nomade.<sup>242</sup>

Gjatë shekullit të nëntë, Perandoria e Shenjtë Romake (e cila filloi më 800 me kurorëzimin e Karlit të Madh si perandor i shenjtë romak) nisi të shpërbëhej. Kjo shpërbërje ndodhi kur një tjetër valë migrimesh globale vërshoi në Europë. Muslimanët sulmuan nga bazat e tyre në Afrikën Veriore dhe u vendosën në Sicili e Sardenjë e madje në vitin 846 mësynë Romën. Ç'është më e rëndësishme (ndonëse më pak domethënëse nga pikëpamja kulturore), magjarët u dyndën nga lindja dhe pushtuan Hungarinë e sotme duke bërë kërdrinë në një pjesë të madhe të Europës. Ata goditën Holandën e sotme, jugun e Francës dhe Gjermaninë. Kapakun e

<sup>242</sup> William H. McNeill, *The Rise of the West* (Chicago: Chicago University Press, 1963), fq. 485.

vunë mësymjet e ndryshme vikinge në Europë. Si rezultat i gjithë këtyre migrameve (shumica e të cilave vinin nga lindja), përbërja etnike e Europës u rimodelua në linja të tjera.

Ç'lidhje ka e gjitha kjo me sistemin politik feudal? Tashmë mund ta shohim se krijimi i një sistemi politik feudal nuk qe thjesht rezultat i teknologjive të reja (kryesisht yzengjija) që u përhapën nga Lindja, por qe edhe një përgjigje ndaj sfidave të shumta ushtarake globale që përfshinë Europën nga Lindja mes viteve 370 dhe rreth 1000. Por gjithashtu është e rëndësishme të vihet në dukje se institucionet politike dhe ushtarake ishin të ndërthurura brenda strukturës klasore feudale. Sepse fisnikëve dhe aristokratëve iu njoh pjesërisht kontrolli mbi fshatarët në mënyrë që të mund të nxirrnin prej tyre një tepricë për luftën. Por fisnikëve nuk iu desh shumë kohë që ta konsolidonin kontrollin mbi fshatarët dhe sundimtarët. Kontrata sociale e njohur si *feud* ishte veçanërisht e rëndësishme. Ndryshe nga *beneficija* e mëparshme, e cila ishte një kontratë e përjetshme midis sundimtarëve dhe fisnikëve, feudi ishte i trashëgueshëm kështu që nga njëra anë garantonte vazhdimësinë e linjës së fisnikërisë dhe nga ana tjetër u jepte fisnikëve pushtet të konsiderueshëm mbi sundimtarët. Kësisoj, sovraniteti u 'parcelizua' në nivelin e lokalitetit feudal (çifligu i fshatit), dhe fisnikët nisën të gëzonin pushtet të konsiderueshëm politik.<sup>243</sup>

Për ta përmbledhur. Sistemi feudal u krijua nga një përzierje komplekse forcash teknologjike, etnike, klasore, ushtarake e politike dhe në secilin rast ka patur një dimesion të rëndësishëm global apo lindor. Por ka edhe një faktor tjetër që lipset diskutuar para se ta përfundojmë trajtimin mbi ngritjen e ekonomisë agrikulturore mesjetare të Europës Pe-

<sup>243</sup> Perry Anderson, *Lineages of the Absolutist State* (London: Verso, 1979).

rëndimore. Pasi sfidat ushtarake kishin nisur të shuheshin rreth vitit 1000, problemi kryesor vërtitej rreth nevojës për t'i dhënë një pamje legjitime ekonomisë, duke qenë se konsistonte në një marrëdhënie tejet të pabarabartë sociale midis fisnikërisë dhe fshatarësisë. Kësisoj, pasi paqja u kthye dhe fisnikët nuk mund ta përligjinin më tej shfrytëzimin e fshatarëve me arsyetimin se u ofronin mbrojtje ushtarake, sistemi në mënyrë të pashmangshme do ta humbte legjitimitetin. Kështu që shfrytëzimit të fshatarësisë duhej t'i jepet një pamje 'e natyrshme'. Kjo lidhej ngushtë me procesin përmes të cilit u ndërtua apo u shpik identiteti evropian. Si u arrit kjo?

### **Shpikja e identitetit të botës së krishterë në kontekstin global**

#### *Formimi ose shpikja e 'rrezikut islamik'*

Është jetike të kuptohet se procesi i identitetformimit është i thjeshtë dhe kompleks në të njëjtën kohë. Thjeshtësia vjen nga fakti se 'vetja' (domethënë ajo që do të përkufizohet si 'ne') në të vërtetë nuk ekziston. Europa nuk ishte një tërësi e harmonishme, por ishte e përçarë me konflikte të thella të brendshme, midis fshatarëve e fisnikëve, fisnikëve e sundimtarëve, sundimtarëve e klerikëve, sundimtarëve e papës, papës e perandorëve të shenjtë romakë.<sup>244</sup> Kështu që nuk mund të flitej për homogjenitet të brendshëm. E vetmja mënyrë për të formuar një identitet përbashkues është të krijosh një 'tjetër' të jashtëm kundrejt të cilit do të formohet 'vetja' homogjene. Që do të thotë, meqë nuk kishte një 'vete' të vetme, do të ishte më e lehtë që kjo të përkufizohej me atë që nuk ishte. Është jetike të vihet në dukje se vetja dhe tjetri janë thjesht paraqitje ose sajime bazuar mbi atë se si

<sup>244</sup> Norbert Elias, *The Civilizing Process* (Oxford: Blackwell, 1994); Hendrik Spruyt, *The Sovereign State and its Competitors* (Princeton: Princeton University Press, 1994).

do të donim ta shihnim 'veten' dhe 'ata'. Në kontekstin mesjetar 'vetja' përfaqësonte gjithçka të mirë e të drejtë, kurse 'tjetri' u sajua si e kundërta e saj e ligë dhe e padëshirueshme. Kësisoj, puna e parë ishte të gjendej e të sajohet një tjetër imagjinar. Kush do të ishte ky? Duke qenë se prelatët e krishterë u bënë aktorët kyç në formimin e identitetit evropian, si kandidat të përshtatshëm ata zgjodhën Islamin. Por Islami duhej paraqitur jo vetëm si i lig, por edhe si rrezik, në mënyrë që evropianët të bashkoheshin kundër tij. Siç e ka vënë në dukje në mënyrë origjinale Maxime Rodinson, 'muslimanët ishin një kërcënim për botën e krishterë perëndimore shumë kohë para se të bëheshin problem'.<sup>245</sup>

Por si u sajua Islami si një rrezik i lig? Para së gjithash, përkundër gjithë retorikës, ngritja e Islamit qe një nxitës për mitbërësit evropianë. Islami menjëherë u dënua nga të krishterët si një fe idhujtare pagane (edhe pse dy fetë kanë shumë ngjashmëri thelbësore). Kjo u legjitimua duke i bërë jehonë historisë së Zanafillës për Noen dhe tre bijtë e tij, ku Jafetit iu dha 'Europa e krishterë e destinuar për t'u zgjeruar', kurse Shemit iu dha Azia 'e populluar nga paganët' (domethënë, të pabesët) të destinuar për t'u përthithur nga Jafeti. Kjo vlejti veçanërisht për t'u dhënë mundësinë komisionerëve kyç të krishterë të pushtetit për ta përfaqësuar Islamin në përgjithësi dhe Muhammedin në veçanti si mishërim të ligësisë pagane. Papa Inocenti III do ta cilësonte atë si 'Bisha e Apokalipsit'.<sup>246</sup>

Përpyekja për ta denigruar Muhammedin arriti kulmin në 'Ferrin' e Dantes, ku autori endet në thellësitë e ferrit

<sup>245</sup> Maxime Rodinson, "The Western Image and Western Studies of Islam", te Joseph Schacht dhe C. E. Bosworth (red.), *The Legacy of Islam* (London: Oxford University Press, 1974), fq. 9.

<sup>246</sup> Shih, veçanërisht, R. W. Southern, *Western Views on Islam in the Middle Ages* (Cambridge: Mass.: Harvard University Press, 1962); Rana Kabbani, *Europe's Myth of the Orient* (Bloomington: Indiana University Press, 1986), kapitulli 1.

(me nëntë rrahtë gjithnjë e më të thellë. Sa më i keq të ketë qenë një person në jetë, aq më i thellë edhe rrethi ku është flakur. Dante e takon Muhammedin në rrethin e tetë, thuajse në fund. Të vetmit njerëz poshtë Muhammedit janë më tradhtarët që ka njohur bota, si Judë Iskarioti e Bruti, njerëzit e fundit para se Dante të arrijë në fund ku qëndron Djalli. Veç kësaj, siç e vë në dukje Edward Said në lidhje me pjesën përkatëse në libër:

Dënimi i Muhammedit, që është edhe fati i tij i përjetshëm, është veçanërisht krupëndjellës: ai çahet përgjithmonë më dysh nga mjekra deri në fund, si një vozë që i shqyhen dërrasat, siç shprehet Dante. Në këtë pikë, vargjet e Dantes nuk i kursejnë lexuesit asgjë nga detajet eskatologjike që bart një ndëshkim i tillë.<sup>247</sup>

Por është interesant fakti se Dante nuk i ka hedhur në ferr filozofët muslimanë, meqë vetë ishte mjaft i ndikuar nga shkrimet e tyre,<sup>248</sup> por i ka vënë në zonën e mesme të purgatorit. Më përgjithësisht, siç e vë në dukje Rana Kabbani: 'Islami u pa si mohim i Krishterimit, kurse Muhammedi si mashtrues, si një epshor i lig, një Antikrisht në aleancë me Djallin. Bota islame u pa si një Antieuropë.'<sup>249</sup>

Ky proces shpikjeje kërkonte dinakëri të madhe për shumë arsye. Së pari, është fakt se Islami dhe Krishterimi kanë shumëçka të përbashkët. Muslimanët dhe të krishterët besojnë në të njëjtin Zot të vetëm. Ndërkohë që muslimanët e konsiderojnë Muhammedin si profet të madh të Zotit, ata megjithatë e pranojnë Jezusin si një profet të rëndësishëm dhe e toleronin me kënaqësi praninë e të krishterëve në mesin e tyre. Po ashtu, të dyja fetë kanë marrë nga traditat ju-

<sup>247</sup> Edward W. Said, *Orientalism* (London: Penguin, 1991 [1978]), fq. 68.

<sup>248</sup> Philip K. Hitti, *History of the Arabs* (London: Macmillan, 1937), fq. 114, 459, 586, 613.

<sup>249</sup> Kabbani, *Europe's Myth*, fq. 5.

daike e helenike: 'Arabishtja dhe hebraishtja janë gjuhë semitike dhe të dyja rregullojnë dhe rirregullojnë materiale me rëndësi thelbësore për Krishterimin'.<sup>250</sup> Për më tepër, të dyja fetë e shpien origjinën e tyre tek Abrahami. Ajo që duam të themi është se ngjashmëritë e thella midis dy feve mund të kishin shërbyer si urë për të prodhuar një marrëdhënie të harmonishme midis botës së krishterë dhe Lindjes së Mesme. Por elitat europiane zgjodhën të merrnin një rrugë që i çoi në shtypjen e muslimanëve për të prodhuar artificialisht një 'Vete' homogjene europiane.

Mënyra e dytë se si Islami u portretizua si një rrezik i brendshëm, qe sajimi i një lloj 'teorie dominoje' islamike. Kjo teori ishte sa e thjeshtë, aq edhe komplekse: e thjeshtë sepse Islami i përmbahet nocionit universalist të *xhihad*-it (ndonëse ky i fundit u keqinterpretua qëllimisht) dhe ishte komplekse, ironikisht, ngaqë kërkonte finesë të madhe sepse, po të kishin dashur, me gjasë muslimanët *do mund* ta kishin pushtuar gjysmën e prapambetur të Europës. Por ata zgjodhën të mos e bënin këtë. Kjo pikëpamje, sigurisht, bie ndesh me pretendimin e zakonshëm eurocentrik se po të mos kish qenë për zbrapsjen e 'pushtimit' musliman më 733 (jo 732) në Tours dhe Poitiers nga heroi Charles Martel, Europa do të ish pushtuar. Dhe siç na shpjegon Edward Gibbon, po të kish ndodhur kjo:

Ndoshta sot ekzgejeza kur'anore do të mësohej në shkollat e Oxford-it, nga katedrat e të cilave do t'u shpjegohej synetlinjve shenjtëria dhe e vërteta e revelatës së Muhammedit. Nga të tilla mynxyra botën e krishterë e shpëtoi gjenialiteti dhe fati i një njeriu.<sup>251</sup>

<sup>250</sup> Said, *Orientalism*, fq. 74.

<sup>251</sup> Edward Gibbon, *The Decline and Fall of the Roman Empire*, II (New York: The Modern Library, 1931), fq. 801.

Por në historitë muslimane të kohës, Beteja e Tours-it dhe Poitiers-it si dhe figura e Charles Martel-it përmenden shumë pak. Vëmendje shumë më e madhe i kushtohet disfatës së arabëve në Konstandinopojë (718). Fakti është që muslimanët nuk i mundi forca e kalorësiso goditëse të Martel-it, por joshja me sukses e të ashtuquajturve pushtues drejt një fortëse ku ushtria e tij derdhi një rrebesh shigjetash e shtizash mbi sulmuesit. Ç'është më e rëndësishme, nuk bëhej fjalë për ndonjë 'pushtim islamik', por për një grup të vogël mësymësish në një inkursion të vogël (që kishte si shënjestër faltoren e pasur të Shën Martin). Siç shpjegon Bernard Lewis:

Vështirë të dyshohet se duke e shpërfillur Poitiers-in [dhe Tours-in] e duke theksuar Konstandinopojën, historianët muslimanë nuk i kanë parë ngjarjet nga një këndvështrim më realist se historianët e mëvonshëm perëndimorë, Ngadhnyesit frankë në Poitiers nuk u ndeshën veçse me një bandë inkursionistësh [muslimanë] që vepronin përtej kufijve të tyre më të largët, mijra milje larg atdheut të tyre ... Qe dështimi i ushtrisë arabe në pushtimin e Konstandinopojës, dhe jo mundja e një njësie inkursioni në Tours dhe Poitiers ajo që e bëri botën e krishterë lindore dhe perëndimore të mbijetonte.<sup>252</sup>

Kësisoj, pasi muslimanët kishin shtënë në dorë pjesë të ndryshme të 'Europës Perëndimore', mbi të gjitha Spanjën dhe Sicilinë, realiteti ishte se nuk kishin ndonjë interes për të shkuar më tej. Arsyeja ishte e thjeshtë: pjesa perëndimore e Europës ishte e prapambetur dhe pa interes për ta. Bizanti ishte edhe më i fuqishëm, edhe më joshës. Siç e ka vënë në dukje në mënyrë origjinale Marc Bloch, nga të gjithë 'armiqtë e Europës Perëndimore, Islami me siguri ishte më

<sup>252</sup> Bernard Lewis, *The Muslim Discovery of Europe* (London: Phoenix, 1994), fq. 19-20; gjithashtu McNeill, *Rise*, fq. 469.

pak i rrezikshmi ... Për një kohë të gjatë, as Galia dhe as Italia, me qytetet e tyre të varfra, nuk kishin asgjë që t'i afrohej shkëlqimit të Bagdadit ose Kordovës.<sup>253</sup> Në fakt, valët e shumta migruese që kishin vërshuar në Europë, kishin bërë kërدينë shumë më tepër sesa inkursionet e rralla të muslimanëve. Por mitbërësit europianë zgjodhën ta ekzagjeronin 'rrezikun universal' të Islamit me qëllimin për ta çimentuar identitetin e ri europian si 'Mbrotjtëse e Besimit të Vetëm të Vërtetë' (domethënë, e Krishterimit).

Prelatët e krishterë u përpoqën të sajnin një lloj 'teorie dominoje islamike'. Ashtu siç teoria e dominosë e sajuar nga Shtetet e Bashkuara pas 1947-ës lidhej me shpikjen e 'rrezikut sovjetik' që duhej përmbajtur, edhe prelatët e krishterë të mesjetës e panë me rëndësi jetike që Europa të konsolidohej e të forcohej si një 'ledh mbrotjtës' kundër të ashtuquajturit 'rrezik islamik' universal. Kësisoj, deklarata si ajo e peshkopëve të Rheims-it (në Trosly, më 909) shpallehin vazhdimisht:

Ajo që po shihni është zemërimi i Zotit që ka shpërthyer ... Nuk të zë syri veçse qytete të zbrazura nga banorët, manastire të bëra rrafsh me tokën ose të djegura, fusha të shkretuara ... Kudo i forti e shtyp të dobëtin dhe njerëzit janë bërë si peshqit në det që verbërisht gllabërojnë njëritjetrin.<sup>254</sup>

Strategjia e përmbajtjes do ta gjente shprehjen e saj më të qartë në 'raundin e parë' të kryqëzatave mes viteve 1095 dhe 1291. Siç e vë në dukje Maxime Rodinson,

imazhi i Islamit nuk u përvijua nga kryqëzatat, siç pretendojnë disa, por nga uniteti ideologjik i botës së krishterë latine i zhvilluar gradualisht. Kjo prodhoi një imazh

<sup>253</sup> Bloch, *Feudal Society*, I, fq. 3.

<sup>254</sup> Po aty.

më të mprehtë të tipareve të armikut dhe i përqendroi energjitë e Perëndimit tek kryqëzatat.<sup>255</sup>

Ironikisht, fisnikët iu përgjigjën thirrjes së papës Urban II për grumbullim si ‘kalorës të Krishtit’ (*milites Christi*), të elektrizuar nga ideja se nëse vdisnin në betejë, do të bëheshin martirë të Krishtit e do të shpërbleheshin bujarisht me një biletë për parajsë.<sup>256</sup>

### *Shpikja e botës së krishterë*

Pasi Islami u sajua kësisoj si një ‘rrezik i lig’, mbetej të farkëtohej një identitet për gjysmën e prapambetur të Europës. Është me rëndësi të vihet në dukje se nuk ka diçka që mund të quhet Europë, po të nisemi nga ideja se një tërësi e tillë ekziston në një hapësirë të mirëpërkufizuar gjeografike. S’ka asgjë të natyrshme për sa i përket Europës. Europa gjithmonë ka qenë një ide, diçka e ndërtuar dhe e rindërtuar vazhdimisht (siç do ta shohim përgjatë këtij libri). Ajo është përkufizuar dhe ripërkufizuar jo sipas një rezultat shkencor apo objektiv i ndryshimit të rrethanave apo kufijve gjeografikë, por sipas një përkufizimi moral që i ripërcakton kufijtë gjeografikë të asaj çka përbën Europën në çdo pikë në kohë. Në fund fare, një përkufizim i tillë moral ngrihet mbi atë se si ‘europianët’ dëshirojnë ta përfytyrojnë veten. Atëbotë, si e krijoi vetveten Europa kundrejt tjetrit islamik?

Gjëja e parë që duhet vënë në dukje këtu është se vetja europiane u farkëtua në një kontekst global. Europa filloi të njihet si ‘botë e krishterë’ sepse identiteti i saj u përfytyrua ose u krijua si i krishterë katolik kundrejt Lindjes së Mesme islame. Kjo shënoi fazën e parë të identitetformimit europi-

<sup>255</sup> Maxime Rodinson, *Europe and the Mystique of Islam* (London: I. B. Tauris, 1987), fq. 7.

<sup>256</sup> Jonathan Riley-Smith, *The First Crusade and the Idea of Crusading* (London: Athlone Press, 1986), veçanërisht kapitulli 1.

an që do të vazhdonte deri në shekullin e gjashtëmbëdhjetë (ndonëse mund të hasen përmendje të *respublica christiana* deri në shekullin e tetëmbëdhjetë). Që Europa si botë e krishterë ishte një 'ide', pasqyrohet në faktin se Krishterimi në origjinë është një fe lindore. Prandaj paraqitja e Europës si vendlindja apo 'mbrojtësja' e besimit të krishterë detyrimisht kërkonte ndoca akrobaci të mëdha intelektuale për ta bërë lidhjen midis Europës dhe Krishterimit të dukej si diçka e lëmuar dhe e natyrshme. Risjellja në kujtesë e historisë së Zanafillës për tre djemtë e Noes ishte e rëndësishme pasi nëpërmjet saj Islami paraqitej si fe pagane, kurse Jafeti (Europa) si i krishterë. Veç kësaj, siç e vë në dukje Mudimbe, 'nuk duhet harruar se që nga lindja e tij, Krishterimi [europian] e ka përvetësuar si rrugën e vetme për të komunikuar me hyjnore, ashtu dhe të vetmin imazh të drejtë të Zotit dhe të madhësisë së Zotit'.<sup>257</sup> Dhe siç e vë në dukje Robert Holton:

Krishterimi zuri fill në Lindjen e Mesme, e jo në Europë, por pastaj u perëndimizua e europianizua. Aq sukses pati kjo, sa [Krishterimi] u bë ledhi i 'qytetërimit perëndimor' kundër Islamit gjatë kryqëzatave. Sërish, një fenomen joperëndimor përvetësohet nga elementë të fuqishëm brenda Perëndimit në ngritje, si pjesë e mënyrës së tij të dallueshme të të jetuarit.<sup>258</sup>

Kështu, Europa u paraqit si burimi i Krishterimit, misioni i së cilës do të ishte përhapja e mesazhit universal të kësaj feje në mbarë botën për t'i gjunjëzuar 'të pabesët paganë'. Nga ana tjetër, krijimi i Europës si botë e krishterë që parakushti jetik për të krjuar rend dhe për t'i dhënë legjitimitet sistemit tejet të pabarabartë ekonomikopolitik feudal. Si u arrit kjo?

<sup>257</sup> V. Y. Mudimbe, *The Invention of Africa* (Indianapolis: Indiana University Press, 1988), fq. 57.

<sup>258</sup> Robert J. Holton, *Globalization and the Nation-State* (London: Macmillan, 1998), fq. 32.

### *Farkëtimi i rendit dhe i legjitimitetit*

Kodi i ri moral i krishterë që do t'i jepte legjitimitet strukturës së padrejtë ekonomiko-politike feudale, u njoh si 'dekreti i tre urdhrave', ose çka Georges Duby e quante 'tri-funksionalitet'.<sup>259</sup> Kjo e plotësonte por edhe e zgjeronte nocionin ekzistues të 'paqes dhe paktit të Zotit' për të cilin kanë folur Marc Bloch dhe të tjerë.<sup>260</sup> Dekreti u hartua nga një grup i pushtetshëm prelatësh në shekullin e njëmbëdhjetë. Ai shpallte se Zoti i ka caktuar tri detyra të ndryshme njerëzimit. Këto ishin, sipas radhës, lutja për shpëtimin e të gjithëve (priftërinjtë dhe peshkopët); lufta për mbrojtjen e të gjithëve (kalorësit ose fisnikët) dhe; të punuarit për të ofruar burimet e nevojshme për mbështetjen e dy grupeve të para (fshatarët). Ishte jetike që këta të fundit t'u shërbenin fisnikëve pasi këta kishin për detyrë të mbronin klerin. Këtë e diktonte besimi se,

është vullneti i Krijuesit në Qiell e në Tokë që të lartët përjetë të sundojnë mbi të ulëtit. Çdo individ e çdo klasë duhet të mbajë vendin e vet, të kryejë detyrat e veta e të gëzojë privilegjet dhe të drejtat që i takojnë ... Të ngresh krye ndaj këtij rendi është mëkat i rëndë.<sup>261</sup>

Shkurt, ishte veçse 'vullneti i Zotit' që fshatarët t'u shërbejnë fisnikëve dhe priftërinjve. Në këtë mënyrë, Katolicizmi dhe krjimi i botës së krishterë u shërbente dy funksioneve jetike sociale: së pari, të krijonin një koncept koherent të vetes kundrejt tjetrit (që ishte Islami) për të bërë të mundur një unitet dhe harmoni relative brenda Europës dhe, së dyti, pa Dekretin e Tre Urdhrave, sistemi ekonomik feudal thuajse me siguri do të kishte shpërthyer.

<sup>259</sup> Georges Duby, *The Three Orders: Feudal Society Imagined* (Chicago: Chicago University Press, 1980).

<sup>260</sup> Marc Bloch, *Feudal Society*, II (Chicago: Chicago University Press, 1961), fq. 412-420.

<sup>261</sup> Gerd Tellenbach, *Church, State and Christian Society at the Time of the Investiture Conflict* (Oxford: Blackwell, 1959), fq. 39.

Në këtë mënyrë, hierarkia qiellore u bart në hierarkinë sociale feudale. Për më tepër, veprimtaritë ushtarake dhe identiteti imponues i kalorësit u përshkruan si legjitimë, duke qenë se as Kisha dhe as masat nuk mund të vetëmbroheshin. Këto parime të reja morale qenë burimi i vetëm më i rëndësishëm që i dha mundësinë fisnikërisë të mbahej në një pozitë pushteti mbi fshatarësinë nga njëra anë dhe mbi sundimtarët laikë nga ana tjetër. Më lart e vumë në dukje se si institucioni i feudit siguronte jo vetëm vazhdimësinë fisnikërore të familjeve, por i shërbente edhe konsolidimit të pushtetit të kësaj klase mbi sundimtarët. Pika kritike këtu është se një nga faktorët që legjitimuan feudin që Dekreti i Tre Urdhrave. Veç kësaj, dekreti i ri i rivendoste të drejtat feudale mbi fshatarësinë (të cilët qenë zhvendosur nëpër mbarë kontinentin gjatë kaosit në shekujt kur dyndjet aziatike kishin përfshirë Europën). Kjo u arrit nëpërmjet imazheve të ferrit që i priste nëse nuk do t'i bindeshin 'vullnetit të Zotit'.

Përfundimisht, e gjithë kjo u bë e mundur ngaqë Kisha Katolike kishte monopolin mbi hirin e shpëtimit. Ajo mund ta shpinte besimtarin në parajsë ose, nëpërmjet çkishërimit, mund të degdiste në ferr. Rreth fundit të shekullit të trembëdhjetë, imazhet e ferrit të përshkruar nga Dante ishin aq të fuqishme, sa shkelja e kodit të krishterë në sytë e masave bartte një fat më të keq se vdekja (domethënë, dënimin e përjetshëm). Për më tepër, në një epokë kur nuk kishte shtete formale, kjo rezultoi një mënyrë efikase për të siguruar bindje dhe njëfarë rendi relativ. Besimi se nuk ka shpëtim jashtë Kishës (*extra ecclesiam nulla salus*), pranohej universalisht.<sup>262</sup> Mënyra kryesore se si Kisha prekte zemrat dhe mendjet e fshatarësisë, ishte përmes administrimit të rre-

<sup>262</sup> Michael Mann, *The Sources of Social Power*, I (Cambridge: Cambridge University Press, 1986), fq. 381 e në vijim.

gullt të kungimit nga priftërinjtë. Përmes Dekretit të Tre Urdhrave, Krishterimi mundej ta paraqiste marrëdhënien tejet të pabarabartë midis fshatarësisë dhe fisnikëve si krejtësisht 'të natyrshme'. Aq e suksesshme ishte kjo, sa do të kish qenë tejet e vështirë për fshatarësinë që të përfytyronin një rend të ndryshëm social (çka do të kish qenë sakrilegj me përkufizim). Në këtë mënyrë, krijimi i identitetit evropian, farkëtuar në një kontekst global, qe jetik për konsolidimin dhe riprodhimin e feudalizmit mesjetar.

### Konkluzion

Ky kapitull ka treguar se shumica e elementeve kritike që përbënin shoqërinë feudale europiane në fillim të mijëvjeçarit të dytë, në masë të madhe u formuan nga forca lindore. Për më tepër, formimi i një identiteti kolektiv evropian u realizua brenda një konteksti global. Me fjalë të tjera, 'qytetërimi perëndimor lindi nga takimi midis barbarëve evropianë dhe qytetërimeve të mëdha të Lindjes'.<sup>263</sup> Megjithatë, përshtypja që mbetet deri këtu është se në Europë mbizotëronte një ekonomi feudale ose rurale, 'e bazuar në sigurimin e jetesës'. Por më e rëndësishme në rrëfimin progresiv të ngritjes së Perëndimit qe rigjallërimi i tregtisë diku pas 750-ës. Jo më pak të rëndësishme qenë një sërë minirevolucionesh 'protokapitaliste'. Kjo pjesë e historisë zakonisht i atribuohet 'gjenialitetit' të pionierëve italianë. Por siç e shtjellon kapitulli 6, italianët nuk ishin pionierët gjenialë të kapitalizmit që mendojnë studiuesit eurocentristë, sepse pas Italisë qëndronte Lindja si më e përparuar.

<sup>263</sup> Thomas H. Greer dhe Gavin Lewis, *A Brief History of the Western World* (New York: Harcourt, Brace Jovanovich, 1992), fq. 45; krahaso, Gerard Delanty, *Inventing Europe* (London: Macmillan, 1995), fq. 26.

## 6. MITI I PIONIERËVE ITALIANË, 1000-1492

Venecianët, pizanët dhe gjenovezët vinin të gjithë, herë si mësymës ... herë si udhëtarë që përpiqeshin të ngadhnjenin mbi Islamit me mallrat që sillnin ... kurse tani çdokush prej tyre sjell në viset tona armët e tij të luftës dhe na ofron më të mirën e asaj që bën dhe trashëgon ... [Sepse tashmë kemi vendosur një komunikim dhe kushte] të dëshirueshme për ne e të urryera për ta, që neve na shkojnë për shtat e atyre jo.

*Salahuddin Ejubi, 1174*

Kush është kryezot i Malakkës ia ka vënë duart në fyt Venecias

*Tomé Pires*

Rritja e një ekonomie tregu masive në Kinë gjatë shekullit të njëmbëdhjetë mund të ketë mjaftuar për ta ndryshuar balancën botërore [kundër] komandës dhe [në drejtim të] sjelljes së tregut në një mënyrë tejet kritike ... dhe me përhapjen e sekreteve teknike të kinezëve jashtë Kinës, mundësi të reja u hapën në pjesët e tjera të Botës së Vjetër, në mënyrën më të spikatur në Europën Perëndimore.

*William H. McNeill*

Studiuesit eurocentristë i kushtojnë rëndësi të veçantë revolucionit tregtar 'të pas 1000-ës' (megjithëse, siç e pamë në kap. 2, ky rigjallërim në fakt filloi në periudhën pas 750-ës), si dhe revolucioneve lundrimore e financiare. Na thuhet se pas gjithë këtyre kapërcimeve qëndron gjenialiteti i pionierëve italianë. Siç shprehet një studiues: 'Edhe sot e kësaj dite është e pamundur të gjendet diçka – si për shembull taksa mbi të ardhurat – që të mos ketë patur njëfarë

precedenti në ndonjë nga republikat italiane'.<sup>264</sup> Po ashtu, narrativat eurocentriste për 'fuqitë udhëheqëse' në botë në periudhën pas 1000-ës shpesh fillojnë me Venecian.<sup>265</sup>

Ky kapitull arsyeton se imazhi i 'pionierit italian' s'është veçse një mit. Italia e fitoi fuqinë e saj ekonomike duke e vendosur veten brenda një ekonomie globale që ekzistonte tashmë, të krijuar e të mirëmbajtur nga fuqitë madhore të Lindjes (kap. 2-4). Italia nuk e gjeti botën dhe e ndryshoi, por bota më e përparuar lindore e gjeti Italinë dhe bëri të mundur ngritjen e zhvillimin e saj. Pretendimi im kryesor është se thujse të gjitha shpikjet madhore që qëndrojnë pas zhvillimit të kapitalizmit italian, u përfytuan nga Lindja më e përparuar, sidomos nga Lindja e Mesme dhe Kina, duke u përhapur përmes Urës Islame të Botës nëpërmjet globalizmit lindor. Për më tepër, teksta vërtet ishte në krye në nënkontinentin inferior ose të prapambetur evropian, Italia megjithatë ishte një lojtare e vogël në arenën globale, e cila gjithnjë i binte violinës së dytë për shtetet dhe tregtarët më të përparuar muslimanë të Lindjes së Mesme e veçanërisht të Afrikës Veriore.

### **Tregtia e Lindjes si elementi i pestë në 'revolucionet' institucionale e teknologjike europiane të mesjetës së mesme**

Historianët eurocentristë tipikisht e shohin ngritjen e Europës pas vitit 1000 në kuadër të një ekonomie ose qytetërimi rajonal të mëvetshëm ose autonom. Veçanërisht qytetet konsiderohen të kenë qenë 'autoqefale': 'qyteti mesjetar ... i cili, si majaja mes një brumi të madh, solli ngritjen e

<sup>264</sup> Armando Saponi, cituar te Fernand Braudel, *Civilization and Capitalism, 15th-18th Century*, III (Berkeley: University of California Press, 1992), fq. 91.

<sup>265</sup> Për shembull, Charles Kindleberger, *World Economic Primacy, 1500-1990* (New York: Oxford University Press, 1996).

Europës'.<sup>266</sup> Në narrativën konvencionale, shumimit të qyteteve i atribuohen veti thujse 'magjike'. Supozohet se me mbarimin e përçarjeve të brendshme që e kishin rrënuar Europën mes viteve 370-1000, rendi i brendshëm që doli së andejmi detyrimisht siguroi zhvillimin e qyteteve dhe të tregtisë. Nën këtë pretendim qëndron ideja se 'njeriu evropian' për nga natyra është ekonomikisht racional dhe se në kushtet e duhura (në paqe dhe nën qeveri minimaliste *laissez-faire*) ngrihet dhe natyrshëm bën atë që di të bëjë më mirë, tregtinë. Sepse, siç na tregon Adam Smith, është në natyrën njerëzore të 'këmbejë diçka me një tjetër'.<sup>267</sup> Atëherë këtu kemi një nga supozimet klasike eurocentrike: që 'liria perëndimore' ka bërë të mundur zhvillimin kapitalist ose komercial, e shprehur më së miri në frazën e zakonshme mesjetare *Stadt luft Macht Frei* (ajri i qytetit të bën të lirë), ose *Westen Stadt luft Macht Frei* (ajri i qytetit perëndimor të bën të lirë).

Veçanërisht i çuditshëm brenda kontekstit eurocentrik është koncepti i shumëpërdorur i 'tregtisë së largët'. Është i çuditshëm sepse ndërsa në njërin skaj të këtij filli qëndronte Europa, nuk është gjithmonë e qartë se ç'qëndronte në skajin tjetër. Dhe zakonisht harrohet se jo vetëm që në skajin tjetër ishte Lindja, por se kjo e fundit luajti një rol kritik në ngritjen e tregtisë europiane. Sepse tregtia europiane në fund të fundit u bë e mundur vetëm nëpërmjet vërshimit të mallrave lindorë që hynë në Europë përmes Italisë. Së dyti, shumë 'kapacitete burimore' lindore, si ide, institucione e teknologji, nga Lindja e Mesme dhe Kina, arritën në Itali dhe Europë kryesisht përgjatë arterieve tregtare të ekonomisë globale (kurse disa u mësuan gjatë kryqëzatave).

<sup>266</sup> Braudel, *Civilization*, III, fq. 94.

<sup>267</sup> Adam Smith, *The Wealth of Nations* (New York: The Modern Library, 1937 [1776]), fq. 13.

Gjithsesi, kjo nuk do të thotë se Italia ishte e parëndësishme për fatet e tregtisë, financave e prodhimit europian. Në fakt kishte rëndësi qendrore. Por kjo vetëm ngaqë Italia ishte një nga përcjellësit kryesorë përmes të cilit 'burimet' (jo vetëm tregtia) lindore hynë në Europë dhe e riformuan atë.

Siç e pamë në kap. 2, nga fundi i shekullit të tetë Italia u lidh me nënsisteme të ndryshme të ekonomisë globale, që përfshinte Europën, Afrikën dhe Azinë. Kjo i dha Italisë një privilegj të pashoq. Meqë e kam trajtuar këtë deri diku hollësisht në kapitullin 2, do të mjaftohem duke vënë në dukje se qe pikëhyrja e drejtpërdrejtë e Italisë në ekonominë fitimprurëse globale afro-aziatike ajo që siguroi fatin e saj. Siç e vë në dukje Abu-Lughod:

Ky depërtim i drejtpërdrejtë në pasuritë e Lindjes ua ndryshoi rolin qyteteve detaro-tregtare të Italisë nga pasive në aktive. Ringjallja e panairëve të Champagne-ës në shekullin e dymbëdhjetë mund të shpjegohet bindshëm si me kërkesën e rritur për mallra lindore, të stimuluar nga kryqëzatat, ashtu dhe me sasinë në rritje të këtyre mallrave që pozitat strategjike të italianëve në enklavat bregdetare të Levantit mund të ofronin.<sup>268</sup>

Venecia përfundimisht triumfoi kundrejt rivales së saj, Gjenovës, jo falë të ashtuquajturës zotësi të saj, por falë aksesit të saj fitimprurës në Lindje përmes Egjiptit dhe Lindjes së Mesme. Braudel e konfirmon këtë përmes një pyetjeje retorike:

A mund të shpjegohet [kryesimi i Venecias brenda Europës] me lidhjet e saj të preferuara (dhe tradicionale) me Lindjen, ndërkohë që qytetet e tjera italiane ishin më të interesuara me botën perëndimore e cila në atë kohë po

<sup>268</sup> Janet L. Abu-Lughod, *Before European Hegemony* (Oxford: Oxford University Press, 1989), fq. 108; Andre Wink, *Al-Hind: the Making of the Indo-Islamic World*, I (Leiden: E. J. Brill, 1995), fq. 35-38.

merrte formë ngadalë? ... Gjaku jetëdhënës i tregtisë veneciane ishte lidhja me Levantin. Nëse Venecia duket të jetë një rast i veçantë, kjo sepse e gjithë veprimtaria e saj tregtare nga A-ja gjer te Z-ja diktohej nga Levanti.<sup>269</sup>

Shkurt, ndërsa italianët luajtën një rol të rëndësishëm në përhapjen e komercializimit në mbarë botën e krishterë, ata nuk ishin prionierët e mëdhenj komercialë siç i portretizon eurocentrizmi. Siç u vu në dukje në kapitullin 2, ata në çdo kohë ishin të varur nga kushtet e vëna nga muslimanët e Lindjes së Mesme deri më 1291 dhe nga ata të Egjiptit pas-këtaj. Por në fund fare, roli më i rëndësishëm që patën lidhjet tregtare të Italisë me Lindjen e Mesme dhe më vonë me Egjiptin, qe se këto rrugë tregtare shërbyen si një nga kanalet përgjatë së cilave 'kapacitetet burimore' jetike të Lindjes u përhapën për të fertilizuar Perëndimin e prapambetur. Këto kapacitete burimore mundësuan revolucionet e ndryshme ekonomike e lundrimore 'italiane' për çka këta të fundit kanë gëzuar një famë të pajustificueshme.

### *Originat lindore të revolucionit financiar*

Zakonisht supozohet se italianët u kanë paraprirë një sërë institucionesh financiare. Siç na thuhet, shpikja më e rëndësishme qe *commenda* (ose *collegantia*), gjoja e shpikur nga italianët rreth shekullit të njëmbëdhjetë.<sup>270</sup> Kjo ishte një lloj marrëveshjeje kontraktuale ku investitori financonte ekspeditën e një tregtari. Kjo metodë jo vetëm e stimuloi tregtinë ndërkombëtare duke bërë bashkë kapitalin dhe 'krahun punëtor tregtar', por pati efekte të ngjashme edhe në krijimin e një burse, duke ofruar një treg për kursimet i cili nga ana e tij u fryu flakëve të zhvillimit ekonomik. Por

<sup>269</sup> Braudel, *Civilization*, III, fq. 128, 132.

<sup>270</sup> Po aty, fq. 129-30; Douglass North dhe Robert Thomas, *The Rise of the Western World* (Cambridge: Cambridge University Press, 1973), fq. 53.

*commenda* është shpikur në Lindjen e Mesme. Dhe ndonëse rrënjët e saj shkojnë deri në kohërat paraislamike,<sup>271</sup> ajo u zhvillua më tej nga tregtarët e hershëm muslimanë.<sup>272</sup> Siç e vë në dukje Abraham Udovitch, 'është forma islame e kësaj kontrate (*kirâd, mukârada, mudaraba*) që përbën shembullin më të hershëm të një ujdje komerciale identike me institucionin ekonomik e ligjor që [shumë më vonë] do të njihej në Europë si *commenda*'.<sup>273</sup> Kjo vështirë se mund të konsiderohet si zbuluesë, meqë vetë Muhammedi kish qenë një tregtar *commenda*. Po ashtu s'ka pse të përbëjë çudi që italianët nisën ta përdornin këtë institucion duke patur parasysh se Italia ishte e lidhur drejtpërdrejt me sistemin tregtar arab. Gjithashtu vlen të vihet në dukje se duke filluar nga shekulli i tetë, *kirad*-i në Islam është përdorur edhe në kreditim e prodhim, e jo vetëm në tregti.<sup>274</sup>

Italianëve po ashtu gabimisht u atribuohet edhe zbulimi i një sërë institucionesh të tjera financiare, përfshirë kambialin, institucionet e kreditimit, të siguracioneve dhe bankare. Fakti është se të gjitha këto institucione u përfytuan ose nga Lindja e Mesme islamike, ose nga Lindja e Mesme paraislamike, sepse 'shumë teknika biznesi ishin ngulitur fort para se të kodifikoheshin nga Kur'ani'.<sup>275</sup> Sumerët dhe persët sasanidë i kanë përdorur bankat, kambialët dhe çeqet para shfaqjes së Islamit, ndonëse qenë muslimanët ata

<sup>271</sup> M. J. Kister, "Mecca and Tamim", *Journal of the Economic and Social History of the Orient* 8 (1965), 117 e më poshtë.

<sup>272</sup> Jack Goody, *The East in the West* (Cambridge: Cambridge University Press, 1996), fq. 58.

<sup>273</sup> Abraham L. Udovitch, "Commercial Techniques in Early Medieval Islamic Trade", te D. S. Richards (red.), *Islam and the Trade of Asia* (Oxford: Bruno Cassirer, 1970), fq. 48.

<sup>274</sup> Abraham L. Udovitch, *Partnership and Profit in Medieval Islam* (Princeton: Princeton University Press, 1970), fq. 78; S. D. Goitein, *A Mediterranean Society*, I (Berkeley: University of California Press, 1967), fq. 362-367.

<sup>275</sup> Abu-Lughod, *Hegemony*, fq. 216.

që i çuan më tej këto fillime të hershme. Ironikisht, njëra nga arsytet për këtë ka të bëjë me nevojën e kapitalistëve muslimanë për ta shmangur ndalimin e kamatës. Për shembull, pagesat shpesh vonoheshin deri në dy muaj a më shumë me qëllimin për ta fshehur kamatën nëpërmjet pagimit të një çmimi më të lartë (çka i bënte të nevojshme këto institucione).<sup>276</sup> Bankierët muslimanë ishin një fenomen i zakonshëm, ashtu si dhe valutëkëmbyesit, dhe vetë bankat hynin në marrëveshje të tipit *commenda* për të dhënë para ose hua kundrejt fitimit. Bankat shërbenin si një përcjellës jetik për tregtinë ndërkombëtare, duke i transferuar fondet nga një vend në tjetrin. Bankierët jepnin dëftesa – ‘dëftesëpagesa’ – ose kambialë për një vend të largët (*suftexhe*) si dhe ‘urdhër për pagesë’ (*havâle*) që ishte e njëjta gjë me çekun e sotëm. Siç e vë në dukje Abu-Lughod lidhur me *havâla*-në: ‘Në cepin e sipërm të majtë shkruhej shuma që duhej paguar (me shifra), kurse në cepin e poshtëm të majtë shkruhej data dhe emri i paguesit’.<sup>277</sup> Dhe siç e vë në dukje autorja në fjalë në po atë faqe, dëftesëpagesa ishte në fakt me origjinë persiane, dhe kish qenë në përdorim shumë shekuj para se të përdorej në Europë.

Së fundmi, italianëve zakonisht u atribuohet zbulimi i sistemeve të përparuara të kontabilitetit. Por shumë sisteme të ndryshme lindore kontabiliteti ishin gjithashtu të mirëzhvilluara, sidomos në Lindjen e Mesme, Indi dhe, mbi të gjitha, në Kinë.<sup>278</sup> Disa prej këtyre sistemeve me gjasë ishin po aq efikase sa edhe metoda perëndimore e ‘regjistrimit të dyfishtë’ e ngritur në qiell prej Weber-it. Por vlen të vihet në dukje se në Perëndim, kontabiliteti me një shënim ishte

<sup>276</sup> Goitein, *Mediterranean Society*, I, fq. 197-199; Udovitch, “Commercial Techniques”, fq. 61-62.

<sup>277</sup> Abu-Lughod, *Hegemony*, fq. 223.

<sup>278</sup> Goody, *East*, fq. 79; Abu-Lughod, *Hegemony*, fq. 224.

metoda më e përhapur, e përdorur deri në fund të shekullit të nëntëmbëdhjetë.<sup>279</sup> Dhe siç do ta shohim në kapitullin 8, tregtarët italianë filluan ta përdornin matematikën në vend të sistemit të vjetër të abakusit vetëm pasi tregtari nga Piza Leonardo Ficonacci e përcolli këtë dije lindore më 1202. Si përfundim, mund ta mbyllim këtu me fjalët me vend të Jack Goody-t:

Ajo që shohim në Itali ishte në thelb një ringjallje, rigjallërim ose rikrijim [i institucioneve] që kishin ekzistuar në forma të ndryshme të Lindjes e Afërt ... Ndërsa llogaritë e thesarit, llogaritë tregtare, financat e tregut nga panairët e Champagne-ës deri tek bankat më të qëndrueshme, dokumentet financiare dhe partneritetet tregtare si *commenda* dhe kompanitë me aksione, qenë të rëndësishme për zhvillimin [e ardhshëm] të kapitalizmit industrial, të gjitha këto kishin ndodhur ndërkohë në pjesë të tjera të botës.<sup>280</sup>

### *Originat lindore të revolucionit lundrimor*

Revolucioni lundrimor u bazua mbi astrolabin dhe busullën, velën trekëndore, fletën fundore të timonit dhe trupi drejtkëndor i anijeve (si dhe sistemet me tri direkë dhe metodat e reja të lundrimit, të cilat i trajtoj në kap. 7). Vela trekëndore, e cila varej nga një shulicë në një kënd prej 45 gradësh me direkun, mund të lëvizet sipas drejtimit të erës. Ishte një shpikje jetike pasi, ndryshe nga vela katërkëndore, u mundësonte anijeve të drejtoheshin kundër erës. Një problem madhor me të cilin përballej tregtia detare europiane, ishte ai i përmasave të anijeve, që e kufizonte ngarkesën e transportueshme. Kapërcimi teknologjik jetik në këtë

<sup>279</sup> Kenneth Pomeranz, *The Great Divergence* (Princeton: Princeton University Press, 2000), fq. 168-169; Goody, *East*, fq. 75.

<sup>280</sup> Goody, *East*, fq. 68, 72.

pikë që fleta fundore e timonit (shekulli i trembëdhjetë), e cila duke u montuar mbi një kiç të drejtë ose drejtkëndor, lejonte ndërtimin e anijeve shumë më të mëdha, duke e shumëfishuar hapësirën e ngarkesës. Kufizimi në lundrim impononin edhe hartat portolane të cilat, ndonëse të mjaftueshme për lundrim në Europë, ishin shumë kaba për lundrim oqeanik. Këtë problem e zgjidhi astrolabi (një mjet që lejon përcaktimin e pozicionit sipas yjeve). Po ashtu, shpikja e busullës nuk që më pak e rëndësishme, sepse mund të përdorej edhe në mot me re (domethënë, kur yjet nuk duken). Kjo bëri të mundur zgjatjen e stinës së lundrimit nga gjashtë muaj në tërë vitin, duke e dyfishuar numrin e udhëtimeve. Këto kapërcime u dhanë mundësinë europianëve që të kuturisnin në oqean. Por sado të suksesshme qenë këto shpikje në kontekstin europian, fakti është se shumica e tyre u shpikën dhe të gjitha u përsosën në Lindje.

Astrolabi për herë të parë u shfaq në Greqinë e lashtë, ndonëse detajet për të nuk kanë qenë kurrë të qarta dhe përmendjet e tij janë gjithnjë e më të largëta mes tyre. Por qenë muslimanët ata që i bënë të gjitha shpikjet madhore, të cilat mund të gjurmohen pas me gjasë tek el-Fazariu në mesin e shekullit të tetë (dhe jo tek Masha'allahu, siç është pretenduar ndonjëherë). Në shekullin e nëntë, astrolabi prodhohej rregullisht, dhe në mesin e shekullit të dhjetë arriti në Europë përmes Spanjës islame.<sup>281</sup> Teksti më i vjetër në latinisht për astrolabin, *Sententie astrolabi* (nga Spanja Veriore e fundit të shekullit të dhjetë) mbështetet fuqishëm në tekste të ndryshme islamike, përfshirë edhe trajtesën e el-Khwarezmiut mbi astrolabin.<sup>282</sup> Por po aq mbresëlënëse ishin për-

<sup>281</sup> Emile Savage-Smith, "Celestial Mapping", te J. Brian Harley dhe David Woodward (red.), *History of Cartography*, II (1) (Chicago: Chicago University Press, 1992), fq. 12-70; Paul Kunitzsch, *The Arabs and the Stars* (Northampton: Variorum, 1989), kapitujt 8, 10.

<sup>282</sup> Kunitzsch, *Arabs*, kapitulli 9.

sosjet e shumta të bëra nga astronomë të ndryshëm muslimanë, të cilat bënë të mundur përdorimin e rregullt të astrolabit nga europianët e mëvonshëm (shih kap. 8).

Busulla e marinarit u përdor për herë të parë në kontekstin evropian më 1185. Por nuk mund të jetë shpikur nga italianët, apo nga çfarëdo evropianësh të tjerë, për faktin e thjeshtë se është krejt e qartë se është përdorur në anijet kineze rreth vitit 1090.<sup>283</sup> Por edhe kjo ka qenë thjesht kulminacion i një sërë shpikjesh kineze që shkojnë pas deri në vitin 83 të erës sonë kur u shpikën kompasët e parë kaba dhe madje deri në shekullin e katërt para erës sonë kur u shpikën kompasët akoma më kaba me magnet. Italianët vetëm sa e huazuan busullën, e cila qe përhapur nga Kina deri në Europën e prapambetur përmes muslimanëve.<sup>284</sup> Me zhvillimin e teknikave të lundrimit do të merrem në kap. 7, por këtu do të shqyrtoj origjinat e teknologjive të reja të anijendërtimit, duke filluar me pretendimin e Lynn White se vela trekëndore e ka origjinën në Europë.

Para së gjithash, pavarësisht faktit se ndoshta kurrë nuk do ta dimë kush e shpiku i pari velën trekëndore, Lynn White (duke ndjekur Lionel Casson-in) këmbëngul se e kanë shpikur romakët. Ky pretendim bazohet në dy piktura varkash me vela trekëndore (njëra mbi një gurr vari të shekullit të dytë, kurse tjetra në një mozaik të shekullit të katërt).<sup>285</sup> Së dyti, megjithëse White e pranon se asnjë anije e madhe europiane nuk ka patur velë trekëndore para shekullit të gjashtë, ai me të drejtë e shpjegon këtë duke vënë në

<sup>283</sup> Joseph Needham, Wang Ling dhe Lu Gwei-Djen, *Science and Civilisation in China*, IV (3) (Cambridge: Cambridge University Press, 1971), fq. 554-584; Hans Breuer, *Columbus was Chinese* (New York: Herder and Herder, 1972), fq. 83-102.

<sup>284</sup> George F. Hourani, *Arab Seafaring in the Indian Ocean in Ancient and Early Medieval Times* (Beirut: Khayats, 1963), fq. 108-109.

<sup>285</sup> Lionel Casson, *Ships and Seamanship in the Ancient World* (Princeton: Princeton University Press, 1971), fq. 243-245 dhe figurat 181, 182.

dukje se përdorimi i velës trekëndore në anije të mëdha kërkon eksperimentim të madh dhe përsosje të modelit. Ajo që nënkuptohet është se europianët po merreshin me përsosjen e velës trekëndore gjatë katër shekujve para vitit 533. Më tutje White vë në dukje dy të dhëna që sugjerojnë përdorimin e saj në anijet europiane në shekullin e gjashtë. E para është përmendja e shkurtër në biografinë e Shën Cezarit të Arlesit; e dyta është interpretimi që i bën Jules Sottas fjalëve të Procopius-it, të cilat gjoja përbëjnë një konfirmim të fuqishëm se vela trekëndore është përdorur në tri anije të mëdha romako-lindore në vitin 533.<sup>286</sup> Së treti, krahas shumë të tjerëve, White pretendon se rasti tjetër i përdorimit të kësaj vele haset në Mesdhe rreth vitit 880. Së katërti dhe së fundmi, White e përmbyll duke thënë se karavela portugeze që anija nga e morën këtë shpikje muslimanët (të cilët për herë të parë e përdorën vetëm në shekullin e gjashtëmbëdhjetë).<sup>287</sup> Le t'u përgjigjem me radhë këtyre pretendimeve (ndonëse do t'ia nis me të fundit).

Së pari, referenca në biografinë e Shën Cezarit të Arlesit (cituar për herë të parë nga Jal në vitin 1848) për të vërtetuar përdorimin e velës trekëndore nga europianët në shekullin e gjashtë, është vënë në pikëpyetje nga H. H. Brindley.<sup>288</sup> Pasazhi origjinal i cituar nga Cezari sipas Brindley-it nuk është veçse një aludim: 'tres naves, quas Latenas vocant, majores, plenas tritico direxerunt'. Supozimi është se cilësimi i këtyre tri anijeve me grurë si 'latines' do të thotë se kishin vela trekëndore. Po ashtu ka arsye për ta vënë në pikëpyetje interpretimin e fjalëve të Procopius-it se tri anije

<sup>286</sup> Jules Sottas, "An Early Lateen Sail in the Mediterranean", *The Mariner's Mirror* 25 (1939), 229-230.

<sup>287</sup> Diskutimi rezultues është nga Lynn White, *Medieval Religion and Technology* (Berkeley: University of California Press, 1978), fq. 255-260.

<sup>288</sup> H. H. Brindley, "Early Pictures of Lateen Sails", *The Mariner's Mirror* 12 (1) (1926), 9-10.

të flotës së Justinianit në vitin 533 kishin vela trekëndore. Procopius-i në fakt thotë se admirali i flotës 'dha urdhër që tri anijet që bartnin oficerët e komandës kryesore ta kishin një të tretën e këndin të sipërm të velës të lyer me të kuqe'. Siç vë në dukje Richard Bowen, 'nga fjala "kënd" Sottas-i menjëherë nxjerr përfundimin se anijet kishin vela trekëndore'.<sup>289</sup> Përveç faktit të dukshëm se është anormale pse nuk kishin të tilla vela të gjitha anijet, në po atë faqe Bowen nxjerr përfundimin se, 'duket më e logjikshme ... që velat trekëndore kanë të bëjnë me velat e sipërme trekëndore, që ishin një pajisje standarde në anijet romake me vela katërkëndore pas vitit 50 të erës sonë'. Të vihet re se velat e sipërme trekëndore viheshin horizontalisht, e jo vertikalisht, dhe nuk funksiononin si velë kryesore.

Së dyti, pretendimi i White-it, se vela trekëndore është përdorur në një anije europiane në vitin 880, është problematik. Kjo skicë e famshme, e zbuluar për herë të parë nga Jal në vitin 1848, sipas Brindley-it është, 'aq e përkryer, sa e vë në pikëpyetje origjinalitetin e saj; në këtë aspekt nuk duket aspak si një punim i shekullit të nëntë'.<sup>290</sup> Ç'është më e rëndësishme, por jo befasuese, Brindley vërteton se data është e gabuar (duke qenë se referenca origjinale e ekspozuar në Bibliotheque Nationale, edhe pse i përket shekullit të nëntë, është për një mbret të lashtë, e jo për një anije me velë trekëndore).

Së treti, pretendimi i White-it se qenë portugezët ata që ua kaluan velën trekëndore muslimanëve në fund të shekullit të pesëmbëdhjetë, nuk mund të jetë i saktë. Dimë (siç është trajtuar në kap. 2) se persët kanë lundruar deri në Indi e përtej përmes Gjirit Persik duke filluar nga shekujt e tretë

<sup>289</sup> Richard LeBaron Bowen, *Arab Dhows of Eastern Arabia* (Rehoboth, Mass.: publikuar privatisht, 1949), fq. 7, n. 9.

<sup>290</sup> Brindley, "Early Pictures", 9.

e të katërt. Po ashtu, në mesin e shekullit të shtatë muslimanët lundronin në tërë gjatësinë e Oqeanit Indian. Por do të kishte qenë e pamundur për anijet perse e arabe që të ktheheshin në vendin e tyre me vela katërkëndore për shkak të erërave mbizotëruese veriore të Gjirit. Kështu që pa velën trekëndore nuk do të kishin ekzistuar anijet mesolindore që i shohim të kenë lundruar në Oqeanin Indian. Dhe me siguri nuk asnjë gjurmë të velës katërkëndore në asnjë anije perse apo arabe të asaj kohe.

Tani le t'i kthehem diskutimit mbi pikturat e Casson-it ku bazohet ekskluzivisht White. Piktura e një anijeje romake me një velë trekëndore e gdhendur mbi një gur varr të shekullit të dytë vihet në pikëpyetje nga Needham, i cili hedh mendimin se mund të bëhet fjalë për një velë katërkëndore.<sup>291</sup> Kurse piktura tjetër e vetme e Casson-it (që daton nga shekulli i katërt) nuk përbën të dhënë përfundimtare për një shpikje romake. Por edhe sikur romakët ta kenë shpikur vërtet velën trekëndore, është me rëndësi të vihet në dukje se pas vitit 50 të erës sonë nuk ka të dhëna për përsosje apo zhvillim të mëtejshëm të velave.<sup>292</sup> Me siguri, as Casson-i dhe as White-i nuk ofrojnë të dhëna të tilla; kjo gjë thjesht nënkuptohet ose merret si e mirëqenë. Veçanërisht e rëndësishme këtu është se dy pikturat e lundrave romake gjoja me velë trekëndore, në fakt paraqesin vela shumë të vogla. Kurse mesolindorët e përdornin këtë lloj vele në anije shumë më të mëdha dhe ç'është më e rëndësishme, ata përdornin vela kryesore shumë të mëdha trekëndore. Bashkëkohësi Ibni Shehrijai madje përmend një velë arabe 76 këmbë të lartë në mesin e shekullit të dhjetë (çka do të ishte pak a shumë e krahasueshme me direkët e anijeve më të

<sup>291</sup> Needham, e të tjerë, *Science*, IV (3), fq. 609.

<sup>292</sup> Cecil Torr, *Ancient Ships* (Cambridge: Cambridge University Press, 1895), fq. 86-91.

mëdha europiane të fillimshekullit të gjashtëmbëdhjetë).<sup>293</sup> Për më tepër, Gerald Tibbetts na tregon se anijet arabe të shekullit të pesëmbëdhjetë – domethënë para Vasko de Gamës në vitin 1498 – ishin me siguri po aq të mëdha sa *dhout*-t moderne (këto të fundit janë 100 këmbë të gjata, me direkë 75 këmbë të lartë).<sup>294</sup> Mbi të gjitha, përdorimi i velave të mëdha trekëndore flet për një ‘kapacitet adoptues’ të qartë, duke qenë se përdorimi i një vele të madhe trekëndore në një anije të madhe kërkon shumë përsosje dhe një periudhë të gjatë eksperimentimi (siç e pranon edhe vetë White-i). Si përfundim, nuk është e mundur të nxirret përfundimi se persët apo arabët janë me siguri shpikësit e velës trekëndore – ndonëse po aq i gabuar do të ishte përjashtimi i kësaj mundësie. Megjithatë ka shumë gjasë që kanë qenë muslimanët ata të cilët ua kaluan atë europianëve pasi e kishin përsosur për një periudhë të gjatë kohore, duke bërë të mundur udhëtimin e Vasko de Gamës më 1498.

Për sa i përket fletës fundore të timonit dhe trupit drejt-këndor, këto janë pa dyshim shpikje kineze, të cilat janë shfaqur që në vitet 400 p.e.s. dhe janë përhapur drejt perëndimit, për të arritur në Europë rreth vitit 1180 përmes Urës Islame të Botës.<sup>295</sup> Në fund, është me vlerë të thuhet se megjithëse luftanijet veneciane ishin më të përparuarat në Europë në fillimet e shekullit të pesëmbëdhjetë, shkëlqimi i tyre zbehej në krahasim me luftanijet kineze. Galerat më të mëdha veneciane, të cilat arrinin në 150 këmbë gjatësi dhe 20 këmbë gjerësi, nuk ishin asgjë në krahasim me anijet më të mëdha kineze me përmasa 500 me 180 këmbë. Për më te-

<sup>293</sup> Ibn-Shahriya in Hourani, *Arab Seafaring*, fq. 100.

<sup>294</sup> Gerald R. Tibbetts, *Arab Navigation in the Indian Ocean before the Coming of the Portuguese* (London: The Royal Asiatic Society of Great Britain and Ireland, 1971), fq. 49.

<sup>295</sup> Needham, e të tjerë, *Science*, IV (3), fq. 635-654.

për, 'galerat veneciane mbroheshin nga me harkëtarë, kurse anijet kineze ishin të armatosura me armë zjarri, topa prej tunxhi e hekuri [të derdhur], mortaja, shigjeta me flakë dhe gjyle shpërthyes'.<sup>296</sup>

*Originat lindore të revolucioneve 'energjitike' dhe  
'protoindustriale' europiane*

Lidhur me revolucionin energjistik mesjetar, Carlo Cipolla në përputhje me mendimin e përgjithshëm pohon se shpikja e mullinjve me ujë që një risi tërësisht europiane, po të marrim parasysh mungesën e tyre në Lindje.<sup>297</sup> Por siç e vë në dukje Arnold Pacey:

Mendohej se [mulliri me ujë] ishte një zhvillim që i përket vetëm Perëndimit. Por tashmë dihet se ka patur mullinj të shumtë me ujë në afërsi të Bagdadit, dhe se forca e ujit është përdorur për prodhimin e letrës në atë rajon për dy ose më shumë shekuj para se të përdorej në Europë.<sup>298</sup>

Në fakt, Pacey nuk thotë sa duhet. Një pamje më të plotë na ofronjë el-Hassani dhe Hill-i:

Muslimanët ishin qartazi shumë të ethshëm për ta shfrytëzuar çdo rrjedhë të mundshme ujore si burim potencial energjie për bluarje. Madje ata e masnin rrjedhën e një përroi me numrin e mullinjve që mund të rrotullonte, domethënë, aksh përrua ishte kaq e aq 'mulli fuqi' ... Kishte mullinj në çdo provincë të botës islame, nga Spanja e Afrika Veriore deri në Transoksianë.<sup>299</sup>

Mullinj të dhe rrotat e ujit u përhapën në tërë Lindjen e Mesme përgjatë lumenjve, për t'u përdorur për ujitje, për të

<sup>296</sup> Gavin Menzies, *1421* (London: Bantam Press, 2002), fq. 43.

<sup>297</sup> Carlo Cipolla, *Before the Industrial Revolution* (London: Routledge, 1993), fq. 210.

<sup>298</sup> Arnold Pacey, *Technology in World Civilization* (Cambridge, Mass.: MIT Press, 1991), fq. 43.

<sup>299</sup> Ahmad Y. al-Hassan dhe Donald R. Hill, *Islamic Technology* (Cambridge: Cambridge University Press, 1986), fq. 53.

bluar drithë dhe për të copëtuar materiale për procese industriale. Po ashtu kishte *noria* gjigande në Lumin Orontes në Hama të Sirisë (makina ujëngritëse prej druri deri në 60 këmbë të larta). *Noria* dhe mullinj me ujë u ndërtuan gjithashtu në Spanjën muslimane. Për më tepër, që nga mijëvjeçari i dytë p.e.s., Lindja e Mesme kishte zhvilluar gjithfarë skemash mbresëlënëse për menaxhimin ujqor, përfshirë akuaduktet mbitokësore për të furnizuar me ujë qytetet dhe fshatrat, dhe sidomos akuadukte nëntokësore (*kanat*-et në Iran, ose *khattara*-t në Marok).<sup>300</sup> Dhe sistemet e ujitjes nuk mund të shihen si tregues i despotizmit oriental (siç mund të përgjigjen eurocentristët), sepse në Lindjen e Mesme këto sisteme ishin tejet të decentralizuara për t'iu përshtatur kallëpit të një shteti hidraulik e të centralizuar.

Megjithatë, eurocentrizmi i anashkalon mjeshtërisht këto arritje të muslimanëve, duke pretenduar se mulliri ka lindur shumë më herët, në kohën e Perandorisë Romake. Por duket se mullinj të për herë të parë janë zhvilluar në Egjiptin e lashtë, dhe që andej janë përhapur më vonë në Perandorinë Romake, edhe pse këto nuk ishin mullinj me ujë.<sup>301</sup> Mullinj të e parë me ujë (risia vendimtare) u shfaqën në Kinë në shekullin e parë p.e.s. Kjo ndonjëherë anashkalohet nëpërmjet pohimit se që mulliri romak ai që frymëzoi mullirin më të vonshëm mesjetar të Europës, duke qenë se romakët, ndryshe nga kinezët, përdornin rrota vertikale, të cilat do të përbënin bazën e mullinjve të mëvonshëm mesjetarë me ujë. Por ndikimin kinez e nxjerr në pah fakti se mulliri me ujë mesjetar evropian varej në masë kritike nga 'çekiçi me lëshim', qartazi i shpikur në Kinë në shekullin e katërt p.e.s.

<sup>300</sup> Jonathan Bloom dhe Sheila Blair, *Islam: Empire of Faith* (London: BBC Worldwide, 2001), fq. 104-105.

<sup>301</sup> Hugh Thomas, *An Unfinished History of the World* (London: Papermac, 1995), fq. 92-93.

Në fund, a ishte mulliri me ujë një shpikje unike europiane e zhvilluar për herë të parë në shekullin e trembëdhjetë? Nuk mund të jetë kështu, sepse për herë të parë mulliri me erë përmendet në Persi në vitin 644. Megjithatë, siç vë në dukje Needham, 'ndoshta më e sigurt është përmendja e mullinjve me erë në veprat e vëllezërve Benu Musa (850-870) kurse një shekull më vonë autorë të shumtë të besueshëm flasin mullinjtë e famshëm me erë të Sistanit (si për shembull, Ebu Is'hak el-Istakhriu dhe Ebu el-Kasim ibni Haukali).<sup>302</sup> Mulliri me erë persian më vonë u përhap jo vetëm në Europë, por edhe në Afganistan e Kinë.<sup>303</sup> Një përgjigje e zakonshme e përjashton origjinën persiane, mbi bazën se mulliri me erë i Lindjes së Mesme vendosej horizontalisht, ndryshe nga mulliri europian, që vendosej vertikalisht. Që modeli persian nuk arriti në Europë, kjo është e vërtetë, por të thuash se persët nuk patën kurrfarë kontributi, nuk është e drejtë. Sepse është e qartë se është përhapur ideja e mullirit. Dhe me siguri nuk është rastësi që kryqtarët europianë, të cilët me siguri do ta kenë hasur mullirin me erë persian gjatë 'aventurave' të tyre – sidomos po të kihet parasysh se shumë prej tyre qëndruan e u vendosën në Lindjen e Mesme – jo shumë kohë më vonë do ta përdornin atë në Europë.

### *Tekstilet*

Dimë se dy industritë më të rëndësishme në Europë pas vitit 1000 ishin tekstilet dhe letra, ndonëse prodhimi i hekurit po bëhej gjithashtu i rëndësishëm. Duket e qartë se një sërë teknologjish tekstile arritën në Europë nga Lindja, ndër

<sup>302</sup> Joseph Needham dhe Wang Ling, *Science and Civilisation in China, IV (2)* (Cambridge: Cambridge University Press, 1965), fq. 556-557.

<sup>303</sup> R. J. Forbes, "Power", te Charles Singer, E. J. Holmyard, A. R. Hall dhe T. I. Williams (red.), *A History of Technology, II* (Oxford: Clarendon Press, 1956), fq. 614-617.

të cilat më të spikaturat ishin rrota tjerrese, filaturat, avlë-mendi dhe pedali i këmbës. Rrota tjerrese e pati origjinën në Kinë dhe arriti në Itali përmes Spanjës muslimane në shekullin e trembëdhjetë.<sup>304</sup> Nuk është rastësi që makinat italiane të mëndafshit të shekullit të trembëdhjetë i ngjajnë aq shumë modelit të mëparshëm kinez. Siç e vë në dukje Hugh Honour:

Kur Kubla Hani vendosi *pax tartarica*-n në Azi, dengje [tekstileshe kineze] u bartën nga Kina në Lindjen e Mesme dhe në Europë përgjatë rrugës së karvaneve për të cilët Balducci Pegoletti deklaronte se është krejt e sigurt, qoftë natën apo ditën. Nuk është për t'u habitur që ky vërshim i madh brokadash e qëndismash, shumë më cilësore e të pasura në ngjyrë e modele se çfarëdo që mund të prodhonte Europa, të ketë ngjallur admirim e emocion.<sup>305</sup>

Dhe duke patur parasysh se në qytete të ndryshme italiane gjejmë 'filatura mëndafshi me makineri shumë të ngjashme me atë që përdorej në Kinë, ajo që supozohet është se ndonjëri nga tregtarët europianë që udhëtonin në Lindje në atë kohë, e ka sjellë planin me vete në hejbe'.<sup>306</sup> Filaturat e mëndafshit (makinat shtjellëse) qenë shpikur në Kinë në vitin 1090. Këto makina përbëheshin nga një kallëp ku shtillej mëndafshi, të vënë në punë me anë të një pedali, me një dërrasë ngritëse dhe një sistem rrotullues. Modeli italian i ngjet atij kinez deri në detajet më të imëta, si leva e kapur tek maniveli.<sup>307</sup> Dhe për më tepër, makinat italiane pak a shumë qenë riprodhime të atyre kineze deri në she-

<sup>304</sup> Dieter Kuhn, *Science and Civilisation in China*, V (9) (Cambridge: Cambridge University Press, 1988), fq. 419-433.

<sup>305</sup> Hugh Honour, *Chinoiserie: the Vision of Cathay* (London: John Murray, 1961), fq. 35.

<sup>306</sup> Robert Temple, *The Genius of China* (London: Prion Books, 1999), fq. 120.

<sup>307</sup> Pacey, *Technology*, fq. 103-107; Temple, *Genius*, fq. 120-121.

kullin e tetëmbëdhjetë.<sup>308</sup> Së fundi, nuk është për t'u habitur që këto makina përfundimisht hynë në Europë përmes Spanjës muslimane, sepse të gjitha aspektet kryesore të tezgjahut ishin në përdorim të plotë atje dhe kjo po ashtu nuk është për t'u habitur po të kihet parasysh se tekstilet islame i kishin mbizotëruar tregjet europiane për shekuj me radhë.

### *Letërprodhimi*

Një nga industritë më të rëndësishme europiane të mesjetës ishte letërprodhimi. Por letra që prodhuar së pari në Spanjën muslimane më 1150 dhe më pas që përhapur në Europë. Letra vetë u shpik nga Cai Lun në Kinë në vitin 105 e.s. (shih kap. 8) dhe filloi të prodhohej jo shumë kohë më vonë.<sup>309</sup> Por si arriti në Europë? Siç e ka shpjeguar së pari Thomas Carter, letra u përhap drejt perëndimit shumë ngadalë. Së pari arriti në Turkistan mes shekujve të katërt e të gjashtë, por përdorej rrallë. Ndërsa letra vetë ndeshet në Transoksianë dhe në Persi shumë para Betejës së Talasit,<sup>310</sup> më 751, vetëm pas kësaj beteje robërit kinezë i përcollën teknikat kritike të prodhimit të saj. Siç tregon el-Kazviniu,

Robër lufte u sollën nga Kina. Mes tyre ishte njëri i cili dinte për prodhimin e letrës dhe e vuri në jetë këtë proces. Që andej u përhap derisa u bë produkti kryesor i Semerkandit, prej ku eksportohej në të gjitha vendet.<sup>311</sup>

Letërprodhimi u përhap nga Semerkandi në Bagdad rreth vitit 794 dhe letra arabe e prodhuar në Damask, e njohur në Europë si *charta damascena* (letra e Damaskut), u bë

<sup>308</sup> Kuhn, *Science*, V (9), fq. 428-433.

<sup>309</sup> Thomas F. Carter, *The Invention of Printing in China and its Spread Westward* (New York: The Ronald Press Company, 1955), kapitulli. 13.

<sup>310</sup> Jacques Gernet, *A History of Chinese Civilization* (Cambridge: Cambridge University Press, 1999), fq. 288.

<sup>311</sup> Al-Qazwini, cituar te al-Hassan and Hill, *Islamic Technology*, fq. 191.

burimi kryesor me letër për Europën deri në shekullin e pesëmbëdhjetë. Atëherë për ta përmbledhur: 'Tregtia dhe kontaktet e tjera midis arabëve dhe kinezëve u dhanë mundësinë arabëve të njiheshin mjaft herët me letrën dhe fjalë arabe për letrën si *kagaz* dhe e barazvlefshmja *kirtas*, e cila gjendet në Kur'an, janë me prejardhje kineze.'<sup>312</sup>

Megjithëse nuk ka dyshim se kapërcimin madhor e arritën kinezët, arabët gjithsesi patën një kontribut të pavarur. Në veçanti arabëve iu desh ta ngurtësonin letrën për t'iu përshtatur shkruarve të cilët përdornin pena (ndryshe nga kinezët të cilët përdornin furça). Letërprodhimi më vonë arriti në Spanjën muslimane rreth vitit 1150 dhe që andej u përhap në Europë përmes Francës, më 1157, dhe Italisë, më 1276 (mbi njëmijë vjet pas shpikjes kineze).<sup>313</sup> Ndikimin musliman e nxjerr në pah fakti se anglezët përdorin termin *ream*, kurse italianët termin *risma*. Termi i mëparshëm arabisht ishte *rismah*.<sup>314</sup>

### *Industria e hershme europiane e hekurit*

Siç e pamë në kapitullin 3, ndërsa hekurprodhimi ka nisur shumë para erës sonë, qenë kinezët ata të cilët e çuan më përpara se kushdo tjetër këtë proces gjatë 'mrekullisë sunge' të shekullit të njëmbëdhjetë. Këtu vetëm sa do të vë në dukje se kohët e përhapjes së risive përkatëse nga Kina në Europë bien në sy vetëm për gjatësinë e tyre: njëmbëdhjetë shekuj për motorët fryrës metalurgjikë me energji ujore dhe katërmëdhjetë shekuj për gjyrykun me piston.<sup>315</sup> Gjithashtu është hedhur ideja se *Flussofen*-i europian, i cili

<sup>312</sup> Tsien Tsuen-Hsuin, *Science and Civilisation in China*, V (1) (Cambridge: Cambridge University Press, 1985), fq. 297.

<sup>313</sup> Carter, *Invention*, kapitulli 13; Tsuen-Hsuin, *Science*, V (1), fq. 296-299.

<sup>314</sup> Al-Hassan dhe Hill, *Islamic Technology*, fq. 192.

<sup>315</sup> Joseph Needham, *Science and Civilisation in China*, I (Cambridge: Cambridge University Press, 1954), fq. 240.

zëvendësoi *Stuckofen*-in stirian ose austriak (furnaltën) në shekullin e katërbëdhjetë, qe faza e fundit në bartjen e teknologjisë kineze që kish ardhur përmes Azisë Qendrore, Siberisë, Turqisë e Rusisë.<sup>316</sup> Për t'u shënuar është se indianët dhe muslimanët gjithashtu ishin prodhues të rëndësishëm. Hekuri ishte një industri jetike në Islam. Madje një vend i rëndësishëm i kushtohej edhe në Kur'an: 'Zoti e zbriti hekurin në tokë. Në të ka fuqi të madhe dhe dobi të shumta për njerëzimin' (57:25). Duket se teknikat lindore të hekurprodhimit kanë arritur në Europë përmes Urës Islame të Botës.

### *Orëbërja europiane*

'Ora qe arritja më e madhe e gjenialitetit mekanik mesjetar [të Europës]', thotë studiuesi eurocentrist i deklaruar, David Landes.<sup>317</sup> Mendohet se ora e parë publike është vënë në kullën e Kishës së Shën Eustorxhos në Milano në vitin 1309. Kurse ora e parë e bartshme supozohet të jetë shfaqur në Pallatin Visconti në Milano në vitin 1335. Por për çudi, edhe studiuesit eurocentristë e pranojnë se askush nuk e di kush është shpikësi.<sup>318</sup> Që kinezët nuk janë mbështetur tek ora, është një parashtrim i arsyeshëm. Që kinezët nuk kanë qenë të interesuar, ose që kanë qenë të paafte të ndërtojnë një orë mekanike, është pretendim i paarsyeshëm. Fakti është se në fund të shekullit të njëmbëdhjetë, Su Tzu-Jung ndërtoi një orë astronomike. Në vitin 1086 ai u udhëzua nga perandori kinez të rindërtonte orën më të hershme me unaza (të shpikur nga Han Kung-Lien). Duke folur për përshkrimin që Su i bën orës së vet, Needham përfundon:

<sup>316</sup> Braudel, *Civilization*, I, fq. 376.

<sup>317</sup> David S. Landes, *The Wealth and Poverty of Nations* (London: Little, Brown, 1998), fq. 49.

<sup>318</sup> Po aty, fq. 48.

'Me tërë larminë e saj në detaje, kjo ishte një nga arritjet më të mëdha teknike të mesjetës në çdo qytetërim'.<sup>319</sup> Sfida më e madhe në ndërtimin e një ore qëndronte në shpikjen e mekanizmit të karelit (një pajisje që rregullon lëvizjen e boshteve dhe të disqeve për të siguruar kohëmatje të saktë). Cardwell vinte në dukje se, 'jemi plotësisht në errësirë për sa u përket hapave përmes të cilave një apo disa gjeni të panjohur kanë shpikur mekanizmin e karelit i cili ... përbën ndoshta shpikjen e vetme më të madhe të njerëzimit pas rrotës'.<sup>320</sup> Misteri zgjidhet nga fakti i qartë se ishin kinezët (me gjasë I-Hsing më 725) ata që e kishin shpikur mekanizmin e karelit, dhe, për më tepër, ka të dhëna për bartjen e tij në Perëndim. Ideja duket se është përhapur në Lindjen e Mesme muslimane. Pastaj, më 1277 (rreth gjashtëdhjetë vjet para orës së Visconti-t) një tekst arab mbi kohëmatjen, i cili përmbante edhe idenë e orës me rëndesë, me mekanizëm kareli me zhivë, u përkthye në Toledo.<sup>321</sup> Për t'u shënuar gjithashtu është se thujse të gjitha teknikat dhe mekanizmat e orës europiane, përfshirë automatët, ingranazhet komplekse dhe ingranazhet me segmente si dhe shtytësin me rëndesë dhe sinjalet me tingull, ishin të pranishme në artin andaluzian (domethënë, të Spanjës muslimane) të orëbërjes.<sup>322</sup> Interesante është se Lynn White hedh idenë se gjashtë perpetumobilet duket se janë frymëzuar nga indiani i shekullit të dymbëdhjetë, Bhaskara.<sup>323</sup> Sido që të jetë, shumë nga orët europiane kishin tipare modeli me një ngjash-

<sup>319</sup> Needham dhe Ling, *Science*, IV (2), fq. 464, dhe fq. 446-463; krahaso. Gernet, *History*, fq. 341.

<sup>320</sup> D. S. L. Cardwell, *Technology, Science and History* (London: Heine-mann, 1972), fq. 14.

<sup>321</sup> Clive Ponting, *World History* (London: Chatto and Windus, 2000), fq. 371.

<sup>322</sup> Donald R. Hill, *Studies in Medieval Technology* (Aldershot: Ashgate, 1998), kapitulli 13, fq. 15.

<sup>323</sup> White, *Medieval Religion*, fq. 52-54.

mëri të madhe me orën e Su-it.<sup>324</sup> Veç kësaj, ka të dhëna të mira rrethanore që të bëjnë të mendosh se kinezët (dhe ndoshta indianët) përmes muslimanëve mund fare mirë të kenë influencuar orëbërësit evropianë.

Por në mos tjetër gjë, kjo mjafton për ta hedhur poshtë refrenin eurocentrist se kinezët nuk ishin aq të përparuar teknologjikisht sa për të prodhuar një orë.

### Përfundim

Që Italia ka qenë e rëndësishme për zhvillimin e Europës gjatë një pjese të madhe të periudhës së mesjetës, ngjan të jetë një parashtrim krejtësisht i arsyeshëm. Por ideja se italianët kanë qenë pionierët e çdo lloj shpikjeje që i dha hov kapitalizmit evropian, është një mit. Ndikimi lindor mbi Italinë ka qenë i thellë sa ç'ka qenë i gjerë. Së fundmi, kur mendojmë për Italinë, shpesh mendojmë për ushqimin e saj unik si dhe për produktet e saj të shumta kulturore. Por buka e picës për herë të parë është shpikur në Egjipt. Arabët futën kultivimin e orizit dhe të shafranit në Sicili dhe Spanjë (çka bëri të mundur bërjen e *paella-s*). Kurse kafeja erdhi nga Etiopia (fjala vjen nga arabishtja *kahva*).<sup>325</sup> Por makaronat ose spageti nuk kanë ardhur nga Kina (*contra* Marko Polos), por nga etruskët e lashtë të cilët popullonin pjesën perëndimore të Italisë.

Na thuhet se një nga treguesit më të mëdhenj të gjenialitetit dhe perfeksionit italian është ura e Ponte Vecchio-s. Por siç e vë në dukje Michael Edwardes:

Ndërtuesit e urave të para segmentare me harqe në Europë, si ajo e Ponte Vecchio-s mbi lumin Arno në Firence

<sup>324</sup> Needham dhe Ling, *Science*, IV (2), fq. 543-544.

<sup>325</sup> Bloom dhe Blair, *Islam*, fq. 106-107.

(1345), duhet të jenë ndikuar nga mjeshtëria paraprirëse kineze. Fama e teknicienëve të Kinës vazhdoi [për shumë shekuj] dhe Pjetri i Madh i Rusisë, gjatë procesit të modernizimit të vendit, në vitin 1675 thirri inxhinierë kinezë për projektet e tij për ndërtimin e urave.<sup>326</sup>

Në të vërtetë, në lidhje me Ponte Vecchio-n, Needham vë në dukje se ‘një urë e ngjashme por akoma më e përparuar ... u ndërtua rreth vitit 610 [e.s.] nga një inxhinier kinez me aftësi të jashtëzakonshme, Li Çhun’.<sup>327</sup> Për më tepër, kishte rreth njëzet të tjera të ngjashme në Kinë para shekullit të katërbëdhjetë. Dhe po të kemi parasysh se shumë perëndimorë i vizitonin dhe i admironin këto ura (përfshirë Marko Polon), ka shumë të ngjarë që kjo dije e përcjellë t’i ketë nxitur inxhinierët italianë.

Gjithsesi, ajo që zakonisht na vjen ndërmend kur ‘përfytyrojmë Italinë’ është Rilindja, e cila, siç supozohet, çliroi atë dinamikë europiane që do të arrinte kulmin me kapërcimin e Perëndimit në modernitetin kapitalist. Këtu shpesh mendojmë për Leonardo da Vinçin, i cili këmbëngulte se piktura duhet të bazohet në matematikë, sidomos në gjeometri e optikë (një lajtmotiv i ‘Europës së përparuar’). Por gjeometria dhe optika ku mbështetej Da Vinçi u zhvilluan dhe u përcollën nga muslimanët e Lindjes së Mesme dhe të Afrikës Veriore. Siç e shpjegon kapitulli 8, pas Rilindjes Perëndimore qëndron Lindja. Së fundmi, supozimi tradicional i historisë eurocentrike – se stafeta e fuqisë globale më vonë kaloi nga Italia tek iberikët të cilët filluan epokën europiane të zbulimeve gjeografike – është një tjetër mit. Kapitulli 7 shpjegon pse.

<sup>326</sup> Michael Edwardes, *East-West Passage* (New York: Taplinger, 1971), fq. 85.

<sup>327</sup> Needham, e të tjerë, *Science*, IV (3), fq. 177.

## 7. MITI I EPOKËS SË VASKO DE GAMËS, 1498-RR.1800

Me të tillë që hapat nuk m'i ndjekin në mbetsha  
 më e hidhur do të ishte se tmerret e detit në stuhi.  
 Më jepni një anije dhe përmes rrezikut do t'i prij  
 sepse më mirë kjo se shokë të pasinqertë...  
 Mrekulli e Zotit është kjo [anije], kafsha ime e barrës, mikja ime.  
 Jetën e kam shterur për dije dhe për këtë i famshëm jam bërë;  
 në pleqëri dija [shkencore] nderin ma ka rritur  
 dhe meritë për këtë sikur të mos kisha,  
 mbretërit kurrë s'do t' mi kishin hedhur sytë.

*Ahmed ibni Mexhid, lundërtar musliman, rr. 1475*

Nëse pretendimi që hedh në pjesën I të këtij libri është i saktë – që Azia ishte përpara Europës deri në shekullin e nëntëmbëdhjetë – atëherë si do t'i përgjigjemi pretendimit eurocentrik se pas vitit 1500 Europa e pushtoi Azinë? Dhe si do t'i përgjigjemi pretendimit të mirënjohur se epoka pas 1492-shit që epoka europiane e zbulimeve gjeografike e cila solli protoglobalizimin e udhëhequr nga Perëndimi? Ose, në një kontekst aziatik, si do ta marrim përshkrimin e mirënjohur eurocentrik të historisë së Azisë mes viteve 1498 dhe 1800 si 'epoka e Vasko de Gamës'? Më konkretisht, si do ta trajtojmë përshkrimin e mirënjohur eurocentrik artikulluar në mënyrë aq shprehëse nga John Roberts në librin e tij, *The Triumph of the West*?

Një fakt ... është aq i dukshëm sa anashkalohet lehtë: europianët qenë të vetmit që eksploruan. Për më tepër, udhëtimet eksploruese shënuan fillimin e një epoke të re, të një epoke ekspansioni botëror nga europianët ... Ashtu si Luther-i në shekullin pasues, Henri [Lundërta-

ri] ndihmoi në fillimin e historisë moderne pa patur ndonjë qëllim të tillë ... Vetëquajtja e mbretit të Portugalisë [Manuelit] ‘Kryezot i Etiopisë, Arabisë, Persisë dhe Indisë’ ishte veçse një mburrje e relativisht e vogël ... Pushtimi i detrave të hapur që i pari dhe më i madhi triumfi mbi forcat e natyrës, i cili do të sillte dominimin e qytetërimit perëndimor mbi mbarë globin.<sup>328</sup>

Dhe Roberts vazhdon të argumentojë se:

Sot njerëzit kanë filluar të përdorin një fjalë të prerë posaçërisht për të përmbledhur këtë gjendje mendore – ‘eurocentrizëm’, që do të thotë ‘ta vendosësh Europën në qendër të gjërave’, dhe ajo që nënkupton zakonisht ky term është se kjo gjë është e gabuar. Por, sigurisht, nëse flasim thjesht për fakte, për atë që ka ndodhur, dhe jo për vlerën që u japim këtyre fakteve, atëherë është krejt e saktë që Europa të vendoset në qendër të historisë në kohërat moderne.<sup>329</sup>

Përgjigja ime është se ‘faktet’ për të cilat flet Roberts, janë thjesht ato që ka përzgjedhur retorika eurocentrike, pikërisht për ta ‘vendosur Europën në qendër të historisë’. Kjo bëhet e qartë nëse shqyrtojmë një tërësi alternative faktesh. Këtu unë paraqes gjashtë kundërparashtrime kryesore ndaj historisë së mirënjohur eurocentrike, të cilat së bashku ofrojnë një pamje krejt tjetër dhe që njëkohësisht konfirmojnë argumentet e parashtruara në pjesën I të këtij libri.

### **Miti i epokës moderne europiane të zbulimeve në Azi**

Ekspeditat portugeze nuk ishin mishërimi i një epoke flamurbajtëse europiane zbulimesh e cila nxjerr në pah shenjat e një ‘shqetësimi racional’ apo të një kureshtjeje im-

<sup>328</sup> J. M. Roberts, *The Triumph of the West* (London: BBC, 1985), fq. 175, 184, 186, 188, 194.

<sup>329</sup> Po aty, fq. 201.

pulsive unike. Ato në fakt ishin 'fryma e fundit' ose 'raundi i dytë' i epokës mesjetare të kryqëzatave – me 'raundin e parë' mes viteve 1095 dhe 1291. Që do të thotë se këto ekspedita bartnin mentalitetin e vjetër kryqqtar më shumë se një sërë idesh moderne. Prapaskena më e ngushtë e ekspeditave kishte të bënte me pushtimin e Konstandinopojës nga osmanët më 1453, që shkaktoi një krizë të madhe në botën e krishterë. Kjo krizë identitare e krishterë u acarua më tej me pushtimin e Athinës (Qyteti i Shenjtë i mendimtarëve të Rilindjes) nga muslimanët më 1456. 'Një kor i madh vaji u ngrit ... Tokë e shenjtë e Heladhës qe përdhosur.'<sup>330</sup> Kjo nxiti një dëshirë për të kontaktuar me të krishterët e Lindjes (mbi të gjitha me mbretin e zi Katolik imagjinari, Prift Gjonin). Vërtet,

në gjysmën e dytë të shekullit të pesëmbëdhjetë, përgatitja dhe drejtimi i një kryqëzate të madhe u bë pjesë e planeve të Kishës për reformë papnore ... Një papë i fuqishëm reformator do të përpiqej për paqen brenda botës së krishterë, do të frymëzonte një kryqëzatë dhe do ta rigjallëronte Besimin.<sup>331</sup>

'Kërcënimi' islam, shoqëruar me përçarjen e botës së krishterë, e nxiti Kishën Katolike të shpallte një sërë dekretesh papnore. Për Kishën ishte një çështje për jetë a vdekje: vetë mbijetesa e botës së krishterë ishte në rrezik. Siç deklaronte Papa Piu II, 'Një luftë e pashmangshme me turqit na kanoset. Nëse nuk rrokim armët dhe nuk shkojmë në luftë për t'u përballur me armikun, mendojmë se kjo fe do të marrë fund.'<sup>332</sup>

<sup>330</sup> Michael Edwardes, *East-West Passage* (New York: Taplinger, 1971), fq. 135.

<sup>331</sup> Brandon H. Beck, *From the Rising of the Sun* (New York: Peter Lang, 1987), fq. 17.

<sup>332</sup> Papa Piu II, cituar te Robert Schwoebel, *The Shadow of the Crescent* (Nieuwkoop: B. De Graaf, 1967), fq. 71.

Dekreti i parë papnor (*Dum Diversas*), shpallur më 1452 nga Papa Nikola V, pohonte se, 'Papa e autorizon Mbretin e Portugalisë t'i sulmojë, t'i pushtojë e t'i nënshtrojë saraçenët [muslimanët] ... të rrëmbejë pasuritë dhe territoret e tyre, t'i vërë ata nën skllavëri të përjetshme dhe t'ia kalojë tokat dhe pasuritë e tyre Mbretit të Portugalisë'.<sup>333</sup> Kjo u pasua nga një dekret i dytë (*Romanus Pontifex*) nga i njëjti papë më 1455, dekret që me të drejtë është quajtur 'Karta e imperializmit portugez'. Në të, Princ Henri Lundërtari mbulohet me lëvdata si ushtar i Krishtit dhe mbrojtës i Besimit. Dekreti e lëvdon për dëshirën e tij për të përhapur emrin e Krishtit dhe për t'i detyruar 'të pabesët' të hyjnë në vathën e Kishës Katolike dhe veçanërisht ia konfirmon qëllimin për të lundruar rreth Kepit e për të krijuar lidhje me banorët 'katolikë' të Indeve (të cilët besohej se sundoheshin nga mbreti Prifti Gjon). Besohej se ky popull 'e nderonte emrin e Krishtit' dhe duke bërë aleancë me ta, portugezët do të mund të udhëhiqnin luftën kundër saraçenëve dhe 'të pabesëve' të tjerë. Pasi u legjitimua kësisoj imperializmi portugez në Indet, kjo u pasua nga një tjetër dekret i rëndësishëm papnor, *Inter Caetera* (1456), i cili e konfirmonte *Romanus Pontifex*-in duke i njohur 'pushtet shpirtëror mbi të gjitha rajonet e pushtuara nga portugezët tani dhe në të ardhmen, "nga kepet e Bojadorit [në brigjet veriperëndimore të Afrikës] dhe Nunit, përgjatë Guinesë e përtej, drejt jugut, për në Indet"'.<sup>334</sup> Në veçanti ata u udhëzuan të gjenin Priftin Gjon me të cilin, siç shpresohet, portugezët mund të bënin aleancë dhe të mposhtnin muslimanët (Prifti Gjon kërkohet pasi besohej se jetonte përtej perandorisë islame).

<sup>333</sup> Charles R. Boxer, *The Portuguese Seaborne Empire, 1415-1825* (London: Hutchinson, 1969), fq. 21.

<sup>334</sup> Po aty, fq. 22-23.

Deklarimit paraprak të Oqeanit Indian nga Kisha si një *nullius diocesis* (që deri diku ishte një pararendës mesjetar i krishterë i konceptit të mëvonshëm të *terra nullius*), i bëhej jehonë me pretendimin se oqeani në fjalë ishte një *mare liberum*. Kjo i bëri portugezët të besonin që në fillim se ishte krejtësisht me vend që të gjitha anijet aziatike të kishin leje nga portugezët për të zhvilluar tregti në atë që tashmë besohej se ishte një oqean portugez'.<sup>335</sup> Thënë ndryshe, Krishterimi nuk u përdor vetëm si një parim për ligjësi për 'imperializmin' portugez në Indet pasi fakti që kryer tashmë, por fundamentalisht krijoi besimin se kjo mënyrë veprimi ishte e rregullt moralisht. Asgjë nga këto nuk do të thotë se motivet ekonomike ishin të parëndësishme, por pasuritë ekonomike do të ishin ndër të tjera një mënyrë e rëndësishme për të zhvilluar luftën kundër 'të pabesëve'. Tregues këtu është fakti se më 1457 në Lisbonë u shtyp një monedhë e quajtur *cruzado* (kryqëzatë) dhe, jo më pak e rëndësishme, ari vinte nga Guinea.

### **Mitet binjake të epokës portugeze të zbulimeve dhe të epokës perëndimore të protoglobalizimit**

As portugezët nuk e 'zbuluan' Azinë dhe Kepin e Stuhive, dhe as 'eksplorimet' e pas 1497/8-ës nuk ishin shenjat e para të protoglobalizimit perëndimor. Ato ishin pjesë e globalizimit të udhëhequr nga afro-aziatikët (lindorët). Konvencionalisht mendohet se Kepin e Stuhive (më vonë i quajtur Kepi i Shpresës së Mirë) e zbuloi lundërtari portugez Bartholome Dias më 1487-8 dhe se Vasko de Gama e bëri me sukses rrugën deri në Indi përmes Kepit një dekadë më vonë. Por në fakt portugezët qenë të fundit që e zbuluan

<sup>335</sup> M. N. Pearson, *The New Cambridge History of India* (Cambridge: Cambridge University Press, 1987), fq. 38.

Kepin – popuj të ndryshëm lindorë e kishin arritur, në mos kishin lundruar rreth tij, shumë shekuj më parë. Në mesin e shekullit të pesëmbëdhjetë, lundërtari i famshëm arab Shihabeddin Ahmed ibni Mexhid lundroi drejt perëndimit, deri tek Kepi, për të vazhduar drejt veriut, përgjatë bregut perëndimor të Afrikës, para se të hynte në Mesdhe nëpërmjet Ngushticës së Gjibraltarit.<sup>336</sup> Dhe vija bregdetare ‘përshkruhet kaq hollësisht në manuale, sa askush nuk mund ta vërë në dyshim se detarët arabë/persë kanë lundruar më parë rreth Afrikës’.<sup>337</sup> Për t’u shënuar gjithashtu është se rreth vitit 1420, një lundër indiane (ose ndoshta kineze) lundroi përreth Kepit dhe vazhdoi për rreth 2000 milje në Oqeanin Atlantik.<sup>338</sup> Për më tepër, admirali (musliman) Çeng Ho lundroi deri në bregun lindor të Afrikës në fillim të shekullit të pesëmbëdhjetë, ndonëse po ashtu është e mundur që detarët kinezë ta kenë kaluar Kepin që në shekullin e tetë, në mos më herët.<sup>339</sup> Po ashtu ka të dhëna se javanezët e kanë kaluar Kepin. Më 1645, Diogo do Couto thotë për javanezët se:

[janë] të gjithë njerëz me shumë përvojë në artin e lundrimit, aq sa pretendojnë se janë më të lashtët ... është e sigurt se kanë lundruar më parë deri në Kepin e Shpresës së Mirë dhe kanë qenë në kontakt me ... [Madagaskarin] ku ka shumë vendas zeshkanë e të javanizuar, të cilët thonë se rrjedhin prej tyre.<sup>340</sup>

<sup>336</sup> Shih diskutimin te Gerald R. Tibbetts, *Arab Navigation in the Indian Ocean before the Coming of the Portuguese* (London: The Royal Asiatic Society of Great Britain and Ireland, 1971), fq. 206-208.

<sup>337</sup> Janet L. Abu-Lughod, *Before European Hegemony* (Oxford: Oxford University Press, 1989), fq. 19; and fq. 209, 258, 363.

<sup>338</sup> Joseph Needham, Wang Ling dhe Lu Gwei-Djen, *Science and Civilisation in China*, IV (3) (Cambridge: Cambridge University Press, 1971), fq. 501-502; krahaso, Gavin Menzies, *1421* (London: Bantam, 2002), veçanërisht kapitullin 4.

<sup>339</sup> Colin Ronan (red.), *The Shorter Science and Civilisation in China*, III (Cambridge: Cambridge University Press, 1986), kapitulli 3.

<sup>340</sup> Diogo do Couto, cituar te Anthony Reid, *Southeast Asia in the Age of Commerce 1450-1680*, I (New Haven: Yale University Press, 1993), fq. 36.

Kjo rrugë migrimi me siguri ka filluar në shekujt e parë të mijëvjeçarit të parë të erës sonë.<sup>341</sup> Si përfundim, një larmi e tërë tregtarësh lindorë kishin lundruar përtej Kepit dhe në brigjet lindore, në mos ato perëndimore të Afrikës shumë kohë para se Henri Lundërtari të nisej në udhëtimin e tij.

Një tjetër mit eurocentrik ka të bëjë me pretendimin se arritja e Vasko de Gamës në Indi përfaqëson një lloj kontakti të parë me një popull deri atëherë të izoluar. Por siç e pamë në kapitujt 2-4, India, si dhe pjesa tjetër e Azisë, kishin luajtur një rol kritik në ekonominë globale të udhëhequr nga afro-aziatikët për shumë shekuj me radhë para Vasko de Gamës. Realiteti është se Kolombit dhe De Gamës u ka paraprirë për rreth një mijëvjeçar epoka afro-aziatike e zbulimeve. Këtë e dëshmon fakti se:

Kur De Gama lundroi deri në brigjet e Afrikës Lindore më 1498, lundroi në një botë të njohur dhe të lidhur tashmë me Mesdheun dhe Europën. Tregtarët arabë kishin depërtuar e konvertuar dhe qenë ngulitur e kishin lidhur martesë deri në Sofala në jug [në brigjet juglindore të Afrikës] dhe e kishin lidhur të gjithë Afrikën Lindore bregdetare në veri të saj me pjesët e tjera të Oqeanit Indian si dhe me Detin e Kuq dhe Europën.<sup>342</sup>

Një tjetër mit i ndërlydhur me këtë ka të bëjë me supozimin eurocentrik se De Gama realizoi kontaktin e parë me një popull primitiv. Siç e pamë hollësisht në kapitullin 4, indianët ishin më të përparuar se 'zbuluesit' e tyre evropianë. Dëshmi rrethore për këtë pretendim përbëjnë takimi fillestar i De Gamës me zamorinin (sundimtarin) indian të Kalikutës. Ardhja e portugezëve nuk e mahniti aspak zamorinin indian, përkundrazi. Kur Vasko de Gama hirësisht

<sup>341</sup> Andre Wink, *Al-Hind: the Making of the Indo-Islamic World*, I (Leiden: E. J. Brill, 1995), fq. 27-28.

<sup>342</sup> Pearson, *New Cambridge History*, fq. 11.

u pranua në audiencë para zamorinit, i dhuroi atij disa nga prodhimet më të përparuara europiane. Por indianët nuk e përmbajtën dot habinë përballë inferioritetit të produkteve në fjalë. Siç shprehet Needham:

Hendekun teknologjik midis [Lindjes] dhe Perëndimit e dëshmon mjaft mirë vizita e parë e Vasko de Gamës në Kalikut më 1498. Ai tregoi mallra të ndryshme, si rroba, kapela, sheqer e vaj ... Mbreti qeshi me to dhe i tha admiralit të ofronte më mirë flori. Ndërkohë, tregtarët muslimanë të pranishëm aty u treguan indianëve se portugezët ishin në thelb piratë dhe nuk zotëronin asgjë që indianët mund të dëshironin ndonjëherë.<sup>343</sup>

Në fakt, ishin këshilltarët e sundimitarit ata që qeshën, kurse ky i fundit u ndje tejet i fyer nga dhuratat, të cilat i refuzoi si të padenja edhe për tregtarin më të varfër.

Nocioni se indianët u mahnitën nga portugezët, në të vërtetë duhet marrë përmbys. Mbreti i Portugalisë João II e kishte dërguar Pedro de Covilhao-n për të eksploruar Indi-në në vitin 1487. Kur ky i fundit u kthye, raportoi se qe,

mahnitur me ç'kishte parë në portet e Indisë: tregtinë e madhe ... dhe mbi të gjitha, me sasi të mëdha të kanelës në depot e tregtarëve arabë, me piperin që kacavirrej pemëve dhe me sasi të pamata të erëzave që rriteshin nëpër fusha siç rritet gruri në Europë.<sup>344</sup>

Disa vjet më vonë, Cabral-i u kthye në atdhe jo vetëm me rrëfime të ngjashme llamburitëse, por madje solli me vete edhe disa produkte indiane. Portugezët në përgjithësi i mahniste pasuria e popullatës po aq sa pasuria e shpalosur

<sup>343</sup> Joseph Needham, te Mansel Davies, *A Selection from the Writings of Joseph Needham* (Lewes, Sussex: The Book Guild, 1990), fq. 176.

<sup>344</sup> Joseph Desomogyi, *A Short History of Oriental Trade* (Hildesheim: Georg Olms Verlagsbuchhandlung, 1968), fq. 83.

në pallate.<sup>345</sup> Kështu që, nëse portugezët duket të kenë qenë të motivuar nga një kureshtje e fuqishme që gjoja aziatikëve u mungonte, kjo vetëm ngaqë portugezët, ndryshe nga aziatikët, dinin aq pak për botën nga njëra anë dhe nga ana tjetër ngaqë aziatikët kishin shumë më tepër ç'mund të ofronin.

Në mënyrë të përmbledhur, as lundrimi përreth Kepit dhe as arritja e portugezëve në Indi nuk meriton cilësimin e një zbulimi pionierik. Ndonëse pa dyshim përbënin një zbulim të madh për europianët, për afrikanët dhe aziatikët ishin thjesht gjëra të ditura. Ajo që kish ndodhur ishte se europianët po lidhesin drejtpërdrejt me ekonominë globale të udhëhequr nga afro-aziatikët, të krijuar në periudhën pas 500-ës. Shkurt, europianët nuk e 'zbuluan' Azinë dhe Afrikën, sepse popujt e këtyre kontinenteve prej kohësh kishin qenë në kontakt me Europën.

### **Miti i gjenialiteti europian në ekspeditat portugeze**

Arritja e portugezëve në Azi nuk ishte tregues i gjenialitetit europian, por u bë e mundur vetëm falë përvetësimit nga europianët të teknologjive lundrimore dhe ideve shkencore superiore të aziatikëve. Europa nuk e ribëri Azinë mes viteve 1500-1800, por Azia ndihmoi në ribërjen e Europës mes viteve 500-1800. Fakti është se po të mos kish qenë për përhapjen dhe përvetësimin e shkencës si dhe të teknologjive lundrimore lindore, Vasko de Gama nuk do të kishte arritur dot as deri tek Kepi, jo më në Indi. Huazimi i shkencës muslimane nga portugezët filloi në shekullin e dymbëdhjetë, deri diku me iniciativën e familjes mbretërore. Monarkia portugeze mori në shërbim shkencëtarë të

<sup>345</sup> Michael Adas, *Machines as the Measure of Men* (Ithaca: Cornell University Press, 1989), fq. 41-45; Jack Goody, *The East in the West* (Cambridge: Cambridge University Press, 1996), fq. 111.

shumtë hebrenj të cilët përmes përkthimeve që bënë e përcollën drejtpërdrejt dijen origjinale muslimane (çka në kontekstin e kryqëzatave ishte një mënyrë më 'e përshtatshme politikisht' sesa të punuarit drejtpërdrejt me muslimanë). Veç kësaj, portugezët përfituan më gjerësisht nga migrimi i shkencëtarëve hebrenj të cilët u larguan nga Spanja në fund të shekullit të katërbëdhjetë gjatë kulmit të pogromeve.

Lundrimi oqeanik paraqiste sfida të reja për iberikët, si për sa i përket konstruksionit të anijeve, ashtu dhe lundrimin. Por, siç e vë në dukje Patricia Seed, ata iu drejtuan lindorëve – sidomos muslimanëve përmes hebrenjve – për t'i zgjidhur këto sfida të shumta.<sup>346</sup> Sfida e parë kishte të bënte me nevojën për t'i marrë në ballë erërat e forta që frynin nga jugu i Kepit të Bojador-it në brigjet perëndimore të Afrikës. Kjo u zgjidh në vitet 1440 me ndërtimin e karavelave të cilat kishin fletë fundore timoni si dhe tri direkë, njëri prej të cilëve me velë trekëndore. Por origjina e karavelës shkon pas në shekullin e trembëdhjetë, kur portugezët ndërtuan varka të vogla peshkimi të bazuara në *karib*-in e muslimanëve.<sup>347</sup> Dhe, siç e pamë në kapitullin 6, fleta fundore e timonit, shumë e rëndësishme, ishte shpikje kineze. Aty po ashtu vumë në dukje se vela trekëndore, sipas të gjitha gjasave, e kishte prejardhjen në Lindjen e Mesme, ndonëse qe bërë një tipar i përhershëm i lundrimin musliman shumë kohë para shekullit të pesëmbëdhjetë. Dhe, me siguri, mesolindorët e kishin përsosur akoma më tej para se t'ua kalonin europianëve. Për t'u shënuar gjithashtu është se vetëm në mesin e shekullit të pesëmbëdhjetë u fut në Europë sistemi tejet i rëndësishëm me tre direkë (me vela të

<sup>346</sup> Ky paragraf, dhe dy paragrafet në vijim, janë marrë te Patricia Seed, *Ceremonies of Possession in Europe's Conquest of the New World, 1492-1640*(Cambridge: Cambridge University Press, 1995), fq. 107-128.

<sup>347</sup> Martin Elbl, "The Caravel", te Robert Gardiner (red.), *Cogs, Caravels and Galleons* (London: Brassey's, 1994), fq. 91.

kombinuara katërkëndore e trekëndore). Pa këtë risi, 'ekspeditat zbuluese' nuk do të qenë realizuar kurrë. Por ky element kish qenë prej kohësh një element standard në lundrimin kinez, dija e të cilit fare mirë do të mund të përcillej nga kushdo prej vizitorëve europianë të Kinës në shekullin e trembëdhjetë, ose nga europianët apo muslimanët të cilët i kishin vëzhguar prej kohësh anijet kineze që lundronin për në Afrikë apo për në Lindjen e Mesme.<sup>348</sup>

Por vetë vela trekëndore paraqiste një sfidë të dytë. Kjo sepse kjo lloj vele krijonte një rrugë zigzage (ose trekëndore) në lundrim, çka detyrimisht e bënte shumë më të vështirë përlllogaritjen e distancës lineare të përshkuar. Kjo u zgjidh me anë të gjeometrisë dhe trigonometrisë, të zhvilluara dhe të huazuara nga matematikanët muslimanë (shih kap. 8). Një sfidë të tretë përbënin baticat e fuqishme në jug të Kepit të Bojador-it, të cilat mund t'i nxirrnin anijet në breg ose thjesht t'i shpartallonin. Zgjidhja e këtij problemi kërkonte dije mbi ciklet hënore (duke qenë se hëna i shkaktonte baticat). Në fund të shekullit të katërmëdhjetë, kjo dije u zhvillua nga hartografi hebre që jetonte në Portugali, Jakob ben Abraham Cresques. Sfida e katërt ishte nevoja për harta më të sakta detare se ato që ekzistonin (si hartat portolane). Zgjidhja u gjet në astronominë muslimane, e cila ishte në gjendje të përllogariste përmasat e tokës dhe, duke përdorur gradët, të përcaktonte distancën e përshkuar.

Astrolabi që veçanërisht i rëndësishëm. Sërish, siç e pamë në kapitullin 6, kjo pajisje ishte përsorur nga astronomët muslimanë dhe që përcjellë në Europë përmes Spanjës muslimane në mesin e shekullit të dhjetë. Por portugezëve gjithashtu u duhej të përcaktonin vendndodhjen e saktë edhe gjatë ditës. Për këtë ata u mbështetën në sugjerimet e bëra

<sup>348</sup> G. S. L. Clowes, "Ships of Early Explorers", *Geographical Journal* 69 (1927), 216; Needham, e të tjerë, *Science*, IV (3), fq. 29.

nga astronomi i shquar musliman nga Kordova, Ibni Saffari (traktati i të cilit qe përkthyer në latinisht). Ata jo më pak huazuan risitë e muslimanëve në matematikë për të përcaktuar gjatësinë dhe gjerësinë gjeografike, duke mbështetur në tabelat e zhvilluara nga një astronom musliman i shekullit të njëmbëdhjetë. Veç kësaj, përllogaritja e gjerësisë gjeografike kërkonte edhe dije të vitit diellor (duke qenë se pjerësia e këndit të diellit ishte kritike për këtë përllogaritje). Sërish, ata iu drejtuan kalendarëve të sofistikuar diellorë të muslimanëve e hebrejve të zhvilluar në shekullin e njëmbëdhjetë. Në vitin 1537 Pedro Nunes krenohet se: 'është e qartë se zbulimi i brigjeve, ishujve, kontinenteve nuk ka ndodhur rastësisht. Përkundrazi, marinarët tanë janë nisur të mirinformuar, të pajisur me instrumentet dhe rregullat e astronomisë dhe gjeometrisë'.<sup>349</sup> Dhe vërtet, ata ishin tejet të mirëinformuar. Por kjo vetëm falë përparimeve të shënuara në shkencën hebreje, e cila megjithatë ishte kryesisht muslimane, ku qenë bazuar ekspeditat eksploruese të portugezëve.

Por ndikimi musliman nuk mbaronte këtu. Së pari, është e mundur, ndonëse jo e sigurt, që Vasko de Gamës t'i jetë treguar një hartë tejet e hollësishme e Indisë nga një musliman nga Guxharati, Malemo Cana, në Malindi, para se të nisej për të kaluar Detin e Arabisë. Më e sigurt është se De Gama arriti të shkonte në Indet me ndihmën e një timonieri anonim musliman nga Guxharati (i marrë në anije në Malindi, në bregun e Afrikës Lindore). Është interesante se ky lundërtar shpesh mendohet të ketë qenë i famshmi Ahmed ibni Mexhid, ndonëse Gerald Tibbetts sjell një sërë argumentesh që hedhin mjaft dyshime mbi këtë mendim.<sup>350</sup>

<sup>349</sup> Pedro Nunes, cituar te Seed, *Ceremonies*, fq. 126.

<sup>350</sup> Tibbetts, *Arab Navigation*, fq. 9-11.

Që roli i lundërtarit musliman ka qenë vërtet jashtëzakonisht i rëndësishëm, bëhet e qartë nga fakti se mungesa e tij në udhëtimin e kthimit do të thotë se De Gama qe shumë me fat që arriti të kthehej. Siç shpjegohet në *Journal of the First Voyage of Vasco da Gama*:

Për shkak të bunacave dhe erërave të shumta të papërshtatshme, na u deshën tre muaj pa tre ditë për ta kaluar gjirin [Detin e Arabisë] dhe të gjithë njerëzit tanë ... vuanin nga fryrja e mishrave të dhëmbëve, aq sa nuk mund të hanin. Edhe këmbët u enjteshin, si dhe pjesë të tjera të trupit, dhe këto enjtje përhapeshin derisa i sëmuri vdiste ... Tridhjetë nga burrat tanë vdiqën në këtë mënyrë ... dhe ata që mund të drejtonin lundrimin në çdo anije ishin vetëm shtatë a tetë, por aq këta nuk ishin aq mirë sa ç' duhej të ishin. Ju siguroj se po të kishte vazhduar kjo gjendje edhe dy javë të tjera, nuk do të kish mbetur asnjëri për t'i drejtuar anijet.<sup>351</sup>

Më vonë ata u detyruan ta digjnin njëren nga anijet, sepse thjesht nuk kishte marinarë mjaftueshëm për t'i drejtuar të gjitha. Por edhe kështu, kjo përvojë nuk ishte aspak një përjashtim në kontekstin europian. Antonio Pigafetta, aventurieri i ri italian i cili shoqëroi Magellan-in (rreth njëzet vjet pas udhëtimit të De Gamës), na tregon se:

Hanim vetëm biskota të bluara, plot me krimba e që kutërbonin nga urina e minjve ... Pinim ujë të ndotur e të verdhë. Hanim edhe lëkura buajsh ... Sa për minjtë ... nuk ngopeshim me ta ... njëzet prej nesh vdiqën ... njëzet e pesë a tridhjetë u sëmuren.<sup>352</sup>

Së fundmi, kur lexon vargjet e cituara në hyrje të këtij kapitulli, është krejt e falshme të mendosh se këto fjalë janë

<sup>351</sup> Cituar te E. G. Ravenstein (red.), *A Journal of the First Voyage of Vasco Da Gama, 1497-1499* (London: Bedford Press, 1899), fq. 87.

<sup>352</sup> Antonio Pigafetta, cituar te Miriam Estensen, *Discovery* (St Leonards, New South Wales: Allen and Unwin, 1998), fq. 15-16.

shkruar nga pena e Vasko de Gamës. Por në fakt janë shkruar nga lundërtari i famshëm musliman, Ahmed ibni Mexhid.<sup>353</sup> Për rreth njëmijë vjet me radhë, detarët arabë e persianë kishin qenë shumë më të përparuar se sivëllezërit e tyre europianë. Dhe ironia këtu është se ndërsa De Gama kërkonte të ndërmernte kryqëzatë kundër Islamit, ishte për-cjellja e ‘kapaciteteve burimore’ lindore – e sidomos muslimane – përmes Urës Islame të Botës, ajo që i jepte mundësinë atij ta ndërmernte këtë udhëtim.

### Miti i epërsisë ushtarake të Europës në Azi

Në zemër të narrativës eurocentrike qëndron epërsia ushtarake e Europës. Ky supozim është pa dyshim një mit. Është ndriçuese ta nisim duke e krahasuar Vasko de Gamën me admiralin kinez (musliman) Çeng Ho, i cili e kapërceu Oqeanin Indian dhe zbarkoi në bregun lindor të Afrikës shumë dekada para se De Gama të bënte të njëjtën gjë por nga drejtimi i kundërt. A do të ishte më me vend të cilësohej De Gama si ‘Çeng Ho i Europës’, apo Çeng Ho si ‘Vasko de Gama i Kinës’? Një krahasim i tillë vetëm sa do t’i turpëronte europianët. Ndërsa anija më e gjatë e De Gama-s ishte rreth 85 këmbë e gjatë, anija më e madhe e Çeng Ho-së ishte gati 500 këmbë e gjatë dhe 180 e gjerë (me rreth 1000 burra).<sup>354</sup> Edhe fleta e timonit të anijeve të Çeng-ut ishte gati sa gjysma e anijes kryesore të Kolombit, Nina-s. Tonazhi prej 100 tonësh e Nina-s sërish ishte qesharak krahasuar me 3100 tonët e anijeve më të mëdha të Çeng-ut. Madje edhe tonazhi i *carrack*-ëve ‘të mëdhenj’ portugezë ishte vetëm sa një e pesta e anijeve më të mëdha të Çeng-ut. Për më tepër,

<sup>353</sup> Ahmad ibn-Majid, cituar te Tibbetts, *Arab Navigation*, fq. 195.

<sup>354</sup> Ravenstein, *Journal*, fq. 163; Needham, e të tjerë, *Science*, IV (3), fq. 480-482; Menzies, 1421, fq. 38.

përballë anijeve portugeze me tre direkë qëndronin anijet me nëntë ose dhjetë direkë të Çeng-ut, të pajisura me porta të shumta uji dhe dymbëdhjetë kompartamente të papërshkueshme nga uji. Së fundmi, katër anijet dhe 170 burrat e De Gamës kishin përballë qindra anijet dhe 27.550 njerëzit e Çeng-ut në ekspeditën e 1431/3-shit.

Gjithashtu tronditëse është po të mendojmë se numri i njerëzve në disa prej këtyre ekspeditave kineze i tejkalonte edhe përmasat e ushtrive më të mëdha të fuqive europiane të asaj kohe. Për më tepër, numri i anijeve pjesëmarrëse në shumë prej ekspeditave kineze i kalonte përmasat e Flotës Mbretërore deri në fundin e shekullit të gjashtëmbëdhjetë në raportin 10:1. Tronditëse ishte edhe madhësia e flotës kineze (siç është vënë në dukje në kap. 3). Madje edhe pas së ashtuquajturës 'tërheqje' më 1434, flota minge mbeti më e madhja në botë, dhe ndoshta më e madhe se ç'mund të ofronte e gjithë Europa perëndimore.<sup>355</sup> Për krahasim, niveli i pranisë detare portugeze në Azi ishte i papërfillshëm. Përgjatë shekullit të gjashtëmbëdhjetë, portugezët dërgonin në Lindje mesatarisht shtatë anije në vit dhe vetëm katër syresh arrinin të ktheheshin në atdhe; histori kjo që do të vazhdonte edhe në shekullin e shtatëmbëdhjetë. Një histori e ngjashme haset edhe në kontekstet e Holandës dhe të Anglisë. Mes viteve 1581 dhe 1630, numri total i anijeve të dërguara nga holandezët, portugezët dhe anglezët bashkë, ishte mesatarisht tetë anije në vit.

Por pika kritike është se anijet aziatike ishin ushtarakisht të mjaftueshme për t'u bërë ballë anijeve europiane. Një 'betejë midis flotës [së Çeng Ho-së] dhe të gjitha flotave të tjera të botës sëbashku, do t'i kishte ngjarë një përballjeje

<sup>355</sup> Goody, *East*, fq. 92.

midis një tufe peshqaqenësh dhe një tufe sardelesh'.<sup>356</sup> Por edhe pas 1434-ës, epërsia e flotës kineze vazhdoi. Në vitin 1598, flota minge mundi një flotë pushtuese japoneze me rreth 500 anije.<sup>357</sup> Ajo gjithashtu i zbrapste me sukses flotat portugeze, holandeze e angleze kurdo që këta përpiqeshin ta 'hapnin' Kinën. Kështu për shembull, kur portugezët tentuan ta zgjeronin me forcë pozitën e tyre në Kinë më 1521 dhe 1522, u mposhtën me vendosmëri nga flota kineze e rojës bregdetare. Vetëm në vitin 1557 (vit kur japonezët u nxorrën nga sistemi kinez i haraçit) portugezëve iu lejua zyrtarisht një pozitë në Makao. Makao ishte një magazinë e vogël tregtare në një gadishull të vogël të pabanuar në Gjirin e Kantonit, e lidhur me tokën përmes një rripi shumë të ngushtë (ku furnizimi me ushqime mund të pritej fare lehtë nëse portugezët do të tregoheshin të pabindur) Ky 'koncesion' nuk iu dha portugezëve për shkak të epërsisë së tyre ushtarake, por falë dëshirës së kinezëve për ta zvogëluar tregtinë e ndërmarrë nga japonezët dhe në këtë mënyrë 'përdorën' portugezët në vend të tyre. Dhe megjithëse portugezët arritën të merrnin një pjesë të tregtisë me Kinën, kjo u bë në kushtet më strikte të vëna nga perandori i Kinës. Sido që të jetë, do të ishte e gabuar të ekzagjerohej ndikimi i tregtisë portugeze në Kinë po të kihet parasysht se vetëm një anije në vit lejohej të udhëtonte atje.

Situata ishte paksa më ndryshe në Azinë Perëndimore. Në Gjirin Persik portugezët kishin pak ndikim mbi osmanët të cilët e ruanin këtë rrugë të rëndësishme detare. Sido që të jetë, portugezët i pengonte ta merrnin këtë rrugë detare nevojë për të ruajtur marrëdhëniet e mira me Persinë safevide (si një kundërpeshë ndaj turqve osmanë në ngritje). Kështu

<sup>356</sup> Menzies, 1421, fq. 43.

<sup>357</sup> *Gang Deng, Chinese Maritime Activities and Socioeconomic Development, c. 2100 BC-1900AD* (London: Greenwood Press, 1997), fq. 70-71.

që thjesht nuk qenë në gjendje ta mbushnin hendekun në Gjirin Persik (megjithëse kishin marrë Hormuzin), përmes të cilit turqit bartnin sasi të mëdha erëzash, shumë më tepër se ato që portugezët bartnin rreth Kepit. Portugezët nuk patën më shumë fat edhe në orvatjet e tyre për të shtënë në dorë rrugën e Detit të Kuq. Dështimi i tyre në marrjen e Adenit u dha një goditje të fortë shpresave të tyre, pasi ishin tepër të ethshëm për ta devijuar tregtinë e erëzave nga kontrolli osman. Madje edhe flota portugeze e dërguar atje për ta bllokuar të ashtuquajturën tregti hyrëse 'ilegale', nuk pati sukses. Dështimi i Albuquerque-s për ta marrë Adenin më 1513 nënkuptonte se Deti i Kuq mbetej një liqen musliman. Kjo do të rezultonte me pasoja veçanërisht të padëshirueshme për portugezët, pasi pas vitit 1540 nisi tregtia e erëzave përmes Detit të Kuq dhe Levantit.

Është e vërtetë se portugezët jo gjithmonë hasnin në qëndresë, por kur ndodhte kjo, ata zakonisht ishin humbësit. Për shembull ata hasën në qëndresë në Açeç, me pasoja të rënda për ta. Açeç ruajti rrugët e veta të tregtisë së erëzave me Detin e Kuq, në pavarësi nga portugezët. Si rrjedhojë këta të fundit nuk mundën ta ndalonin zhvendosjen e sasive gjithnjë e më të mëdha tregtie nga rrugët e tyre në rrugët e hershme përmes Detit të Kuq dhe Egjiptit. Jo vetëm rruga e Detit të Kuq, por e gjithë rruga deri në Indi e në Azinë Juglindore mbeti nën kontrollin e muslimanëve.<sup>358</sup> Për më tepër, 'madje thuajse brenda rrezes së qitjes së fortesave së Gaos, piratët moplalhë të Malabarit periodikisht bënin kërdinë mbi tregtinë bregdetare portugeze duke u prerë udhën *cafila*-ve.<sup>359</sup> Në 'bastionin' e tyre në Melaka, portugezët shpesh gjunjëzoheshin nga flotat javaneze dhe açeçiane.

<sup>358</sup> Reid, *Southeast Asia*, I, fq. 20-21.

<sup>359</sup> Boxer, *Portuguese*, fq. 58.

Këtu është interesante të vihet në dukje se imazhi i një bote lindore ushtarakisht të varfër u përmbys dhimbshëm që më 1511 kur Albuquerque sulmoi Melakën dhe pa se vendasit dinin ta përdornin po aq mirë sa ata vetë artilerinë e rëndë.<sup>360</sup> Por kjo s'ka pse të jetë befasuese po të kihet parasysh se baruti, tyta dhe topi janë shpikur në 'oborrin e pasmë' të Azisë Juglindore, në Kinë.

Për aq sa portugezët patën ndonjë sukses, kjo shpesh vetëm falë aftësisë së tyre për t'i kundërvënë ndaj njëri-tjetrit fraksionet rivale aziatike. Rastet e këtij lloji janë të shumta, por dy shembuj vlen të përmenden. Së pari, armiqësia mes zamorinit (raxhai detar) të Kalikutës dhe raxhait të Koçinit u mundësoi portugezëve të fitonin një pozitë në Kalikutë. Së dyti, rivaliteti midis tri mbretërive në Sejlton u dha mundësinë portugezëve të ruanin një prani atje. Duke patur parasysh dobësinë e tyre ushtarake, nuk është për t'u habitur që portugezëve u duhej të mbështeteshin kryesisht tek fati dhe dinakëria. Për t'u shënuar gjithashtu është se portugezët patën jashtëzakonisht fat që fuqitë kryesore lindore zakonisht zgjidhnin të mos u kundërviheshin. Por kjo konfirmon tezën time të përgjithshme. Sepse, siç arsyeton Chaudhuri, nuk kishte arsye që aziatikët t'u kundërviheshin portugezëve, duke qenë se këta nuk konsideroheshin si kërcënim ushtarak.<sup>361</sup>

Pak a shumë e njëjta gjë ka ndodhur me holandezët. Edhe pse holandezët u mbështetën tek forca më shumë se çdo 'kolonizator' tjetër, një pjesë të madhe të kësaj force ua kushtuan marrëdhënieve me portugezët sesa me aziatikët.<sup>362</sup> Veç kësaj, sukseset e tyre mund të ekzagjerohen lehtë.

<sup>360</sup> Jakob Van Leur, *Indonesian Trade and Society* (The Hague: W. van Hoeve, 1955), fq. 159.

<sup>361</sup> K. N. Chaudhuri, *Trade and Civilisation in the Indian Ocean* (Cambridge: Cambridge University Press, 1978), fq. 79.

<sup>362</sup> Fernand Braudel, *Civilization and Capitalism, 15th-18th Century*, III (Berkeley: University of California Press, 1992), fq. 212-213.

Megjithëse Goan dhe Makaon ua lanë portugezëve, arritën t'u merrnin këtyre të fundit disa porte kyçe, si Batavia, Sejloni, Melaka, Bantami, ndonëse kjo nuk qe e lehtë. Melakën e kishin sulmuar disa herë (për shembull, më 1607), por arritën ta merrnin vetëm më 1641. Ndërsa kur mbytn tetëdhjetë xhunke kineze më 1622, kinezët nuk pranuan të bënin tregti me ta deri një shekull më vonë, më 1727 (kur atyre iu dha një pozitë në Kanton). Gjatë këtij intervali, tregtarët kinezët shkonin në Java, por 'e mbanin tregtinë në duart e tyre dhe diktonin kushtet e tyre'.<sup>363</sup> Dhe, siç do ta shohim më vonë, poshtërimi i holandezëve u bë i plotë gjatë qëndrimit të tyre në ishullin japonez të Deshimës. Madje edhe në Batavia, e ashtuquajtur bastion holandez, tregtarët aziatikë ishin në gjendje t'u rezistonin inkursioneve holandeze.<sup>364</sup>

Si përfundim, fakti i thatë është se portugezët (dhe pasardhësit e tyre europeanë) thjesht nuk e zotëronin fuqinë ushtarake apo njerëzore për të shkuar në Azi 'me tytat në flakë' dhe për t'i detyruar aziatikët të nënshtroheshin në tre shekujt pas 1498-ës. Aq të dobët ishin ushtarakisht, sa nuk mund t'i mbushnin hendekët e njëpasnjëshëm që krijoreshin vazhdimisht në mbarë perandorinë e tyre imagjinare. Prandaj nuk është edhe aq për t'u habitur që 'teknologjia detare rrallë përmendet [nga europianët bashkëkohës] si tregues i epërsisë së europianëve mbi popujt joperëndimorë'.<sup>365</sup>

### Miti i monopolit tregtar european në Azi

Njëri nga faktorët që kanë mbajtur gjallë besimin eurocentrik se europianët e kanë dominuar sistemin tregtar të

<sup>363</sup> Clive Ponting, *World History* (London: Chatto and Windus, 2000), fq. 525.

<sup>364</sup> M. A. P. Meilink-Roelofs, *Asian Trade and European Influence in the Indonesian Archipelago between 1500 and about 1630* (The Hague: Martinus Nijhoff, 1962).

<sup>365</sup> Adas, *Machines*, fq. 48.

Azisë, qëndron në rëndësinë e ekzagjeruar që i është dhënë rrugës së Kepit pas 1500-ës. Ka një konsensus se zemra e ekonomisë botërore për nga pozicioni, që ishte bota islame, e humbi rëndësinë pasi Perandoria Osmane në rënie po zëvendësohej nga europianët gjithëpushtues. Kështu, për shembull, Fernand Braudel këmbëngul se nuk duhet 'nën-vlerësuar prania e portugezëve të cilët ia kaluan Islamit në Oqeanin Indian: sepse ky triumf i *teknologjisë* detare europiane vazhdoi ta pengonte përbindëshin turk që të vendoste një prani reale jashtë Gjirit Persik dhe Detit të Kuq'.<sup>366</sup> Një përfundim po kaq triumfalist sugjeron se:

Azia Qendrore ... u izolua që nga fillimi i shekullit të gjashtëmbëdhjetë ... dhe prandaj mbeti në skaj të historisë ... Zbulimi i rrugës detare për në Azinë Lindore [përmes Kepit] e bëri Rrugën e Mëndafshit gjithnjë e më të panevojshme ... Nga kapërcyelli i kohërave moderne, historia e Azisë Qendrore kthehet në histori province, çka na përlligj të mos u kushtojmë më shumë se një përshkrim të shpejtë shekujve pasues të kësaj historie.<sup>367</sup>

Në këtë përshkrim eurocentrik të jepet ideja sikur zbulimi i një rruge të re nga europianët rreth Kepit krijoi një 'liqen lumor' musliman ku rrugët e vjetra tregtare të muslimanëve erdhën duke u tharë, teksa rrjedha portugeze përmes Kepit u bë kryesore.

Ky formulim eurocentrik bart shumë probleme, ndër të cilët më i vogli nuk është se portugezët thjesht iu bashkuan rrugëve kryesore tregtare të mbizotëruara nga muslimanët osmanë.<sup>368</sup> Më konkretisht, janë pesë arsye kryesore pse rru-

<sup>366</sup> Braudel, *Civilization*, III, fq. 468, theksimi me kursiv është i imi.

<sup>367</sup> P. M. Holt, Ann K. S. Lambton dhe Bernard Lewis, cituar te Andre Gunder Frank, *ReOrient* (Berkeley: University of California Press, 1998), fq. 118.

<sup>368</sup> Marshall G. S. Hodgson, *Rethinking World History* (Cambridge: Cambridge University Press, 1993), fq. 97, 129.

ga portugeze e Kepit nuk arriti ta nxirrte jashtë loje fuqinë tregtare muslimane. Së pari, rruga e re e Kepit nuk ishte veçanërisht fitimprurëse sepse nuk i ulte kostot. Së dyti, fakti është se një vëllim shumë më i madh tregtar shkonte në Europë përmes Levantit dhe Venecias, që arrinte atje përmes Detit të Kuq, Gjirit Persik dhe rrugëve tokësore të karvaneve. Deri në vitin 1585, mbi tri herë më shumë piper dhe erëza kalonin përmes rrugës së Detit të Kuq dhe tokës në Europë, sesa përmes Kepit.<sup>369</sup> Veç kësaj, vetëm 10% e karafilit që hynte në Europë kalonte përmes Kepit.<sup>370</sup> Së treti, studimet e vona tregojnë se para vitit 1650 shumë më tepër eksporte metalesh të çmuara europiane për në Lindje kalonin përmes Perandorive Osmane e Perse, sesa nëpërmjet Kepit.<sup>371</sup> Për më tepër, sasia e argjendit që kalonte përmes këtyre perandorive u rrit edhe më shumë në periudhën 1650-1700 (sërish, shumë më tepër se sasia e bartur përmes Kepit).<sup>372</sup> Megjithatë, mund të thuhet se portugezët me siguri e mbizotëronin eksportin e argjendit në Azinë Jugore. Por befasues është fakti se midis 1580-ave dhe 1670-ave, sasitë e argjendit të eksportuara në Azinë Lindore nga të gjithë evropianët së bashku ishin mesatarisht 2240 tonë, kurse sasia e argjendit japonez ishte 6100 tonë.<sup>373</sup> Edhe sikur shifrat për Europën të jenë nënvlerësuar me 50%, eksporti japonez i argjendit sërish e tejkalonte lehtësisht atë të gjithë Europës

<sup>369</sup> Frederic C. Lane, "Venetian Shipping during the Commercial Revolution", *American Historical Review* 38 (2) (1933), 228; Niels Steensgaard, *The Asian Trade Revolution of the Seventeenth Century* (Chicago: Chicago University Press, 1974), fq. 155-169.

<sup>370</sup> Pearson, *New Cambridge History*, fq. 44.

<sup>371</sup> Najaf Haider, "Precious Metal Flows and Currency Circulation in the Mughal Empire", *Journal of the Economic and Social History of the Orient* 39 (3) (1996), 298-367.

<sup>372</sup> Sanjay Subrahmanyam, "Precious Metal Flows and Prices in Western and Southern Asia, 1500-1750: some Comparative and Conjunctural Aspects", te S. Subrahmanyam (red.), *Money and the Market in India 1100-1700* (Delhi: Oxford University Press, 1994), fq. 201, gjithashtu fq. 197-201.

<sup>373</sup> Llogaritja from Reid, *Southeast Asia*, I, tabela 3, fq. 27.

mbarë. Së katërta, dëshmi e qartë që rruga e Kepit nuk kish-te ndonjë rëndësi kushedi çfarë, është se portugezët 80% të fitimit të tyre tregtar e përftonin brenda Azisë Lindore nëpërmjet tregtisë mes vendeve. Miti i monopolit tregtar portugez askund nuk bëhet më i qartë sesa nga fakti se një pjesë të madhe të fitimit portugezët e siguronin nga këmbimi valutor e jo nga tregtia. Së pesti e së fundmi, monopolin portugez e përgënjeshtrojnë fakti i thjeshtë se në shekullin e gjashtëmbëdhjetë, vetëm 6% të tonazhit të përgjithshëm dëtar nën sistemin tregtar të Oqeanit Indian u përkiste portugezëve.<sup>374</sup>

Mund fare mirë të përgjigjet se portugezët kontrollonin së paku tregtinë e erëzave. Por kontrolli i tregtisë së erëzave nga portugezët bie në sy vetëm për mungesën e tij. Në Malabar, për shembull, ata arrinin të blinin dhe të dërgonin me anije vetëm 10% të sasisë së përgjithshme të prodhuar. Po ashtu ata zotëronin vetëm 5% të tregtisë së piperit në Guxharati. Për më tepër, kur portugezët morën në kontroll portin indian të Diut më 1535, guxharatianët shpejt filluan të grumbullonin sasi të mëdha piperi në Gjirin e Bengalit, prej ku e tregtonin në mbarë Oqeanin Indian. Po ashtu, kur portugezët u përpoqën ta bllokonin tregtinë nga Kalikuta, rrugë të reja tregtare u shfaqën, ku piperi tregtohej nga Kanara (në veri të Malabarit) si dhe nga Gjiri i Bengalit dhe Açe. Charles Boxer përlllogarit se më 1585, vetëm açehanët tregtonin në Xhidde (në Detin e Kuq) thujse të njëjtën sasi erëzash që portugezët sillnin në Europë përmes Kepit.<sup>375</sup> Nëse kontrolli i portugezëve mbi piperin nuk ishte aspak mbresëlënës, kontrolli i tyre mbi erëzat e tjera ishte akoma më pak. E vetmja erëz mbi të cilën portugezët arri-

<sup>374</sup> Van Leur, *Indonesian Trade*, fq. 212, krahaso, fq. 235.

<sup>375</sup> Boxer, *Portuguese*, fq. 59, 61.

tën njëfarë monopoli ishte kanella. Por për fatin e keq të kurorës portugeze, kjo rezultoi një fitore pirroje sepse, 'në të vërtetë, fitimet kryesore i vilnin guvernatorët dhe ofiqarët të cilët e përvetësonin ose e tregtonin kanellën, përkundër tërë legjislacionit të miratuar në Goa dhe Lisbonë për t'i parandaluar këto abuzime'.<sup>376</sup>

Në këtë pikë, mund të pretendohet se kishte një monopol tregtar portugez çka e vërtetonte sistemi i *cartaz*-it i vënë në jetë në tërë Oqeanin Indian. Që do të thotë se të gjitha anijet joportugeze ishin të detyruara të kishin një pasaportë (*cartaz*) e cila e detyronte bartësin t'u paguante para ose taksa portugezëve. Por sistemi i *cartaz*-it ironikisht rezultoi të ketë qenë një lëshim disi i nënkuptuar nga portugezët kundrejt faktit që ata thjesht nuk arritën, e jo më të ruanin, një monopol tregtar në Azi. Ajo që i shpëton këndvështrimit konvencional eurocentrik është se *cartaz*-i ishte më shumë një mjet i përdorur nga aziatikët për qëllimet e tyre. Shumë tregtarë aziatikë mbanin flamurin portugez jo dhe aq si she një nënshtrimi, por si mënyrë për të përfituar nga doganat e ulëta në portet portugeze (sepse anijet portugeze paguanin tarifa shumë më të ulëta – 3.5% kundrejt 6%). Por edhe për ata që nuk mbanin *cartaz*, 'pranimi i kontrollit portugez në fakt nënkuptonte thjesht pagimin e një dogane shtesë prej rreth 5%. Kjo ishte gjithë domethënia e kontrollit portugez dhe kjo shumë mund të rikuperohej lehtësisht me një rritje të lehtë të çmimeve'.<sup>377</sup> Veç kësaj, shumë pronarë aziatikë anijesh zgjidhnin ta blenin *cartaz*-in sepse kushtonte shumë më pak se armatosja e anijeve. Problemi i tregtarëve aziatikë nuk ishte edhe aq pamundësia për t'i bërë ballë fuqisë ushtarake të portugezëve, por se para se të vinin këta

<sup>376</sup> Po aty, fq. 62.

<sup>377</sup> Pearson, *New Cambridge History*, fq. 54.

të fundit, sistemi tregtar në Oqeanin Indian kishte funksionuar në linja paqësore. Prandaj për aziatikët, armatosja e anijeve ishte jo vetëm e panevojshme, por edhe irracionale ekonomikisht. Kësisoj, 'tekta portugezët kishin vendosur të investonin në armë për të mbledhur pagesa kundrejt mbrojtjes, Guxharati vendosi të paguante çmimin për mbrojtje ... [çka] u mundësoi të vazhdonin të bënin tregti sipas dëshirës'.<sup>378</sup> Gjithsesi, kjo ishte zgjidhja më e lirë ose 'ekonomikisht racionale'. Për t'u shënuar gjithashtu është se pas të ashtuquajturit 'ndalim perandorak' më 1434, shumë tregtarë privatë kinezë lundronin me dokumente të blera në Melaka ose Makao, sepse kjo i bënte anijet zyrtarisht portugeze, kështu që mund ta anashkallonin me sukses (dhe madje me çmim të ulët) ndalimin.<sup>379</sup>

Prandaj, për shumë tregtarë aziatikë, flamuri portugez ishte më shumë çështje 'rehatie', sesa bezdie. Dhe nëse portugezët e kanë mbizotëruar Oqeanin Indian, duke i nxjerrë jashtë loje të gjithë të tjerët (çka është e qartë se nuk ka ndodhur), si mund ta shpjegojmë faktin se guxharatianët dhe diasporat e tjera lindore tregtare ishin të kënaqur të bashkëpunonin vullnetarisht me ta dhe të financonin një pjesë të madhe të tregtisë portugeze? Por aziatikët gëzonin avantazhe shumë të rëndësishme tregtare nga lidhja e aleancave tregtare simbiotike me portugezët.<sup>380</sup>

Edhe kur aziatikët zgjidhnin të mos u paguanin para portugezëve, këta të fundit e shihnin se s'mund të bënin ndonjë gjë të madhe. Për shembull, nëse anijet 'vulëkuqe' japoneze sulmoheshin nga portugezët (ose nga cilado fuqi europiane), e raportonin rastin tek autoritetet japoneze në

<sup>378</sup> Philip D. Curtin, *Cross-Cultural Trade in World History* (Cambridge: Cambridge University Press, 1984), fq. 145.

<sup>379</sup> Po aty, fq. 144-148; shih gjithashtu fq. 159-167 dhe kapitullin 8.

<sup>380</sup> Pearson, *New Cambridge History*, fq. 55.

Nagasaki, të cilat atëherë kapnin dhe mbanin peng anije europiane të cilat i linin të lira vetëm pasi të paguhej kompensimi i kërkuar. Kjo na kthen sërish te çështja e cekur më sipër e inferioritetit ushtarak. Realiteti është se ëndrrat për pushtim reshtën së shpejti dhe portugezët u qetësuan dhe u bënë një nga grupet e shumta tregtare në Oqeanin Indian. Sipas Tomé Pires-it në librin e tij *Suma Oriental*, edhe në të ashtuquajturin bastion të tyre, në Melaka, fliteshin jo më pak se tetëdhjetë e katër gjuhë,<sup>381</sup> çka tregon se portugezët ishin thjesht një nga diasporat e shumta tregtare (dhe jo nga më të rëndësishmet).

Pak a shumë të njëjtin fat patën edhe holandezët. Pavarësisht gjithë përpjekjeve të tyre, krijimi i një sistemi tregtar monopolist imperial rezultoi të ishte thjesht një ëndërr. Orvatjet për ta monopolizuar tregtinë dhe për t'i rritur çmimet, shpesh krijonte efekt të kundërt. Shembulli më i mirë në këtë drejtim është përpjekja e holandezëve për të krijuar një monopol të karafilit. Pasi i shkatërruan pemët e karafilit në zonat jashtë kontrollit të tyre, në vitet 1660 çmimet u dyfishuan, çka shpejt i trazoi tregjet europiane. Zgjidhja u arrit me importimin në Europë të 'drurit të karafilit' nga Brazili. Së përfundim, përpjekjet e holandezëve për të vënë monopol krijuan efekt të kundërt, pasi sasi të mëdha karafili vërshuan në Europë nga Brazili, çka i pakësoi fitimet e holandezëve në një nga tregtitë e tyre më fitimprurëse me Azinë.<sup>382</sup> Shkurt, holandezët nuk arritën ta realizonin një gjë të tillë për shkak të trysnisë konkurruese globale.

Por më përgjithësisht akoma, pavarësisht përpjekjeve të saj, VOC-i (Kompania Holandeze e Indisë Lindore) nuk arriti të krijonte një treg të monopolizuar askund në Azi.

<sup>381</sup> Tome Pires, *Suma Oriental* (Glasgow: The University Press, 1944), fq. 268-269.

<sup>382</sup> Reid, *Southeast Asia*, I, fq. 23.

Vetëm me një produkt, karafilin, holandezët thuajse arritën ta realizonin këtë gjë, ndonëse kjo shpejt rezultoi një fitore pirroje, siç sapo u tregua më lart. Për më tepër, ky rast ngjan të jetë përjashtimi që vërteton ‘rregullin antieurocentrik’. Sepse në çdo produkt tjetër ku qe përfshirë VOC-i, kushtet tejet konkurruese tregtare globale bënë që mburrjet e holandezëve se zotëronin monopole tregtare të mbështetshin në ëndrra më shumë sesa në fakte. Shembuj të shumtë mund të jepen. Por dy nga më ilustruesit kanë të bëjnë me tregtinë e produkteve të pambukut në veriperëndim të Oqeanit Indian. Këtu holandezëve u duhej të konkurreonin me tregtarët guxharatianë. Në këtë tregti holandezët arritën të zotëronin vetëm 10% të tregut. Për më tepër, guxharatianët kishin raporte më të mëdha fitimi se holandezët. Kjo natyrshëm e irritonte mjaft VOC-it, ndaj kompania bëri një hulumtim për shkaqet e kësaj situate. Siç tregon Van Santen:

Si mundej një tregtar modest nga Guxharati të konkurreonte me VOC-in e fuqishëm? Përgjigja që japin vetë punonjësit e kompanisë tingëllon mjaft bindëse. Tregtarët indianë thjesht punonin me kosto shumë më të ulëta ... Krahas kësaj, siç e pohonin shërbyesit holandezë, ata kishin njohuri shumë më të thella mbi funksionimin e tregut kur blinin dhe shisnin *bafta-t*, *tapechinde-t* apo *chela-t* e tyre.<sup>383</sup>

Van Santen vijon, duke vënë në dukje në po atë faqe se, ‘pas shumë dekadash me rezultate zhgënjyese financiare, VOC e pranoi humbjen dhe në vitet 1660 i dha fund tregtisë’. VOC u përpoq të hynte edhe në tregtinë e pambukut në Mokha, por u ndesh me probleme të ngjashme. Që atje

<sup>383</sup> H. W. Van Santen, “Trade between Mughal India and the Middle East, and Mughal Monetary Policy, c. 1600-1660”, te Karl R. Haellquist (red.), *Asian Trade Routes* (London: Curzon Press, 1991), fq. 89.

VOC eksportoi rreth 70.000 njësi pambuku në mesin e shekullit të shtatëmbëdhjetë. Por kjo ngjan e papërfillshme krahasuar me shifrat e Guxharatit prej 990.000 njësisish më 1647.<sup>384</sup> Kështu, holandezët, ashtu si sivëllezërit e tyre portugezët, panë se s'kishin zgjidhje tjetër veçse të hiqnin dorë nga ambiciet e tyre dhe të bëheshin një ndër grupet e shumta tregtare në sistemin e Azisë.

### Miti i dominimit politik evropian në Azi

Tani vjen pyetja përfundimtare: nëse fuqia ushtarake nuk arriti të siguronte një monopol tregtar evropian, atëherë si arritën evropianët të shtinin në dorë pozitat e tyre, ndonëse modeste, në zonën tregtare aziatike? Evropianët – në fillim portugezët e më vonë holandezët e anglezët – nuk kishin zgjidhje tjetër veçse të bashkëpunonin dhe ndonjëherë t'u bënë temena sundimtarëve e tregtarëve më të fuqishëm aziatikë. Por fakti është se përkundër deklarimeve të tyre mburracake fillestare për 'vdekje të të pabesëve (muslimanë)', kur arritën në Indet, portugezët 'hynë edhe në hapësirën e hegjemonisë islame' dhe qenë të detyruar të bashkëpunonin.<sup>385</sup>

Ky bashkëpunim ose partneritet i ndërsjelltë kishte një sërë aspektesh. Së pari, sundimtarët aziatikë u njohën portugezëve një formë të kufizuar 'ekstraterritorialiteti', që përfshinte ngulimet kyçe të Makaos në Kinë, të São Tomé-s në Bregun Koromandelian të Indisë dhe Hughlin në Bengal. Së dyti, për shkak të mungesës së burimeve, portugezët nuk kishin alternativë përveç se të mbështeteshin në burimet vendase financiare, veçanërisht tek *baniat*-ët indianë.

<sup>384</sup> Van Santen, "Trade", fq. 90.

<sup>385</sup> Eric R. Wolf, *Europe and the People Without History* (Berkeley: University of California Press, 1982), fq. 234.

Së treti, tregtarët portugezë dhe aziatikë përziheshin shpesh mes tyre, për avantazh të të dyja palëve. Tregtarët aziatikë shpesh kishin më shumë mall në anijet portugeze se ç'kishin tregtarët portugezë. Siç e vë në dukje Pearson,

Duket se portugezët dërgonin mallra me anije guxhariane dhe anasjelltas, në një mënyrë të përzier mjaft tipike për tregtinë private portugeze. Këtu luheshin interesat për shumicën e portugezëve, e jo në përpjekjen ekstravagante të shtetit për monopol.<sup>386</sup>

Dhe së katërti, portugezët nuk kishin zgjidhje tjetër veçse të mbështeteshin në burimet vendase për informacion. Siç e shpjegon Braudel:

Në Kandahar ... një tregtar indu, duke e marrë për portugez udhëtarin spanjoll, i ofroi atij shërbimet e tij sepse, siç shpjegoi, 'njerëzit e vendit tuaj nuk e flasin gjuhën e këtij vendi, kështu që është e sigurt se do të hasni në vështirësi po nuk gjetët dikë që t'ju prijë'. Ndiheja, bashkëpunimi, marrëveshjet e fshehta, bashkëjetesa, simbioza, të gjitha këto me kohë u bënë të domosdoshme.<sup>387</sup>

E njëjta gjë vlen edhe për holandezët dhe anglezët deri rreth vitit 1800. Ashtu si portugezët, edhe holandezët e anglezët u përzien me aziatikët në shumë mënyra, përfshirë, ndër të tjera, edhe pajtimin e ekuipazheve të njëri-tjetrit, madje të anijeve të tëra, si dhe huamarrje nga kapitali aziatik.<sup>388</sup> Një shenjë e kësaj ishte se holandezët dhe anglezët shpejt ndoqën rrugën e portugezëve, duke zënë një vend në

<sup>386</sup> M. N. Pearson, "India and the Indian Ocean in the Sixteenth Century", te Ashin Das Gupta dhe M. N. Pearson (red.), *India and the Indian Ocean 1500-1800* (Calcutta: Oxford University Press, 1987), fq. 78.

<sup>387</sup> Braudel, *Civilization*, III, fq. 489.

<sup>388</sup> P. J. Marshall, "Private British Trade in the Indian Ocean before 1800", te Das Gupta and Pearson, *India*, fq. 280, 283, 287, 292-293.

tregtinë fitimprurëse ndëraziatike. Më 1648, drejtuesit e VOC-it shkruanin se, 'tregtia e brendshme dhe fitimet prej saj janë shpirti i kompanisë që duhet ruajtur me kujdes, sepse nëse kalbet shpirti, i gjithë trupi priset'.<sup>389</sup> Dhe siç e vumë në dukje në kapitullin 4, holandezët mbështeteshin tek tregtia e metaleve të çmuara për pjesën dërrmuese të të ardhurave të tyre. Në mënyrë të ngjashme, përballë një mungese kronike prodhimesh për të tregtuar me Azinë, edhe anglezët përfunduan duke u bërë pjesë e tregtisë ndëraziatike:

Në pamundësi për ta realizuar qoftë edhe kuotën e saj prej 10% të eksportit, kompanisë [Kompania e Indisë Lindore] i duhej të mbifaturonte e nënfaturonte për t'i ulur eksportet 'në total', dhe ishte nën presion të vazhdueshëm për të gjetur financim në vetë Azinë për importet e saj aziatike. Kështu që u përfshi në 'tregtinë e brendshme' ndëraziatike, e cila ishte shumë më e zhvilluar dhe fitimprurëse sesa tregtia Azi-Europë.<sup>390</sup>

Sërish, si holandezët edhe anglezët, shpejt e panë se ishin të detyruar të bashkëpunonin, ndonjëherë të bënin temena dhe kurdoherë të mbështeteshin në dashamirësinë e tregtarëve dhe sundimtarëve aziatikë.<sup>391</sup> Dhe nivelet e poshtërimit që europianët ishin të gatshëm të toleronin vetëm për të marrë një pjesë të vogël të tregtisë fitimprurëse aziatike, askund nuk shprehen më mprehtësisht se në përvojën e holandezëve në Japoni. Atje ata ishin të ngujuar në ishullin e vockël të Deshimas (75 me 120 metra), në portin e Nagasakit. Për më se dy shekuj:

<sup>389</sup> Om Prakash, "The Dutch East India Company in the Trade of the Indian Ocean", te J. F. Richards (red.), *Precious Metals in the Late Medieval and Early Modern Worlds* (Durham: Carolina Academic Press, 1983), fq. 189-190.

<sup>390</sup> Frank, *ReOrient*, fq. 74-75.

<sup>391</sup> Wolf, *Europe*, fq. 240.

Holandezët vëzhgoheshin nga shërbëtorët e tyre dhe kontrolloheshin nga një trupë përkthyesish prej 150 vetash. Vetëm një anije në vit lejohej në port dhe oficerët e saj zakonisht 'rriheshin me shkopinj si të ishin qen'. Lejoheshin ta vizitonin vendin një herë në vit për t'i bërë homazhe shogunit.<sup>392</sup>

### Përfundim

Si përfundim, rezultati kryesor i 'perandorisë' detare portugeze (si dhe holandeze e angleze) nuk qe se sa shumë, por se sa pak ndryshuan gjërat për sa i përket dominimit aziatik të ekonomisë globale mes viteve 1500 dhe 1750/1800. Këtij përfundimi vështirë se mund t'i shmangesh: 'epoka europiane' ose 'epoka e Vasko de Gamës' e Azisë nuk është veçse një ëndërr retrospektive eurocentrike. Kjo njëkohësisht vërteton argumentet e bëra në kapitullin 4 se India dhe Azia Juglindore, Japonia, Kina si dhe perandoritë osmane e perse, ishin mjaft të fuqishme ekonomikisht e politikisht për t'i rezistuar inkursionit europian, të paktën deri rreth 1800-ës. Në dritën e gjithë kësaj vlen ta përfundojmë duke e krahasuar mburrjen imperiale të mbretit të Portugalisë, Manuelit I, me atë të sulltanit Osman, Selimit 'të Ashpër' (Javuz Selimit, red.). Në një letër drejtuar papës më 28 gusht 1499, Manueli mburrej se ishte: 'Kryezot i Guinesë dhe i Viseve, Detrave e Tregtisë së Etiopisë, Arabisë, Persisë dhe Indisë'. Kjo mund t'i ketë lënë mbresa papës, por do të dilte se ishte një pretendim katërcipërisht ëndërrimtar. Në këtë kuadër, mburrja e Selimit ishte shumë më afër së vërtetës:

<sup>392</sup> Ponting, *World History*, fq. 525.

Tashmë të gjitha viset e Egjiptit, Malatja, Halebi, Siria, qyteti i Kajros, Egjipti i Epërm, Etiopia, Jemeni, viset deri në kufijtë e Tunizisë, Hixhazi, Meka, Medina dhe Jeruzalemi, Zoti ua shtoftë e ua përmbushtë krenarinë, janë pjesë e Perandorisë Osmane.

Po ashtu, më afër së vërtetës ishin fjalët e sulltanit osman, Sulejmanit (të cilin europianët e quajnë ‘i Madhërishtmi’) më 1538:

Unë jam Sulejmani, në emër të të cilit lexohet hutbeja e së premtes në Mekë dhe Medinë. Jam Shahu i Bagdadit, Cezari i Bizantit dhe Sulltani i Egjiptit, i cili i dërgon flotat e tij në detrat e Europës, Magrebit dhe Indisë.<sup>393</sup>

Prandaj, si përfundim, është e domosdoshme ta korrigjojmë citimin e Roberts-it (bërë në fillim të kapitullit): ‘Nëse flasim thjesht për fakte, për çfarë ka ndodhur [midis viteve 1500-1800] ... atëherë është krejt *e gabuar* ta vendosim Europën në qendër të historisë [së Azisë]’. I njëjti përfundim vlen edhe për zhvillimin e Europës në këto shekuj, temë së cilës do t’i kthehem tani.

<sup>393</sup> Suleyman, cituar te Jonathan Bloom dhe Sheila Blair, *Islam: Empire of Faith* (London: BBC Books, 2001), fq. 158.

## **PJESA III**

**Perëndimi si rajon me zhvillim të vonë dhe  
avantazhet e prapambetjes: globalizimi oriental dhe  
rindërtimi i europës perëndimore si perëndimi  
i përparuar, 1492-1850**



## 8. MITI I 1492-SHIT DHE PAMUNDËSIA E AMERIKËS: KONTRIBUTI AFRO-AZIATIK NË ARRITJEN E PJESËS TJETËR TË BOTËS NGA PERËNDIMI, 1492-RR. 1700

Është mirë të shihet forca, vlera dhe pasojat e zbulimeve. Këto s'mund të shihen askund më mirë sesa tek shtypshkronja, baruti dhe magneti [busulla]. Sepse këto ua kanë ndryshuar faqen dhe gjendjen gjërave në mbarë botën.

*Francis Bacon, 1620*

'Epoka e madhe e ekspansionit europian' nuk nuk nënkupton vërshimin e një dinamizmi të ndrydhur [racional]. Ajo nisi nga skajet e pasigurta të një qytetërimi në tkurrje ... Europa e shekullit të pesëmbëdhjetë do t'iu duket [historianëve në të ardhmen e largët], nëse do ta vënë re ndonjëherë, si e amullt dhe introspektive ... Ekonomia [e saj] në tërësi vazhdonte të vuante një balancë tregtare gjithnjë të pafavorshme me Islamin dhe s'mund të garantonte as ushqyerjen e popullatës së vet.

*Felipe Fernandez-Armesto*

Kurrfarë barazie nuk ishte e mundur dhe as e dëshirueshme për 'të errëtit'. Në linjën e kësaj bindjeje... katolikët dhe protestantët në fillim i damkosën zezakët paganë me 'mallkimin e Kanaanit', pastaj u ofruan shpresën e lirisë përmes 'konvertimit' dhe në fund i pranuan në ... statusin e skllëvërve.

*W. E. B. Du Bois*

Një nga vitet kyç në kronologjinë eurocentrike të historisë botërore është viti 1492. Merret si e padiskutueshme se botën do ta zbulonin europianët. Sepse gjer atëherë vetëm

europianët kishin zhvilluar atë çka Max Weber do ta quante 'shqetësim racional' dhe 'etikë e zotërimit të botës', çka bëri të mundur zhvillimin modern nga njëra anë dhe pushtimin e botës nga ana tjetër. Shenja më e njohur e kësaj që 'zbulimi' i Amerikës nga Kolombi. Nga ana tjetër, Lindjen u udhëhiqte një mentalitet irracional dhe fatalizëm afatgjatë që prodhonte një konformitet pasiv ndaj botës dhe tërheqje prej saj. Prandaj fati i saj ishte të mbetej në prapambetje ekonomike dhe thjesht të priste që europianët ta zbulonin dhe ta emanciponin. Këtu unë rrekem të bëj një kritikë të 'mitit' eurocentrik 'të 1492-shit': që Europa që arkitektja e zhvillimit të saj dhe rreth fundit të shekullit të pesëmbëdhjetë kishte arritur majat e botës.

Fakti është se jo vetëm që Kolombit dhe De Gamës u ka paraprirë epoka afro-aziatike e zbulimeve, e cila filloi pas vitit 500 (kap. 2), por Europa ishte ende shumë pas Lindjes për sa i përket fuqisë ekonomike e ushtarake deri në shekullin e nëntëmbëdhjetë. (kap. 3 dhe 4). Ky kapitull mbron idenë se në periudhën 1500-1800, Europa thjesht po e arrinte Lindjen. Europa nuk ishte një rajon me zhvillim të hershëm, por të vonë, i cili gëzonte 'avantazhet e prapambetjes ekonomike'.<sup>394</sup> Që do të thotë se Europa nuk i priu e vetme zhvillimit të saj, por vazhdoi të imitonte e të përvetësonte kapacitetet burimore superiore të zhvilluara nga rajonet lindore me zhvillim të hershëm e të përhapura të gjitha nëpërmjet globalizimit lindor (shih më poshtë). Veç kësaj, Europën e ndihmoi ta mbyllte distancën edhe përvetësimi i burimeve të Amerikave dhe Afrikës (shih pjesën e parë më poshtë).

<sup>394</sup> Shih, gjithashtu, Andre Gunder Frank, *ReOrient* (Berkeley: University of California Press, 1998), fq. 318-319, 334.

## Pamundësia e Amerikës dhe miti i Kristofor Kolombit

Eurocentrizmi e ngre lart zbulimin e Kolombit si tregues të gjenialitetit modern të Europës. Ky gjenialitet gjoja qëndronte në teknikat superiore europiane të anijendërtimit dhe lundrimit, si dhe në shfaqjen e ideve të moderne shkencore e racionale të lidhura me të ashtuquajturën Rilindje Perëndimore. Në kapitullin e mëparshëm trajtova ‘mitin e Vasko de Gamës’, ku mbrojta idenë se thuajse të gjitha aspektet që bënë të mundur arritjen e tij në Indi – anijet dhe teknologjitë e teknikat e tij të lundrimit – ishin, në një mënyrë ose një tjetër, të marra ose nga Kina, ose nga Lindja e Mesme muslimane. E njëjta gjë vlen edhe për Kolombin. Pa këto dhurata shumëdimensionale të Lindjes, Kolombi thuhet se siguri nuk do ta kishte kaluar dot Atlantikun.

Supozimi se Kolombi përfaqësonte një tërësi idesh moderne racionalo-shkencore është mit, pikërisht sepse udhëtimet e tij (ashtu si ato të Vasko de Gamës) ishin fundamentalisht të ndërlidhura me një mendësi të krishterë kryqtare, të shfaqur për herë të parë në shekullin e njëmbëdhjetë. Me që e kam trajtuar në kapitullin e fundit këtë temë, nuk do ta shtjelloj sërish këtu. Por mjafton të vihet në dukje se Kristofor Kolombi, ashtu si Vasko de Gama dhe monarkia spanjolle, ishin të obsesuar nga ideja e një kryqëzate kundër Islamit. Dhe ndonëse është e vërtetë se Kolombi ishte i vendosur për të gjetur ar, kjo ishte e domosdoshme për të financuar ripushtimin e Tokës së Shenjtë (duke patur parasysh prapambetjen e Europës kundrejt Perandorisë Osmane). Më 26 dhjetor 1492, Kolombi shkruante në ditarin e tij se ‘shpresoj të gjej ar në sasi të tilla që mbretërit [spanjollë] të mundën, brenda tre vjetësh, të përgatiten dhe të ndërmarin pushtimin e Tokës së Shenjtë’.<sup>395</sup> Në mënyrë më dome-

<sup>395</sup> Columbus, cituar te Marc Ferro, *Colonization: A Global History* (London: Routledge, 1997), fq. 5.

thënëse, në 'Lettera Rarissima', më 1503, ai citonte fjalët e Marko Polos: 'Perandori i Katajit para disa kohësh ka kërkuar t'i dërgojnë njerëz të mençur për t'ia mësuar fenë e Krishtit'. A është e mundur që Kolombi e shihte misionin e tij si rikthim të njerit prej 'mbretërve të mençur' në Lindje për të bartur atje Lajmin? Me siguri e shihte veten 'si të zgjedhur, të ngarkuar me një mision hyjnor'.<sup>396</sup> Nuk është rastësi që po atë vit kur Kolombi u nis në udhëtimin e tij, u shpall zyrtarisht Inkuizicioni Spanjoll dhe u mor Granada nga muslimanët. Vetë Kolombi, në fillim të ditarit të vet, e vinte në dukje lidhjen e drejtpërdrejtë midis ripushtimit të Granadës dhe udhëtimit të tij.<sup>397</sup> Veç kësaj, siç e pamë në kapitullin pararendës, papë të shumtë i kishin bekuar udhëtimet përmes një sërë dekretesh papnore. Jo më pak e rëndësishme, 'pushtimi' spanjoll i Amerikave dhe 'pushtimi' portugez i Azisë u sanksionuan zyrtarisht – dhe kësisoj u legjitimuan shpirtërisht – nga Papa Aleksandri VI në Traktatin e Tordesillas-it më 1494 (ndonëse, sigurisht, fuqi të ndryshme protestante europiane më vonë nuk e pranuan legjitimitetin e tij).

Nëse kishte ndonjë gjë të re, ishte se udhëtimeve në fjalë u qe bashkangjitur një identitet europian i shfaqur rish-taz, i cili e skaliste Perëndimin si superior ndaj 'jo-Europës'. Paradoksalisht kjo shkonte krah përkrah me Krishterimin (racizmi do të shfaqej shumë më vonë, siç e shpjegoj në kap. 10). Megjithatë ishte e qartë se europianët i shihnin vendasit indianë (dhe më vonë afrikanët e zinj) aq inferiorë, sa t'i konsideronin pa kurrfarë dyshimi si 'të pjekur për shfrytëzim' dhe 'të pjekur për konvertim'. Cilësimi 'indian' është veçanërisht domethënës, pasi për Kolombin nënkuptonte

<sup>396</sup> Tzvetan Todorov, *The Conquest of America* (New York: Harper and Row, 1984), fq. 10, dhe fq. 11-13.

<sup>397</sup> Shih David Abernethy, *The Dynamics of Global Dominance* (London: Yale University Press, 2000), fq. 184.

'pamundësinë e Amerikës'. Deri në ditën kur vdiq kokëfortësisht refuzoi të pranonte se nuk kishte arritur të zbulonte Kinën ose Indet Lindore (çka është arsyeja pse vendasit u quajtën indianë). Do të nxirrte gjithfarë justifikimesh të rreme gjeografike (të gjitha në kuadër të koncepteve ortodokse të krishtera për gjeografinë e botës) për të provuar se kishte zbuluar vërtet Azinë. Nga shumë shembuj, dy vlejné të përmenden. Besonte se Kuba ishte Kipangu (Japonia e Marko Polos), ndonëse pasi zbarkoi atje me të drejtë ndryshoi mendim, por pastaj nxori përfundimin se kishte arritur në tokën kineze të cilën e kishte kërkuar me dëshpërim. Dhe kur 'indianët' vendas i folën për karibat (banorët e Karaibeve) Kolombi e dëgjoi këtë si kaniba (shtetasit e Hanit të Madh të Azisë), çka ia 'konfirmonte' sërish të pamundurën! Prandaj dhe pretendimi i mprehtë i Edmundo O'Gorman-it se Kolombi e shpiku më shumë se ç'e zbuloi Amerikën.<sup>398</sup> Mendësia e Kolombit është rrokur saktë në fjalët e Bartolome de Las Casas-it: 'Ç'gjë e mrekullueshme është se si kur një njeri e dëshiron diçka dhe e ngulit fort atë në imagjinatë, gjithçka që dëgjon dhe shikon në çdo hap kujton se ia vërteton atë gjë.'<sup>399</sup> Jo për t'u habitur, emërtimi i këtij kontinenti 'Kolombia' rezultoi një pamundësi. Për më tepër, 'pamundësia e Amerikës' nuk ishte askund më e qartë në mendjen e Kolombit, sesa në perceptimin e tij për njerëzit që gjeti atje.

Kur zbarkoi në Amerikë, Kolombi nisi t'i shihte vendasit në dy mënyra, të dyja të frymëzuara nga botëkuptimi i tij paraprak i krishterë. Ata që e përshëndesnin me njëfarë dashamirësie, u panë si 'bij' të pafajshëm 'të natyrës', të përshtatshëm për të pranuar Krishterimin. Kurse për armiqësorët, ku përfshiheshin edhe ata që nuk pranonin të kon-

<sup>398</sup> Edmundo O'Gorman, *The Invention of America* (Bloomington: Indiana University Press, 1961), veçanërisht fq. 3; gjithashtu Todorov, *Conquest*, fq. 14-33.

<sup>399</sup> Las Casas, cituar te O'Gorman, *Invention*, fq. 79.

vertoheshin, nisi të mendonte se do të duhej të nënshtrohe-  
shin nëpërmjet forcës, skllavërimit ose shfarosjes. Së këtejmi  
edhe ideja e 'të egrit fisnik' i cili mund të asimilohej, kun-  
drejt 'të egrit jofisnik' të cilit i takonte ose skllavërimi, ose  
shfarosja. Ky ishte sfondi i debatit të famshëm të Vallado-  
lid-it më 1550, ku koncepti i të egrit jofisnik i Juan Gines de  
Sepulveda-s u vu përballë konceptit të të egrit fisnik të Bar-  
tolome de Las Casas-it. Ky i fundit fitoi sepse Kisha Kato-  
like e mbështeti, dhe kjo vetëm sepse pohimi se vendasit  
nuk mund të bëheshin të krishterë do të binte ndesh me  
teorinë e monogjenezës të përvijuar në Bibël. Për më tepër,  
në vitin 1537 papa arriti në përfundimin se vendasit jo ve-  
tëm që kishin kapacitet për ta pranuar Krishterimin, por  
'dëshirojnë tej mase ta pranojnë atë'.<sup>400</sup> Megjithatë, Kolombi,  
krahas spanjollëve që kishte me vete, nuk e 'zbuloi' Ameri-  
kën, por e interpretoi atë (ose e shpiku) përmes prizmit për-  
zgjedhës të botëkuptimit të tij paraprak. Ose, siç shprehet  
Todorov: 'Ai e dinte që më parë se ç' do të gjente; përvoja  
konkrete i vlente vetëm për të ilustruar një të vërtetë që ai e  
kishte tashmë'.<sup>401</sup> Amerika nuk ekzistonte në vetvete që të  
'zbulohej', por u kuptua vetëm përmes perceptimesh të jash-  
tme të krishtera, të imponuara ose të projektuara; së këtejmi  
edhe pamundësia e dyfishitë e Amerikës për Kolombin.

Pavarësisht fitoresh ideologjike të Las Casas-it mbi Se-  
pulveda-n, do të ishte krejtësisht e gabuar të supozonim se  
koncepti i Kishës për barazinë e natyrshme të të gjithë nje-  
rëzve e përjashtonte trajtimin e pabarabartë ndaj disa prej  
tyre. Në fakt, dy këndvështrimet për vendasit indianë i  
dhanë shkas një versioni të hershëm retorike imperiale që  
do të piquej plotësisht kryesisht në shekujt e tetëmbëdhjetë

<sup>400</sup> Cituar te Alfred W. Crosby, *The Columbian Exchange* (Westport: Greenwood, 1972), fq. 11.

<sup>401</sup> Todorov, *Conquest*, fq. 17.

dhe të nëntëmbëdhjetë në Britani (shih kap. 10). Pikëpamja ‘dashmirëse’ e Las Casas-it gjithsesi frymëzoi një mision imperial ku vendasit do të ‘konvertoheshin kulturalisht’ dhe identiteti e praktikat e tyre kulturore do të transformoheshin sipas linjave të Krishterimit perëndimor. Për më tepër, Las Casas-i kurrë nuk e kundërshtoi të drejtën e spanjollëve për të sunduar mbi vendasit dhe as besonte se këta të fundit duhet të lejoheshin të vendosnin për fatin e tyre. Kështu që, në termat e Todorov-it, debati gjithnjë presupozonte inferioritetin e vendave dhe mbështetej në një ideologji skllavërimi kundrejt një ideologjie kolonialiste/asimilacioniste.<sup>402</sup> Prandaj, këto pikëpamje në dukje të kundërta ideologjike për vendasit logjikisht, edhe pse vrazhdësisht, qëndronin krahas përkrah.

Sidoqoftë, vlen të thuhet se këto pikëpamje ngjajnë ‘relativisht tolerante’ krahasuar me ato të kolonëve puritanë në veri, antipatia paranojake e të cilëve karshi vendasve çoi jo në ‘konvertimin kulturor’, por në ‘zgjidhjen e parë’ të shfarosjes së Tjetrit Indian, si dhe në aparteid social.<sup>403</sup> Dhe ndërsa filmi epik *How the West was Won* na tregon për një popull pionierësh e liridashësish të cilët ndërtuan qytetërimin më të shkëlqyer mbi tokë, ka një heshtje të mprehtë që e thyen lavdinë. Sepse ideja se indianët janë veçse ‘kafshë të egra’ (Timothy Dwight) apo ‘qenër gjahu’ (John Adams) të cilët duhen shkullur ‘nga strofkullat e tyre’ (Roger Williams), ‘në vitet 1770 që bërë një aksiomë aq universale, sa do të shkruhej me gërma të mëdha në certifikatën e lindjes së Shteteve të Bashkuara të Amerikës’.<sup>404</sup>

<sup>402</sup> Po aty, fq. 46-47.

<sup>403</sup> Richard Slotkin, *Regeneration Through Violence* (Middleton: Wesleyan University Press, 1973); Michael Kammen, *People of Paradox* (New York: Alfred A. Knopf, 1972); Reginald Horsman, *Race and Manifest Destiny: the Origins of American Racial Anglo-Saxonism* (Cambridge, Mass.: Harvard University Press, 1981).

<sup>404</sup> Richard Drinnon, *Facing West: the Metaphysics of Indian-Hating and Empire-Building* (Minneapolis: University of Minnesota Press, 1980), fq. 99.

Por për t'iu rikthyer narrativës: retorika e Kishës Katolike bartte disa (ndonëse qartazi jo të gjitha) nga tiparet dalluese të retorikës imperiale britanike që do të shfaqej gjatë dhe pas shekullit të tetëmbëdhjetë. Ideja europiane e shekullit të tetëmbëdhjetë se 'qytetërimi' është monopol i Perëndimit, ishte në fakt 'një version i shekullarizuar i parashtrimit primitiv kristiano-perëndimor: "*Nemini salus ... nisi in Ecclesia*" [ose "*extra-Ecclesiam non est*"]'.<sup>405</sup> Që do të thotë, nuk mund të ketë shpëtim jashtë Kishës Katolike të Perëndimit. Kjo u bë e qartë që në fillim me leximin ritualist nga spanjollët të 'Thirrjes' (*Requirimiento*), e cila ishte 'një ultimatum për indianët që të pranojnë epërsinë e Krishterimit ose luftën'.<sup>406</sup> Pjesa kyç e tekstit deklaronte se:

Në emër të Madhërisë së Tij ... unë ... shërbëtori i tij ... ju lutem dhe ju bëj thirrje në mënyrën më të mirë që di ... [që] ta njihni Kishën si kryezot të botës mbarë ... [Nëse e bëni këtë] Madhëria e Tij dhe unë në emër të tij do t'ju pranojmë ... Por nëse nuk e bëni ... me ndihmën e Zotit, do të hyj me forcë kundër jush dhe do të bëj luftë kudo ... Do t'ju vë nën zgjedhën e Kishës ... Do t'i marr gratë e fëmijët tuaj dhe do t'i bëj sklevër ... dhe do t'ju bëj çdo të ligë e çdo dëm që një kryezot mund t'u bëjë vartësve të tij që nuk i binden ose nuk e pranojnë atë.<sup>407</sup>

Që pikërisht kjo mendësi që e bëri Kishën të supozonte pa skrupuj se mund thjesht t'ia çante barkun botës 'joeuropiane' dhe t'i njihte të drejtën e plaçkës dy vendeve kryesore katolike, Spanjës dhe Portugalisë (me anë të Traktatit të Tordesillas-it). Si përfundim, perceptimet europiane nënkuptonin se ishte thjesht e pamundur që vendasit e Ameri-

<sup>405</sup> Arnold J. Toynbee, *A Study of History*, VIII (London: Oxford University Press, 1963), fq. 111, n. 2.

<sup>406</sup> Patricia Seed, *Ceremonies of Possession in Europe's Conquest of the New World, 1492-1640* (Cambridge: Cambridge University Press, 1995), fq. 70.

<sup>407</sup> Cituar po aty, fq. 69.

kës të konceptoheshin si njerëz në të drejtën e tyre apo të trajtoheshin me dinjitet, barazi e ndershmëri. Sepse synimi i gjithë kësaj ishte që vendasit të trajtoheshin si një faqe e bardhë ose vozë boshe për t'u shkruar apo mbushur, dhe rrjedhimisht shfrytëzuar, nga Krishterimi Perëndimor.

Afrikanët gjithashtu u sollën dhe u degraduan në 'përvojën amerikane' të Europës. Megjithatë, të kërkuar një ideologji të gatshme e koherente këtu do të ishte problematike, sepse degradimi i afrikanëve bazohej në një tërësi idesh të krishtera të sajuara atypëraty. Në një mënyrë apo një tjetër, europianët arritën të besonin se skllavërimi i afrikanëve ishte i natyrshëm pasi ishte hyjnisht i sanksionuar. Një nga idetë më të rëndësishme ishte ajo e Mallkimit të Hamit në Bibël (ose më saktë Mallkimi i Kanaanit). Historia e Zanafillës, e rrëfyer në kapitullin 9, vargjet 18-26, tregon se Hami e pa të atin, Noen, të dehur e lakuriq dhe e përqeshi. Për këtë arsye, Zoti nuk mallkoi Hamin, por të birin, Kanaanin (ndonëse rasti nisi të quhej 'Mallkimi i Hamit'). (Duket se arabët e mesjetës qenë të parët që e kaluan mallkimin nga Kanaani tek Hami.<sup>408</sup>) Kanaani (dhe të gjithë pasardhësit e tij) u mallkua me fatin që të ishte 'shërbëtor i shërbëtorëve për vëllezërit e tij' (kap. 9, v. 25). Por edhe kështu, është e rëndësishme të vihet në dukje se ky besim fetar nuk përbënte një qëndrim të përpunuar plotësisht. Siç e vë në dukje George Frederickson, mallkimi funksiononte:

në nivelin e besimit popullor e të mitologjisë më shumë sesa si ideologji formale. Në fakt, u refuzua nga autoritetet, të cilave thjesht iu desh të vinin në dukje se mallkimi ra vetëm mbi Kanaanin, e jo mbi të vëllanë, Kushin, nga i cili, sipas ekzegjzës standarde biblike të shekujve të

<sup>408</sup> Jan Nederveen Pieterse, *White on Black* (London: Yale University Press, 1992), fq. 44.

gjashtëmbëdhjetë e shtatëmbëdhjetë, e kishte prejardhjen raca afrikane.<sup>409</sup>

Gjithashtu vlen të vihet në dukje se ndërsa raca si koncept më vete nuk figuronte në perceptimin përçmues të afrikanëve, pas rreth 1440-ës, siç vë në pah George Frederickson, portugezët po tregtonin skllëvër të zinj. Prandaj ai hedh mendimin se, 'edhe para zbulimit të Amerikës, disa të krishterë iberikë ishin më të prirur t'i shihnin të zinj të destinuar nga Zoti për të qenë "druprerës e ujëbartës" se sa si ekzemplarë të virtyteve të krishtera'.<sup>410</sup> Megjithatë, bashkëshoqërimi i lëkurës së zezë me skllavërinë ishte një ide që do të merrte disa shekuj për t'u fermentuar në mendësinë europiane, edhe nëse 'inferioriteti' i të zinjve që vërtetuar tashmë. Ironikisht, që dhënia fund e tregtisë së skllavërve ajo që pjesërisht ndihmoi në zhvillimin e racizmit shkencor.

Çështja kyçe është se këto perceptime përçmuese për afrikanët e zinj legjitimuan, ose shërbyen si mjet në tragjedinë që do të shpalojë më vonë. Meqë kjo është trajtuar më se mjaftueshëm në literaturë, do të vë në dukje vetëm disa tipare të spikatura të kësaj historie. Nuk duhet të biem pre e pretendimit të disa historianëve se tmerret e 'Rrugëkalimit të Mesëm' (udhëtimi përmes detit nga Afrika në Amerikë) janë thjesht një produkt i ekzagjeruar i 'propagandës abolicioniste'. Veçanërisht i madh ishte rreziku i rraskapitjes fizike shkaktuar kryesisht nga dehidratimi dhe dizanteria. Skllëvërit shpesh nuk kishin zgjidhje veçse të liroheshin aty ku qëndronin. Siç shpjegon xherrahu i një anijeje të kohës: 'Kuverta, domethënë dyshemeja e hapësirës ku ata qëndronin, ishte e mbuluar me gjakun dhe mukozat e tyre ... sa

<sup>409</sup> George M. Frederickson, *Racism: a Short History* (Melbourne: Scribe Publications, 2002), fq. 45.

<sup>410</sup> Po aty, fq. 29.

ngjante si një kasaphanë'.<sup>411</sup> Aq i rëndë ishte kutërbimi që përhapnin anijet me skllevër, sa vendasit amerikanë e merrnin vesh mbërritjen e tyre të afërt kur ato ishin ende me milje larg nga bregu. Siç është e mirëditur, kapitenët e anijeve shpesh i hidhnin zezakët e sëmurë nga anija. Siç na njofton një vëzhgues bashkëkohës i tregtisë së skllevërve në Liverpoolin e shekullit të tetëmbëdhjetë, 'zezakët hidheshin aq shpesh në det, sa vija e peshkaqenëve që i vëzhgonin këto anije dhe prisnin të ushqeheshin prej tyre, mund të shihej për milje të tëra'.<sup>412</sup> Realiteti i këtij udhëtimi përcillet në fjalët e skllavit bashkëkohës, Olaudah Equiano, i cili na tregon:

Së shpejti më vendosën poshtë, nën kuvertë [të anijes së skllevërve] ku hundëve të mia iu ofrua një mirëseardhje që nuk e kisha përjetuar kurrë më parë në jetë, aq sa, me neverinë e shkaktuar nga kutërbimi dhe të qarët bashkë, u sëmura aq keq sa nuk isha më në gjendje të haja. Tashmë prisja vetëm mikun e fundit, vdekjen, që të më shpëtonte.<sup>413</sup>

Dhe ç'është e vërteta, së shpejti vdekja do t'i shpëtonte shumë skllevër. Në literaturën mbi numrin e skllevërve të transportuar përlllogaritjet variojnë nga 12 deri në 20 milionë, por shumica e autoriteteve bien dakord në rreth 15 milionë. Po ashtu bihet dakord se mesatarisht 10% kanë vdekur gjatë udhëtimit. Kësisoj, një përlllogaritje e arsyeshme, në mos konservative, tregon se rreth 1.5 milionë skllevër të zinj kanë vdekur vetëm në Rrugëkalimin e Mesëm. Nëse një përqindje e tillë vdekshmërie do të kishte ndodhur mes një

<sup>411</sup> Alexander Falconbridge, cituar te James Walvin, *Black Ivory* (Washington, DC: Howard University Press, 1994), fq. 49-50, dhe fq. 38-58.

<sup>412</sup> "Dicky Sam", *Liverpool and Slavery* (Liverpool: Scouse Press, 1984 [1884]), fq. 34.

<sup>413</sup> Cituar te "Transatlantic Slavery: Against Human Dignity", National Museums and Galleries on Merseyside (Liverpool, 2002), fq. 12.

popullate të re angleze në atë kohë, do të qe konsideruar si një epidemi tragjike.<sup>414</sup>

Kur arrinin afrikanët damkoseshin me hekur të skuqur dhe pastaj u shiteshin skllavopronarëve me ankand si të ishin bagëti.<sup>415</sup> Dhe ndërsa trajtimi i klasave punëtore të të bardhëve në Angli në shekujt e tetëmbëdhjetë e nëntëmbëdhjetë vështirë se mund të quhet njerëzor, atyre megjithatë nuk u rezervohej ai nivel mizor shfrytëzimi e degradimi kulturor që përjetonin zezakët në Amerikë. Jetëgjatësia në ato që në fakt ishin 'kampe pune të detyruar' nuk i kalonte shtatë vitet.<sup>416</sup> Veçanërisht ngjethës ishte institucioni i 'marinimit' ose i 'përshtatjes me klimën', një periudhë tre vjeçare ku skllavopronarët përpiqeshin 't'ua shuanin identitetin skllavërvë të rinj, t'ua thyenin vullnetin dhe t'u shkëpusnin çdo lidhje me të kaluarën'.<sup>417</sup>

Një trajtim i aspektit dehumanizues të skllavërisë në Amerikat, bëhet në librin e Orlando Patterson-it, *Slavery and Social Death*.<sup>418</sup> Siç e vë në dukje ai, trajtimi i skllavërvë afrikanë në Amerikat shkonte shumë më përtej konceptit të tëhuajëzimit të materialistëve marksistë. Ishte një proces që synonte ta zhvishte tërësisht identitetin si dhe humanitetin e skllavërvë. Megjithatë, John Thornton me të drejtë na tërheq vëmendjen që të mos mendojmë se evropianët ia arrinin gjithmonë t'i dehumanizonin zezakët.<sup>419</sup> Po ashtu, nuk është e saktë që afrikanët të shihen më përgjithësisht thjesht si 'viktima pasive' të pushtetit superior evropian. Sepse, siç

<sup>414</sup> Herbert S. Klein, *The Atlantic Slave Trade* (Cambridge: Cambridge University Press, 1999), fq. 150.

<sup>415</sup> Walvin, *Black Ivory*, fq. 250-251.

<sup>416</sup> Peter Fryer, *Black People in the British Empire* (London: Pluto Press, 1988), fq. 10-11.

<sup>417</sup> "Transatlantic Slavery", fq. 8.

<sup>418</sup> Orlando Patterson, *Slavery and Social Death* (Cambridge, Mass.: Harvard University Press, 1982).

<sup>419</sup> John Thornton, *Africa and Africans in the Making of the Atlantic World, 1400-1800* (Cambridge: Cambridge University Press, 1998).

vënë në dukje C. L. R. James dhe W. E. B. Du Bois, sklleverit përdorën strategji të shumta qëndrese, si vetëvrasja, të punuarit ngadalë e deri tek revoltat e hapura.<sup>420</sup> Në fakt revoltat e sklleverve qenë një nga faktorët që e nxitën lëvizjen abolicioniste. Për më tepër, tregtia e sklleverve me gjasë nuk do të kish qenë e mundur pa ndihmën e hapur të eliteve vendase afrikane të cilët i zinin sklleverit në Afrikë pikësepari. Po ashtu nuk duhet të harrojmë se afrikanët luajtën një rol të rëndësishëm në krijimin e ekonomisë globale shumë kohë para se europianët pandershmërisht ta pretendonin si krijim të tyre.

Në mënyrë të ngjashme, pikëpamja e spanjollëve për indianët vendas si inferiorë – sidomos për ata që i rezistuan projektit imperial të krishterë – do të shkaktonte një tjetër tragjedi njerëzore nga më të mëdhatë e botës. Kur rrekemi të përlogarisim numrin e vendasve të vdekur, menjëherë ndeshemi me problemin e përlogaritjes së numrit të popullsisë më 1492 (menjëherë para arritjes së Kolombit). Ky numër vlerësohet nga 8 deri në 13 milionë. William Denevan jep një shifër të mesme prej 54 milionësh,<sup>421</sup> shifër e pranuar nga shumëkush. Një shifër e pranuar përgjithësisht për të vdekurit është rreth 90% e popullsisë para 1492-shit. Po të fusim në llogari edhe lindjet pas 1492-shit, ngjan se diku mes 50-100 milionë duhet të kenë vdekur si pasojë e drejtpërdrejtë e inkursionit europian gjatë shekullit të gjashtëmbëdhjetë. Ndërsa popullsia e indianëve të Amerikës përbënte rreth 13% të popullsisë së mbarë botës më 1492, në vitin 1600 përbënte vetëm pak më shumë se 1%. Këtij përfundimi vështirë se mund t'i shmangesh. Siç e vë në dukje

<sup>420</sup> C. L. R. James, *The Black Jacobins* (London: Allison and Busby, 1989 [1938]); W. E. B. Du Bois, *Africa and the World* (New York: International Publishers, 1975 [1946]), fq. 60-66.

<sup>421</sup> William Denevan, *The Native Populations of the Americas in 1492* (Madison: University of Wisconsin Press, 1992).

Jan Carew lidhur me rrënimin e shkaktuar në Antilet e Mëdha:

Për të paftuarit europianë që një fillim i lavdishëm, por për lukajot e pavetëdijshëm e mikpritës, që fillimi i fundit. Në më pak se dyzet vjet, konkuistadorët, kolonët dhe gjahtarët spanjollë të sklevërve, sëmundjet, uria dhe dëshpërimi, njësoj si kalorësit e Apokalipsit, do të lëshonin vdekje e shkatërrim mbi kryet e pafajshme të shumicës së banorëve.<sup>422</sup>

Një tjetër mit eurocentrik është se 'pushtimi i Amerikave' është një tregues i qartë i epërsisë ushtarake europiane (çka njihet si 'legjenda e zezë').<sup>423</sup> Ndonëse ishte faktor, kjo s'mund të ofrojë një shpjegim të mjaftueshëm për tragjedinë që do të shpalojë. Faktori kryesor që ndihmoi në pushtimin europian fillimisht, qenë mikrobet dhe sëmundjet që u sollën nga Eurazia.<sup>424</sup> Të vihet re se përcaktuar nuk ishte inferioriteti gjenetik i vendasve, por fakti se ata nuk kishin zhvilluar sisteme imunitare kundër sëmundjeve të veçanta euraziatike. Siç e vë në dukje Alfred Crosby, përfundimi që del është se qenë sëmundjet ato që e dobësuan qëndresën e vendasve, duke ua hapur rrugën tytave europiane për të bërë më të keqen.<sup>425</sup> Ose për ta shprehur me pohimin e thukët të Blaut-it, 'Amerikanët nuk u pushtuan, por u infektuan'.<sup>426</sup> Gjithsesi, 'legjendë e zezë' apo jo legjendë, nuk duhet t'i biem me furçë faktit se trajtimi brutal i këtyre njerëzve nga spanjollët ka qenë një orë e zezë për njerëzimin.

<sup>422</sup> Jan Carew, "Columbus and the Origins of Racism in the Americas: Part One", *Race and Class* 29 (4) (1988), 3.

<sup>423</sup> David S. Landes, *The Wealth and Poverty of Nations* (London: Little, Brown, 1998), fq. 99-112.

<sup>424</sup> *Shih botimin e posaçëm të Annals of the Association of American Geographers* 82 (3) (1992).

<sup>425</sup> Crosby, *Columbian Exchange*, kapitulli 2.

<sup>426</sup> James M. Blaut, *The Colonizer's Model of the World* (London: Guilford Press, 1993), fq. 184, dhe 186.

Jo më pak e rëndësishme është se perceptimet përulëse për indianët vendas dhe afrikanët, 'natyrshëm' i bënin ata të përshtatshëm ose të pjekur për shfrytëzim ekonomik nga europianët. Paradoksi i 'pamundësisë së Amerikës' (ose pamundësia për t'i trajtuar indianët vendas dhe afrikanët me barazi apo me hijen më të zbehtë të dinjitetit) ishte se kjo pamundësi hapi mundësinë e plaçkitjes së burimeve të tyre, si trojet, fuqinë punëtore dhe metalet e çmuara. Siç e vumë në dukje në kapitullin 3, në vitin 1500 Europa nuk ishte në gjendje të prodhonte ndonjë gjë të madhe që t'u interesonte konsumatorëve aziatikë, kurse europianët vazhdonin të paguanin për mallrat aziatike. Në fakt treguesi më i qartë i prapambetjes së Europës në vitin 1500 ishte deficitin e saj i përhershëm tregtar me Azinë. Madje edhe studiuesi eurocentrik John Roberts e pranon se 'pa vërshimin, mbi të gjitha të argjendit [nga Amerikat], vështirë se do mund të kishte ndonjë tregti me Azinë, pasi në Europë nuk prodhohej thuajse asgjë me interes për Azinë'.<sup>427</sup> Duke qenë se europianët nuk mund të prodhonin mjaftueshëm mallra të kërkuara nga aziatikët, u duhej të paguanin me metale të çmuara (kryesisht argjend). Por rezervat e Europës nuk mjaftonin, kështu që metalet e çmuara të plaçkitura ose të përvetësuara të Amerikave (dhe të Afrikës) i shpëtuan europianët, siç i shpëtoi puna prodhuese e vendasve amerikanë dhe e skllëvërve afrikanë, të cilët i nxirrnin metalet në fjalë.<sup>428</sup> Teksa skllëvërit afrikanë punonin përkrah amerikanëve vendas në nxjerrjen e argjendit, ata mbizotëronin në nxjerrjen e arit.<sup>429</sup> Kryesisht këtu u bë i qartë fillimisht kontributi i afrikanëve në përparimin e Perëndimit. Në 300

<sup>427</sup> J. M. Roberts, *The Penguin History of the World* (London: Penguin, 1995), fq. 641.

<sup>428</sup> Blaut, *Colonizer's Model*, kapitulli 4; Frank, *ReOrient*, kapitulli 2.

<sup>429</sup> Joseph E. Inikori, *Africans and the Industrial Revolution in England* (Cambridge: Cambridge University Press, 2002), fq. 183-185.

vitet pas 1500-ës, 85% e prodhimit botëror të argjendit dhe 70% e arit erdhi nga Amerikat. Kurse pjesa dërrmuese e metaleve të dërguara në Europë përfundoi në Azi për të financuar një nga deficitet më të qëndrueshme tregtare kontinentale që bota ka parë ndonjëherë. Shumica e arit dhe argjendit përfunduan në Kinë dhe sasi të konsiderueshme po ashtu, në Indi.

Një tjetër pikë kyçe këtu, siç u vu në dukje në kapitullin 3, është se ari dhe argjendi përbënin 'komoditete' globale që bliheshin dhe shiteshin për të nxjerrë fitime nga ndryshimet në kursin e këmbimit mes tyre (ndryshe, arbitrazh), ose çka unë e quaj 'procesi i riciklimit global të argjendit'. Kjo do të përbënte një nga burimet kryesore të fitimit për tregtarët europianë në Azi pas 1498-ës. Kështu që pra punën e vendasve amerikanë dhe të afrikanëve si dhe të furnizimit me ar dhe argjend spanjollo-amerikan (dhe, sigurisht, pa kërkesën e fuqishme për argjend të krijuar nga ekonomitë kineze e indiane), nuk do të kish patur një sistem global këmbimi dhe as një burim likuiditeti për europianët që të paguanin deficitin e tyre të përhershëm tregtar me Azinë. Së fundmi, dhe ç'është më e rëndësishmja, gjatë shekujve të tetëmbëdhjetë e nëntëmbëdhjetë, skllavëria e zezë, tregtia e skllavëve, qendrat amerikane të prodhimit me skllavër të zinj dhe tregjet e skllavëve, të gjitha patën një kontribut domethënës në 'kapërcimin' agrikulturor e industrial të Britanisë (shih kap. 11).

Në fund, një tjetër dobi e madhe e Amerikave ndaj Europës që se ky kontinent u përdor për të konsoliduar e rindërtuar identitetin perëndimor. Faktori kritik në ripërkufizimin e Europës si Perëndim i përparuar, që zgjerimi i kufirit drejt perëndimit duke përfshirë Amerikat pas 1492-shit. Kjo solli me vete një zgjerim të kategorisë së Tjetrit, ku tashmë u përfshinë edhe afrikanët e amerikanët vendas.

Suksesi i këtij projekti imperial që kritik në farkëtimin e ide-së – për herë parë që nga Perandoria Romake – se Europa përfaqëson qytetërimin e përparuar. Kësisoj, zgjerimi i kufirit perëndimor bëri të mundur një kërcim në identitetin evropian, nga një status periferik në një më të ngritur si ‘qytetërimi i përparuar’. Kjo gjithashtu e zgjeroi edhe dallimin midis Europës Lindore dhe asaj Perëndimore teksa kjo e fundit e zhvilloi fuqinë e saj tregtare e detare përmes zgjerimit në Perëndimin e Largët, kurse e para, ruajti feudalizmin duke përbërë një *cordon sanitaire* ose barrierë mbrojtëse kundrejt Islamit në lindje. Për t’u shënuar është fakti se se pas shekullit të pesëmbëdhjetë, ideja e ‘Europës Perëndimore’ nisi të kristalizohej gjithashtu ndërsa turqit osmanë dhe europianolindorët u përfytyruan si barbarë.<sup>430</sup> Kësisoj, identiteti evropianoperëndimor, gjatë shekujve të gjashtëmbëdhjetë e shtatëmbëdhjetë u përkufizua gjithnjë e më shumë përmes fqinjëve të ngushtë ‘paganë/barbarë’ në lindje, dhe atyre ‘të egër’ në jug dhe në perëndim.

Nëse Amerikat luajtën rol të rëndësishëm që Europa të mund ta arrinte Lindjen, të tillë rol luajti edhe përvetësimi i ideve e teknologjive më të përparuara të Lindjes, të cilat u përhapën përmes globalizimit oriental. Kjo edhe përbën kritikën e dytë madhore të mitit të 1492-shit, e cila zë pjesën tjetër të kapitullit.

### **‘Rilindja lindore’ dhe tri paradokset e Rilindjes perëndimore**

Shumë studiues eurocentrikë i gjejnë origjinat e ‘dynamizmit evropian’ tek Rilindja, e cila mendohet se u dha evropianëve ‘racionalitetin shkencor’ dhe ‘individualizmin’

<sup>430</sup> Thierry Hentsch, *Imagining the Middle East* (Montreal, Quebec: Black Rose Books, 1992); Iver Neumann, *Uses of the Other* (Minneapolis: University of Minnesota Press, 1999).

e nevojshtëm. Rilindja konsiderohet të ketë qenë një rizbulim i shkencës së kulluar greke të lashtë. Një shprehje tipike e kësaj pikëpamjeje pohon se,

Europa nuk mori nga Lindja asgjë pa të cilën nuk do të mund të kish lindur shkenca moderne; nga ana tjetër, çfarë mori që me vlerë pikërisht ngaqë u inkorporua në traditën intelektuale europiane. Dhe kjo e fundit, sigurisht, i ka themelet në Greqinë [e lashtë].<sup>431</sup>

Por kjo e fsheh faktin se shumë nga idetë kyçe mbi të cilat u ngrit Rilindja europiane dhe revolucioni i ardhshëm shkencor (si dhe iluminizmi – shih kap. 9) në fakt u përfutuan nga Lindja pasi u përhapën përmes Urës Islame të Botës me anë të globalizimit oriental. Siç e vë në dukje Michael Edwardes:

Në tërësi, kjo periudhë e madhe ngjizjeje donte t'ia dinte pak, ose aspak, për Lindjen. Rilindja ia ktheu shpinën Orientit, duke përvetësuar një vizion të caktuar të botës së lashtë. Por kjo nuk do të thotë se burrat e Rilindjes nuk ishin tejet të vetëdijshëm për ekzistencën e Lindjes ... Rilindja, pavarësisht fytyrës së saj klasike [greke], gëllonte me ndikime nga Lindja, të maskuara dhe që thuajse kurrë nuk u njiheshin burimi.<sup>432</sup>

Megjithatë, me raste autorë eurocentrikë e pranojnë se disa nga idetë e Rilindjes erdhën nga Lindja e Mesme. Por ky lëshim tërhiqet me përjashtimin e mundësisë që Lindja mund të ketë patur çfarëdo roli të pavarur në gjithë këtë (dogma islamike). Kjo dogmë pohon se muslimanët ishin thjesht bartës ose përkthyes të teksteve të lashta greke dhe gjithçka që ata bënë që thjesht rikthim i tyre atje ku e kishin

<sup>431</sup> A. Rupert Hall, "General Introduction", te Marie Boas, *The Scientific Renaissance 1450-1630* (London: Collins, 1962), fq. 6. Shih Frank, *ReOrient*, fq. 185-193, për një rishikim të mirë të qëndrimit eurocentrik.

<sup>432</sup> Michael Edwardes, *East-West Passage* (New York: Taplinger, 1971), fq. 94.

originën. Kësisoj tipikisht na thuhet se '[përfundimisht manteli i grekëve i kaloi botës islame, në gjirin e së cilës u ruajt trashëgimia greke derisa të rindizej interesi i Perëndimit për të'.<sup>433</sup> Shkurt, muslimanët portretizohen thjesht si bibliotekarë, e jo si mendimtarë origjinalë. Ndonëse e stisur mirë, kjo histori nuk përputhet me të dhënat e konsiderueshme që flasin për idetë e shumta të pavarura lindore të pranishme kudo në Rilindjen europiane. Siç e vë në dukje William McNeill:

Perëndimorët zbuluan se muslimanët zotëronin një sofistikim të mendjes dhe pasuri dijeje shumë përtej asaj të disponueshme në latinisht ... Lehtësia me të cilën ata [europianët] i përvetësuan këto trashëgimi të huaja ndoshta nuk ka të ngjashme në historinë e civilizimit, përveç ndoshta përvetësimit të qytetërimit lindor [egjiptian] nga grekët në shekullin e gjashtë p.e.s.<sup>434</sup>

Por kjo me siguri nuk është aq për t'u habitur po të kemi parasysh se 'ndikimi [intelektual] i Perëndimit në këtë periudhë ishte praktikisht zero, ndoshta për arsyen e kuptueshme se Perëndimi s'kishte thujtë asgjë ç'të ofronte'.<sup>435</sup> Teksa kinezët duket se kanë përjetuar një Rilindje në shekullin e njëmbëdhjetë,<sup>436</sup> kryesisht kontributi i muslimanëve që me rëndësi kritike për të ardhmen intelektuale të Europës.

Në fillimet e shekullit të nëntë, kalifi i shtatë, Abasid, el-Me'muni, themeloi 'Shtëpinë e Dijes' (*Bejt el-Hikme*) në Bagdad, ku ndër të tjera u përkthyen në arabisht edhe vepra greke, veçanërisht ato të Ptolemeut, Arkimedit dhe Euklidit. Por dijetarët arabë gjithashtu u mbështetën shumë në

<sup>433</sup> Margaret Wertheim, *Pythagoras' Trousers* (London: Time Books, 1996), fq. 35.

<sup>434</sup> William H. McNeill, *The Rise of the West* (Chicago: Chicago University Press, 1963), fq. 602, 609.

<sup>435</sup> Bernard Lewis, *The Muslim Discovery of Europe* (London: Phoenix, 1994), fq. 221.

<sup>436</sup> Jacques Gernet, *A History of Chinese Civilization* (Cambridge: Cambridge University Press, 1999), fq. 298, 337-347.

tekstet perse dhe indiane (si dhe kineze) mbi mjekësinë, filozofinë, teologjinë, letërsinë e poezinë. Pastaj ata krijuan një korpus të ri dijeje – me ndihmën e shkencëtarëve e përkthyesve hebrej – që ishte jo vetëm diçka më shumë se thjesht një amalgamë e mendimit grek, por që shpesh ishte kritike ndaj ideve greke dhe njëkohësisht i bartte shumë më tej ato, shpesh në drejtime të reja. Në këtë proces ndihmonte fakti se Bagdadi ndodhej në qendër të ekonomisë globale dhe jo vetëm merrte ide të reja nga Azia, por pasi i përpuhonte sërish ato, i përcillte në Spanjën muslimane. Gjithnjë e më shumë pas vitit 1000, evropianët i përkthenin në latinisht tekstet shkencore të muslimanëve. Rënia e Toledos më 1085 pati rëndësi të veçantë, pasi atje intelektualë të shumtë evropianë ranë në kontakt me librat teknikë të muslimanëve. Të mësuarit nga Islami e vazhdoi mbreti spanjoll Alfonso X (1252-1284), në masë të madhe nëpërmjet ndërmjetësve hebrej (siç bënin edhe mbretërit portugezë). Ndër shembujt e shumtë në këtë kuadër, vlen të vihet në pah se teksti i rëndësishëm i Ibni Khalif el-Muradiut i vitit 1266, ‘Libri i Sekreteve mbi Përfundimet e Ideve’, u përkthye në oborrin e Toledos. Ky tekst dhe shumë të tjerë u patën dhënë iberikëve shpikje të shumta të muslimanëve. Së fundmi, edhe italianët ranë në kontakt drejtpërdrejt me këto ide si nëpërmjet lidhjeve tregtare me Lindjen e Mesme, ashtu edhe gjatë kryqëzatave. Por çfarë i shtuan muslimanët korpusit të dijes greke?

### *Përparimet e muslimanëve në matematikë*

Siç e vë në dukje me të drejtë Jack Goody, ‘matematika ishte njëra nga fushat ku zhvillime paralele por jo identike u shënuan në Lindje dhe në Perëndim. Për sa i përket gjeometrisë, zhvillimi i hershëm ndodhi në Mezopotami (në Irakun e lashtë) dhe Egjipt, dhe vetëm më vonë u vazhdua nga

grekët'.<sup>437</sup> Dhe në fakt, shkollat në Irakun e lashtë mësonin algjebër dhe gjeometri, e njihnin që më 1700 p.e.s. teoremën që sot njihet me emrin e Pitagorës, si dhe e dinin vlerët e numrit pi. Po ashtu ata zhvilluan 'sistemin gjashtëdhjetor', ku rrethi ndahet në treqind e gjashtëdhjetë gradë, ora në gjashtëdhjetë minuta, minuta në 60 sekonda dhe dita në 24 orë. Duke vazhduar nga Iraku i lashtë përmes Egjiptit të lashtë dhe Greqisë (e cila përfitoi nga afërsia me këto rajone me zhvillim të hershëm), fazën tjetër madhore zhvillimore e inicuan muslimanët pas rreth 800-ës, kur nisën t'i bartnin shumë më përpara këto zhvillime të hershme. Matematikani pionier Muhammed ibni Musa el-Khuarezmiu (780-847) shkroi librin me ndikim të madh, 'Mbi Llogaritjen me Numrat Indianë' (rr. 825). Ky libër luajti rol të madh në përhapjen e sistemit numerik indian në Islam dhe në Perëndim.<sup>438</sup> Interesante është se të parët që i futën në përdorim numrat ishin fenikasit mesolindorë (të cilët vetëquheshin *kan'ani*, kanaanitë, nga Kanaani në brigjet lindore të Mesdheut). Por kapërcimi i madh që kishin arritur indianët ishte sistemi me nëntë numra si dhe zeron (*śūnya*) në rendin dhjetësh. Ky sistem u mor rreth vitit 760 nga dijetarët arabë.<sup>439</sup> Vepra e el-Khuarezmiut u çua më tej nga një sërë dijetarësh muslimanë, si el-Uklidisiu, Ebu'l-Uefa el-Buzajaniu, el-Mahaniu, el-Kindiu dhe Kushejr ibni Lebbaniu.<sup>440</sup> Pasi u përhapën në mbarë Lindjen e Mesme, këto ide arritën në Spanjën muslimane rreth fundit të shekullit të dhjetë, ku

<sup>437</sup> Jack Goody, *The East in the West* (Cambridge: Cambridge University Press, 1996), fq. 234.

<sup>438</sup> Jonathan Bloom dhe Sheila Blair, *Islam: Empire of Faith* (London: BBC Worldwide, 2001), fq. 125.

<sup>439</sup> Wazir Hasan Abdi, "Glimpses of Mathematics in Medieval India", te A. Rahman (red.), *History of Indian Science, Technology and Culture, AD1000-1800* (New Delhi: Oxford University Press, 1999), fq. 50-94.

<sup>440</sup> Seyyed Nasr, *Science and Civilization in Islam* (Cambridge, Mass.: Harvard University Press, 1968), kapitulli 5.

europianët e prapambetur ranë në kontakt me to (veçanërisht përmes Kordovës si dhe me rënien e Toledos më 1085 dhe pushtimin e Saragozës nga aragonezët më 1118).

Në fillim europianët ishin të ngadaltë në adoptim dhe parapëlqenin sistemin e vjetër bazuar në abakus. Por më 1202, tregtari nga Piza Leonardo Fibonacci, pasi jetoi në Tunizi, u bind për konceptet e reja lindore dhe shkroi një libër ku e hidhte poshtë sistemin e vjetër me abakus në favor të sistemit të ri indo-arab. Ky i fundit më në fund nisi të përdorej nga komunitetet tregtare italiane. Nuk është diçka e jashtëzakonshme të thuash, siç shprehet Charles Singe, se adoptimi i sistemit numerik lindor nga europianët 'qe një faktor madhor në zhvillimin e shkencës [perëndimore] dhe jo pa ndikim në përcaktimin e lidhjeve mes shkencës dhe teknologjisë në shekujt e gjashtëmbëdhjetë dhe shtatëmbëdhjetë'.<sup>441</sup>

Vepra e el-Khuarezmiut mbi algjebërën ishte po aq e rëndësishme. Ajo u përkthye në latinisht më 1145 nga anglezi Robert i Ketton-it si dhe nga italianii Gerard i Cremonas. Emrin e el-Khuarezmiut Ketton-i e përktheu 'Algorithmi' (së këtejmi edhe termi 'algoritëm'). Kurse termi 'algjebër' vjen nga titulli i njërit prej librave të el-Khuarezmiut, *El-Xhebr ve'l-Mukala*. Libri i tij mbeti teksti kryesor në Europë mbi lëndën deri në shekullin e gjashtëmbëdhjetë. Atë e shoqëruan risi të ndryshme islamike që shkonin shumë përtej teorisë së Ptolemeut. Ptolemeu përdorte korda të bazuara në një teori tejet kaba. El-Battaniu i zëvendësoi kordat me sinusin. Po ashtu, trigonometria sferike u çua përpara nga teoria e Ebu'l-Vefa el-Buzajaniut për tangentin, nga teorema e Ebu Nasrit për sinuset, dhe teorema e Ibni el-Hejthemit

<sup>441</sup> Charles Singer, "Epilogue: East and West in Retrospect", te Charles Singer, E. J. Holmyard, A. R. Hall dhe T. I. Williams (red.), *A History of Technology*, III (Oxford: Clarendon Press, 1956), fq. 767.

për bashkëtangjentët.<sup>442</sup> Jo më pak e rëndësishme është se rreth fillimit të shekullit të dhjetë, të gjashta funksionet klasike të trigonometrisë qenë përkufizuar e tabeluar nga matematikanët muslimanë.<sup>443</sup> Kurse teksti i Nasiruddin et-Tusiut për trigonometrinë e rrafshët, i gjysmës së dytë të shekullit të trembëdhjetë, nuk do të arrihej nga asnjë matematikan evropian deri më 1533.<sup>444</sup>

### *Konceptimi islamik i njeriut si veprues racional*

Qenë muslimanët (sidomos mutezilitët) ata që hodhën idenë se njeriu është veprues i lirë dhe racional, çka pranohej si një nga lajtmotivet e mendimit modern evropian. Një ide e tillë u shfaq jo shumë kohë pas vdekjes së Muhammedit, duke shënuar një lëvizje drejt 'teologjisë racionale islame' (në mënyrë që mësimet e Muhammedit të mos shtrembëroheshin dot nga autoritetet e mëvonshme politike). E njohur me termin *ixhtihad*, kjo teologji parashikonte ushtrimin e gjykimit të pavarur dhe, mbi të gjitha, nocionin se Zoti mund të kuptohet vetëm nëpërmjet arsyes individualiste njerëzore. Kjo ide u përfshi në veprat e dijetarëve si el-Kindiu (800-873), er-Raziu (865-925), el-Farabiu (873-950), Ibni Sinai (980-1037), Ibni Rushdiu (1126-98) dhe ez-Zehraui (936-1013). Këto ide bien në sy për ngjashmërinë me idetë që do të frymëzonin Martin Luther-in dhe Reformën. Ideja kritike e er-Raziut ishte se e gjithë 'e vërteta' (shkencore dhe fetare) mund të arrihet drejtpërdrejt nga mendja individuale njerëzore përmes përsiatjes racionale ose arsyes, kurse kjo e fundit mund të arrihet vetëm kur mendja

<sup>442</sup> Juan Vernet, "Mathematics, Astronomy, Optics", te Joseph Schacht dhe C. E. Bosworth (red.), *The Legacy of Islam* (Oxford: Clarendon, 1974), fq. 477.

<sup>443</sup> E. S. Kennedy, *Studies in the Islamic Exact Sciences* (Beirut: American University of Beirut, 1983), fq. 41.

<sup>444</sup> Joseph Needham dhe Wang Ling, *Science and Civilisation in China*, III (Cambridge: Cambridge University Press, 1959), fq. 109.

çlirohet nga emocionet irracionale: shkurt, 'objektiviteti' është jetik. Po ashtu, Ibni Rushdiu (i njohur në Perëndim si Averroes) këmbëngulte se hulumtimi shkencor mund të arrihet vetëm duke u ndarë nga dogma fetare dhe se ekzistenca e Zotit mund të provohet vetëm mbi baza racionale.

Shkurt, këta dhe të tjerë filozofë e shkencëtarë muslimanë patën një ndikim themelor në ndryshimin e mendimit evropianë. Idetë e tyre, të asimiluara nga Perëndimi, u dhënë mundësinë mendimtarëve evropianë të shkonin përtej besimit katolik në autoritetin hyjnor drejt qendërsisë së individit. Muslimanët gjithashtu filluan të përfaqonin objektivitetin dhe eksperimentimin shkencor, që më vonë do të kishin ndikim mbi revolucionin shkencor evropian.

### *Metodat shkencore islamike si prelude i revolucionit shkencor evropian*

Një nga aspektet më radikale të revolucionit shkencor islamik ishte nocioni se mendimi i lashtë grek nuk ishte kurrësi i përsosur dhe mund, në mos duhej, sfiduar. Kësisoj:

Teksa shkencëtarët muslimanë nuk e braktisën krejtësisht traditën greke, ata e riformuluan atë me anë të një koncepti të ri revolucionar se si duhet përpunuar dija, koncept që ende përcakton mënyrën se si zhvillohet shkenca sot. Ata arsyetuan se mjete dhe metoda më të mira do të sillnin rezultate më të sakta.<sup>445</sup>

Kjo ishte diçka që grekët nuk e kishin rrokur plotësisht. Ajo që dijetarët muslimanë u përpoqën të korrigojnë ishte rrallësia e eksperimenteve shkencore tek grekët. Veç kësaj, dijetarët muslimanë filluan të vinin në pikëpyetje traditat e trashëguara në shumë fusha, si mjekësia, higjiena, optika, fi-

<sup>445</sup> Bloom dhe Blair, *Islam*, fq. 131.

zika e kështu me radhë. Në këtë linjë të re të menduari shkencor, egjiptiani Ibn el-Hejthem (965-1039) shkroi një libër mbi optikën që si përfundim pati një ndikim shumë të madh në Europë. Jo më pak i rëndësishëm që ndikimi i mjekut egjiptian Ibn en-Nefis (vd. 1288). Vepra e tij për trupin njerëzor, e cila e kundërshtonte qëndrimin tradicional të mjekut grek Galenit, i ka paraprirë plotësisht veprës tejet të përshëndetur të anglezit William Harvey me jo më pak se tre shekuj e gjysmë.

Të rëndësishme gjithashtu ishin veprat e er-Raziut, el-Farabiut dhe Ibni Sinait. Përparimet e shënuara prej tyre në mjekësi e higjienë, në kontekstin europian ishin revolucionare. Er-Raziu e bazoi spitalin e tij në eksperimentim, ku pacientët ndaheshin në dy grupe për të parandaluar përhapjen e sëmundjes. Kjo gjithashtu çoi në zhvillimin e karantinës, e cila më vonë u përqaftua ethshëm në Perëndim.<sup>446</sup> Ai po ashtu që i pari që zhvilloi dije mbi sëmundje të ndryshme, ndonëse ka të dhëna të mira që të bëjnë të mendosh se edhe vetë ka qenë mjaft i ndikuar nga novacionet e mëhershme kineze.<sup>447</sup> Sido që të jetë, 'veprat mjekësore të er-Raziut për shekuj me radhë ushtruan një ndikim të madh në mendjet e Perëndimit latin'.<sup>448</sup> Dëshmi të këtij ndikimi përbën edhe fakti se veprat e tij të përkthyer u rishtypën rreth dyzet herë mes viteve 1498-1866. Ebu Nasr el-Farabiu (i njohur në Perëndim si Avennasar) shkroi një libër të rëndësishëm, 'Katalog i Shkencave', i përkthyer në latinisht nga Gerardi i Cremona-s dhe Juani i Seviljes. I shquar në këtë aspekt ishte edhe Ibni Sinai (i njohur në Perëndim si Avicenna), libri i famshëm i të cilit, 'Kanon i Mjekësisë', u

<sup>446</sup> Lewis, *Muslim Discovery*, fq. 128-130.

<sup>447</sup> Joseph Needham, Lu Gwei-Djen dhe Nathan Sivin, *Science and Civilisation in China*, VI (6) (Cambridge: Cambridge University Press, 2000), fq. 124-125.

<sup>448</sup> Philip K. Hitti, *History of the Arabs* (London: Macmillan, 1937), fq. 367.

përkthye në latinisht në shekullin e dymbëdhjetë (si edhe enciklopedia e tij, 'Libri i Shërimit'). Për më tepër, 'Kanoni i Mjekësisë' u bë teksti bazë për shkollat europiane të mjekësisë deri rreth gjysmës së dytë të shekullit të gjashtëmbëdhjetë. Në përgjithësi, ndikimi arab në zhvillimin e shkollës së rëndësishme të Salernos pas 1050-ës qe i madh.<sup>449</sup> Po ashtu interesant është edhe fakti se edhe kinezët janë pionierë të shumë aspekteve të rëndësishme të mjekësisë moderne, përfshirë praktikat e imunologjisë, mjekësisë ligjore dhe ekzaminimit mjekësor, të gjitha të bartura në Perëndim përmes Urës Islame të Botës.<sup>450</sup>

Jo më pak ndikim do të kishin edhe arritjet e muslimanëve në astronomi. Ibni esh-Shatiri i shkollës së Maragha-s, i cili jetoi në shekullin e katërmëdhjetë, zhvilloi një sërë modelesh matematikore që ishin thuajse identikisht të njëjta me ato të zhvilluara nga Koperniku në teorinë e tij heliocentrike 150 vjet më vonë. Kjo ngjashmëri e ka bërë Noel Swerdlow-n të shprehet se 'duket një seri rastësish tepër të spikatura për të pranuar mundësinë e një zbulimi të pavarur [nga Koperniku]'.<sup>451</sup> Edhe ekspertë të tjerë kanë mbrojtur mendimin se Koperniku i ka huazuar modelet e esh-Shatirit.<sup>452</sup> Në fakt, Koperniku është cilësuar si 'ndjekësi më i shquar i Shkollës së Maragha-s'.<sup>453</sup> Për më tepër, teoria heliocentrike, të paktën në mënyrë të nënkuptuar, për herë të parë është zbuluar në 'tekstet hermetike' në Egjiptin e

<sup>449</sup> Luis Garcia Ballester, M. R. McVaugh dhe A. Rubio-Vela, *Practical Medicine from Salerno to the Black Death* (Cambridge: Cambridge University Press, 1994), fq. 13-29.

<sup>450</sup> Needham, e të tjerë, *Science*, VI (6).

<sup>451</sup> Swerdlow, cituar te George Saliba, *A History of Arabic Astronomy* (London: New York University Press, 1994), fq. 64.

<sup>452</sup> Kennedy, *Studies*, fq. 50-83; Saliba, *History*, fq. 245-305.

<sup>453</sup> N. Swerdlow dhe O. Neugebauer, *Mathematical Astronomy in Copernicus' De Revolutionibus* (Berlin: Springer, 1984), fq. 295.

lashtë.<sup>454</sup> Koperniku e ka përmendur në mënyrë të shkoqur egjiptianin e lashtë, Hermes Trismegistus, në hyrjen e vepërës së tij madhore. Për më shumë, 'Trismegistus-in asnjë shkencëtar sot nuk do ta pranonte si pararendës, por gjatë Rilindjes ky egjiptian enigmatik gëzonte një status të jashtëzakonshëm'.<sup>455</sup> Për t'u vënë në pah gjithashtu është edhe vepra më e hershme e el-Khuarezmiut mbi astronominë. Ky i fundit jo vetëm që bëri përmirësime mbi tekstin e Ptolemeut, 'Gjeografinë', por bëri edhe harta të ndryshme që përfshinin pozicionin e shumë yjeve. Këto harta do të rezultojnë të rëndësishme për tregtinë oqeanike. El-Khuarezmiu gjithashtu përlloragiti perimetrin e tokës me një gabim prej më pak se 0.04% (ndryshe, prej vetëm 41 metrash). Vepra e tij u çua më tej nga el-Biruniu dhe el-Idrisiu.

Kësisoj, mendimi i hershëm islamik do të kishte një ndikim shumë përtej Rilindjes Europiane, duke frymëzuar revolucionin shkencor europian. Ideja e Bacon-it se shkencën duhet bazuar në eksperimentim dhe se përfitimi maksimal mund të arrihet nga ndarja e punës, është thujse fjalë për fjalë i njëjtë me argumentin e parashtruar nga dijetarët më të hershëm musliman. Siç e vë në dukje Robert Briffault:

Debatet se kush ishte zhvilluesi i parë i metodës eksperimentale ... janë pjesë e keqparaqitjes së hatashme [eurocentrike] të origjinave të civilizimit europian. Në kohën e [Francis] Bacon-it, metoda eksperimentale e arabëve ishte e përhapur gjerësisht dhe e kultivuar ethshëm në mbarë Europën.<sup>456</sup>

<sup>454</sup> Martin Bernal, *Black Athena*, I (London: Vintage, 1991), fq. 155-156; Frances Yates, *Giordano Bruno and the Hermetic Tradition* (London: Routledge and Kegan Paul, 1964), veçanërisht fq. 154.

<sup>455</sup> Wertheim, *Pythagoras' Trousers*, fq. 81, dhe fq. 81-91.

<sup>456</sup> Robert Briffault, cituar te Ziauddin Ahmad, "Muslim Contribution to Scientific Progress", te Mohammad R. Mirza dhe Muhammad I. Siddiqi (red.), *Muslim Contribution to Science* (Lahore: Kazi, 1986), fq. 117.

Megjithatë, kjo mund të hidhet poshtë duke nxjerrë si kundërargument një tjetër dogmë islamike: se edhe në qofshin zhvilluar ide të reja shkencore e individualiste në Islam, këto më vonë janë nxjerrë jashtë loje pasi autoritetet fetare kanë dashur të ripërforcojnë kontrollin e tyre. Prandaj kjo ka qenë veçse një 'revolucion islamik i abortuar'. Kjo pastaj krahasohet me situatën në Europë ku mungesa e pengesave fetare bëri të mundur një zhvillim të lirshëm të shkencës perëndimore (e cila nga ana e saj mbajti gjallë 'dinamikën europiane'). Problemi kryesor me këtë dogmë është se nuk arrin ta zhvlerësojë faktin e thjeshtë se arritjet intelektuale të muslimanëve patën rëndësi jetike në mundësimin e përparimit intelektual të Europës, veçanërisht të Rilindjes dhe të revolucionit shkencor. Ndonëse europianët më vonë arritën t'i shpinin më tej këto ide lindore,<sup>457</sup> pa ide të origjinale lindore pikësëpari do të kishte pak ose aspak për të çuar më tej.

Por këtu ka edhe dimension tjetër që duhet përmendur. Sepse është e mundur që Rilindja t'u detyrohet jo vetëm muslimanëve, indianëve e kinezëve, por edhe afrikanëve të zinj.<sup>458</sup> Siç e vë në dukje W. E. B. Du Bois, tekstet origjinale shkencore greke nuk kaluan vetëm në Lindjen e Mesme, por edhe në Afrikë, veçanërisht në Aleksandri e Kajro (e cila, siç e pamë në kap. 2, i dominoi tregtarët italianë deri më 1517 e më tutje). Veç kësaj, Sudani i zi kishte qenë prej kohësh një qendër dijeje e kulture, prej së cilës shumëçka u përcoll sërish në Europën mesjetare. Megjithatë, teksa egjiptianët pa dyshim kontribuan në zhvillimin e dijes shkencore,<sup>459</sup> sidomos përmes Shtëpisë egjiptiane të Dijes (*Dar el-*

<sup>457</sup> H. Floris Cohen, *The Scientific Revolution* (Chicago: Chicago University Press, 1994), kapitulli 8.

<sup>458</sup> Du Bois, *Africa*, kapitulli 10.

<sup>459</sup> Hitti, *History*, fq. 628-631.

*Hikmeh*) të themeluar më 1005, origjina e tyre etnike nuk është e qartë. Ajo që është e qartë është se shumë nga të ashtuquajturit maurë mesolindorë, veçanërisht ata që banonin në Spanjë, ishin afrikanë të zinj me origjinë (së këtejmi edhe termi mesjetar evropian ‘*blackamoor*’). Ky hibridizim racash bëri të mundur edhe një ndërthurje idesh. Për më tepër, afrikanë të zinj e vizitonin Spanjën për të marrë leksione në universitetet e atjeshme, kurse spanjollët shpesh udhëtonin në Afrikën Veriore për t’u njohur me idetë e tyre. Hulumtime të mëtejshme mund të nxjerrin në pah se disa nga figurat e famshme egjiptiane, disa prej të cilëve janë përmendur tashmë, ishin të zinj me origjinë (Dhu’n-Nuni është një shembull i mirënjohur, e po ashtu edhe afrikanoveriori Shën Agustin, i një periudhe shumë më të hershme). Interesante është se Shkolla e Athinës e Leonardo da Vincit e paraqet Averroesin me lëkurë të errët. Dhe me siguri mendimi i lashtë egjiptiano-zezak – ndryshe nubian – ka ndikuar mbi Rilindjen sidomos përmes ‘teksteve hermetike’ (shumë prej të cilave u përkthyen pas 1460-ës nga Marsilio Ficino në oborrin e Cosimo di Medici-t.).<sup>460</sup> Sido që të jetë, Du Bois na vë përballë kësaj pyetjeje gacmuese retorike:

A është e mundur, apo me gjasë, që Afrika e zezë të mos ketë patur rol krijues [në Rilindje]? Që asnjë shkencë të mos ketë ardhur nga truri i zi? Që Europa e cila i lavdëronte e ngrinte në qiell të zinj të asaj kohe, ta ketë bërë këtë vetëm nga kureshtja apo bamirësia? Apo mos ka më shumë të ngjarë që kontributet kulturore të shumë negroidëve të jenë harruar apo të mos kenë spikatur si të tilla ngaqë ngjyra e lëkurës ishte e parëndësishme, apo nuk dihej e është harruar dhe ngaqë për Europën moderne civilizimi i zi është një kontradiktë terminologjike?<sup>461</sup>

<sup>460</sup> Cheik Anta Diop, *The African Origins of Civilization* (Westport: L. Hill, 1974); Bernal, *Black Athena*, fq. 24, 151-155, 434-437.

<sup>461</sup> Du Bois, *Africa*, fq. 223.

Së fundmi, është e rëndësishme të vihet në dukje se i gjithë ky proces bazohet në tre paradokse mizore. I pari është se në të njëjtën kohë kur muslimanët po i jepnin Europës ide të reja e më të përparuara, të krishterët po e demonizonin Islamin dhe po bënin luftë me muslimanët përmes kryqëzatave. Së dyti, Lindja dha shumë nga idetë e Rilindjes, por vetëm për të parë se si europianët u kthyen dhe pandershmërisht pretenduan se ato ide i kishin zhvilluar vetë në mënyrë të pavarur. Për më tepër, më vonë europianët e shpallën Perëndimin si mishërim të qytetërimit të përparuar racional, kurse Lindja u pa me përçmim si një qytetërim inferior që nuk ishte veçse një djerrinë irracionale intelektuale. Paradoksi i tretë dhe më mizor ishte se pikërisht ky konceptim i Perëndimit si superior (si i përkufizuar mbi të gjitha me 'racionalitetin shkencor') më vonë do të ushqente ndërmarrjen e misionit civilizues imperial të Perëndimit ndaj Lindjes.

### **Origjinat lindore të shtypshkronjës, miti i Johann Gutenberg-ut**

S'mund të ketë dyshim se shpikja e shtypshkronjës pati rrjedhoja të jashtëzakonshme për sa i përket zhvillimit të Europës. Së pari e mbi të gjitha, ndikimi i Rilindjes dhe i revolucionit shkencor do të kish qenë shumë më i dobët në mungesë të librave të shtypur. Siç shpjegon Marie Boas:

shtypshkronja ... e bëri më të lehtë zhvillimin e shkencës: botimi i zbulimeve që bënte dikush, u bë diçka gjithnjë e më normale, çka siguronte që idetë e reja të mos humbnin, por të ishin të disponueshme si bazë për punën e të tjerëve ... Botimi e lehtësoi jashtë mase përhapjen dhe nga ana tjetër, veprat shkencore të pashtypura përgjithësisht kishin shumë pak gjasë që të ndiknin tek të tjerët.<sup>462</sup>

<sup>462</sup> Boas, *Scientific Renaissance*, fq. 29-30.

Një tjetër rezultat i shtypshkronjës ishte se ndihmoi në ngritjen e nacionalizmit,<sup>463</sup> si dhe në konsolidimin e burokracisë dhe në zhvillimin e ekonomisë europiane, më përgjithësisht.<sup>464</sup> Shkurt, ngjan me vend të themi se shtypshkronja ia ndryshoi me rrënjë natyrën qytetërimin perëndimor. Por ajo që nuk është e saktë është që Johann Gutenberg të njihet si shpikësi i shtypshkronjës.

Siç argumenton Michael Clapham, përpjekja për të gjetur një 'shpikës të vetëm të shtypshkronjës dhe rivaliteti i natyrshëm që lindi mes mbështetësve të Johann Gutenberg-ut ... të Mainz-it dhe Laurens Coster-it ... të Haarlem-it, kanë pjellë jo vetëm ndoca sajime [por] shumë interpretime të pandershme të të dhënave'.<sup>465</sup> Ajo që dimë është se origjina e shtypshkrimit mund të gjurmohet drejtpërdrejt në Kinën e shekullit të gjashtëmbëdhjetë dhe në Korenë e fillimeve të shekullit të katërmëdhjetë. Shtypshkrimi me kallëpe druri filloi në Kinë gjatë shekullit të gjashtë të erës sonë. Shtypshkrimi me kallëp u shpik në fillim të shekullit të nëntë dhe libri më i hershëm i shtypur që ekziston, daton në vitin 868. Shtypshkrimi i librave u përshkallëzua pas rreth 950-ës.<sup>466</sup> Që më 953, Feng Tao urdhëroi shtypjen e tekstit klasik të Konfucit, 'çka për shtypshkronjën kineze pati thuar se të njëjtin rezultat që do të kishte Bibla e Gutenberg-ut për shtypshkronjën europiane'.<sup>467</sup> Por kjo shpesh

<sup>463</sup> Benedict Anderson, *Imagined Communities* (London: Verso, 1983).

<sup>464</sup> Michael Mann, *The Sources of Social Power*, I (Cambridge: Cambridge University Press, 1986); Anthony Giddens, *The Nation-State and Violence* (Cambridge: Polity, 1985).

<sup>465</sup> Michael Clapham, "Printing", te Charles Singer, E. J. Holmyard, A. R. Hall dhe T. I. Williams (red.), *A History of Technology*, II (Oxford: Clarendon Press, 1956), fq. 377.

<sup>466</sup> Gernet, *History*, fq. 332-333; Tsien Tsuen-Hsuei, *Science and Civilisation in China*, V (1) (Cambridge: Cambridge University Press, 1985), fq. 146-169; Thomas F. Carter, *The Invention of Printing in China and its Spread Westward* (New York: The Ronald Press Company, 1955), fq. 41.

<sup>467</sup> Carter, *Invention*, fq. 239.

nënvlerësohet me pretendimin se shtypshkronja e Gutenberg-ut përdorte gërmat e lëvizshme, që ishin shumë më të përparuara. Por kjo e fsheh faktin e thjeshtë se shtypshkronja e parë me gërma të lëvizshme është shpikur në Kinë nga Pi Sheng rreth vitit 1040.<sup>468</sup>

Pavarësisht kësaj, studiuesit eurocentrikë ndonjëherë e kundërshtojnë këtë me pretendimin se shtypshkrimi me gërma të lëvizshme nuk zuri vend kurrë në Kinë dhe shtypshkrimi me kallëp mbeti i preferuari. Por kjo nuk ishte për shkak të ndonjë mungese gjenialiteti nga ana e kinezëve, por sepse shtypshkrimi me kallëp ishte më i përshtatshëm për natyrën e shkrimit kinez. Dhe siç vihej në dukje nga jezuitët, 'metoda kineze e shtypit ishte më e përshtatshme për gërmat e shumta e të ndërlikuara kineze sesa shtypshkrimi me gërma të lëvizshme'.<sup>469</sup> Ironikisht, kjo sipërfaqësisht e përforcon pretendimin standard eurocentrik se shtypshkronja e Gutenberg-ut ishte më efikase dhe e shpejtë ngaqë tipografia europiane bazohej në vetëm njëzet e gjashtë gërma të alfabetit. Por Lach dhe Kley vënë në dukje se jezuitët mendonin se shtypshkrimi kinez ishte jo vetëm po aq efikas sa ai europian, por se i pari kishte shumë avantazhe ndaj të dytit.<sup>470</sup> Veç kësaj, është interesante të vihet re se vetëm në shekullin e nëntëmbëdhjetë shtypshkrimi europian u bë më i shpejtë se shtypshkrimet aziatike; gjer atëherë ishte një mënyrë e ngadaltë dhe e shtrenjtë për riprodhimin e teksteve.<sup>471</sup> Megjithatë, David Landes këmbëngul se ndryshe nga Europa, shtypshkrimi kurrë nuk 'shpërtheu' në Kinë.<sup>472</sup> Por rreth fundit të shekullit të pesëmbëdhjetë, Kina me gjasë

<sup>468</sup> Tsuen-Hsuin, *Science*, V (1), fq. 145.

<sup>469</sup> Donald F. Lach dhe Edwin J. Van Kley, *Asia in the Making of Europe*, III (Chicago: Chicago University Press, 1993), fq. 1598.

<sup>470</sup> Po aty, fq. 1595.

<sup>471</sup> Gernet, *History*, fq. 336.

<sup>472</sup> Lands, *Wealth*, fq. 51.

shtypte më shumë libra se të gjitha vendet e tjera së bashku.<sup>473</sup> Që në vitin 978, njëra nga bibliotekat e Kinës përbante 80.000 vëllime (ndonëse në atë kohë disa nga bibliotekat kryesore islamike e tejkalonin lehtësisht këtë numër). Pavarësisht kësaj, eurocentrizmi mbron idenë se asnjëra nga këto nuk mund ta zhvlerësojë faktin se Gutenberg-u që i pari që zhvilloi shtypshkronjën me gërma të lëvizshme metalike. Por fakti është se kjo lloj shtypshkronje është shpikur në Kore në vitin 1403 (plot pesëdhjetë vjet më herët).<sup>474</sup>

Atëherë, si dhe në ç' masë u përhapën në Perëndim këto shpikje kineze dhe koreane? Ka të dhëna të forta se shtypshkronja kineze me kallëp arriti në Europë dhe u përdor për herë të parë në Gjermani në shekullin e trembëdhjetë (pasi kishte arritur në Poloni [1259] dhe Hungari [1283] me pushtimet mongole).<sup>475</sup> Në mënyrë domethënëse, Needham vë në dukje se,

Robert Curzon ... (1810-73) ka thënë se librat europianë e kinezë të shtypur me kallëp janë aq të ngjashëm në çdo aspekt, sa, 'mund të gjykojmë se procesi i shtypshkrimit i zbatuar në to duhet të jetë kopjuar nga shembujt e lashtë kinezë, të sjellë nga Kina nga ndoca udhëtarë të hershëm emrat e të cilëve nuk kanë arritur deri tek ne'.<sup>476</sup>

Por për ç'tipografi të lëvizshme metalike bëhet fjalë?

Së pari duhet pyetur a është thjesht një rastësi e kulluar që Gutenberg-u ta ketë zbuluar shtypshkronjën e tij, e cila në vija të përgjithshme që zbuluar në mesin e shekullit të njëmbëdhjetë në Kinë dhe në vija specifike rreth pesëdhjetë vjet më parë në Kore? Ndërkohë që nuk gjen ndonjë të dhë-

<sup>473</sup> Lach dhe Kley, *Asia*, fq. 1595, n. 209.

<sup>474</sup> Carter, *Invention*, fq. 239-240; Sang-woon Jeon, *Science and Technology in Korea* (Cambridge, Mass.: MIT, 1974), fq. 173-184; Tsuen-Hsuin, *Science*, V (1), fq. 319-331.

<sup>475</sup> Tsuen-Hsuin, *Science*, V (1), fq. 132-172, 303-313.

<sup>476</sup> Robert Curzon, cituar te Tsuen-Hsuin, *Science*, V (1), fq. 313.

në për bartjen e saj të drejtpërdrejtë, Thomas Carter mbron idenë e bartjes së tërthortë. Së pari, nuk ka dyshim se letërbërja, një parakusht i domosdoshëm i shtypshkrimit, është bartur në perëndim (siç u pa në kap. 6). Së dyti, një sërë produktesh të shtypura arritën në Europë, përfshirë letra bixhozi (të fundit të shekullit të katërmëdhjetë), kartmonedha, imazhe të shtypura dhe libra kinezë. Së treti, Carter hedh idenë se dija për metodën tipografike mund të jetë përcjellë nga çdonjëri prej evropianëve të shumtë që patën udhëtuar në Kinë.<sup>477</sup> Sido të që jetë, përfundimi i Hudson-it duket i drejtë:

Duke qenë se tipografia koreane pa një zhvillim kaq të spikatur menjëherë para shfaqjes së këtij procesi në Europë [nga Gutenberg-u], dhe duke qenë se ka patur linja të mundshme transmetimi mes Lindjes së Largët dhe Gjermanisë, atyre që pohojnë pavarësinë e plotë të shpikjes evropiane u takon ta vërtetojnë pretendimin e tyre.<sup>478</sup>

### Originat lindore të revolucionit ushtarak evropian

Revolucioni ushtarak evropian (1550-1660), ku shpata, heshta, topuzi e harku me shkrehje u zëvendësuan nga baruti, tyta e topi, ka qenë pa dyshim një moment kritik në zhvillimin e Europës.<sup>479</sup> Shumë mendojnë se kjo jo vetëm e nxori Europën në krye të botës për sa i përket fuqisë ushtarake, por gjithashtu mundësoi edhe zhvillimin e shtetit burokratik dhe të kapitalizmit.<sup>480</sup> Por ajo çka është lënë jash-

<sup>477</sup> Carter, *Invention*, fq. 242.

<sup>478</sup> G. F. Hudson, *Europe and China* (Boston: Beacon Press, 1961), fq. 168; gjithashtu, Clapham, "Printing", fq. 378, 380.

<sup>479</sup> J. M. Roberts, *Essays in Swedish History* (London: Weidenfeld and Nicolson, 1967).

<sup>480</sup> Charles Tilly, *Coercion, Capital and European States, AD990-1990* (Oxford: Blackwell, 1990); Giddens, *Nation-State*, fq. 103-116, 222-254; Mann, *Sources*, I, kapitujt 12-15.

të vëmendjes në gjithë këtë, është se të gjitha elementet e këtij revolucion janë shpikur gjatë revolucionit të parë ushtarak, rreth viteve 850-1290 në Kinë.

Këtë e kam trajtuar hollësisht në kapitullin 3, prandaj këtu do të përqendrohem vetëm në procesin e përhapjes globale nga Lindja.

Studiuesit eurocentrikë shpikjen e barutit shpesh ia atribuojnë shkencëtarit evropian Roger Bacon në vitin 1267. Por siç e vumë në dukje në kapitullin 3, receta e barutit daton në vitin 850 në Kinë, kurse në vitin 1044 ishte e disponueshme publikisht në format shtypi. Joseph Needham gjithashtu vë në dukje se në njoftimin e publikuar të Baconit për barutin, duket se autori ka përshkruar fishekzjarret kineze.<sup>481</sup> Për më tepër është krejt e mundur që atij t'i ketë rënë në dorë receta kineze e barutit. Si mund të jetë bartur kjo dije nga Kina në Perëndim? Paul Cressey dhe Arnold Pacey përmendin William-in e Rubrick-ut (mik personal i Bacon-it), i kthyer nga Kina më 1256/7.<sup>482</sup> Veç faktit që ai fare mirë mund ta ketë sjellë informacionin, një sërë evropianësh (kryesisht fretër) kishin udhëtuar në Kinë e qenë kthyer prej andej që nga viti 1245, dhe çdonjëri prej tyre mund ta ketë sjellë recetën.<sup>483</sup>

Në kapitullin 3 pamë se mushqeta e parë me tytë metalike u shfaq në Kinë rreth mesit të shekullit të trembëdhjetë, dhe me siguri jo më vonë se 1275-a, kurse topi i parë (Zjarrvrellësi) u shpik në Kinë rreth vitit 1288. Kjo është e rëndësishme pasi topi i parë evropian daton më 1326 në Firence

<sup>481</sup> Joseph Needham, Ho Ping-Yu, Lu Gwei-Djen dhe Wang Ling, *Science and Civilisation in China*, V (7) (Cambridge: Cambridge University Press, 1986), fq. 49.

<sup>482</sup> Paul Cressey, "Chinese Traits in European Civilization: a Study in Diffusion", *American Sociological Review* 10 (5) (1945), 598; Arnold Pacey, *Technology in World Civilization* (Cambridge, Mass.: MIT Press, 1991), fq. 45.

<sup>483</sup> Needham, e të tjerë, *Science*, V (7), fq. 47-50, 570-572.

dhe më 1327 në Angli (ky i fundit paraqitet në një dorëshkrim të Walter de Millemete-it).<sup>484</sup> Siç shprehet Pacey:

Është tejet interesante që ilustrimi më i hershëm i një [topi] europian ... paraqet një tytë krejt të llojit kinez, të vendosur mbi një mbështetëse dhe që hedh një shigjetë. Dikur mendohej se [topi] është shpikje europiane, kurse armët kineze erdhën më vonë ... Kjo pikëpamje nuk është më e besueshme.<sup>485</sup>

Topi presupozon një zhvillim paraprak të shtrirë në një kohë tepër të gjatë, çka është e qartë se mungon në kontekstin europian. Askush nuk ka ofruar të dhëna në kontekstin europian që ta mbështesin një gjë të tillë. Por një linjë e tillë zhvillimi paraprak është me siguri e qartë në kontekstin kinez (me rreth katër shekuj të kaluar). Jo më pak i rëndësishëm është fakti se topi kinez qëllonte gjyle shpërthyes, çka në Europë do të arrihej vetëm në shekullin e pesëmbëdhjetë. Për më tepër, topat kinezë ndonjëherë ishin të bërë me hekur të derdhur dhe, rrjedhimisht, ishin shumë më të fortë e efikasë se topat europianë me hekur të rrahur. Vetëm në gjysmën e dytë të shekullit të gjashtëmbëdhjetë do ta arrinin europianët këtë aspekt.

Bartja e tytës dhe e topit në Europë bazohet vetëm në të dhëna rrethanore. Needham dhe Ling hedhin mendimin se kjo mund të jetë realizuar ose nga tregtarët italianë në Tebriz, ose nga fretërit europianë (të përmendur më lart), ose nga muslimanët e ndryshëm që patën shërbyer si ushtarakë në Kinë pas 1260-ës.<sup>486</sup> Me siguri ka patur kontakte të mjaftueshme mes Europës dhe Kinës për ta bërë të mundur për-

<sup>484</sup> O. F. G. Hogg, *English Artillery 1326-1716* (London: Royal Artillery Institution, 1963), fq. 6-9, 46; William H. McNeill, *The Pursuit of Power* (Oxford: Blackwell, 1982), fq. 81, 84.

<sup>485</sup> Pacey, *Technology*, fq. 47.

<sup>486</sup> Needham, e të tjerë, *Science*, V (7), fq. 572-579.

cjelljen e idesë së topit, ndoshta përmes paraqitjeve pamore dhe/ose informacionit konkret mbi ndërtimin e tij. Megjithëse këto pretendime janë thjesht spekulative, është e qartë se topi nuk doli prej hiçit. Propozimet për një shpikje të pavarur europiane janë problematike, ndonëse jo thjesht ngaqë topi më i hershëm ekzistues daton thujtse dyzet vjet më vonë se shpikja e Zjarrvjellësit kinez. Sepse, siç u vu në dukje më lart, ajo që e ndriçon çështjen është se asnjë ekspert nuk ka ofruar kurrë ndonjë të dhënë për zhvillimet e domosdoshme europiane që duhet t'i kenë paraprirë topit të parë european të 1326/7-ës. Pa këto të fundit, përcjellja e dijes kineze ofron të vetmen përgjigje të mundshme. Kështu që u takon studiuesve eurocentrikë të vërtetojnë të kundërtën. Për t'u shënuar gjithashtu është edhe ideja e zakonshme eurocentrike se ndërtimi i anijeve të mëdha me topa është një shpikje unike europiane. Por kjo ide e injoron faktin se topat qenë përdorur prej kohësh në anije shumë më të mëdha kineze.

Së fundmi, duhet të marrim parasysh edhe zhvillimet ushtarake islamike, të cilat po ashtu patën një ndikim të pavarur në Europë. Teknologjitë ushtarake islame jo vetëm u zhvilluan me shpejtësi të madhe, por mbetën superiore ndaj atyre të europianëve për një kohë shumë të gjatë. Pas shekullit të tetë, ushtritë muslimane kanë patur në përbërje trupa zjarrvënëse me veshje kundër zjarrit. Ata kanë përdorur atë që kryqtarët e quanin 'zjarr grek' (naftë), që ishte një lëndë djegëse. Zjarri grek është një emërtim i gabuar, sepse fenomeni e ka origjinën në Lindjen e Mesme. Në vitin 673, një arkitekt sirian nga Baalbeku, i njohur si Callinicus, kaloi në radhët e Bizantit, duke marrë me vete edhe sekretin e armës së re.<sup>487</sup> Domethënës është fakti se bizantinët nuk e

<sup>487</sup> Siç edhe Lynn White e pranon te vepra e tij, *Medieval Religion and Technology* (Berkeley: University of California Press, 1978), fq. 285; shih, gjithashtu, Ahmad Y.

quajtën atë zjarr grek, ngaqë e dinin se e kishte origjinën në Lindjen e Mesme. Lënda djegëse përhapej me anë zjarrvënësesh (*zerraja*) me forcë shkatërruese, përdorej për të ngjyer e ndezur shigjetat, si dhe në granada që flakeshin me dorë, me makina (katapulta), ose qëlloheshin si raketa.<sup>488</sup> Kurse katapulta me kundërpeshë ishte një shpikje unike muslimane. Në shekullin e dymbëdhjetë, periudha e Salahuddin el-Ejjubiut (Saladinit) shënoi një fazë të re e më intensive të zhvillimit teknologjik ushtarak. Mjetet zjarrvënëse, për shembull, përdroreshin nga muslimanët në çdo betejë. Kryqtarët nuk kishin asnjë kundërpërgjigje ndaj kësaj dhe fati i tyre përballë furisë së muslimanëve superiorë u vulos në Akka më 1291 (siç u vu në dukje në kap. 2).

Më vonë, Perandoria Osmane – për të cilën Hodgson ka përdorur cilësimin e famshëm ‘perandori baruti’ – do të bëhej epiqendra e risive të ndryshme teknologjiko-ushtarake, shumë prej të cilave u bartën në Europën Perëndimore. Në veçanti mushqetat turke u përhapën me shpejtësi përmes Azisë së Mesme deri në Indi në lindje e në Europë në perëndim. ‘Jo vetëm që ky ishte eksporti më i madh në botë i mushqetave, por disa syresh ishin të një cilësie tepër të lartë’.<sup>489</sup> Veçanërisht osmanët kontribuan konsiderueshëm në zhvillimin e mushqetës me tytat prej çeliku, të cilat ishin më të forta dhe më pak të prirura për të plasur se ato që prodhoheshin në Europë. Nuk është për t’u habitur që ‘europianët i çmonin tytat turke dhe prodhuesit më të mirë europianë të armëve ndonjëherë i përdornin tytat turke si bazë për armët [e tyre]’.<sup>490</sup> Për më tepër, ekspertët europianë

al-Hassan dhe Donald R. Hill, *Islamic Technology* (Cambridge: Cambridge University Press, 1986), fq. 106-107; Needham, e të tjerë, *Science*, V (7), fq. 77.

<sup>488</sup> Al-Hassan dhe Hill, *Islamic Technology*, fq. 108.

<sup>489</sup> Pacey, *Technology*, fq. 74.

<sup>490</sup> Po aty, fq. 80.

për një kohë të gjatë do t'i hutonte cilësia e lartë e tytave turke të mushqetave dhe e çelikut indian Wootz (shih kap. 9). Osmanët me gjasë shpikën edhe shkrehësin (i njohur si *serpentine*), ndonëse kjo mund të ketë qenë shpikje kineze.<sup>491</sup> Vlen të vihet në dukje megjithëse 'protoartileria' romake (katapultat) dhe harku mesjetar european me shkrehje kishin shkrehës, këto nuk mund të kenë përbërë bazën e shkrehësit më të vonshëm me ndjezje të mushqetave, sepse ky i fundit ishte një shpikje krejtësisht e pavarur.

Si përfundim, thuhet se çdo aspekt i rëndësishëm teknologjik i revolucionit ushtarak european është marrë nga Lindja duke u bartur në Perëndim përmes një zinxhiri të gjatë përcjellës. Dhe ndërsa europianët më vonë i çuan më tej këto teknologji ushtarake – në shekullin e nëntëmbëdhjetë, me siguri – fakti mbetet se pa përparimet e disponueshme lindore nuk do të kishte patur çfarë të zhvillohej më tej.

<sup>491</sup> Krahaso. Needham, e të tjerë, *Science*, V (7), fq. 455-465; Pacey, *Technology*, fq. 75.

## 9. ORIGJINAT KINEZE TË INDUSTRIALIZIMIT BRITANIK: BRITANIA SI VEND IMITUES ME ZHVILLIM TË VONË, 1700-1846

Për mendimin tim, ajo çka nënkupton *vu-vei* [*laissez-faire*] është që kurrfarë paragjykimi personal [vullneti privat apo publik] nuk duhet ta pengojë Taon universale [ligjin e gjërave] dhe se asnjëlloj dëshire e obsesioni nuk duhet ta shmangë rrjedhën e vërtetë të proceseve. Arsyeja duhet t'i prijë veprimit në mënyrë që pushteti të ushtrohet në përputhje me cilësitë e brendshme dhe rendin e natyrshëm të gjërave.

*Liu An, Huai Nan Tzu, 120 p.e.s.*

Mjaft më me Greqi e Romë;  
Hambarët e tyre të shterur nuk joshin më askënd!  
Edhe pse ndihmë nga jashtë më kot kërkojmë,  
ngadhnjimet tona në sy të njerëzisë dështojnë...  
Mbi flatra shqiponjash poeti ngrihet lart  
drejt Kinës në Lindje për virtyte të freskëta  
dhe nga burimi i dritës bart  
moralin konfuçian në veshët e Britanisë.

*William Whitehead, 1759*

### **Domethënia e etiketimit të Britanisë si 'vend i industrializuar rishtas' apo 'me zhvillim të vonë'**

Në kapitullin e fundit trajtuam periudhën mes viteve 1492-1700 dhe diskutuam se si Europa mezi po i arrinte fuqitë më të përparuara të Lindjes. Njëkohësisht kjo bëhej e mundur nga përvetësimi kolonialist i materialit të çmuar 'joeuropean' dhe asimilimi i 'hambarëve burimorë' të Lind-

jes. Këtu i kthehem aspektit asimilacionist të historisë. Momenti tjetër dhe më domethënës në kronologjinë standarde eurocentrike i shkëlqimit të Perëndimit ka të bëjë me revolucionin industrial britanik. Në fakt historia britanike përbën kulmin e narrativës eurocentrike, sepse është e pranuar universalisht se Britania ka qenë vendi i parë i industrializuar. Merrni çfarëdo libri standard të historisë ekonomike mbi industrializimin dhe do ta shihni se nis me kapërcimin ‘e hershëm’ të Britanisë në shekujt e tetëmbëdhjetë e nëntëmbëdhjetë. Kjo gjë shpallet madje që në titujt e veprave madhore mbi këtë çështje, ndër të cilat mund të përmendim *The First Industrial Revolution* (“Revolucioni i parë industrial”) të Phyllis Deane dhe *The First Industrial Nation* (“Shteti i parë industrial”) të Peter Mathias.<sup>492</sup> Ose, siç e shpall R. M. Hartwell në përgjigjen ndaj pyetjes retorike se ‘a ka patur revolucion industrial?': ‘Ka patur një revolucion industrial dhe ka qenë britanik.’<sup>493</sup>

Ka dy aksioma të tjera akoma të ndërthurura që gjenden në epiqendër të rrëfimit eurocentrik të revolucionit industrial britanik: e para, se ky revolucion u mundësua nga mjedisi i favorshëm shoqëror që la trashëgim shteti liberal *laissez-faire* britanik (kritikën e të cilit e bëj në kapitullin 11). Së dyti, ky kapërcim u arrit nga zgjuarsia dhe individualizimi i anglo-saksonëve pa ndihmë të jashtme. Tipik në këtë pikë është pretendimi i Walter Rostow se ‘rasti britanik i tranzicionit është unik në kuptimin që duket se është arritur nga dinamikat e brendshme të një shoqërie të vetme, pa ndërhyrje të jashtme’.<sup>494</sup> Ose, në një interpretim tipik mark-

<sup>492</sup> Phyllis Deane, *The First Industrial Revolution* (Cambridge: Cambridge University Press, 1965); Peter Mathias, *The First Industrial Nation* (London: Methuen, 1983).

<sup>493</sup> R. M. Hartwell, “Was there an Industrial Revolution?”, *Social Science History* 14 (1990), 575, theksimi im me kursiv.

<sup>494</sup> Walt W. Rostow, *The Stages of Economic Growth* (Cambridge: Cambridge University Press, 1961), fq. 157, theksimi është i imi.

sist, Perry Anderson pohon se revolucioni industrial britanik 'qe një shpërthim spontan e vigan i forcave prodhuese, i shembullt në forcë e universal në shtrirje'.<sup>495</sup> Sekret i përgjithshëm i suksesit të britanikëve mendohet se qëndron në tiparin e tyre unik të individualizmit ose të vetëndihmesës. Rëndësinë e kësaj e shpreh David Landes, në mënyrë tipike smithiane, si kurën universale të varfërisë:

Historia na tregon se kurat më të suksesshme të varfërisë vijnë nga brenda... Vendimtare janë puna, përkoria, ndershmeria, durimi, këmbëngulja. Për njerëzit e munduar nga mjerimi e uria, kjo mund të përmblihet në indiferencë egoiste. Por në thelb, asgjë nuk jep aq forcë sa vetëfuqizimi.<sup>496</sup>

Më specifikisht, theksohet shumë zgjuarsia e shpikësve pionierë britanikë. Tipikisht historianët përqendrohen në procesin përmes të cilit revolucioni industrial britanik u shty nga një 'sekuence sfide dhe përgjigjeje'. Kjo sekuencë përfshinte një proces nëpërmjet të cilit 'përsheptimi i një faze të procesit prodhues krijonte trysni të fortë mbi faktorët prodhues të një apo më shumë fazave të tjera [të quajtura *bottleneck*, "grykëshishe"] dhe ndillte shpikje që e korrigjonin çekuilibrin'.<sup>497</sup> Qenë zgjidhjet e grumbulluara të "grykëshisheve" të shumta nga shpikje të reja pioniere britanike që kulminuan me arritjen e kapitalizmit modern industrial. Ose, siç shprehet Landes, sekret i suksesit të britanikëve qëndron në aftësinë e tyre për të arritur ndryshim 'të vetëgjeneruar'.<sup>498</sup>

<sup>495</sup> Perry Anderson, *Lineages of the Absolutist State* (London: Verso, 1979), fq. 419-420.

<sup>496</sup> David S. Landes, *The Wealth and Poverty of Nations* (London: Little, Brown, 1998), fq. 523.

<sup>497</sup> David S. Landes, *The Unbound Prometheus* (Cambridge: Cambridge University Press, 1969), fq. 84; Charles P. Kindleberger, *World Economic Primacy* (Oxford: Oxford University Press, 1996), fq. 132.

<sup>498</sup> Landes, *Unbound Prometheus*, fq. 39.

Argumenti fundamental i këtij kapitulli është se megjithëse britanikët kanë patur dorë, historinë në masë të madhe e ka bërë ndryshimi 'i gjeneruar nga të tjerët'. Marshall Hodgson njëherë vuri në dukje kalimthi se Oksidenti është 'trashëgimtari i pavetëdijshëm i ... revolucionit industrial të Kinës së dinastisë Sung'.<sup>499</sup> Përveç fjalës 'i pavetëdijshëm', pajtohem. Sepse siç arsyetoj në këtë kapitull, britanikët i morën e i përvetësuan me vetëdije teknologjitë kineze – qoftë vetë teknologjinë, qoftë dijen mbi një teknologji të caktuar. Në këtë kuptim Britania ishte si një vend çfarëdo 'me zhvillim të vonë' ose i industrializuar rishtas, në atë që gëzonte 'avantazhet e prapambetjes' dhe ishte e aftë të asimilonte e të rafinonte teknologjitë e përparuara të zhvilluara fillimisht nga vende me zhvillim të hershëm. Në një kuptim pra, britanikët mund të karakterizohen ashtu siç u pëlqen shumë perëndimorëve t'i përshkruajnë japonezët mes viteve 1868 dhe 1913 (ose pas 1945-ës): popull me një kapacitet në masë të madhe të përfutur, dhe ishin të shkëlqyer në kopjimin, asimilimin dhe rafinimin e ideve të të tjerëve.

Ndërsa ky kapitull merr përsipër t'ia zhveshë robën eurocentrike revolucionit industrial britanik, është e qartë se kjo është një nismë kundrintuitive. Shumica dërrmuese prej nesh vazhdojnë të besojnë se të studiuarit e Britanisë të shekullit të tetëmbëdhjetë do të na japë të gjitha kriteret që çojnë në zhvillimin e suksesshëm ekonomik, të njohur ndryshe si 'modernizim'. Siç shprehet Eric Jones, 'supozimi është se historianët e ekonomisë duhet të kërkojnë një transformim unik; se këtë e kemi gjetur tashmë; se ky është revolucioni industrial britanik'.<sup>500</sup> Ky supozim e mbizotëron përfytyrimin perëndimor, aq sa 'çdo nxënës shkollë e di [këtë],

<sup>499</sup> Marshall G. S. Hodgson, *The Venture of Islam*, III (Chicago: Chicago University Press, 1974) fq. 197.

<sup>500</sup> Eric L. Jones, *Growth Recurring* (Oxford: Clarendon Press, 1988), fq. 13.

duke qenë se thuajse çdo program mësimor në historinë e ekonomisë fillon në këtë pikë ... [sidomos] nëse ka parë ndonjë serial televiziv mbi shkëlqimin e species sonë'.<sup>501</sup> Por nëse e vëmë historinë britanike në një kontekst më të gjerë historiko-global, (ose në kohëzgjatjen e gjatë globale), jemi të detyruar ta sfidojmë idenë se 'transformimi i madh' britanik përfaqëson mosvazhdimësinë më të rëndësishme në historinë botërore të ekonomisë. Është më me kuptim që revolucioni industrial britanik të shihet thjesht si një çast (jo i parëndësishëm) në historinë e vazhdueshme grumbulluese të zhvillimit globalo-ekonomik që i lidh 'partnerët' historikisht të largët kinezë të dinastisë Sung me Britaninë e shekullit të tetëmbëdhjetë. Në këtë kuptim, Eric Jones ka të drejtë kur arsyeton se përparimi i Kinës sunge nuk ka qenë si i Britanisë, por ai i Britanisë ka qenë si i Kinës.<sup>502</sup> Por në një kuptim tjetër, ky përbashkim errëson dy dallime kritike: së pari, ndryshe nga Kina, Britania ishte shumë e varur nga asimilimi dhe huazimi i shpikjeve të tjerëve, siç tregon ky kapitull. Së dyti, po në kontrast të mprehtë nga mrekullia kineze, industrializimi britanik varej në masë të madhe nga përvetësimi kolonialist i shumë burimeve joeuropiane, si toka, krahu i punës, lëndët e para e tregjet (shih kap. 11). Nëse jo për gjë tjetër, kjo duhet të shërbejë për ta përmbysur, ose të paktën për ta zvogëluar prirjen eurocentrike për ta denigruar mrekullinë sunge në favor të kapërcimit 'të mëvetëm' të Britanisë.

Përmbledhurazi, domethënia e atypëratyshme e etiketimit të Britanisë si vend me zhvillim të vonë është e dyfish-të. Së pari, ky etiketim shemb presupozimin universal se Britania qe 'e para'. Së dyti, na e riorienton vëmendjen si

<sup>501</sup> Po aty, fq. 28.

<sup>502</sup> Po aty, fq. 80.

drejt strategjive përmes të cilave britanikët i imituan dhe asimiluan teknologjitë dhe idetë më të përparuara që buroin nga vendet me zhvillim të hershëm të Lindjes (me në krye Kinën) si dhe ndaj procesit të globalizimit oriental që e bëri të mundur këtë gjë. Ky kapitull i çon përpara këto propozime në tre faza. Pjesa e parë shqyrton mënyrat se si idetë kineze e ndikuan iluminizmin europian dhe zbulon rrugët e përhapjes përgjatë të cilave hambarët burimorë të Kinës udhëtuan drejt Perëndimit. Pjesa e dytë trajton kontributin kinez në revolucionin agrrikulturore britanik. Kurse pjesa e tretë nxjerr në dritë kontributet kineze në revolucionin industrial britanik.

### **Kina: një model për industrializimin britanik**

Argumenti im kryesor këtu është se britanikët nuk kanë patur veçanërisht shumë shpikës të shkëlqyer. Aftësia e tyre qëndron më shumë në asimilimin dhe rafinimin e shpikjeve dhe ideve teknologjike më të hershme kineze. Por si arritën britanikët të kishin akses në këto burime kineze dhe si ndikuan idetë kineze në kulturën dhe politikën britanike?

#### *Iluminizmi oriental*

Periudha europiane e iluminizmit ka qenë veçanërisht skizofrenike në kuptimin që teksa i ka shërbyer rritjes së 'racizmit të nënkuptuar' (shih kap. 10), paradoksalisht shumë nga idetë me të cilat u shoqëruan pozitivisht mendimtarët e iluminizmit u përcollën drejtpërdrejt nga Lindja. Këtu unë shqyrtoj këtë ndikim pozitiv lindor, para se t'i kthehem në kapitullin tjetër trajtimit të mënyrave se si europianët më vonë e denigruan Lindjen.

Idetë kineze qenë veçanërisht të rëndësishme për sa i përket stimulimit të iluminizmit në Europën kontinentale dhe në Britani. Idetë kineze ndikuan mbi idetë europiane mbi qeverisjen, filozofinë morale, stilet artistike (për shembull, rokoko), veshjet, orenditë dhe letrat e mureve, kopshetet, ekonominë politike, çajpirjen e shumë të tjera. Lidhja midis iluminizmit europian dhe mendimit kinez u krijua përfundimisht nga besimi i përbashkët në arsyen njerëzore si qendër e gjithçkaje. Arsyeja ishte jetike, pasi bënte të mundur zbulimin e 'ligjeve të lëvizjes' që mendohej se ishin të mbishkruara në të gjitha sferat e jetës shoqërore, politike e 'natyrore'. Në vitin 1687 u përkthye një libër për Konfucin (*Confucius Sinarum Philosophus*), në parathënien e të cilit autori pohonte se:

Mund të thuhet se sistemi moral i këtij filozofi është pafundësisht sublim, por se në të njëjtën kohë është edhe i thjeshtë, i arsyeshëm e i përfutur nga burimet më të kulluara të arsyes natyrore ... Kurrë arsyeja, e privuar nga revelata hyjnore, nuk është shfaqur e zhvilluar kaq mirë dhe kaq e fuqishme.<sup>503</sup>

Libri pati ndikim të madh në Europë. Kur lexuan këtë tekst:

njerëzit panë të mahnitur se dymijë vjet më parë në Kinë, emri i së cilës gjendej në gjuhën e çdo tregtari në pannairet e mëdha, Konfuci kishte patur të njëjtat mendime, në të njëjtën mënyrë, dhe kishte bërë të njëjtat beteja ... Kësisoj Konfuci u bë shenjtori mbrojtës i iluminizmit të shekullit të tetëmbëdhjetë.<sup>504</sup>

<sup>503</sup> Cituar te Arnold H. Rowbotham, "The Impact of Confucianism on Seventeenth Century Europe", *The Far Eastern Quarterly* 4 (1) (1944), 227.

<sup>504</sup> Kjo referencë dhe dy referencat pasuese janë nga Adolf Reichwein, *China and Europe* (Taipei: Ch'eng-Wen Publishing Company, 1967), fq. 77, 78 and 79, respektivisht.

Data kritike në këtë histori është 1700-a: 'viti i kalimit kur joshja e botës së mësuar [europiane] u kthye drejt Kinës'. Gjatë tetëdhjetë viteve në vijim, shumë evropianë u bënë tejet kureshtarë për Kinën, aq sa përjetuan një dashuri virtuale me botën e rokokosë.

Shumë mendimtarë iluministë u shoqëruan pozitivisht me Kinën dhe idetë e saj, përfshirë Montaigne, Malebranche, Leibniz, Volteri, Quesnay, Wolff, Hume dhe Adam Smith. Një nga mendimtarët më të shquar të iluminizmit ishte edhe Volteri. Libri i tij *Essai sur les mœurs* (1756) është cilësuar si një 'përmbledhje e përsosur e të gjitha ndjenjave [pozitive] të kohës për Lindjen e Largët'. Për më tepër, në librat *L'Orphelin de la Chine* [1755] dhe *Zadig* [1748], Volteri shfrytëzoi konceptimet kineze për politikën, fenë e filozofinë – të gjitha të bazuara mbi parime racionale – për të sulmuar preferencën evropiane për aristokracinë e trashëguar. Në fakt shumë mendimtarë madhorë të iluminizmit e merrnin nga Kina preferencën e tyre për 'metodën racionale'.

Në masën që disa studiues eurocentrikë e pranojnë se Kina pati ndikim mbi iluminizmin, zakonisht presupozohet se ajo gëzoi një vend pozitiv vetëm në Francë (pa dyshim ngaqë absolutizmi i shtetit francez e bënte 'Kinën despotike' të dukej tërheqëse). Por idetë kineze gjithashtu luajtën rol të rëndësishëm edhe në kulturën britanike. Britanikët zhvilluan një shije të fortë për kinezëritë, nga çajpirja, letrat e mureve, kopshtet anglo-kineze, e deri tek idetë mbi ekonominë politike.<sup>505</sup> Në kanonin anglo-sakson, ekonomisti politik qendror evropian ishte skocezi Adam Smith. Por teksa shumë anglo-saksonë ngushtazi e shohin Adam Smithin si ekonomistin e parë politik, pas tij qëndronte François

<sup>505</sup> William W. Appleton, *A Cycle of Cathay* (New York: Columbia University Press, 1951), kapitulli 6; Reichwein, *China*, fq. 113-126; Hugh Honour, *Chinoiserie: the Vision of Cathay* (London: John Murray, 1961), fq. 44-52, 125-174.

Quesnay, 'fiziokrati' francez. Kurse pas Quesnay-it qëndronte Kina.<sup>506</sup> Quesnay, dhe jo Smith-i, qe europiani i parë i cili kritikoi idetë e merkantilizmit. Termi 'fiziokraci' do të thotë 'sundim i natyrës'. Rëndësia e ideve të tij, të përfuara nga Kina, ishte të paktën e dyfishtë: së pari, ai pa tek agrikultura një burim të rëndësishëm të pasurisë (çka u bë një ide e rëndësishme në revolucionin agrikulturor britanik). Së dyti, dhe ç'është më e rëndësishmja, ai besonte se agrikultura mund të shfrytëzohet plotësisht vetëm kur prodhuesit të çlirohen nga ndërhyrjet arbitrare të shtetit. Vetëm atëherë do të sundojnë 'ligjet natyrore' të tregut (siç e kishin kuptuar me kohë kinezët). J. J. Clarke vë në dukje se:

Idetë revolucionare të Quesnay-it nënkuptonin çlirimin nga ortodoksia ekonomike e ... merkantilizmit ... dhe ndikimi i tij mbi teoritë e Adam Smith-it për tregun e lirë ka qenë thelbësor. Ajo çka shpeshherë anashkalohet në trajtimet mbi vendin e Quesnay-it në mendimin modern është detyrimi i tij ndaj Kinës, ndryshe nga ç'ndodhte në kohën e tij kur njihet gjerësisht si 'Konfuci evropian'.<sup>507</sup>

Detyrimi i Quesnay-it ndaj koncepteve kineze të ekonomisë politike, gjendej në shumë ide, më e rëndësishmja ndër të cilat ishte ajo e *wu-wei*-t, e përkthyer në frengjisht si *laissez-faire*. Ky koncept kinez ka qarkulluar shumë më herët se fillimi i epokës sonë (shih citimin nga Liu An në fillim të kapitullit). Dhe jo më herët se në vitin 300 e.s., Kuo Hsiang e përshkruante *wu-wei*-n si atë që bën të mundur që 'çdo gjë të lejohet të bëjë atë që bën natyrshëm, në mënyrë që natyra e saj të jetë e kënaqur'.<sup>508</sup> Lidhja e veçantë e Quesnay-it me

<sup>506</sup> Lewis A. Maverick, *China A Model for Europe*, I (San Antonio, Texas: Paul Anderson, 1946), fq. 111-123; Martin Bernal, *Black Athena*, I (New York: Vintage, 1991), fq. 172; Francesca Bray, *Science and Civilisation in China*, VI (2) (Cambridge: Cambridge University Press, 1984), fq. 569.

<sup>507</sup> J. J. Clarke, *Oriental Enlightenment* (London: Routledge, 1997), fq. 49.

<sup>508</sup> Kuo Hsiang, cituar te Colin A. Ronan, *The Shorter Science and Civilisation in China* (Cambridge: Cambridge University Press, 1978), fq. 97.

iluminizmin qëndronte në theksimin e qëndërsisë së metodës shkencore, siç shprehej në *Tableau economique* të tij (përndryshe tejet komplekse), parimet e së cilës ishin thelbësisht të ndikuara nga mendimi kinez.<sup>509</sup> Vlen të vihet në dukje gjithashtu se Quesnay-in e ndiqte Nicolas-Gabriel Clerc-in, libri i të cilit *Yu le Grand et Confucius* (1765) haptazi u bënte thirrje europianëve për të imituar kinezët nëse dëshironin të gëzonin zhvillim të fortë ekonomik. Duke i bërë jehonë Quesnay-it, edhe ai këmbëngulte (ashtu si edhe Adam Smith njëmbëdhjetë vjet më vonë) se ekonomia do të funksiononte më së miri nëse hiqeshin të gjitha barrierat. Siç shprehet Basil Guy: 'Si ligjvënësi edhe ligji duhet t'i pranojnë parimet e ... rendit natyror dhe duke vepruar kështu, të përputhen me idealin kinez të *wu-wei-t* [*laissez-faire*] i cili gjithmonë ka frymëzuar teoritë e tyre mbi qeverisjen'.<sup>510</sup>

Asgjë nga këto nuk nënkupton se iluminizmi evropian që produkt i kulluar i ideve kineze. Dhe është e qartë se ka patur disa mendimtarë të iluminizmit të cilët e kanë refuzuar Kinën si model për Europën, me në krye Montesquieu-në dhe Fenelon-in. Aspekti skizofrenik i iluminizmit u bë i qartë me perceptimin e ndryshuar evropian për Kinën. Ndërsa filloi me perceptimin e Katajit të mahnitur, pas 1780-ës përfundoi me idenë se kinezët janë 'njerëz të rënë' të një toke barbare nën asfiksi despotike. Por siç na kujton Martin Bernal, 'asnjë evropian i shekullit të tetëmbëdhjetë [para 1780-ës] nuk do të mund të pretendonte se Europa kish bërë vetveten'.<sup>511</sup> E tillë ishte rëndësia që mendimtarët evropianët i jepnin Kinës, nga fundi i shekullit të shtatëmbëdhjetë deri rreth vitit 1780, sa madje Volteri e sulmonte Bossuet-në sepse nuk e përmendte Kinën në librin e tij të

<sup>509</sup> Reichwein, *China*, fq. 101-109.

<sup>510</sup> Basil Guy, cituar te Clarke, *Oriental Enlightenment*, fq. 50.

<sup>511</sup> Bernal, *Black Athena*, fq. 198.

historisë botërore. Sir William Temple i shprehte ndjenjat mbizotëruese me këto fjalë: ‘mbretëria e Kinës duket e strukturuar dhe e qeverisur me forcën dhe nivelin më të lartë të urtësisë, arsyes e aftësisë njerëzore’.<sup>512</sup> Por rreth 1780-ës ndodhi kthimi njëqind e tetëdhjetë gradësh: ‘cikli i Katajit’ kish bërë një rreth të plotë. Pikëpamjen e re e përfaqësonte në mënyrë tipike Oliver Goldsmith: ‘Artet që mund të jenë shpikur nga racat e tjera të njerëzimit [për shembull, Kina] kanë arritur përsosmërinë atje [në Europë]’.<sup>513</sup> Ose, siç shprehej konti i tetë i Elginit (duke i bërë jehonë Goldsmith-it dhe Purchas-it), në duart e Kinës:

shpikja e barutit ka shpërthyer në kapsolla e fishekzjarre. Busulla e marinarit s’ka prodhuar ndonjë gjë më të hajrit se lundra brigjesh. Arti i printimit ka mbetur në botimet stereotip të Konfucit, kurse pasqyrimet më cinike të groteskes kanë përbërë produktet kryesore të koncepteve kineze të sublimes dhe të së bukurës.<sup>514</sup>

Në këtë proces u bë një gabim i vogël, por me pasoja, sepse krijoi iluzionin se europianët ishin tërësisht të pavarur, origjinalë e gjenialë. Ky kapitull e nxjerr në dritë këtë mendim si arrogancë të pastër. Por para se ta tregoj këtë, është me vend të tregohet se si janë përhapur deri në Europë idetë dhe teknologjitë kineze.

### *Kanalet e përcjelljes nga Kina në Europë*

Dija për Katajin e përcjellë drejtpërsëdrejti në Europë filloi me murgjit e shumtë françeskanë të cilët vajtën atje për herë të parë pas vitit 1245. Rrëfimet e tyre u zbehën nga

<sup>512</sup> Sir William Temple, cituar te Michael Edwardes, *East-West Passage* (New York: Taplinger, 1971), fq. 107.

<sup>513</sup> Oliver Goldsmith, cituar te Bernal, *Black Athena*, fq. 198.

<sup>514</sup> The eighth earl of Elgin, cituar te Ronald Hyam, *Britain’s Imperial Century 1815-1914* (London: Batsford, 1976), fq. 37.

historitë mahnitëse për Katajin të transmetuara në Europë nga Marko Polo në gjysmën e dytë të shekullit. Më vonë jezuitët do të bëheshin pjesa më e rëndësishme e transmetimit. Matteo Ricci shkroi një sërë vëllimesh që u përkthyen në gjuhë të ndryshme europiane në vitin 1610, të cilat konfirmonin se ‘Kina e tij ishte pa dyshim e njëjtë me Katajin e [mrekullueshëm të] Marko Polos’.<sup>515</sup> Qenë jezuitët ata që i bindën europianët se baruti, busulla, letra dhe printimi qenë shpikur në Kinë (megjithëse më vonë këto arritje u anashkaluan apo u fshinë në historitë e ndryshme eurocentrike të botës). Një europian bashkëkohës i cili jetonte në Kinë, At de Magaillans-it, i kishin bërë përshtypje të madhe shkallët ujore. Braudel bënë këtë pyetje retorike:

A kishte të drejtë pra (1678) At de Magaillans-i, i cili thekson vështirësinë dhe rrezikun e një ndërmarrjeje të tillë, ta paraqiste [shkallën ujore] si një shembull të mënyrës kineze për të ndërtuar gjithfarë mjetesh mekanike me shumë më pak instrumente se ç’kemi ne [në Perëndim]’?<sup>516</sup>

Urëtimet e europianëve që kanë jetuar ose e kanë vizituar Kinën, e bëjnë të qartë se ka qenë pikërisht kështu, çka tregon për një qytetërim teknologjik unik e mbresëlënës. Perëndimorët në përgjithësi e shihnin Kinën (e po ashtu edhe Egjiptin) si bartës ‘shembujsh pozitivë qytetërimesh të larta e të rafinuara. Të dyja kanë dëshmuar arritje të mëdha materiale, filozofi të thella e sisteme superiore të të shkruarit.’<sup>517</sup> Megjithatë, mund të kundërshtohet se jezuitët e kanë ekzagjeruar qëllimisht rastin e tyre për t’i lënë mbresë perandorit të Kinës për të përfituar favore. Por në të vërtetë

<sup>515</sup> Jonathan Spence, *To Change China* (Boston: Little, Brown, 1969), fq. 6.

<sup>516</sup> Fernand Braudel, *Civilization and Capitalism, 15th-18th Century*, I (London: Collins, 1981), fq. 338-339.

<sup>517</sup> Bernal, *Black Athena*, fq. 172.

shumica e rrëfimeve të tyre për Kinën ishin çuditërisht të balancuara dhe jezuitët nuk druheshin të vinin në dukje ato sfera ku besonin se europianët ishin superiorë.

Sido që të jetë, jezuitët përbënin një kanal të rëndësishëm për përcjelljen e ideve ekonomike dhe mbi të gjitha, të teknologjive kineze. Shembujt janë të shumtë. Luigji XIV dërgoi gjashtë jezuitë në Kinë në vitin 1685 me një listë të gjatë subjektsh (hartuar nga Akademia Franceze e Shkenca) për të mësuar për gjithfarë fushash, nga shkenca, flora e fauna, deri tek agrikultura. Është fakt interesant se këtë Luigjit ia sugjeroi Colbert-i, i nxitur nga ana e tij prej Leibniz-it.<sup>518</sup> Vetë Leibniz-i i shkroi misionit jezuit në Kinë duke u kërkuar specifikisht të përcillnin informacion për prodhimin e metaleve, të çajit, letrës, mëndafshit, porcelanit 'të vërtetë', bojrave tekstile e xhamit, si dhe për teknologjitë agrikulturore, ushtarake e detare kineze. Pa një dije të tillë, arsyetonte Leibniz-i, 'pak përfitim do të ketë nga misioni në Kinë'.<sup>519</sup> Ç'është më e rëndësishme, Leibniz-i u kërkoi jezuitëve të sillnin me vete në Europë teknologji, makina e modele kineze, si dhe përshkrime për agrikulturën dhe industrinë kineze. Për fat të mirë jezuitët e përmbushën këtë kërkesë. Një nga hulumtimet më të gjithanshme u ndërmor nga Turgot (ministri i Financave i Luigjit XVI) i cili në vitin 1765 dërgoi dy misionarë të krishterë në Kinë me një tekst gjithëpërfshirës pyetjesh.<sup>520</sup> Po ashtu shkrimtarë të shumtë europianë udhëtuan në Kinë dhe shkruan libra mbi ato ç'ka panë. Një shembull i spikatur është libri *An Account of Chinese Husbandry* i Kapiten Ekeberg-ut, i përkthyer në germanisht dhe anglisht.<sup>521</sup> Veç kësaj, marinarët holandezë me

<sup>518</sup> Maverick, *China*, fq. 13-14.

<sup>519</sup> Leibniz, cituar te Bray, *Science*, VI (2), fq. 569.

<sup>520</sup> Maverick, *China*, fq. 41-59; Bernal, *Black Athena*, fq. 199.

<sup>521</sup> Bray, *Science*, VI (2), p. 570.

bazë në Batavia qenë një tjetër kanal i rëndësishëm për përhapjen e ideve dhe teknologjive kineze.

Nga viti 1600 e këtej, informacioni për Kinën u grumbullua përmes letrave të jezuitëve, por pas vitit 1650 librat mbi Kinën u bënë mbizotëruese. Të botuara në shumë gjuhë europiane, ato përcollën mrekullitë e shumta të Katajit në nivel të përgjithshëm, dhe teknologjitë e idetë ekonomike të tij në mënyrë të veçantë.<sup>522</sup> Krahas shkrimeve të Matteo Ricci-t në vitin 1610, Nicolas Trigault, Alvarez Semedo, Martino Martini dhe të tjerë bënë përshkrime të hollësishme librore për të gjitha aspektet e Kinës, përfshirë edhe pjesë për 'pjellorinë e prodhimit' dhe 'artet mekanike'. Ç'është më e rëndësishme, librat e shumtë të jezuitëve e nxitën përfytyrimin e europianëve, nga intelektualët tek njerëzit e zakonshëm dhe nga masat tek disa nga monarkët europianë. Kësisoj, Europa jo vetëm u mbush me tekste mbi Kinën, por mori edhe shumë teknologji e modele drejtpërsëdrejti të kopjueshme që do të mundësonin revolucionet agrikulurore e industriale. Vlen të përmendet një përmbledhje e gjerë:

Gjatë shekullit [të 17-të] u shfaqën me qindra libra për Azinë, të shkruara nga misionarë, tregtarë, kapitenë anijesh, mjekë, marinarë, ushtarë e udhëtarë të pavarur. Kishte të paktën njëzet e pesë përshkrime të mëdha vetëm për Azinë Jugore, pesëmbëdhjetë për Azinë Juglindore kontinentale, rreth njëzet për arkipelagët dhe gjashtëdhjetë syresh për Azinë Lindore. Krahas këtyre kontributeve madhore të pavarura qëndronin qindra libra korrespondence të jezuitëve, rrëfime të tërthorta, rrëfime udhëtimesh ... pamflete, gazeta e të ngjashme. Librat u botuan në të gjitha gjuhët europiane, u ribotuan shpesh e

<sup>522</sup> Maverick, *China*; Wolfgang Franke, *China and the West* (Oxford: Blackwell, 1967), kapitulli 4.

u përkthyen, u përfshinë në përmbledhje të shumta e të mëdha literature udhëtimi të botuar përgjatë shekullit, për t' u vjedhur nga autorë apo botues më të vonshëm ... Pak europianë të lexuar mund të kenë mbetur krejtësisht të paprekur prej saj dhe do të kishte qenë vërtet befasese nëse efektet e saj nuk do viheshin re në letërsinë, artin, dijen e kulturën europiane bashkëkohore.<sup>523</sup>

Së këtejmi, është e qartë se europianët patën mundësi të kishin akses të lehtë në idetë dhe teknologjitë më të përparuara kineze (si dhe të tjera aziatike). Siç do ta shohim pak më poshtë, me këtë informacion dhe disa nga vetë teknologjitë, europianët dhe veçanërisht britanikët filluan t' i asimilonin ato për t' i arritur kinezët dhe për t' i kaluar. Për fat të keq praktikisht asnjë shpikës perëndimor nuk e ka pranuar se ka huazuar ide nga perëndimorë të tjerë, e aq më pak nga kinezët. Siç e shpreh Francesca Bray,

nëse shpresojmë të gjejmë pranim të hapur të një ndikimi të tillë në veprat e tyre, do të mbetemi të zhgënjyer: Autorët dhe shpikësit perëndimorë i kanë vjedhur paturpësisht veprat e njëri-tjetrit ... [dhe] mund të jemi të sigurt se nuk kanë patur skrupuj që të mos i shesin për të vetat ide të ardhura nga ana tjetër e botës.<sup>524</sup>

Megjithatë, sërish është e mundur të gjurmohet përhapja e ideve dhe teknologjive të veçanta kineze në Perëndim (edhe pse të gjitha këto e bëjnë më të vështirë), prandaj në frymën e Volterit, le t' i rishqyrtojmë revolucionet agrikulturore e industriale britanike duke i rinxjerrë në dritë kontributet e shumta kineze të lëna në errësi nga eurocentrizmi.

<sup>523</sup> Donald F. Lach dhe Edwin J. Van Kley, *Asia in the Making of Europe*, III (Chicago: Chicago University Press, 1993), fq. 1890; shih, gjithashtu, Clarke, *Oriental Enlightenment*, fq. 40.

<sup>524</sup> Bray, *Science* VI (2), fq. 571.

## Origjinat kineze të revolucionit agrikulturor britanik

Revolucioni agrikulturor tradicionalisht mendohet se përfaqëson në mos një nga parakushtet kritike, të paktën një nga kushtet aktuale të kohës për zhvillimin e industria-lizimit britanik. Ky revolucion përfshin një sërë shpikjesh gjoja gjeniale e origjinale britanike, siç janë ‘seed-drill’ (farë-mbjellësja) dhe ‘shati i tërhequr nga kuajt’ (të ndërtuara në vitin 1700 por të përhapura në masë në vitet 1730), ‘makina shirëse e vënë në punë nga kuajt’ (1780), ‘plugu i Rodherhemit’ (patentuar më 1730) dhe ‘makina rotulluese e shirjes’. Gjithashtu të rëndësishme bëhen metodat e reja të përdorimit të tokës, si teknikat e alternimit të të mbjellave, plehrat, bimët e reja dhe mbarështimi selektiv. Nëse të gjitha këto do të ishin zbuluar apo zbatuar për herë të parë në Britani, atëherë do të mund të pranohej pretendimi eurocentrik për gjenialitetin dhe origjinalitetin britanik. Por ka të dhëna të forta që tregojnë ndryshe.

### *Plugu me veshëz hekuri i shekullit të tetëmbëdhjetë (plugu i Rodherhemit)*

Shumica e komentuesve e pranojnë se plugu me veshëz të hekurt qe një risi jetike teknologjike e cila i dha hov të madh prodhimit agrikulturor në Britani (ndonëse u desh një kohë e gjatë para se të përdorej gjerësisht). Plugu i Rodherhemit i 1730-ës ishte shumë më eficient krahasuar me plugun e rëndë kthyes të mesjetës (shih kap. 5). Veshëza katrore e drunjte e plugut mesjetar u zëvendësua me një veshëz të hekurt me hark të lidhur në një nivel me plorin. Kjo e reduktonte në masë të madhe fërkimin (ashtu si edhe mungesa e rrotave). Ky lloj plugu gjoja u zhvillua për herë të parë në Holandën e shekullit të shtatëmbëdhjetë (i njohur si plugu ‘bastard’ holandez) dhe më vonë u bart në Britani

nga inxhinierët holandezë (të cilët erdhën për tharjen e kënetave të Anglisë Lindore). Plugun e tyre e pasoi plugu anglez i Rodherhemit që bartte shumë elemente të plugut 'bastard', por ishte një mjet i rafinuar me një strukturë shumë më të lehtë dhe që do të rafinohej edhe më gjatë shekullit tjetër. A mos vallë shpikësit origjinalë holandezë e konfirmojnë pretendimin eurocentrik për një shpikje të pavarur europiane?

Paul Leser për herë të parë në vitin 1931 hodhi pretendimin se plugu europian e ka origjinën në Kinë dhe se pa huazimin e tij Europa nuk do ta kishte realizuar revolucionin agrikor. <sup>525</sup> Në të vërtetë, të gjitha elementet e plugut 'bastard' holandez qenë shpikur në Kinë që prej rreth dymijë vjetësh. Por a është kjo thjesht një rastësi? Më së afërti Francesca Bray e ka hedhur poshtë këtë mundësi mbi bazën se plugët e rinj europianë i ngjanin shumë shpikjes shumë më të hershme kineze. Dhe, në të vërtetë, plugët kinezë me veshëz hekuri i paraprijnë përsosmërisht modelit të përshkruar në vitin 1784 nga europiani James Small (i ashtuquajtur pionier i plugut). Për më tepër, shfaqja e beftë e plugëve të rinj europianë, shumë të ndryshëm nga ato që qenë përdorur për rreth njëmijë vjet, të bën të mendosh se kjo nuk mund të ketë qenë thjesht rastësi. Sido që të jetë, është e qartë se holandezët (të cilët kishin qëndruar në Azinë Lindore në shekullin e shtatëmbëdhjetë) e sollën në vendin e tyre modelin kinez dhe krijuan plugun holandez ose 'bastard' i cili më vonë u përshtat në formën e plugut britanik të Rodherhemit. <sup>526</sup> Siç përfundon Robert Temple:

Nuk ka patur asnjë element më të rëndësishëm [se huazimi i plugut kinez] në revolucionin agrikor euro-

<sup>525</sup> Shih po aty, fq. 553-555, 558-559.

<sup>526</sup> Po aty, fq. 581-583.

pian. Kur mendojmë se vetëm dyqind vjet kanë kaluar që kur Europa befasi filloi ta arrinte e më vonë ta kalonte agrikulturën kineze, mund ta shohim se ç'lustër e hollë dhe e përkohshme mbulon superioritetin e besuar perëndimor në prodhimin e ushqimit.<sup>527</sup>

### *Makina rrotulluese e shirjes*

Shpikja e makinës rrotulluese të shirjes (e cila ndante lëvoret dhe kërcejtë e drithit pas korrjes) shënoi një kapërcim madhor. Por asaj i paraprinte prej shumë kohësh makina rrotulluese kineze e shirjes, e shpikur në shekullin e dytë p.e.s. dhe e rafinuar përgjatë shekujve në vijim.<sup>528</sup> Ash-tu si plugu me veshëz hekuri, edhe ky mjet u mor drejtpërsëdrejti nga Kina. Për herë të parë u soll në Francë nga jezuitët në vitet 1720 dhe atje ndolli interes të madh. Modele të ndryshme u sollën në Suedi ku u përshtatën nga shkencëtarë suedezë si Jonas Norberg. Interesante është se Norberg e ka thyer konvencionin evropian duke pohuar se 'ide në fillestare e mora ... nga tri modele të ndryshme të sjella nga Kina.'<sup>529</sup> Së fundmi, makina rrotulluese e shirjes u soll në Europë edhe nga marinarët holandezë mes viteve 1700 dhe 1720 (e zbuluar në përdorim në Batavi).<sup>530</sup>

### *Farëmbjellësja dhe shati i tërhequr nga kuajt*

Para se të përhapej farëmbjellësja, farat mbilleshin mundimshëm me dorë, proces ky edhe i ngadaltë edhe tejet joefikas që rezultonte në humbjes e një pjese të madhe të të mbjellave për shkak se një pjesë e farave binin në boshllëqë

<sup>527</sup> Robert Temple, *The Genius of China* (London: Prion Books, 1999), fq. 20.

<sup>528</sup> Bray, *Science*, VI (2), fq. 366-75; Joseph Needham dhe Wang Ling, *Science and Civilisation in China*, IV (2) (Cambridge: Cambridge University Press, 1965), fq. 154.

<sup>529</sup> Cituar te Bray, *Science*, VI (2), fq. 377.

<sup>530</sup> Temple, *Genius*, fq. 23-25.

në terren, çka bënte të mbinin tufa bimësh të cilave u duhej të konkurronin për dritë, lagështi dhe ushqim. Kjo metodë ndryshonte shumë nga farëmbjellësja me shumë tuba e shpikur në shekullin e tretë p.e.s.:

Mund të ishte deri në tridhjetëfish më me rendiment për sa u përket të korrave që jepte. Kjo ka qenë kështu për shtatëmbëdhjetë apo tetëmbëdhjetë shekuj. Përgjatë tërë kësaj kohe Kina ishte aq shumë para Perëndimit për sa i përket prodhimit agrikulturor sa dallimi ishte, sikur dy gjysmat e botës të mund ta shihnin, si dallimi midis ... 'botës së zhvilluar' dhe ... 'botës në zhvillim'.<sup>531</sup>

Europa shumë vonë e arriti Kinën pasi Jethro Tull shpiku, siç besohet, farëmbjellësen (e cila megjithatë ishte kaba dhe nisi të përdorej gjerësisht shumë dekada më vonë). Ky mjet i mbillte farat në radhë të rregullta dhe në një thellësi të caktuar. Aparati prashitës i mbante farat poshtë dhe ajroste dheun. Sado gjeniale dhe revolucionare të ketë qenë kjo kur u fut për herë të parë në Britani, fakti mbetet se që shpikur në Kinë rreth dymijë vjet më parë.

Nuk është e lehtë të gjurmosh përhapjen e kësaj shpikjeje nga Kina. Këtu ndeshim një nga dilemat e procesit të përhapjes. Sepse ashtu si në rastin e mullirit të erës, ajo që u përhap në fakt që ideja e farëmbjellëses, po të kemi paraysh se modeli i Tull-it ndryshonte në shumë drejtime nga modelet kineze. Kjo shpjegohet me faktin se farëmbjellësja kineze përdorej vetëm në pjesën veriore të vendit, larg nga portet e Kinës Jugore të frekuentuara nga europianët. Çka do të thotë se ndryshe nga disa shpikje të tjera kineze, është e pagjasë që kjo të jetë çuar drejtpërsëdrejti në Europë nga marinarët europianë. Por është shumë e mundur që *ideja* e farëmbjellësit të jetë përcjellë, me gjasë nëpërmjet përhapjes

<sup>531</sup> Po aty, fq. 27.

së librave e manualëve për këtë mjet. Për shembull, në librin e tij *The History of the Great and Renowned Monarchy of China* (1655), Alvarez Semedo na tregon:

Kur po kaloja nga *Honumi* [Honami], pashë dikë që po plugonte me një plug me tre plorë, duke hapur tri brazda njëherësh, dhe duke qenë se dheu ishte i mirë për farën që këtu e quajmë bishtajë, fara që vënë në një shinik, ose në katrore, të vendosur në pjesën e sipërme të plugut në atë mënyrë që me lëvizjen e plugut farat të binin njëtrajtshëm mbi dhé siç bien mbi mokër me lëvizjen e gorgullës, kështu që njëkohësisht toka plugohet dhe mbillet me shpresën për prodhim.<sup>532</sup>

Ajo që përshkruan Semedo me siguri ka qenë farëmbjellësja me prashitje. Dhe të vihet re data: 1655. Kjo s' do të thotë se që pikërisht ky libër që bëri të mundur huazimin e farëmbjellëses me prashitje nga Europa, por është e pamohueshme që të ketë patur trajtesa të botuara mbi këtë shpikje kineze që europianët mund t'i lexonin në kohën e tyre të lirë. Po ashtu është befasuese të vëresh se parimet bazë të Tull-it për farëmbjellësen, të përshkruara në librin e tij *Horse-Hoeing Husbandry* (1733) janë riprodhim thuajse fjalë për fjalë i përshkrimeve në manualet origjinale kineze që datojnë deri në shekullin e tretë para erës sonë.<sup>533</sup> Dhe, në fakt, Bray thotë se sistemi i Tull-it i ngjante aq shumë 'praktikës bujqësore të Kinës Veriore, sa të bën të mendosh se Tull e ka huazuar sistemin me të gjitha elementet nga Kina'.<sup>534</sup>

Duke qenë se që ideja ajo që u përcoll, europianëve iu desh ta rishpiknin për veten e tyre dhe nuk është për t'u habitur që modeli përfundimtar dukej i ndryshëm nga

<sup>532</sup> Alvarez Semedo, cituarë Lach dhe Kley, *Asia*, fq. 1595.

<sup>533</sup> Parimet e Tull-it dhe formula kineze janë riprodhuar te Bray, *Science*, VI (2), fq. 559, 560.

<sup>534</sup> Bray, *Science*, VI (2), fq. 571.

varianti origjinal kinez. Dhe ç'është e vërteta fakti që forma përfundimtare pjesërisht ndryshonte nga modeli kinez pjesërisht bënte të krijohej iluzioni i një shpikjeje origjinale britanike. Por siç e vë në dukje Bray:

Mund të arsyetohet se farëmbjellësja europiane që një zhvillim i logjikshëm nga teknikat e mëparshme horti-kulturore si mbjellja në radhë, megjithatë nuk mund të jetë e rastit që shpikësit europianë papritur nisën të punonin mbi makineri për mbjelljen e disa radhëve misër njëherësh në vija të drejta, pikërisht si makineritë përkatëse kineze dhe pikërisht në periudhën kur informacioni mbi agrikulturën kineze po bëhej lehtësisht i gjindshëm.<sup>535</sup>

Për më tepër, ngjan se Jethro Tull ia ka arritur ta mbajë të fshehtë origjinën lindore të farëmbjellësit 'të tij'. Aq i suksesshëm ka qenë në këtë drejtim sa vetëm në vitin 1795 Bordi Agrikulturor Britanik mësoi se farëmbjellësja kishte qenë përdorur me kohë në Lindje dhe siguroi vetë një farëmbjellëse (si dhe një plug) nga Kina.<sup>536</sup>

Le ta përmbledhim çështjen. Megjithëse teknologjitë madhore britanike agrikulturore kishin origjinë të dukshme kineze, u desh një periudhë e gjatë para se fermerët britanikë t'i përvetësonin këto teknika: farëmbjellësen në mesin e shekullit të nëntëmbëdhjetë, plugun e Rodherhemit në vitet 1820 dhe makinën rrotulluese të shirjes rreth vitit 1870. Kësisoj, historia e zhvillimit agrikulturor britanik nuk mund të fillojë e të mbarojë me shpikjet teknologjike, dhe jo më së paku ngaqë këto dolën në skenë relativisht vonë. Ndonëse këto teknologji luajtën rol të rëndësishëm, ajo që bëri dallimin në fund që futja e risive biologjike e ekologjike: bimët e reja tokëkursyese, ushqimet me kalori të larta

<sup>535</sup> Po aty, fq. 582.

<sup>536</sup> Arnold Pacey, *The Maze of Ingenuity* (London: Allen Lane, 1974), fq. 191.

dhe metodat e reja të alternimit të të mbjellave. Qe pikërisht ky 'zbulim' i fundit ai që e bëri Turnip Townshend-in të shënohej në hartë. Ajo që nuk na tregohet zakonisht, është se shumëçka nga kjo u arrit vetëm falë ndihmës që dha Kina si dhe Amerikat (ky kontribut trajtohet më hollësisht në kap. 11).

Sistemet e reja të alternimit të të mbjellave, të përshëndetura nga britanikët si një nga kapërcimet kritike agrikulurore, ishin tërësisht të paraprirra nga kinezët. Madje kinezët kishin zhvilluar shumë sisteme të tilla që në shekullin e gjashtë, të gjitha të treguara në *Chi Min Jao Shu*.<sup>537</sup> Këto sisteme jo vetëm përdoreshin gjerësisht, por ishin tejet të sofistikuara. Kjo ishte një nga arsytet pse prodhimi agrikor i Kinës ia kishte kaluar lehtësisht për shekuj me radhë atij të Britanisë. Për më tepër, disa nga bimët alternuese revolucionare të përdorura nga britanikët në shekullin e tetëmbëdhjetë ishin përdorur nga kinezët që para njëmijë e dyqind vjetësh (për shembull, bathët, patatja e ëmbël, meli, gruri e elbi dhe rrepa). Do të ishte tejet befasuese sikur dija dhe detajet e këtyre sistemeve të mos qenë përcjellë deri në Europë (siç tregohet më sipër). Është gjithashtu e rëndësishme të vihet në dukje se Bota e Re i dha Britanisë shumë nga të mbjellat që rezultuan jetike për revolucionin agrikor,<sup>538</sup> si rrepa, patatja, misri, plehu i zogjve guano, karrota, lakra, hikrra, sumbullarja, kolza, tërfili dhe të tjera bimë foragjere. Rrepa dhe tërfili siguruan bazën e sistemit britanik të alternimit të të mbjellave, guanoja shërbeu si një pleh i rëndësishëm kurse patatja rriti kaloritë e marra nga masat.<sup>539</sup> Së

<sup>537</sup> Bray, *Science*, VI (2), fq. 429-433.

<sup>538</sup> Alfred W. Crosby, *The Columbian Exchange* (Westport: Greenwood, 1972), kapitulli 5; Braudel, *Civilization*, I, fq. 158-171.

<sup>539</sup> Kenneth Pomeranz, *The Great Divergence* (Princeton: Princeton University Press, 2000), fq. 57-58.

fundmi, rëndësi u jepet zakonisht teknikave të reja në mbarshtimin e kuajve që bënë të mundur rritjen e kuajve më të mëdhenj e më të fuqishëm. Por ajo që anashkalohet zakonisht është fakti se këtë gjë e bëri të mundur në masë të madhe futja e ‘racave lindore’ – kuajt arabë nga Perandoria Osmane (kali arab i Darley-it, turku i Byerley-it dhe arabi i Godolphin-it) – në fillimet e shekullit të tetëmbëdhjetë.<sup>540</sup>

### Origjinat kineze të revolucionit industrial britanik

Krahas pambukut, industria e hekurit dhe çelikut ka përbërë shtyllën kryesore të industrializimit të Britanisë. Historitë eurocentrike gjithmonë fillojnë me një sërë kapërcimesh të shënuara teknologjike britanike. Lista zakonisht përmban hekurin e derdhur me shkrirje koksi të Abraham Darby-t (1776), procesin e përzierjes [*puddling*] të Henry Cort-it (1784) dhe sidomos motorin me avull të James Watt-it (1776). Dhe, si zakonisht, historianët eurocentrikë e tregojnë këtë si një ‘sekuencë sfide dhe përgjigjeje’ (ravijëzuar në hyrjen e këtij kapitulli), ku shpikësit pionierë britanikë qenë të aftë t’u jepnin zgjidhje të gjitha çështjeve kyçe që kishin të bënin me çdo shpikje. Për shembull, motori atmosferik i Thomas Newcomen-it (1705) u rafinua nëpërmjet një linje të gjatë zhvillimesh, si motori hidraulik me shfryrje i patentuar i John Wilkinson-it (1757) dhe motori me avull i James Watt-it, të cilat e arritën kulmin me motorin me presion të lartë të Richard Trevithick-ut më 1802 (i cili e çoi në ndërtimit e lokomotivës së parë me avull më 1804). Pyetja është: a ishin britanikët aq origjinalë sa ç’pretendon eurocentrizmi? Kjo pjesë i përgjigjet negativisht kësaj pyetjeje. Dhe duke marrë parasysh rolin shumë të rëndësishëm

<sup>540</sup> Stuart Piggott, *Ruins in a Land Landscape* (Edinburgh: Edinburgh University Press, 1976), fq. 115, 124.

që luajti në industrializimin e Britanisë, është me vend t'ia nisim nga motori me avull.

### *Motori me avull*

Kenneth Pomeranz arsyeton se ajo çka çoi në 'dallimin e madh' midis Britanisë dhe Kinës pas vitit 1800, qe fakti se Britania ishte e bekuar me miniera të thella e të ujshme kundrejt atyre të cekëta e të thata të Kinës. Kjo bëri të nevojshme shpikjen e motorit me avull në Britani për pompimin e ujit jashtë dhe motori me avull bëri të mundur industrializimin e gjithanshëm të Britanisë (duke qenë se u përdor gjerësisht jo vetëm në miniera, por edhe në fabrika, hekurudha, etj.). Kurse minierat e cekëta e të thata të Kinës rezultuan të pafata për vendin, pasi kjo rrethanë nuk bëri të nevojshme shpikjen e motorit me avull dhe prandaj nuk pati industrializim.<sup>541</sup>

Tri çështje kryesore e bëjnë problematik arsyetimin e Pomeranz-it. Së pari, gjermimi i thellë ka filluar në Kinë që në periudhën e Shteteve Ndërluftuese (shekulli i 5-të – 221 p.e.s.). Mes kësaj periudhe dhe asaj të dinastisë Sung, minierat më të thella arrinin mesatarisht diç më pak se 300 këmbë (kurse gjatë dinastive Ming dhe Çing, shumë miniera arritën në thellësitë nga 3000 deri në 4800 këmbë, kurse njëra arriti deri në 8500 këmbë).<sup>542</sup> Së dyti, shumë miniera me siguri ndodheshin në nivelin e ujit dhe prandaj kërkohnin kullim (për shembull, në ultësirat e Kiangsuit Verior). Robert Hartwell vë në dukje se atje 'rritja e shkallës së punimeve gjatë shekullit të njëmbëdhjetë me gjasë duhet të ketë kërkuar investim thelbësor në mjetet e kullimit, çka me gjasë duhet të ketë përfshirë pompa me gjyrykë hidraulikë,

<sup>541</sup> Pomeranz, *Great Divergence*, fq. 59-68.

<sup>542</sup> Peter J. Golas, *Science and Civilisation in China*, V (13) (Cambridge: Cambridge University Press, 1999), fq. 285-287.

të ngjashme me ato që përdoreshin në pusët e kripës në Siçuan'.<sup>543</sup> Dhe siç shpjegon Peter Golas:

Edhe sasi të pakta uji shkaktojnë probleme të mëdha në minierat e qymyrit, por në Kinë këtij problemi i shtohet edhe fakti që shumë nga qymyri i saj ndodhet i lidhur me gurin gëlqeror të shtresëzuar që shpesh përmban sasi të mëdha uji. Për shkak të dredhave të tejzgjatura, këto rezervuare preken shpesh gjatë procesit të gërmimit ... Në rastin më të mirë kjo gjë e ka bërë heqjen e ujit problemin më të madh e më të përhapur në minierat e qymyrit në Kinë ... Por problemi më i madh për minatorët kinezë deri atëherë kish qenë uji i tepërt e jo i pakët.<sup>544</sup>

Së treti, dhe ç'është më ironikja, është më së paku e debatueshme nëse motori me avull do të që zhvilluar në Britani po të mos kish qenë për risitë e hershme pionierike kineze, ndër të cilat më për t'u veçuar është pompa hidraulike me gjyryk të cilën kinezët nuk e kanë përdorur më së paku për zbrazjen e minierave të përmbytura.

Është sqaruese në vetvete po të fillojmë duke vënë në dukje se elementet bazë të motorit me avull qenë shfaqur për herë të parë të printuara në gjuhën kineze në *Trajtesë mbi Agrikulturën të Uang Çen* (1313). Këto elemente e kanë origjinën që në gjyrykët hidraulikë (përdorur për herë të parë në vitin 31 e.s.). Siç njihet zakonisht, motori me avull i Watt-it që një përparim i makinës së Wilkinson-it. Por vetë shpikja e Wilkinson-it ishte pak a shumë identike me makinën e Uang Çen-it. E vetmja shtesë, por jo e parëndësishme, ishte përdorimi i kollodokut (i cili ndoshta ishte një nga katër shpikjet vërtet të pavarura që europianët bënë gjatë pe-

<sup>543</sup> Robert Hartwell, "Markets, Technology, and the Structure of Enterprise in the Development of the Eleventh-Century Chinese Iron and Steel Industry", *Journal of Economic History* 26 (1) (1966), 48.

<sup>544</sup> Golas, *Science*, V (13), fq. 186, 336.

riudhës 500-1700). Veç kësaj, nuk është më pak e rëndësishme të vihet në dukje se gjyryku i mbyllur kinez, që ishte një pompë me dy veprime, shtytëse dhe thithëse, me çdo goditje e shfrynte ajrin nga njëra anë e pistonit teksa thithte brenda një sasi të barabartë ajri nga ana tjetër. Jo vetëm që kishte një ‘ngjashmëri të ngushtë në formë’ me motorin e Watt-it, por rreth fundit të shekullit të shtatëmbëdhjetë kinezët kishin zhvilluar një turbinë me avull.<sup>545</sup> Interesante është se nisur nga argumenti i Needham-it dhe Ling-ut, Pomeranz vë në dukje se:

Kinezët e kishin kuptuar me kohë parimin bazë shkencor që ishte në lojë – ekzistenca e presionit atmosferik – dhe kishin krijuar me kohë (si pjesë e gjyrykut të tyre të mbyllur) një sistem pistoni/cilindri me dy veprime, shumë të ngjashëm me të Watt-it, si dhe një sistem për ta shndërruar lëvizjen rrotulluese në lëvizje lineare, të mirë sa çdo tjetër që njihet para shekullit të njëzetë. Gjithë çfarë mbetej ishte të përdorej pistoni për të rrotulluar rrotën dhe jo e kundërta. (Tek gjyryku, shkulumi i ajrit të nxehët të lëvizur nga pistoni ishte qëllimi, dhe jo një hap drejt dhënies forcë rrotës). Një misionar jezuit i cili demonstroi vënien në punë të modeleve në miniaturë të një karroce me turbinë avulli si dhe të një avulloreje para një gjykate në vitin 1671, duket se ka punuar nga modele kineze po aq sa nga modele perëndimore.<sup>546</sup>

Për më tepër, Robert Temple vë në dukje:

Modelet europiane [për motorin me avull] ishin të përfutuara, përmes ndërmjetësish të ndryshëm, si Agostino Ramelli (1588), të gjitha nga Kina. Sa për pistonat që vinin në punë rrotat, e jo e kundërta, stimuli kinez aty ekzistonte veçmas. Pistonat e vënë në punë nga baruti

<sup>545</sup> Needham dhe Ling, *Science*, IV (2), fq. 135-136, 225-228, 369-370, 387, 407-408, 411.

<sup>546</sup> Pomeranz, *Great Divergence*, fq. 61-62.

shpërthyes u provuan në Europë nisur nga ideja, siç shprehet Needham, se 'pistoni dhe bjella mund të konsiderohen si një gjyle e lidhur me litar'. Duke qenë se kinezët i kishin shpikur si barutin ashtu dhe topin, djegia e brendshme dhe motori me avull u frymëzuan pjesërisht nga fakti se topi ka një gjyle që i përshtatet saktësisht grykës dhe shtyhet me forcë – kontribute të mëtejshme kineze në prejardhjen e të dy motorave<sup>547</sup>.

Topi praktikisht është një motor njëcilindërs me djegie të brendshme dhe, siç e ka vënë në dukje Lynn White, 'të gjithë motorët tanë modernë ... e kanë prejardhjen prej tij'.<sup>548</sup> Në fakt, njëra nga sfidat madhore me të cilat u përball James Watt kur po zhvillonte motorin e tij me avull, ishte nevoja për të shpuar një cilindër të saktë që nuk fuste ajër. Interesant është fakti se iu drejtua John Wilkinson-it për ndihmë. Është interesant sepse Wilkinson-i kishte një mulli shpues të dizenuar për prodhimin e topave dhe ishin kinezët ata që kishin shpikur topin, i cili më vonë iu përcoll evropianëve (siç e pamë në kap. 3 dhe 8).

Asgjë nga këto nuk do të thotë se Pommeranz dhe të tjerët e kanë gabim kur theksojnë rëndësinë e zhvillimit dhe përdorimit të gjerë të motorit me avull në industrializimin e Britanisë, por do të thotë se shumë nga aspektet fundamentale të motorit me avull qenë zhvilluar për herë të parë në Kinë shumë shekuj para se evropianë si Leonardo da Vinçi të ëndërronin për një mjet të tillë. Fakti është që motori britanik me avull nuk u shfaq mrekullisht prej hiçit. Ndërsa shpikësit britanikë patën rolin e tyre, do të ishte e padrejtë të anashkalohej kontributi kinez.

<sup>547</sup> Temple, *Genius*, fq. 65-6; Joseph Needham, Ho Ping-Yu, Lu Gwei-Djen dhe Wang Ling, *Science and Civilisation in China*, V (7) (Cambridge: Cambridge University Press, 1986), fq. 544-568.

<sup>548</sup> Lynn White, *Medieval Technology and Social Change* (Oxford: Clarendon Press, 1962), fq. 100.

### *Furrat me qymyr dhe furnaltat*

Eurocentrizmi veçanërisht thekson zëvendësimin ‘revolucionar’ në Britani të qymyrdrurit me qymyrin (në kushtet e një shpyllëzimi galopant), duke arritur në pretendimin e njohur se Coalbrookdale-i i Britanisë që ‘i pari vend’ në botë që përdori koksin për të shkrirë mineralin e hekurit. Siç shprehet Phyllis Deane: ‘Arritja më e rëndësishme e revolucionit industrial që se qymyri ia ndryshoi bazën ekonomisë britanike nga druri dhe uji në qymyr dhe hekur’.<sup>549</sup> Por, siç e vumë në dukje në kap. 3, kjo e mjegullon faktin se Kina e kishte përdorur qymyrgurin për të zëvendësuar qymyrdrurin që në shekullin e njëmbëdhjetë. Për më tepër furnalta e kishte zanafillën në Kinë në shekullin e dytë para erës sonë, kurse në shekullin e pestë të erës sonë kinezët kishin zhvilluar një proces ‘bashkëfuzioni’ ku hekuri i rrahur dhe ai i derdhur përziheshin për të prodhuar çelikun. ‘Ky është në thelb procesi i çelikut i 1863-shit i Martin-it dhe Siemens-it, por i bartur njëmijë e katërqind vjet më parë.’<sup>550</sup> Megjithatë, në vitin 1850 Britania ende prodhonte sasi relativisht të vogla çeliku (krahasuar me hekurin) për shkak të koston së tij të madhe të prodhimit. Këtë gjë e ndryshoi shpikja e konvertuesit Bessemer (1852). Në këtë pikë është sqaruese të vihet në dukje se,

Punës së Henry Bessemer-it i kishte paraprirë më 1852-shin William Kelly [ndonëse këtij të fundit nuk iu njoh e gjithë merita] ... [Dhe] Kelly kishte sjellë katër ekspertë kinezë çeliku në Kentucky në vitin 1845, prej të cilëve kishte mësuar parimet e prodhimit të çelikut të zbatuara në Kinë për më shumë se dymijë vjet.<sup>551</sup>

<sup>549</sup> Deane, *First Industrial Revolution*, fq. 129.

<sup>550</sup> Temple, *Genius*, fq. 68.

<sup>551</sup> Po aty, fq. 49.

### *Prodhimi i hekurit dhe çelikut*

Siç u vu në dukje në kapitullin 3, deri në vitin 1788 nivelet e prodhimit të hekurit në Britani ishin ende më të ulëta se ato që qenë arritur në Kinë në vitin 1078. Dhe vetëm në kapërcyell të shekullit të nëntëmbëdhjetë do të mundeshin britanikët të mateshin me çmimet e ulëta të produktit kinez të shekullit të njëmbëdhjetë. Siç e ka vënë në dukje Joseph Needham:

Është një paradoks i jashtëzakonshëm historik që ... qytetërimi perëndimor, i cili e ka influencuar aq shumë qytetërimin botëror sot, varet aq shumë nga punimi i hekurit dhe çelikut [dhe] kinezët kanë qenë 1300 vjet para Perëndimit për sa i përket derdhjes së hekurit.<sup>552</sup>

Po ashtu edhe India ishte përpara Britanisë. Çeliku Wootz i Indisë ishte më i miri në botë për shumë shekuj deri në shekullin e nëntëmbëdhjetë dhe çmohej veçanërisht në Persi ku njihej si çelik Damasku. Deri rreth fundit të shekullit të tetëmbëdhjetë prodhimi britanik ishte inferior ndaj çelikut të Damaskut.<sup>553</sup> Po ashtu, deri në vitin 1842, hekuri dhe çeliku indian ishin jo vetëm po aq të mirë, në mos më të mirë se produktet britanike, por edhe shumë më të lirë sesa ato që prodhoheshin në Sheffield.<sup>554</sup> Interesant është fakti se në këtë kohë në Indi kishte rreth pesëdhjetë herë më shumë furnalta sesa në Britani (dhe ende dhjetë herë më shumë në vitin kulmor 1873 në Britani). Ç'është më e rëndësishme, prodhuesit perëndimorë mbeteshin ende të hutuar nga cilësia e prodhimit indian dhe pers.

<sup>552</sup> Needham, te Mansel Davies, *A Selection from the Writings of Joseph Needham* (Lewes, Sussex: The Book Guild, 1990), fq. 144.

<sup>553</sup> Ahmad Y. al-Hassan dhe Donald R. Hill, *Islamic Technology* (Cambridge: Cambridge University Press, 1986), fq. 256-257.

<sup>554</sup> Dharampal, *Indian Science and Technology in the Eighteenth Century* (Delhi: Impex, 1971), fq. 220-263.

Prandaj nuk është për t'u habitur që kur britanikët me vonesë u interesuan për prodhimin e çelikut, i hodhën sytë nga teknikat kineze dhe indiane të prodhimit. Orvatja e tyre e parë për kopjimin e këtij procesi u ndërmor nga Benjamin Huntsman në vitin 1740 dhe të tjera përpjekje u bënë gjatë tetëdhjetë viteve në vazhdim. Siç e vë në dukje Arnold Pacey lidhur me sistemin britanik:

[Megjithëse] 'çeliku i poçit' i prodhuar në këtë mënyrë ishte i cilësisë së lartë që nevojitej për të bërë mjete për tornot ... [prapëseprapë] kurrë nuk u arrit struktura që shihej në disa shpata aziatike dhe kjo, bashkë me cilësinë e lartë të këtyre të fundit, vazhdonte t'i hutonte prodhuesit perëndimorë të çelikut. Edhe në vitet 1790, çeliku indian Wootz vazhdonte të studiohej në Sheffield, ku përdorej për të bërë mostra të një cilësie që nuk mund të arrihej me mënyra të tjera.<sup>555</sup>

Për më tepër, rreth fundit të shekullit të tetëmbëdhjetë, një sërë shkencëtarësh europianë hulumtuan origjinën e çelikut indian Wootz, ndër të cilët më i njohuri është Michael Faraday.<sup>556</sup> Siç përfundon Braudel: 'Gjatë dekadave të para të shekullit të nëntëmbëdhjetë, shumë shkencëtarë perëndimorë ... bënë përpjekje për të zbuluar sekretet e damaskut [ose të çelikut Wootz]: rezultatet e kërkimit të tyre shënuan lindjen e metalografisë [britanike]'.<sup>557</sup> E rëndësishme gjithashtu është të vihet në dukje se prodhuesit britanikë kryen eksperimente në uzinën e çelikut të Corby-t për të riprodhuar teknikat e lashta kineze të çelikbërjes. Këto eks-

<sup>555</sup> Arnold Pacey, *Technology in World Civilization* (Cambridge, Mass.: MIT Press, 1991), fq. 81.

<sup>556</sup> Arun Kumar Biswas, "Mineral and Metals in Medieval India", te A. Rahman (red.), *History of Indian Science, Technology and Culture, AD1000-1800* (New Delhi: Oxford University Press, 1999), fq. 312, nn. 78-83.

<sup>557</sup> Braudel, *Civilization*, I, fq. 377.

perimete patën sukses, duke arritur të prodhonin një çelik të uniformizuar.

### *Përpunimi i pambukut*

Industria e pambukut qe shtylla tjetër, në mos madhorrja, e revolucionit industrial britanik. Në vitin 1830, produktet e pambukut u bënë produktet kryesore të eksportit. Kësisoj industria e pambukut qe stimuluesja e industrializimit të Britanisë. Sërish historianët përqendrohen në një sërë shpikjesh të pavarura të realizuara nga shpikës të ndryshëm britanikë, ku përfshihen: sovajka fluturuese e John Kay-it (1733), makina tjerrëse e John Wyatt-it dhe Lewis Paul-it (1738), tjerrësja e shumëfishtë e James Hargreaves-it (rreth 1765), tjerrësja me ujë e Richard Arkwright-it (1767), tjerrësi hibrid i Samuel Crompton-it (1779), tezgjahu mekanik i Edmund Cartwright-it (1787) dhe, sërish, motori me avull i James Watt-it (1776). Dhe sërish këto shpikje mendohet se ndoqën rrugën e brendshme të një 'sekuence sfidash dhe përgjigjesh', ku zbatimi i vazhdueshëm i gjenialitetit britanik i shpiku dhe në vazhdim i rafinoi këto teknologji. Rezultati qe një rritje dhjetëfish në tjerrje, e përballueshme vetëm me pambukun e importuar nga Amerika (shih kap. 11).

Zakonisht mendohet se mjedisi 'i ndyrë' i Lancashire-it në Anglinë Veriore qe vendi ku feksën rrezet e para verbuese të modernitetit. Por në të vërtetë mrekullia e pambukut nuk nisi në Lancashire. Sepse industria e pambukut kurrësi nuk ishte diçka unike e Britanisë së shekullit të tetëmbëdhjetë, por kishte pararendëse të fuqishme në Indi dhe në Kinë. Kina jo vetëm printe për sa u përket makinave tekstile, por kishte shpikur edhe 'makinën e madhe tjerrëse' që ishte superiore ndaj makinës së Arkwright-it. Për më tepër, në tekstile kinezët zotëronin makina që ndryshonin vetëm në një detaj kritik si nga tjerrësja e shumëfishtë e Hargrea-

ve-it, edhe nga sovajka fluturuese e Kay-it.<sup>558</sup> Siç e vë në dukje Dieter Kuhn:

Teknicienët kinezë të tekstitit i kishin shpikur të gjitha pjesët esenciale të një instrumenti tjerres [të ngjashëm me shpikjet britanike] për përdorim industrial që në shekullin e trembëdhjetë ... Për sa i përket strukturës mekanike, as tjerresja e shumëfishtë, e cila kurrë nuk ishte e lehtë për t'u vënë në punë, nuk matej me cilësinë e makinës së madhe tjerrese për përpunimin e hithrës kineze.<sup>559</sup>

I vetmi ndryshim ishte se makina kineze përdorej për të prodhuar jo pambuk, por mëndafsh. Sidoqoftë që përhapja e teknologjive kineze të mëndafshit ajo çka përfundimisht krijoi bazën për teknologjitë britanike të tekstitit të pambukut.

Përhapja e parë e shpikjeve tekstile kineze në Europë ndodhi në shekullin e trembëdhjetë (ku ato bënë të mundur rritjen e industrisë italiane të mëndafshit – siç vihet në dukje në kap. 6). Italianët ua përcollën këto ide britanikëve. Një nga momentet kyçe këtu ka të bëjë me fabrikat e John Lombe-it për prodhimin e mëndafshit. Këto qenë të rëndësishme pasi ofruan atë model për prodhimin e pambukut që do të zhvillohej në Derby. Këtu shohim se makina e Lombe-it që në fakt kulminacioni i një sërë përhapjesh globale ku Kina i fliste tërthorazi Europës dhe, sigurisht, Britanisë. John Lombe-i i mori idetë e tij nga Italia, ku makinat e mëndafshit në fjalë ishin tashmë në përdorim.<sup>560</sup> Por përshkrimi i tyre si shpikje italiane e mjegullon sakaq prejardhjen e tyre kineze. Siç shpjeguar në kapitullin 6, aspekti kyç i

<sup>558</sup> Joel Mokyr, *The Lever of Riches* (New York: Oxford University Press, 1990), fq. 221.

<sup>559</sup> Dieter Kuhn, *Science and Civilisation in China*, V (9) (Cambridge: Cambridge University Press, 1988), fq. 224.

<sup>560</sup> A. P. Wadsworth dhe J. Mann, *The Cotton Trade and Industrial Lancashire 1600-1780* (Manchester: Manchester University Press, 1931), fq. 106.

këtyre makinave ishte përdorimi i filaturave (ose i bobinave). Këto qenë përfutur nga Kina ku të tilla makina qenë përdorur që më 1090.<sup>561</sup> Edhe makina e Lombe-it bazohej në përdorimin e filaturave dhe u ngjante shumë makinave kineze. Për më tepër, siç e pamë në kapitullin 6, thuajse të gjitha aspektet e makinave italiane u ngjanin modeleve më të hershme kineze që në kohën kur Lombe-i vizitoi Italinë.<sup>562</sup> Por pika kryesore këtu është se që fabrika e mëndafshit e Derby-t (e bazuar në modele italiane, nga ana e tyre të bazuara në modelet origjinale kineze) ajo që ofroi modelin për prodhuesit e rinj të pambukut.

***Shenja të superioritetit industrial britanik,  
apo thjesht arrogancë britanike?***

Na thuhet shpesh se një nga shenjat klasike të superioritetit dhe gjenialitetit industrial britanik është edhe ura e parë prej hekuri e ndërtuar në Coalbrookdale të Britanisë që në vitin 1779. Siç thuhet tipikisht në një tekst, në Coalbrookdale

e treguan gjenialitetin e tyre John Wilkinson-i dhe rivalët e tij. Darby i parë e kishte përdorur hekurin e tij për të derdhur qypa dhe tepsi, por Wilkinson-i dhe mjeshtrat e Shropshire-it tashmë ishin shumë më ambiciozë. Në bashkëpunim me Abraham Darby-n e tretë, Wilkinson-i ndërtoi urën e parë prej hekuri afër Coalbrookdale-it. Kjo urë ekziston edhe sot dhe ideja ishte aq novatore sa qyteti pranë saj sot quhet Ironbridge.<sup>563</sup>

Por kjo e mbulon tërësisht faktin se kishte mijra ura të varura prej hekuri në Kinë që para njëmijë vjetësh. Urën e

<sup>561</sup> Pacey, *Technology*, fq. 103-107; Temple, *Genius*, fq. 120-121.

<sup>562</sup> Kuhn, *Science*, V (9), fq. 428-433.

<sup>563</sup> Denis Richards dhe Anthony Quick, *Britain 1714-1851* (London: Longmans, 1961), fq. 132-133.

*parë* të varur prej hekuri e gjejmë në Kinë (Çingtung në Junnan) që në vitin 65 e.s., kurse urat e varura me zinxhir hekuri u shfaqën më vonë mbi lumin Çin-sha mes viteve 580 dhe 618 e.s.<sup>564</sup> Jo vetëm që këto shembuj kinezë 'dihet se i kanë frymëzuar inxhinierët perëndimorë',<sup>565</sup> por rrëfimet e jezuitëve për urat e varura kineze janë diskutuar nga arkitektë të ndryshëm britanikë si Sir William Chambers, dhe madje i kanë tërhequr vëmendjen edhe Thomas Telford-it.<sup>566</sup> Gjithashtu na thuhet se një tjetër tregues i gjenialitetit industrial britanik është shfaqja 'për herë të parë' e sistemit të llambave me gaz të rrugës në vitin 1798. Sërisht kjo e mbulon faktin se kinezët kishin rreth dymijë vjet që e përdornin gazin natyror për ndriçim para 'shpikjes' britanike.<sup>567</sup>

Turjela britanike gjithashtu mbahet si triumf, duke qenë se mund të arrinte deri në rreth 200 këmbë thellësi. Por këto thellësi nuk ishin asgjë krahasuar me atë që mund të bënin turjelat në minierat e thella të Kinës ku mund të arrinin në 3000 deri në 4800 këmbë thellësi. Kinezët kishin që në shekullin e parë para erës sonë që i përdornin turjelat e gjata. Vetëm në shekullin e nëntëmbëdhjetë Perëndimi e arriti Kinën. Domethënës është fakti që metodat kineze të shpimit u përdorën në Europë për shpim me shëllirë (1834) si dhe për shpim me vaj (1841). Drake-u ndërtoi një pus naftë në Pensilvani në vitin 1859 duke përdorur metodat kineze me kabëll. Siç përfundon Temple:

Metoda e 'shkelmimit poshtë', siç quhej, për shpim me vaj në Amerikë deri në shfaqjen e avullit si forcë, ishte saktësisht e njëjtë me teknikën kineze të shpimit me fill harku ... Madje edhe turjelat moderne rrotulluese duket

<sup>564</sup> Davies, *Selection*, fq. 151.

<sup>565</sup> Jones, *Growth Recurring*, fq. 36.

<sup>566</sup> Pacey, *Maze*, fq. 190.

<sup>567</sup> Braudel, *Civilization*, I, fq. 368, 370.

se kanë prejardhje pjesërisht kineze. Shkurt, shpimi i thellë perëndimor ishte, në thelb, një huazim nga Kina dhe industria moderne e naftës është e ngritur mbi teknikat orientale njëmijë e nëntëqind vjet para Perëndimit.<sup>568</sup>

Një tjetër tregues akoma i superioritetit industrial britanik, na thuhet, është shpikja e anijeve me seksione dhe ndarje që nuk fusin ujë. Këto i atribuohen gjenialitetit të Sir Samuel Bentham-it i cili e zhvilloi këtë shpikje të madhe për Flotën Mbretërore rreth vitit 1795. Por siç ka treguar e shoqja më vonë (përkundër konvencionit europian), merita për shpikjen në fjalë duhet t'u njihet kinezëve.<sup>569</sup> Fakti është që seksioni/ndarja që nuk fut ujë është përdorur në anijet kineze që në shekullin e dytë të erës sonë. Për më tepër, është veçanërisht befasues fakti se flota britanike nuk e përvetësoi drejtpërsëdrejti këtë shpikje kineze deri në fundin e shekullit të tetëmbëdhjetë. Është befasues si fakt sepse Marko Polo i kishte treguar Perëndimit për këtë risi jetëshpëtuese që në vitin 1295. Dhe është për të ardhur keq kur mendon se sikur britanikët ta kishin zbatuar këtë risi tek *Titaniku*, që konsiderohej si arritja kulmore e anijendërtimit perëndimor apo britanik, jo më pak se 1502 jetë do të kishin shpëtuar në udhëtimin e parë të kësaj anijeje (edhe pse rekordi i shpejtësisë për Atlantikun nuk do të që thyer).

Treguesi më i madh i arrogancës britanike ndoshta gjendet në organizimin e Ekspozitës së Madhe më 1851, e cila i shpalli botës epërsinë industriale të Britanisë. Kjo ekspozitë u mbajt në Pallatin e Kristaltë të Paxton-it, që gjoja që ndërtuar me xham të mbështetur në struktura hekuri e çeliku. Por ajo që nuk na tregohet zakonisht, është se 'harqet më të mëdha të Paxton-it, harqet anësore 72 këmbëshe,

<sup>568</sup> Temple, *Genius*, fq. 54.

<sup>569</sup> Joseph Needham, Wang Ling dhe Lu Gwei-Djen, *Science and Civilisation in China*, IV (3) (Cambridge: Cambridge University Press, 1971), fq. 420-422.

ishin bërë prej bredhi Memeli të laminuar. Në atë serë gjoja prej hekuri dhe qelqi, kishte 205 milje trarë dhe 34 milje ullukë të drunjtë.<sup>570</sup> Kjo reflektonte faktin që sot mbetet i mbuluar, se druri e jo çeliku mbetej baza e shumëçkaje gjatë industrializimit të Britanisë. Pavarësisht përfytyrimit që kemi për anije hekuri e çeliku, fakti është se në prag të Ekspozitës së Madhe, 90% e anijeve britanike ishin prej druri. Për më tepër, vetëm pas vitit 1852 çeliku u bë aq i lirë sa britanikët të mund ta prodhonin në sasi të mëdha.

Dhe kjo gjë u bë e mundur me krijimin e konvertuesit të Bessemer-it i ndikuar, siç e kemi parë më lart, nga mjeshtëria kineze.

Së fundmi, por jo më pak e rëndësishmja, një nga treguesit klasikë të revolucionit industrial britanik është revolucioni në transport, një aspekt madhor i të cilit që krijimi pionierik i kanaleve dhe sidomos i shkallës ujore. Gjithmonë na thuhet se ishte britaniku James Brindley 'ai që do të bëhej një nga inxhinierët më të mëdhenj të kanaleve, gjenialiteti mekanik [i të cilit] ... u zbatua për problemin e ndërtimit të një kanali. Rezultati që një triumf i vërtetë.'<sup>571</sup> Por siç e pamë në kapitullin 3, ndërtimi i kanaleve me shkallë ujore ka qenë një tipar madhor i mrekullisë ekonomike të dinastisë Sung, i shpikur në vitin 984, diç më pak se tetëqind vite më parë.<sup>572</sup> Veç kësaj, 6000 kilometrat kanale të hapura në Britani mes viteve 1750 dhe 1858 thuajse e humbin krejt domethënien krahasuar me 5000 kilometrat e kanaleve të hapura gjatë dinastisë Sung rreth shtatë shekuj më parë, të cilat bartnin shumë më tepër anije kineze vigane në krahasim me lundrat e vogla e të çuditshme, të shtyra shumë ngadalë nga kuajt përgjatë kanaleve të ngushta të Britanisë. Në she-

<sup>570</sup> F. T. Evans, përmbledhur te Jones, *Growth Recurring*, fq. 18-19.

<sup>571</sup> Richards dhe Quick, *Britain*, pp. 149-150.

<sup>572</sup> Needham, *e të tjerë*, *Science*, IV (3), fq. 300-306, 359; Pacey, *Technology*, fq. 6.

kullin e njëmbëdhjetë, anijet private kineze që përshkonin Kanalin e Madh mund të mbanin deri në 110 tonë (masë që e kalon peshën maksimale të bartshme të anijes flamurtare të Kolombit, *Nina-s*). Kurse në fund të shekullit të nëntëmbëdhjetë, anijet kineze të kanalit mund të bartnin rreth 140 tonë (rreth tri herë më shumë se lundrat britanike).

### Përfundim

Asgjë nga këto nuk do të thotë se industrializimi britanik u ngrit vetëm mbi themele kineze, por do të thotë se u ngrit në masë domethënëse mbi procesin e ndryshimit 'të gjeneruar nga të tjerë' që shkonte mbrapsht deri në shpikjet e shumta kineze të bëra 700 deri në 2300 vjet më parë. Do të ngjante e drejtë të thoshim se industrinë britanike të hekurçelikut dhe pambukut ishin domethënëse jo vetëm si të vona, por edhe për cilësinë e tyre si të përfutuara. Suksesi i britanikëve këtu nuk qëndron në origjinalitetin e tyre, por në këmbënguljen e tyre problemzgjdhëse për t'i përpunuar dhe rafinuar shpikjet e të tjerëve. Në këtë drejtim Britania përputhet ngushtë me perceptimin standard të një vendi me industrializim të vonë, i tillë që ka gëzuar të gjitha 'avantazhet e prapambetjes' dhe ka qenë i aftë për të përvehtësuar zbulimet teknologjike të të tjerëve. Që britanikët shumë vonë i çuan përpara ato duket një supozim i arsyeshëm. Por denigrimi i rolit të Kinës në gjithë këtë është krejtësisht i paarsyeshëm, sepse pa shpikjet e mëparshme kineze do të kishte patur pak për të çuar përpara. Për më tepër, pa këto kontribute kineze Britania sipas të gjitha gjasave do të kishte mbetur një vend i vogël e i prapambetur në periferi të një kontinenti po aq të prapambetur, edhe ai në periferi të ekonomisë globale afro-aziatike që prej shekullit të pestë para erës sonë.

Për ta thënë shkurt, perspektiva ime 'globalo-historike akumulative' e industrializimit sugjeron se theksimi konvencional i revolucionit industrial britanik si vendi ku, siç shprehet Rostow, 'filloi gjithçka', tashmë mund të shihet si produkt i një këndvështrimi mendjengushtë eurocentrik. Ndaj zor se mund të bëjmë diçka më të mirë se ta mbyllim me fjalët e Eric Jones-it:

Dikur dukej se kishim një ngjarje të saktë për të cilën mund të mësonim. Krijta filloi me ... një revolucion industrial në Britaninë e fundit të shekullit të tetëmbëdhjetë. Tashmë e dimë me siguri se ngjarja në fjalë ishte në fakt një proces, më i vogël, shumë më pak britanik [dhe shumë më tepër lindor], pafundësisht më pak i beftë, pjesë e një vazhdimësie [botërore-historike] dhe që iu desh shumë më tepër kohë për të përparuar.<sup>573</sup>

<sup>573</sup> Jones, *Growth Recurring*, fq. 26, 27.

## 10. NDËRTIMI I IDENTITETIT RACIST EUROPIAN DHE KONCEPTIMI I BOTËS, 1700-1850: MISIONI CIVILIZUES IMPERIAL SI NJË NDËRMARRJE MORALE

Turqia, Kina dhe të tjerët një ditë mund të bëhen vende të zhvilluara. Por këta njerëz kurrë nuk do të fillojnë të përparojnë ... derisa të gëzojnë të drejtat njerëzore dhe këto nuk do t'i arrijnë kurrë pa u pushtuar nga Europa.

*Winwood Reade*

Është thënë se vetëm misioni ynë civilizues mund ta përligjë pushtimin nga ana jonë të trojeve të popujve të paqytetëruar. Të gjitha shkrimet, leksionet dhe transmetimet tona përsërisin deri në neveri dëshirën tonë për të civilizuar popujt afrikanë [dhe lindorë]. Pa dyshim që ka njerëz të lumtur ta konsiderojnë si progres të civilizimit përmirësimin e kushteve materiale, rritjen e aftësive profesionale, përmirësimet për sa i përket strehimit, higjienës dhe edukimit skollistik. Këto, pa dyshim, janë 'vlera' të dobishme, madje të domosdoshme. Por a e përbëjnë ato 'civilizimin'? A nuk është civilizimi, mbi gjithçka tjetër, zhvillim i *personalitetit njerëzor*?

*At Placide*

Ky kapitull u shërben tri qëllimeve kryesore. Së pari, çon përpara pretendimin tim se formimi identitar luajti një rol të rëndësishëm në shkëlqimin e Perëndimit, çka e bën duke treguar se formimi identitar qe një faktor i rëndësishëm që shpuri në imperializëm, i cili nga ana e tij bëri të mundur fazën më të vonshme të shkëlqimit të Perëndimit (shih kap. 11). Së dyti, në bazë të retorikës imperiale qëndronte shpikja e një identiteti racist. Kjo më mundëson ta kundërshtoj supozimin e përgjithshëm eurocentrik se nën

shkëlqimin e Perëndimit qëndronin tiparet progresive liberale. Së treti, përforcon pretendimin tim të përgjithshëm se konteksti global ishte jetik për shkëlqimin e Perëndimit. Siç e vë në dukje Gerard Delanty:

ideja [ose identiteti] e Europës shprehjen e saj më të qëndrueshme e gjeti në ballafaqimin me Orientin në epokën e imperializmit. Identiteti evropian mori formë gjatë ballafaqimit me qytetërimi të tjera. Europa nuk e përftoi identitetin e saj nga vetvetja, por nga krijimi i një sërë kontrastesh globale. Në retorikën që mbante të gjallë këtë dikotomi të Vetes dhe Tjetrit, Europa dhe Orienti [u bënë] pole të kundërta në një sistem vlerash qytetërimore të përkufizuara nga Europa.<sup>574</sup>

Pretendimi se imperializmi u ngrit mbi një retorikë raciste ngjan i papranueshëm vetëm nëse e shkrijmë racizmin me formën e tij 'shkencore', e cila u shfaq në Europë pas viteve 1840, domethënë shumë vonë për imperializmin. Por duke ndjekur George Frederickson-it (si dhe James Blautin), unë bëj dallim midis racizmit të nënkuptuar dhe atij të shkoqur.<sup>575</sup> Së pari, racizmi i nënkuptuar u konceptua në shekullin e tetëmbëdhjetë dhe në gjysmën e parë të shekullit të nëntëmbëdhjetë. Teksa konceptimi i racizmit të shkoqur filloi në fillim të shekullit të tetëmbëdhjetë, fenomeni u shfaq me forcë (sidomos në Britani) pas viteve 1840. Së dyti, racizmi i nënkuptuar e vendos 'dallimin' përmes kriterëve kulturore, institucionale dhe mjedisore në vend të tipareve gjenetike. Por edhe kështu, ai bart një marrëdhënie raciste pushteti që përfshin epërsinë perëndimore dhe inferioritetin lindor. Prandaj racizmi i nënkuptuar është shumë më i

<sup>574</sup> Gerard Delanty, *Inventing Europe* (London: Macmillan, 1995), fq. 84.

<sup>575</sup> George M. Frederickson, *Racism: a Short History* (Melbourne: Scribe Publications, 2002); James M. Blaut, *The Colonizer's Model of the World* (London: Guilford Press, 1993), fq. 65.

fshehtë se racizmi i shkoqur, duke qenë se funksionon në një nivel shumë më subliminal dhe aspekti i tij racist shpesh është i mbuluar. Qe racizmi i nënkuptuar ai që u mundësoi shumë evropianëve të besonin sinqerisht se po e ndihmonin Lindjen përmes imperializmit, ndërkohë që në fakt po shkaktonin shtypje, mjerim e vuajtje të madhe me të gjitha mënyrat, kulturalisht, ekonomikisht, politikisht e ushtarakisht.

Këto ideologji kanë marrëdhënie ose implikacione të ndryshme për imperializmin. Racizmi i nënkuptuar supozon se inferioriteti qytetërimor mund dhe duhet shëruar nëpërmjet 'misionit civilizues' imperial. Kurse racizmi i shkoqur (ose shkencor), duke qenë se përqendrohet në tiparet fiziologjike/gjenetike, priret ta shohë inferioritetin racial si të përhershëm. Prandaj racizmi i shkoqur ka një marrëdhënie inkohërente me imperializmin. Shumë racistë shkencorë ishin 'pesimistë' dhe e kundërshtonin imperializmin ose si një mision të pafrytshëm (nga që racat lindore e kishin të pamundur të civilizoheshin), ose sepse kjo do të shpinte drejt degjenerimit të racës superiore nëpërmjet ndërkryqëzimit, siç arsyetojnë De Gobineau dhe Robert Knox. Për më tepër, disa syresh paralajmëronin kundër imperializmit mbi bazën se vetë klima do të shkaktonte degjenerimin e racave superiore. Ndryshe nga këta, disa darvinistë socialë dhe racistë shkencorë ishin më pak 'pesimistë'. Ata besonin se raca anglo-saksone ka detyrën për të trashëguar botën duke qenë se racat inferiore janë të destinuara të zhduken dhe progesi i civilizimit është i sigurt vetëm në duart e britanikëve (siç thotë Charles Kingsley).

Ndërsa ky konceptim i racizmit fillimisht mund të tingëllojë kompleks, në fakt thjeshtohet në mënyra të ndryshme. Do të ishte problematike të mendonim se racizmi i shkoqur është një binjak identik i racizmit të nënkuptuar.

Sepse teksa midis tyre ka elemente të qarta vazhdimësie, po ashtu ka edhe mosvazhdimësi kritike, çka nënkupton se çdo fazë shënohet nga tipare të ngjashme dhe të ndryshme. Ndonjëherë duket sikur gjenealogjitë historike të racizmit të nënkuptuar dhe të shkoqur janë të ndara. Prandaj lexuesi duhet të mbajë parasysh se paraqitja që unë bëj është domosdoshmërisht një version i thjeshtuar i asaj që në fakt është një histori komplekse. Sidoqoftë dy pika janë të rëndësishme këtu. Së pari, megjithëse racizmi i shkoqur ishte një faktor i rëndësishëm, unë do ta vë shumë më tepër theksin mbi racizmin e nënkuptuar, nisur nga rëndësia e tij kritike për gatimin e imperializmit. Së dyti, më intereson më pak të ofroj një gjenealogji që do të ecte përmes kthesave e dredhave të shumta e të holla në konceptimin e racizmit të nënkuptuar dhe të shkoqur. Ajo ku unë përqendrohem specifikisht është marrëdhënia midis racizmit dhe formimit të identitetit european në krjimin e retorikës së imperializmit.

Këtu vlen të vihet në dukje një pikë e fundit. Siç arsyetoj më poshtë, paradoksalisht racizmi i nënkuptuar përfundimisht u shfaq pikërisht në epokën e progresit/iluminizmit. Por, siç e vë në dukje edhe Thierry Hentsch, ta shohësh iluminizmin si një periudhë ku mendimtarët u nisën haptazi për të krijuar një botëkuptim racist të nënkuptuar, është një këndvështrim tejet i thjeshtuar.<sup>576</sup> Mbi të gjitha ky ishte një proces i nënvetëdijshëm. Për më tepër iluminizmi ishte 'skizofren'. Sepse paradoksi i tij më i madh ishte se teksa huazonte dhe përvetësonte idetë lindore (kryesisht kineze) – siç e pamë në kapitullin 9 – këto u farkëtuan në një korpus dijeje që e imagjinonte Lindjen si të pacivilizuar duke arritur së këtejmi në misionin civilizues imperial dhe në shtypjen e Lindjes.

<sup>576</sup> Thierry Hentsch, *Imagining the Middle East* (Montreal, Quebec: Black Rose Books, 1992), fq. 112- 113.

### **Rindërtimi i identitetit europian: racizmi, ligjërimi i perandorisë dhe konceptimi i botës**

Racizmi i nënkuptuar u shfaq tamam gjatë iluminizmit. Mbi të gjitha, iluminizmi qe një moment përkufizues në rishpikjen e identitetit europian. Praktikisht bazohej në pyetjen 'kush jemi?' dhe 'cili është vendi ynë në botë?'. Përgjigja që iu dha kësaj pyetjeje shpuri në sistematizimin, klasifikimin dhe, në fakt, konceptimin e botës, çka solli si rezultat besimin se Perëndimi është – dhe gjithmonë ka qenë – bartësi i vetëm i qytetërimit dhe i progresit njerëzor në fuqitë ekonomike, intelektuale e politike. Siç e shpreh Samir Amin, ky proces ripërfytyrimi 'shpiku një Perëndim eternal [progresiv], unik që në çastin e origjinës [së përfytyruar] të tij'.<sup>577</sup> Kjo retorikë krijoi (në masë të madhe në mënyrë të pavetëdijshme) një lloj regjimi aparteidi intelektual ku Perëndimi ishte fundamentalisht i veçuar prej Lindjes nga një kufi imagjinar që e kishte prejardhjen që tek Greqia e lashtë. Ideja se Lindja kishte qenë prej kohësh në kontakt me Perëndimin dhe kishte qenë pioniere e progresit ekonomik, hasej shpesh para shekullit të tetëmbëdhjetë, por në shekullin e nëntëmbëdhjetë kjo ide thua jse qe zhdukur. Në këtë mënyrë europianët mundën ta injoronin ose ta marginalizonin kontributin pozitiv të Lindjes në ngritjen e Perëndimit. Kësisoj, teoritë e reja për botën çuan në pohimin se ngritja e Perëndimit është një lindje e virgjër, e arritur vetëm me përpjekjet e europianëve. Në këtë mënyrë, europianët e paraqitën veten si subjekti progresiv i historisë së botës, në të shkuarën dhe në të tashmen, kurse popujt lindorë u zhvlerësuan si objekti i tyre pasiv. Siç e shpreh Linda Tuhiwai Smith:

<sup>577</sup> Samir Amin, *Eurocentrism* (London: Zed Books, 1989), fq. 89.

Një nga karakteristikat që mendohej se i kanë popujt primitivë ishte se nuk mund ta përdorim mendjen apo intelektin tonë. Nuk mund të shpiknim gjëra, nuk mund të krijojmë institucione apo histori, nuk mund të imagjinonim, nuk mund të prodhojmë asgjë me vlerë, nuk dinim ta shfrytëzojmë tokën dhe burimet e tjera natyrore, nuk i praktikojmë 'artet' e civilizimit. Duke mos i patur këto virtyte, skualifikoheshim ... jo vetëm nga civilizimi, por edhe nga vetë njerëzimi. Thënë ndryshe, nuk ishim 'plotësisht njerëz'; disa prej nesh madje nuk konsideroheshin as pjesërisht njerëz.<sup>578</sup>

Pikërisht kjo ide çoi në përfytyrimin e aziatikëve si 'njerëz pa histori'. Me vështrimin e popujve lindorë si të paaftë për të arritur progresin, bëhej aksiomatike ideja se vetëm Perëndimi mund t'i jepte dhuntinë e civilizimit Lindjes përmes imperializmit.

Në të menduarit imperializmin, e nis me pretendimin e bërë nga John Mackenzie (ku ndjek Edward Said-in) i cili e sheh atë si diçka 'më shumë se një tërësi fenomenesh ekonomike, politike e ushtarake. Veç kësaj, është një ideologji komplekse me shprehje të përhapura kulturore, intelektuale e teknike.'<sup>579</sup> Ndërsa grupet ekonomike, politike e ushtarake të interesit pa dyshim kanë përfituar nga imperializmi, do të ishte gabim të mendohej se retorika në fjalë është krijuar vetëm për ta ose me urdhër të tyre. Po ashtu do të ishte po aq e gabuar ta reduktosh imperializmin në cilindo grup të veçantë interesi (siç mendojnë shpesh teoricienët materialistë). Për më tepër, ndërkohë që kapitalistët e shfrytëzuan mjaft mirë imperializmin, është për t'u vënë re se vetë kon-

<sup>578</sup> Linda Tuhiwai Smith, *Decolonizing Methodologies* (London: Zed Books, 1999), fq. 25.

<sup>579</sup> John R. Mackenzie, cituar te Smith, *Decolonizing Methodologies*, fq. 22.

tribuan pak në ndërtimin e retorikës. Arkitektët e tij kryesorë në fakt qenë akademikët, intelektualët, mësuesit, shkencëtarët, udhëtarët, romancierët, gazetarët, misionarët e krishterë, politikanët dhe burokratët.

Nëse imperializmi kishte një thelb, ky kishte të bënte me glorifikimin e europianëve si 'Zotërinjtë e Njerëzimit' dhe me përforcimin e egos europiane si superiore.<sup>580</sup> Kësisoj do të përbënte mjetin me anë të të cilit: kapitalistët do të përhapnin mesazhin e krishterë të shpëtimit; shkencëtarët do të çonin më tej zhvillimin e dijes shkencore për të gjithë; mësuesit do të përhapnin dijen europiane; burokratët do të universalizonin burokracinë racionale; politikanët do të sillnin demokraci. Por siç do ta shohim më tej (dhe në kap. 11), 'premtimin' do ta përgënjeshtrohte imperializmi 'i zbatuar', duke qenë se shtypja dhe shfrytëzimi ekonomik u bënë refreni i misionit britanik. Këtu vlen të vihet në dukje një çështje e fundit. Fokusi im kryesor këtu është mbi krijimin e retorikës imperiale britanike. Sepse kjo e fundit, ndërsa kishte të përbashkëta tipare të përgjithshme me retorika të tjera imperiale europiane, edhe ndryshonte në një sërë aspektesh, disa prej të cilave i nxjerr në pah në vijim.

Britanikët ia arritën ta rikrijonin botën duke konceptuar një tabelë imagjinare të 'ligës qytetërimore'. Siç tregohet në tabelën 10.1, britanikët e vendosën veten në Ligën e Parë. Europianët kontinentalë u vendosën në Divizionin Një (ose 'Bota e Parë'); 'të verdhët' në Divizionin Dy (ose 'Bota e Dytë'), kurse 'të zinjët' në Divizionin Tre (ose 'Bota e Tretë') gati për të rënë në Divizionin Katër ('Planeti i Majmunëve'). Kriteret klasifikuese u përfatuan nga nocione të ndryshme, si:

<sup>580</sup> Shih Victor G. Kiernan, *The Lords of Mankind* (New York: Columbia University Press, 1986 [1969]).

Teoria e despotizmit oriental;  
 teoria e Piter Panit për Lindjen;  
 klasifikimi sipas klimës dhe temperamentit;  
 Evangjelizmi Protestant;  
 darvinizmi social dhe racizmi shkencor.

### *Teoria e despotizmit oriental*

Një nga teoritë kryesore të dikotomisë Lindje/Perëndim është ajo e despotizmit oriental. Kjo teori karakterizonte shkrimet e udhëtarëve europianë në Azi si dhe studiues akademikë, nga të tillë si Bodin-i, Machiavelli e veçanërisht Montesquieu, deri tek Mill-i, Marksi e Weber-i, ndër të tjerë.

Ajo pohonte se Europa është vendlindja e demokracisë dhe prandaj është edhe bartësja e zhvillimit ekonomik e politik, kurse Azia u përjashtua si djep i despotizmit dhe rrjedhimisht si viktimë e amullisë ekonomike.

E kam shqyrtuar në detaje këtë teori përgjatë tërë këtij libri, prandaj nuk është e nevojshme të përsëritet i gjithë argumenti. Ndërsa ideja u shfaq qartazi në shekujt e shtatëmbëdhjetë dhe tetëmbëdhjetë, në shekullin e nëntëmbëdhjetë e kishte përfshirë plotësisht shoqërinë. Revista *The Edinburgh Review* shprehte pikëpamjen e përhapur të kohës kur pohonte se:

Fryma e institucioneve orientale nuk ishte miqësore ndaj përhapjes energjike të mendimit. Në të gjitha epokat e botës Azia ka qenë e privuar nga drita e lirisë dhe si rrjedhojë ka pësuar fatin e një steriliteti absolut për sa u përket fryteve të larta të kulturës së punës e të mendjes.<sup>581</sup>

<sup>581</sup> *The Edinburgh Review*, cituar te C. Northcote Parkinson, *East and West* (London: John Murray, 1963), fq. 196.

Tabela 10.1 Retorika britanike e imperializmit: tabela e ligës qytetërmore dhe rikrijimi racist i botës

Klasifikimi qytetërmor	'Të civilizuarit' (Liga e Parë dhe Divizioni 1) Bota e Parë	'Barbarët' (Divizioni 2) Bota e Dytë	'Të egrit' (Divizioni 3) Bota e Tretë
Vendet përkatëse	Britania në Ligën e Parë Europa Perëndimore në Divizionin 1	p.sh. Perandoria Osmane, Kina, Siami dhe Japonia	p. sh. Afrika, Australia dhe Zelanda e Re
Ngjyra racore	Të bardhë	Të verdhë	Të zinj
Temperamenti	Të disiplinuar/punëtorë	Melankolikë/të ngurtë	Flegmatikë/ të lëshuar
Karakterit klimaterik	I ftohtë e i lagësht	I thatë e tropikal	Tejet i thatë
Karakterit njerëzor	Të krishterë	Paganë	Ateistë/paganë
Teoria e despotizmit oriental	Liberal-demokracia, liria, individualizmi, racionaliteti	Despotizmi, skllavëria, kolektivizmi, irracionaliteti	Despotizmi ose mungesa e qeverisjes, kolektivizmi, irracionaliteti
Teoria e Piter Panit	Paternalë/mashkullorë	Adoleshentë/femërorë, imitues, ekzotikë dhe irracionale	fëmërorë/femërorë, të varur nga të tjerët, indiferentë, irracionale
Parimet për ligjëse sociale	Britanikët si populli i zgjedhur ose raca zotëruese	Popujt e rënë	Njeriu natyral në gjendjen e natyrshme
Parimet për ligjëse politike	Sovranë (hapësirë e populluar me kufinj)	Josovranë/sundim perandorak jo i drejtpërdrejtë(hapësirë e populluar pa kufinj)	<i>Tera nullius</i> /sundim i drejtpërdrejtë kolonial (hapësirë boshe ose djerrë)
Cilësia qytetërmore rezultuese	Normale	Deviante	Deviante

Kësaj do t'i bënin jehonë fjalët e Lord Curzon-it (Gubernator i Indisë, 1898-1905), përshkrimi i të cilit për Kinën do të shtrihej për të gjithë shoqëritë aziatike:

Mosbesimi në ndërmarrjen private ka hedhur rrënjë në mendjen e mësuar të besojë se qeveria është gjithçka kurse individit asgjë ... Çdo ndërmarrje private vdes nga asfiksioni zyrtar ... Të gjitha klasës qeverisëse ... i intereson ruajtja e statukuosë ... [Të gjitha klasave] u pëlqen njësoj amullia.<sup>582</sup>

Ose, siç shprehet John Stuart Mill për Kinën dhe Egjiptin: popujt e tyre 'kanë arritur në një ngecje të përhershme për shkak të mungesës së lirisë mendore dhe individualitetit ... Ngaqë institucionet [despotike] nuk u shpërbënë për t'ua lënë vendin të tjerave, përmirësimi i mëtejshëm ndaloi.'<sup>583</sup>

Kjo teori do të ishte tejet e rëndësishme në procesin e formimit të identitetit evropian, pasi u dha mundësinë evropianëve për ta përfytyruar veten si liberalë dhe demokratë të padiskutueshëm, qoftë edhe vetëm pse ishin 'jo Lindja despotike'. Kjo do të ishte e domosdoshme pasi – siç do ta shohim në kap. 12 – para shekullit të njëzetë asnjë shtet në Europë nuk ishte demokratik apo liberal. Prandaj ky 'portret i tmerrshëm totalitar' i Orientit shërbeu për ta shmangur vëmendjen nga problemi i mangësisë demokratike të shteteve evropiane.<sup>584</sup> Për më tepër, mendimtarët eurocentrikë jo vetëm e fabrikuan Europën si demokratike, por edhe u përpoqën ta shpinin pas në kohë këtë nocion, në mënyrë që ta paraqisnin Europën si djepin dhe shtëpinë e demokracisë. Në kapitullin 5 vumë në dukje se procesi i formimit të identitetit është edhe i thjeshtë edhe kompleks

<sup>582</sup> Lord Curzon, cituar te Parkinson, *East*, fq. 221-222.

<sup>583</sup> John Stuart Mill, cituar te Ronald Hyam, *Britain's Imperial Century, 1815-1914* (London: Batsford, 1976), fq. 55.

<sup>584</sup> Hentsch, *Imagining*, fq. 107 e më tej.

njëkohësisht. Ajo që na intereson këtu është aspekti 'kompleks', sepse kompleksiteti në fjalë vjen nga akrobacitë e shumta intelektuale të nevojshme për të konceptuar një identitet të caktuar, në këtë rast një Europë të kulluar e të përparuar, kurdoherë demokratike e progresive, kundrejt Lindjes kurdoherë të prapambetur, despotike e regresive. Një rezultat jetik i të gjithë kësaj që nocioni se historinë europiane e ka mbizotëruar një vijueshmëri progresive, kurse Lindjen cikle regresive amullie.

Akrobacia e madhe intelektuale këtu ka të bëjë me ri-përftyrimin e Greqisë. Në një kohë relativisht të shkurtër (nga fundi i shekullit të tetëmbëdhjetë deri në fillim të shekullit të nëntëmbëdhjetë) mendimtarët europianë papritur e ngritën Greqinë e lashtë në djepin e qytetërimit europian, me institucionet e përftyruara demokratike dhe racionalitetin shkencor.<sup>585</sup> Vendosija e Greqisë brenda Europës që gjithashtu e një rëndësie të madhe për shkak të gjoja rolit të saj në shumë të rëndësishmen Rilindje (e cila supozohet se krijoi 'dinamikën europiane'). Por kjo ide e një Greqie të kulluar europiane nuk ishte aspak siç e shihnin vetë grekët. Ata e shihnin Greqinë si të ngulitur fort brenda asaj që njihej si 'Oksidenti helen'. Që Europa ka qenë një ide më shumë se një 'realitet' gjeografik, reflektohet në faktin se 'Europa' në mitologjinë greke ishte bija e Agenorit, mbretit të Tiros, e cila ndodhet në brigjet e Libanit.<sup>586</sup> Le të vihet re se edhe Troja ndodhej në pjesën lindore të Dardaneleve. Në të vërtetë 'Greqia ishte e lidhur shpirtërisht dhe kulturalisht me Lindjen dhe ... përpjekja për t'iu larguar, ose për ta mohuar këtë trashëgimi lindore, gjithnjë i ka sjellë Greqisë një varfërim dhe vrazhdësim të vlerave të saj shpirtërore e kul-

<sup>585</sup> Martin Bernal, *Black Athena*, I (London: Vintage, 1991).

<sup>586</sup> Denys Hay, *Europe: the Emergence of an Idea* (Edinburgh: Edinburgh University Press, 1957), fq. 1.

turore'.<sup>587</sup> Martin Bernal e ka quajtur këtë 'modeli i lashtë' (antieurocentrik), çka përbën një pohim se Greqia ka qenë e ndikuar fuqishëm nga Egjipti i lashtë.

Por të pranosh qoftë se Greqia e lashtë ishte pjesërisht lindore, ose se Rilindja mori formë apo qe e përshkruar nga ide lindore (kryesisht islame), apo se Greqia nuk ka qenë veçanërisht demokratike, do të ishte tejet kundërvënëse, sepse do të kishte minuar pretendimin e shfaqur se Europa gjithmonë ka qenë unikalisht progresive dhe gjeniale; do ta kishte këputur vijën lineare të progresit evropian që dijetarët eurocentrikë tashmë kishin shpikur ose atribuar. Kësisoj intelektualët dhe mendimtarët evropianë u rrekën ta spas-tronin aspektin oriental të Greqisë dhe të ekzagjeronin tiparet e saj evropiane si dhe institucionet e saj shkencore e demokratike. Kjo kishte rëndësi jetike duke qenë se demokracia greke kish qenë kaba, për të thënë më të paktën, meqë vetëm meshkujt grekë merrnin pjesë në procesin politik – kurse gratë ishin të përjashtuara – dhe skllavëria ishte një institucion fundamental në shoqërinë e lashtë greke (natyrisht, skllavërit ishin gjithashtu të përjashtuar). Për më tepër, shkenca e saj i detyrohej shumë Egjiptit të lashtë. Kështu që në terminologjinë e Bernal-it, 'modeli i lashtë' i Greqisë u zëvendësua me 'modelin arjan' (krijimi modern eurocentrik i Greqisë si Europë e kulluar).<sup>588</sup> Dhe siç e vënë në dukje Bernal dhe Ali Mazrui, sajimi i Greqisë së lashtë qe kritik për konceptimin eurocentrik të Europës demokratike e shkencore si përjetësisht superiore ndaj Lindjes despotike dhe parashkencore.<sup>589</sup>

<sup>587</sup> John Campbell dhe Philip Sherrard, "The Greeks and the West", te Raghavan Iyer (red.), *The Glass Curtain Between Asia and Europe* (London: Oxford University Press, 1965), fq. 71.

<sup>588</sup> Bernal, *Black Athena*, kapitujt 4-8.

<sup>589</sup> Ali Mazrui, *World Culture and the Black Experience* (Seattle: University of Washington Press, 1974), veçanërisht fq. 38-81.

Shkurt, teoria e despotizmit oriental ishte kritike jo vetëm për të 'shpjeguar' prapambetjen aziatike por, çka është jo më pak e rëndësishme, për të çimentuar identitetin e Europës – të shkuar dhe të tashëm – si vendlindja e qytetërimit të përparuar e demokratik. Në këtë mënyrë teoria e ngriti Europën si subjektin ose agjentin përjetësisht progresiv, duke i dhënë njëkohësisht lindorit vendin e objektit të përjetshëm regresiv dhe pasiv të historisë botërore.

### *Teoria e Piter Panit për Lindjen*

Teorinë e despotizmit oriental e përplotësoi një ide e dytë që mund të quhet 'teoria e Piter Panit për Lindjen'. Në shumë mënyra, 'zbulimet' ose dija e grumbulluar gjatë iluminizmit kulmoi në këtë teori. Ngjashmëria themelore midis dy teorive ishte shpikja e një Perëndimi racional dhe e një Lindjeje irracionale. Dallimi ishte se teoria e Piter Panit krijoi një imazh romantik të Tjetrit si i paaftë më shumë se sa mizor, ashtu si dhe joshës, i shthurur dhe ekzotik, duke e përfytyruar Lindjen si një fëmijë i pafajshëm i cili nuk do të rritet kurrë me dëshirën e vet. Rezultati edhe këtu që nocioni se Europa drejtohet nga një vijueshmëri progresive, kurse Lindja nga një amulli regresive.

Teoria u dha shkas kategorive të ndryshme dyjare, të përfytyruara për të dalluar Perëndimin nga Lindja. Kësisoj Perëndimi u përfytyrua si shpikës, proaktiv, shkencor, i disiplinuar, i vetëzotëruar, mendjeshëndoshë, i arsyeshëm, praktik, i orientuar nga mendja, i pavarur dhe mbi të gjitha paternal. Ky ishte një konstruksion tërësisht imagjinar, sepse siç e kemi parë në kapitujt e mëparshëm, Perëndimi ka qenë shumë i varur nga teknologjitë dhe idetë superiore lindore përgjatë periudhës mes viteve 500-1800. Nga ana tjetër Lindja u përfytyrua si e kundërta inferiore e Perëndimit: imituese, pasive, supersticioze, dembele, spontane, e krisur,

emocionale, ekzotike, e orientuar drejt trupit, e varur dhe mbi të gjitha, fëminore. Për të njëjtën arsye ky nuk ishte një konstrukt më pak imagjinar. I rëndësishëm është fakti, siç e vumë në dukje në kapitullin 1, se kjo retorikë e Lindjes dhe Perëndimit ishte sinonimike me retorikën patriarkale, ashtu që termat Perëndim dhe Lindje mund t'i zëvendësojmë me 'maskulinitet' dhe 'feminitet' dhe në përfundim të kemi saktësisht të njëjtën tërësi të kundërtash dyjare.

Teoria e Piter Panit për Lindjen është sinonimike me doktrinën e 'unitetit psikik të njerëzimit'. Siç shpjegon Blaut, kjo teori ishte e lidhur ngushtë me 'racionalitetin'.<sup>590</sup> Thelbi i iluminizmit ishte se i vendoste të gjithë popujt në një linjë vazhdimësie mendore. Njeriu perëndimor ishte i privilegjuar si plotësisht racional në një kuptim mendor dhe të pjekur, kurse njeriu lindor ishte i papjekur dhe i pazhvilluar psikikisht, domethënë nuk e kishte arritur fazën e zhvillimit të plotë mendor (racional). Pika kritike është se:

duke patur parasysh unitetin [e supozuar] psikik të njerëzimit, joeuropeanët sigurisht që mund të rriteshin, mund të bëheshin të arrinin racionalitetin dhe modernitetin, përmes një sërë përvojash mësimi [domethënë përmes imperializmit perëndimor]. (Shprehja 'tutelë koloniale' ishte një shenjë dalluese e doktrinës dhe kjo mënyrë të konceptuari haset në shumicën e teksteve historike e gjeografike të kohës.)<sup>591</sup>

Përshkrimi i Perëndimit si një burrë racional, i pavarur dhe prindëror kundrejt Lindjes si një fëmijë apo grua irracionale, e varur dhe e paaftë, ishte shumë i rëndësishëm në promovimin e idesë së misionit civilizues imperial si një detyrë morale. Sepse ishte aksiomatike ideja se vetëm Perën-

<sup>590</sup> Blaut, *Colonizer's Model*, fq. 95-102.

<sup>591</sup> Po aty, fq. 96.

dimi prindëror mund dhe duhej ta emanciponte apo ta nxirrte nga errësira Lindjen feminare, njësoj siç ati e sheh si detyrën e tij ta rrisë të birin. Për më tepër, përshkrimi i Lindjes si një grua joshëse dhe ekzotike përbënte një motiv më shumë për Perëndimin patriarkal për të ndërmarrë pushtime e penetrime dhe për të arritur kontroll dhe përmbushje imperiale.

Dëshmi të mëtejshme se e gjitha kjo ishte e sajuar, ofron fakti se teoria e Piter Panit dhe teoria e despotizmit oriental ishin në një kuptim të qartë, të papajtueshme. Sepse teksa Lindja përfytyrohej si një kërcënim despotik (një shprehje e mizorisë dhe pushtetit totalitar), në të njëjtën kohë përfytyrohej edhe si një entitet shumë më pak i rrezikshëm që gjoja ishte i paaftë dhe feminar (shprehje e pafajësisë dhe pafuqisë). Në këtë mënyrë Lindja njëkohësisht shënohej me një ndarje manikeane midis 'një imazhi të së keqes' dhe një 'imazhi romantik të pafajësisë'. Ndonëse këto dukeshin të papajtueshme, gjenialiteti i intelektualëve eurocentrikë shfaqej në aftësinë e tyre për t'i shartuar këto të dy në një retorikë koherente e të lëmuar. Paraqitja e Lindjes si një kërcënim despotik ishte po aq e rëndësishme për retorikën e imperializmit sa edhe ideja se Lindja është e pafajshme, ekzotike dhe mbi të gjitha pasive dhe e paaftë, duke qenë se kjo e fundit u përdor për ta bërë imperializmin të dukej si një 'vokacion moral' (domethënë ishte detyrë e princit përrëndimor që ta emanciponte bukurinë e tij të fjetur lindore). Askund nuk paraqitet më qartë lidhja midis teorisë së Piter Panit, teorisë së despotizmit oriental dhe imperializmit sesa në vjershën e famshme të Rudyard Kipling-ut shkruar në vitin 1899, *The White Man's Burden*. Në të ai i përshkruante popujt lindorë si 'gjysmë djaj e gjysmë fëmijë'. Barra ishte detyra morale për ta 'shëruar sëmundjen' e shthurjes lindore. Megjithatë mbetej barrë, pasi imperialistët s'duhej të

shpresonin kurrfarë mirënjohjeje për shërbimet e tyre ndaj njerëzimit. Përkundrazi, shpërblimi, siç paralajmëronte Kipling, do të ishte veçse:

Akuzat e atyre që u bëre mirë  
Urrejtja e atyre që i ruajte.

### *Klasifikimi sipas klimës dhe temperamentit*

Një aspekt kritik i mendimit iluminist ishte rëndësia që i jepej marrëdhënies midis klimës, temperamentit dhe civilizimit. Montesquieu, Adam Ferguson dhe William Falconer qenë veçanërisht të rëndësishëm në këtë pikë, edhe të paraprirë nga të tillë si Michel Montaigne, Pierre Charron dhe Jean Bodin. Banorët e klimave të thata ose tropikale konsideroheshin në një 'gjendje të ulët morali', kurse ata të klimave të buta i karakterizonte një 'aktivitet i rritur i trurit'.<sup>592</sup> Dukej krejtësisht e natyrshme që europianët të ishin njerëz punëtorë, meqë jetonin në një klimë të ftohtë e të lagësht dhe po ashtu që afrikanët të ishin të mefshtë apo dembelë, për shkak të mjedisit të tyre tejet të thatë. Siç e shpreh Philip Curtin, 'Përfundimi është [se] ... sipas Falconer-it, balanca më e mirë e mundshme e cilësive njerëzore gjendet afër skajit verior të zonës së butë, domethënë në Britani'.<sup>593</sup>

Klima dhe temperamentit ishin të lidhura ngushtë me nivelin e qytetërimit. Siç u vu në dukje në kapitullin e fundit, njerëzit e verdhë (sidomos kinezët) në vitet 1780 shiheshin si popull i degraduar që kishin rënë në shthurje morale e prapambetje si rezultat i klimës së tyre degjeneruese, nga

<sup>592</sup> D. N. Livingstone, "Climate's Moral Economy: Science, Race and Place in Post-Darwinian British and American Geography", te A. Godlewski dhe N. Smith (red.), *Geography and Empire* (Oxford: Blackwell, 1994).

<sup>593</sup> Philip D. Curtin, *The Image of Africa* (Madison: University of Wisconsin Press, 1964), fq. 65-66.

njëra anë, dhe i peshës së despotizmit oriental, nga ana tjetër.<sup>594</sup> Kjo, sigurisht, ishte një paraqitje njaft e çuditshme që nuk mund të përputhej me besimin e mëparshëm evropian për Kinën si një shembull qytetërimi të përparuar. Nuk mund të pajtohej as me faktin se Kina Veriore është po aq ‘e butë’ sa Europa. Dhe sido që të jetë, as regjimi dhe as klima nuk kishin ndryshuar papritur në fund të shekullit të tetëmbëdhjetë për ta shpjeguar këtë ‘rënie’. Siç e shpjegon Michael Edwardes, e gjitha kjo ishte ndoshta ‘një reagim i natyrshëm kundër adhurimit [të mëparshëm] absolut të Kinës, por edhe një reagim i bazuar fundamentalisht në injorancë. Në këto kushte, nuk kishte rrugë të mesme midis lavdërimit të tepërt dhe përbuzjes totale.’<sup>595</sup> Në këtë mënyrë, imazhi i dikurshëm i Kinës si një Konfuc fisnik e i urtë papritur, pas 1780-ës u zëvendësua me imazhin e një Fu Mançu-je ogurzi. Temperamenti kinez u konsiderua si melankolik, meqë pasi kishin qenë të mëdhenj dikur, tashmë kinezëve u duhej të përshtateshin me ‘dështimet’ e tyre.

‘I egrí’ i zi përfytyrohej si ‘njeri i natyrshëm në gjendjen e natyrshme’, vetëm një hap larg majmunit. Një shembull tipik është pikëpamja e shprehur nga eksploruesi britanik William Dampier. Kur arriti në Australi rreth fundit të shekullit të shtatëmbëdhjetë, ai mbeti i mahnitur nga ‘shformimi natyror’ i vendasve, të cilët kishin ‘pamjen më të pakëndshme dhe tiparet më të shëmtuara nga çdo popull që kam parë, megjithëse kam parë një larmi të madhe të egrish’.<sup>596</sup> Ky përshkrim i Dampier-it u riprodhua një shekull më vonë kur shkencëtarët evropianë i vendosën abo-

<sup>594</sup> Hyam, *Britain's Imperial Century*, fq. 37.

<sup>595</sup> Michael Edwardes, *East-West Passage* (New York: Taplinger, 1971), fq. 109.

<sup>596</sup> William Dampier, cituar te Richard White, *Inventing Australia* (Sydney: Allen and Unwin, 1981), fq. 3; shih, gjithashtu, Robert Hughes, *The Fatal Shore* (London: Harvill, 1996), fq. 48.

rigjenët e Australisë një hap larg majmunit. Peter Cunningham pyeste nëse aborigjenët duheshin vendosur 'në zeron e civilizimit, si nyja lidhëse midis racës njerëzore dhe majmunit, sepse vërtet disa prej grave duket se u mungon vetëm bishti për të qenë plotësisht të tilla'.<sup>597</sup>

Pikërisht këtu manifestohet qartë lidhja midis origjinës së racizmit të shkoqur (shkencor) dhe atij të nënkuptuar. Momenti kritik këtu ishte krijimi i Vargut të Madh të Qenies, shtjelluar nga Carl Linnaeus në librin e tij *Systema Naturae* (1735). Në botimet pasuese të librit ai gradualisht krijoi një kuadër bazë. Në fillim i përshkroi katër racat njerëzore brenda një hierarkie: të bardhë, të verdhë, të kuq dhe të zinj (me të bardhët në majë). Pastaj, më 1758 e ndau *genus homo* në dy: grupi i dytë përfshinte orangutangët dhe disa njerëz të egër që nuk mund të flisnin, por kishin ndjenja. Ngaqë të zinjët u vendosën një nyjë mbi orangutangët 'pa bisht' dhe ngaqë shkallët midis çdo elementi ishin të vogla, u arrit në rezultatin se njeriu i zi është në fund të civilizimit njerëzor dhe qëndron vetëm mbi orangutangun.

Së këtejmi antropologët dhe biologët në veçanti zhvilluan një linjë të gjatë 'teorish' e 'klasifikimesh', të cilat e patën kulmin me shfaqjen e racizmit shkencor në Britani pas vitit 1840. Rreth fundit të shekullit të tetëmbëdhjetë, Pieter Camper nisi të maste profilin e kokës njerëzore. Rezultati që se evropianët gëzonin shkallën më të lartë të inteligjencës dhe bukurisë, kurse të zinjët qëndronin në pikën më të ulët të shkallës, vetëm mbi kafshët më të sofistikuara. Camper u pasua nga një linjë mendimtarësh të cilët gjithashtu studiuan përmasat dhe formën e kafkës, si Cuvier, Blumenbach dhe Retzius, të cilët arritën të gjithë në të njëjtin përfundim: se evropiani është më inteligjenti, kurse i ziu

<sup>597</sup> Peter Cunningham, cituar te White, *Inventing*, fq. 8.

më pak i tilli. Comte de Buffon hodhi pretendimin se populli Hottentot (khoi-khoi-t e Afrikës Jugore) përbënin lidhjen e munguar mes majmunit dhe njeriut. Ky pohim i Buffon-it përputhej bukur me pretendimin e Edward Long-ut se: 'Sado qesharak mund të tingëllojë ideja, nuk mendoj se një burrë orangutang do të qe fyerje për një femër Hottentot'.<sup>598</sup> Ndërsa shumica prej nesh sot nuk do të gjenin asgjë për t'i bishtnuar në pjesën e parë të fjalisë, shumë nga bashkëkohësit e tij do të kishin qenë dakord me pjesën e dytë.

Një tjetër mit 'shkencor' popullor e filloi Maeterlinck-u, i cili e 'krahasoi "lobin lindor" në trurin e njeriut, nga i cili buron intuita, feja, nënvetëdija, me "lobin perëndimor", i cili prodhon arsyen, shkencën, vetëdijen'.<sup>599</sup> Për më tepër, Dr. James Hunt pretendonte se 'zhvillimi i ndaluar mendor i njeriut të zi vjen si rrjedhojë e mbylljes më herët të qepjeve të kafkës në "racat e ulëta njerëzore"'.<sup>600</sup> Interesante është se këto mite ushqeheshin nga zakoni britanik për të mbajtur helmetën diellore me shtresë të brendshme. Kjo gjë u jepte mundësinë administratorëve kolonialë britanikë të konceptonin supersticionin, bazuar në prirjen e tyre më të madhe për të pësuar goditje nga dielli, se kafkat e tyre ishin më të holla, çka nënkuptonte se trutë e tyre ishin më të mëdhenj. Siç e vë në dukje George Orwell, 'kafka e hollë ishte shenjë e epërsisë racore, dhe helmata me shtresë të brendshme ishte një lloj embleme e perandorisë koloriale'.<sup>601</sup>

Racizmi shkencor ushqehej nga nocioni i krishterë i poligjenezës, sipas të cilit racat e ndryshme njerëzore kishin

<sup>598</sup> Edward Long, *History of Jamaica*, cituar te Homi K. Bhaba, *The Location of Culture* (London: Routledge, 1994), fq. 91.

<sup>599</sup> Raghavan Iyer, "The Glass Curtain Between Asia and Europe", te R. Iyer (red.), *The Glass Curtain Between Asia and Europe* (London: Oxford University Press, 1965), fq. 20.

<sup>600</sup> Dr James Hunt, cituar te Hyam, *Britain's Imperial Century*, fq. 81.

<sup>601</sup> George Orwell, cituar te Hyam, *Britain's Imperial Century*, fq. 158.

prejardhje të ndryshme. Me hedhjen poshtë të idesë së krishterë të prejardhjes së njeriut (e cila nënkuptonte se të gjithë njerëzit janë potencialisht të barabartë përderisa të gjithë mund të bëhen të krishterë), iu hap rruga teorisë së inferioritetit të përhershëm të të zinjve si dhe të të verdhëve. Megjithatë, ndërkohë që lulëzoi në Francë, në Britani teoria në fjalë gjeti terren më pak pjellor për shkak të rilindjes protestante.<sup>602</sup> Vetëm gjatë viteve 1840 racizmi i shkoqur do të shfaqej plotësisht në Britani.

### *Rilindja protestante*

Paradoksi më i madh i rilindjes së Protestantizmit Britanik është se ndërsa i vuri pritë shfaqjes së plotë të racizmit shkencor me parapëlqimin e monogjenezës kundrejt poligjenezës, kontributi i tij ndaj racizmit të nënkuptuar and misionit civilizues që i gjithanshëm. Risjellja në vëmendje e historisë së Zanafillës për tri bijtë e Noes që e rëndësishme jo më së paku ngaqë justifikonte misionin civilizues. Historia e Zanafillës e kryente këtë rol ngaqë shpallte – ose të paktën kështu intepretohej – se *detyra* e Jafetit (europianët) ishte ta përthithte Shemin (aziatikët) dhe të skllavëronte e të kolonizonte Hamin ose Kanaanin (afrikanët e zinj). Sipas Zanafillës 9:27, ‘Zoti do ta shumojë Jafetin dhe ai do të banojë në tendat e Shemit dhe Kanaani do të jetë shërbëtori i tij’. Rilindja protestante i mbushte misionarët e krishterë me dëshirën për t’u shpërndarë nëpër botë për të përhapur Fjalën mes të gjithë jobesimtarëve. Siç e shpreh A. J. Christopher:

Misionarët, me gjasë më shumë se anëtarët e degëve të tjera të establishmentit kolonial, synonin një transformim radikal të shoqërisë vendase ... Prandaj, me ose pa

<sup>602</sup> Frederickson, *Racism*, kapitulli 2.

vetëdije, ata u përpoqën për shkatërrimin e shoqërive parakoloniale dhe për zëvendësimin e tyre me shoqëri të reja sipas imazhit të Europës.<sup>603</sup>

Misionarët e krishterë përbënin një nga zërat më të fuqishëm e me ndikim të misionit civilizues. Siç e vë në dukje David Abernethy, pasi zinin vend në pjesë të ndryshme të perandorisë koloniale, misionarët 'bënin trysni të fortë për ndërhyrjen e qeverisë për lehtësimin e misionit civilizues'.<sup>604</sup>

Një tjetër aspekt i rëndësishëm i rilindjes protestante që se u dha mundësinë britanikëve për t'u vetëdalluar jo vetëm prej të zinjve dhe të verdhëve, por edhe nga kombet e tjera europiane. Britanikët e vendosën veten në majë të hierarkisë (në Ligën e Parë). Pastaj sajuan një radhitje brenda Divizionit të Parë. Francezët katolikë u vendosën poshtë gjermanëve, kurse portugezët katolikë lëkundeshin në fund të Divizionit të Parë në buzë të rënies nga kategoria. Siç e vë në dukje Palmerson, 'E vërteta shqeto është se nga të gjitha kombet europiane [përveç irlandezëve] portugezët janë në fund të shkallës morale'.<sup>605</sup> Po ashtu është shumë e rëndësishme të vihet re se irlandezët katolikë u përjashtuan nga Divizioni i Parë për t'u vendosur në Divizionin e Tretë. Kështu e përshkruante revista satirike britanike *Punch* këtë pikëpamje: irlandezët janë 'lidhja e munguar midis gorrillës dhe zezakut'.<sup>606</sup> Prononcimet e klasës së lartë britanike apo angleze për irlandezët ishin përplot me deklarime se këta të fundit janë një 'racë e egër' (siç shprehej Samuel Mard-

<sup>603</sup> A. J. Christopher, *Colonial Africa* (Totowa: Barnes and Noble, 1984), fq. 83.

<sup>604</sup> David B. Abernethy, *The Dynamics of Global Dominance* (London: Yale University Press, 2000), fq. 222.

<sup>605</sup> Lord Palmerston, cituar te Hyam, *Britain's Imperial Century*, fq. 39.

<sup>606</sup> *Punch* (1849), cituar te Richard Ned Lebow, *White Britain and Black Ireland* (Philadelphia: Institute for the Study of Human Issues, 1976), fq. 40.

sen).<sup>607</sup> Qëndrimi urryes dhe mosbesues i klasës së lartë angleze kundrejt irlandezëve që një nga faktorët kyç në shpërnguljen e tyre në kolonitë e Australisë. Kjo është domethënëse pasi tregon se ngjyra e lëkurës ishte një kriter i domosdoshëm, ndonëse qartazi jo i mjaftueshëm. Çfarë kishte më shumë rëndësi në fund ishte se sa i përshtateshin qytetërimet e tjera ‘standardit’ imagjinar ‘të civilizimit’ që ishte i vetmi që kishte arritur përsosmërinë në Angli.

Siç ka arsyetuar bindshëm Linda Colley, britanikët ishin thujtë po aq armiqësorë ndaj francezëve katolikë (për të mos përmendur irlandezët katolikë) sa ç’ishin ndaj popujve të ndryshëm lindorë.<sup>608</sup> Ata besonin se ndryshe nga Katolicizmi, Protestantizmi përfaqësonte civilizimin. Katolikët francezë shiheshin si gjysmë skllëvër që lëngonin nën despotizmin francez (ndonëse irlandezët gjykoheshin si rrugëçer të egër). Në atmosferën e dendur protestante të Britanisë së shekujve të tetëmbëdhjetë e nëntëmbëdhjetë, britanikët filluan ta përfytyronin veten si kanakarë të vëmendjes së veçantë të Zotit, se ishin ‘populli’ i vërtetë ‘i zgjedhur i Zotit’. Kjo ide mishërohej në vjershën e famshme të William Blake-ut e cila i nxiste britanikët të mos ndaleshin kurrë derisa të ‘ndërtonin Jeruzalemin në tokën e gjelbër e të ëmbël të Britanisë’. Siç shpjegon Linda Colley, protestantët britanikë e dinin se:

ishin të detyruar të sprovoheshin rregullisht përmes përiudhash mëkati dhe vuajtjeje të skajshme, dhe e merrnin për të mirëqenë se lufta – sidomos me ata që nuk ishin protestantë – ishte e drejta e tyre e lindur. Por ata gjithashtu besonin se nën Providencën Hyjnore ata do të siguronin shpëtimin dhe do të arrinin të dalloheshin.

<sup>607</sup> Marsden, cituar te Hughes, *Fatal Shore*, fq. 188.

<sup>608</sup> Linda Colley, *Britons: Forging the Nation 1707-1837* (New Haven: Yale University Press, 1992).

Shkurt, shumë prej tyre besonin se toka e tyre nuk ishte asgjë më pak se një Izrael tjetër dhe më i mirë.<sup>609</sup>

Kështu, nga konceptimi i britanikëve si Populli i Zgjedhur i Zotit mbetej një hap i shkurtër drejt të parit të imperializmit dhe anglikanizimit të botës si fati i shpallur i Britanisë.

### *Darvinizmi social dhe racizmi shkencor (ose i shkoqur)*

Racizmi i shkoqur (ose shkencor) u shfaq me forcë në Britani vetëm pas viteve 1840. Në krijimin e kësaj retorike luajtën rol shumë zhvillime intelektuale (disa prej të cilave janë përmendur më lart). Një nga momentet e rëndësishme është botimi i *On the Origin of Species* i Charles Darwin-it, libër i cili shpejt u bart në teoritë e shkencave sociale. Megjithatë, disa nga idetë në këtë libër i paraprinin Darwin-it, veçanërisht në veprën e Herbert Spencer-it. Idetë e 'përzgjedhjes natyrore' dhe të 'mbijetesës së më të fortit' (frazë kjo e përdorur për herë të parë nga Herbert Spencer-i) u bënë të rëndësishme në përligjen e epërsisë së racës së bardhë për perëndimorët. Importimi i darvinizmit në teoritë e shkencave sociale kishte rëndësi të veçantë pasi 'dukej se e theksonte vlefshmërinë "shkencore" të ndarjes së racave në të përparuar dhe të prapambetura, ose në europiano-ariane [kundrejt atyre] ... orientalo-afrikane'.<sup>610</sup> Kjo teori gjeti vend krahas trajtesave raciste të shkoqura (shkencore) që po dilnin në pah, zhvilluar nga Comte Arthur de Gobineau në Francë, Robert Knox dhe Charles Kingsley në Britani, Nott dhe Gliddon në SHBA dhe një sërë autorësh në Gjermani, si Karl Vogt dhe i linduri anglez Houston Stewart Chamberlain. Këto teori u shfaqën në vitet 1840 por u shumuan pas

<sup>609</sup> Colley, *Britons*, fq. 29-30.

<sup>610</sup> Edward W. Said, *Orientalism* (London: Penguin, 1991 [1978]), fq. 206, gjithashtu fq. 227.

viteve 1850 (megjithëse rrënjët e tyre shkonin pas në shekullin e tetëmbëdhjetë).<sup>611</sup> Në kontekstin anglez, racizmi shkencor karakterizohej së tepërmi nga një prej personazheve në romanin *Tancred* (1847) të Benjamin Disraeli-t, i cili na thotë se suksesi historik i Anglisë është një

çështje race. Një racë saksone, e mbrojtur nga një pozitë ishullore, e ka vulosur shekullin me karakterin e saj të zellshëm e metodik. Kur një racë superiore, me një ide superiore për Punën dhe Rendin, përparon, gjendja e saj do të jetë progresive ... Gjithçka ka të bëjë me racën.<sup>612</sup>

Për herë të parë në historinë botërore, zhvillimi i shoqërive u mendua se bazohej mbi tiparet e përhershme racore ('Gjithçka ka të bëjë me racën'). Theks i veçantë u vu – sërish për herë të parë në historinë botërore – mbi rëndësinë e ngjyrës së lëkurës dhe cilësitë gjenetike si kriter përkufizues i civilizimit. Libra si *Tha Races of Man* i Robert Knox, *Social Evolution* i Benjamin Kidd apo *The Inequality of Races* i Comte de Gobineau, konceptuan një ndarje në tre të racave bazuar mbi ngjyrën e lëkurës – të bardhë, të verdhë dhe të zezë (sipas historisë së Zanafillës). Kjo tashmë konceptohej si një hierarki e përhershme dhe për disa racistë shkencorë, ndonëse jo për të gjithë, përligjite zhdukjen e racave inferiore në rastin më të keq dhe aparteidin në rastin më të mirë. Konstruksioni racist me shpejtësi u përhap në retorikën popullore imperiale, duke gjetur shprehje në një tërësi të pafundme deklarimesh të lëshuara nga burokratët imperialë dhe politikanët britanikë.

Tipik ishte Joseph Chamberlain:

<sup>611</sup> Shih diskutimin e përmbledhur te: Curtin, *Image of Africa*; Ivan Hannaford, *Race: The History of an Idea in the West* (Baltimore: Johns Hopkins University Press, 1996); Michael Banton, *The Idea of Race* (London: Tavistock, 1977); Frederickson, *Racism*.

<sup>612</sup> Benjamin Disraeli, cituar te Banton, *Idea of Race*, fq. 25.

Unë besoj në këtë racë, raca më e madhe qeverisëse që bota ka parë ndonjëherë; në këtë racë anglo-saksone, kaq krenare, kaq këmbëngulëse, kaq vetëbesuese dhe e vendosur; kjo racë të cilën as klima dhe as ndryshimi s'mund ta degjenerojë, e cila pa dyshim do të jetë forca mbizotëruese e së ardhmes dhe e civilizimit universal.<sup>613</sup>

Për më tepër, imperializmi si një mision civilizues gjente shprehjen e saktë në fjalët e Lord Curzon-it: 'Tek perandoria kemi gjetur jo vetëm çelësin e lavdisë dhe pasurisë, por edhe thirrjen e detyrës dhe rrugët për t'i shërbyer njerëzisë'.<sup>614</sup>

I rëndësishëm është fakti se retorika raciste u ndërthur me të drejtën ndërkombëtare. James Lorimer, për shembull, e ndau njerëzimin në tri zona: njerëzimi i bardhë i civilizuar, njerëzimi i verdhë barbar dhe njerëzimi i zi i egër.<sup>615</sup> M. F. Lindley pohonte se, 'territori i prapambetur përfshin territorin e banuar nga vendas që janë aq poshtë në shkallën e civilizimit, sa ata të Afrikës Qendrore'.<sup>616</sup> Kurse John Westlake në librin e tij *Chapters on the Principles of International Law* (1894) arsyetonte se 'rajonet e pacivilizuara të tokës duhet të aneksohen ose të pushtohen nga fuqitë e përparuara perëndimore'.<sup>617</sup> Vërtet, e drejta ndërkombëtare europiane e ofronte si recetë dhe e përligjte aktivisht kolonizimin dhe imperializmin në Lindje.<sup>618</sup> E drejta ndërkombëtare europiane e bënte të mundur imperializmin përmes klasifi-

<sup>613</sup> Joseph Chamberlain, cituar te White, *Inventing*, fq. 71.

<sup>614</sup> Lord Curzon, cituar te A. P. Thornton, *The Imperial Idea and its Enemies* (New York: St Martin's Press, 1966), fq. 72.

<sup>615</sup> James Lorimer, *Institutes of the Law of Nations*, I (Edinburgh: Blackwood and Sons, 1883), fq. 10-12.

<sup>616</sup> M. F. Lindley, *The Acquisition and Government of Backward Territory in International Law* (London: Longmans, Green, 1926).

<sup>617</sup> John Westlake, përmbledhur te Said, *Orientalism*, fq. 206-207.

<sup>618</sup> Mohammed Bedjaoui, "Poverty of the International Order", te Richard Falk, Friedrich Kratochwil dhe Saul Mendlovitz (red.), *International Law* (Boulder: Westview Press, 1985), fq. 153.

kimit të vet ose konstruktimit politik të gjendjeve të ndryshme të botës. Si përfundim, ajo bënte të mundur një ‘çterritorizim’ mendor të popujve lindorë. Si ndodhte kjo?

Vendet e Divizionit të Tretë u etiketuan me konceptin e *terra nullius*. Në thelb viset e ‘të egërve’ u përfytyruan si hapësira boshe apo të djerra. Siç shprehej në mënyrë tipike Lord Carnarvon-i në vitin 1874: ‘misioni i Anglisë’ i bënte thirrje ‘një shpirti aventure për të mbushur hapësirat boshe të tokës’,<sup>619</sup> ndonëse siç e vë në dukje me sarkazëm Edward Said, ‘[britanikëve] nuk u bëhej vonë se hapësira e bardhë në hartë banohej nga vendasit’.<sup>620</sup> Por, sigurisht, nuk u bëhej vonë pikërisht ngaqë vendasit përfytyroheshin si njerëz të egër në rastin më të mirë dhe si kafshë në rastin më të keq dhe prandaj nuk mund të pretendonin për një hapësirë sovraane. Ky ‘çterritorizim’ mendor nënkuptonte se aneksimi i plotë kolonial ishte krejtësisht i përligjur. Ndryshe nga trajtimi i të egërve të zinj dhe konceptimi i *terra nullius*, ‘të verdhët’ e vendeve të Divizionit të Dytë konceptoheshin si ‘popuj të rënë’ dhe viset e tyre përfytyroheshin si ‘hapësira pa kufij’. Kësisoj, me degjenerimin e tyre moral, ishte veçse e përligjur që europianët të shkonin e t’i rigjeneronin sipas linjave perëndimore. Megjithatë, për shkak se viset e tyre nuk ishin të shpallura *terra nullius* (por qartazi as sovraane), europianët e administronin trajtimin ‘korrektues’ përmes perandorisë informale më shumë se sa përmes aneksimit të drejtpërdrejtë kolonial. Nga ana tjetër europianët gëzonin sovranitet të plotë. Kjo gjë i izolonte ata nga misioni civilizues britanik mbi bazën se vetëm Europa përmbante qenie njerëzore të civilizuar – qoftë edhe në sytë e britanikëve, disa ishin më të civilizuar se të tjerët.

<sup>619</sup> Lord Carnarvon, cituar te Hyam, *Britain’s Imperial Century*, fq. 105.

<sup>620</sup> Said, *Orientalism*, fq. 216.

## Kontradikta morale e misionit civilizues imperial

Pasi retorika e imperializmit që farkëtuar përmes rikrijimit të identitetit evropian dhe konceptimit racist të botës, nisja e 'misionit civilizues' u bë një detyrë morale. Argumenti materialist se Britania e kishte arritur kulmin e fuqisë materiale dhe prandaj ishte angazhuar me imperializëm sepse 'mundej', është tepër e thjeshtë, sepse e anashkalon faktin se që identiteti i ri imperial britanik ai që e mbishkruajti 'fuqinë e tij të madhe' me një synim moral, çka do të thotë se identiteti i tyre i shtyu britanikët ta ndiqnin imperializmin jo thjesht sepse 'mundeshin', por sepse besonin se 'duhej' ta ndiqnin ('Barra e Njeriut të Bardhë'). Siç e ka vënë në dukje fillimisht Edward Said, orientalët nuk kishin status tjetër veçse të shiheshin si problem që duhej zgjidhur, preferueshëm përmes aneksimit kolonial. 'Vetë cilësimi i diçkaje si "orientale" ... përmbante një program të nënkuptuar veprimi ... Nëse fillojmë të mendojmë për orientalizmin si një lloj projeksioni perëndimor mbi Orientin dhe vullnet për ta qeverisur atë, do të ndeshemi me më pak surpriza'.<sup>621</sup> Por, siç e shpjegoj në kap. 13, asgjë nga këto nuk do të thotë se fuqia materiale apo faktorët materialë janë të parëndësishëm. Pa dyshim, fuqia materiale ishte një parakusht jetik për imperializmin britanik. Por çështja kritike që duhet vënë në dukje është se një fuqi e madhe kanalizohet në drejtime specifike në varësi të identitetit të veçantë të 'faktorit' në fjalë. Atëherë si ndodhi që identiteti racist e mbushi fuqinë e madhe britanike (ose perëndimore) me një synim moral për të arritur kësisoj deri tek imperializmi?

Rezultati i 'tabelës së ligës qytetërimore' dhe konceptimi racist i botës konsistonte në besimin se Perëndimi është

<sup>621</sup> Po aty, fq. 207, 95.

normal e i përparuar ndërsa Lindja u përfytyrua si devian- te, si e prapambetur dhe barbare ose e egër (shih tabelën 10.1). Ç'është më e rëndësishme, identiteti perëndimor u konceptua në mënyrë të tillë që Lindja nuk mund të tolero- hej për deviancën e saj imagjinare. Europeanët nisën ta shih- nin imperializmin si një 'mision civilizues' ku 'detyra mora- le' e njeriut perëndimor ishte t'i jepte Lindjes dhuntinë e ci- vilizimit. Etiketimi i imperializmit si një mision civilizues është me vend për disa arsye: së pari sepse u krijua për ta civilizuar dhe emancipuar Lindjen duke e shfarosur identi- tetin dhe kulturën lindore për t'i zëvendësuar me cilësi su- periore perëndimore. Së dyti, termi vlen sepse ndërsa impe- rializmi nuk qe patjetër i mirë për botën siç rezultoi, impe- rialistët britanikë megjithatë e besonin sinqerisht se po e 'civilizonin' apo emanciponin/çlironin Lindjen. Ky besim nuk demonstrohej në mënyrë cinike për të mbrojtur veprimet e tyre, siç supozojnë materialistët. Siç e thotë shprehja e famshme e Mr. Podsnap-it të Charles Dickens-it, vendet e tjera ishin thjesht 'një gabim' dhe sipas përfytyrimit të tyre racist, u takonte britanikëve ta 'korrigjonin këtë gabim'. Në gjithë këtë britanikët nuk shihnin asgjë të gabuar. Sepse ç'mund të kishte më fisnike se t'i ndihmosh të tjerët të shi- jojnë frytet e modernitetit e të civilizimit që vetëm Perëndi- mi i kishte krijuar dhe që vetëm britanikët mund t'i ofronin, pavarësisht se popujt lindorë ishin ose shumë injorantë, ose shumë kokëfortë për ta kuptuar e vlerësuar dorën bujare imperiale të Britanisë?

Si duheshin trajtuar ose administruar atëherë popujt lindorë për 'deviancën' e tyre (domethënë, si mund të shty- heshin për t'u bërë 'të qytetëruar')? 'Strategjia civilizuese' përkatëse do të përzgjidhej sipas nivelit të perceptuar të civilizimit ku Perëndimi gjykonte se ndodhej çdo shtet ose popull lindor. Sa më i pacivilizuar të gjykohej se ishte një

shtet ose popull, aq më i ashpër duhej të ishte trajtimi disiplinues për ta shëruar sëmundjen. Banorët e vendeve të Divizionit të Tretë (racat e egra të zeza), të cilat mezi konsideroheshin si njerëz, do të trajtoheshin me kolonizim dhe, në rastin ekstrem, me gjenocid dhe aparteid social. Banorët e vendeve të Divizionit të Dytë (racat e verdha barbare), të gjykuara si më të civilizuar se të zinjët por në inferioritet të mjerueshëm kundrejt europianëve në Divizionin e Parë, do të trajtoheshin përmes 'perandorisë informale'.

Megjithatë misioni civilizues britanik bazohej në një kundërshti themelore. Nga njëra anë ky mision ishte mënyra për të imponuar *konvertimin kulturor* që synonte 't'i ngrinte popujt lindorë' në nivelin e civilizimit britanik. Kjo e bënte të nevojshme që institucionet dhe praktikat kulturore, ekonomike e politike britanike të transformoheshin sipas linjave britanike. Nga ana tjetër, konvertimi kulturor shkonte krah për krah me strategjinë e *përmbajtjes*, e cila synonte t'i mbante popujt dhe ekonomitë lindore nën kontroll. Me fjalë të tjera, kundërshtia manifestohej në dëshirën e dyfishtë për t'i ngritur popujt në fjalë (konvertimi kulturor) dhe për t'i mbajtur nën kontroll (përmbajtja). Por kjo kundërshti ishte logjikisht inkohere brenda retorikës raciste të perandorisë koloniale. Kjo kishte dy arsye. Së pari, misioni civilizues do ta konvertonte Lindjen sipas linjave perëndimore për ta zhdukur rrezikun identitar që paraqiste Lindja, në mënyrë që Perëndimi të mund të ndihej superior. Por që Perëndimi të mbetej 'superior', ishte gjithashtu jetike që ekonomitë lindore të përmbaheshin në mënyrë që të mos lejoheshin ta sfidonin hegjemoninë perëndimore. Së dyti, konvertimi kulturor dhe përmbajtja nënkuptonin njësoj shtypjen e Lindjes. Konvertimi kulturor mishëronte vetë thelbin e racizmit të nënkuptuar ku identiteti dhe kultura e grupit të synuar do të shfaroseshin për t'u zëvendësuar me kulturën

‘superiore’ të vendit imperial. Konvertimi kulturor është në fakt i barazvlefshëm me atë që Pierre Clastres e quan ‘ethnocid’. Kjo ndërthurej me idenë pas përmbajtjes: për shkak se popujt lindorë ishin inferiorë në rastin më të mirë apo më pak se njerëz në rastin më të keq, ‘natyrshëm’ mund të shfrytëzoheshin, të shtypeshin e të përdoreshin për t’u shërbyer nevojave të ndryshme të ‘Vendit Mëmë’.

Përfundimi i këtij diskutimi është se nëse racizmi nuk do të kishte ekzistuar dhe nëse Perëndimi do t’i kishte parë popujt europianë si qenie të barabarta njerëzore, imperializmi do të mund të mos kish ndodhur kurrë. Ose siç shprehet Edward Said, ‘pa proceset e rëndësishme që vepruan në prodhimin si dhe në pushtimin, nënshtrimin dhe kolonizimin e hapësirës [mendore], vetë perandoria nuk do të kishte ekzistuar’.<sup>622</sup> Tashmë mbetet të shqyrtojmë se si u shpalos kundërshtia morale e misionit civilizues imperial (për t’u trajtuar në pjesën e tretë të kap. 11).

<sup>622</sup> Edward W. Said, “Representing the Colonized: Anthropology’s Interlocutors”, *Critical Inquiry* 15 (1989), 216.

## 11. ANA E ERRËT E INDUSTRIALIZIMIT BRITANIK DHE MITI I *LAISSEZ-FAIRE*: LUFTA, IMPERIALIZMI RACIST DHE ORIGJINAT AFRO-AZIATIKE TË INDUSTRIALIZIMIT

Colbert ngjan se ... nuk ka qenë shpikësi i sistemit [proteksionist] ... sepse ... ky sistem qe përpunuar në formën e plotë nga anglezët shumë kohë para tij.

*Friedrich List*

Pax Britannica, e cila gjithmonë ka qenë një gënjeshtër e pacipë, tashmë është bërë një përbindësh grotesk hipokrizie.

*John A. Hobson*

I vetmi mësim për t' u marrë është se Lindja dhe Perëndimi janë thjesht emra ... Kush ka dëshirë do të silltet hijshëm. Nuk ka ndonjë popull për të cilin jeta e moralshme është një mision i veçantë.

*Mahatma Gandhi*

[Perandoria Britanike ishte] një superstrukturë madhështore e tregtisë amerikane dhe e fuqisë detare [britanike] mbi themelet afrikane.

*Malachy Postlethwayt*

Në kapitullin 9 e vumë në dukje se industrializimi britanik zë një vend të veçantë brenda retorikës eurocentriste të historisë botërore. Vumë në dukje gjithashtu se çelësi i 'Kapërcimit të Madh' të Britanisë qëndron në kulturën e saj individualiste të vetëndihmesës, brenda së cilës e patën zanafillën gjithfarë shpikjesh gjeniale. Kjo nga ana e saj kon-

vencionalisht mendohet se është një funksion i qëndrimit minimalist *laissez-faire* (jointervencionist) të shtetit dhe kjo nga ana e saj ushqen mendimin e përgjithshëm eurocentrik se industrializimi britanik që një çështje krejtësisht e brendshme e bazuar mbi ndryshimin e vetëgjeneruar.

Në këtë kapitull unë e kundërshtoj këtë peizazh nëpërmjet dy argumentesh të përgjithshme: së pari se shteti britanik kuptohet më mirë si një vend despotik e intervencionist me zhvillim të vonë që luajti një rol jetik në mundësimin e industrializimit. Pjesa e parë dhe e dytë shtjellojnë se si u zbatua ky argument në arenën e brendshme. Së dyti, ndryshe nga teza eurocentrike e ndryshimit 'të vetëgjeneruar' të udhëhequr së brendshmi ('logjika e brëndshmërisë'), arsyetoj se përvetësimi racist imperial i burimeve lindore që një kontribut kritik i jashtëm ndaj industrializimit britanik – siç trajtohet në pjesën 3. Kësisoj, teksa kapitulli 9 fokusohet në asimilimin e burimeve kineze, këtu shqyrtoj përvetësimin imperial të burimeve lindore në historinë e ngritjes së Perëndimit; ajo çka e quaj 'originat afro-aziatike të industrializimit britanik'. Shkurt, rëndësia e etiketimit të Britanisë si një vend despotik dhe racist me zhvillim të vonë, është se ky etiketim detyrimisht na e zhvendos fokusin në qëndrimin intervencionist, përvetësues dhe shtypës që shteti mbajti si brenda edhe jashtë gjatë periudhës së industrializimit.

### **Lufta dhe miti i *laissez-faire*-it britanik**

Merrni një tekst standard çfarëdo të historisë ekonomike mbi industrializimin britanik dhe do të gjeni po të njëjtën histori të mirënjohur tashmë: se 'triumfin' britanik e bëri të mundur shenjtëria e 'individualizimit sovran' dhe jo ajo e 'etatizmit sovran'. Në mishërimin e saj liberal kjo formulë

pohon se është më mirë qeverisja nga dora e padukshme e konkurrencës ekonomike sesa nga dora e dukshme e shtetit intervencionist. Ose siç e shpreh Dugald Stewart kur përmbledh pozicionin e Adam Smith-it: 'Nuk nevojitet ndonjë gjë më shumë për ta bartur një shtet nga barbarizmi më i ulët në shkallën më të lartë të bollëkut, përveç paqes, taksimit të lehtë dhe një administrim të tolerueshëm të drejtësisë; gjithçka tjetër bëhet e mundur nga rrjedha e natyrshme e gjërave'.<sup>623</sup>

Në thelb, shteti britanik besohet se ka krijuar kushtet e duhura për pushtimin e paqshëm të natyrës dhe 'traditës' teksa njëkohësisht është vetëpërmbajtur nga ndërhyrja drejtpërdrejt në ekonomi (domethënë *laissez-faire*), ndaj edhe kapërcimi i saj ngadhnyjes. Ky supozim paraqet joshje universale nëpër teoritë dhe historitë e shumta të industrializimit britanik.

Fjala kritike që përbën shtyllën e konceptit të *laissez-faire*-it është 'spontaniteti'. Siç e shpreh Peter Mathias këtë pikëpamje standarde:

Industrializimi në Britani ... zakonisht me të drejtë merret si rasti klasik i rritjes spontane, që u përgjigjet kryesisht influencave të tregut dhe që qëndron në themel të formave shoqërore e institucionale, jo i organizuar me vetëdije nga qeveria sipas interesave për promovimin e rritjes industriale. Për aq sa shteti [britanik] që i rëndësishëm, roli i tij kryesor që institucionalizimi i këtyre forcave themelore shoqërore e ekonomike, për të krijuar sigurinë e nevojshme në vend dhe jashtë brenda së cilës forcat e tregut dhe ekonomike ... do të operonin [spontanisht]. [Shteti] nuk synoi t'i jepte një vrull qendror pro-

<sup>623</sup> Dugald Stewart, cituar te Friedrich List, *The National System of Political Economy* (London: Longmans, Green, 1885), fq. 120.

cesit të rritjes industriale apo t'i jepte formë zhvillimit ...  
U kujdes më shumë për kontekstin sesa për procesin; për  
të rregulluar kushtet e jashtme sesa për të krijuar forcat e  
brendshme.<sup>624</sup>

Të qëndruarit larg 'procesit' (politika e ndërhyrjes pozitive shtetërore) dhe kujdesja më shumë me 'kontekstin' (domethënë *laissez-faire* dhe sigurimi vetëm i kushteve të domosdoshme kontekstuale), nënkuptonin se shteti siguron taksat të lehta, buxhete të balancuara, tregti të lirë dhe politikë të jashtme paqësore.

Të paktën ky është peizazhi i mirënjohur që ia bashkëshoqërojmë historisë britanike. Por ky kapitull e nxjerr në pah këtë si një nga mitet qendrore të historisë botërore (eurocentrike qoftë ose tjetërsoj), duke qenë se ajo çka bie në sy tek intervencionizmi shtetëror britanik është shkalla e tij tejet e lartë.

### *Industrializimi i militarizuar i Britanisë*

Imazhi konvencional që kemi për industrializimin e Britanisë është se u arrit në mungesë të luftës, çka u dha mundësinë kapitalistëve pionierë britanikë të bënin atë që mund të bënin më mirë. Prandaj tingëllon befases fakti se gjatë periudhës së rëndësishme (1688-1815) shteti britanik ka qenë jo më pak se 52% të kohës në luftë. Më befasese akoma janë shumat e shpenzuara për luftën. Tabela 11.1 tregon barrën e vërtetë të mbrojtjes, kjo e fundit e llogaritur duke e marrë mbrojtjen si një pjesë e të ardhurave kombëtare (çka njëkohësisht rrafshon efektet shtrembëruese të inflacionit dhe të rritjes ekonomike).

<sup>624</sup> Peter Mathias, *The First Industrial Nation* (London: Methuen, 1983), fq. 31.

Tabela 11.1 *Shpenzimet e vërteta të qeverisë britanike (shpenzimet të shprehura si pjesë e të ardhurave kombëtare)*

	1715-1815 =100		1715-1815 =100		1715-1815 =100	
	ShQQ	ShQQ	D1	D1	D2	D2
1715-1815	20	100	11	100	18	100
1760-1815	23	114	13	116	21	113
1815-1850	14	71	5	40	12	65
1715-1850	17	84	7	64	14	79
1850-1913	9	43	3	29	5	26
1914-1980	33	165	8	71	12	67

Shënime: ShQQ = shpenzimet e qeverisë qendrore për të gjitha shërbimet, D1 = shpenzimet e zakonshme dhe të jashtëzakonshme ushtarake, D2 = shpenzimet e zakonshme dhe të jashtëzakonshme ushtarake bashkë me pagesat e interesit për borxhet ushtarake.

*Burimi:* Linda Weiss dhe John M. Hobson, *States and Economic Development* (Cambridge: Polity, 1995), fq. 130.

Mes viteve 1715 dhe 1815, shpenzimet për mbrojtjen kanë qenë thajse 30% e periudhës 1850-1913 dhe madje i kanë tejkalar shpenzimet e bëra gjatë periudhës 1914-1980 (që përfshin dy luftrat botërore). Ç'është më befasuese, shpenzimet D2 mes viteve 1715 dhe 1815 kanë qenë sa dyfishi i atyre të bëra në të gjitha shërbimet nga shteti mes viteve 1850 dhe 1913 dhe i kanë tejkalar ndjeshëm shpenzimet D2 mes viteve 1914 dhe 1980. Jo më pak befasuese është se tabela 11.2 nxjerr në pah se barra e vërtetë ushtarake britanike gjatë fazës kryesore të industrializimit ua ka tejkalar në mënyrë domethënëse të gjitha fuqive madhore europiane në fazat përkatëse. Si përfundim është Britania, dhe jo Rusia autokratike apo Gjermania autoritare ajo së cilës i shkon më shumë për shtat koncepti i 'industrializimit ushtarak'.

Tabela 11.2 *Barrat (reale) të krahasuara për mbrojtjen e fuqive të mëdha europiane gjatë fazave të tyre respektive të industrializimit<sup>a</sup>*

	Mbr. e Bash. 1715-1850	Franca 1840-1913	Gjermania <sup>b</sup> 1850-1913	Italia 1860-1913	Austria 1870-1913	Rusia 1860-1913
D1	7	3.7	3.8	3.4	3.1	4.7
D2	14	c. 4.5	3.8	c. 4.0	c. 3.5	c. 6.5

*Shënime:* <sup>a</sup> Datat e industrializimit të ofruara këtu janë vetëm përafrime.

<sup>b</sup> Të dhënat për Prusinë mes viteve 1850-1871. Të vihet re se D1 dhe D2 të Gjermanisë janë të njëjta, sepse pagesat e interesit nuk mund të çintegroheshin. Megjithatë, D1 janë pak të inflacionuara.

*Burimi:* Llogaritur nga të burimet e dhëna te John M. Hobson, *The Wealth of States* (Cambridge: Cambridge University Press, 1997), fq. 284-290.

### ***Borxhi më i lartë kombëtar në botë***

Ideja popullore është se një nga kontributet madhore të shtetit liberal britanik ka qenë sigurimi i buxheteve të balancuara. Kjo pikëpamje është një mit, duke qenë se midis viteve 1688 dhe 1815, borxhi publik i grumbulluar ishte në shifrat kolosale 180% të të ardhurave kombëtare.<sup>625</sup> Përmasat e borxhit kombëtar të Britanisë mund të vlerësohen vetëm duke i krahasuar me ato të vendeve të ndryshme që përgjithësisht mendohet se kanë patur borxhe të larta. Borxhi kombëtar i Ruisë cariste në vitin 1914 ishte 47% e të ardhurave kombëtare, kurse në Gjermaninë e Wilhelm-it në vitin 1913 ishte 9%. Një tjetër krahasim domethënës është se në vitin 1900, borxhi federal i Shteteve të Bashkuara ishte sa 59% e të ardhurave kombëtare.<sup>626</sup>

<sup>625</sup> Linda Weiss dhe John M. Hobson, *States and Economic Development* (Cambridge: Polity, 1995), fq. 115.

<sup>626</sup> *Economic Report of the President* (Washington, DC: United States Government Printing Office, 1996), fq. 367.

### *Taksa të larta e të padrejta*

Shteti britanik mendohet t'i ketë mbajtur taksat të ulëta (për t'u dhënë mundësinë kapitalistëve të kursejnë, të investojnë e të grumbullojnë) dhe njëkohësisht të drejtë për të mos i penalizuar masat. Kjo është shumë e rëndësishme pasi na thuhet se shtetet me zhvillim të vonë, despotike e intervencioniste, priren të vendosin taksa tejet regresive (domethënë taksa të tërthorta) të cilat i penalizojnë grupet me të ardhura të ulëta, me qëllimin për të nxjerrë një teprice që mund të përdoret për të mundësuar investim industrial.

Prandaj është befasuese të shihet se taksat regresive (domethënë barra e tërthortë fiskale) përbënte diç më pak se 10% të të ardhurave kombëtare të Britanisë mes viteve 1715 dhe 1815. Kjo shifër ia kalonte si Ruisë autokratike (8%) në fazën e saj të industrializimit, ashtu dhe Kinës së dinastive Ming dhe Çing (shih kap. 3). Kurse në periudhën 1715-1850, taksat e tërthorta të Britanisë përbënin jo më pak se 66% të të ardhurave të qeverisë qendrore, ndërkohë që taksat e drejtpërdrejta përbënin vetëm 18%. Jo më pak domethënës është fakti së në Britani, rritja e taksave për grupet me të ardhura të ulëta i kalonte fitimet e tyre, kurse nën autokracinë cariste, rritja e të ardhurave të fshatarësisë e kalonte rritjen e barrës së saj fiskale.<sup>627</sup> Për më tepër, taksat e tërthorta ishin të lidhura ngushtë me despotizmin, militarizmin dhe proteksionizmin britanik.

### *Sistemi britanik i proteksionizmit kombëtar: despotizëm, militarizëm dhe taksim regresiv*

Imazhi konvencional që kemi për Britaninë gjatë industrializimit të saj, mbi të gjitha është imazhi i një vendi koz-

<sup>627</sup> J. V. Beckett dhe Michael Turner, "Taxation and Economic Growth in Eighteenth Century England", *Economic History Review*, 43 (3) (1990), 377-403; Paul Gregory, *Russian National Income, 1885-1913* (Cambridge: Cambridge University Press, 1982), fq. 130-132, 193.

mopolit ose liberal dhe me tregti të lirë. Pa dyshim, ajo çka e ka krijuar këtë imazh është shfuqizimi i Ligjeve të Corn-it në vitin 1846. Por problemi i që nxjerr krye sakaq është ai i kronologjisë: tregtia e lirë erdhi vetëm në fund të procesit të industrializimit. Ta zgjerosh këtë pas në kohë për t'i dhënë një lustër *laissez-faire*-i shtetit britanik në periudhën e industrializimit, është anakroniste. Tabela 11.3 më poshtë na tregon arsyen pse është kështu, duke nxjerrë në pah faktin se tarifat britanike ishin domethënëse si për nivelin e tyre shumë të lartë, ashtu dhe për faktin se ua kalonin tarifave të të gjitha shteteve europiane në fazat përkatëse të industrializimit. Shifrat britanike në fazën kulmore industriale (1800-45) ishin rreth gjashtë herë më të larta se ato që vilte Gjermania, e përfytyruar si proteksioniste, gjatë fazës së saj të industrializimit dhe një e gjysmë më të larta se ato të Rusisë (e cila zakonisht mendohet të ketë qenë shteti i industrializuar kryeproteksionist i Europës).

Tabela 11.3 *Tarifat mesatare në vendet europiane gjatë fazës së industrializimit*<sup>a</sup>

MB 1700-99	MB 1800-45	Franca 1840-1913	Gjermania <sup>b</sup> 1850-1913	Aus.-Hun. 1860-1913	Italia 1860-1913	Rusia 1870-1913
27	40	10	7	12	11	26

*Shënime:* <sup>a</sup> Të vihet re se të gjitha shifrat janë tarifa mesatare mbi të gjitha importet (dhe jo vetëm mbi importet e taksueshme) dhe janë llogaritur duke marrë proporcionin e të ardhurave doganore si përqindje të të gjitha importeve.

<sup>b</sup> Të dhënat e Prusisë për vitet 1850-1871.

Burimet: për Britaninë: Weiss dhe Hobson, *States*, f. 124. Për Gjermaninë dhe Rusinë: Hobson, *Wealth of States*, f. 284-90. Për Francën: J. V. Nye, 'The Myth of Free-Trade Britain and Fortress France: Tariffs and Trade in the Nineteenth Century', *Journal of Economic History* 51 (1) (1991), 26. Për Austro-Hungarinë dhe Italinë: Brian R. Mitchell, *International Historical Statistics: Europe, 1750-1993* (London: Macmillan, 1998).

Përshkallëzimi i tarifave të Britanisë pas viteve 1790, dhe sidomos pas vitit 1815, është mjaft domethënës për dy arsye. Së pari, kjo ndodhte në një kohë kur rritja ekonomike jo vetëm po rritej, por po 'fluturonte' (shih pjesën në vazhdim). Së dyti, problematizon pikëpamjen tradicionale që pohon se pas 1800-ës Britania priu rrugën për sa i përket liberalizimit të tarifave në atë masë sa shfuqizimi i Ligjit të Corn-it në vitin 1846 që i pashmangshëm. Por rritja e tarifave pas vitit 1815 'u bë aq shumë më e rëndë në peshë dhe në efekt ... sa praktikisht ato përbënë një sistem të ri'.<sup>628</sup> Kësisoj mes viteve 1800 dhe 1809, tarifat mesatare u rritën në 36%; mes viteve 1810 dhe 1819 u rritën në 44% dhe mes viteve 1820 dhe 1829 arritën kulmin me 55%. Megjithatë, deri mes viteve 1830-1839 tarifat mbetën të larta deri në 38%. Kjo shifër e fundit është domethënëse pasi në asnjë pikë në kohë asnjë shtet tjetër europian nuk ka vjelë një përqindje kaq të lartë gjatë fazës së tij industriale. Për më tepër, në vitin 1840, jo më pak se 1146 sende kishin tarifa.

Domethënës është fakti se pikërisht sipas stilit tipik 'despotik', kjo politikë fiskale nuk kishte ndonjë arsye të fortë ushtarake, por shteti e shtrydhte ekonominë në përgjithësi dhe masat në veçanti për të vjelë taksa të tërthorta tregtie për të financuar militarizmin britanik. Të ardhurat nga tarifat përbënin 2.6% të të ardhurave kombëtare dhe 37% të shpenzimeve ushtarake (D1) mes viteve 1715 dhe 1790. Tarifat u ngritën më shumë akoma për të financuar luftat kundër Napoleonit, duke përbërë 3.8% të të ardhurave kombëtare dhe 25% të shpenzimeve ushtarake (D1) midis viteve 1790-1815. Ato u rritën sërish progresivisht pas 1815-ës për të financuar interesat masive të borxheve kombëtare, të cilat qenë rritur si pasojë e militarizmit të vazhdu-

<sup>628</sup> Albert H. Imlah, *Economic Elements in the Pax Britannica* (Cambridge, Mass.: Harvard University Press, 1958), fq. 115.

eshëm gjatë njëqind e njëzet viteve të mëparshme. Mes viteve 1815-50, të ardhurat doganore përbënin 4.6% të të ardhurave kombëtare dhe 70% të interesit vjetor të paguar (ndërkohë që interesat përbënin pak më shumë se 50% të shpenzimeve të qeverisë qendrore). Veç kësaj, edhe mes viteve 1850-1913, të ardhurat nga tarifat regresive përbënin deri në 2% të të ardhurave kombëtare dhe 60% të shpenzimeve ushtarake.

Në procesin e financimit të militarizmit britanik, rreth 60% e të gjitha lëndëve të para taksoheshin përmes tarifave, ndërkohë që shumë prej tyre ishin jetike për industrinë britanike. Kjo gjë e rriste çmimin e prodhimeve britanike të eksportit, duke i bërë ato më pak konkurruese jashtë. Për t'i kënaqur ata industrialistë që dëmtoheshin nga tarifat mbi lëndët e prodhimit, shteti krijoi një sistem rregullator mjaft kompleks, që përfshinte dhurata, rikthime të pagesave doganore dhe ulje. Në fund fare këtij sistemi rregullator proteksionist iu shtuan shtresa të tjera rregullacioni. Një tjetër shtresë rregullacioni akoma iu shtua këtij pingu proteksionist në formën e Akteve të Lundrimit. Marrë në tërësi, është e qartë se rregullacionet ishin përcaktuese më shumë se *laissez-faire*-i gjatë revolucionit industrial britanik.

Për t'u shënuar gjithashtu është se, në një aspekt kritik, 1846-a nuk shënoi kthimin e Britanisë drejt tregtisë së lirë. Mes viteve 1846-1860, tarifat britanike mbetën në një 20%-ësh të shëndoshë, mes viteve 1860-1879 qenë në shifrën e konsiderueshme 10% dhe vetëm në periudhën e vonë 1880-1913 ranë në shifrën modeste prej 6%. Është e vërtetë se pas 1846-ës shumica e këtyre importeve të tarifuar nuk prodhoheshin në Britani (prandaj nuk kishte arsye proteksioniste për tarifimin e tyre). Por ato kishin një ndikim tejet negativ mbi prodhuesit kolonialë (shih më poshtë) si dhe konsumatorët britanikë të klasës punëtore. Për më tepër, të

ardhurat nga taksimi progresiv mbi pronën dhe të ardhurat arritën t'i tejkalonin në mënyrë të qëndrueshme të ardhurat doganore vetëm pas vitit 1911. Në studimin e tij klasik *Imperialism*, stërgjyshi im John A. Hobson me të drejtë argumentonte se militarizmi dhe imperializmi kontinental kanë lulëzuar përmbi taksimin e tërthortë dhe proteksionizmit tarifor.<sup>629</sup> Por ajo çka ai nuk e ka vlerësuar sa duhet, është se ky konkluzion ka vlejtur jo më pak për Britaninë deri në vitin 1911. Gjatë (dhe pas) fazës kryesore të industrializimit qenë kryesisht masat pa të drejta ato që mbajtën peshën më të madhe të barrës fiskale të militarizmit dhe proteksionizmit britanik.

Ideja thuajse universale se shteti britanik, ose *Pax Britannica*, me synim të qartë e shtyu Europën kontinentale të përvetësonte tregtinë e lirë, ka gjithashtu nevojë për rishikim. Qëndrimet britanike për sa i përket mbështetjes së tregtisë së lirë kontinentale të bëjnë përshtypje vetëm për indeferencën e tyre. Së pari, tregtia e lirë europiane nuk u arrit në dekadat e mesme të shekullit të nëntëmbëdhjetë. Në fakt, në vitin 1875 (në kulmin e 'epokës së liberalizimit') tarifat mesatare mbi manifakturat ishin 10% për Europën dhe 14% nëse përfshijmë edhe Shtetet e Bashkuara (shih kap. 12). Më e mira që mund të thuhet për këtë periudhë është se ishte një epokë 'tregtie më të lirë' (ose më saktë, epokë proteksionizmi të moderuar). Së dyti, Europës do t'i duhej të priste marrëveshjen Cobden-Chevalier të 1860-ës para se të fillonte të lëvizte drejt 'tregtisë më të lirë'. Në fakt, qe Franca ajo që mori përsipër një rol veçanërisht të spikatur në promovimin e këtij ndryshimi.<sup>630</sup> I rëndësishëm

<sup>629</sup> John A. Hobson, *Imperialism* (London: George Allen and Unwin, 1968 [1902]), fq. 98-109.

<sup>630</sup> J. V. Nye, "The Myth of Free Trade Britain and Fortress France: Tariffs and Trade in the Nineteenth Century", *Journal of Economic History* 51 (1) (1991), 23-46.

është fakti se Richard Cobden në fillim e refuzoi propozimin e hedhur nga Chevalier. Më ironikja është se Cobden-i

akoma kishte pikëpamjen se të gjitha kombet duhet të lihen ta rregullojnë politikën e tyre fiscale [komerciale] sipas interesave vetjake, pa u kufizuar nga marrëveshjet me vendet e tjera dhe se Britania në veçanti, pasi kishte pranuar Tregtinë e Lirë, duhej të shmangte çdo rregullim tarife me një vend tjetër.<sup>631</sup>

Gjithashtu është veçanërisht ironik fakti se William Gladstone nuk e pengoi përfundimin e marrëveshjes me Francën në vitin 1872. Qëndrimin e tij e përfaqësoi Lord Lyons, 'i cili i tha Duc de Broigle-it se Britania qe ngopur me marrëveshje tregtie dhe se ai besonte në lirinë e çdo vendi për të caktuar tarifën e veta, të nënshtrueshme vetëm ndaj sigurisë së tregtisë britanike'.<sup>632</sup> Nëse kjo e fundit nënkuptonte tarifa më të ulëta, do të ishte e favorshme; nëse jo, shumë keq. Për më tepër, duke folur për Gladstone-in, Sir Louis Mallet, 'vuri në dukje se kurrë nuk kishte shërbyer në një qeveri kaq jodashmirëse, madje armiqësore, ndaj "politikës së tregtisë së lirë në kuptimin më të gjerë" [dhe u ankua se ajo] e kishte rrënuar tërë punën e tij në Bordin e Tregtisë'.<sup>633</sup>

Prova e kësaj indiference, në mos armiqësie, ndaj promovimit të tregtisë së lirë europiane, qëndron në dy tregues të thjeshtë: së pari, Britania nuk bëri asgjë për ta ndaluar zhvendosjen kontinentale mbrapsht drejt proteksionizmit pas 1877/79-ës. Sido që të jetë, qëndrimi i saj i njëanshëm ndaj tregtisë ia kufizoi mundësinë për ta përmbajtur proteksionizmin kontinental, ashtu si edhe natyra e dobët insti-

<sup>631</sup> D. C. M. Platt, *Finance, Trade, and Politics in British Foreign Policy 1815-1914* (Oxford: Clarendon Press, 1968), fq. 87.

<sup>632</sup> Platt, *Finance*, fq. 89.

<sup>633</sup> Sir Louis Mallet, cituar te Platt, *Finance*, fq. 89.

tucionale e të ashtuquajturit regjimi britanik i tregtisë ndërkombëtare. Së dyti, është fakt se qeveria britanike kishte negociuar shumë pak marrëveshje me fuqi të tjera kontinentale gjatë së ashtuquajturës epokë e tregtisë së lirë. Kësisoj, në vitet 1860 Italia negocioi njëzet e katër marrëveshje të tilla, Belgjika dhe Franca nga nëntëmbëdhjetë secila, Gjermania tetëmbëdhjetë, Austro-Hungaria katërmëdhjetë kurse Britania tetë.

Si përfundim, përshkrimi i zakonshëm që i bëhet industrializimit britanik si i ngritur mbi *laissez-faire*-in, sado i përhapur të jetë, prapëseprapë mbetet një mit. Taksat britanike, tarifat, deficitet buxhetore, borxhi kombëtar dhe shpenzimet ushtarake shquheshin vetëm për nivelet e tyre të larta. Pyetja që lind është: a ishte e gjitha kjo thjesht rastësore, apo mes niveleve të tilla të theksuara të intervencionizmit shtetëror dhe industrializimit kishte ndonjë marrëdhënie shkakësore? Pjesa vijuese shtjellon se bëhej fjalë për këtë të fundit.

### **Lufta, zhvillimi i vonë dhe shteti intervencionist e despotik**

#### *Militarizmi, shteti intervencionist dhe krijimi proaktiv i kapitalit financiar*

Zhvillimi i kapitalit financiar në themel mbështetej në politikat proaktive të shtetit britanik, kryesisht të ndërmarra për të financuar militarizmin britanik. Me përshkallëzimin e shpenzimeve ushtarake pas 1688-ës, qeveritë ishin të detyruara të mbështeteshin në huara. Për të gjetur huatë e nevojshme shteti ndërmori 'revolucionin financiar'.<sup>634</sup> Në vitin 1694 u themelua Banka e Anglisë, me qëllimin për të

<sup>634</sup> P. G. M. Dickson, *The Financial Revolution in England* (London: St Martin's Press, 1967).

organizuar huatë shtetërore të luftës në tregun kapital të Londrës. Përgjatë tërë shekullit të gjatë të tetëmbëdhjetë (1688-1815) bonot shtetërore siguruan një kanal të fuqishëm për rrjedhjen e kapitalit të Qytetit të Londrës. Veç kësaj, shërbimet e zgjeruara të kapitalit që ofronte Qyteti dhe fitimet e tij të padukshme lehtësuan industrializimin e Britanisë dhe njëkohësisht siguruan një balancë pozitive pagesash. Këto fitime të padukshme ishin jetike po të marrim parasysh se midis viteve 1796 dhe 1931 balanca tregtare ka qenë çdo vit në deficit.<sup>635</sup> Kjo situatë jo vetëm ndryshonte dukshëm me tepricat historike tregtare të Kinës, por gjithashtu vlen të vihet në dukje se gjatë shekullit të nëntëmbëdhjetë Britania kurrë nuk iu afrua Kinës as për sa i përket nxjerrjes së prodhimit botëror manifakturore, as për sa i përket pjesës së prodhimit botëror që kjo e fundit kishte arritur mes viteve 1750-1830.<sup>636</sup>

Shteti britanik gjithashtu ndërhyri për të vendosur një treg të integruar kapitali, sërish kryesisht për qëllime fiskalo-ushtarake.<sup>637</sup> Gjatë luftrave të Napoleonit, shteti themeloi Bursën e Londrës për të racionalizuar shitjen e bonove shtetërore. Kjo në të njëjtën kohë nxiti rritjen e bankave rajonale. Në tërësi pak dyshime mund të ketë se borxhi kombëtar i Britanisë ishte një nga ushqyesit kryesorë të financave publike dhe private në shekullin e tetëmbëdhjetë dhe në gjysmën e parë të shekullit të nëntëmbëdhjetë. Kjo gjë askund nuk konfirmohet më shumë sesa në politikën e nënkuptuar të ‘kursimeve të detyruara’.

<sup>635</sup> Imlah, *Economic Elements*, fq. 70-75; Phyllis Deane dhe W. A. Cole, *British Economic Growth 1688-1959* (Cambridge: Cambridge University Press, 1969), fq. 37.

<sup>636</sup> Paul A. Bairoch, “International Industrialization Levels from 1750 to 1980”, *Journal of European Economic History* 11 (2) (1982), 296; Angus Maddison, *Monitoring the World Economy* (Paris: OECD, 1995), fq. 30, 182-190.

<sup>637</sup> Weiss dhe Hobson, *States*, fq. 118-119; P. K. O'Brien, “The Impact of the Revolutionary and Napoleonic Wars, 1793-1815, on the Long-Run Growth of the British Economy”, *Review* 12 (3) (1989), 349-350.

### *Militarizmi, despotizmi dhe kursimet e detyruara*

Këtu unë marr në trajtim politikën e Britanisë për 'kursimet e detyruara' (tradicionalisht e bashkëshoqëruar me regjimet autokratike ose staliniste). Kjo lloj politike kërkon që shteti të vendosë taksa të larta mbi grupet me të ardhura të ulëta me qëllimin për të shtrydhur të ardhura të mjaftueshme për investim në industrializim. Dallimi i dukshëm midis programeve britanike dhe staliniste ishte se shteti sovjetik i investonte të ardhurat drejtpërdrejt, kurse Britania tërthorazi. Në thelb, shteti britanik i rishpërndante fondet nga klasat e varfra konsumatore tek investitorët e pasur financiarë, të cilët i përdornin për të investuar në ekonomi.

Më lart vumë në dukje se shteti britanik financoi një pjesë të mirë të shpenzimeve ushtarake përmes huave të marra nga tregu i kapitalit i Londrës. Në thelb shteti u paguante kamatë investitorëve të pasur financiarë me taksa regresive të tërthorta të vjela kryesisht nga grupet me të ardhura të ulëta, duke i rishpërndarë kësisoj të ardhurat nga të varfrit (konsumatorët) tek shumë të pasurit (kursyesit dhe investitorët). Vlerësimi im është se rreth 80% të të gjitha huave janë marrë nga tregu i kapitalit i Londrës (dhe 20% nga tregu i kapitalit i Amsterdami).<sup>638</sup> Çka do të thotë se rreth 80% të totalit të interesave të paguara nga shteti ka përfunduar drejt e në duart e investitorëve të Qytetit të Londrës. Duke patur parasysh regresivitetin e taksimit, besoj se 50-60% të interesave janë paguar nga grupet me të ardhura të ulëta. Mbi këtë bazë llogaris se gjatë periudhës 1715-1850 rreth 5% e të ardhurave kombëtare në total janë bartur nga klasa e varfër punëtore dhe konsumatorët e klasës së ulët e të mesme tek investitorët e pasur financiarë. Këto janë shifra tronditëse (të barazvlefshme me thuajse dy-

<sup>638</sup> Përlllogaritur nga Stefan Oppers, "The Interest Rate Effect of Dutch Money in Eighteenth Century Britain", *Journal of Economic History* 53 (1) (1993), 25-43.

fishin e shumës së shpenzuar nga Britania për mbrojtjen mes viteve 1850-1913). Veç kësaj, shumat e rishpërndara gjatë luftrave të Napoleonit ishin pak më poshtë se 9% e të ardhurave kombëtare (çka, sipas një eksperti, mundësoi dyfishimin e investimeve private).<sup>639</sup> Nuk është befasues fakti se shekulli i tetëmbëdhjetë pa një shtrydhje të konsumit, kurse kursimet dhe investimet u rritën mjaft, duke i shërbyer kësajsoj ngritjes së normës së rritjes ekonomike.<sup>640</sup>

Në këtë mënyrë, duket e qartë se shteti praktikisht ka implementuar një politikë tejet të suksesshme të kursimeve të detyruara. Kjo e vë në dyshim besimin konvencional dhe e kundërshton pretendimin e Peter Mathias-it se 'shteti në të vërtetë bëri shumë pak për të promovuar ... investimin, [ose] për të vënë në lëvizje kapital për investim në prodhim ... [drejtpërdrejt ose] tërthorazi'.<sup>641</sup> Shumat e rishpërndara janë tronditëse. Gati 40% e të gjitha taksave të qeverisë qendrore u rishpërndanë nga të varfrit tek të pasurit (krahasueshëm me shumat e rishpërndara nga shtetet keqneziane të mirëqenies të pasluftës).

### *Proteksionizmi tarifor dhe zhvillimi i vonë*

Politika proteksioniste britanike lidhej gjithashtu me procesin e zhvillimit të vonë. Supozimi standard është se Britania ishte një 'vend me zhvillim të hershëm' dhe ka gëzuar 'avantazhet e pionieres', domethënë nuk është ballafaquar me ndonjë konkurrencë të jashtme domethënëse dhe prandaj nuk e ka ndjerë nevojën për intervencionizëm dhe proteksionizëm shtetëror. Por Britania u ballafaqua me konkurrencë të jashtme, veçanërisht në industrinë boshtore të

<sup>639</sup> O'Brien, "Impact", 346 dhe 345-357.

<sup>640</sup> N. F. R. Crafts, *British Economic Growth during the Industrial Revolution* (Oxford: Clarendon Press, 1985), fq. 62-63; Weiss and Hobson, *States*, fq. 120-121.

<sup>641</sup> Mathias, *First Industrial Nation*, fq. 32-33.

tekstil-pambukut dhe të hekurit. Që nga shekulli i shtatëmbëdhjetë e tutje Britania do të mbushej me tekstile indiane të cilësisë së lartë me dhe çmime të ulëta.

Industria britanike e pambukut u zhvillua në stil tipik zhvillimi të vonë nëpërmjet 'industrializimit me zëvendësim importesh' (si dhe përmes skllavërisë – shih pjesën 3 më poshtë).<sup>642</sup> Importimi i basmës së ngjyrosur u ndalua në dy faza, më 1701 dhe 1721. Për më tepër, në stil klasik zhvillimi të vonë, britanikët i kopjuan dhe rafinuan teknologjitë e teknikat indiane për të ulur kostot dhe për të rritur konkurrencën.<sup>643</sup> Ose, siç e ka shprehur saktë Braudel, përballë dyndjes së tekstileve indiane:

Hapi i parë i Anglisë që mbyllja e kufinjve të saj në pjesën më të madhe të shekullit të tetëmbëdhjetë ndaj tekstileve indiane ... Pastaj ajo u përpoq ta bënte të vetin këtë treg me fitimprurës, çka mund të arrihej vetëm duke bërë reduktime drastike në krahun e punës. Pa dyshim nuk është rastësi që revolucioni mekanik nisi në industrinë e pambukut.<sup>644</sup>

Konkretisht, konkurrenca indiane nxititi 'shpikjen' e makinës tjerresë të Wyatt-it dhe Paul-it (1738), të tjerresës me ujë të Arkwright-it (1767) dhe të tjerresit hibrid të Crompton-it (1779), të cilat bënë të mundur prodhimin e një filli që mund të matej me prodhimin indian.<sup>645</sup> Pati gjithashtu përhapje të drejtpërdrejtë si dhe imitim të vetëdijshëm të pro-

<sup>642</sup> Joseph Inikori, "Slavery and the Revolution in Cotton Textile Production in England", te J. E. Inikori dhe S. Engerman (red.), *The Atlantic Slave Trade* (London: Duke University Press, 1992), kapitulli 6.

<sup>643</sup> Kenneth Pomeranz, *The Great Divergence* (Princeton: Princeton University Press, 2000), fq. 53.

<sup>644</sup> Fernand Braudel, *Civilization and Capitalism, 15th-18th Century*, III (Berkeley: University of California Press, 1992), fq. 522.

<sup>645</sup> K. N. Chaudhuri, *The Trading World of Asia and the English East India Company 1660-1760* (Cambridge: Cambridge University Press, 1978), fq. 273 e më tej.; Braudel, *Civilization*, III, fq. 566-567, 572.

dhimeve dhe teknikave indiane, sidomos për sa i përket procesit të ngjyrosjes së tekstilit.<sup>646</sup> Megjithatë, vetëm në vitet 1840 britanikët do të mund të arrinin cilësinë e ngjyrosjes indiane si në *bandanna*-të e tyre (shami mëndafshi). Një histori e ngjashme karakterizon edhe industrinë tjetër madhore britanike, hekurin. Siç u vu në dukje në kapitujt e mëparshëm, hekuri dhe çeliku britanik mbetën inferiorë ndaj atyre të prodhuar në Indi deri në shekullin e nëntëmbëdhjetë e në të. Por britanikët arritën të dilnin në krye duke vendosur tarifa të larta mbi importet indiane të hekurit dhe duke imponuar tregtinë e lirë më vonë brenda Indisë (shih më poshtë).<sup>647</sup> Kësisoj, mbrojtja e dy industrive kyçe ishte thelbësore nëse do të bëhej fjalë për ndonjë mundësi rritjeje përballë konkurrencës superiore të Lindjes.

Jo më pak i rëndësishëm këtu është fakti se shteti britanik vuri në zbatim një lloj 'politike tregtie strategjike' (zakonisht e bashkëshoqëruar me vende të industrializuara rishitas, si Koreja e Jugut, Tajvani e Japonia pas 1945-ës).<sup>648</sup> Kjo politikë parashikon që shteti t'u ofrojë lehtësi fiskale prodhuesve të cilët i eksportojnë prodhimet e tyre. Pas 1721-shit shteti britanik qëllimisht i promovoi eksportet duke u ofruar zbritje për lëndët e para të importuara atyre prodhuesve të cilët e eksportonin prodhimin përfundimtar. Veç kësaj, taksat mbi eksportet u hoqën dhe u zëvendësuan me shpërblime mbi eksportin, të cilat i bënë eksportet tesktilë britanike më konkurruese në botë. Interesante gjithashtu është se përqindja e prodhimeve industriale britanike të eksportuara pas 1750-ës, është e ngjashme me atë të Koresë së Jugut gjatë periudhës së saj të 'industrializimit me bazë

<sup>646</sup> A. P. Wadsworth dhe J. Mann, *The Cotton Trade and Industrial Lancashire, 1600-1780* (Manchester: Manchester University Press, 1931), fq. 124-128.

<sup>647</sup> Arnold Pacey, *The Maze of Ingenuity* (London: Allen Lane, 1974), fq. 278-282.

<sup>648</sup> Ha-Joon Chang, *Kicking Away the Ladder* (London: Anthem, 2002), fq. 22.

eksporti'.<sup>649</sup> Megjithatë, do të ishte e gabuar të mendohej se reforma e 1721-shit shënoi fillimin e një qëndrimi të kulluar racional ekonomik, kryesisht sepse tarifat vazhduan të përdoshin si një armë fiskale në arsenalin e shtetit.

Kësisoj, kemi parë se ndryshe nga çdo version popullor, shteti britanik ka zbatuar një program tejet intervencionist e represiv i cili në masë të madhe e ka bërë të mundur industrializimin në kurriz të klasës punëtore (domethënë, aspekti i brendshëm i anës së errët të industrializimit britanik). Tani do t'i kthehem shpalosjes së anës së errët në kontekstin global. Kjo shpalosje njëkohësisht përgënjeshtrohet qëndrimin e përgjithshëm eurocentrik se industrializimi britanik ka qenë një proces i brendshëm i bazuar në ndryshimin e vetëgjeneruar.

### **Racizmi, industrializimi dhe kontradikta morale e misionit imperial civilizues të Britanisë**

Ndërsa kapitulli 9 u mor me përvetësimin e 'kapaciteteve burimore' kineze në ngritjen e industrializimit britanik, kjo pjesë përqendrohet në përvetësimin racisto-imperial të burimeve lindore, që bëri të mundur përparimin e Britanisë. Fernand Braudel e ka vënë në dukje origjinën e jashtme – më saktë imperiale – të industrializimit britanik duke bërë këtë pyetje mahnitëse retorike:

Nëse kontinenti i vogël i Europës do të lihet i lirë të pluskonte në detrat dhe dherat e Azisë, do të zhdukej nga sytë ... Tashmë nga e gjitha bota ... [Britania] po merrte një pjesë të madhe të fuqisë dhe përmbajtjes së saj. Që kjo pajë e tepërt ajo që i dha mundësinë [Britanisë] të arrinte lartësi [të reja] në kapërcimin e sfidave me të cilat

<sup>649</sup> Joseph E. Inikori, *Africans and the Industrial Revolution in England*(Cambridge: Cambridge University Press, 2002), fq. 151-155.

u ndesh në rrugën e progresit. A do të kishte qenë revolucioni industrial [i Britanisë] – çelësi i fatit të saj – i mundur në fund të shekullit të tetëmbëdhjetë pa këtë ndihmë të vazhdueshme? Çfarëdo përgjigjeje t'i japin historianët kësaj pyetjeje, kjo e fundit duhet bërë.<sup>650</sup>

Këtu unë i përgjigjem negativisht pyetjes së Braudel-it. Gjithashtu theksoj se imperializmi qe produkt i 'racizmit të nënkuptuar' të identitetit britanik të konceptuar gjatë shekujve të tetëmbëdhjetë e nëntëmbëdhjetë (shih kap. 10). Për më tepër, analiza ime e sheh impaktin kulturor të imperializmit mbi shoqëritë lindore jo vetëm si të rëndësishëm, por shpesh si më të rëndësishëm se impakti ekonomik (çka nuk e zvogëlon impaktin ekonomik negativ). Megjithatë kjo pjesë, ashtu si dy të fundit, bie fundamentalisht ndesh me historinë e ekonomisë liberale e cila është përpjekur ta anashkalojë plotësisht këtë kontribut të jashtëm në industrializimin britanik. Interesant këtu është riafirmimi i eurocentrizmit nga Patrick O'Brien kur i përgjigjet argumentit të Braudel-it:

Braudel-i gjente kënaqësi tek pyetjet e mëdha, por lidhjet që shkojnë nga ekonomia botërore tek revolucioni industrial nuk janë kurrsesi aq të forta sa ta dobësojnë seriozisht praninë e 'konsensusit eurocentrik' se burimet e këtij të fundit duhet kërkuar brenda kontinentit e jo jashtë tij ... Për historinë e industrializimit europian (madje edhe britanik), 'perspektiva botërore' për Europën shfaqet më pak e rëndësishme se 'perspektiva europiane' për botën.<sup>651</sup>

Kjo pjesë ofron të dhëna të hollësishme empirike që nxjerrin në pah origjinat afro-aziatike të industrializimit britanik, duke riafirmuar 'perspektivën botërore' të Braudel-it.

<sup>650</sup> Braudel, *Civilization*, III, fq. 386-387.

<sup>651</sup> P. K. O'Brien, "The Foundations of European Industrialization: from the Perspective of the World", *Journal of Historical Sociology* 4 (3) (1991), 305, 311.

*Kontradiktat e tregtisë së lirë imperiale:  
njollojja karshi shndërrimit kulturor*

Në kapitullin 10 vumë në dukje se në 'misionin civilizues' imperial kishte një kontradiktë fundamentale: ky shndërrim kulturor që dizenuar për 't'i ngritur popujt lindorë' në nivelet e qytetërimit britanik (pjesa civilizuese e misionit), kurse strategjia e përmbajtjes synonte t'i mbante poshtë ekonomitë e tyre. Gjithashtu vumë në dukje se paradoksalisht, kjo kontradiktë logjikisht rridhte nga retorika raciste e perandorisë që britanikët kishin krijuar. Të dyja linjat u bashkuan duke qenë se përbënin mënyrat për glorifikimin e civilizimit britanik. Ky shndërrim kulturor (etnocid ose shfarosje e identitetit/kulturës lindore) i shërbente këtij qëllimi pasi nënkuptonte perëndimizimin ose anglicizimin e botës. Kurse përmbajtja siguronte që ekonomia britanike të mbetej e pasfiduar si fuqia udhëheqëse e botës. Kjo është historia në zemër të diskutimit tonë këtu.

Kontradikta morale e misionit civilizues ndoshta nuk ka qenë askund më e dukshme sesa në politikën e tregtisë së lirë. Teoria pohonte se tregtia e lirë është një forcë civilizuese. Sipas Adam Smith-it dhe David Ricardo-s, tregtia e lirë ishte e mirë pikërisht sepse mbështetej mbi nocionin e 'vetëndihmesës', 'specializimit' dhe 'avantazhit krahasues' kombëtar. Ishte një proces civilizues sepse do t'i detyronte popujt e Lindjes t'i zhvillonin intensivisht ekonomitë e tyre përmes vetëndihmesës dhe 'punës së fortë' individualiste, lajtmotivi i civilizimit të përparuar. Interesante këtu është lidhja midis vetëndihmesës individualiste dhe Protestantizmit. Sepse siç na thotë Samuel Smith, 'Qielli i ndihmon ata që ndihmojnë veten'. Ideologjia e tregtisë së lirë u përhap me shpejtësi në shoqërinë britanike. Richard Cobden, për shembull, e shpalli mesazhin e tregtisë së lirë si, 'ilaçi i madh universal i cili, si një zbulim i dobishëm mjekësor, do

të shërbejë për t'i injektuar të gjitha kombet e botës me pasuri dhe me shijen shpëtuese për qytetërim'.<sup>652</sup> Ose, siç e shprehte në një letër për Dufour-in, 'Tregtia e Lirë është diplomacia e Zotit dhe nuk ka rrugë tjetër të sigurt për t'i lidhur popujt me fijet e paqes'.<sup>653</sup> Pastaj, sigurisht, ishte edhe epigrama i Dr. John Bowring-ut se, 'Jezu Krishti është tregtia e lirë dhe tregtia e lirë është Jezu Krishti'.<sup>654</sup> Shkurt, tregtia e lirë ishte një nga rrugët kritike për t'i ofruar botës manën e civilizimit perëndimor, jo më pak se frytet e Lindjes Perëndimit. Kjo teori ishte në përputhje me dëshirën e Britanisë për ta shndërruar Lindjen sipas linjave të Perëndimit. Megjithatë, duke marrë parasysh dritëshkurtësinë e supozuar të udhëheqësve lindorë, sigurisht që u takonte britanikëve largpamës që ta përhapnin tregtinë e lirë në mbarrë botën për të mirën e të gjithëve; kjo ishte në fakt 'detyra e tyre morale'. Por ky arsyetim përplasej me atë të aspektit më të fshehur 'përmbajtës' të imperializmit, i cili nga ana e tij mbështetej mbi një sërë standardesh të dyfishta raciste.

Shndërrimi kulturor dhe përmbajtja e Lindjes përmes imperializmit të tregtisë së lirë manifestohej në shumë mënyra. Së pari ishte imponimi i marrëveshjeve të pabarabarta, që përbënin mjetin me anë të të cilit britanikët do të 'përhapnin bekimin e civilizimit'. Këto marrëveshje iu 'ofruan' shumë vendeve 'joperëndimore', si Brazili (1810), Kina (1842-1858), Japonia (1858), Siami (1824-1855), Persia (1836, 1857) dhe Perandoria Osmane (1838, 1861). Këto marrëveshje i zhveshnin vendet nga autonomia tarifore dhe zakonisht i kufizonin tarifat në 5%. Standardi i parë i dyfishtë racist këtu del në pah nga fakti se gjatë të ashtuquajturës

<sup>652</sup> Richard Cobden, cituar te Ronald Hyam, *Britain's Imperial Century, 1815-1914* (London: Batsford, 1976), fq. 56.

<sup>653</sup> Cobden, cituar te Platt, *Finance*, fq. 88.

<sup>654</sup> Bowring, cituar te Eric Williams, *Capitalism and Slavery* (London: Andre Deutsch, 1944), fq. 136.

epokë e tregtisë së lirë të mesit të shekullit të nëntëmbëdhjetë, shtetet europiane iu nënshtruan ‘marrëveshjeve reciproke’ të negociuara lirisht midis ‘partnerëve kontraktualë’. Kjo ndryshonte qartazi me marrëveshjet ‘me dyer të hapura’ të imponuara Lindjes (kryesisht vendeve në Divizionin 2). Për më tepër, indiferenca britanike për ta përhapur tregtinë e lirë në Europë dallonte kryekëput me imponimin me forcë të tregtisë së lirë në botën ‘joeuropiane’. Dhe më përgjithësisht, qëndrimi ushtarak pasiv i Britanisë kundrejt Europës kontinentale pas vitit 1815 dallonte kryekëput me përdorimin e shpeshtë të dhunës nga ana e saj në Lindje.<sup>655</sup> Një tjetër standard i dyfishtë racist këtu ishte se teksa ekonomitë europiane të industrializuara përmes proteksionizmit tarifor – dhe Britania gëzonte një tarifë prej jo më pak se 32% mes viteve 1700-1850 – ekonomitë lindore detyroheshin të kalonin drejt e në tregti të lirë ose afër tregtisë së lirë. Kjo shërbente për t’i përmbajtur ekonomitë e tyre sepse ua mohohte shansin për të ngritur industrinë e tyre ende në djep.

Është veçanërisht e rëndësishme këtu që të vëmë në dukje se imponimi i marrëveshjeve të pabarabarta nuk mbështetej mbi një arsye të pastër ekonomike, por ishte gjithashtu një mënyrë më e përgjithshme nëpërmjet së cilës britanikët përpiqeshin të impononin shndërrimin kulturor. Dëmi që shkaktonte kjo gjë shpesh ishte më i madh se ai i përmbajtjes ekonomike. Mund të thuhet se aspekti më denigrues i marrëveshjeve të pabarabarta qëndronte tek çënimin në përgjithësi i sovranitetit dhe autonomisë kulturore të vendeve të Lindjes. Le të marrim si shembull Kinën. Luftrat e Opiumit dhe marrëveshjet e imponuara pas tyre rezultuan se ishin një pykë për ta hapur Kinën ndaj sulmit kulturor

<sup>655</sup> John M. Hobson, “Two Hegemonies or One? A Historical-Sociological Critique of Hegemonic Stability Theory”, te P. K. O’Brien dhe A. Clesse (red.), *Two Hegemonies* (Aldershot: Ashgate, 2002), veçanërisht fq. 307-314.

të Britanisë kundër identitetit të saj. Këto marrëveshje u cilësuan 'të pabarabarta' për tri arsye kryesore. Së pari, Kina nuk u pajtua me to dhe si përfundim ato u imponuan përmes fuqisë ushtarake britanike e perëndimore. Së dyti, u diktuan vetëm sipas interesave perëndimore në çënim të sovranitetit dhe pavarësisë kulturore të Kinës. Së treti, ato simbolizonin ndjesinë kineze të poshtërimit dhe padrejtësisë.

Tre ishin aspektet kryesore të impaktit negativ kulturor dhe politik të imperializmit britanik në Kinë. Së pari, përmes marrëveshjeve të pabarabarta sovraniteti kinez u sulmua në themel nëpërmjet imponimit 'me armë në kokë' të 'jashtëterritorialitetit', nocionit se të gjithë rezidentët e huaj, dhe jo vetëm diplomatët, mund të jetonin në Kinë, por do t'u nënshtroheshin vetëm ligjeve perëndimore. Një sërë 'koncesionesh' u vunë për këtë qëllim (territore të caktuara për të huajt që do t'i nënshtroheshin ligjit britanik). Kjo u justifikua nëpërmjet së drejtës ndërkombëtare perëndimore pasi Kina konsiderohej si e pacivilizuar dhe rrjedhimisht josovrane. Britanikët me këmbëngulje refuzuan t'i trajtonin kinezët si të barabartë. Siç deklaroi Duka i Argyll-it në kohën e Luftës së Dytë të Opiumit:

Është absurditet i madh të arsyetosh thuase karshi kinezëve jemi të obliguar nga të njëjtat norma që rregullojnë marrëdhëniet ndërkombëtare në Europë ... Do të ishte çmenduri ta lidhnim veten nëpërmjet atij kodi me një popull barbar që nuk e njeh atë dhe po ta njihte, nuk do ta ndiqte.<sup>656</sup>

Këtu vlen të vihet në dukje gjithashtu se jashtëterritorialiteti iu imponua edhe Perandorisë Osmane, Tajlandës dhe shumë vendeve të tjera, mbi bazën se edhe ato nuk e kalonin 'testin e civilizimit'.

<sup>656</sup> Duke of Argyll, cituar te Hyam, *Britain's Imperial Century*, fq. 66.

Së dyti, sovraniteti kinez u sulmua me anë të marrëveshjeve të pabarabarta nga politika britanike e shtrëngimit të kinezëve për të pranuar administrim të huaj të agjencive kyçe burokratike, si shërbimi postar, doganat detare dhe agjencitë taksuese (për shembull, taksa e kripës). Marrja në dorë nga britanikët e Doganave Perandorake Detare për herë të parë ndodhi në vitin 1853 kur konsujt britanikë në Shangai vendosën të mblidhnin taksat doganore. Më vonë, në vitin 1863, Robert Hart u bë kreu i PDP, çka përbënte marrje të plotë nën kontroll nga britanikët. Është e qartë se pamundësia e qeverisë kineze për të përcaktuar politikën e vet të tregtisë së jashtme përbënte një sulm madhor ndaj sovranitetit dhe autonomisë së saj.

Sulmi i tretë ndaj autonomisë kulturore kineze përmes marrëveshjeve të pabarabarta qëndronte në këmbënguljen e britanikëve për ndalimin e temenasë. Ndërkohë që nuk kishte pasoja ekonomike, nga të gjitha kërkesat e britanikëve kjo ishte më poshtëruesja dhe më me pasoja. Efekti i saj që shkatërrimi i mbarë strukturës shoqërore dhe moralonormative mbi të cilën që ndërtuar shteti dhe shoqëria kineze. Siç e pamë në kapitullin 3, para shekullit të nëntëmbëdhjetë Kina kishte zhvilluar 'standardin e saj qytetërimor', të bazuar në temenanë. Temenaja ndaj perandorit nënkuptonte njohjen formale të Kinës si Mbretëria e Mesme superiore. Por siç e vumë në dukje, ky ishte një 'konstrukt mbrojtës' i krijuar për të ruajtur legjitimitetin e brendshëm të institucioneve kineze përballë pushtimit të huaj dhe uzurpimit 'barbar'. Por pas shekullit të gjashtëmbëdhjetë kjo do të rezultonte gjithnjë e më e pafrytshme përballë sfidave europiane. Këto të fundit filluan me debatin e 1645-ës për ritet, vazhduan me incidentin e Lord Macartney-it më 1793 (kur ky i fundit refuzoi të bënte temena) dhe arriti kulmin me ndalimin e 1873-shit. Kjo përbënte poshtërimin më

të madh të Kinës, pasi në këtë mënyrë dëmtohej rëndë i gjithë sistemi i saj ndërkombëtar, bashkë me sistemin e brendshëm të legjitimitetit. Veç kësaj, poshtërimi kulturor arrihej në një sërë mënyrash, ku rasti më i famshëm ndoshta është kur britanikët vendosën shenja jashtë hapësirës çlodhëse në Shangai (sot Parku Huangpu) ku thuhej: 'Ndalohet për qentë dhe kinezët'. Mund vetëm të merret me mend se si do të reagonin britanikët sikur kinezët të kishin marrë në dore Parkun St James (afër Pallatit të Buckingham-it) dhe të vendosnin aty shenja me mbishkrimin: 'Ndalohet për qentë dhe britanikët'.

Por për t'iu kthyer diskutimit të përgjithshëm: një strategji e dytë përmbajtëse imperiale e ndërthurur me shndërrimin kulturor parashikonte imponimin e tregtisë së lirë si një mënyrë për t'i çindustrializuar ekonomi të ndryshme koloniale. Dhe këtu i vijnë tek standardi i tretë i dyfishtë racist: sepse ndërsa politika e tregtisë së lirë shitej si ndihmuese apo qytetëruese për shoqëritë, efekti i saj ishte të promovonte ekonominë britanike në kurriz të ekonomive lindore. Një shembull i spikatur ishte minimi ose çindustrializimi i ekonomisë indiane. Pasi që mbështetur në manifakturën indiane të pambukut në shekullin e shtatëmbëdhjetë, qeveria britanike u përgjigj duke vendosur tarifa të larta mbi importet indiane në fillim të shekullit të tetëmbëdhjetë (siç është vënë në dukje). Më vonë akoma, në shekullin e nëntëmbëdhjetë, britanikët siguruan që tregu indian të qe i pambrojtur (duke imponuar tregtinë e lirë). Me kërkesë të Lancashire-it, taksat doganore mbi importet e pambukut në Indi midis viteve 1882-1894 u hoqën (pasi qenë ulur në 5% mes viteve 1859-1882). Sandardi i dyfishtë dhe trajtimi hipokrit i Indisë për sa i përket pambukut ishte befasues. Sepse ndërsa njëra çizme e mbante mbërthyer sistemin indian të prodhimit të pambukut (me anë të tarifave

shumë të larta britanike), çizmeja tjetër i futi manufakturat britanike në Indi pa kurrfarë barriere. Qe një nga 'goditjet e lira' më të pandershme që britanikët i dhuruan vetes. Kjo na shpie në atë që Ha-Xhun Çang, sipas Friedrich List-it, e quan taktika e 'shkelmimit të shkallës'.<sup>657</sup> Siç e shpreh List-i:

Tregtia e lirë është në interesin e Britanisë si mënyra për të siguruar epërsinë e saj prodhuese ... Është një hile tejet e rëndomtë që kur [dikush] ka arritur në majë, ta shkelmojë shkallën nga e cila është ngjitur për të mos i lejuar të tjerët të ngjiten pas tij. Këtu qëndron sekreti i doktrinës kozmopolite të Adam Smith-it dhe të ... qeverisë britanike.<sup>658</sup>

Por ndryshe nga ç'pretendon List-i, kjo strategji nuk synonte të ruante epërsinë e Britanisë ndaj vendeve të tjera të Europës, po të marrim parasysh se qeveritë britanike bënë pak për të promovuar apo ruajtur tregtinë e lirë europiane, por synonte të ruante epërsinë e Britanisë ndaj ekonomive të Lindjes, sepse britanikët e imponuan tregtinë e lirë vetëm jashtë Europës.

Kështu, ndërsa në shekullin e shtatëmbëdhjetë ekonomia britanike ishte importuese neto e tekstileve indiane, në vitin 1815 Britania eksportonte rreth 250 milionë jardë pambuk me vlerë rreth 40 milionë paundë, kurse më 1874 eksportonte 3.5 miliardë jardë me vlerë rreth 190 milionë paundë.<sup>659</sup> Në vitin 1873, 40-45% të të gjithë eksportit britanik të tekstileve të pambukut shkante në Indi.<sup>660</sup> Kësisoj, pasi dikur kishte eksportuar manufaktura pambuku në Britani, në mesin e shekullit të nëntëmbëdhjetë India qe shndë-

<sup>657</sup> Chang, *Kicking Away the Ladder*.

<sup>658</sup> Friedrich List, *National System*, fq. 189, 368.

<sup>659</sup> Hyam, *Britain's Imperial Century*, fq. 25.

<sup>660</sup> Werner Schlote, *British Overseas Trade from 1700 to the 1930s* (Westport: Greenwood Press, 1952), fq. 172-173.

rruar në një furnizues me pambuk të papërpunuar për industrinë e Lancashire-it, e cila prodhimet e përfunduara i eksportonte sërish në Indi. Shkurt, kostoja sociale e përpunimit të industrisë tekstile britanike, qe çindustrializimi i industrisë indiane.<sup>661</sup> Siç shpjegonte një zë britanik i shekullit të nëntëmbëdhjetë:

Sikur të mos kishin qenë këto taksa doganore dhe dekrete ndaluese, mullinjtë e Paisley-it dhe të Mançesterit do të kishin ndaluar ... Ato u ngritën me sakrificat e manifakturistëve indianë ... Manifakturisti i huaj përdori armën e padrejtësisë politike për ta mbajtur poshtë dhe në fund për t'ia marrë frymën një rivali me të cilin nuk do të kishte konkurruar dot në kushte të barabarta.<sup>662</sup>

E njëjta histori vlen edhe për industrinë e hekurit (gjatë shekullit të nëntëmbëdhjetë) ku ekonomia indiane kishte qenë një nga prodhuesit kryesorë në botë. Siç e vë në dukje me ironi Felipe Fernandez-Armesto, pasi ka vënë në dukje epërsinë e zhvillimit industrial të Indisë para uzurpimit imperial britanik:

me një saktësi të rrallë në histori, rrënimi industrial [çindustrializimi] i Indisë përkoi me vendosjen e sundimit ose hegjemonisë britanike ... U arrit që konkurrencës potenciale të ekonomisë së saj [të Indisë] t'i zihej fryma. Asnjë episod tjetër në vetvete nuk ka qenë më vendimtar në zhvendosjen e balancës së burimeve botërore se sa kjo zhvendosje në burimet që ata [britanikët] kishin në dorë.<sup>663</sup>

Dhe siç e ka vënë në dukje Friedrich List, kjo marrëdhënie tregtie 'të lirë' midis Britanisë dhe Indisë në përfundim

<sup>661</sup> R. P. Dutt, *The Problem of India* (New York: International Publishers, 1943).

<sup>662</sup> Horace Wilson (1845), cituar te Peter Fryer, *Black People in the British Empire* (London: Pluto Press, 1988), fq. 12.

<sup>663</sup> Felipe Fernandez-Armesto, *Millennium* (London: Black Swan, 1996), fq. 361, 367.

përbënte një nga 'shkëmbimet e pabarabarta' për aq sa e dënonte këtë të fundit të mbetj në fazën prodhuese agrikulturore dhe të lëndëve të para, duke ia minuar kësisoj perspektivën për zhvillim industrial.<sup>664</sup>

Si përfundim politika tregtare imperiale e Britanisë ngërthente kontradiktën morale midis shndërrimit kulturor dhe përmbajtjes, e cila funksiononte në favor të Britanisë dhe në dëm të interesave ekonomike dhe të dinjitetit kulturor të Lindjes. Për më tepër, i njëjti problem shfaqej edhe në orvatjet e britanikëve për t'i mobilizuar popujt dhe ekonomitë e Lindjes për 'të përhapur bekimin e qytetërimit' në mbarë botën.

***Racizmi dhe komodifikimi i Lindjes:  
originat afro-aziatike të industrializimit britanik***

Të bindur për epërsinë e tyre, britanikët e shihnin krejtësisht me vend që Lindja të zhbëhej e të riorganizohej për t'u shërbyer nevojave të tyre industriale. Ky nuk ishte thjesht një funksion i ushtrisë superiore apo i pushtetit material ekonomik, por në thelb buronte nga qëndrimi patriarkal dhe racist ndaj racave 'të zeza' dhe 'të verdha'. Në botë-kuptimin britanik ishte aksiomatike që këta të fundit nuk duheshin trajtuar si të barabartë. Siç shprehej në stil tipik socio-darvinian racisti shkencor Charles Kingsley:

Çdo komb që mund të prodhojë shumë më tepër se nevojat e veta, e ka për detyrë morale që të përmbushë nevojat e të tjerëve me tepritë e veta ... Specia njerëzore ka të drejtën të kërkojë ... që çdo popull të zhvillojë kapacitetet e vendit të vet, ose t'u hapë rrugën atyre që do ta zhvillojnë atë.<sup>665</sup>

<sup>664</sup> List, *National System*, kapitujt 8, 13.

<sup>665</sup> Charles Kingsley, cituar te Hyam, *Britain's Imperial Century*, fq. 106.

## Siç shpjegon Pierre Clastres:

Prandaj nuk mund të lireshin të qeta shoqëritë [lindore] të cilat e braktisën botën në prodhimtarinë e saj të qetë fillestare. Prandaj në sytë e Perëndimit, shkapërderdhja që përfaqësonte mosshfrytëzimi i burimeve të pamata ishte e patolerueshme. Zgjidhja që u lihej këtyre shoqërive paraqiste një dilemë: ose prodhim, ose shfarosje; ose etnocid [dmth. shndërrim kulturor] ose gjenocid.<sup>666</sup>

Kësisoj, paradoksalisht ‘përhapja e bekimit të civilizimit’ nënkuptonte komodifikimin e tokës, krahut të punës, tregjeve dhe burimeve të Lindjes. Sepse nëse të kolonizuarit nuk do të kontribuonin në civilizim, atëherë ishte aksiomatike që britanikët t’i mobilizonin siç duhej. Pikërisht këtu kalojmë në anën përvetësuese të historisë.

Shprehja përfundimtare e qëndrimit të nënkuptuar racist të Britanisë qëndron tek komodifikimi i krahut të zi të punës nërpëmjet skllavërisë. Skllavëria e të zinjve dhe afrikanët në përgjithëse e bënë të mundur industrializimin britanik në të paktën shtatë mënyra madhore. Kontributi i parë qëndron në fitimet e vjela nga tregtia e skllavërve. Stanley Engerman dhe Roger Anstey e kanë hedhur poshtë këtë duke argumentuar se fitimet nga tregtia e skllavërve kanë qenë tejet të vogla krahasuar proporcionalisht me investimet apo të ardhurat kombëtare (i njohur si argumenti i ‘raporteve të ulëta’).<sup>667</sup> Por, duke komentuar të dhënat e Engerman-it, Barbara Solow arsyeton se për vitin 1770, ‘fitimet nga tregtia e skllavërve kanë përbërë ... gati 8% të investimit total dhe 39% të investimeve tregtare dhe industriale. Këto

<sup>666</sup> Pierre Clastres, “On Ethnocide”, *Art and Text* 28 (1988), 57.

<sup>667</sup> Stanley Engerman, “The Slave Trade and British Capital Formation in the Eighteenth Century: a Comment on the Williams Thesis”, *Business History Review* 46 (1972), 430-43; Roger Anstey, “The Volume and Profitability of the British Slave Trade, 1761-1807”, te Stanley Engerman dhe Eugene Genovese (red.), *Race and Slavery in the Western Hemisphere* (Princeton: Princeton University Press, 1975), fq. 3-31.

raporte nuk janë të ulëta; përkundrazi janë tejet të mëdha.<sup>668</sup> Nëpërmjet krahasimit, ajo vazhdon duke thënë se në vitin 1980 në SHBA, raporti i fitimit total të brendshëm të korporatave ka qenë rreth 40%. Veç kësaj, asnjë industri amerikane sot nuk zotëron 8% të investimit total. Siç arsyeton William Darity, fitimet nga tregtia e skllëve në 1784-6 si pjesë e investimit total britanik ishin përmbi tri herë më shumë se shuma që industria amerikane e automobilëve përfaqëson si pjesë e investimit total amerikan dyqind vjet më vonë.<sup>669</sup>

Megjithatë, vlerësimet e Roger Anstey-it për fitimet nga tregtia e skllëve janë më konservatore se ato të Engerman-it. Të dhënat e tij sugjerojnë se fitimet në fjalë përbënin vetëm 0.11% të të ardhurave kombëtare, 'çka është aq e papërfillshme sa për ta shembur mitin e rëndësisë jetike të tregtisë së skllëve në financimin e revolucionit industrial britanik'.<sup>670</sup> Por ajo që fshehin këto figura është se argumenti i 'raporteve të ulëta' vlen jo më pak për nivelet e investimit të kapitalit në industritë e pambukut dhe të hekurit (të cilat ishin lokomotivat e industrializimit britanik). Nivelet e investimit në të dyja këto industri (po të marrim për bazë vlerësimin e ekzagjeruar të Anstey-it për të ardhurat kombëtare për ta bërë më të lehtë krahasimin) në secilën prej tyre përbënin diku tek 0.22% të të ardhurave në periudhën 1780-1800. Le të kujtohet gjithashtu se Liverpuli ndodhet në pragun e industrisë së pambukut të Lancashire-it, e cila ofronte një portë të gatshme për daljen e një pjese të kapitalit të grumbulluar. Për t'u habitur, duke supozuar një përqind-

<sup>668</sup> Barbara Solow, "Caribbean Slavery and British Growth: the Eric Williams Hypothesis", *Journal of Development Economics* 17 (1985), 105.

<sup>669</sup> William Darity, "British Industry and the West Indies Plantations", te Inikori dhe Engerman, *Atlantic Slave Trade*, fq. 256.

<sup>670</sup> Anstey, "Volume", fq. 24. Vini re se ai i llogarit të ardhurat nga tregtia e skllëve në 200,000 paundë në vit, dhe të ardhurat kombëtare në 180 milionë paundë.

je kursimesh prej 7% të të ardhurave kombëtare, ai arrin në përfundimin se fitimet nga tregtia e skllëvërve do ta kishin rritur investimin total me një 0.11%-ësh të papërfillshëm. Por kjo shifër nuk e pasqyron saktë raportin e fitimit me investimin, që duhet të ketë qenë shumë më i madh se kaq. Nëse supozojmë se 50% të fitimeve i kanë shkuar industrisë së pambukut, kjo do të kishte financuar diku mes 25-30% të investimit total të industrisë, shifër që do të sugjeronte tezën e një 'raporti të lartë'.

Sido që të jetë, problemi imediat i këtij debati është se i vlerëson efektet e skllavërisë së zezë mbi industrializimin britanik vetëm për sa iu përket fitimeve të tregtisë së skllëvërve. Kësisoj mendohet se nëse fitimet nga tregtia e skllëvërve kanë qenë të papërfillshme për industrializimin britanik, atëherë rrjedhimisht e tillë ka qenë edhe skllavëria vetë. Por kjo anashkalon shumë kontribute të krahut të zi të punës në prodhim, fitimet dhe të ardhurat prej të cilit ishin të rëndësishme për industrializimin britanik në të paktën gjashtë mënyra të tjera. Përfundimisht këto pika nxjerrin në pah nevojën për ta zëvendësuar argumentin eurocentrik të 'raporteve të ulëta' me një tezë të 'raporteve të larta'.

Një tjetër kontribut afrikan qëndron në fitimet e riinvestuara nga shfrytëzimi i krahut të zi të punës në dy Amerikat nga pronarët britanikë të plantacioneve. Pas 1750-ës, shumë plantacione me skllëvër të zinj ishin në zotërim të pronarëve britanikë që vetë jetonin larg këtyre pronave. Kjo do të thotë se fitimet thelbësore të arritura nga eksportet e tregtisë koloniale gjenin një portë të gatshme për të rrjedhur në industrinë britanike. Kështu për shembull, në fund të shekullit të tetëmbëdhjetë, të ardhurat nga pronat koloniale ishin të barazvlefshme me rreth 50% të investimit bruto britanik.<sup>671</sup> Po të marrim parasysh se shumë nga kjo do të jetë

<sup>671</sup> Përlllogaritur nga Deane dhe Cole, *British Economic Growth*, fq. 34.

riinvestuar në industrinë britanike, vetëm kjo duhet të ketë siguruar një kontribut masiv në procesin e industrializimit. Për më tepër, në vitin 1770, vetëm fitimet prej eksporteve nga Indet Perëndimore përbënin 38% të investimit privat total, ose 2.5% të të ardhurave kombëtare.<sup>672</sup> Kjo do të thotë se vetëm 15% e kësaj shume do të kishte mjaftuar për të financuar investimin e mbarë industrisë britanike të pambukut (ose teza e 'raportit të lartë').

Një kontribut i tretë afrikan qëndron në faktin se në vitin 1801, për shembull, të ardhurat neto britanike nga eksporti mbështesnin rreth gjysmën e forcës punëtore joagrikulturore të Anglisë dhe Uellsit.<sup>673</sup> Fakti që rreth 60% e kësaj tregtie në atë kohë ishte me rajonin amerikan të bazuar në skllavërinë dhe me Afrikën, do të thotë se konsumatorët zezakë dhe skllëvërit e zinj mbështesnin rreth një të tretën e forcës totale punëtore joagrikulturore të Anglisë dhe Uellsit. Vetëm ky është një kontribut shumë i madh. Veç kësaj, sikur punëtorët anglezë dhe uellsianë të mbështetur nga zezakët të investonin 8% të të ardhurave të tyre (përqindja mbizotëruese e kursimeve shtëpiake personale), vetëm kjo do të kishte mjaftuar për të financuar gati gjysmën e investimit total në industrinë e pambukut, një tjetër shenjë e kjo e tezës së 'raporteve të larta'.

Së katërti, një kontribut i veçantë i skllavërisë së zezë në industrializimin britanik qëndron në furnizimin kolonial nga Atlantiku me lëndë të parë. Rreth fundit të shekullit të tetëmbëdhjetë, raporti i komoditeteve/lëndëve të para të

<sup>672</sup> Përlllogaritur nga Ronald Bailey, "Africa, the Slave Trade, and the Rise of Industrial Capitalism in Europe and the United States", *American History: a Bibliographic Review* 2 (1986), 32.

<sup>673</sup> P. K. O'Brien dhe S. L. Engerman, "Exports and the Growth of the British Economy from the Glorious Revolution to the Peace of Amiens", te Barbara Solow (red.), *Slavery and the Rise of the Atlantic System* (Cambridge: Cambridge University Press, 1991), fq. 189.

prodhuara nga afrikanët në dy Amerikat ishte deri në 83% (dhe ishte akoma 69% në vitin 1850). Ajo që vlen të vihet re më shumë këtu është furnizimi me pambuk të papërpunuar të prodhuar në Amerikat thujse vetëm nga skllëvërit e zinj afrikanë.<sup>674</sup> Megjithatë, Engerman pretendon se vlera bruto e tregtisë së skllëvërve përbënte një pjesë të papërfillshme të të ardhurave kombëtare të Britanisë (argumenti i ‘raporteve të ulëta’). Por le të kujtojmë se pa pambukun e papërpunuar të prodhuar nga skllëvërit, industria britanike e pambukut nuk do të kish mundur ta luante rolin e saj thelbësor në industrializimin në përgjithësi. Kenneth Pomeranz vë në dukje se kur eksportet e pambukut me bazë skllavërinë nga Shtetet e Bashkuara u shterën në vitet 1861 dhe 1862 (gjatë Luftës Civile), konsumi britanik i pambukut ra me 55% dhe çmimet u dyfishuan. Në vetëm një vit mullinjtë e Lancashire-it e përgjysmuan forcën punëtore dhe shumë firma shpallën falimentin.<sup>675</sup> Kësaj shtate Britania iu përgjigj duke iu kthyer furnizimit me pambuk të papërpunuar nga Egjipti (krahas importit të pambukut të papërpunuar nga India), duke e vazhduar kësaj varësinë nga puna e zezë afrikane.

Së pesti, tregtia e skllëvërve dhe vlera e prodhuar nga skllëvërit kontribuoi masivisht në stimulimin e financave britanike. Si Banka Barclays edhe ajo e Lloyds-it u rritën mbi një pjesë të fitimeve në fjalë (ashtu si banka të tjera më të vogla).<sup>676</sup> Institucionet financiare britanike morën një shtytje të konsiderueshme nga nevojat e mëdha për kredi (si dhe siguracione) të tregtarëve britanikë të skllëvërve dhe të pronarëve të plantacioneve me skllëvër. Sipas Joseph Inikori-t, pagesat e siguracioneve për tregtinë e skllëvërve

<sup>674</sup> Wadsworth dhe Mann, *Cotton Trade*, fq. 183-192; Inikori, *Africans*, fq. 372, 482.

<sup>675</sup> Pomeranz, *Great Divergence*, fq. 278.

<sup>676</sup> Williams, *Capitalism*, fq. 98-102; Darity, “British Industry”, fq. 257.

dhe tregtinë e Indeve Perëndimore, përbënin deri në 63% të tregut britanik të sigurimeve detare në total.<sup>677</sup> Më herët e vumë në dukje se tregu i kapitalit i Londrës vendosi shumata të mëdha parash në bono shtetërore gjatë fazës së industrializimit. Po ashtu vumë në dukje se qenë vetëm fitimet thelbësore të padukshme ato që i dhanë mundësinë Britanisë të ruante një balancë teprice pagesash gjatë shekujve të tetëmbëdhjetë e nëntëmbëdhjetë. Gjatë fazës kryesore të industrializimit, shumica e fitimeve të padukshme vinin nga sistemi komercial i Atlantikut. Është për t'u vënë re se teza për 'raportet e larta' artikullohet në mënyrë të nënkuptuar nga Inikori:

Sado e madhe të ishte huamarrja shtetërore gjatë luftës [përmes tregut të kapitalit të Londrës], duket se, mesatarisht, transaksionet vjetore në instrumenta tregtare (kambialesh dhe bono kompanish) në Londër ishin më të mëdha se transaksionet me bono shtetërore gjatë periudhës [1700-1850] ... Pjesa dërrmuese e kambialeve që qarkullonin në tregtinë provinciale dhe në qendrat e prodhimit e në Londër, ashtu si dhe bonot e kompanive, buronin drejtpërdrejt dhe tërthorazi nga tregtia transatlantike e skllëverve dhe nga tregtia e përqendruar rreth prodhimeve amerikane të prodhuara nga skllëvërit.<sup>678</sup>

Një kontribut i gjashtë afrikan ndaj industrializimit britanik bëhet i qartë në fitimet totale të përfutuara nga eksportet britanike në kolonitë. Për shembull, në vitet 1784-6, këto fitime përbënin deri në 55% të investimit total bruto britanik, ose 64% të investimit total privat (80% të kësaj shifre e përbënte tregtia me Afrikën dhe Amerikat).<sup>679</sup> Domethënia e kësaj del në pah nga fakti se shumata e investu-

<sup>677</sup> Inikori, *Africans*, fq. 356.

<sup>678</sup> Po aty, fq. 361.

<sup>679</sup> Darity, "British Industry", fq. 255.

ara në industrinë e pambukut përbënin vetëm 4% të investimit total bruto të Britanisë. Kështu që rreth 9% të fitimeve nga tregtia trekëndore do të mjaftonin për të gjithë investimin në industrinë e pambukut. Është e qartë se shifra 9% është një nënvlerësim i trashë i shumëve të përfutuara që kanë patur gjasë të jenë investuar në industrinë britanike në përgjithësi. Dhe nuk është më pak e rëndësishme të vihet në dukje se fitimet totale nga tregtia imperiale do të përbënin shumë më tepër se 55% të investimit total bruto të Britanisë. Kjo sepse shumë nga eksportet e destinuar për Europën ishin në fakt rieksperte të prodhimeve të importuara koloniale (me origjinë kryesisht nga kolonitë me skllëvër të zinj). Prandaj ajo çka nënkupton kjo është se shumë më pak se 9% të fitimeve të përfutuara nga tregtia trekëndore do të mjaftonin për ta financuar industrinë britanike të pambukut (ndoshta vetëm 6%). Për më tepër, për ta lidhur me argumentin e dytë të shtjelluar më lart: fitimet në total nga pronat koloniale jashtë vendit bashkë me fitimet nga tregtia me kolonitë, mjaftonin për të financuar të gjithë investimin e brendshëm bruto të Britanisë në fund të shekullit të tetëmbëdhjetë. Sërisht kjo e përforcon tezën time për 'raportet e larta'.

Në përfundim, një kontribut i shtatë i Afrikës qëndron në faktin se sistemi i tregtisë trekëndore nuk siguronte vetëm fitime të mëdha, por edhe një kërkesë të madhe për eksporte britanike, në mungesë të së cilës industrializimi britanik do të qe kufizuar ndjeshëm. Ndërkohë që këto tregje ishin të rëndësishme për një gamë të tërë industrish, ato ishin veçanërisht thelbësore për industritë tejet të rëndësishme të hekurit dhe pambukut.<sup>680</sup> Aktet e Lundrimit këtu patën rëndësi kritike. Këto ligje, të imponuara nga statuti

<sup>680</sup> Inikori, *Africans*, fq. 427-472.

racist shtetëror, krijuan një sistem monopolist tejet proteksionist, të projektuar për t'i privilegjuar tregtarët britanikë në kurriz të popujve lindorë. Adam Smith i pati cilësuar ato së 'distinktivët e turpshëm të skllavërisë'. Në veçanti, Aktet e Lundrimit ishin të ngulitura në sistemin kolonial të tregtisë, ku tregtia trekëndore përbënte një pjesë jetike. Aktet e Lundrimit dhe sistemi kolonial siguronin tregje të garantuara monopoliste për eksportet britanike pikërisht në kohën kur nivelet e kërkesës së brendshme po binin (domethënë, kur kërkesa e brendshme e grumbulluar po tkurrej). Në këtë mënyrë, ndërsa eksportet industriale britanike u rritën me mbi 150% mes viteve 1700-1770, tregu i brendshëm u rrit me vetëm 14%. Veç kësaj po thaheshin edhe tregjet europiane dhe pjesa e Britanisë në tregtinë e prodhimeve industriale në Europë ra nga 84% (1700) në 45% (1773) dhe 29% (1855). Kurse pjesa e Britanisë në tregtinë drejt kolonive të Amerikave dhe Afrikës u rrit nga 12% (1700) në 43% (1773). Nëse i marrim të gjitha kolonitë, pjesa e eksporteve industriale të Britanisë u rrit nga 14% në 1700-ën, në 55% në 1773-shin dhe në 71% në vitin 1855.<sup>681</sup> Në fakt, edhe disa studiues eurocentrikë janë detyruar të pranojnë se rritja e zotërimeve koloniane (sidomos në Amerikat dhe Indet Perëndimore) është arsyeja për një pjesë të madhe të rritjes së eksporteve angleze.<sup>682</sup> Çështja madhore këtu është se këto tregje mbajtën shumë nga rritja (ndoshta 70%) e prodhimit industrial britanik gjatë shekullit kritik të tetëmbëdhjetë.<sup>683</sup>

Megjithatë, në një artikull të mirënjohur, Patrick O'Brien e riafirmonte eurocentrizmin duke e shpërfillur rolin e

<sup>681</sup> Crafts, *British Economic Growth*, fq. 145.

<sup>682</sup> R. P. Thomas dhe D. N. McCloskey, "Overseas Trade and Empire 1700-1860", te Roderick Floud dhe Donald McCloskey (red.), *The Economic History of Britain Since 1700*, I (Cambridge: Cambridge University Press, 1981), fq. 92.

<sup>683</sup> O'Brien dhe Engerman, "Exports", fq. 189.

sistemit tregtar kolonian në rritjen e industrializimit europian. Ai arsyetonte se për Europën në tërësi, tregtia me ‘periferitë’ ishte e papërfillshme dhe përbënte 1-2% të të ardhurave kombëtare europiane.<sup>684</sup> Në këtë mënyrë, një argument i tillë eurocentrik e fshin ose e fsheh anën e errët të industrializimit europian. Por me siguri në kontekstin britanik argumenti i tij është problematik. Edhe pse e pranon se kjo shifër nuk e vlerëson si duhet rastin e Britanisë, sërish arrin në përfundimin se edhe këtu fitimet nga tregtia me ‘periferinë’ kanë qenë të papërfillshme.<sup>685</sup> Por sipas llogaritjeve të mia, vetëm për periudhën 1750-1800, tregtia britanike me ‘periferinë’ i bie të ketë përbërë rreth 15% të të ardhurave kombëtare, një shifër kjo kolosale, e cila gjatë shekullit të nëntëmbëdhjetë u rrit edhe më tej, duke arritur në 34% të të ardhurave kombëtare në vitin 1855 (çka përbën mbi 900% të shumave të shpenzuara për mbrojtjen britanike mes viteve 1850-1913). Për më tepër, vetëm brenda sistemit tregtar trekëndor, kjo shifër ka qëndruar në rreth 12% të të ardhurave kombëtare të Britanisë mes viteve 1750-1800.

Paradoksalisht, mbështetja për këtë argument vjen nga Patrick O’Brien dhe Stanley Engerman, të cilët në një artikull të vitit 1991, arrinin në përfundimin se:

Transportuesit detarë anglezë e mbizotëronin biznesin e transportit të skllëvërve nga Afrika në Botën e Re. Pa punën e detyruar dhe të lirë të afrikanëve, ritmi i rritjes së tregtisë transkombëtare nga viti 1660 deri në ndalimin e tregtisë së skllavërve [më 1807], do të kishte qenë shumë më i ulët ... Është e vështirë të përfytyrohet një rrugë tjetër zhvillimi që do të mund ta kishte bartur si tregtinë

<sup>684</sup> P. K. O’Brien, “European Economic Development: the Contribution of the Periphery”, *Economic History Review* 35 (1982), 1-18; O’Brien, “Foundations”, 303-306.

<sup>685</sup> O’Brien, “Foundations”, 310-311.

ndërkombëtare ashtu dhe atë britanike në nivelin e arritur në fillim të shekullit të nëntëmbëdhjetë.<sup>686</sup>

Dhe për më tepër, duke e hedhur poshtë argumentin standard rikardian kundërfaktual (shih konkluzionin më poshtë) ata vazhdojnë duke thënë se tregtia imperiale qe një faktor jetik në stimulimin e industrializimit britanik në një kuptim më të përgjithshëm.

Kështu që, si përfundim, nuk është nevoja të pranohet plotësisht teza e Eric Williams-it në veprën e tij klasike, *Capitalism and Slavery*, për të pretenduar se konsumatorët/prodhuesit afrikanë dhe skllëvërit e zinj luajtën një rol pozitiv dhe thelbësor në industrializimin britanik. Veç kësaj, vlen të vihet në dukje se skllavërinë e të zinjve e plotësonte komodifikimi i popujve lindorë, dhe jo më së paku përmes punës jokontraktuale, në mënyrë që t'u shërbenin nevojave industriale të Britanisë. Puna jokontraktuale kineze dhe sidomos indiane ishte veçanërisht e rëndësishme. Indianët u vunë të punonin në qendra të ndryshme koloniale prodhimi në mbarë botën, veçanërisht në Mauritius ku do të prodhonin sheqer për të ëmbëlsuar jo më së paku çajin indian që tashmë britanikët po e pinin me oreks të madh. Duke e përmbledhur sistemin e punës jokontraktuale, Ronald Hyam vë në dukje se:

Ishte pra një sistem që përfshinte zhvendosje të mëdha fuqie njerëzore, statistikisht mjaft i krahasueshëm me skllavërinë e Atlantikut dhe riprodhues i shumë prej tipareve të kësaj të fundit. Vdekshmëria në udhëtimet e gjata drejt Indeve Perëndimore ishte e tmerrshme, kurse kushtet në plantacione të llahtarshme. Megjithatë britanikët vazhduan me këmbëngulje ta bindnin veten ... se ky ishte një sistem i pranueshëm dhe e mbronin atë si të

<sup>686</sup> O'Brien dhe Engerman, "Exports", fq. 181-182.

domosdoshëm e jo të ‘pacivilizuar’ si skllavëria. Si rezultat, qe puna indiane ajo që krijoi shumë nga pasuria tejet-detase e perandorisë nëpërmjet shfrytëzimit të lëndëve të para të tropikut.<sup>687</sup>

Ngjashmërisht, shumë nga ekonomitë e Lindjes u komifikuan dhe riorganizuan për të prodhuar prodhime primare dhe lëndë të para për t’u shërbyer nevojave të industrializimit britanik. Dhe sërish ky përfytyrohej si një proces civilizues. Për t’u vënë në dukje këtu është se britanikët kërkonin me dëshpërim ta tejkalonin deficitin e hershëm tregtar me Kinën që kishte shkaktuar përthithjen e vazhdueshme të arit nga Britania. Një nga mënyrat se si u arrit kjo qe përmes sigurimit të burimeve të reja për furnizimin me çaj. Për këtë qëllim, pjesë të caktuara të Indisë u ‘riorganizuan’ për të rritur çaj. Teksa në vitin 1850 britanikët qenë mbështetur tek Kina për të gjithë furnizimin e tyre me çaj, brenda pesëdhjetë vjetësh arritën ta importonin 85% të çajit nga India. Por arma më e rëndësishme që u dha mundësinë britanikëve ta përmbysnin deficitin tregtar, qe eksporti i opiumit në Kinë. Pasi qe furnizuar me opiumin e Turqisë që nga fundi i shekullit të tetëmbëdhjetë, britanikët i riorganizuan pjesë të caktuara të Indisë si burime të furnizimit me opium. Në vitin 1828, opiumi indian përbënte 55% të të gjitha eksporteve britanike në Kinë (edhe pse shteti kinez e kishte ndaluar zyrtarisht konsumin e tij). Dhe kur komisioneri Lin afërmendsh u përpoq ta reduktonte tregtinë e drogës në vitin 1839, britanikët e përdorën këtë si pretekst për Luftrat e Opiumit. Përmes këtyre mënyrave të pabesa, britanikët arritën ta përmbysnin deficitin historik tregtar me Kinën. Sepse fakti është se vetëm duke futur drogë me forcë në Kinë (me anë të fuqisë ushtarake britanike) dhe

<sup>687</sup> Hyam, *Britain's Imperial Century*, fq. 209.

duke pirë çaj indian në Angli, qe e mundur t'i ndryshohej rrjedha e arit që shkonte në Kinë.

Po ashtu, shumë pjesë të tjera të botës u kthyen në qendra prodhimi lëndësh të para për ekonominë britanike. Mbi të gjitha, kolonitë e Amerikave u riorganizuan për ta furnizuar Britaninë me importe 'tokëkursyese'. Siç e vë në dukje Eric Jones, 'i gjithë ekspansioni i Kufirit të Madh [Amerikat] mund të shihet si një zgjatim i "Hektarëve Fantazmë" të Europës'.<sup>688</sup> Termi 'hektarët fantazmë' cilëson sipërfaqen e tokës që britanikëve do t'u nevojitej në vendin e tyre për të prodhuar të njëjtën sasi. Mbi bazën e përlllogaritjeve të hollësishme mbi eksportet e sheqerit, pambukut dhe drurit nga Bota e Re, Pomeranz arrin në përfundimin se kjo sipërfaqe përfshin nga 25 deri në 30 milionë akra.<sup>689</sup> Kjo të shpie në përfundimin se në mungesë të këtyre importeve tokëkursyese, britanikëve do t'u qe dashur ta trefishonin sipërfaqen e tokës që përdornin në atë kohë për të prodhuar të njëjtën sasi të produkteve në fjalë. Kësisoj, pa këto kontribute koloniale, britanikët do të kishin qenë të detyruar ta kanalizonin në bujqësi forcën punëtore që përdorej në industri. Po ashtu, duke patur parasysh se sa e madhe ishte kjo sipërfaqe fantazmë, është e mundur që në mungesë të saj industrializimi britanik do të qe rrezikuar mjaft.

Veç kësaj, bujqësia në Afrikën Perëndimore u riorganizua për të prodhuar vaj palme, kakao, ar dhe gomë për t'u shërbyer nevojave të ekonomisë britanike. Australia ishte gjithashtu e rëndësishme dhe u riorganizua për të furnizuar një pjesë të madhe të leshit britanik. Ndërsa në vitin 1842, vetëm 2% e leshit të importuar në Britani vinte nga Australia, kjo shifër u rrit në 40% në vitin 1860 dhe në 67% më 1886.<sup>690</sup>

<sup>688</sup> Eric L. Jones, *The European Miracle* (Cambridge: Cambridge University Press, 1981), fq. 83.

<sup>689</sup> Pomeranz, *Great Divergence*, fq. 274-278.

<sup>690</sup> Përlllogaritur nga Hyam, *Britain's Imperial Century*, fq. 322.

Në këtë mënyrë u riorganizuan edhe shumë vende të tjera. Rezultatin përfundimtar për sa u përket interesave të Britanisë e tregon me sarkazëm W. S. Jevons në librin *The Coal Question* (1865):

Fushat e Amerikës Veriore dhe të Rosisë janë fushat tona me grurë; Çikago dhe Odessa janë hambarët tanë; Kanada dhe Baltiku pyjet tona për dru; Australia ka fermat tona të dheneve, kurse në Argjentinë dhe në stepat perëndimore të Amerikës Veriore kemi kopetë tona të gjedhëve; Peruja na dërgon argjendin e saj, kurse ari i Afrikës së Jugut dhe Australisë rrjedh drejt Londrës; indutë ... rrisin çaj për ne, kurse plantacionet tona të kafesë, sheqerit e të erëzave janë të gjitha në Indet ... tokat e mbjella me pambuk, të cilat prej kohësh kanë pushtuar jugun e Shteteve të Bashkuara, tashmë po zgjerohen kudo nëpër rajonet e ngrohta të tokës ... shumë rajone të globit [janë] kontribuesit tanë me dëshirë.<sup>691</sup>

Por për sa u përket kolonive, efekti i qartë i të gjithë kësaj nuk ishte edhe aq ngritja e suksesshme e ekonomive të tyre 'lart në nivelin' e civilizimit britanik, sa ç'ishte përmbytja e tyre. Siç e ka vënë në dukje Alec Hargreaves lidhur me kolonitë europiane, pavarësisht arsytimit për shndërrimin kulturor ('misioni civilizues'):

ato nuk prodhuan kopje të ekonomive industriale të Europës, përkundrazi, mbetën në masë dërrmuese agrikul-turore. Ato duhej ta mbështesnin, por jo ta konkurronin, sistemin industrial të Europës duke e furnizuar me ushqime dhe lëndë të para si dhe me tregje për mallrat e prodhuara.<sup>692</sup>

<sup>691</sup> W. S. Jevons, cituar te Hyam, *Britain's Imperial Century*, fq. 47-48, theksimi është i imi.

<sup>692</sup> Alec Hargreaves, "European Identity and the Colonial Frontier", *Journal of European Studies* 12 (1982), 167.

Kjo na kthen sërish tek Friedrich List-i. Sepse ishte kjo marrëdhënie asimetrike ajo që përbënte problemin e 'shkëmbimit të pabarabartë' pikërisht sepse i dënonte prodhuesit kolonialë të përqendroheshin në një prodhim agrikor ose primar në fazën prodhuese të lëndës së parë, çka nuk e lejonte kalimin në industrializim.

Së fundmi, është e rëndësishme të përsërisim çështjen e vënë në dukje më lart: se pavarësisht impaktit rrënues ekonomik që imperializmi i shkaktoi perandorisë, impakti kulturor shpesh ishte shumë më shqetësues. Në kapitullin 8 ceka trajtimin dehumanizues të skllëvërve të zinj afrikanë. Gjithashtu fola për impaktin kulturor negativ të imperializmit britanik në lidhje me Kinën. Por një shembull veçanërisht domethënës është rasti i Australisë, ku aborigjenët u përballën me një sulm të gjithanshëm kulturor e ekzistencial pasi të bardhët filluan të nguliteshin atje më 1788. Vlen të përmenden disa pika përmbledhëse.

Së pari, pas njëqind vjet ngulitjeje britanike, jo më pak se njëzet mijë aborigjenë qenë vrarë në dhunë territoriale.<sup>693</sup> Po ashtu ka të dhëna bindëse që tregojnë se në Tazmani u zbatua 'zgjdhja përfundimtare'.<sup>694</sup> Nuk është për t'u habitur që aborigjenët nisën ta shihnin zbarkimin e ngulitësve anglezë në Australi në vitin 1788 jo si një ngulim të lavdishëm apo zbulim pionierik që duhej kremtuar çdo vit si Dita e Australisë, por si një pushtim në plot kuptimin e fjalës. Megjithatë shumë më tepër jetë u humbën nga impakti i sëmundjeve që sollën evropianët. Njëqind vjet pas ngulitjes së të bardhëve, shkalla e vdekjeve tek aborigjenët ishte diku mes 80-90%, shifër e krahasueshme me shkallën e vdekjeve

<sup>693</sup> Richard Broome, *Aboriginal Australians* (St Leonards, New South Wales: Allen and Unwin, 1982), fq. 51; Henry Reynolds, *The Other Side of the Frontier* (Ringwood, Victoria: Penguin, 1982), fq. 122-123.

<sup>694</sup> Henry Reynolds, *An Indelible Stain?* (Harmondsworth: Penguin, 2001), kapitulli 4.

tek vendasit e Amerikës njëqind vjet pas ngulitjes spanjolle. Disa autorë australianë kanë përdorur termin 'holokaust' për të përshkruar përvojën aborigjene.<sup>695</sup> Megjithatë, ideologjia e re raciste britanike e shihte këtë si krejtësisht të natyrshe e të pranueshme. Sepse, siç shprehej Edward Curr, superintendenti i *Van Diemen's Land Company*, 'është në rëndin e natyrës që, ndërsa civilizimi përparon, popujt e egër duhet shfarosur'.<sup>696</sup>

Së dyti, pas dhunës qëndron një tjetër histori e cila sipas autorëve të ndryshëm australianë mund të cilësohet si gjenocid 'paqësor'.<sup>697</sup> Kjo nënkuptonte orvatjen për të shkatërruar kulturën, trashëgiminë dhe identitetin aborigjen. Ajo që vlen të përmendet veçanërisht këtu është historia e 'brezave të grabitur', fëmijët aborigjenë të vënë me përdhunë nën 'kujdestarinë' e të bardhëve me synimin e hapur që të reshtnin së qeni aborigjenë. Kjo filloi në vitet e para të kolonizimit dhe vazhdoi deri në mesin e shekullit të njëzetë.<sup>698</sup> Sigurisht, në kohën e vet besohej se kjo ishte një detyrë civilizuese për t'u ofruar fëmijëve në fjalë një të ardhme më të mirë. Por kjo ishte një e ardhme e bardhë, e shkëputur nga e kaluara aborigjene. Së fundmi, por jo për nga rëndësia, aborigjenët u izoluan nëpërmjet një aparteidi social, duke u vendosur në 'vendbanime' në periferi të qyteteve të të bardhëve. Kushtet në këto kampe janë përshkruar si 'të krahasueshme me ato në burgje ose çmendina, ku superintendët e bardhë ushtronin kontroll të jashtëzakonshëm mbi je-

<sup>695</sup> See T. Barta, "After the Holocaust: Consciousness of Genocide in Australia", *Australian Journal of Politics and History* 31 (1) (1984), 154-161.

<sup>696</sup> E. Deas Thomson (1842), cituar te Robert Hughes, *The Fatal Shore* (London: Harvill, 1996), fq. 278.

<sup>697</sup> Barta, "After the Holocaust"; Colin Tatz, *Genocide in Australia* (Canberra: Aboriginal Studies Press, 1999); Reynolds, *Indelible Stain?*

<sup>698</sup> Reynolds, *Indelible Stain?*, fq. 155-179.

tën e përditshme të robërve aborigjenë'.<sup>699</sup> Dëshmi të shumta nga aborigjenët i përshkruajnë ato si 'kampe përqendrimi'. Kështu që pas të dhënave abstrakte që e shënojnë riorganizimin e Australisë si një eksportuese leshi drejt vendit mëmë, qëndron një histori e errët, e cila tregon se ç'kuptim mund të ketë patur dhe si është perceptuar misioni civilizues nga aborigjenët në avanpostin kolonial në 'fund të botës'.

### **Përfundim: a ishte intervencionizmi shtetëror dhe imperializmi britanik një keqpërdorim parash?**

E gjitha kjo nuk do të thotë aspak se të tilla nivele të theksuara intervencionizmi të brendshëm shtetëror nga njëra anë dhe ndërhyrja imperialiste nëpërmjet përvetësimit të burimeve të Lindjes nga ana tjetër, qenë shkaku i vetëm i industrializimit të Britanisë, por do të thotë se e gjitha kjo luajti një rol mjaft të rëndësishëm. Megjithatë, historianët liberalë të ekonomisë e hedhin poshtë këtë pretendim me arsyetimin se shpenzimet koloniale dhe për mbrojtjen si dhe politikatat intervencioniste shtetërore shkaktuan vetëm një 'keqshpërndarje' të burimeve të Britanisë, çka nuk solli rezultatete më të mira të mundshme. Prandaj në mungesë të tyre, vazhdon arsyetimi kundërfaktual liberal ose rikardian, do të ishin arritur nivele akoma më të larta rritjeje ekonomike.<sup>700</sup> Një argument i tillë e fshin ose e fsheh anën e errët dhe, me ose pa dashje, e ruan përfytyrimin e pastruar moralisht të industrializimit britanik të ushqyer nga shumë studiues eurocentrikë, e sidomos liberalë. Prandaj le t'i marrim dy kategoritë në fjalë, intervencionizmin shtetëror

<sup>699</sup> Anne-Marie Willis, *Illusions of Identity* (Sydney, New South Wales: Hale and Iremonger, 1993), fq. 96-97.

<sup>700</sup> Jeffrey G. Williamson, "Why was British Growth so Slow during the Industrial Revolution?", *Journal of Economic History* 44 (1984), 687-712.

dhe kolonializmin, për ta vlerësuar në mënyrë kritike këtë argument.

Çështja e parë që është për t'u shënuar, është se qasja kundërfaktuale na thotë vetëm atë që do të mund të kishte ndodhur në mungesë të intervencionizmit shtetëror, por nuk na shpjegon atë që në fakt ka ndodhur. Fakti mbetet se ngritja e ekonomisë britanike ndodhi në një kohë kur shpenzimet ushtarake, borxhi kombëtar dhe taksat e tarifave doganore arritën nivele tejet të larta. Kështu që edhe sikur rritja ekonomike të kish qenë më e theksuar në mungesë të intervencionizmit shtetëror, kjo nuk e hedh poshtë faktin se një ndërhyrje e tillë e theksuar ka ecur krahas me ngritjen e ekonomisë britanike. Por në kanonin liberal ka një shteg të hapur që vlen të vihet në dukje: liberalët janë gati ta pranojnë se ndërhyrja mund të ketë patur një efekt pozitiv ekonomik në kushtet e një kërkese të brendshme të ulët. Intervencionizmi shtetëror është i frytshëm kur brenda vendit nuk ka një kanal për përthithjen e prodhimit të shtuar. Ky shteg vlen të vihet në dukje pikërisht sepse në fakt në shekullin e tetëmbëdhjetë ka patur një mungesë të kërkesës së brendshme të grumbulluar, e cila njihet si 'kriza kejeziane'.<sup>701</sup> Atëherë ndoshta një argument më i përshtatshëm kundërfaktual do të ishte se kostoja 'reale' e mundësisë së humbur e intervencionizmit shtetëror do të mund të kish qenë ose çindustrializimi i ekonomisë britanike më së shumti, ose së paku një rrugë shumë më e ngadaltë dhe e gjatë zhvillimi.

Liberalët parashtrajnë dy argumente të tjera kundërfaktuale për të hedhur poshtë rolin pozitiv të imperializmit në industrializimin e Britanisë. I pari është se çfarëdo që mund të kenë qenë përfitimet ekonomike të kolonive për Britaninë, kostot ushtarake për mbrojtjen e kolonive kanë

<sup>701</sup> Weiss dhe Hobson, *States*, fq. 119-123; O'Brien dhe Engerman, "Exports", fq. 193-209.

qenë shumë më të mëdha. Prandaj, thonë ata, në mungesë të kolonive ekonomia britanike do të kish qenë më produktive duke qenë se kjo do t'i kishte rritur më tej kursimet (ose, sipas J. A. Hobson-it, do ta kishte rritur kërkesën e brendshme të grumbulluar). Lance Davis dhe Robert Huttenback pretendojnë se midis viteve 1860-1912, taksapaguesi britanik ishte më i rënduari në Europë dhe paguante mesatarisht 1.14 paundë për mbrojtjen (krahasuar me 0.86 paundë që paguante francezi dhe 0.75 që paguante gjermani).<sup>702</sup> Ata gjithashtu vënë në dukje se shpenzimet e Britanisë për mbrojtje ndaheshin në 'mbrojtje të brendshme' dhe 'mbrojtje imperiale'. Ata hedhin mendimin se sikur Britania të kishte hequr dorë nga kolonitë, taksapaguesi britanik do të që lehtësuar me afërsisht 30 centë, çka do të rezultonte në një rritje të ndjeshme të kursimeve dhe investimeve.

Problemi kryesor me këtë argument është se matja e shpenzimeve për mbrojtjen në një monedhë të caktuar, nuk arrin ta nxjerrë në pah barrën e vërtetë tatimore dhe prandaj nuk na thotë asgjë për mundësinë reale për të paguar. Për ta bërë këtë lipset që shpenzimet për mbrojtjen të vlerësohen në raport me të ardhurat kombëtare. Sipas përllogaritjeve të mia, barra reale mesatare e mbrojtjes për fuqitë e mëdha në periudhën 1870-1913 ka qenë si vijon: Britania 3.2%, Gjermania, 3.8%, Franca 4%, Rusia 5.1%, Japonia 8.2%.<sup>703</sup> Dhe le të vihet re se një dallim prej 1% të të ardhurave kombëtare është mjaft domethënës. Është e qartë se taksapaguesi britanik ka qenë i privilegjuar si i nëntaksuar dhe jo i mbitaksuar. Më e rëndësishme akoma, nëse kostoja

<sup>702</sup> Lance Davis dhe Robert Huttenback, *Mammon and the Pursuit of Empire* (Cambridge: Cambridge University Press, 1988).

<sup>703</sup> John M. Hobson, "The Military Extraction Gap and the Wary Titan: The Fiscal Sociology of British Defence Policy, 1870-1913", *Journal of European Economic History* 22 (3) (1993), 463-473, 478-493. Shih, gjithashtu, Niall Ferguson, "Public Finance and National Security: the Domestic Origins of the First World War Revisited", *Past and Present* 142 (1994), 148-153.

e kolonive ka qenë rreth 30% e shpenzimeve për mbrojtjen në total, barra e vërtetë përfundimtare imperialo-mbrojtëse e Britanisë i bie të ketë qenë vetëm 1% e të ardhurave kombëtare. Në terma realë kjo është e barazvlefshme me shumat e papërfillshme që Islanda ka shpenzuar për mbrojtjen në gjysmëshekullin e fundit. Siç ka qenë i detyruar edhe Paul Kennedy ta pohojë: 'Tipari më i jashtëzakonshëm i *Pax Britannica*-s pas 1815-ës ka qenë lirësia e saj'.<sup>704</sup> Si përfundim, duke patur parasysh se taksapaguesi britanik ka qenë gjithsesi i nëntaksuar në krahasim me taksapaguesin e Europës kontinentale, është e vështirë të thuash se si kolonitë mund të kenë përbërë barrë fiskale në çfarëdo kuptimi real në periudhën pas 1850-ës. Dhe siç konkludon edhe Avner Offer, është e vështirë ta thuash se si kostot minimale të imperializmit mund t'i kenë tejkaluar përfitimet e mëdha ekonomike që siguronin kolonitë.<sup>705</sup>

Një kundërpërgjigje e dukshme do të ishte se, në periudhën para 1815-ës, kostot reale të mbrojtjes për Britanisë ishin tejet të larta (siç e vura në dukje në pjesën e mësipërme). Nisur nga kjo mund të thuhet se në këtë periudhë, kostot tejet të larta imperiale i kanë tejkaluar përfitimet ekonomike nga kolonitë. Këtij argumenti unë i përgjigjem në dy mënyra. Së pari, Britania ka qenë në luftë jo më pak se dymbëdhjetë herë mes viteve 1715-1815. Sipas një eksperti, më pak se gjysma e këtyre luftrave kanë qenë për zotërimet koloniale, por edhe kur kanë qenë, kolonitë vetë zakonisht nuk kanë qenë faktori kryesor.<sup>706</sup> Së dyti, siç u shpjegua më lart, ndërsa kostot e luftës (për kolonitë ose çfarëdo qoftë) kanë qenë vërtet tejet të larta në periudhën 1715-1815, këto

<sup>704</sup> Paul M. Kennedy, *The Realities Behind Diplomacy* (London: Fontana, 1989), fq. 32, theksimi im.

<sup>705</sup> Avner Offer, "The British Empire, 1870-1914: a Waste of Money?", *Economic History Review* 46 (2) (1993), 215-238.

<sup>706</sup> K. J. Holsti, *Peace and War* (Cambridge: Cambridge University Press, 1991), kapitulli 5.

sipas të gjitha gjasave do të kishin shërbyer për të stimuluar industrializimin, po të marrim parasysh se në këtë periudhë ekonomia britanike vuante nga kërkesa e ulët e grumbulluar.

Argumenti i dytë kundërfaktual thotë se tregjet e garantuara koloniale i shërbenin vetëm vazhdimin të industrive të prapambetura britanike dhe kostoja e kësaj ishte mundësia e humbur për zhvillimin e industrive të reja e më jetike. Por po të marrim parasysh se këta autorë zakonisht e fushin edhe industrinë tekstile të pambukut në këtë kuadër, kjo vështirë se e shpjegon se si proteksionizmi dhe tregjet koloniale bënë të mundur ngritjen e kësaj industrie së pari. Megjithatë Thomas dhe McCloskey përgjigjen se: 'në pamje të parë tingëllon e çuditshme të arsyetosh se pa tregjet e jashtme [koloniale] për prodhimet e saj të pambukut ... Britania do të kishte mundur të gjente tregje brenda vendit'. Sigurisht, ata e pranojnë se kërkesa e brendshme nuk do t'i kishte përballuar dot nivelet e prodhimit. Por, arsyetojnë ata, 'në afat të gjatë ... njerëzit dhe paratë e përdorura për prodhimin e tepërt të pambukut do të ishin orientuar drejt birrës, rrugëve, shtëpive e të tjera gjërave të brendshme'.<sup>707</sup> Ndoshta, por kjo nuk ndodhi. Sido që të jetë, është e vështirë të merret me mend se si prodhimi i birrës dhe ndërtimi i rrugëve e shtëpive do të mund të kishte siguruar një rezultat më të kënaqshëm se ai i arritur nga eksporti i prodhimeve britanike të pambukut. Ç'është më e rëndësishme, asgjë nga këto nuk mund ta hedhë poshtë faktin e thjeshtë se përfitimet e shumta nga kolonitë dhe intervencionizmi shtetëror e ndihmuan pozitivisht ekonominë britanike, edhe sikur e gjitha kjo të ketë qenë, për ta thënë me termin e preferuar të ekonomistëve liberalë, 'suboptimale'. Suboptimalizëm i thënçin!

<sup>707</sup> Thomas dhe McCloskey, "Overseas Trade", fq. 100.

# **PJESA IV**

**Konkluzion: perëndimi oriental karshi mitit  
eurocentrik të Perëndimit**



## 12. MITET BINJAKE TË SHTETIT LIBERALO-DEMOKRATIK RACIONAL PERËNDIMOR DHE TË HENDEKUT TË MADH MIDIS LINDJES DHE PERËNDIMIT, 1500-1900

Kush e njih veten dhe tjetrin,  
do ta kuptojë se Lindja dhe Perëndimi  
nuk mund të ndahen

*Goethe*

Siç e kemi parë përgjatë tërë këtij libri, eurocentrizmi vendos një vijë të prerë ndarëse midis Lindjes dhe Perëndimit, e cila shërben për t'i paraqitur këto të dyja jo vetëm si të ndara, por cilësisht të ndryshme (në kuptimin zhvillimor). Ç'është më e rëndësishme, siç e vumë në dukje në kapitullin 1, brenda ligjërimit eurocentrik ky hendek nënkupton një lloj aparteidi intelektual kur Perëndimi superior është në karantinë kundrejt Lindjes inferiore. Lindja gjoja është e mbushur me institucione despotike e irracionale që e bllokojnë zhvillimin ekonomik. Ky pretendim mbështetet në teorinë e despotizmit oriental (ose çka Max Weber e quan 'patrimonializëm'). Kurse nga ana tjetër, prania e shteteve racionale e liberale në Europë ka bërë që vetëm Perëndimi të jetë i aftë për zhvillim ekonomik progresiv. Pjesa I e këtij libri shtjelloi idenë se teoria e despotizmit oriental është sajësë dhe e fsheh si praninë e shteteve relativisht racionale, ashtu edhe zhvillimin domethënës ekonomik në Lindje. Por mbetet të shihet se në ç'masë shteti perëndimor ka qenë racional siç e merr për të mirëqenë eurocentrizmi. Për ta vlerësuar këtë pretendim, do të përqendrohëm në tri aspekte të 'shtetit racional':

- 1 një burokraci e centralizuar ‘racionalo-ligjore’ e cila funksionon sipas normash jopersonale (e jo arbitrare) dhe presupozon një ndarje të qartë mes sferës publike dhe asaj private;
- 2 një qëndrim ‘minimalist’ ose *laissez-faire* ndaj ekonomisë (ku shteti nuk ndërhyr në funksionimin ‘e natyrshëm’ të tregut të lirë). Kjo njëkohësisht shkon në zemër të pretendimit se ekonomia është racionale në kuptimin që funksionon më së miri në mungesë të ndërhyrjeve e shtrembërimeve politike;
- 3 një prirje demokratike ku të drejtat politike qytetare janë të garantuara në favor të fuqizimit të individëve.

Ky kapitull i merr në trajtim të gjitha këto aspekte me radhë dhe arrin në përfundimin se shtetet perëndimore kanë qenë shumë më pak racionale se ç’është përfytyruar rëndom (duke përfshirë të gjithë periudhën ‘shpërthyesë’ 1500-1900). Dhe nëse shtetet lindore kanë qenë shumë më racionale se ç’është marrë si e mirëqenë nga eurocentrizmi (siç arsyetuaam në kapitujt 2-4), atëherë përfundimi duhet të jetë se racionaliteti ose Hendeku i Madh qytetërimor midis Lindjes dhe Perëndimit i përfytyruar nga eurocentrizmi, nuk mund të jetë i vërtetë.<sup>708</sup> Një përfundim i tillë e shemb kuadrin shpjegues eurocentrik për ngritjen e Perëndimit dhe hedh themelet për kuadrin tim antieurocentrik të parashtruar në kapitullin e fundit.

### **Miti i shtetit të centralizuar e racional perëndimor, 1500-1900**

Franca zakonisht konsiderohet si një nga shtetet më të centralizuara e racionale të Europës, e shenjtëruar në mitologjinë popullore nga deklarimi i famshëm, ndonëse vetë-

<sup>708</sup> Krahaso Graeme Gill, *The Nature and Development of the Modern State* (Basingstoke: Palgrave Macmillan, 2003), fq. 172-191.

mashtues, i Luigjit XIV, se *L'état c'est moi* (Shteti jam unë). Ky është një mit pikërisht sepse sfera publike në Francë nuk është ndarë nga ajo private në asnjë moment para shekullit të nëntëmbëdhjetë, e ndoshta as të njëzetë. Shteti francez ka patur vetëm një burokraci fiskale me centralizim të dobët dhe me shtrirje të kufizuar infrastrukurore në shoqërinë civile. Edhe rreth vitit 1800, raporti i burokratëve me popullatën ishte 1:4100.<sup>709</sup> Shtrirjen e dobët infrastrukurore të shtetit e nxjerr në pah fakti se ky i fundit, për një pjesë të madhe të të ardhurave të tij mbështetej në taksimin kolektiv e jo individual. Fshatarëve u përcaktohej vendndodhja në njësi kolektive komunale pjesërisht për qëllime taksimi. Nëse një pjesëtar nuk arrinte ta paguante pjesën e tij të taksës, do të përballlej me zemërimin jo të papërfillshëm të pjesëtarëve të tjerë.<sup>710</sup> Me fjalë të tjera, anëtarët e komunës, dhe jo shteti, ishin përgjegjës për vjeljen e taksave. Veç kësaj, shteti ishte tejet i varur nga *taille* (taksa e tokës), në ndryshim nga taksat mbi veprimtarinë tregtare. Në tërësi, taksat në Francë ngarkoheshin në mënyrë arbitrare dhe sipas rastit (domehtënë, pandershmërisht), dhe të dhënat për taksat e vjela ishin në masë të madhe të padukshme për publikun. Kjo vetem shërbente për të përforcuar perceptimin e përgjithshëm se shteti ishte i padrejtë dhe tendencioz ndaj interesave private, në kurriz të publikut.<sup>711</sup>

Përzierja e sferave publike dhe private nuk del në pah më qartësisht nga fakti se shteti mbështetej në korrupsion, që do të thotë, në shitjen e ofiqeve individëve të pasur privatë në këmbim të një pagese të vetme në total. Problemi

<sup>709</sup> Linda Weiss dhe John M. Hobson, *States and Economic Development* (Cambridge: Polity, 1995), fq. 45.

<sup>710</sup> Margaret Levi, *Of Rule and Revenue* (London: University of California Press, 1988), fq. 112, 115.

<sup>711</sup> John D. Brewer, *The Sinews of Power* (London: Unwin Hyman, 1989), fq. 129-132.

është se këta individë e përdornin ofiqin e tyre publik për të zgjeruar fitimet e tyre private sipas modelit patrimonial (duke thithur deri në 50% të të ardhurave shtetërore). Domethënës është fakti se ishte paefekshmëria e sistemit tati-mor ajo që shkaktoi krizën fiskale e cila çoi në Revolucionin Francez të 1789-ës.<sup>712</sup> Më pak i mirënjohur është fakti se tregu ndërkombëtar i bonove i ngriti çmimet e borxheve shtetërore të Francës (duke ngritur interesat) për shkak të mungesës së besimit në aftësinë e shtetit francez për të paguar borxhet, çka e acaroi më tej krizën fiskale.<sup>713</sup> Shkurt, shteti francez nuk ishte kurrsesi institucioni racional që përfytyron imagjinata eurocentrike, me siguri jo në ndonjë moment para shekullit të nëntëmbëdhjetë, në mos të njëzetë.

Prusia, e cila gjithashtu zakonisht mbahet si një nga shtetet më racionale të Europës, bie në sy vetëm për shkallën e saj të theksuar të irracionalitetit. Elektori i Madh i Prusisë, Friedrich Wilhelm (1640-88) njëri deklaroi, ndonëse pa famën e Luigjit XIV: 'E rrënoj autoritetin e junkerëve dhe e ndërtoj sovranitetin tim si shkëmb prej bronzi'. Por ky është një tjetër ushtrim në mitndërtim. Fakti është se junkerët – klasa e pronarëve prusianë të tokave të cilët mbushnin radhët e burokracisë – e përdornin vazhdimisht ofiqin e tyre publik si mënyrë për të grumbulluar pushtet privat. Agjenda politike shtetërore ishte në masë të madhe e ngarkuar me interesat private të kësaj klase në dëm të drejtëpërdrejtë të masave, nga politika fiskale, në politikën e tregtisë, në atë të jashtme e shumë të tjera. Dhe sistemi politik mbeti tejet i shtrembëruar në favor junkerëve deri në revolucionin e 1918-ës. Kështu, për shembull, megjithëse në shekullin e

<sup>712</sup> C. B. A. Behrens, *The Ancien Regime* (London: Thames and Hudson, 1967), fq. 138-143.

<sup>713</sup> J. C. Riley, *International Government Finance and the Amsterdam Capital Market 1740-1815* (Cambridge: Cambridge University Press, 1980).

nëntëmbëdhjetë vërtet ekzistonte e drejta universale e votës në Gjermani, sistemi prusian treklasor zgjedhor, siguronte që zakonisht të fitonin interesat politike të junkerëve (çështje së cilës i kthehem më poshtë).

Raporti i vogël në Francë i burokratëve fiskalë për popullsi (1:4100) ngjan mbresëlënës krahasuar me atë të Prusisë: 1:38000.<sup>714</sup> Një tregues i qartë i paefektshmërisë së burokracisë ishte se deri në fundin e shekullit të nëntëmbëdhjetë, shteti prusian as nuk e dinte sa njerëz punonin për të. Siç e vë në dukje Michael Mann, 'nëse një shtet nuk numëron dot zyrtarët e vet, nuk mund të jetë burokratik as për së largu'. Në këtë linjë ai arrin në përfundimin se, 'do të ishte absurde që shteti prusian të quhej "burokratik", siç e quajnë shumica e historianëve'.<sup>715</sup> Për më tepër, megjithë reformat pas 1806-ës të ndërmarra nga Stein dhe Scharnhorst, push-teti i junkerëve nuk pësoi rënie deri më 1918 (siç u përmend më lart). Ironia e skajshme këtu është se mbështetjen më të fortë për këtë pretendim nuk e jep tjetërkush veçse Max Weber-it, i cili arsyeton se dështimet e politikës së jashtme gjermane në periudhën 1900-1918 ishin pasojë e drejtpërdrejtë e faktit se burokracia nuk ishte as mjaftueshëm racionale, as e centralizuar, as e kufizuar nga një shoqëri e fortë civile. Problemi ishte se burokracia që marrë peng nga interesat private irracionale të klasës dominuese agrare të junkerëve. Për këtë arsye u flijuan interesat kombëtare në altarin militarist të junkerëve në vitin 1914.<sup>716</sup>

Si përfundim, deri në fund të shekullit të nëntëmbëdhjetë, kandidatët më të mirë thjesht nuk arrijnë t'i përmbu-

<sup>714</sup> Weiss dhe Hobson, *States*, fq. 45.

<sup>715</sup> Michael Mann, *The Sources of Social Power*, II (Cambridge: Cambridge University Press, 1993), fq. 390, gjithashtu fq. 450-452.

<sup>716</sup> Max Weber, *Gesammelte Politische Schriften* (Tubingen: J. C. B. Mohr, 1988), fq. 126-127, 180-181, 230, 282, 377, 410. Shih, gjithashtu, John M. Hobson dhe Leonard Seabrooke, "Reimagining Weber: Constructing international society and the social balance of power", *European Journal of International Relations*, 7 (2) (2001), 239-274.

shin 'standardet racionale të civilizimit'. Shtetet madhore mbështeteshin në masë të madhe tek ofiqarët privatë dhe lokalë patrimonialë, të cilët i trajtonin ofiqet e tyre si patrimoninë e tyre private. Kjo na shpie në përfundimin e sigurt se burokracitë perëndimore katakterizoheshin më shumë nga normat patrimoniale e tradicionale sesa nga ato që u atribuohen burokracive moderne racionalo-ligjore.

### **Miti i shtetit minimalist liberal perëndimor, 1500-1900**

Siç arsyeton Max Weber, dhe sidomos Adam Smith, shteti racional ose i civilizuar mendohet se ndjek një politikë liberale ose minimaliste e cila e shmang ndërhyrjen në ekonomi (politika e *laissez-faire*).<sup>717</sup> Kjo është jetike pasi është ky element që e lejon ekonominë të funksionojë lirisht sipas ligjeve të veta të ofertës dhe kërkesës, duke bërë të mundur një shpërndarje racionale të mallrave dhe shërbimeve për të siguruar rezultatet më të mira. Prandaj shumëçka ngrihet mbi këtë pretendim. Për ta vlerësuar këtë aspekt, do të përqendrohëm kryesisht në politikën europiane për tregtinë. Pyetja është: sa e lejonin tregtinë e lirë shtetet europiane gjatë fazës së tyre të industrializimit?

Politika tregtare europiane spikat vetëm për mbizotërimin e proteksionizmit përmbi tregtinë e lirë. Kjo politikë vazhdoi nga shekulli i shtatëmbëdhjetë deri në gjysmën e dytë të shekullit të njëzetë. Mes viteve 1700-1846, shteti britanik ka vjelë tarifa doganore mesatarisht jo më pak se 32%. Për më tepër, tarifat industriale për Europën ishin 19% në vitin 1820, 10% më 1875 dhe 19% më 1913.<sup>718</sup> Jo më pak e

<sup>717</sup> Adam Smith, *The Wealth of Nations* (New York: The Modern Library, 1937 [1776]).

<sup>718</sup> Paul A. Bairoch, *Economics and World History* (Chicago: University of Chicago Press, 1993), fq. 40.

rëndësishme, 'epoka e tregtisë së lirë' e mesit të shekullit të nëntëmbëdhjetë ishte në fakt përjashtimi që vërtetonte rregullin proteksionist, siç u shpjegua në kapitullin 11 ku treguam se epoka mes viteve 1860-1877/9 u karakterizua nga një proteksionizëm i moderuar, dhe jo nga tregtia e lirë. Për më tepër, nëse e marrim periudhën 1860-1877/9 si përfaqësuese të epokës europiane të tregtisë së lirë (siç bëjnë shumë historianë), tarifa mesatare në këtë periudhë ishte afër 20%-ëshit. Për ta krahasuar, kjo shifër është e ngjashme me tarifën amerikane Smoot-Hawley të 1930-ës, e cila në literaturë zakonisht përshkruhet si një nga aktet më proteksioniste të miratuara ndonjëherë. Po ashtu është interesante të vihet në dukje se midis viteve 1600 dhe 1900, 'tregtia më e lirë' u arrit në Europë vetëm në 6% të kohës. Jo më pak interesant është fakti se gjatë gjithë kësaj periudhe, Europa kurrë nuk i arriti nivelet e ulëta të tarifave që ishin në Perandorinë Osmane gjatë shekujve të shtatëmbëdhjetë e tetëmbëdhjetë.

E rëndësishme gjithashtu është se fuqitë e mëdha europiane, sidomos Britania, kanë ndërhyrë në ekonomi përmes proteksionizmit doganor në masë të madhe për të vjelë taksën për qëllime ushtarake.<sup>719</sup> Një precedent i tillë që krijuar në epokën e merkantilizmit. Ministri i financave i Luigjit XIV, Colbert-i, e ka përmbledhur saktë besimin e përgjithshëm europian se: 'tregtia është burimi i financave [shtetërore] dhe financat janë damari jetik i luftës'.<sup>720</sup> Çështja kritike është se mjelja e ekonomisë për të ardhura fiskalo-ushtarake i trazonte të ashtuquajturat ligje të ofertës dhe kërkesës. Dhe kjo mbeti kështu deri në gjysmën e dytë të shekullit të njëzetë, çka të bën të mendosh se shtetet kyçe europiane e përfaqësonin në mënyra të ndryshme 'shtetin irracional patrimonial' të Weber-it.

<sup>719</sup> Weiss dhe Hobson, *States*, kapitulli 4.

<sup>720</sup> Colbert, cituar te E. H. Carr, *Nationalism and After* (London: Macmillan, 1945), fq. 5.

Si një lidhje me pjesën pararendëse (si dhe vijuese), është gjithashtu e rëndësishme të vihet në dukje se një nga arsytet për zbatimin e proteksionizmit doganor, ishte se shtetet europiane ishin shumë të dobëta për t'u mbështetur në taksimin progresiv mbi të ardhurat. Çka do të thotë se nuk ishin të centralizuara sa duhet; kishin burokraci të pamjaftueshme për të depërtuar në shoqëri për të vjelë taksat mbi të ardhurat dhe po ashtu nuk ishin demokratike sa duhet. Kësisoj, ato u mbështetën në taksat – e sidomos tarifat – e tërthorta regresive të cilat mund të vilesnin lehtë e në porte të caktuara, si dhe përdhunshëm, duke qenë se masat nuk kishin zë politik (shih më poshtë).<sup>721</sup> Deri në fillim të shekullit të njëzetë, regjimet fiskale europiane spikasin vetëm për regresivitetin e tyre. Kështu për shembull, në vitin 1900, raporti i taksave mbi të ardhurat me të ardhurat e përgjithshme të shtetit ishte 0% në Austri, Belgjikë, Francë, Gjermani e Suedi; 12% në Itali; 13% në Mbretërinë e Bashkuar; 15% në Danimarkë; 20% në Holandë; 39% në Norvegji dhe 55% në Zvicër,<sup>722</sup> kurse mesatarja në shtetet e Europës Perëndimore ishte 14%. Por edhe këto të dhëna fiskale e ekzagjerojnë progresivitetin e vërtetë të regjimeve fiskale. Sepse në shumicën e rasteve, taksimi mbi të ardhurat nuk ishte veçanërisht progresiv, ose ngaqë taksat ishin më të larta për grupet me të ardhura të ulëta, ose ngaqë grupet më të pasura ishin në gjendje t'i minimizonin thelbësisht taksat e tyre në gjithfarë mënyrash.

Jo më pak mbresëlënëse është fakti se deri në vitet 1960, Perëndimi për herë të parë në histori nisi të lëvizte drejt një tregtie të lirë të vërtetë (edhe pse kjo do të merrte mbi njëzet

<sup>721</sup> John M. Hobson, *The Wealth of States* (Cambridge: Cambridge University Press, 1997); krahaso, John A. Hobson, *Imperialism: a Study* (London: George Allen and Unwin, 1968 [1902]), fq. 94-109.

<sup>722</sup> Peter Flora, *State, Economy, and Society in Western Europe 1815-1975*, I (London: Macmillan, 1983), fq. 281-339. Une i kam korrigjuar shifrat e tij per Gjermanine.

vjet për t'u realizuar). Megjithatë, vetëm gjatë viteve 1960 shtetet perëndimore ishin demokratizuar dhe centralizuar mjaftueshëm për t'u lejuar qeverive që t'i shpëtonin sistemet e tyre fiskale nga varësia e deriatëhershme ndaj taksave regresive të tregtisë (domethënë tarifat proteksioniste) në favor të taksave mbi të ardhurat.<sup>723</sup> Për ta përmbledhur, mbështetja në taksat regresive të tregtisë përgjatë gjithë periudhës së kapërcimit ishte rrjedhojë e dobësisë së burokracive shtetërore dhe e mungesës së demokracisë, çka ishte lajtmotivi i shteteve 'irracionale paramoderne' patrimoniale. Veç kësaj, shteti i rriti tarifat për të mbrojtur interesat e ndryshme private (të klasës industriale dhe financiare) në kurriz të masave. Ekonomistët politikë këtë proces e quajnë 'rentëkërkim'. Sërish, rentëkërkimi mendohet të jetë lajtmotivi i shteteve irracionale 'patrimoniale', sepse nënkupton që shteti i privilegjon interesat e aktorëve privatë përmbi interesin publik.

Është e qartë pra se për sa i përket politikës tregtare europiane intervencionizmi shtetëror spikaste vetëm për nivelet e tij të larta. Më domethënëse akoma, ky intervencionizëm shtrihej në shumë fusha të tjera të ekonomisë.<sup>724</sup> Këtë kontekst më të gjerë për sa i përket industrializimit britanik e kam diskutuar në kapitullin 11, kështu që nuk do t'i përsëris këtu të njëjtat përfundime. Duke patur parasysh se Britania në përgjithësi mendohet si shteti *laissez-faire par excellence* gjatë fazës së tij të industrializimit, po t'i kthejmë sytë drejt kontinentit europian, me siguri nuk do të gjejmë aty praninë e 'shtetit minimalist' racional të Max Weber-it ose Adam Smith-it.

<sup>723</sup> Hobson, *Wealth*, veçanërisht fq. 19-20, 210-211.

<sup>724</sup> Per shembull, Clive Trebilcock, *The Industrialization of the Continental Powers 1870-1914* (London: Longman, 1981); Alexander Gerschenkron, *Economic Backwardness in Historical Perspective* (Cambridge, Mass.: Harvard University Press, 1962).

## Miti i shtetit demokratik perëndimor, 1500-1900

Eurocentrizmi pretendon se ndryshe nga despotizmi oriental, shteti demokratik perëndimor u njihte të drejta dhe liri individëve. Në këtë linjë, një shoqëri civile e fortë mendohet se ka qenë privilegj unik i Perëndimit (çka përbën arsyen kryesore pse vetëm Perëndimi kaloi në kapitalizmin modern). Siç e pamë në kapitullin 10, eurocentrizmi tipikisht e shtrin pas në kohë konceptin modern të demokracisë politike deri në Greqinë e lashtë, për të sajuar më pas një pikturë të përjetshme të demokracisë perëndimore duke e gjurmuar këtë koncept tek *Magna Carta* e Anglisë (1215), tek Revolucioni i Lavdishëm Anglez (1688/9) dhe tek Kushtetuta Amerikane (1787/9) dhe Revolucioni Francez (1789). Në këtë mënyrë, Europa dhe Perëndimi paraqiten si demokratike përgjatë ngritjes së tyre të gjatë. Problemi imediat këtu është se asnjë shtet perëndimor s'ka qenë demokratik para shekullit të njëzetë. Siç arsyeton James Blaut, historianët eurocentrikë kërkojnë 't'i çojnë pas deri në Mesjetë shumë nga virtytet pozitive të shoqërive europiane të cilat u shfaqën pas ngritjes së Europës, pasi Europa kishte kohë që e kishte filluar modernizimin e saj ekonomik'.<sup>725</sup> Çka do të thotë se historianët eurocentrikë përpiqen të 'shtyjnë pas në kohë' një koncept të shekullit të njëzetë që nuk ka patur zbatim të vërtetë më parë. Nëse është kështu, përparimi perëndimor nuk mund të ketë ardhur si rezultat i shtetit liberalo-demokratik dhe për rrjedhojë, as i një shoqërie civile të fuqishme.

Një lexim i shkurtër i tabelës 12.1 nxjerr në pah se shumica e shteteve perëndimore i njohën të drejtat politike qytetare për meshkujt vetëm në shekullin e njëzetë dhe në

<sup>725</sup> James M. Blaut, *Eight Eurocentric Historians* (London: Guilford Press, 2000), fq. 144.

shumë raste e drejta universale e votës u njoh vetëm në mesin e shekullit të njëzetë. Të vihet re se shtetet janë paraqitur në rend zbritës, me Norvegjinë si e para që njohu të drejtën universale të votës dhe SHBA bashkë me Portugalinë e Zvicrën, të fundit. Të dhënat spikasin vetëm për nivelet e ulëta të njohjes së kësaj të drejte deri në kapërcyell të shekullit të njëzetë. Kështu, në vitin 1900, vetëm 14% e të gjithë popullsisë australiane (mbi moshën njëzet vjeç) kishin të drejtën e votës, kurse në Gjermaninë e vitit 1912 kjo shifër ishte 39%. Befasues është fakti se krahasuar me Gjermaninë, situata ishte akoma më e keqe për shumicën e shteteve liberale europiane. Në vitin 1900 ose më vonë, përqindja e popullatës së rritur që gëzonte të drejtën e votës në Belgjikë ishte 4%; në Itali më 1909, 15%; në Zvicër më 1908, 16%; në Britani më 1910, 29%; në Danimarkë më 1913, 30%; në Norvegji më 1906, 35%; në Zvicër deri më 1967, 38% dhe në Francë, më 1940, 40%.<sup>726</sup> I vetmi shtet liberal që ia kaloi Gjermanisë qe Holanda, ku, në vitin 1901, 52% e popullsisë gëzonin të drejtën e votës. Për më tepër, vetëm shtatë nga katërbëdhjetë vendet e shqyrtuara këtu e njohën të drejtën e votës për meshkujt në shekullin e nëntëmbëdhjetë dhe asnjëri nuk e njohu të drejtën universale të votës në po këtë shekull.

Tabela 12.1 *Njohja e të drejtave politike qytetare në shtetet kryesore perëndimore*

Shteti	E drejta e votës për meshkujt	E drejta universale e votës
Norvegjia	1898	1913
Danimarka	1848	1915
Austria	1907	1918
Suedia	1918	1918

<sup>726</sup> Flora, *State*, fq. 96-151.

Holanda	1917	1919
Britania	1918	1928
Spanja1	-	1931
Franca	1848	1946
Gjermania	1849	1946
Italia	1919	1946
Belgjika	1919	1948
SHBA	1965 (1870)	1965
Portugalia	-	1970
Zvicra	1879	1971

---

*Burimi:* Ha-Joon Chang, *Kicking Away the Ladder* (London, Anthem Press, 2002), fq. 73.

Por edhe këto shifra të ulëta e ekzagjerojnë nivelin e vërtetë të qytetarisë politike. Në Prusi (e cila dominonte sistemin politik gjerman), sistemi i votës ishte i stisur në favor të grupeve më të pasura. Sistemi prusian i 'votës triklasore' ishte i ndarë në mënyrë të pabarabartë. Grupi i parë përbënte 3.5%-ëshin më të pasur të popullsisë, i dyti 13%-ëshin tjetër, kurse grupi i tretë më i varfër përbënte 83.5%. Por çdo grup kishte votë të barabartë, që do të thotë se 3.5% të majës kishin po aq peshë vote sa 83.5% të fundit, kurse 16.5% më të pasurit gëzonin një shumicë të fortë përmbi 83.5% më të varfrit. Për më tepër, nëse kësaj ia shtojmë faktin se parlamenti gjerman kishte vetëm të drejta të kufizuara dhe varej nga kancelari i Rajhut i cili nga ana e tij i përgjigjej perandorit, kuptohet qartë se koncepti i qytetarisë politike në Gjermani ishte i rremë.

Më përgjithësisht, në të gjitha vendet perëndimore të cilat njohën të drejtën e votës për meshkujt në shekullin e nëntëmbëdhjetë, një tufë shtrembërimesh e barrierash siguronin që demokracia të mbetej fantazi. Këto përfshinin votimin e hapur, çka çonte në blerjen e votës si dhe në mashtrimet e gjera zgjedhore (le të vihet re se vota e fshehtë u pra-

nua vetëm gjatë shekullit të njëzetë). Megjithëse Britania miratoi Aktin për Praktikën e Korrupsionit dhe Ilegalit në vitin 1883, impakti real i këtij akti për frenimin e korrupsionit zgjedhor, i cili mbeti një problem edhe për shumë kohë në shekullin e njëzetë. Situata ishte akoma më e rëndë në Shtetet e Bashkuara. Siç e vë në dukje Ha-Xhun Çang, megjithëse Amendamenti i Pesëmbëdhjetë u dha zezakëve të drejtën e votës në vitin 1870, kjo e drejtë më vonë u revokua në shtetet e jugut më 1890. Për më tepër, një sërë pengesash vazhduan në tërë vendin kundër zbatimit të amendamentit në praktikë.<sup>727</sup> Këto përfshinin pengesa të ndryshme formale, si kushtet për alfabetizëm dhe ato arbitrare të ‘karakterit’, ashtu si dhe pengesa informale, më e famshme ndër të cilat ishte kërcënimet kundër zezakëve të cilët votonin. Këto pengesa do të tejkaloheshin vetëm në vitin 1965 me miratimin e Aktit për të Drejtat e Votës. Gjithashtu është e rëndësishme të vihet në dukje se kostot tepër të mëdha të zgjedhjeve krijojnë shtrembërime të tjera që e cungonin demokracinë në praktikë. Siç përfundon Çang:

Me të tilla zgjedhje kaq ‘të shtrenjta’, nuk ishte ndonjë habi e madhe që zyrtarët e zgjedhur të ishin të korruptuar. Rreth fundit të shekullit të nëntëmbëdhjetë, korrupsioni legjislativ në SHBA, e sidomos në asamblatë e shteteve, u bë aq problematik sa presidenti i ardhshëm i SHBA-së, Theodore Roosevelt, do të qaj se anëtarët e asamblesë së Nju Jorkut, të cilët ua shisnin hapur votën grupeve të lobingut, ‘mendonin për jetën publike dhe shërbimin civil siç mendon shkaba për delen e ngor-dhur’.<sup>728</sup>

Për t’u shënuar gjithashtu është se SHBA qe një nga shtetet më të fundit perëndimore që përqafoi demokracinë

<sup>727</sup> Ha-Joon Chang, *Kicking Away the Ladder* (London: Anthem, 2002), fq. 74-75.

<sup>728</sup> Po aty, fq. 75-76.

politike. Kësisoj është e qartë se, deri në vitin 1900, demokracia e vërtetë politike në Perëndim mbetet fantazi. Siç shprehet Patricia Springborg:

Është ironia më e madhe në historinë e teorive mbi legjitimitetin shtetëror ... që Lindja ... pluraliste, transaksionale, sipërmarrëse ... të cilësohej 'despotike' nga Perëndimi pastoral, i amullt e relativisht i pazhvilluar, lëshimi kryesor i të cilit në emër të demokracisë ishin parlamentet, ku aksesi universal u njoh si e drejtë vetëm në shekullin e njëzetë të epokës sonë.<sup>729</sup>

### Përfundim

Një nga pretendimet kryesore të kapitujve 2-4 është se vendet lindore kanë qenë shumë më racionale e mundësidhënese ndaj zhvillimit se ç'sugjeron teoria eurocentrike e despotizmit oriental. Në këtë kapitull u mbrojt ideja se vendet perëndimore kanë qenë shumë më pak racionale dhe demokratike gjatë periudhës së kapërcimit se ç'e merr për të mirëqenë eurocentrizmi. Kjo i hedh poshtë pretendimet se midis Lindjes dhe Perëndimit ka patur një Hendek të Madh qytetërimor dhe ky përfundim ia heq duarsh eurocentrizmit shpjegimit e tij kryesor mbi ngritjen e Perëndimit. Çështja fundamentale tashmë mbetet përcaktimi i një pyetjeje më të përshtatshme me të cilën duhet filluar analiza që do t'i bëjmë shkëlqimit të Perëndimit, e cila nga ana e saj kërkon një përgjigje më të përshtatshme. Kjo i mbetet kapitullit të fundit.

<sup>729</sup> Patricia Springborg, *Western Republicanism and the Oriental Prince* (Austin: University of Texas Press, 1992), fq. 19.

### 13. NGRITJA E PERËNDIMIT ORIENTAL: IDENTITETI/VEPRUESHMËRIA, STRUKTURA GLOBALE DHE RASTËSIA

Nëse kam të drejtë kur kërkoj përmbysjen [e eurocentrizmit} dhe zëvendësimin e tij [me antieurocentrizmin], do të jetë e domosdoshme jo vetëm të rimendohen bazat fundamentale të 'qytetërimit perëndimor', por edhe të kuptohet depërtimi i racizmit dhe i 'shovinizmit kontinental' në të gjithë historiografinë, filozofinë apo historinë tonë të shkruarit.

*Martin Bernal*

Historia përvijohet nga lëvizje përtej vijës imagjinare që ndan Lindjen nga Eurazia Perëndimore.

*Herodoti*

Globalizimi i dijes dhe i kulturës perëndimore vazhdimisht riafirmon vetëperceptimin e Perëndimit si qendra e dijes legjitime, si arbitër i asaj që mund të quhet dije dhe si burimi i dijes 'së civilizuar'. Ky lloj dijeje globale zakonisht quhet dije 'universale', e gjindshme për të gjithë dhe 'e pazotëruar' nga askush, që do të thotë derisa studiuesit joperëndimorë të ngrejne pretendime mbi të. Kur bëhen të tilla pretendime, historia rishikohet (sërish), ashtu që historia e civilizimit të mbetet histori e Perëndimit. Për këtë qëllim, bota mesdhetare, pellgu i kulturës arabe dhe viset në lindje të Konstantinopojës përvetësohen si pjesë e historisë së civilizimit perëndimor, e filozofisë dhe e dijes perëndimore.

*Linda Tuhiwai Smith*

Kapitullin pararendës e mbyllëm duke vënë në dukje se pikërisht ato tipare që mendohej se kanë ndihmuar në shkëlqimin e Perëndimit sipas eurocentrizmit, racionaliteti

dhe demokracia, kanë munguar në Europë gjatë periudhës së kapërcimit të saj 1500-1900. Kështu që na nevojitet të zhvillojmë një shpjegim teorik alternativ antieurocentrik. Ky kapitull orvatet të bëjë pikërisht këtë, në katër faza. Pjesa e parë shtjellon mendimin se çështja e organizimit qendror e paraqitur nga eurocentrizmi, lipset të riformulohet para se të mund të rrokim qoftë versionin progresiv të historisë botërore, qoftë ngritjen e Perëndimit.

Pjesët 2-4 përvijojnë konturet e shpjegimit tim antieurocentrik, duke e vënë theksin në rëndësinë e strukturës globale e në përhapjen e 'kapaciteteve burimore' të Lindjes që u asimiluan në Perëndim, si dhe duke u përqendruar tek roli i identitetit evropian dhe në përvetësimin imperial të burimeve të Lindjes pas vitit 1492, çka hodhi themelet e fazës së fundit të ngritjes së Perëndimit. Së fundmi theksoj rëndësinë e rastësisë, kurse konkluzioni i përmbledh këto argumente duke kundërvënë antieurocentrizmin dhe eurocentrizmin për të ofruar një skicë alternative të historisë së botës. Ajo që rrjedh nga pretendimi im se Lindja ka luajtur rol thelbësor në ngritjen e Europën, është se na duhet ta zëvendësojmë idenë e Perëndimit të kulluar me atë të Perëndimit oriental.

### **Kërkimi i përgjigjes në vendin e gabuar – formulimi i një pyetje të re**

Eurocentrizmi gabon duke bërë pyetjen e gabuar që në fillim. Të gjithë studiuesit eurocentrikë e nisin [në mënyrë të shkoqur ose të nënkuptuar] duke bërë dy pyetje të ndër-lidhura: 'Çfarë tipari kishte Perëndimi që bëri të mundur kapërcimin e tij në modernitetin kapitalist?' dhe 'Çfarë tipari i Lindjes nuk e lejoi atë ta bënte këtë kapërcim?' Sigurisht, këto pyetje përshkojnë punën studimore të Max Weber-it

dhe që atëherë kanë mbetur qendrore për eurocentrizmin. Por, siç e vumë në dukje në kapitullin 1, shumë studiues nuk përpiqen në mënyrë të shkoqur apo të vetëdijshme të mbrojnë një korpus mendimi të quajtur eurocentrizëm. Por, me apo pa dashje, pyetjet standarde që bëhen detyrimisht shpjen në një rrëfim eurocentrik.

Në analizë të fundit, këto pyetje në mënyrë të nënkuptuar janë të ngarkuara kundrejt Lindjes. Së pari, ato e orientojnë studiuesin që ta konsiderojë të pashmangshëm ngritjen e Perëndimit. Kjo ndodh sepse studiuesit e nisin duke e marrë dominimin aktual të Perëndimit modern si fakt, të cilin pastaj e shtrijnë pas në kohë për të kërkuar gjithfarë faktorësh unikë perëndimorë që i kanë dhënë shkas këtij zhvillimi. Anasjelltas, duke e marrë dobësinë ose prapambetjen e Lindjes së sotme si fakt, sërish e shtrijnë atë pas në kohë për të kërkuar gjithfarë faktorësh që nuk e kanë lejuar kapërcimin në modernitet atje. Kësisoj, si përfundim i mveshin pashmangshmëri 'sëmundjes së sotme' të Lindjes. Ç'është më e rëndësishme, një çështje e tillë shpie detyrimisht në lëvdimin e arritjeve të Lindjes vetëm sipas kritereve të Perëndimit, gjegjësisht nëse ka arritur ta bëjë kapërcimin përfundimtar. Kësisoj, ngaqë Lindja qartazi nuk e ka arritur kapërcimin përfundimtar, çdo arritje ekonomike që mund të ketë shënuar Lindja detyrimisht konsiderohet si e parëndësishme. Në këtë proces Lindjes i mohohet çdo lloj kapaciteti progresiv ekonomik, për të konfirmuar se progresi ekonomik është dhe gjithmonë ka qenë monopol i Perëndimit.

Për ta përmbledhur, tri janë përfundimet e ndërlidhura që dalin nga pyetjet standarde: së pari, mveshja e një 'ligji të hekurt të zhvillimit perëndimor' si dhe i një 'ligji të hekurt moszhvillimi lindor'; së dyti, supozimi i 'subjektit proaktiv europian' kundrejt 'objektit pasiv lindor' në historinë botë-

rore dhe; së treti, ngritja e Perëndimit merret si një gjendje e përhershme dhe që mund të shpjegohet vetëm përmes faktorësh me rrënjët rigorozisht në Europë. Përfundimi i pastër i gjithë kësaj është se Perëndimi përfshihet në rrëfimin progresist të ngritjes së botës moderne kapitaliste, kurse Lindja përjashtohet nga ky rrëfim. Me dashje ose pa dashje, kjo sjell si rezultat të parët e ngritjes së Perëndimit si një lindje ngadhënjyese e të mrekullueshme virgjëreshe, çka përbën vetë thelbin e mitit eurocentrik të Perëndimit të kulluar.

Ky përfundim mund të kundërshtohet mbi bazën se është veçse e arsyeshme që të vështrohet drejt së kaluarës për të dalluar tiparet që kanë bërë të mundur ngritjen e Perëndimit dhe 'mosngritjen' e Lindjes. Ndryshe si mund t'i gjejmë një përgjigje kësaj pyetjeje? Por me përkufizim, pyetja detyrimisht nuk e lejon studiuesin të zbulojë faktin se Lindja jo vetëm ka arritur zhvillim domethënës ekonomik, por se kjo nga ana e saj ka ndihmuar në masë të madhe në ngritjen e Perëndimit. Shkurt, ky fakt alternativ nuk mund të rroket logjikisht nga një pyetje që e shpie studiuesin t'i trajtojë ngritjen e Perëndimit dhe tragjedinë e Lindjes si dy rrëfime të ndara nga njëra anë dhe nga ana tjetër ia zhvendos vëmendjen analitike drejt faktorëve progresivë që ekzistojnë vetëm brenda Perëndimit.

Për ta ilustruar pretendimin tim se problemi qëndron në pyetjet fillestare të parashtruara nga eurocentrizmi, vlen të bëjmë një eksperiment të thjeshtë mendor. Le të mendojmë sikur jetojmë, të themi, në vitet 900 të erës sonë. Siç tregohet në kapitullin 2, Lindja e Mesme dhe Afrika Veriore muslimane ishin djepi i qytetërimit në atë periudhë. Rajoni në fjalë ishte jo vetëm më i përparuari ekonomikisht në botë dhe përbënte qendrën e ekonomisë globale, por gëzonte edhe rritje të konsiderueshme ekonomike e ndoshta edhe rritje të të ardhurave për frymë, çka mendohet si *sine qua*

*non* e kapitalizmit modern (shih kap. 2-4). Nëse do të ngrinim një universitet në atë kohë dhe do të hulumtonim shkaqet e zhvillimit ekonomik të Islamit, mund të arrinim në këtë përgjigje: Lindja e Mesme dhe Afrika Veriore ishin të zhvilluara për arsye se kishin një tërësi unike institucionesh racionale e progresive. Së pari, ishte një rajon i paqtuar ku qytetet lindnin dhe kapitalistët përfshiheshin në tregti të largët globale. Së dyti, tregtarët muslimanë nuk ishin vetëm tregtarë, por edhe investitorë kapitalistë racionalë të cilët tregtonin, investonin dhe spekulonin në veprimtari globale kapitaliste për t'i rritur në maksimum fitimet e tyre. Së treti, që krijuar një tërësi institucionesh racionale, me një sistem likuidimi, banka që kryenin shkëmbim monedhash, pengje dhe huadhënie me interes, një lloj i veçantë kontabiliteti me regjistrim të dyfishtë, ligje partneriteti dhe kontraktuale, çka të gjitha flasin për një element të fuqishëm besimi. Së katërti, pas vitit 800 mendimi shkencor u zhvillua me hapa të shpejtë. Së pesti, Islami që veçanërisht i rëndësishëm në stimulimin e kapitalizmit në shkallë globale. Me siguri, askujt nuk do t'i shkonte mendja të shkruante një libër të titulluar 'Etika e Krishterë dhe Fryma Kapitaliste' ku Islami do të përshkruhej si 'ndrydhës i rritjes'. Gjasat do të ishin më të mëdha që të shkruhej një libër me titull 'Etika Islame dhe Fryma Kapitaliste', i cili do të nxirrte në pah pse vetëm Islami ka kapacitetin për zhvillim të madh ekonomik dhe pse Europa e krishterë do të mbetej përjetë e ngecur në amullinë agrare. Ose mund të biem dakord me pretendimin e bashkëkohësit Said el-Endelusi (i njohur më vonë si Ibni Haldun) se fakti që Europa ndodhet në një zonë të butë-të ftohtë nënkupton se banorët e saj janë injorantë, u mungon kureshtja shkencore dhe janë të destinuar të mbeten të prapambetur.

Ndryshe mund të shkojmë edhe në vitin 1100. Nëse do të ngrinim një universitet në atë kohë me një departament

të shkencave sociale, do të mund të orvateshim t'i jepnim përgjigje pyetjes imponuese të asaj kohe, gjegjësisht: Si arriti Kina e dinastisë Sung të bënte kapërcimin në prodhimin industrial si dhe një rritje intensive ekonomike (për frymë) ndërkohë që Europa kish ngecur në agrarizëm të prapambetur dhe në një komercializëm ralitivisht të dobët? Do të mund të jepnim këtë shpjegim: Kina zotëronte tipare dhe institucione unike që mungonin në Perëndim. Po ashtu kishte një shtet të fortë që krijonte një mjedis të qëndrueshëm e të paqtë dhe që promovonte në mënyrë aktive kushtet e domosdoshme për zhvillimin e kapitalizmit. Kurse Europa ishte e copëtuar në një luzmë shtetesh, ku asnjëri nuk ishte mjaft i fuqishëm për të krijuar një mjedis të brendshëm të paqtë aq sa të bënte të mundur zhvillimin e kapitalizmit. Për më tepër, ndërsa Kina i kishte zgjidhur problemet e saj të brendshme që në vitin 221 p.e.s. dhe kishte qenë në paqe që atëherë, Europa ishte një botë plot me shtete në luftë me njëri-tjetrin. Veç kësaj, Kina kishte një etikë të fortë pune që ishte pjesë e fesë së saj konfuciane, racionale si asnjë tjetër, kurse Europën e mbante peng Katolicizmi i cili promovonte respektin për autoritetin dhe një lloj fatalizmi afatgjatë që e pengonte zhvillimin e kursimit, punës së përkushtuar dhe shqetësimit racional. Ndoshta do të mund të shkruhej një libër me titull 'Etika Konfuciane dhe Fryma Kapitaliste', ku do të shpalosej pse Katolicizmi e pengon zhvillimin ekonomik dhe pse vetëm Konfucianizmi zotëronte virtytet e duhura që e bënin të pashmangshëm një zhvillim domethënës ekonomik.

Problemi i qartë këtu është se në shpjegimin e suksesit të Islamit apo të Kinës dhe të dështimit të Europës, detyrimisht arrijmë t'u mveshim shkaqe të përhershme një situate që ka qenë gjithmonë e ndryshueshme. Po ashtu, nëse do të uleshim në vitin 1900 për të hulumtuar shkëlqimin e Perën-

dimit, nuk do të ishte më pak problematike që ta kthenim me kokë poshtë teorinë e mëparshme për epërsinë e Islamit apo të Kinës. Kësisoj, në të gjitha shpjegimet kryerëm më shumë perëndimore për ngritjen e Perëndimit shohim një prirje për t'i mvëshur këtij të fundit veti të përhershme që e kanë bërë të pashmangshme kapërcimin e tij në kapitalizmin modern ('logjika e pandryshueshmërisë' e eurocentrizmit), duke nënkuptuar njëkohësisht një Lindje të prapambetur, përjetësisht të paaftë për t'u zhvilluar. Por nëse do të kemi parasysh se Lindja pati arritur zhvillim domethënës ekonomik pas vitit 500 dhe deri në vitin 1800 ka qenë më e përparuar se Perëndimi, bëhet e qartë se një analizë e tillë do të ishte krejtësisht e kotë. Dhe tashmë duhet të jetë e qartë se një ndërmarrje e tillë e kotë rrjedh pashmangshmërisht nga pyetja nga e cila niset eurocentrizmi.

Problemi kryesor me pyetjen 'Pse Europa dhe jo Kina?' apo 'Pse Perëndimi dhe jo Lindja?', është se këto janë pyetje absolute që kërkojnë përgjigje absolute, të tilla që do t'u mvëshnin tipare pozitive të përhershme Perëndimit dhe tipare negative të përhershme Lindjes. Prandaj ajo që na duhet është një pyetje relativiste në kohë, e cila duhet të shmangë grackën e mvëshjes tipare të përhershme çfarëdo rajoni. Kjo është e rëndësishme pikërisht ngaqë mvëshja e tipareve unike dhe të përhershme Perëndimit detyrimisht e mjegullon rrëfimin alternativ lindor që jam përpjekur ta nxjerr në dritë në këtë libër. Shkurt, një pyetje relativiste në kohë do të na lejojë ta sjellim sërish Lindjen nga skaji marginal apo getoja e errët ku është burgosur nga historia eurocentrike e botës.

Si do të ishte një pyetje relativiste alternative? Duke ndjekur analizën e Jack Goody-t në librin e tij udhëçelës, mund të pyesim: Si dhe pse krahu udhëheqës i fuqisë globale ekonomike u zhvendos mes Lindjes dhe Perëndimit

midis viteve 500 dhe 1800, për të arritur kulmin me kapërcimin në kapitalizmin modern? Siç e kemi parë në këtë libër, Lindja udhëhiqte për sa i përket pushtetit intensiv dhe ekstensiv global mes viteve 500-1800 derisa lavjerrësi u kthye përfundimisht në favor të Perëndimit në shekullin e nëntëmbëdhjetë.

Një shpjegim i mundshëm për këtë është dhënë nga Michael Mann. Ky e pranon se Kina ka patur nivele më të larta pushteti ekstensiv se Europa së paku deri më 1500, por nga ana tjetër thotë se 'në një tjetër gamë pushteti, në atë të pushteteve intensive, sidomos në agrikulturë, Europa po kalonte përpara rreth viteve 1000'.<sup>730</sup> Kjo përbën bazën për refuzimin nga ana e tij e asaj që ai e quan prirje e historianëve revizionistë drejt 'vetëdenigrimit të Europës'. Por në dritën e argumenteve të parashtruara në librin e tij, ky pretendim për Europën duket problematik për disa arsye. Së pari, shumë nga teknologjitë jetike që e bënë të mundur revolucionin agrikulturor mesjetar të Europës, erdhën nga Lindja. Së dyti, agrikultura kineze mbeti superiore ndaj asaj europiane deri në shekullin e nëntëmbëdhjetë (siç e kanë pranuar edhe një sërë studiuesish eurocentrikë). Një pikë e tretë e ndërlidhur me këto është se udhëheqja e gjatë e Kinës ishte për shkak se teknologjitë agrikulturore kineze bënë të mundur nivele shumë më të larta pushteti intensiv. Këtë e pasqyrojnë më së miri fakti se kinezët kishin zhvilluar plugun me veshëz hekuri me hark, i cili ishte shumë më superior se plugu kaba mesjetar me veshëz druri katrorë që përdorej në Europë. Europeanët filluan ta arrinin Kinën vetëm gjatë shekullit të tetëmbëdhjetë, pjesërisht ngaqë adoptuan plugun e hekurt kinez (si dhe shumë teknologji të tjera agrikulturore e industriale kineze – shih më poshtë).

<sup>730</sup> Michael Mann, *The Sources of Social Power*, I (Cambridge: Cambridge University Press, 1986), fq. 378.

Mann e përdor edhe harkun gotik si një tjetër shembull të pushtetit superior intensiv të Europës.<sup>731</sup> Por kjo shpikje erdhi nga Lindja e Mesme muslimane përmes Amalfit. Prandaj problemi siç e shoh unë nuk është 'vetëdenigrimi i Europës', por prirja mbizotëruese mes historianëve botërorë në drejtim të 'vetëpromovimit të Europës'.

Në dritën e tërë kësaj, është e qartë se nuk mundemi të përcaktojmë një tërësi të përhershme e unike tiparesh për një rajon të caktuar. Siç e vë në dukje Goody:

E qartë është se arritjet superiore të Perëndimit nuk mund të shihen më si tipare të përhershme apo qoftë edhe jetëgjata të këtyre kulturave, por si rezultat i një prej luhatjeve të lavjerrësit ... Përvijimi më i thjeshtë i një teorie duhet të fillojë me pranimin e një alternimi.<sup>732</sup>

Tri pjesët në vazhdim përvijojnë përgjigjen time, e cila kërkon një analizë shumëshkakësore, të përqendruar në rolet e strukturës globale, faktorit veprues/identitetit dhe të rastësisë. Le t'i marrim të gjitha me radhë.

### **Struktura globale dhe veprimi lindor: përhapja dhe përvetësimi i burimeve lindore përmes globalizimit oriental në ngritjen e Perëndimit oriental**

Pjesa I e këtij libri përvijoi konturet e ekonomisë globale me udhëheqje afro-aziatke siç u shfaq pas vitit 500 (e prirë kryesisht, por jo ekskluzivisht, nga persët mesolindorë e afrikanoveriorët dhe më pas nga muslimanët). Siç e pamë në kapitullin 2, eurocentristët i përjashtojnë origjinat globale të ngritjes së Perëndimit mbi bazën se para dhe pas 1500-

<sup>731</sup> Po aty, fq. 404.

<sup>732</sup> Jack Goody, *The East in the West* (Cambridge: Cambridge University Press, 1996), fq. 8.

ës, tregtia europiane me 'periferitë' ka qenë marginale. Edhe sikur kjo të jetë e vërtetë (që nuk është), çështja kritike është se rëndësia përfundimtare e ekonomisë globale është se kjo e fundit ka krijuar një tërësi të gatshme arteriesh komunikimi që kanë lidhur pjesën më të madhe të globit dhe njëkohësisht kanë përbërë një linjë përcjellëse përgjatë së cilës 'kapacitetet burimore' kryesore të Lindjes arritën në Perëndimin e prapambetur në periudhën 500-1800. Po ashtu, rëndësi të veçantë ka patur Ura Islame e Botës, përmes së cilës kaluan shumë nga këto kapacitete në udhëtimin e tyre nga Lindja në Perëndim.

Pretendimi bazë këtu është se në çdo kulminacion madhor në zhvillimin e Europës, përvetësimi i ideve, institucioneve dhe teknologjive superiore të Lindjes ka luajtur një rol të madh, çka bie ndesh me fjalët e Lynn White se: 'parashtrimi im fundamental është ... se dominimi teknologjik i kulturës perëndimore nuk është karakteristik vetëm për botën moderne, por fillon të shfaqet në mesjetën e hershme dhe bëhet krejt i dukshëm në mesjetën e vonë'.<sup>733</sup> Por teknologjitë kritike, si yzengjitë, kapistalli, mulliri me erë dhe ai me ujë, me gjasë patkoi dhe ndoshta plugu mesjetar, u përhapën nga Lindja duke bërë të mundur revolucionet ekonomike dhe politike të mesjetës në Europë. Për më tepër, rrjedhat globale të migrimeve lindore që mbërritën në valë të njëpasnjëshme në Europë pas vitit 370, ndihmuan në krijimin e strukturës politike feudale. Faza tjetër e zhvillimit të Europës ka pasur të bëjë me 'revolucionet protokapitaliste' të ndryshme – si në tregti, prodhim, financa e lundrim – që mendohet se u prinë nga italianët pas vitit 1000. Por kapitulli 6 nxjerr në dritë se shtysa madhore për revolucionin financiar italian erdhi nga Lindja, sepse atje (krye-

<sup>733</sup> Lynn White, *Medieval Religion and Technology* (Berkeley: University of California Press, 1978), fq. 80.

sisht në Lindjen e Mesme) u zhvilluan për herë të parë partneritetet dhe kontratat (ose *commenda*), çeçet, kambialet, sistemi bankar, këmbimi valutor, huadhënia me interes për tregti dhe investim, ligjet kontraktuale dhe sistemet racionale të kontabilitetit, të cilat u përcollën dhe u përvetësuan të gjitha nga italianët. Të gjitha teknologjitë madhore që përbënë themelin e revolucionit lundrimor – busulla, hartat, fleta fundore e timonit, barku katror i anijes, sistemet me shumë vela dhe ndoshta vela trekëndore, u zhvilluan për herë të parë dhe me siguri u përsosën ose në Kinë ose në Lindjen e Mesme islame. Për më tepër, përparimet në shkencën indiane, kineze, ndoshta afrikane e sidomos islame (veçanërisht në matematikë dhe astronomi), si dhe përsosja e astrolabit nga arabët, bënë të mundur zhvillimin e teknikave detare të cilat më pas u përhapën duke bërë të mundur udhëtimet eksploruese të europianëve. Dhe së fundmi, por jo për nga rëndësia, prodhimi tekstil mesjetar europian, letërprodhimi, rafinimi i sheqerit dhe prodhimi i hekurit (dhe ndoshta orëbërja), të gjitha u bënë të mundura nga përhapja e teknologjive lindore. Ndërkohë që shumë nga këto u përhapën përmes ekonomisë globale, është për t'u vënë në dukje se kryqëzatat shërbyen gjithashtu si një përcjellës i rëndësishëm për përhapjen e burimeve lindore në Europë.

Kapitulli 8 nxjerr në pah risitë madhore lindore që u përhapën deri në Europë, duke i dhënë mundësinë kësaj të fundit të futej në fazën e 'arritjes' në shekullin e pesëmbëdhjetë. Idetë lindore (sidomos islame, por edhe hebreje, indiane, e ndoshta zezako-afrikane) qenë jetike në mundësimin e Rilindjes perëndimore dhe të revolucionit shkencor. Teknologjitë në themel të revolucionit ushtarak të Europës (1550-1660), si baruti, tyta dhe topi, të gjitha u zhvilluan për herë të parë gjatë revolucionit ushtarak kinez mes viteve

850-1290 (ndonëse edhe Lindja e Mesme muslimane kontribuoi në forma të rëndësishme). Veç kësaj, as origjina e shtypshkronjës nuk mund t'i njihet Gutenberg-ut, duke qenë se shtypi i parë i lëvizshëm metalik është shpikur në Kore në vitin 1403, dhe shumë teknologji ose ide shumë më të hershme kineze në lidhje me shtypshkronjën u përhapën për të bërë të mundur me vonesë 'kapërcimin evropian'.

Faza tjetër e rëndësishme në ngritjen e Perëndimit, e vlerësuar veçanërisht nga eurocentrizmi, është triumfi i revolucionit industrial britanik. Por kapitulli 9 e nxjerr në pah se si disa nga idetë e iluminizmit u huazuan drejtpërdrejt nga Lindja, e sidomos nga Kina. Për më tepër, shumica e teknologjive e teknikave kryesore ku u bazuan revolucionet agrikuturore e industriale britanike, u shpikën në Kinë dhe u përhapën përmes një sërë rrugësh tregtare globale. Këto përfshinin farëmbjellësen, prashitjen me kuaj, plugun me veshëz të hekurt me hark, makinën rrotulluese të shirjes, metodat e qarkullimit të të mbjellave, furrat me qymyr dhe furnaltat, metodat e prodhimit të hekurit dhe çelikut, teknologjitë e prodhimit të pambukut, kanalet dhe shkallët ujore, idenë e motorit me avull dhe shumë të tjera.

Si përfundim, në mungesë të një ekonomie globale dhe të globalizimit lindor, shumë nga kapacitetet burimore më të përparuara lindore nuk do të ishin përhapur deri në Perëndim dhe pa to, evropianët fare mirë do të mund të kishin mbetur në periferinë e prapambetur të ekonomisë globale me udhëheqje afro-aziatike. Nëse do të kishte ndodhur kështu, sigurisht, s'do të kish qenë fare nevoja për të shkruar një libër mbi ngritjen e Perëndimit, por studiuesit e shkencave sociale do të debatonin pse Lindja ka qenë kaq progresive e jo më pak dhe pse Europa ka mbetur një shoqëri e prapambetur dhe e pandryshueshme, që luhatet në periferi të sistemit më të përparuar aziatik. Pa dyshim, teks-

ti kryesor 'oksidentalist' do të kish qenë 'Afro-Azia dhe Popujt pa Histori' (për të perfrazuar librin e Eric Wolf 'Europa dhe Popujt pa Histori'). Dhe pa dyshim, dikush do të ishte duke shkruar një libër kritik ndaj oksidentalizmit, duke treguar se si Perëndimi ka luajtur rol domethënës në formimin e Lindjes, të titulluar ndoshta 'Originat Perëndimore të Qytetërimit Lindor' ose 'Lindja Oksidentale'.

Megjithatë, fakti mbetet se Europa, e jo Lindja, kapërceu në modernitetin kapitalist (sigurisht, siç janë të ethshëm ta vënë në dukje studiuesit eurocentristë). Por nëse kjo nuk është rezultat i racionalitetit, gjenialitetit e liberal-demokracisë superiore të Perëndimit (siç tregohet në kapitujt 12 dhe 2-4), një teori alternative do të mund të ishte se Perëndimi shkëlqeu falë kapacitetit të tij adoptues dhe në mënyrë domethënëse, disa studiues eurocentrikë në fakt e kanë ndjekur këtë linjë, si për shembull:

Ajo çka e ka bërë të jashtëzakonshëm atë [Perëndimin], ka qenë më pak aftësia shpikëse sesa gadishmëria për të mësuar nga të tjerët e për të imituar, aftësia për të përveçësuar mjete e teknika të shpikura në pjesë të tjera të botës, për t'i ngritur ato në nivele më të larta efikasiteti, për t'i shfrytëzuar ato për qëllime të tjera dhe me intensitet më të lartë.<sup>734</sup>

Ky argument me siguri vlen deri diku, duke qenë se evropianët arritën t'i përvetësonin kapacitetet burimore të Lindjes në mënyrë të frytshme (edhe pse do të duhej një kohë e gjatë para se të udhëhiqnin). Por megjithëse qartazi ka qenë një faktor i rëndësishëm, ky kapacitet përvetësues nuk mund të përbëjë një shpjegim të mjaftueshëm për ngritjen e Perëndimit. Kjo për dy arsye kryesore.

<sup>734</sup> F. Oakley, cituar te Goody, *East*, fq.8.

Së pari, në ngritjen e Perëndimit ka patur shumë rastësi dhe fat (çka e trajtoj më poshtë). Së dyti, argumenti i adoptimit do të mund të zinte pozitë qendrore vetëm nëse do të përvetësonim një qasje strukturalisto-materialiste. Por siç e thekson pjesa në vazhdim, në kuadrin tim shpjegues unë përfshij edhe rëndësinë e veprueshmërisë dhe të identitetit evropian. Me këtë e kam fjalën për identitetin grabitqar dhe gjithnjë e më racist të evropianëve çka solli dhe ushqeui imperializmin, i cili nga ana e tij ndihmoi në mundësimin e fazës së vonë të ngritjes së Perëndimit. Me fjalë të tjera, thjesht asimilimi apo adoptimi i kapaciteteve burimore të Lindjes ka qenë një faktor i domosdoshëm, por jo i mjaftueshëm, në zhvillimin e Perëndimit.

Për ta përmbyllur këtë pjesë: rëndësia kryesore e argumentit 'asimilacionist' është se e kundërshton supozimin eurocentrik për një dallim radikal midis Lindjes dhe Perëndimit nga njëra anë dhe margjinalizimin e Lindjes në rrëfimin progresiv të historisë botërore nga ana tjetër. Kësisoj mund të shohim se që nga viti 500 i erës sonë, Lindja dhe Perëndimi nuk kanë qenë njësi të ndara, por kanë qenë gjithmonë të ndërthurura 'pa teklif' (*promiscuously*, për të huazuar shprehjen e Michael Mann-it).<sup>735</sup> Veçanërisht, Lindja nuk mund të paraqitet si një viktimë apo bartëse pasive e fuqisë evropiane, jo më së paku ngaqë jo vetëm krijoi një ekonomi globale pas vitit 500, por për një kohë të gjatë që përpara evropianëve. Siç e vë në dukje Andre Gunder Frank:

nuk ka patur një 'ekonomi botërore evropiane' veçmas 'ekonomisë botërore indo-oqeanike'. Nëse ka qenë njëfarësoj, kjo e fundit e ka përfshirë të parën dhe jo e kundërta ... E vetmja 'përgjigje' është të kuptohet se Europa

<sup>735</sup> Mann, *Sources*, I, kapitulli 1.

dhe Azia ... kanë qenë pjesë e së njëjtës ekonomi botërore prej shumë kohësh dhe se pjesëmarrja e tyre e përbashkët në të u ka dhënë formë fateve të tyre 'të ndara'.<sup>736</sup>

Mbi të gjitha, origjinat e modernitetit kapitalist si dhe të globalizmit nuk mund të zbulohen në kuadër të një Perëndimi udhëçelës e të pavarur, por duhen ritreguar përmes një procesi afatgjatë historik globalo-kumulativ (ose të një procesi 'konfluente globale'),<sup>737</sup> ku Lindja, e bashkuar me Europën përmes globalizimit lindor që në vitet 500, ka luajtur një rol jetik në rrëfimin progresiv të ngritjes së Perëndimit. Megjithatë, me po të njëjtin kriter, do të ishte gabim që Perëndimi të shihej si një përfitues pasiv i bujarisë lindore (si në oksidentalizëm), jo më së paku ngaqë europianët patën një kontribut të rëndësishëm në të gjithë procesin. Veprueshmëria europiane përbën në fakt ana tjetër të argumentit tim të përgjithshëm.

### **Veprueshmëria/identiteti europian dhe përvetësimi i burimeve lindore në ngritjen e Perëndimit oriental**

Mënyra e dytë se si Lindja ka bërë të mundur ngritjen e Perëndimit oriental ka qenë përmes përvetësimit të burimeve lindore nga Europa. Kritik për argumentin tim këtu është theksimi i veprueshmërisë ose identitetit europian. Le të kujtojmë se rrëfimet eurocentrike vënë theks të veçantë mbi veprueshmërinë europiane dhe sidomos në progresivi-

<sup>736</sup> Andre Gunder Frank, *ReOrient* (Berkeley: University of California Press, 1998), fq. 335-336.

<sup>737</sup> Frazja që Nathan Sivin i atribuon kornizës të perdorur nga Joseph Needham; shih Sivin, hyrjen e redaktorit, të Joseph Needham dhe Lu Gwei-Djen, *Science and Civilisation in China*, VI (6) (Cambridge: Cambridge University Press, 2000), fq. 13-14. Termi i Pacey-it, "dialog global", është gjithashtu i dobishëm; Arnold Pacey, *Technology in World Civilization* (Cambridge, Mass.: MIT Press, 1991); krahaso, Jerry H. Bentley, *Old World Encounters* (New York: Oxford University Press, 1993).

tetit moral (sidomos liberalizmi dhe demokracia) dhe 'shqetësimit racional' të Europës, çka do të bënin të mundur ngritjen autonome dhe të pashmangshme të Perëndimit. Prandaj ndoshta nuk është për t'u habitur që studiuesit kryesorë antieurocentrikë ndajnë dëshirën e përbashkët për ta lënë krejtësisht mënjanë veprueshmërinë ose identitetin europian.

Vetëm në këtë mënyrë, mendojnë ata, mund të prodhohen një teori që nuk e ekzagjeron unikalitetin e Perëndimit. Kjo nga ana tjetër i shpie të prodhohen teori thelbësisht materialiste. Ja si shprehet për këtë Janet Abu-Lughod:

Pretendimi im është se konteksti – gjeografik, politik e demografik – ku ka ndodhur zhvillimi, ka qenë shumë më domethënës e përcaktues sesa çdo faktor i brendshëm psikologjik apo institucional. Europa bëri përpara sepse 'Orienti' ishte përkohësisht në rrëmujë ... Fakti se 'Perëndimi fitoi' në shekullin e gjashtëmbëdhjetë kurse sistemi i mëparshëm [lindor] dështoi, nuk mund të përdoret për të arsyetuar bindshëm se vetëm institucionet dhe kultura e Perëndimit do të mund të kishin fituar.<sup>738</sup>

Eric Wolf e pohon qëndrimin e tij materialist duke rithirrur premisën e punës të Marksit: 'Ndryshe nga ata që mendojnë se Mendja ndjek një rrjedhë të vetën të pavarur, do të thoja se ideologjibërja ... ndodh brenda diapazonit të përcaktuar të një mënyre prodhimi të zbatuar për ta bërë natyrën të nënshtrueshme për përdorimin njerëzor'.<sup>739</sup> Por refuzimin më të fortë të 'ideacionalizmit' e ka bërë James Blaut, i cili këmbëngul se imperializmi europian nuk mund të shpjegohet me një ndjesi unike 'etjeje kulturore' nga ana e europianëve. Siç shprehet vetë ai:

<sup>738</sup> Janet L. Abu-Lughod, *Before European Hegemony* (Oxford: Oxford University Press, 1989), fq. 18, 354.

<sup>739</sup> Eric R. Wolf, *Europe and the People Without History* (Berkeley: University of California Press, 1982), fq. 388, dhe fq. 385-391.

Për ta pranuar këtë, do duhej besuar se në kulturën europiane ka diçka absolutisht fundamentale ... që i bën europeanët të ndryshëm nga njerëzit e tjerë. Kjo pranon një pjesë të mirë të pretendimit eurocentrik se europianët janë unikë ndër njerëzit, por thjesht e kthen përmbysh argumentin dhe pretendon se unikaliteti i tyre qëndron jo në progresivitet, por në agresivitet, grabitqari dhe makutëri.<sup>740</sup>

Po në të njëjtën faqe ai vazhdon duke thënë se, 'komunitetet gjakësore protokapitaliste, të gatshme e të ethshme për të pushtuar, plaçkitur e skllavëruar kudo që kjo gjë sillte përfitim, gjendeshin në shumë pjesë të hemisferës lindore, në të trija kontinentet'.

Unë e nis me supozimin se në konceptimin e një rrëfimi antieurocentrik, nuk na duhet patjetër ta flakim tutje vep-rueshmërinë bashkë me llumin eurocentrik. Së pari, kjo gjë më së paku do të bartte rrezikun e krijimit të një lloji oksidentalizmi ku Europa do të paraqitej vetëm si një 'përfituese pasive' e forcave apo influencave globale të lindore. Një rrëfim i tillë do të mund të gjendej në një libër me titull 'Afro-Azia dhe Popujt pa Histori' (siç u vu në dukje më lart). Por kjo vetëm sa do të riprodhonte ligjërimin difuzionist dhe esencializmin që e shoqëron atë (ndonëse në favor të Lindjes kundrejt Perëndimit). Së dyti, është e rëndësishme që të mos konkretizohet struktura e jashtme ose globale. Nuk është ky vendi për t'i përsëritur të gjitha argumentet e bëra kundër teorisë së Immanuel Wallerstein-it për sistemet botërore. Çështja themelore që kërkohet të vihet në dukje këtu është se është me rëndësi që t'i rezistohet logjikës funksionaliste të një qasjeje globalo-strukturore. Po ashtë ky është as vendi për t'iu rikthyer 'debatit veprues-strukturë' i

<sup>740</sup> James M. Blaut, *The Colonizer's Model of the World* (London: Guilford Press, 1993), fq. 208, n. 2.

cili është kthyer në një industri të vërtetë shtëpiake brenda sociologjisë. Por siç arsyeton me të drejtë E. P. Thompson në kritikën që i bën strukturalizmit të Althusser-it, vepruesit nuk mund të shihen si *Träger*, domethënë si bartës pasivë të strukturave.<sup>741</sup> Dhe së treti, në kundërshtim me Frankun, Pomeranz-in e të tjerë,<sup>742</sup> një nga arsyet pse individët nuk janë ‘bartës pasivë të strukturave’, është se ‘struktura’ (qoftë e brendshme apo globale) nuk është ‘diku atje’, e pavarur ndaj të kuptuarit ose perceptimeve tona. Perceptimet e vepruesve që lidhen me identitetin, janë të rëndësishme në udhëheqjen dhe frymëzimin e interesave dhe akteve të vepruesve, që do të thotë se vepruesit veprojnë dhe përgjigjen ndryshe brenda të njëjtit mjedis strukturor në varësi të identitetit të tyre. Thënë më thjesht, mënyra se si vepruesit mendojnë për botën, përcakton edhe mënyrën se si veprojnë në të. Prandaj deri në një farë mase (por jo plotësisht), struktura është ajo çka vepruesit bëjnë me të. Le ta shpiem pak më tej këtë.

Për t’u vënë re në këtë kontekst është fakti se, ndërsa Kina ishte fuqia udhëheqëse përgjatë pjesës më të madhe të mijëvjeçarit të dytë, identiteti i saj e bëri të zgjidhte heqjen dorë nga imperializmi (siç e pamë në kap. 3). Është e vërtetë se identiteti i saj ishte hierarkik dhe Kina përfytyrohet si ‘Mbretëria e Mesme e civilizuar’ në dallim nga të gjitha racat e tjera të largëta të perceptuara si ‘barbare’. Por pavarësisht kësaj ngjashmërie sipërfaqësore, sistemi ndërkombëtar kinez i haraçit ishte tejet i ndryshëm nga imperializmi perëndimor. Siç e pamë hollësisht në kapitullin 3, sistemi i haraçit ishte më shumë vullnetar sesa i imponuar dhe, për

<sup>741</sup> E. P. Thompson, *The Poverty of Theory and Other Essays* (London: Merlin Press, 1978).

<sup>742</sup> Frank, *ReOrient*, fq. xvi, xxvi; Kenneth Pomeranz, *The Great Divergence* (Princeton: Princeton University Press, 2000); Marshall G. S. Hodgson, *Rethinking World History* (Cambridge: Cambridge University Press, 1993).

më tepër, shteti kinez kurrë nuk u orvat t'i konvertonte kulturalisht apo qoftë edhe t'i shfrytëzonte shtetet e saj të ashtuquajtura vasale.<sup>743</sup> Ky sistem ishte i dizenuar më shumë për t'i joshur 'vasalët' drejt Kinës, jo më së paku duke u ofruar atyre përfitime të konsiderueshme ekonomike. Së fundmi, identiteti i Kinës ishte më shumë një konstrukt mbrojtës i dizenuar për të ruajtur autonominë kulturore kineze përballë pushtuesve të mundshëm 'barbarë' (domethënë mongolëve) si dhe për të riprodhuar legjitimitetin e saj të brendshëm në sytë e popullatës së saj. Prandaj Kina zgjodhi t'i shmangej imperializmit, edhe pse ishte fuqia më e madhe në botë gjatë pjesës më të madhe të mijëvjeçarit të dytë.

Qëndrimi kinez ndryshonte radikalisht nga ai europian. Identiteti europian u bë gjithnjë e më i përkufizueshëm në terma imperialiste, duke filluar nga viti 1453 e me ritme të shpejta në shekujt e tetëmbëdhjetë e të nëntëmbëdhjetë. Në këtë periudhë të fundit, europianët kishin ndërtuar një Hendek të Madh midis Lindjes dhe Perëndimit. Përkufizimi i Lindjes si inferiore dhe e paaftë për vetëzhvillim dhe njëkohësisht përkufizimi i identitetit perëndimor si i pavarur, proaktiv dhe prindëror, natyrshëm e përshkroi imperializmin si një detyrë morale (misioni civilizues). Është absolutisht fakt se rreth vitit 1800, Perëndimi kishte arritur të udhëhiqte për sa i përket fuqisë materialo-ushtarake dhe ky jo më pak qartazi qe një faktor i rëndësishëm në kolonizimin e Lindjes. Por nuk kishte asgjë të pashmangshme për sa i përket rolit imperial që europianët zgjodhën të merrnin përsipër botërisht. E kemi parë këtë në lidhje me konceptimin e identitetit kinez. Përfundimisht europianët nuk zgjodhën ta ribënin botën thjesht ngaqë 'mundeshin' (siç pretendohet në shpjegimet materialiste), por sepse besonin

<sup>743</sup> Krahaso, David Abernethy, *The Dynamics of Global Dominance* (New Haven: Yale University Press, 2000), veçanerisht kapitullin 10.

se duhej ta bënin këtë. Çka do të thotë se aktet e tyre udhëhiqeshin në masë të madhe nga identiteti i tyre që e konsideronte imperializmin si një politikë të përshtatshme moralisht (siç shpjegohet në kap. 10). Shkurt, nuk ka një marrëdhënie të mirëqenë midis imperializmit dhe fuqisë superiore materiale, sepse ajo çka, ndryshe nga Kina, e bëri Europën imperialiste në fund, qe identiteti i saj specifik.

Megjithatë, asgjë nga këto nuk do të thotë se fuqia ose faktorët materialë janë të parëndësishëm. Sepse ato kanë rëndësi jetike. Përhapja (dhe përvetësimi) i burimeve materiale nga Lindja drejt Perëndimit, përbën një aspekt jetik të argumentit tim të përgjithshëm. Dhe për ta përsëritur, fuqia materiale qe një parakusht jetik për imperializmin britanik. Por çështja kritike që duhet vënë në dukje këtu është se fuqia materiale në përgjithësi dhe një fuqi e madhe në veçanti, kanalizohen në drejtime të ndryshme në varësi të identitetit specifik të vepruesit. Tani le të marrim në konsideratë gjenealogjinë e identitetit europian dhe se si ky i fundit ka përcaktuar dhe udhëhequr aktet e ndërmarra nga europianët dhe se si këto të fundit bënë të mundur ngritjen e Perëndimit oriental. Do të diskutoj çdo rresht të tabelës 13.1.

Në periudhën e hershme të mesjetës, europianët e konceptuan identitetin e tyre negativisht kundër Lindjes së Mesme islame. Islami u zgjodh si 'Tjetri' pjesërisht ngaqë Europa nuk kishte asgjë në vetvete që të mund të përdorej për të krijuar një identitet të vetëm. Çështja është se ky nocion negativ identitar çoi në ndërtimin e Krishterimit, i cili nga ana e tij luajti një rol të rëndësishëm si në konsolidimin e riprodhimin e sistemit feudal europian, ashtu dhe në nxitjen e kryqëzatave (1095-1291). Siç u shpjegua në kapitullin 5, pa këto ide të krishtera, struktura sociale tejet joegalitare e feudalizmit europian nuk do të kishte arritur të fitonte legjitimitet e fuqi dhe rrjedhimisht do të kishte shpërthyer

së brendshmi. Nëse do të kishte ndodhur kjo, Europa do të mund të kishte shkuar pas në Epokën e Errët (ndonëse po kaq të ngjarë ka që europianët t'i shpëtonte nga ky fat impakti energjdhënës i kapaciteteve tregtare e burimore lindore të cilat kishin depërtuar kryesisht përmes Italisë e Spanjës nga Ura Islame e Botës).

Pas vitit 1453, europianët katolikë u ndjenë veçanërisht në rrezik nga i ashtuquajtimi 'kërcënimi turk'. Siç e pamë në kapitujt 7 dhe 8, pikërisht kjo nxiti edhe 'raundin e dytë' të kryqëzatave pas 1492/1498-ës (iniciuar respektivisht nga Kolombi dhe De Gama).

'Përvoja amerikane dhe afrikane' që pasoi që jetike në konceptimin e identitetit europian. Me rëndësi kritike këtu që metamorfoza e botës së krishterë-europiane në Europën si Perëndim i përparuar (shih kap. 8). Ndërsa nën feudalizëm europianët ishin vetëpërkufizuar negativisht kundrejt Islamit, ky megjithatë mbetej një identitet i mbështetur në pasiguri. Pas shekullit të pesëmbëdhjetë, për herë të parë që pas vitit 500, europianët nisën ta përfytyronin veten si superiorë ndaj afrikanëve të zinj dhe amerikanëve vendas, të përfytyruar si të egër paganë. Tashmë po fillonte të shfaqej eurocentrizmi (edhe pse mbështetur mbi konceptime të ndryshme kristiane të dallueshmërisë). Ky qëndrim u dha europianëve vetëjustifikimin moral për të ndërmarrë përvehtësimin imperial të burimeve amerikane dhe mbishfrytëzimin e amerikanëve vendas si dhe, mbi të gjitha, të afrikanëve të zinj. Fillimisht, përfitimi madhor ekonomik nga plaçkitja e arit dhe argjendit, çka u dha mundësinë europianëve të financonin deficitin tregtar me Azinë si dhe të përfshiheheshin në këmbim valutor global. Në të njëjtën kohë, Europa Perëndimore nisi të kristalizohej si mishërim i qytetërimit të përparuar ndërkohë që europianolindorët, krahas turqve osmanë, nisën të përfytyroheshin si 'barbarë'.

Tabela 13.1 *Ndërtimi dhe pasojat e identitetit perëndimor*

Faza identitare	Vetija	Tjetri	Strategjitë përvetësuese perëndimore në botë
(1) 500-1453	Europa e ndërtuar si botë e krishterë	Lindja e Mesme islame dhe 'saraçenët' të konstruktuar si armiq dhe kërcënim i lig	Sulmimi i Islamit në 'raundin e parë' të kryqëzatave. Pa strategji përvetësimi (ndotëse kryqëzatat bënë të mundur përvetësimin e shumë burimeve të ndryshme mesolindore)
(2) 1453-1780	Europa e përfytyruar gjithnjë e më shumë si Perëndimi i përparuar	Islami (kryesisht turku osman) i konceptuar përmes Krishterimit si kërcënim armiqësor dhe barbar; afrikanët dhe vendasit amerikanë të konceptuar si 'paganë' ose 'të egër', dhe, kështu, 'të pjekur' për shfrytëzim e represion	Sulmimi i Islamit në 'raundin e dytë' të kryqëzatave, nisur nga Kolombi dhe De Gama Përvetësimi i metaleve të çmuara amerikane, çka financoi deficitin tregtar të Europës me Azinë dhe bëri të mundur fitimin nga këmbimi valutor përmes qarkullimit global të argjendit Përvetësimi i burimeve 'joeuropiane' përmes tregtisë së sklleverëve si dhe komifikimi e përvetësimi i krahut afrikan e amerikan të punës, çka në masë domethënëse bëri të mundur industrializimin e Perëndimit (e veçanërisht të Britanisë)
(3) 1780-1900	Europianët të përfytyruar si superiorë dhe bartës të qytetërimit të përparuar	E gjithë bota joperëndimore e përfytyruar si e banuar ose nga <i>të egër</i> inferiorë ose <i>barbarë</i> , dhe prandaj e pjekur për shfrytëzim/represion, si dhe për shndërrim kulturor sipas modelit perëndimor	Tregtia e sklleverëve (zyrtarisht deri më 1807 në Britani) dhe prodhimi i sklleverëve (zyrtarisht deri më 1833 në Britani, 1865 në SHBA, 1888 në Brazil) bëri të mundur industrializimin e Perëndimit, e sidomos të Britanisë Përvetësimi i tokave, krahut të punës dhe tregjeve afrikane e aziatike përmes imperializmit formal e informal, në masë domethënëse bënë të mundur industrializimin e Europës, dhe veçanërisht të Britanisë

‘Përvoja amerikane’ e periudhën 1500-1750/1780, përfaqëson fazën e tranzicionit nga ‘eurocentrizmi i krishterë’ i shfaqur rishtazi, në një konceptim të plotë të Europës si superiore mbi të gjithë pjesën tjetër të botës. Çka është kritike, pas vitit 1700 identiteti europian nisi të konceptohej përgjatë linjash raciste të nënkuptuara (deri rreth vitit 1840) dhe kriteresh të shkoqura raciste më pas. Pasojë e këtij rikonceptimi qe përshkrimi i imperializmit si detyrë morale (kap. 10). Por paradoksalisht, konceptimi i popujve lindorë si inferiorë bëri që shfrytëzimi dhe përvetësimi i burimeve të tyre (tokat, krahu i punës dhe tregjet) të paraqiteshin si diçka krejt e natyrshme apo legjitime. Kjo gjë nga ana e saj bëri të mundur në masë domethënëse industrializimin e Britanisë. Siç u shpjegua në kapitullin 11, kjo së pari përfshinte adoptimin e prodhimeve bujqësore tokëkursyese nga Amerikat si dhe garantoi furnizim me pambuk të papërpunuar përmes prodhimit nga skllëvërit e zinj. Së dyti, komodifikimi i punës së skllëvërve të zinj dha fitime të cilat e nxitën mjaft investimin në ekonominë britanike (çka e quaj ‘teza e raportit të lartë’). Së treti, skllavëria e zezë i dha një shtytje tejet të madhe kapitalit financiar të Britanisë. Së katërti, Ligjet për Lundrimin dhe imponimi i tregtisë së lirë në perandori bënë të mundur rritjen e eksporteve britanike, çka ushqeu zhvillimin industrial të Britanisë. Së pesti, britanikët e riorganizuan Lindjen në qendra të prodhimit të lëndëve të para industriale të cilat u përvetësuan dhe u shfrytëzuan në shërbim të nevojave industriale të Britanisë. Për t’u shënuar gjithashtu është se në këtë proces, shumë ekonomi lindore u mbajtën poshtë përmes ‘përmbajtjes’, duke ruajtur kësisoj udhëheqjen ekonomike të Britanisë. Së fundmi, imperializmi detyrimisht solli edhe orvatjen për ‘shndërrim kulturor’ (ndryshe etnocid) të Lindjes, ngaqë Perëndimi ndihej i kërcënuar prej së ashtuquajturës ‘deviancë kulturore lindore’.

Në rastet ekstreme, europianët zbatuan edhe genocid e apar-teid social.

Për ta përmbledhur, tri pika vlejné të vihen në dukje këtu. Së pari, qe shqetësimi racist i Europës më shumë se ‘shqetësimi racionalist’ ajo që bëri të mundur fazën e fundit të ngritjes së Perëndimit. Së dyti, lidhja e qartë midis thek-simit që i bëj strukturës globale dhe identitetit, qëndron në faktin se ky i fundit gjithnjë është konceptuar brenda një konteksti global. Ose, siç shprehet Edward Said-i: ‘Orienti është pjesë integrale e qytetërimit dhe kulturës *materiale* europiane’.<sup>744</sup> Së treti, supozimi eurocentrik i një logjike të hekurt europiane të përhershmërisë e cila e bën të pa-shmangshme ngritjen e Perëndimit, bëhet problematik nga fakti se pa plaçkitjen dhe shfrytëzimin e burimeve lindore – tokat, krahu i punës dhe tregjet – Europa nuk do të kishte arritur ta bënte kapërcimin në modernitetin industrial. Për më tepër, logjika eurocentrike e përhershmërisë lëkundet edhe nga fakti se Europa ka patur shumë fat në arritjen e këtij kapërcimi. Ose, siç e ka shprehur Michael Mann duke i bërë jehonë rëndësisë së rastësisë: ‘Kësisoj, zhvillimi i historik botëror ndodhi, por nuk ishte i ‘domosdoshëm’, rezultat teleologjik i një “shpirti të botës”, i “fatit të Nje-riut”, i “triumfit të Perëndimit” ... apo i çfarëdo prej këty-re’.<sup>745</sup> Atëherë, si e bëri të mundur rastësia ngritjen e Perën-dimit oriental?

### **Impakti i rastësisë në ngritjen e Perëndimit oriental**

Studiuesit e shquar antieurocentrikë Kenneth Pome-ranz dhe James Blaut theksojnë ‘rastësinë’ (ose aksidentin

<sup>744</sup> Edward W. Said, *Orientalism* (London: Penguin, 1991 [1978]), fq. 2, theksimi me kursiv është i imi.

<sup>745</sup> Mann, *Sources*, I, fq. 531.

fatlum) si faktor kritik në ngritjen e Perëndimit.<sup>746</sup> Në njëfarë kuptimi, ngritja e Perëndimit vërtet mund të shpjegohet thuasje plotësisht përmes rastësisë. Sepse europianëve vërtet u nevojitej shumë fat duke qenë se nuk kishin qenë as racionalë, as liberalo-demokratë dhe as gjenialë sa për t'i paraprirë në mënyrë të pavarur zhvillimit të tyre. I pari dhe ndoshta më i lumturi fat që u takoi europianëve qe se Lindja kishte arritur një zhvillim domethënës ekonomik përmes një kapaciteti shpikës, i cili do t'i furnizonte europianët me 'kapacitetet' e shumta 'burimore' mbi të cilat do të ndodhte ngritja e Perëndimit. Së dyti, sikur aziatikët të mos kishin krijuar një ekonomi globale, në mungesë të globalizimit lindor, shumë nga shpikjet e tyre më të avancuara thjesht nuk do të kishin arritur në Europë.

Një rastësi e tretë tejet fatlume është se shoqëritë më të fuqishme të Lindjes nuk u përpoqën ta kolonizonin Europën dhe ta përthithnin në orbitën e tyre kulturore (siç do të bënin europianët më vonë). Siç e vumë në dukje në kapitullin 2, mongolët hoqën dorë së pushtuari zemrën e Europës duke iu kthyer Kinës. Paradoksalisht, krijimi i Perandorisë Mongole qe një fat i madh për europianët, sepse ajo bëri të mundur përcjelljen e mallrave dhe të kapaciteteve burimore të Lindjes në Perëndim nëpërmjet rrugës veriore të ekonomisë globale (përmes Paqes Mongole). Gjithashtu në kapitullin 5 vumë në dukje se muslimanët nuk treguan interes për pushtimin e Europës Perëndimore mesjetare, edhe pse kryen shumë mësymje 'të pacipa' në kontinent. Për më tepër, siç u shpjegua në kapitullin 3, bekim për Europën qe vetëpërmbajtja e Kinës në kuptimin që kjo e fundit nuk zgjodhi ta universalizonte 'standardin e saj qytetërimor' përmes imperializmit. Trishtueshëm, vetëpërmbajtja dashami-

<sup>746</sup> Pomeranz, *Great Divergence*; Blaut, *Colonizer's Model*.

rëse e Kinës do të ndëshkohej rreth katërqind vjet më vonë nga fushata imperiale europiane e imponimit të drogës, e luftës dhe e mësymjes kundër vetë identitetit kinez (kap. 11).

Një rastësi e katërt fatlume, siç e thekson Blaut, që se Spanjës i ndeshi këmba në Amerikë, ku ari dhe argjendi ishin me bollëk (shih kap. 8). Kjo që jashtëzakonisht fatlume sepse Kolombi në fakt u nis për të arritur në Kinë, por përfundoi në Amerikë. Përndryshe do të kishte përfunduar duke i bërë temena perandorit kinez, një skenar ky mjaft i ndryshëm nga ai që u shpalos në Amerikë. Ose, siç e vë në dukje Fernandez-Armesto: 'Nëse do të kishte arritur në Japoni, Kolombi do të pritej si një i çmendur ekzotik, i përburzur ngaqë hante me gishta, kurse në Kinë do të pritej si një haraçsjellës primitiv i cili kish sjellë dhurata qesharake'.<sup>747</sup> Për më tepër, nëse do të kishte zbarkuar në Kinë, metalet e çmuara të Amerikës do të kishin mbetur në vend dhe duke patur parasysh se ç'rëndësi të veçantë patën ato në mundësimin e 'fazës së arritjes' të Perëndimit pas vitit 1500, kjo do të kishte qenë një goditje e rëndë. Për më tepër, siç shprehet James Axtell:

pa plaçkitjen e menjëhershme të arit dhe argjendit indian, pas udhëtimit të parë spanjollët [me gjasë] do të kishin hequr dorë nga Kolombi si një italian kokëkrisur dhe të zgjuar nga portugezët, do t'i kishin drejtuar energjitë e tyre ekonomike drejt Lindjes, drejt pasurive të vërtetuara të Afrikës, Indisë dhe Indeve Lindore.<sup>748</sup>

Por Axtell-i ndoshta gabohet në një drejtim. Sepse pa përvetësimin e arit dhe argjendit amerikan, europianët nuk do të mund ta kishin ruajtur as praninë e tyre modeste në Azi në periudhën 1500-1800 (duke qenë se kjo para financoi

<sup>747</sup> Felipe Fernandez-Armesto, *Millennium* (London: Black Swan, 1996), fq. 345.

<sup>748</sup> James Axtell, "Colonial America without the Indians: Counterfactual Reflections", *Journal of American History* 73 (4) (1987), 984.

tregtinë e tyre atje – shih kap. 7) dhe për rrjedhojë ‘nuk do të mund t’i kishin drejtuar energjitë e tyre ekonomike drejt Afrikës, Indisë dhe Indeve Lindore’. Tragjikisht, europianët gjithashtu patën fat që vendasit e Amerikës nuk kishin imunitet të mjaftueshëm kundër sëmundjeve euraziatike që u bartën atje dhe që e lehtësuan në masë të madhe procesin e kolonizimit europian. Me të njëjtin kriter, europianët po ashtu qenë tejet fatlumë që patën akses në fuqinë punëtore të skllëverve afrikanë dhe sidomos që patën sisteme imunitare të mjaftueshme për t’u rezistuar sëmundjeve euraziatike.

Një fat i pestë i përgjithshëm mund të përmbliidhet nën shpjegimin se, ‘europianët shpesh u ndodhën në vendin e duhur, në kohën e duhur’. Shembulli i Amerikave vjen sërisht në mendje. Por një tjetër shembull është se Kompania Angleze e Indisë Lindore u gjend në Indi pikërisht kur pushteti mogul nisi të shpërbëhej vetiu në fraksione të ndryshme rivale. Fakti është se anglezët fillimisht nuk e mundën Indinë me anë të fuqisë së tyre ‘të jashtëzakonshme’ ushtarake. Fitorja e ashtuquajtur heroike e Robert Clive-it në Plassey në vitin 1757 qe një rezultat fatlum, sepse ajo që e mposhti ushtrinë indiane nuk qe fuqia superiore ushtarake britanike, por një sërë përçarjesh fatale që shkakton shpartallimin e ushtrisë indiane në atë çka praktikisht qe një ‘puç fushëbeteje’.<sup>749</sup> Për më tepër, pas vitit 1757, britanikët arritën të siguronin një zotërim imperial vetëm duke i kundërvënë ndaj njëri-tjetrit fraksionet e ndryshme politike. Vetëm më vonë arriti artilleria europiane ta konsolidonte pushtetin britanik në Indi. Por nëse pushteti mogul do të kishte qëndruar që në fillim, në kurorën imperiale të Britanisë ndoshta nuk do të kishte patur një xhevahir indian. Veç kësaj, sikur indianët të mos qenë treguar dashamirës e

<sup>749</sup> Fernandez-Armesto, *Millennium*, fq. 365-367.

të mos e kishin mirëpritur Kompaninë e Indisë Lindore që në fillim të shekullit të shtatëmbëdhjetë, britanikët as nuk do të kishin gëzuar ndonjë prani atje dhe as nuk do të kishin mundur ta zgjeronin hapësirën e tyre të pushtetit pas shpërbërjes së vetvetishme të pushtetit mogul. Pjesa tjetër do të kish qenë histori.

Për t'i përmbledhur këto tri pika të fundit, tashmë mund ta shohim se historia e ngritjes së Perëndimit nuk mund të tregohet në terma të përhershëmrisë së strukturës sociale europiane. Skaji udhëheqës i fuqisë globale qëndroi në pjesë të ndryshme të Lindjes deri rreth vitit 1800. Midis viteve 500 dhe 1000, ky skaj i takonte Lindjes së Mesme. Rreth vitit 1100, 'lavjerrësi' nisi të luhatej drejt Lindjes, me Kinën që nisi të kryesonte për sa i përket pushtetit global intensiv dhe atij ekstensiv rreth shekullit të pesëmbëdhjetë. Pas vitit 1500, lavjerrësi nisi të kthehej shumë ngadalë sërisht drejt Perëndimit me europianët që nisën të angazhoeshin në imperializëm dhe njëkohësisht i intensifikuan lidhjet e tyre me Lindjen. Por vetëm shumë kohë pasi kishte filluar faza e industrializimit skaji udhëheqës i fuqisë intensive dhe ekstensive globale u zhvendos në Britani. Për fat të keq nuk mund ta dimë se Lindja do ta kishte arritur kapërcimin përfundimtar në industrializmin modern në mungesë të imperializmit perëndimor, sepse strategjitë e Perëndimit të përmbajtjes ekonomike e cunguan potencialin për rritje të shumë ekonomive lindore (ndonëse Japonia që një përjash-tim që e vërteton këtë duke qenë se u industrializua me sukses në mungesë të kolonializmit europian). Megjithatë, analogjia më e mirë për të kuptuar kapërcimin përfundimtar perëndimor është ajo me stafetën 400 metërshe. Sepse një gjë është e sigurt: se britanikët nuk do ta kishin kaluar kursesë të parët vijën e finishit sikur Lindja të mos i kishte

bërë tri etapat e para në kohë rekord. Ose, siç shprehet Jack Goody:

modernizimi është një proces i vazhdueshëm ku rajone të ndryshme kanë marrë pjesë me kërcime bretkose. Askush nuk zotëron tipare [shpikëse] unike të përhershme që do t'u bënin të mundur të shpiknin apo të adoptonin të vetëm ndryshime domethënëse siç qe Revolucioni Agrikulturor [ose Industrial].<sup>750</sup>

### Konkluzion

Tashmë mund të paraqes një vizion alternativ antieurocentrik të ca prej pikave kyçe në historinë botërore në pesëqind vitet e fundit që mendoj se duhet të përbëjnë fokusin kryesor të vëmendjes sonë analitike. Kjo njëkohësisht më jep mundësinë që t'i parashtoj në tabela disa nga argumentet kryesore të këtij libri dhe t'i ballafaqoj me rrëfimin eurocentrik (shih tabelën 13.2).

Vlen të vihet në dukje se autorë eurocentrikë si Roberts dhe Landes pretendojnë se ndryshe nga rrëfimi antieurocentrik, ai i tyre mbështetet vetëm në 'fakte empirike'. Siç shprehet Roberts, 'nëse flasim vetëm për fakte ... dhe jo për vlerën që u japim atyre, atëherë është mjaft me vend që ta vendosim Europën në qendër të historisë në kohërat moderne [domethënë pas 1500-ës]'.<sup>751</sup> Dhe pa dyshim David Landes do ta hidhte poshtë vizionin tim të historisë botërore siç e ka hedhur poshtë atë të Andre Gunder Frank-ut: si 'histori e keqe', 'eurofobike'<sup>752</sup> madje ndoshta 'oksidentaliste'. Në këtë kontekst të veçantë, goditëse janë fjalët e men-

<sup>750</sup> Goody, *East*, fq. 7.

<sup>751</sup> John M. Roberts, *The Triumph of the West* (London: BBC Books, 1985), fq. 201.

<sup>752</sup> David S. Landes, *The Wealth and Poverty of Nations* (London: Little, Brown, 1998), fq. 514.

çura të W. E. B. du Bois-së: 'duhet t'i bëjmë të qarta faktet duke e shpërfillur tërësisht dëshirën dhe besimin tonë. Ajo çka dimë, me aq sa mundemi, janë gjërat që ka ndodhur në botë'.<sup>753</sup> Sepse siç kam argumentuar në këtë libër – me ose pa vetëdije – eurocentrizmi nuk zgjedh faktet relevante sipas një 'objektiviteti shkencor', por vetëm ato 'fakte' që përzgjedhin Perëndimin dhe përjashtojnë Lindjen në rrëfimin progresiv të historisë botërore.

Kështu, vetëm pasi t'i lajmë hesapet me eurocentrizmin mund të fillojmë të përftojme një pamje më përfshirëse, empatike e të plotë të historisë botërore. Empatia nuk duhet përkthyer si 'mendim iluzionar' (siç mund të kundërshtojë David Landes). Empatia është jetike sepse na jep mundësinë për t'i tejkalar paragykimet shtrembëruese e përzgjedhëse të eurocentrizmit të cilat gabimisht na mësojnë ta injorojmë apo marginalizojmë Lindjen. Kërkimi historik empatik na jep mundësinë për ta rifituar atë çka George James me të drejtë e ka quajtur 'trashëgimi të vjedhur' të Lindjes,<sup>754</sup> duke ua rinjohur popujve lindorë statusin si vepues krijues e aktivë. Këtë e bëjmë jo sepse e dëshirojmë, por sepse siç e tregon me fakte ky libër, lindorët pa dyshim kanë qenë 'popuj me histori' të cilët kanë dhënë kontribut të rëndësishëm dhe kanë sakrifikuar në shumë mënyra për të bërë të mundur kapërcimin në kapitalizmin modern. Vetëm kur ta pranojmë këtë do të mund të ofrojmë një rrëfim të kënaqshëm për ngritjen e Perëndimit oriental.

Në dritën e tërë kësaj, vlen të perifrashohen fjalët e Henry Reynolds (një zë i shquar australian për ripajtimin me aborigjenët) të marra nga libri i tij *Black Pioneers*:

<sup>753</sup> W. E. B. Du Bois, *Black Reconstruction in America* (New York: Russell & Russell, 1935), fq. 722.

<sup>754</sup> George G. M. James, *Stolen Legacy* (New York: Philosophical Library, 1954).

Tabela 13. 2 *Dy vizione të momenteve kyçe në historinë botërore, rr. 500-1900*

	Eurocentrizmi	Antieurocentrizmi
733	Fitorja e Charles Martel-it mbi 'saraçenët' në Betejën e Tours dhe Poitiers	Fitorja e arabëve në Talas vendos dominimin islam në Azinë Qendrore Perëndimore. Osmanët pushtojnë Konstandinopojën (1453)
600-1000	Europa prin revolucionin mesjetar agrikorulturor	Kina zhvillon shumë teknologji që do të bënin të mundur revolucionin -500 agrikorulturor evropian në shekujt e tetëmbëdhjetë dhe nëntëmbëdhjetë
rr. 1000	Italianët fillojnë tregtinë e largët dhe kapitalizmin e hershëm, dhe Italia bëhet fuqia udhëheqëse globale	Italianët i bashkohen ekonomisë globale të udhëhequr nga afro-aziatikët. Globalizimi lindor bën të mundur përhapjen e 'kapaciteteve burimore' lindore që do të bënin të mundur zhvillimin e Perëndimit të prapambetur
Pas 1905	Kryqtarët evropianë marrin në kontroll Lindjen e Mesme islame	Italianët mbeten të varur nga Lindja e Mesme dhe Egjipti musliman
rr. 1400-1650	Rilindja dhe revolucioni shkencor italian	Rilindja lindore ose islame (e cila më vonë do të bënte të mundur rilindjen dhe revolucionin shkencor evropian)
1434	Kina tërhiqet nga bota duke lënë pas një vakuum që shpejt do të mbushesh nga evropianët superiorë	Kina mbetet e spikatur si fuqia kryesore tregtare e prodhuese e botës dhe arrin t'u rezistojë inkursioneve të Perëndimit si dhe t'u diktojë kushte tregtareve evropianë
1455	Gutenberg-u shpik	Pi-Sheng shpik shtypshkronjën e parë të lëvizshme

1487/8	shtypshkronjën e lëvizshme metalike Bartholome Dias arrin i pari 'Kepin e Stuhive'	rr. 200-1421	(1040); koreanët shpikin shtypshkronjën e parë të lëvizshme metalike (1403) Arabët lundrojnë rreth Kepit (rr. 1450) dhe arrijnë Europën përmes asaj rruge. Kinezët (rr. shek. 9), polinezianët (rr. shek. 3) dhe indianët arrijnë Kepin dhe brigjet lindore të Afrikës
pas 1492	Epoka e zbulimeve europiane dhe shfaqja e protokapitalizmit të hershëm perëndimor	rr. 500-1500/1800	Epoka e zbulimeve afro-aziatike; lindorët krijojnë dhe mbajnë gjallë ekonominë globale (dhe udhëheqin globalizimin lindor). Kinezët zgjedhin të mos iniciojnë imperializimin
pas 1492	Spanjollët plaçkisin arin dhe argjendin e Amerikave	rr. 1450	Kina fut në qarkullim një monedhë argjendi dhe si fuqia udhëheqëse tregare e prodhuese e botës krijon një kërkesë të fortë për argjendin e Europës të plaçkitur nga Amerikat
1498	De Gama vendos kontaktin e parë me një popull indian primitiv e të izoluar	pas 800	Indianët në kontakte tregtare me pjesën tjetër të Azisë; indianët janë superiorë ekonomikisht ndaj 'zbuluesve' të tyre portugezë. Shkencaat dhe teknologjitë kineze, indiane, ndoshta zezakoafrikane dhe me siguri muslimane, ofrojnë bazën për zhvillimin e anijeve dhe lundrimin portugez
1498-rr. 1800	Europianët i mposhtin aziatikët dhe monopolizojnë tregtinë botërore	1498-rr. 1800	Europianët nuk arrijnë t'i mposhtin aziatikët dhe mbeten të varur prej tyre për një thellë të tregtisë ndjellëse të Lindjes; vazhdon epoka afro-aziatike
1550-1660	'Revolucioni ushtarak' european	rr.850-1290	'Revolucioni ushtarak' kinez, elementet teknologjike të të cilit do të krijonin bazën për revolucionin

1700-1850	Ndodh mrekullia e parë industriale në Britani	600 p.e.s. - 1100	ushtarak të Europës Mrekullia industriale kineze. Përvetësimi i ideve dhe teknologjive kineze bën të mundur revolucionin industrial të Britanisë
1700-1850	Industrializimi britanik si triumf i ndryshimit të brendshëm ose të vetëgjeneruar	1700-1850	'Joeuropianët' (dhe sidomos afrikanët) japin kontribut domethënës në industrializimin e Britanisë me anë të përvetësimit dhe shfrytëzimit të burimeve të tyre të shumta
1853	Commodore Perry 'hap' Japoninë e izoluar Tokugawa: Japonia e Meixhi-t si vend me zhvillim të vonë industrializohet duke kopjuar Perëndimin	1603-1868	Japonia e Tokugava-s qëndron e lidhur me ekonominë globale. Zhvillimi i pavarur i kësaj dinastie siguron një trampolinë për industrializimin e mëvonshëm të Meixhi-t (Japonia si vend me zhvillim të hershëm)
vitet 1820	Britania përmbys deficitin tregtar me Kinën	vitet 1820	Britania arrin ta përmbysë deficitin tregtar me Kinën vetëm duke futur atje drogërat me forcë.
1839-1858	Luftrat e opiumit dhe marrëveshjet e pabarabarta 'e hapin forcërisht' dhe e shpëtojnë ekonominë e prapambetur kineze	rr. 850-1911	Kina mbetet e hapur ndaj tregtisë botërore dhe arrin zhvillim të konsiderueshëm ekonomik gjatë kësaj periudhe

Ndoshta arsyeja më e fortë për shkrimin e një libri për pionierët [afro-aziatikë] që të kuptuarit se ata kanë dhënë një kontribut të madh në zhvillimin [e Perëndimit], kontribut që nuk është pranuar kurrë ndershmërisht apo plotësisht. Duket se legjenda [e pionierit perëndimor] ... ka qenë aq qendrore në zhvillimin [e identitetit dhe teorisë perëndimore për ngritjen e Perëndimit] sa pionierëve [lindorë] nuk u është lënë asnjë hapësirë në ligjërim. Nëse do të përfshiheshin, ata do ta ndërlikonin historinë, do ta rrëzonin heroizmin e bardhë dhe do ta zbehnin lavdinë. Nëse do të tregohej se [‘jo të bardhët’] kanë shfaqur të njëjtat [ose më të larta] aftësi e cilësi me të bardhët ... atëherë roli i pionierëve [të bardhë] do të zbehej dhe [shkëlqimi] i tyre do të vihej në pikëpyetje. Një hulumtim i mëtejshëm do të mund të shpinte në përfundimin se [Perëndimi] i detyrohet shumë ‘djaloshit zezak’ të paemër i cili i ka prirë ... [Perëndimit] dhe ia ka treguar pikat e holla të [zhvillimit].<sup>755</sup>

Një nga qëllimet kryesore të këtij libri ka qenë të kryejë pikërisht ‘një hulumtim të mëtejshëm’, rezultatet e të cilit i shpalosin lindorët deri tani anonimë, të cilët i kanë prirë kapitalizmit global pas vitit 500 dhe njëkohësisht kanë ndihmuar në zhvillimin e Perëndimit.

Në fund, këtu vlejné të citohen fjalët e të ndjerit Edward Said në parathënien e vitit 2003 të librit të tij të ribotuar, *Orientalism*:

Më shumë se në përplasjen e sajuar të qytetërimeve, na duhet të përqendrohemi në bashkëpunimin e ngadaltë të kulturave që mbivendosen, huazojné prej njëra-tjetrën dhe bashkëjetojnë ... Por për [këtë] lloj perceptimi më të gjerë na duhet kohë dhe hulumtim durimtar e skeptik, mbështetur në besim tek komunitetet interpretuese që

<sup>755</sup> Henry Reynolds, *Black Pioneers* (London: Penguin, 2000), fq. 9-10.

janë të vështira për t'u mbajtur në këmbë në një botë që kërkon veprim dhe reagim të menjëhershëm.<sup>756</sup>

Ky vëllim është përpjekur të ofrojë pikërisht një analizë të tillë. Veç kësaj, e mbështes plotësisht thirrjen e Said-it për zhvillimin e mëtejshëm të analizave empatike që e kundërshtojnë bipolarizmin e konceptuar të Lindjes dhe Perëndimit bashkë me politikat raciste që e shoqërojnë shpesh, jo më së paku ngaqë njerëzia e globit nuk kërkon asgjë më pak se kaq. Sepse, duke rizbuluar të kaluarën tonë globalo-kolektive, bëjmë të mundur një të ardhme më të mirë për të gjithë.

<sup>756</sup> Edward W. Said, Preface (2003), te *Orientalism* (London: Penguin, [1978] 2003), fq. xxii.



## INDEKSI

### A

A. J. Christopher, 321-2  
 Abraham Cresques, 202  
 Abraham Udrovitch, 173  
 Adam Ferguson, 317  
 Adam Smith, 86, 102, 170-3, 334,  
 352, 358, 368, 388, 391  
 Afro-Azia, 114, 409, 413  
 Ahmed ibn Mexhidi, 44, 192, 197,  
 203, 205  
 Akti i Lundrim, 367  
 Alec Hargreaves, 373  
 Alfred Crosby, 238  
 Ali Mazrui, 313  
 Althusser, 414  
 Alvarez Semedo, 91, 277, 283  
 Amalfi, 405  
 Andre Gunder Frank, 20, 38, 95,  
 118, 211, 226, 410-1, 425  
 anglicizimi i botës, 352  
 Angus Maddison, 89, 114, 143, 345  
 aparteidi intelektual, 28, 306, 383  
 aparteidi social, 231, 330, 375, 420  
 Arnold Pacey, 129, 182, 259, 284,  
 293, 349, 411  
 asfiksi despotike, 273  
 Ashin Das Gupta, 101, 119, 123-4,  
 219  
 asirianë, 154  
 At de Magaillans, 275  
 Australinë aborigjene, 62  
 avarët, 150, 153  
 Avner Offer, 379  
 Azia Juglindore, 11, 56, 66-7, 70, 79,  
 96, 98, 101, 112-3, 120, 130, 208,  
 221, 277

### B

Bagdadi, 11, 67-8, 71, 76-7, 162, 182,  
 186, 222, 243-4  
 Balducci Pegoletti, 185  
 Banka Barclays, 365  
 bankierësh ruralë, 138  
 Bartholome Dias, 196  
 Benjamin Disraeli, 325  
 Benjamin Kidd, 325  
 Bernard Lewis, 161, 211, 243  
 Blumenbach, 319  
 Bonaparti, 27  
 Bossuet, 273  
 bota islame, 65, 71, 77, 182, 211, 243  
 Britania e Lindjes, 133  
 Bryan Turner, 25  
 Buhara, 68  
 burokracia racionale, 308  
 burokracia moderne, 388

### C

Callinicus, 261  
 Carl Linnaeus, 319  
*cartaz*, 99, 214  
 Chamberlai, 324-6  
 Charles Boxer, 213  
 Charles Dickens, 329  
 Charles Kingsley, 304, 324, 360  
 Charles Martel, 153, 160, 161  
 Charles Tilly, 58, 258  
 Chaudhuri, 131, 209, 348  
 civilizimi i zi, 253  
 Coalbrookdale, 291, 296  
 Colbert, 276, 332, 389  
*commenda*, 63, 172, 174, 175, 407  
 Commodore Perry, 132, 142

**Ç**

çezaropapizmi, 39

**D**

Da Vinci, 10, 191

David Landes, 20, 42, 96, 114, 188,  
256, 266, 425, 426

De Gobineau, 304

de Las Casas, 229, 230

demokracia politike, 17, 392, 396

despotizmin francez, 323

despotizmit oriental, 5, 27, 33, 38-9,  
54, 108, 113, 120, 122-3, 125,  
128-9, 132-3, 139, 183, 309, 314,  
316, 318, 383, 392, 396

detyra morale, 315-6, 328-9, 360,  
415, 419

Diogo do Couto, 197

djerria irracionale intelektuale, 254

dogma orientaliste, 46-7

Dorian Gray, 50

Du Bois, 22, 31, 67, 69, 70, 225, 237,  
252-3, 426

Dugald Stewart, 334

**E**

E. P. Thompson, 414

Edward Gibbon, 160

Edward Said, 25, 159, 307, 327-8,  
331, 420, 430

ekonomia feudale, 150, 152

ekzegjeza, 233

el-Biruniu, 251

el-Buzajaniu, 245-6

el-Farabiu, 247, 249

el-Fazariu, 176

el-Idrisiu, 251

el-Jakubiu, 67

el-Kazviniu, 186

el-Khuarezmiu, 176, 245-6, 251

el-Kindiu, 245, 247

Eric Jones, 12, 71, 73, 87, 134, 137,  
267, 301, 372

Eric Wolf, 18, 29, 409, 412

er-Raziu, 247, 249

esencializmi, 413

etatizmi sovran', 333

etika, 39, 226, 402

etjeje kulturore, 412

etnocid, 352, 361, 419

et-Tusiu, 11, 247

Eurazia, 62, 74, 103, 238, 397

eurocentrizmi, 19, 21, 25, 41, 42,  
46-7, 50, 53, 55, 68, 74, 84, 87, 91,  
94, 96, 125, 172, 183, 257, 278,  
286, 368, 351, 383-4, 392, 396-400,  
403, 408, 417, 419, 426

eurocentrizmi i krishterë, 419

**F**

Felipe Fernandez-Armesto, 74, 107,  
225, 359, 422

Fernand Braudel, 71, 108, 169, 209,  
211, 275, 348, 350

Fernandez-Armesto, 422-3

feudalizmi europian, 5, 34, 147-8,  
152, 416

Fiçino, 10

Flynn, 95, 102-3, 141

Francesca Bray, 89, 272, 278, 280

Francesco di Giorgio Martini, 94

Francis Bacon, 90, 225

Frederic Lane, 94

Frederiku i Madh, 11

Friedrich List, 332, 334, 358-9, 374

Friedrich Wilhelm, 386

**G**

Galeni, 249

Galia, 162

- Geimenschaft*, 65  
 George Frederickson, 233-4, 303  
 George Orwell, 320  
 Gerald Tibbetts, 181, 203  
 Gerard Delanty, 167, 303  
 Gerardi i Cremona-s, 246, 249  
*Gesellschaft*, 65  
 Gliddon, 324  
 Grover, 121-2, 128
- Gj**  
 gjenocidi 'paqësor', 375
- H**  
 Hegeli, 35  
 Henry Bessemer, 291  
 Henry Reynolds, 374, 426, 430  
 Hermes Trismegistus, 251  
 historia progresive, 9, 18, 31  
 Hottentot, 320  
 Hugh Honour, 185, 271  
 hunët, 151, 155
- I**  
 Ibn en-Nefis, 249  
 Ibni Battuta, 68-9  
 Ibni el-Hejthemi, 246  
 Ibni Haldun, 113, 401  
 Ibni Kurradhbih, 71  
 Ibni Rushdi, 247  
 Ibni Shehrija, 180  
 Ibni Sina, 247, 249  
 I-Çing, 71  
 identitetformimi europian, 164  
 identiteti europian, 9, 23, 25, 48-9,  
 148, 157-8, 167, 241, 305-6, 311,  
 328-8, 410-2, 416-7, 419  
 iluminizmi oriental, 269  
 imagjinata eurocentrike, 386  
 Immanuel Wallerstein, 38, 47, 413  
 imperializmi, 6-7, 9, 19, 28, 43, 49,  
 120, 195, 302-5, 307-8, 315-6, 324,  
 326, 328-9, 331-2, 342, 351, 353,  
 355, 374, 376, 377, 379, 410, 412,  
 414-6, 419, 421, 424  
 industrializmi britanik, 6, 113, 129,  
 264, 269, 279, 332-4, 344, 350-1,  
 360-4, 366, 370-1, 376, 391  
 imperializmi kontinental, 342  
 industrializimi ushtarak, 336  
 Indokina, 100  
 Inkuizicioni Spanjoll, 228  
 intervencionizmi shtetëror, 335,  
 344, 376-7, 380, 391  
 islamizimi ekonomik, 62  
 izolacionizmi qytetërimor, 54  
 izolacionizmi indian, 120
- J**  
 Jack Goody, 20, 61, 127, 173, 175,  
 200, 244-5, 403, 405, 425  
 Jacques Gernet, 84, 104, 186, 243  
 Jacques Le Goff, 80  
 James Axtell, 422  
 James Blaut, 40, 303, 392, 412, 420  
 James Brindley, 299  
 Jan Carew, 238  
 Janet Abu-Lughod, 57, 59, 73, 412  
 Japonia, 11, 56, 96, 99, 112-4, 116-8,  
 120, 132-4, 136, 139-43, 221, 229,  
 349, 353, 378, 424  
 Jethro Tull, 282, 284  
 João II, 199  
 Johann Gutenberg, 254-5  
 John Bowring, 353  
 John Mackenzie, 307  
 John Roberts, 20, 192, 239, 281  
 John Thornton, 236  
 John Wilkinson, 286, 290, 296  
 Joseph Inikori, 348, 365

- Joseph Needham, 83, 85, 92, 94, 151, 153, 177, 184, 187, 197, 199, 247, 249, 259, 281, 290, 292, 298, 411
- Joshinobu Shiba, 88
- junkerë, 386-7
- Justiniani, 179
- K**
- kalorës të Krishtit, 163
- Kanaani, 233, 245, 321
- Karl Wittfogel, 33
- Kasimbazari, 129
- Kenneth Pomeranz, 20, 104, 109, 117, 175, 285, 287, 348, 365, 414, 420
- Kina, 11, 23-4, 32, 43-6, 53, 55-6, 59, 60-2, 66-8, 70-1, 74, 76, 79-82, 84-5, 88-91, 94-7, 99-112, 114-7, 119-20, 130, 139-42, 151, 153, 155, 168-70, 174, 177, 183-7, 190-1, 202, 207, 209, 218, 221, 227, 229, 240, 255-7, 259-60, 264, 267-77, 280-5, 287-92, 294-8, 300, 302, 311, 318, 338, 345, 353-6, 371, 374, 402-4, 407-8, 414-6, 421-2, 424
- kirâd*, 63, 173
- komodifikimi i popujve, 370
- komunalizmi primitiv, 34
- konfluence globale, 411
- Konfuci, 270, 272
- Konstandinopoja, 77, 161, 194, 397
- kontributi kulturor, 253
- konvertimi kulturor, 231, 330
- Koperniku, 11, 250
- Kordova, 162, 203, 246
- Krishterimi Perëndimor, 233
- Kristofor Kolombi, 18, 48, 227
- kriza kejezeiane, 377
- kryqëzatat mesjetare, 48
- Kur'ani, 64, 187, 188
- Kushtetuta Amerikane, 392
- L**
- Laurens Coster, 255
- legjenda e zezë, 238
- Leibniz, 271, 276
- Levanti, 172
- Li Çhun, 191
- liga qytetërimore, 7, 308, 328
- Lindja regresive, 35, 40
- Lindja e Mesme islame, 10, 163, 416
- Lord Carnarvon, 327
- Louise Levathes, 107
- Luftrat e Opiumit, 354, 371
- Luigji XIV, 11, 276, 385, 386, 389
- Luther, 192, 247
- Lynn White, 43, 150, 177-8, 189, 261, 290, 406
- LI**
- llumi eurocentrik, 413
- M**
- Madagaskari, 69, 197
- Maeterlinck, 320
- Magellan, 204
- magiarë, 155
- Mahatma Gandhi, 332
- Malabari, 98, 208, 213
- Manueli I, 221
- Marc Bloch, 152, 161, 165
- Marie Boas, 242, 254
- Marko Polo, 68, 74, 80, 88, 91-2, 190-1, 228-9, 275, 298
- marksizmi, 19-20, 31, 35
- Marshall Hodgson, 24-5, 53, 66, 267
- Marsilio Ficino, 253
- Martin Bernal, 19, 251, 272-3, 312-3, 397
- Matthew Paris, 75
- Maxime Rodinson, 63-4, 66, 158, 162-3

- mbrojtje imperiale, 378  
 Meilink-Roelofsz, 131, 210  
 Melaka, 98, 130, 208, 210, 215-6  
 merkantilizmi regresiv, 140  
 Mesdhe, 44, 67, 130, 178, 197  
 metoda eksperimentale, 251  
 Mezopotamia, 76  
 Michael Clapham, 255  
 Michael Edwardes, 75, 190-1, 194, 242, 274, 318  
 Michael Faraday, 293  
 Michael Mann, 12, 54, 166, 255, 387, 404, 410, 420  
 misionarë jezuitë, 88  
 misioni civilizues, 6, 49, 254, 302, 304-5, 315, 321-2, 327-8, 330-1, 352, 373, 376, 415  
 misioni civilizues imperial, 6, 254, 302-4, 315, 328, 331  
 miti i Vasko de Gamës, 44  
 mitndërtimi, 386  
 mjeshtra, 83  
 moderniteti, 18, 27, 29, 34, 37, 40, 42-3, 133, 191, 294, 315, 329, 398, 409, 411, 420  
 moderniteti kapitalist, 27, 29, 34, 37, 40, 42-3, 191, 398, 409, 411  
 Mongoli, 150  
 Montaigne, 271, 317  
 Montesquieu, 273, 309, 317  
 Mrekullia kineze, 82  
 mrekkullia europiane, 30  
*mudaraba*, 173  
*mukârada*, 173  
 Muslimanë arabë, 63, 153  
 mutezilitët, 247  
 Muzafar Alam, 122
- N**  
 Napoleoni, 340, 345, 347
- Needham, 92-4, 151, 180-1, 184, 188-91, 199, 202, 205, 250, 257, 259, 260, 262-3, 289-90, 292, 299, 411  
 Nigel Harris, 61  
 Noel Swerdlow, 250  
 norma patrimoniale, 388
- O**  
 Oksidenti, 37-8, 267, 312  
 Oksidenti helen, 312  
 Olaudah Equiano, 235  
 Oliver Goldsmith, 274  
 Oliver Kromuelli, 11  
 Orienti, 38, 77, 80, 242, 303, 311, 328, 420  
 Orlando Patterson, 236  
 Osaka, 137, 138  
 Oscar Wilde, 50  
 Ostrogotë, 155
- P**  
 Pallati i Kristaltë, 298  
 Papa Inocenti III, 158  
 Papa Nikola V, 195  
 Papa Nikola IV, 78  
 Paqeja Mongole, 421  
 Patricia Springborg, 396  
 Patrick O'Brien, 351, 368-9  
 Paul Bairoch, 114  
 Paul Kennedy, 379  
 Pax Britannica, 332, 340, 342, 379  
 Pax Mongolica, 74, 76  
 perandoria informale, 327, 330  
 perandoria koloniale, 320, 322, 330  
 perandoria umejade, 61  
 Perëndimi, 5-7, 10-1, 17-33, 35-45, 47-50, 53, 58-9, 62, 65, 68, 70, 73-6, 82, 91, 94, 113-4, 116-7, 120, 137, 143, 145, 148, 153, 163-4, 167, 172, 174, 182, 189, 191-2, 199, 223,

- 225, 228, 232, 239-41, 243-4,  
248-9, 254, 257, 259, 263, 265, 269,  
275, 278, 282, 292, 297-8, 302,  
306-7, 309, 314-6, 328-33, 353,  
361, 381, 383-4, 390, 392, 396-400,  
402-3, 405-6, 408-13, 415-7,  
419-22, 424, 426, 430, 431
- Perëndimi oriental, 5-6, 9, 17, 19, 23,  
42, 50, 397, 398, 405, 411, 416,  
420, 426
- Perry Anderson, 55, 95, 156, 266
- persë, 153, 173, 179, 181, 184, 197,  
405
- persë, 63
- Peter Golas, 109, 288
- Peter Mathias, 265, 334-5, 347
- Philip Curtin, 61, 99, 317
- Pi Sheng, 256
- Pierre Charron, 317
- pionieri italian, 169
- Pirenne, 61-2
- Pitagora, 245
- Piter Pani, 27, 37, 309, 314-6
- Pjetri i Madh, 191
- pogrome, 201
- Poitiers, 160-1
- politika imperiale, 107
- popujt negroidë, 22
- Procopius, 178
- projeksioni Peters, 24
- proletariati perëndimor, 34
- propaganda abolicioniste, 234
- proteksionizmi britanik, 321, 338
- protoglobalizimi, 192, 196
- protokapitalizmi, 148
- provincializmi, 17
- Prusia, 386
- Ptolemeu, 243, 246, 251
- pushtimi tartar, 75
- Q**
- qytetaria politike, 394
- qytetërimi britanik, 352
- qytet-shteteve italiane, 62
- R**
- R. Bin Wong, 87
- Racizmi shkencor, 320
- Rana Kabbani, 158, 159
- Randall Collins, 36
- Retzius, 319
- Revolucioni Francez, 392
- revolucionari shkencor, 10
- revolucionari agrikulturor, 29, 45, 89,  
147-8, 150, 269, 272, 279-80, 285
- revolucionin financiar, 172, 344, 406
- Revolucioni Francez, 386
- revolucionari shkencor, 29, 45-6, 248,  
251-2, 254, 407
- Rheims, 162
- Richard Bowen, 179
- Robert Clive, 423
- Robert Curzon, 257
- Robert Hartwell, 82, 108, 287-8
- Robert Holton, 59, 164
- Robert Huttenback, 378
- Robert i Ketton, 246
- Robert Knox, 304, 324-5
- Robert Temple, 86, 89, 185, 280-1,  
289
- Rodzinski, 98
- Roger Bacon, 259
- Roger Williams, 231
- rokoko, 270
- Ronald Hyam, 274, 311, 353, 370
- Rudyard Kipling, 28, 316
- Rusia autokratike, 336
- Rr**
- reziku, 47, 157, 162, 192, 234

rreziku sovjetik, 162  
 Rruga e Mëndafshit, 74, 153, 211

## S

Salahuddin el-Ejjubi, 262  
 Samir Amin, 19, 306  
*samurai*, 135-6  
 Satoshi Ikeda, 140-1  
 Semerkand, 68, 76  
 Sepulveda, 230  
 skllëvër të zinj, 234-5, 240, 363-7,  
 370, 419  
 Smoot-Hawley, 389  
 Spanja muslimane, 65, 183, 185-7,  
 189, 202, 244-5  
 Stanley Engerman, 361, 369  
 Su Tzu-Jung, 188  
 Sumatra, 70, 100, 130  
 Sumerët, 173  
 Susan Hanley, 117, 134

## Sh

Shën Agusti, 253  
 shoqëria civile, 38, 385, 392  
 shovinizmi kontinental, 397  
 shqetësimi racional, 193, 226, 402,  
 412, 420  
 shtete despotike, 54  
 shtete irracionale, 391  
 shteti intervencionist, 334, 344  
 shteti minimalist, 388, 391  
 shtypshkrimi kinez, 256

## T

Tebriz, 260  
 teknologjia kineze, 267, 274  
 tekste hermetike, 250, 253  
 teologjia racionale, 247  
 teorie dominoje, 160, 162  
 Timothy Dwight, 231

Tokugava, 132-43  
 Tomé Pires, 168, 216  
*Träger*, 414  
 Traktati i Vestfalisë, 10  
 Tregtarë aziatikë, 219  
 tregtia e lirë, 339, 342, 352, 389  
 tregtia transatlantike, 366  
 tregtia e lirë, 341-3, 349, 352-4,  
 357-8, 388-9, 419  
 Turnip Townshend, 285  
 Turqia, 188, 302, 371

## Th

Theodore Roosevelt, 395  
 Thomas Carter, 186, 258  
 Thomas Newcomen, 286

## U

Ura e Botës, 53, 79  
 Ura Islame e Botës, 406, 417

## V

Van Santen, 122, 124, 217-8  
 Vasko de Gama, 11, 44, 48, 196, 198,  
 200, 205, 227  
 veberianizmi, 19-20, 35

## Xh

*xihad*, 64, 66, 160  
 Xhingis Hani, 74

## W

W. S. Jevons, 373  
 Walt Rostow, 133, 265  
 William Blake, 323  
 William Dampier, 318  
 William Gladstone, 343  
 William Harvey, 249  
 William McNeill, 60, 243  
*wu-wei*, 272

CIP - Каталогизација во публикација  
Национална и универзитетска библиотека  
"Св. Климент Охридски", Скопје

CIP - katalogu në publikim  
Biblioteka Kombëtare Universitare  
"Shën Kliment Ohridski", Shkup

316.7:008(1-11+1-15)  
008(1-11+1-15):316.7


HOBSON, John M.  
Origjinat lindore të qytetërimit perëndimor / John M. Hobson;  
e përktheu nga anglishtja Bujar M. Hoxha. - Shkup: Logos-A, 2018.  
- 440 стр.; 21 см. - (Biblioteka Lexo)

Превод на делото: The Eastern origins of Western civilisation / John M. Hobson.  
- Фусноти кон текстот

ISBN 978-9989-58-719-1

а) Источна и западна цивилизација - Социокултурни аспекти  
COBISS.MK-ID 106913802

**www.logos-a.com**  
Copyright©Logos-A, 2018



LOGOS·A